
بسم الله الرحمن الرحیم

IMAM KHOMEINI

USHTRITË E ARSYES E TË INJORANCËS

TIRANË, 2016

Titulli: **Ushtritë e arsyes dhe të injorancës**

Autori: ***Imam Khomeini***

Recensent: ***Vullnet MERJA***

E përktheu nga arabishtja: ***Haxhi Selim STAFA***

E redaktoi: ***Jerida KULLA***

Korrektura teknike: ***Sonila QAZIMI***

Përkujdesja grafike: ***Sabrie FEZA***

Kapaku: ***Sabrie FEZA***

Botoi: ***Shoqata "FLLADI"***

Copyright: ***Shoqata "FLLADI"***

Botimi i parë, 2015

Tirazhi: 1000

Shtypshkronja e shtëpisë botuese ***LILO***

Ky liber është botuar në bashkëpunim me Qëndrën Ndëkombëtare të Predikimit.

Me emrin e Allahut të Gjithmëshirshmit Mëshirplotit

IMAM KHOMEINI, LIDER I PAHARRUAR

Në Kur'anin e shenjtë, në suren Muxhadele, ajeti 11, lexojmë: **"Allahu do t'i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija."**

Gjithashtu, në suren Fatir, ajeti 28 lexojmë: **"Në të vërtetë, nga robtë e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.**

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *"Dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve."*

Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *"Dijetari është gjallë edhe nëse ka vdekur, kurse injoranti është i vdekur edhe nëse është gjallë."*

Në këto dy ajete të Kur'anit të shenjtë, e në ajete të tjera, në këtë thënie të profetit tonë të dashur dhe në thnien e prijësit të besimtarëve, ima Aliut (paqja qoftë mbi të!) duket qartë pozita e lartë e dijetarëve. Gjithashtu, nëpërmjet tyre kuptohet se dijetarët e devotshëm janë të pavdekshëm.

Është privilegj i madh që të marrësh pjesë në përkujtimin e dijetarëve të mëdhenj si imam Khomeini (Allahu ia shenjtëroftë të fshehtat!), të cilin do ta quaja pa asnjë ekzagjerim flamurtar të vijës së vulës së proftëve, profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dhe të Ehli Bejtit të tij të pastër.

Të nderuar lexues:

Nuk është e lehtë të flitet për imam Khomeinin, ashtu si nuk është e lehtë të vlerësohen veprat dhe mendimet largpamëse të atyre që kanë bërë histori në këtë jetë. Ata që arritën majat e historisë, bënë punë madhështore duke lënë gjurmë të paharrueshme në çdo kohë. Një prej atyre gjurmëlënësve të paharruar është edhe imam Ruhullahu el Musauij el Khomeini (Allahu qoftë i kënaqur me të!)

Çdokush që dëshiron ta përshkruajë personalitetin e imam Khomeinit, nuk di nga t'ia fillojë dhe si ta paraqesë figurën e ndritur të tij sepse, dituria, largpamësia, urtësia, vendosmëria e lartë dhe devotshmëria e imam Khomeinit ishin ato që karakterizonin personalitetin e tij.

Ata që studjojnë jetën e imam Khomeinit do të shohin qartë se ky njeri i lartë ka kaluar nëpër etapa shumë të rëndësishme të edukimit të vetes. Ka kaluar rrugë nëpër të cilat shumë pak i kanë shkelur ato. Kalimi i këtyre rrugëve bënë që imami të shkruajë edhe librin "Mposhtja e egos", që është botuar edhe në gjuhën shqipe, i cili përmban këshilla dhe porosi të vyera për të gjithë njerëzit dhe jo vetëm për besimtarët myslimanë sepse konflikti intelekt-ego gjendet tek të gjithë njerëzit. Vetë jeta e tij shumë e thjeshtë dhe larg luksit, edhe pse në dorën e tij ishin të gjitha pallatet mbretërore, është dëshmuese e gjallë e shpirtit të tij të ndritur nga devotshmëria, pastërtia, mistika e vërtetë, etj.

Cilido që e lexon, e studion dhe e analizon jetën e Imam Khomeinit, do të konkludojë se ai ishte një reformator i madh i cili ndikoi në zgjimin dhe reformimin e shoqërisë islame jo vetëm në Iran por edhe në botë. Këtë e kanë konfirmuar miqtë dhe armiqtë e tij.

Imam Khomeini me thirrjen e tij arriti të c'rrënjosë sistemin djallëzor dhe t'i zgjojë muslimanët nga pavetëdija dhe neglizhenca duke mbjellë në shpirtërat e tyre fuqinë dhe vetbesimin.

Imam Khomeini ishte një e vërtetë të cilën shumë mendje nuk arrijnë ta përceptojnë. Me thirrjen e tij dhe me revolucioni e tij, ai arriti të ringjallë identitetin islam në mesin e muslimanëve brenda dhe jashtë Iranit.

Roli i imam Khomeinit në kundërshtimin e dhunës dhe të shtypjes, qoftë e brendshme apo edhe e jashtme, ishte vendimtar dhe dëshmoi fuqinë e lidershipit islamik.

Imam Khomeini për të ringjallur mësimet e fesë islame ndoqi rrugën e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), e cila bazohej në besimin te Zoti Një i Vetëm e i Pashoq dhe në devotshmëri.

Për këtë ai ka thënë: ***'Është detyrë e jona që t'i thyejmë muret e injorancës dhe të legjendave, me qëllim që të arrijmë në burimin e kthjellët të Islamit origjinal që solli Profeti Muhammed*** *(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Jo vetëm populli iranian por të gjithë të privuarit në mbarë botën, në fytyrën e ndritur të imam Khomeinit panë seriozitetin dhe besnikërinë. Këto veti të larta të imamit bënë që shumë e shumë njerëz nga vende të ndryshme të botës ta duan, ta respektojnë dhe të shkruajnë për personalitetin e tij të lartë.

Zonja Haxher Sinsovat, një myslimane e re nga Ishulli Mindanao në Filipin thotë: 'Në përvjetorin e fitores së Revolucionit Islamik të Iranit, kur e pashë në televizor fotografinë e Imam Khomeinit (kds) duke u falur poshtë pemës, devotshmëria dhe përulja e tij më tërhoqën aq shumë saqë vendosa të studioj jetën dhe veprat e këtij njeriu, sepse doja të dija nga buronte spiritualiteti dhe devotshmëria e tij. Unë mendoj, vazhdon zonja Haxher- se Imam Khomeini e ringjalli sunnetin e Profetit në kohën kur thuhet islami perëndimor dhe islami arab. Imam Khomeini ua prezantoi njerëzve Islamin e vërtetë, i cili ishte Islami që solli Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)."

Ajetollah Khamenei, Lideri Suprem i Revolucionit Islamik, thotë: 'Revolucioni që udhëhoqi imam Khomeini është manifestim i mësimeve madhështore të Profetit Muhamed. Mesazhi i Revolucionit Islamik është respektimi i lirisë së mendimit dhe pavarësia e popujve të botës. Ky mesazh bazohet në mësimet e ndritura të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), i cili i fali njerëzimit dinjitet, nder dhe krenari.'

Imam Khomeini i prezantoi botës pamjen më të çiltër të Profetit islam. Tek imam Khomeini myslimanët panë moralin, adhurimin dhe prijësinë e Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe të imamëve prej familjes së tij të pastër e të dlirë.

Të nderuar lexues:

Nëse duam të njihemi me ndokënd, patjetër duhet të njohim mendimet dhe idetë e tij. Po ashtu ndodh edhe me imam Khomeinin. Nëse duam të njihemi më shumë me figurën e tij shumëdimensionale, duhet të lexojmë pikëpamjet e tij. Prandaj, e pashë të arsyeshme që të përcjell disa prej pikëpamjeve të imamit nga oqeani i pafund i pikëpamjeve të tij.

Imam Khomeini thotë: "Në qoftë se besimi në Zot dhe veprimi i urdhrave të Zotit futen në aktivitetet shoqërore, politike, ekonomike dhe në dimensionet e tjera të jetës së njeriut, atëherë shumë lehtë do të zgjidheshin problemet më të ndërlikuara të botës moderne. Sot bota ka arritur në një qorrsokak dhe nuk ka rrugë tjetër përveçse të dorëzohet përballë mësimeve dhe udhëzimeve të profetëve të Zotit." Në këtë thënie sqarohet më së miri se imam Khomeini ka qenë besimtar i madh. Ai ka thënë se: "Nëse punët tuaja nuk janë të lidhura me Allahun dhe nëse përçaheni, sigurisht që ju do të jeni të poshtëruar."

Në një thënie tjetër Imam Khomeini ka thënë: "Është detyrë e jona që të ftojmë të tjerët në rrugën e Allahut dhe jo t'i ftojmë ata për vetat tona dhe as për interesin vetjak apo jetik.'

Sipas imam Khomeinit, Islami ka ardhur për edukimin e njeriut dhe objekti më i rëndësishëm i programit islam është njeriu dhe edukimi i tij shpirtëror. Islami ka ardhur për reformimin e shoqërisë. Mesazhi islam nuk është i kufizuar as me anën shpirtërore e as me anën materiale, por ai i përfshin të dyja. Kjo do të thotë që Islami dhe Kur'ani kanë ardhur për të formuar njeriun dhe për edukimin e tij në të gjitha aspektet.

Në një vend tjetër, imam Khomeini na flet për mirësinë e Kur'anit ku thotë: 'Është detyrë e muslimanëve që Kur'anin ta kenë shoqëruesin e tyre, sepse ai është Fjala e Allahut dhe Libri i udhëzimit. Çdo mirësi që

zotërojnë dhe do të zotërojnë muslimanët, janë prej begative të këtij Libri të Shenjtë.'

Po ashtu, udhëheqësi i paharruar i të privuarve, ka thënë: 'Motoja jonë është që të mos i bëjmë padrejtësi askujt dhe të mos e pranojmë padrejtësinë. Duhet që muslimanët të jenë të bashkuar kundër të padrejtëve sepse, esenca e thirrjes Islame është uniteti dhe mospërçarja. Kur'ani Famëlartë dëshmon se të gjithë besimtarët në mbarë botën janë vëllezër dhe vëllazëria islame është burimi i të gjitha mirësive.

Imam Khomeini gjithmonë ftonte për unitet në mesin e myslimanëve. Ai ka thënë se në Islam nuk ka sunnit apo shi'it, kurd apo persian, sepse të gjithë janë vëllezër. Është detyrë e jona - sunnitë dhe shi'itë - që të vëllazërohemi me qëllim që t'u presim rrugën atyre që përpiqen të na përçajnë e të na grabisin. Përçarja dhe konflikti në këto ditë konsiderohen vetëvrasje. Pra, përçarja është prej djallit, ndërsa bashkimi dhe mospërçarja është prej të Gjithëmëshirshmit, Allahut. Prej asaj gjuhe nga e cila dalin fjalë për përçarje, ajo gjuhë është e shejtanit.

Të nderuar lexues:

Allahu i Madhëruar në Kur'anin e shenjtë, në suren Haxh" ajeti thotë: **"Kushdo që i lartëson simbolet e Allahut, ajo është prej devotshmërisë së zemrave.**" Edhe imami i paharruar ka qeë një prej simboleve të Allahut i cili të gjithë jetën tij dhe qëien e tij e shkriu në rrugën e Allahut të Madhëruar. Përkujtimi i tij nuk duht të qëndrojë i ngjitur në muret e kësj sale por është e domosdoshme që mendimt dhe idetë e tij të ndritura të përhapen në mesin e njerëzve. Në këtë ditë të përkujtimit të imam Khomeinit ne duhet të llogarisim vetat tona se sa punë kemi bërë për ndreqjen e vetave tona, të familjeve tona dhe të shoqërisë ku jetojmë.

Fjalën time do ta mbyllja me një porosi të vyer të imam Khomeinit, i cili thotë: 'Vendosni të ecni në rrugën e Allahut. Bëjeni të jashtmen tuaj njerëzore. Zbatoni rregullat e sheriatit dhe kërkojini Allahut të Madhëruar t'ju ndihmojë në arritjen e qëllimeve. Kërkoni ndihmën e Allahut që për hir të profetit Muhamed dhe familjes së tij të pastër e të dlirë t'ju mbarësojë në në këtë rrugë. Të shumta janë rrugët e devijimit në këtë jetë. Është e

mundur që për një moment njeriu të rrëshkasë në humnerën shkatërruese. Prandaj, lutjuni Allahut që t'ju mbrojë nga devijimi prej rrugës së drejtë dhe t'ju dhurojë mirësinë e ndjekjes së mësimeve të Tij dobiprurëse për të dyja botët.'

E lus Allahu Fuqiplotë që të na bëjë prej ndjekëve të rrugës së Tij dhe prej zbatuesve të urdhrave dhe porosive të Tij, të profetit Muhamed të familjes së tij të pastër dhe të dijetarëve të paharruar si imam Khomeini (paqja e Allahut qoftë mbi të!)

Vullnet MERJA
Kryetar i Shoqatës Flladi

PARATHËNIA E PËRKTHYESIT NË GJUHËN ARABE

O Dhurues i mendjes vetëm për Ty janë falënderimet, te bujaria Jote përfundojnë qëllimet!

Falënderimi është vetëm për Allahun, *(Paqe e bekim për Muhamedin, Mesazhmbajtësin e Allahut, që u dërgua për të shpëtuar njerëzit prej injorancës, prej dëshpërimit që sjell shmangia prej rrugës së drejtë dhe e përkrahu me ushtritë e Tij!)*

" ... وَلِلَّهِ جُنُودُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ... "

"…ue lil'làhi xhunùdu-s'semàvàti uel-erdi…" **"…të Allahut janë ushtritë e qiejve e të tokës…"**[1]

Paqe e bekim për Muhamedin e për imamët udhëzues në rrugën e drejtë, argumentet e orientimit drejt rrugës së vërtetë.

Këtë libër të vyer po e vë në dorën e lexuesve të shtrenjtë, me synimin që të jetë ndihmë e këndshme dhe që të marrin prej tij mendimin e pastër, të marrin dituri dobisjellëse, njohuri të shumta dhe edukatë të mrekullueshme. Por jo vetëm kaq, lexuesi le të mësojë se ky është libri i fundit që shkroi Imami i ymetit, zotëria i oratorëve, modeli i pastër që duhet ndjekur, udhëheqësi i Revolucionit Islamik dhe themeluesi i Republikës Islamike të Iranit, Imami me shpirt të kulluar, Imam Khumejnij.

[1] Sure "El Fet'h", ajeti 4.

I lutemi Allahut të Lartësuar të ngrejë sa më lart respektin për të, si dhe për ata që kontribuan për përgatitjen e për botimin e këtij libri; i lutemi vetëm Fuqiplotit të japë njërin prej tri shpërblimeve të pandërprera, që Ai, me bujarinë e Tij, ka rezervuar për birin e Ademit kundrejt punës së tij. Këtë premtim e lexojmë në fjalën e të Dërguarit *(Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!):* "Kur biri i Ademit vdes, puna e tij prej kësaj bote ndërpritet, me përjashtim të tri punëve… Ka lënë një dituri e prej secilës përfitohen dobi." Vetëm Allahu qëndron prapa qëllimit.

Es'Sej'jid Ahmed El Fehrij

Fillimi i muajit i lindjes së zotërisë së të Dërguarve (Rebij'ul-ev'vel), viti 1421 të Hixhretit.

PREJ TIJ KËRKOJMË NDIHMË

PARATHËNIE

Autori bën të ditur se s'ka qëllim studimin shkencor të hadithit të nderuar për disa shkaqe:

Shkaku i parë: Standardi i vogël dhe njohuritë e pakta në këtë fushë.

Shkaku i dytë: Komentuesit e librit të respektuar "El Kafij" janë dijetarët më të mëdhenj, kanë meritat më të larta, janë ajka e studiueseve e modeli që duhen ndjekur në fushën e studimeve. Ata janë profesorët më të besueshëm në këtë fushë të diturisë dhe kolonat e filozofisë e të njohjes. Ata janë prej atyre që s'lënë vend për asnjë që të flasë në këtë fushë të diturisë. Në çdo problem ata i kanë prerë dorën kontradiktës. Allahu i shpërbleftë për të mirën që i kanë sjellë Islamit me punën e tyre!

Shkaku i tretë: Përfundimet e marra prej hollësive të diturive janë vetëm për dijetarët e studiuesit, ndërsa dora e masës në këto punë është e shkurtër, kurse ne mendojmë që masa e gjerë e njerëzve të thjeshtë të përfitojë sa më shumë.

Shkaku i katërt: Bazë do të thotë studimi mbi burimin prej nga janë marrë hadithet e nderuara, përbën qëllimin më të lartë për shkrimin e diturive hyjnore. Pa hadithet e nderuara kurrë e asnjëherë nuk mund të kuptohen hollësitë shkencore e filozofike, si dhe anët historike e letrare të diturive hyjnore.

Por jo vetëm kaq, sepse qëllimi më i lartë me diturit hyjnore është lehtësimi i peshave të mëdha që rëndojnë mbi shpirtrat prej botës së natyrës

së errët, si dhe orientimi i shpirtrave drejt botës së të panjohurave, ndërprerja e fluturimeve të shpirtit nëpër degët e pemës së kësaj bote, e cila është baza e pemës së keqe. Ndërsa futja e njeriut në hapësirat e gjera të botës së shpejtësisë dhe mbledhja në intimitetin familjar është shpirti i pemës së mirë. Të gjitha këto arrihen vetëm me eliminimin e bredhjes së mendjeve, me pastrimin e shpirtrave, me përmendjen e gjendjeve dhe me sinqeritetin në të gjitha punët.

Në hadithin e ndwruar që gjendet në librin "El Kàfij", i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* e ka reduktuar diturinë në tri pjesë. I Dërguari i Allahut duke folur për pjesën e parë të diturisë, ka thënë: *"Është dituria rreth besimeve, dituria e vërtetuar me ajete të Kur'anit dhe me hadithe."*

Me fjalë më të holla, dituria rreth besimeve patjetër duhet të jetë e mbështetur me argumente hyjnore. Qëllimi i kwsaj diturie wshtw kërkimi i së vërtetës dhe studimi për të Vërtetin absolut, në atë mënyrë sikur të supozohet se një teolog, ose një filozof e kaloi jetën në punë të shpërndara nëpër degët e shumta të teologjisë e të filozofisë. Por te ai dituria nuk ishte qëllim hyjnor e mjet për të kërkuar e për të njohur të vërtetën. Padyshim që kjo lloj diturie do të jetë një perde, madje një perde e trashë, pasi as dituria e as filozofia e tij nuk do të jenë hyjnore. Zemra do të jetë shumë e kujdesshme, për faktin se kjo botë është bota e shumimit, është bota ku shpirti është më shumë i varur pas degëve të pemës së keqe.

Filozofi nuk mund të jetë hyjnor, as dijetari nuk mund të jetë hyjnor e shpirtëror, pa qenë e gjithë dituria e tij hyjnore. Le të supozojmë se një dijetar bën studime në fushën e Njëtimit të Allahut (teuhidit) dhe zhveshjes prej interesave të kësaj bote. Motivi i kësaj diturie te ai nuk ishte as kërkimi i së vërtetës e as dashuria për Allahun e Lartësuar, por dituria e shpikjet shkencore, si dhe shpirti e shkëlqimet e shpirtit. Në këtë gjendje, puna e këtij studiuesi nuk është argument e shenjë treguese, as urtësia e filozofia e tij nuk është urtësi e filozofi hyjnore, por është thjesht, egoizëm e natyralizëm.

Në mesin e dijetarëve është shumë e përhapur shprehja se një pjesë e diturive, në vetvete, është e kërkuar. Përballë kësaj pjese të diturisë qëndrojnë dituritë praktike. Është kështu jo vetëm në këndvështrimin tim të ngushtë, pasi të gjitha dituritë që merren në konsideratë, kanë cilësinë e parathënies. Me fjalë të tjera, çdo punë është parathënie për një punë tjetër. Në mënyrë të veçantë kjo dukuri shihet qartë në diturinë e teuhidit *(Allahu është Një e i Vetëm)*. Në këtë kuadër, vetë teuhidi shkencor është parathënie për të arritur teuhidin e zemrës, që është teuhidi praktik dhe përmendja e zemrës.

Mbase shumë vetë e kalojnë jetën e tyre në hulumtime rreth teuhidit shkencor. Ata, edhe pse e harxhojnë kohën me lexime, studime, japin mësim e marrin mësim, përsëri nuk arrijnë të gjejnë formulën e teuhidit, sepse nuk janë bërë as dijetarë hyjnorë e as filozofë hyjnorë. Atyre u janë tronditur zemrat më shumë se të tjerëve dhe kjo tronditje e zemrës atyre u ka ardhur, sepse s'kishin ndonjë cilësi e nuk ishin marrë me gjimnastikën e zemrës, si dhe pretenduan se kjo rrugë shtrohet vetëm me anë të studime të ndërsjella.

Lexues i shtrenjtë, të gjitha dituritë e së drejtës fetare janë parathënie për të njohur Allahun e Lartësuar dhe për të bërë që e vërteta e teuhidit të arrijë në zemër. Ja, kjo është feja e Allahut. Në fjalën e Allahut të Lartësuar lexojmë: *"Sibgate-ll'llàhi, ue men ahsenu mine-ll'llàhi sibgaten…"* **"Kjo fe është "ngjyra" që na ka dhënë Allahu! S'ka "ngjyrë" më të bukur se ajo që jep Allahu** ..."[1]

Qëllimi i punës është: disa punë janë parathënie të afërta, disa të tjera janë parathënie për punë të largëta dhe disa të tjera janë parathënie me ndërmjetësim, kurse disa punë të tjera janë parathënie së bashku me ndërmjetësimin.

Ligji i fesë islame (fik'hut) është parathënie për punën; punët që kanë lidhje me adhurimet, janë parathënie për dituritë që mundësojnë

[1] Sure "El Bekare", ajeti 138.

arritjen e teuhidit e të zhveshjes prej interesave të kësaj bote, natyrisht nëse adhurimet kryhen sipas rregullave e disiplinës ligjore të zemrës, sipas rregullave të modeluara të dukshme e të brendshme. Natyrisht që kjo nuk mund të kundërshtohet me fjalë, sepse me adhurimet që ai ka kryer gjatë dyzet ose pesëdhjetë vjetësh s'kanë arritur as njohuri e as të vërteta. Shkaku është se ai prej diturive tona s'ka arritur të njohë as gjendjen.[1]

Puna pa qëllim teuhidin dhe pa zhveshjen prej interesave të kësaj bote, s'ka asnjë lidhje me ne. Besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi) dhe zhveshja prej interesave të kësaj bote, janë dy dituri dhe bebja e syrit të eulijave . Gjithashtu, edhe ajo degë prej së drejtës islame, që merr përsipër përgjegjësinë në lidhje me politikën e qyteteve, rregullimin e banesës, popullimin e vendit dhe organizimin e njerëzve, janë parathënie për punët që kanë prurje të plotë në arritjen e Njëtimit të Allahut e të diturive.

Shpjegimi i kësaj pune është jashtë këtij kuadri të përcaktuar.

Edhe pjesa e shpëtuesve dhe e shkatërruesve në diturinë e moraleve është parathënie për edukimin e shpirtrave. Por edhe edukimi i shpirtrave, nga ana e tij është parathënie për arritjen te të vërtetat, te njohuritë e te përshtatshmëria e shpirtit. Të gjitha këto me qëllimin e lartë që Njëtimi i Allahut (teuhidi) të shfaqet hapur e me gjithë shkëlqimin e tij. Kjo dukuri e zemrës së pastër bëhet kaq e qartë te personat që e arrijnë këtë gradë njohurie. Madje teuhidi bëhet i qartë edhe për mohuesit, qoftë edhe sikur Methneviu të arrijë peshën e shtatëdhjetë dhuratave.[2]

U larguam prej kërkesës dhe maja e lapsit na çoi në një luginë tjetër shumë të thellë. Më sipër shpalosëm se qëllimi i Kur'anit e i haditheve është

[1] Shkëputur prej një poezie të shehut L-Behàij. Përmbajtja e saj është: Dituria zyrtare prej fillimit e deri në fundin e saj, është u tha e ka thënë. Prej kësaj nuk arrihet të mësohet as si e as qysh.

[2] Përmbajtja e dy vargjeve të poezisë së Methnevij'jit: Unë them se shpjegimi i tij arrin deri atje ku s'ka kufi. Methneij'ji në masën e vargut arrin shtatëdhjetë dhurata.

pastrimi i mendjeve e i shpirtrave dhe synon arritjen e qëllimit më të lartë, që ishte Njëtimi i Allahut *(Allahu është Zoti Një e i Vetëm)*. Shpjeguesit e haditheve dhe interpretuesit e Kur'anit Famëlartë nuk e kanë parë këtë problem nga këndvështrimi i kësaj shprehjeje të hollë, që është origjina e origjinave. Ata thjesht kanë ecur së bashku me këto çështje ashtu siç ecin njerëzit e nderuar dhe studimin e hollësishëm nuk e kanë bërë në asnjërën anë, në ato vende ku qëllimi ishte zbritja e Kur'anit dhe burimi, dalja e haditheve.

Këto studime e investigime ata i bënë të ngjashme me anët letrare, filozofike, historike e me anë të tjera të ngjashme. Madje edhe moralistët iu afruan kësaj diturie, ose studiuan me rrugë shkencore e filozofike, si autori i librit "Tahàretul-a'ràk", studiuesi i madh Ibn Meskùjeh dhe autori i librit "Akhlàku-n'nàsirij", i urti hyjnor e filozofi i mbushur me dituri, më i miri i dijetarëve të mëvonshëm, ndihmuesi i umetit e i fesë *(Allahu e shenjtëroftë shpirtin e tij të pastër!)*.

Gjithashtu, e këtillë është gjendja edhe në një pjesë të madhe të librit "Ihjàul-ulùm" të Gazàliut. Në këto botime e të ngjashme me këto, s'ka asnjë shenjë e asnjë gjurmë që të tërheqë vëmendjen në drejtim të pastrimit të moraleve dhe edukimit të së brendshmes, nëse nuk themi që, në origjinë, në ato libra s'ka asgjë që lë gjurmë e ndikon, ose diçka të ngjashme me historinë e moraleve, ashtu siç është shprehur autori, që ka mbledhur në librin e sipërpërmendur tregime mbi tregime, rrëfenja, aforizma e ndodhi të atilla. Nëse njeriu do të shpenzojë kohë t'i lexojë, padyshim që do e pengojnë të shkojë drejt qëllimit origjinal.

Autori i librit "Ihjàul-ulùm", libër madhor, që e përmendin njerëzit e ditur me fjalët më të bukura e me lavdërime të veçanta. Për këtë libër thonë se është fillimi e mbarimi në fushën e diturive rreth moraleve. Imam Khumejnij mendon se libri i sipërpërmendur nuk e ndihmon njeriun të përmirësojë moralet e të shkulë nga rrënjët lëndën që shkakton prishjen dhe degjenerimin për edukimin e brendshëm, sepse studimet e shumta, të shpikura, prurja e madhe e punëve shkencore e jo shkencore, citimet që nuk

sjellin dobi, të vërteta e jo të vërteta, të gjitha këto e pengojnë njeriun prej qëllimit origjinal dhe e vonojnë atë prej edukimit e prej pastrimit të shpirtit.

Në tërësi, sipas mendimit tim, shkurtimi i moraleve shkencore e historike, interpretimi letrar e shkencor i Kur'anit dhe shpjegimi i haditheve me këtë mënyrë është largim prej qëllimit dhe prej asaj që synohet të arrihet, është largim prej asaj që është afër. Më e rëndësishme në doktrinën e këtij autori, në fushën e diturisë së moraleve dhe shpjegimit të haditheve që flasin për moralet, ose interpretimi i ajeteve të Kur'anit që kanë lidhje me moralet, është se autori të ketë mundësi të përgëzojë e të paralajmërojë, të këshillojë, t'i bëjë të tjerët të mendojnë e të tërheqë vëmendjen e tyre, me synimin që qëllimet e tij të zënë vend në shpirtrat e njerëzve.

Me fjalë të tjera, libri i moraleve patjetër duhet të jetë këshillë e shkruar dhe vetë autori i librit të jetë shëruesi i dhimbjeve e përmirësuesi i të metave dhe personi që udhëzon në rrugën e mjekimit.

Shpjegimi i rrënjëve të moraleve dhe tregimi i rrugëve të mjekimit nuk afron asnjë njeri drejt qëllimit, nuk ndriçon asnjë zemër të errësuar dhe nuk përmirëson asnjë zemër të prishur, të degjeneruar e të korruptuar. Libri i moraleve është një libër që zbut shpirtrat e ashpër kur ata e lexojnë; për të pakulturuarin është kulturë, për të errësuarin është ndriçues, por edhe i dituri, në kuadrin e tregimit të rrugës, mund të jetë udhëheqës, kurse në kuadrin e tregimit të ilaçit, do të jetë shërues dhe vetë libri do të jetë ilaç për sëmundjen dhe jo një epikrizë që tregon ecurinë e sëmundjes.

Fjala e mjekut shpirtëror patjetër duhet të jetë në pozitën e ilaçit dhe jo në pozitën e epikrizës, kurse librat e sipërpërmendur janë vetëm receta. Madje, sikur të guxoja, do të thosha se disa nga ato libra mund të konsiderohen receta për punë, në të cilat ka dyshime. Por largimi i shikimit prej kësaj lugine ka qenë më i preferuar te autorët e librave të sipërpërmendur.

Tanimë është hapur rruga për shkrimin e librit të moraleve. Do të ishte mrekulli sikur të gjendej një autor dijetar, me kapacitet për të vlerësuar

e për të shkruar sipas këtij shembulli. Por kjo nuk do të thotë se unë, ose lapsi im i thyer, e ka këtë kapacitet, ose që zemra ime e errësuar e ka këtë aftësi investigimi të mprehtë. Dihet se prurja e dyshimeve është një punë e lehtë, por e vështirë është zgjidhja e saj.

Prandaj ne kërkojmë mbarësinë vetëm prej të Lartit, vetëm Atij i lutemi të dhurojë butësi për zemrat tona të ashpra dhe të na furnizojë me sinqeritet, duke shpresuar që prej këtij libri të fitohet një zemër. Vetëm prej Allahut vjen merita e mirësitë.

ARTIKULLI I PARË

CITIMI I HADITHIT TË NDERUAR PËR T'U LUMTURAUR E PËR TË MARRË BEKIMIN

Mbështetur në vargun e njëpasnjëshëm të përcjellësve të hadithit, disa prej të cilëve janë përmendur në librin tonë "Dyzet hadithe"[1],

[1] Librin "Dyzet hadithe" Imam Khumejni e shkroi në gjuhën perse, në vitin 1358 të Hixhretit,. Në këtë libër shpjegon dyzet hadithet e ardhura prej Profetit e prej familjes së tij, të ruajtur prej gabimeve. Në këtë libër janë përmbledhur kërkesat morale, doktrinare e të njohjes. Ky libër i çmuar me hadithe është botuar prej Institutit për botimin e trashëgimisë së Imamit. Që në fillim të librit të tij "Dyzet hadithe", Imami tregon se ai është mbështetur në librin e nderuar "El Kàfij".

Disa prej shehëve tanë të mëdhenj, të nderuar e të besueshëm, më kanë njoftuar, gojarisht dhe me shkrim. Një prej tyre është edhe shehu, dijetari teolog e juristi i bazave të ligjit të fesë, letrari e teologu i thellë, Muhamed Ridà, i familjes së dijetarit të madh e besnikut shehut Muham'med Tekij El-esfehànij (Allahu e vazhdoftë mbarësinë e tij!), kur e nderoi qytetin Kom me vizitën e tij, si dhe shejhu, dijetari madhor, adhuruesi i përkushtuar e argumenti i besueshëm, Haxhi shejhu Ab'bàs Elkum'mij (Allahu e vazhdoftë mbarësinë e tij!). Të dy këta, kanë përcjellë prej zotësisë tonë, dijetarit të madh, adhuruesit, njeriut të përkorë, juristit e dijetarit të fushës së hadithit, Mirzà Husejn En'Nùrij (Allahu e ndriçoftë vendprehjen e tij!) dheprej dijetarit të madh, shejhut Murtedà El-ensàrij (Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!)

Dhe prej atyre, zotëria ynë, juristi i ligjit të fesë, teologu i besueshëm, studiuesi, dijetari madhor, zotëria ynë, Muhsin El-Emijn El-Amilij (Allahu e bëftë të vazhdueshme mbështetjen e tij!), prej fekijhut të madh, autori i disa librave, zotërisë sonë Muhamed bin Hàshim Elmùsevij'j Err'rredevij Elhindij, afër në Nexhefi Eshrefin, gjallë e i vdekur (Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!), prej dijetarit të madh El'Ensarij; prej tyre zotëria ynë, dijetari i besuar, argumenti i vërtetuar, zotëri Ebul-Kasim Ed'dihkerdij El-Esfehanij, prej Es'sej'jid,

deri në të besueshmin e Islamit, shehun e lartë, Muhamed bin Jaëkub Elkelijnij, *(Pastë kënaqësinë e Allahut!),* në librin e tij përmbledhës "Elkafij", është përcjellë prej disa shokëve tanë, prej Ahmed bin Muhamedit, prej Ali bin Hadijdit, prej Sem'ma'ah bin Mihran: "Isha te Ebu Abdullahu (Imam Sadiku). Te ai ishte një grup prej mbështetësve të tij. Kur aty u përmend injoranca, Ebù Abdullahu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Njihni mendjen e ushtritë e mendjes, njihni edhe injorancën e ushtritë e injorancës që të udhëzoheni në rrugën e drejtë." Sem'mà'ah tha: "Kurban t'u bëfsha! Ne dimë vetëm ato që na ke mësuar ti."

Atëherë Ebù Abdullahu *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Allahu krijoi mendjen prej dritës së Tij dhe mendja është i pari krijim prej shpirtërorëve

---

më të lavdishmit Mijrza Muhamed Hàshim El-Esfehanij (Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!) prej dijetarit të madh El-Ensàrij (Ne kemi edhe rrugë të tjera që nuk përfundojnë te shehu dhe për këtë i kemi lënë ato rrugë); prej zotërisë sonë më të nderuar, Ahmed En'neràkij, prej zotërisë sonë, Mexhlsij që thirrej "deti i diturive dhe demonstrues i shumë qerameteve" (Pastë kënaqësinë e Allahut!), prej profesorit të të gjithëve, Akà Muham'med Bàkir Elbehbehànij, prej babës së tij, të kompletuarit Muhamed Ekmel, prej zotërisë sonë, Muhamed Bakir El-Mexhlisij, prej babait së tij, studiuesit të zotërisë sonë, Tekij Elmexhlisij, prej shehut, studiuesit Elbehàij, prej babait të tij, sheh Husejnit, prej sheh Zejnud'dijn, i njohur me epitetin "dëshmori i dytë", prej shehut Ali bin Abdul-Alij Elmejsij, prej shehut Shemsud'dijn Muhamed bin Elmuedh'dhin Elxhezijnij, prej shehut Dijaud'dijn Ali, prej babës së tij mbajtës i dy gradave, shehut Shemsud'dijn Muhamed bin Mek'kij, prej shejhut Ebu Tàlib Muham'med, krenaria e studiueseve, prej babës së tij, Ajetu-ll'llah Hasen bin Mutah'hir, dijetari i madh Elhalij, prej shehut Ebul-Kasim Xha'fer bin Hasen bin Seijd Elhalij, studiuesi absolut, prej zotësisë sonë, Ebù Ali Fekh'khar bin Muad'd Elmusevij, prej shehut Shadhan bin Xhebràijl Elkum'mij, prej shehut Muham'med bin Ebul-Kasim Et'taberij, prej shejhut Ebù Ali Hasen, prej babës së tij, shejhut të grupit Ebù Xha'fer Muhamed bin Abdull'llah Muhamed bin Hasen Et'tusij, mbledhësi i librit të haditheve "Et'tehdhijb" dhe "El-istibsar", prej imamit të fukahave e teologëve, shehut Ebu Abdull'llah Muhamed bin Muhamed bin Nuëman shehu Mufijd, prej shehut të tij, kreut të dijetarëve të hadithit, shehu Ebu Xha'fer Muhamed bin Ali bin Husejn bin Musa bin Babevejhi Elkum'mij, autori i librit "Men la jahdaruhul-fekijh" (Ai që nuk e ka arritur fekijhun), prej shehut Ebul-Kàsim Xha'fer bin Kùlevejhi, prej shehut më të nderuar argumentit të Islamit, Muhamed bin Jaëkub Elkelijnij, autori i librit "Elkafij".

në anën e djathtë të Arshit. Allahu i tha mendjes: "Largohu!" dhe mendja u tërhoq. Pastaj i tha: "Afrohu!" dhe mendja u afrua.

Allahu i Lartësuar tha: "Të krijova me një krijim të madh, të nderova mbi të gjitha krijesat e Mia."

Tha: "Pastaj Allahu krijoi injorancën prej ujit të kripur të detit të errësuar dhe i tha asaj: "Largohu!" dhe injoranca u tërhoq. Pastaj i tha: "Afrohu!"

Por injoranca nuk u afrua. Ai i tha injorancës: "Tregove mendjemadhësi!" Dhe e mallkoi. Pastaj Allahu bëri për mendjen shtatëdhjetë e pesë ushtri dhe, kur injoranca pa se me çfarë e nderoi Allahu mendjen dhe sa i dha asaj, e fshehu armiqësinë e saj ndaj mendjes dhe tha: "O Zot, edhe kjo është një krijesë si unë, Ti e krijove atë, e nderove dhe e forcove. Unë jam e kundërta e saj. Por për mua s'ka fuqi përballë saj, prandaj më jep edhe mua ushtri, ashtu siç i dhe mendjes."

Allahu tha: "Po. Por nëse pas kësaj kundërshton, ty dhe ushtritë e tua do t'i nxjerrë jashtë mëshirës Sime."
Injoranca tha: "Jam e kënaqur!"
Allahu i Lartësuar i dha edhe injorancës shtatëdhjetë e pesë ushtri përballë shtatëdhjetë e pesë ushtrive që i dha mendjes."
E mira është ministri i mendjes, e kundërta e të mirës qëndron e keqja, që është ministri i injorancës.
Në vijim cilësitë e larta dhe të kundërtat:
Besimi, e kundërta Mohimi
Besueshmëria, e kundërta Mosbesimi
Shpresa, e kundërta Prerja e shpresës
Drejtësia, e kundërta Padrejtësia
Mbetja i kënaqur, e kundërta Mëria
Falënderimi, e kundërta Mosmirënjohja
Lakmia, e kundërta Dëshpërimi
Mbështetja në Allahun, e kundërta Babëzia
Butësia, e kundërta Ashpërsia
Mëshira, e kundërta Zemërimi

Dituria, e kundërta Injoranca
të Kuptuarit, e kundërta Kokëtrashësia
Turpi, e kundërta Paturpësia
Vetëpërmbajtja, e kundërta Dëshira
Shoqërimi, e kundërta Absurditeti
Tmerri, e kundërta Guximi
Kryeultësia, e kundërta Mendjemadhësia
Ecja në qetësi, e kundërta Nxitimi
Butësia, e kundërta Arroganca
Heshtja, e kundërta Fjalët e shumta e të kota
Dorëzimi (te Allahu), e kundërta Mbajtja e vetes me të madh
Pajtimi me gjendjen, e kundërta Dyshimi
Durimi, e kundërta Demoralizimi
Falja e tjetrit, e kundërta Hakmarrja
Gjendja e mirë ekonomike, e kundërta Varfëria
Kujtimi, e kundërta Harresa
Mbajtja në mendje, e kundërta Harresa
Debulesa e simpatia ndaj dikujt, e kundërta Prerja e lidhjeve
Moskërkesa për më shumë, e kundërta Babëzia
Ngushëllimi, e kundërta Mosvajtja për ngushëllim
Dashamirësia, e kundërta Armiqësia
Besa, e kundërta Pabesia
Bindja, e kundërta Mëkatimi e kundërshtimi
Përulja, e kundërta Kryelartësia
Shpëtimi, e kundërta Pësimi
Dashuria, e kundërta Urrejtja
Sinqeriteti, e kundërta Gënjeshtra
E vërteta, e kundërta e Gabuara
Besnikëria, e kundërta Tradhtia
Sinqeriteti, e kundërta Njollosja
Mendjemprehtësia, e kundërta Idiotizmi
Kuptimi, e kundërta Veprimi pa mend
Njohja, e kundërta Mosnjohja
Zemërgjerësia, e kundërta Përgojimi

Siguri për të papranishmin, e kundërta Thurja e intrigave
Ruajtja e sekretit, e kundërta Përhapja e fjalëve
Falja e namazit, e kundërta Lënia e namazit
Agjërimi, e kundërta Mosagjërimi
Lufta në rrugën e Allahut, e kundërta Shmangia
Haxhi, e kundërta Kundërshtimi i besëdhënies
Ruajtja e bisedës; e kundërta Çuarja e prurja e fjalëve
Sjellja e mirë ndaj prindërve, e kundërta Keqtrajtimi i prindërve
E vërteta, e kundërta Hipokrizia
Puna e mirë, e kundërta Puna e keqe
Mbulimi i pjesëve të trupit që duhem mbuluar, e kundërta Zbulimi i pjesëve të trupit
Ruajtja prej dhunës, e kundërta Përhapja e asaj që mbahej e fshehur
Maturia, e kundërta Dufi e vrulli
Përgatitja, e kundërta Nëpërkëmbja e prostitucioni
Pastërtia, e kundërta Ndyrësia
Qëllimi i mirë, e kundërta Agresioni
Pushimi, e kundërta Lodhja
Lehtësia, e kundërta Vështirësia
Dhurata hyjnore, e kundërta Shkatërrimi
Shëndeti, e kundërta Sëmundja
Veprimi me drejtësi, e kundërta Lavdërimi se ka më shumë
Urtësia, e kundërta Trillet
Serioziteti, e kundërta Mendjelehtësia
Lumturia, e kundërta Mjerimi
Pendimi për fajin e bërë, e kundërta Këmbëngulja në fajin
Kërkimi i faljes për mëkatin e bërë, e kundërta Joshja, tundimi
Ruajtja, e kundërta Shkujdesja
Lutja, e kundërta Neveria për diçka me mendjemadhësi
Aktiviteti, e kundërta Përtacia
Gëzimi, e kundërta Hidhërimi
Pajtimi, e kundërta Përçarja
Bujaria, e kundërta Koprracia.

Të gjitha këto ushtri të mendjes nuk mund të jenë të gjitha së bashku në një njeri, me përjashtim të një profeti, një të porosituri, ose të një besimtari, të cilin Allahu Fuqiplotë e ka vënë zemrën e tij në provë me besimin.

Kurse në ndonjërin prej dashamirëve tanë, mund të jenë disa prej ushtrive të mendjes, derisa ai të plotësohet e të pastrohet prej ushtrive të injorancës. Me këtë pastrim ai do të jetë në gradë të lartë, së bashku me profetët e të porositurit. Këtë gradë ai e arrin duke njohur mendjen e ushtritë e mendjes dhe duke mënjanuar injorancën e ushtritë e injorancës. Allahu na dhëntë mbarësi në rrugën e bindjes ndaj e Tij e fitimin e kënaqësisë së Tij!

ARTIKULLI I DYTË

SHPJEGIMI I DIÇKAJE PREJ SË VËRTETËS SË ARSYES E INJORANCËS DHE SHPJEGIMI I QËLLIMIT TË HADITHIT

Mëso se mendja e injoranca, për të cilat flitej në mbledhjen e atyre njerëzve të afërm janë mendja e injoranca që gjenden te njeriu. Mendja është fuqia logjike, domethënë është fuqia shpirtërore, e cila, nën shtytjen e zhveshjes dhe natyrës së krijimit, është e prirur ndaj të mirave e plotësimeve, gjithashtu është motiv për drejtësi e për bamirësi. Përballë kësaj fuqie qëndron e gabuara, që priret kah kjo botë, nuk i nënshtrohet rregullit të mendjes dhe është e vënë në dispozicion të çadrës së mendjemadhësisë së mirëfilltë. Kjo fuqi e gabuar është pema e së keqes, është origjina e të këqijave, të cilat, me dashjen e Allahut, do të përmenden në vijim.

Përsa i përket mendjes që përmendet në hadithin e nderuar, i ardhur prej Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!), kur ai po rendiste cilësitë që përmenden në hadith, në të cilin u tha se krijesa e parë prej shpirtërorëve është mendja e përgjithshme për botën e madhe. Kjo mendje e përgjithshme është e brendshmja e mendjeve pjesore, e sekreteve dhe e të vërtetave të mendjeve pjesore. Por kur kuptohet e vërteta e mendjes, atëherë mësohet ajo që ishte objekti i konstatimit të atyre, mësohet esenca shpirtërore, e zhveshur prej lidhjeve trupore, mësohet që mendja është e para krijesë shpirtërore, është e para dukuri e zemërmadhësisë së shenjtë, e

vullnetit absolut, e ekzistencës së ujit të pijshëm[1] dhe dritës së Profetit të fundit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Në botën e njerëzve, në botën e krijimit e të mohimit, botë që presupozon mohimin e shumë prej domosdoshmërive të mendjes e të fesë, nga ana e konceptimit detyrimisht më të nderuar, Allahut të Lartësuar, që shfaqet në sistemin e ekzistencës dhe në përkufizimin e detyrës.

Në këtë sistem duket qartë fuqia e Allahut dhe konkretizimi i Qenies së shenjtë. Botës së ekzistencës, në fushën e shenjtërisë, i bashkëngjitet edhe injoranca, pamundësia e koprracia, e të tjera të ngjashme me këto, përmendja e të cilave konsiderohen motive për durim e kujdes, përveç studimit e realizimeve të arritura në këtë fushë.

Edhe pse ata që nuk e miratojnë këtë të vërtetë të përmbajtjes së hadithit janë prej ajkës së burrave të hadithit, nuk kanë pasur kujdesin të shikojnë pasojat e dëmshme të mendjes dhe domosdoshmëritë e saj të gabuara, të fshehta, që bëhen të dukshme në sajë të praktikimit të diturive në fushën e Njëtimit të Allahut (teuhidit) dhe të zhveshjes konkrete prej kësaj bote. Duket qartë se burrat e hadithit kanë qenë të çuditur dhe krejtësisht të shkujdesur ndaj kësaj të vërtete.

Këtu qëndron edhe shkaku, që ata nuk cilësohen për mangësi në shenjtërinë e në pastërtinë e tyre, sepse ata kanë kujtuar se bëhet fjalë për botën e mendjes dhe zhveshjen. Por pikërisht kjo e bën të domosdoshme pohimin se bota ka dalë më vonë. Disa studiues, madje prej dijetarëve më të mëdhenj, u sollën me fodullëk ndaj studimit dhe vërtetuan se të gjitha botët, si të njohurat, ashtu edhe të panjohurat janë të vonshme në kohë, duke pohuar se shpjegimi i kësaj çështjeje, së bashku me elementet e saj ka nevojë për një mesazh të veçantë.

---

[1] Kjo shprehje është marrë prej hadithit të Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Sikur të dinin njerëzit si qe fillimi i krijimit, as dy vetë nuk do të kishin kundërshtim. Allahu i Lartësuar, para se të krijonte njerëzit, i tha ujit: "Bëhu i ëmbël, që Unë të krijoj prej teje Xhen'netin Tim dhe ata që janë të bindur ndaj Meje..."; "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 5, K. 2, hadithi 1.

Këtë e lexojmë në ajetin 1 të sures "Et-Talak":

لَعَلَّ ٱللَّهَ يُحۡدِثُ بَعۡدَ ذَٰلِكَ أَمۡرٗا ١

"…leal'le-ll'llàhu juhdithu baëde dhàlike emren" "…mbase pas asaj Allahu mund të bëjë diçka rishtas."[1]

Kjo fjalë i atribuohet dijetarëve të ndritur të hadithit, por ata e kanë larguar atë prej fushës së tyre. Gjithashtu kanë larguar edhe thënien se pohimi i kësaj çështjeje është domosdoshmëri, për shkak të paralajmërimeve të shumta, që lëkundin bazën e pastërtisë e të Njëtimit të Allahut (teuhidit). Por konkretisht ata ishin të shkujdesur ndaj këtij problemi.

Në një formë të përgjithshme, vërtetimi i mendjes së zhveshur dhe bota e mendjes, këto dy nocione, janë në përputhje me hadithet e ardhura prej individëve të Ehli Bejtit, të ruajtur prej mëkateve.

Ajo që tregojnë disa ajete të nderuara hyjnore, përfshijnë edhe argumente të padiskutueshme, të ardhura prej dijetarëve të fushës së logjikës. Kjo është si rezultat i ushtrimeve të njerëzve të ditur është esenca krejtësisht e zhveshur, është mendja e botës madhore, e shprehur me fjalën e disave për njeriun e parë, jo për Ademin, babain e njerëzimit, por për shpirtin e Ademit *(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

وَيَسۡـَٔلُونَكَ عَنِ ٱلرُّوحِۖ قُلِ ٱلرُّوحُ مِنۡ أَمۡرِ رَبِّي وَمَآ أُوتِيتُم مِّنَ ٱلۡعِلۡمِ إِلَّا قَلِيلٗا ٨٥

"Ue jes'elùneke ani-rr'rrùhi kuli-rr'rrùhu min emri rab'bij ue mà ùtijtum minel-ilmi il'là kalijlen" "Të pyesin ty për shpirtin, thuaj: shpirti është prej punëve që i takojnë vetëm Zotit tim dhe, nga dituria ju është dhënë fare pak" [2]

Ajeti 29 i sures "Elhixhr":

[1] Sure "Et-Talak", ajeti1.
[2] Sure "El –Isra", ajeti 85.

فَإِذَا سَوَّيْتُهُ وَنَفَخْتُ فِيهِ مِن رُّوحِي فَقَعُواْ لَهُ سَٰجِدِينَ ٢٩

"Feidhà sev'vejtuhù fijhi min rùhij fekaù lehù sàxhidijne" "Dhe kur atë e përsosa dhe fryva në të prej shpirtit Tim, ata bënë sexhde për atë."

Përballë kësaj të vërtete hyjnore ka edhe një të vërtetë tjetër, që është iluzioni i përgjithshëm për termin njeri, të prirur kah e keqja dhe degjenerimi, prirje që ai e ka nga vetë cilësia e natyrës së krijimit të tij. Prandaj njeriu bën thirrje për gabime e për stisje, të cilat, në vetvete, janë të vërtetat e shejtanit të shejtanëve, të shejtanit më të madh, i cili konsiderohet lëvizësi i shejtanëve në të gjitha dukuritë e djallëzive të tij.

Për këtë të vërtetë ka edhe një zhveshje të errët të botës së Berzahut. Këtë e kanë të qartë dijetarët njohës të së brendshmes.

ARTIKULLI I TRETË

(NË LIDHJE ME DISA CILËSI TË DY TË VËRTETAVE, ARSYES E INIJORANCËS DHE CILËSITË E KËTYRE, TË DYJAVE BAZUAR NË HADITHI SHERIFIN)

E para, Imami *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: "Allahu krijoi mendjen. " Këto dy pika mund të jenë tregues për origjinën e të vërtetës së mendjes.

PIKA E PARË:

Imami e cilësoi mendjen si krijesë. Ky mund të jetë tregues për të vërtetën e mendjes kundrejt urdhrit dhe prej tërheqjeve të saj, sepse bota e urdhrit është shprehja e vërshimit të dritës së Dhënësit, Mëshiruesit absolut, pozitës së botës së madhe të intervalit kohor dhe vërshimi shpirtëror i shndritshëm i Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* Për Allahun e Lartësuar s'mund të ketë as verifikim, as kushtëzim e as ndonjë send që i qëndron përballë. Ai nuk mund të përshkruhet me cilësitë e krijesave, përveçse në formë alegorie. Kjo ka ardhur në disa hadithe.[1]

1 Në lidhje me këtë lexo hadithin e ardhur prej Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!): "Allahu ishte kur s'kishte asgjë. Ai krijoi vendin, krijoi dritën e dritave, prej së cilës morën dritë dritat. Ai bëri të lëvizë prej dritës së Tij, prej secilës morën dritë dritat, është drita prej së

Të diturit e njohurive të thella thonë: Ky është njëri prej kuptimeve të hamendësuara për ajetin e nderuar të Kur'anit: ... أَلَا لَهُ ٱلْخَلْقُ وَٱلْأَمْرُ ... *"…elà lehul-khalku uel-emru…"* "…bëni kujdes, vetëm Atij i takon krijimi e sundimi…"[1]

Ajeti tjetër i nderuar i Kur'anit Famëlartë: ...ٱللَّهُ نُورُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ *"All'llàhu nùru-s'semàvàti uel-erdi…"* "Allahu është drita e qiejve dhe e tokës…"[2]

Ky ajet e tregon më qartë këtë të vërtetë, përveç fjalëve kuptimplota dhe sekreteve të habitshme që ajeti thekson. Bazuar mbi këtë, e vërteta e mendjes, e cila, siç u tha më sipër, është krijesa shpirtërore e parë, shpreh dukurinë e parë dhe pozicionin e parë të dritës hyjnore vërshuese të Dhënësit, të Dukshmit.

Në vijim të këtij studimi del qartë edhe një cilësim tjetër, cilësimi i të Lartit, me cilësinë e mendjes, sepse Ai e krijoi të vërtetën prej dritës së Tij, domethënë e krijoi prej dhënies së Tij të madhe dhe dritës së Tij ndriçuese, për faktin se e vërteta realizohet me shfaqjen absolute dhe qëndron me këtë shfaqje.

Hadithi i sipërm gjendet në librin "El-Kàfij", në kapitullin "Cilësitë e punës" dhe e thekson këtë çështje në mënyrën më të qartë. Gjithashtu e thekson edhe hadithi tjetër që i atribuohet Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Allahu krijoi vullnetin dhe pastaj me vullnetin Ai krijoi sendet."[3]

Ndoshta në këtë hadith sherif qëllimi i përdorimit të fjalës "vullnet" është vërshimi i dritës së Dhënësit, që është Drita e qiejve dhe e tokës. Por mbase qëllimi me këtë fjalë është edhe shfaqja e madhështisë së Allahut për të vërtetën pa ndërmjetës, sepse të vërtetat e dukshme, logjike e jo logjike,

---

cilës ai krijoi Muham'nedin.". Hadithi gjendet në librin "Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 367, libri "Argument", K. 11.

1 Sure "El-A'ràf", ajeti 54.

2 Sure "En'nùr", ajeti 35.

3 "Usùlil-Kàfij" vëll. 1, f. 85, libri "Et'teuhij", K. 14.

ne s'kemi mundësi t'i lidhim me Qenien e shenjtëruar prej të gjitha rregullave e domosdoshmërive, sepse kjo lidhje me Qenien konsiderohet e mirëqenë vetëm për krijesat.

Gjendja e kushtëzimit dhe e shfaqjes, detyrimisht kërkon shfaqjen e madhështisë së Krijuesit të Lartësuar. Shfaqja e madhështisë personale për të Vërtetin dhe dukja e dritës shkëlqyese për bukurinë e të Bukurit të pakushtëzuar, është pikërisht ai vërshim i pakushtëzuar dhe ai vullnet ndriçues, është drita që përmendet në hadithin e nderuar: "Allahu krijoi mendjen prej dritës së Tij. Ajo është krijesa e parë prej shpirtërorëve në të djathtën e Arshit." Mendja u krijua prej vërshimit të dritës së Dhënësit absolut.

Me këtë shpjegim hiqet edhe dyshimi që ka ardhur në hadithin e nderuar, në lidhje me frazën e hadithit: "Allahu e krijoi vullnetin me vetë vullnetin" Për këtë s'është nevoja as për interpretimin e dimensioneve të largëta të studiuesit të madh Mijrdàmàd *(Allahu i ndriçoftë fytyrën!)*, as për shpjegimin e bollshëm e të rrallë të studiuesit të nderuar, ose për shpjegimin e çuditshëm të dijetarit specialist në fushën e hadithit Elmexhlisij, *(Allahu i mëshiroftë të dy!)*.

Por akoma më e habitshme është fakti që edhe filozofi i madh islam, ajka e teologëve *(Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!)* gjithashtu, e ka larguar shikimin prej studimit që kanë bërë ata që kanë arritur gradën e njohjes dhe mendjet e ndritura mbi këtë hadith, por e ka interpretuar në një mënyrë të kundërt, në një kohë që hadithi konsiderohet një dëshmues i madh për këtë çështje. Në kumtesën "Misbàhul-hidàjeti" është studiuar me imtësi vërtetimi i këtij qëllimi, si dhe paditë e ndërsjella, të bëra mes dijetarëve të mëdhenj e burrave të urtë, në lidhje me referimin e frazës: "e pa që ka dalë". Kush ka dëshirë le të lexojë në lidhje me këtë çështje dhe atëherë gjendja do të zbulohet krejtësisht.

PIKA E DYTË

Të analizojmë frazën e hadithit: "Allahu krijoi mendjen". Në këtë hadith krijimi i mendjes i adresohet Allahut. Fjala Allah është "emri më i madh" (El-ismul-aëdham) gjithëpërfshirës, emër në numrin njëjës, por që është në pozitën e shumësit. Prandaj mund të tregojë zbulimin e plotë në pasqyrën e mendjes së parë, që shfaqet në të gjitha punët, kurse e vërteta e mendjes është një dukuri e plotë në të gjitha shkallët e zbulesave morale.

Rezultantja e kësaj fraze të hadithit është vetëm kështu: Dituria është te Allahu; i Vërteti i Lartësuar e i Madhëruar, zbulohet e shfaqet madhërishëm sipas zbulimit të emrit më të madh dhe pozitës së njëjësit në shumësin, si dhe të pozitës së shfaqjes së dritës vërshuese të shenjtëruar, të pakushtëzuar, ndërmjetësi i Tij në pasqyrën e mendjes së parë dhe në të gjitha punët përgjithësuese e të pozitave të atyre punëve. Këtu qëndron edhe shkaku që është shprehur për krijesën e parë me dritën e shenjtëruar të Profetit, vulë e të gjithë profetëve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!),* nisur nga baza se ai është qendra për zbulimin e emrit më të madh dhe pasqyra për zbulimin e pozitës së shumësit e të shumësit të shumësit. Në hadithin e ardhur prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, lexojmë: "E para gjë që ka krijuar Allahu, është drita ime."[1]

Në disa transmetime ka ardhur: "e para gjë që ka krijuar Allahu, është shpirti im."[2]

E dyta, mendja është krijesa e parë prej shpirtërorëve. Bazuar mbi këtë pohim rezulton se joshpirtërorët janë krijuar pas shpirtërorëve.

Qëllimi i përdorimit të fjalës "shpirtërorët" është bota e mendjes dhe të gjitha mendjet e shenjta, lineare dhe transversale. Përdoret fjala

[1] "Avàlij El'leàlij", vëll. 4,f. 99; "Bihàrul-Envàr", vëll. 15, f. 24.
[2] "Bihàrul-Envàr", vëll. 54, f. 309.

"shpirtëror" për shkak të ndërfutjes së raportit në to ose prej abstraksionit, ose se të gjitha botët janë abstrakte. Cilësimi me fjalën "shpirtëror", ose është ndërtuar mbi abstrakten, ose mbi mposhtjen. Mendja shpjegon se shpirtërorët janë përpara të gjithë qenieve. Mendja më e madhe është përpara të gjithëve dhe është garantuese deri në pamundësinë prej librave logjike.

E treta. Një prej cilësive të mendjes është se ajo është krijuar në të djathtën e Arshit. Lidhja me këtë fqinjësi jep disa mundësi. Njëra prej këtyre mundësive është lidhja që ka mendja me fjalën "krijoi" në grupin foljor: "krijoi mendjen". Kuptimi i këtij grupi është: Krijoi mendjen nga ana e djathtë e Arshit, ajo është e para krijesë. Sipas rregullave të sintaksës së gjuhës arabe është njëkohësisht edhe kundrinor i zhdrejtë, edhe i drejtë. Ky interpretim, në këndvështrimin e autorit është parë më i afërm.

Deduksioni i dytë, lidhur me grupin emëror "krijesa e parë", tregon qëllimin e shpirtërorëve, se mendja është e para krijesë në tërësinë e shpirtërorëve nga ana e djathtë e Arshit.

Deduksoini i tretë rezulton se mendja ka lidhje me shpirtërorët, se mendja është krijesa e parë prej shpirtërorëve, që janë nga e djathta e Arshit dhe qëllimi në këtë gjendje prej shpirtërorëve është bota logjike. Këto dy mundësi i kanë përmendur edhe disa dijetarë të shquar.[1]

Mëso se për Arshin ka kuptime e terma, disa prej të cilave janë shprehur në hadithet e nderuara. Në disa hadithe ka ardhur prej fjalës së atyre që kanë arritur gradën e njohjes (el ma'rifetu) se Arshi është si trupi i përgjithshëm rrethues është tërësia e botës dhe dituria e madhe që u është dhënë profetëve e atyre që e meritojnë. Prej kuptimeve që janë në përputhje me fjalën e të Lartit ٱلرَّحۡمَٰنُ عَلَى ٱلۡعَرۡشِ ٱسۡتَوَىٰ *"Err'rrahmànu alel-arshi-stevà"*

[1] "Sadrul-Mute'eh'hilijn".

"I Gjithmëshirëshmi qëndron mbi Arshin"[1] është edhe kuptimi: vërshimi i zgjeruar që është barazia e Allahut dhe shfaqja e pushtetit hyjnor.

Bazuar mbi këtë kuptim mësohet e vërteta se mendja është krijuar në anën e djathtë të Arshit dhe se mendja është dukuria e parë më e afërt te e vërteta. Gjithashtu, zbulesa e mendjes është para të gjithë zbulesave, për faktin se mendja është në kufi me anën e djathtë, kurse shprehja "يَدُ اللهِ" *"jedu-ll'llàhi"* "Dora e Allahut", konsiderohet vërshimi i dritës që shihet me sy që shkon drejt shumimit.

Pikërisht në këtë vërshim gjendet e djathta dhe e majta, kurse nga këndvështrimi i të qenët Një e i Vetëm thuhet:

"كِلْتَا يَدَيْهِ يَمِيْنٌ" *"kiltà jedejhi jemijnun"* "të dyja duart e Tij janë e djathtë".

Me këtë interpretim të Arshit, fjala e Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

"مِنْ نُورِهِ" *"min nùrihi"* "prej dritës së Tij", është shpjegim për Arshin, nëse e interpretojmë dritën me shfaqjen faktike dhe, kur dritën e interpretojmë në shfaqjen personale, kjo tregon qëllimin më të lartë të Njëtimit të Allahut dhe të zhveshjes, në atë mënyrë që lapsi e ka të pamundur ta shpjegojë. Nisur nga ky pohim, hadithi konsiderohet prej fjalëve të vështira dhe dukshmëria e hadithit konsiderohet zbulimi i sekretit. Pikërisht kjo është veçoria e katërt prej veçorive të mendjes, veçori të cilën e tregon hadithi.

E pesta, siç përmendëm më sipër, mendja është krijuar prej dritës së shtrirë, të gëzueshme, prej vërshimit ndriçues, krahas faktit se gjithçka është shtëpia e vërtetimit për shfaqjen e vërshimit të shtrirë, të gëzueshëm dhe dukjen e vërshimit ndriçues.

[1] Sure "Tà-Hà", ajeti 5.

Specialiteti i parë i mendjes, ose i të gjitha mendjeve është njoftimi i kërkesës se bota e mendjes është zbulimi i këtij vërshimi dhe i të gjitha trupave ndërmjetës. Nga kjo anë janë dritat e përziera me errësirat sipas gradëve: afër e larg, pak e shumë. Nuk është e vlefshme që krijimi i këtyre t'i adresohet dritës së të Vërtetit, përveçse në këndvështrimin e unitetit e të bashkimit, por nuk është realizimi që shikohet në shumicën.

Me dashjen e Allahut të Lartësuar do të flasim edhe për cilësitë e tjera të mendjes, që akoma nuk i kemi përmendur. Kjo fjalë e jona natyrisht do të jetë në përshtatje me përmasat e librit, krahas asaj që u përmend prej të vërtetës së mendjes dhe cilësive të saj, cilësi që mësohen nëpërmjet krahasimit me të vërtetën tërësore të injorancës dhe krahasimit me tërësinë e të vërtetës së mendjes. Në të njëjtën kohë, kjo shpreh mendimin se gabimi është me botën e madhe, botë kah e cila shpirti priret drejt së keqes, gënjeshtrës e shkatërrimit. Mendimet e pjesshme në botën e zhdukshme, janë zhdukëse të asaj bote të gabuar. Hadithi shumë i njohur i të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "djalli qarkullon ashtu siç qarkullon gjaku në njeriun"[1] tregon se gabimi i përgjithshëm është i rrethuar me pandehma e me gabime të pjesshme, ose tregon se mendimet e pjesshme janë rezultante dhe dukuri të Iblijsit, djallit të madh.

[1] "Avàlij El'leàlij", vëll. 4, f. 113; "Meusùatu atràfil-hadijthi-m'nebevij'ji-sh'sherijf", vëll. 3, f. 94-95.

SHPJEGIMI I CILËSIVE TË INJORANCËS

Në hadithin e mësipërm, cilësitë e injorancës janë përmendur me shenjë, ose me pohim të drejtpërdrejtë.

Cilësia e parë, e vërteta e injorancës u krijua pas së vërtetës së mendjes dhe kjo largësi në kohë, që mësohet prej fjalës "ثُمَّ" *"thum'me"* "më pas" shpreh qartë se injoranca është e krijuar pas mendjes së përgjithshme dhe pas shpirtit të përgjithshëm. Këtë e dëshmon ajo që theksuam më përpara, kur thamë se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka shpjeguar se mendja e përgjithshme dhe shpirti i përgjithshëm janë të parët.

Më pas ai bëri shenjë për mendjet pjesore e për injorancën pjesore që ishte boshti i pikëpyetjes së pyetësit, për faktin e thjeshtë se qëllimi do të ishte për mendjen e për injorancën. Mendja e injoranca janë dy pjesë dhe krijimi i mendjes është pas krijimit të injorancës, sepse lartësimi i kurbës bëhet sipas rregullit të lavdëruar "mundësimi i më të ulëtës" përfundon prej më të ulëtës në më të nderuarën dhe është e kundërta e rregullit të lavdëruar "mundësimi i më të nderuarës në rendin e zbritjes përfundon prej më të nderuarës në të më të ulëtën." Imami (paqja qoftë mbi të!) e ka theksuar rendin e zbritjes në të cilin mendja ka përparësi ndaj injorancës.

Cilësia e dytë, injoranca është krijuar prej detit. Kjo tregon të vërtetën e shpirtit të përgjithshëm dhe cilësimin e shpirtit të përgjithshëm me lirinë dhe se shpirti i përgjithshëm është trup i përbërë, i kufizuar, për te i cili depërton një shumë, madje depërtojnë disa shuma, ashtu siç është deti vendbashkimi i shumave dhe vendi ku grumbullohen të mbledhurat. Interpretuesit më të mëdhenj të hadithit kanë shpjeguar se pikërisht kjo tregon fillimin e injorancës aktive dhe jo të injorancës së mundshme.

Cilësia e tretë dhe e katërt, mësohet prej fjalës "أُجَاجٌ" *"uxhàxh"* dhe *"uxhàxh"* kuptimin i kripur, i hidhur. Gjithashtu, kjo fjalë mund të tregojë

për dy fuqi, të cilat qëndrojnë përballë njëra-tjetrës, pasioni e zemërimi. Në një farë mënyrë, e vërteta e këtyre dy cilësive është në shpirtin e përgjithshëm dhe në një mënyrë tjetër është në përfytyrimin e përgjithshëm. Ky pasion e ky zemërim është i dobët në shpirtrat e pjesshëm.

Përveç kësaj, më sipër thamë se pasioni e zemërimi janë dy cilësi prej cilësive të injorancës, por krahas kësaj, në hadithin e nderuar për këto dy cilësi thuhet se janë prej cilësive të detit. Gjithashtu, ne kemi përmendur se ato tregojnë për shpirtin e përgjithshëm. Në të vërtetë, cilësitë e shpirtit janë më të plota e më të dukshme në dobësitë se sa në të vërtetat dhe janë e kundërta e cilësive të plotësuara. Nga kjo anë, pasioni në tërësinë e shpirtrave në të vërtetë është dashuria për të arritur të plotësuarën, kurse zemërimi është neveri për pakësimin.

E vërteta e të vërtetave dhe sekreti i sekreteve të saj shprehet në praninë e emrave, me mëshirën e hakmarrjen dhe me cilësinë e bukurisë e të madhështisë. Në këtë pozicion ka sekrete që ne nuk do t'i përmendim.

ORIENTIM TJETËR NË KUPTIMIN E FJALËS "UXHÀXH"

Fjala "uxhàxh", siç u shpjegua më sipër, ka kuptimin "i kripur" e "i hidhur". Ka mundësi që kjo fjalë të tregojë për dy shkallë të zbritjes së të vërtetave shpirtërore, njëra prej të cilave është e pandarë prej esenciales dhe tjetra është e pandarë prej varësisë. Në botën e mendjes varësia me trupat, në origjinë, nuk ekziston, kurse esencialja, në botën e mendjes, i nënshtrohet ndriçimit të dritës të së vërtetës dhe pakësimit të mundshëm. Kjo cilësi, në këto botë, vihet në vendin e duhur me plotësimin e detyrueshëm. Mbase kjo është bota që thirret me termin "xheberùt" – "madhështi". Disa filozofë të mëdhenj, prej interpretueseve të hadithit, për frazën "أَلْبَحْرُ الأُجَاجْ" *"elbahrul-uxhàxh"* - "deti i kripur" kanë thënë se shpreh lëndën e lëndëve, grimcën e parë, ku gjendet fillimi i injorancës së mundshme.[1]

Por kjo nuk është në përshtatje me mundësinë që injoranca të jetë qëllim përfytyrimi tërësor kundrejt mendjes tërësore, qëllim për të cilin janë shprehur pjesa më e madhe e dijetarëve, të cilët, me këtë pohim, kanë zbatuar hadithin e nderuar.

Sikur ne të përputhim injorancën me përfytyrimet pjesore, që në të vërtetë janë dukuri të përfytyrimit tërësor, atëherë qëllimi me grupin emëror *det i kripur* mund të jetë për grimcat elementare. Por qëllimi mund të jetë edhe bota e trupave në përgjithësi, ose grimca sekondare dhe fjala *i kripur* shpreh faktin se ajo është e mangët dhe një diçka që mund të bëhet.

Cilësia e pestë e injorancës, janë errësirat. Mbase kjo cilësi shpreh fuqinë djallëzore, e cila është prej veçorive të përfytyrimit dhe i gjithë përfytyrimi është baza e bazave djallëzore dhe djallëzia e të gjitha përfytyrimeve pjesore

[1] "Sherhu Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 406; "Elvàfij lilfrdil-kàshànij", vëll. 1, f. 62.

përfitohet prej errësirave. Nga njëra anë disa prej veçorive të djallëzisë në hadithin e nderuar janë bërë prej cilësive të përfytyrimit, por ky deduksion është në kundërshtim me njelmërinë.

URTËSI HYJNORE

Prej hadithit të nderuar: "Në lidhje me shpjegimin se mendja i atashohet dritës së të Vërtetit dhe injoranca detit të kripur" përfitohet një shprehje shumë pikante, e cila është prej thelbit të urtësisë së lartë dhe prej sekreteve të bukura hyjnore, të nevojshme për kuptimin e së vërtetës, duke shtuar edhe ushtrimet e mendjes në butësinë e natyrës e pastërtinë e sekretit. Më sipër u tha se mendja i atashohet dritës së të Vërtetit dhe injoranca detit të njelmët.

Me këtë mësohet se burimi i të gjitha plotësimeve dhe fillimi i të gjitha pozitave, si dhe burimi i të gjitha dritave morale në praninë e madhështisë dhe teologjia është drita e shenjtë e të Vërtetit të Madhëruar, i Cili nuk është ndonjë qenie prej qenieve dritë. Ai është shkëlqim, plotësim e bukuri, në të cilin shfaqet hija e dritës së përjetshme dhe rreze prej bukurisë së të Bukurit të parë. Fjalën e të Lartit: ٱللَّهُ نُورُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِۚ *«All'llàhu nùru-s'semàvàti uel-erdi"* «Allahu është drita e qiejve dhe e tokës…"[1] deri në fundin e ajetit është një njoftim i bukur dhe një tregim që sjell vetëm kënaqësi.

Prej kësaj pozite hyjnore dhe prej këtij burimi të lartë, në ajetet e nderuara hyjnore e në fjalët bujare të mbajtësve të shpalljes e të mesazheve, ka deklarime e shenja të shumta për këtë fjalë të mençur, që tregon se Allahu është Zoti Një e i Vetëm. Gjithashtu, edhe madhështia e të gjitha botëve e bukuria e plotësimi i mbarë qenieve, të gjitha janë shfaqje të madhështisë së vetë qenies së të Vërtetit të Lartësuar, janë hija e qenies së Tij e rrezatim i plotësimit e i bukurisë së qenies së Tij. Kurse të gjitha mangësitë, errësirat, vështirësitë, pamundësitë, humbjet dhe të gjitha ndyrësitë, ngjeshjet, çdo e keqe, poshtërim e barbari, të gjitha këto të fundit e kanë burimin te mangësia vetjake dhe te deti i njelmët, te ajo grimca që

[1] Sure "En-Nur", ajeti 35.

shihet kur rrezja e diellit hyn në errësirë. Ja kjo është pema e keqe, nëna e degjenerimit dhe lënda e lëndëve për të gjitha këto punë. Këtë e lexojmë në fjalën e të Lartit:

مَّآ أَصَابَكَ مِنۡ حَسَنَةٖ فَمِنَ ٱللَّهِۖ وَمَآ أَصَابَكَ مِن سَيِّئَةٖ فَمِن نَّفۡسِكَۚ

"Mà esàbeke min hasenetin femine-ll'lli ue mà esàbeke min sej'jietin femin nefsike"
"Çdo e mirë që të vjen, të vjen prej Allahut dhe çdo e keqe që të ndodh, vjen prej vetes tënde…"[1]

Çdo dritë e bukuri, padyshim që është vërshim prej fushës së shenjtë dhe të gjitha ndriçimet e bukuritë që nuk kanë shkëlqyer në pasqyrën e personit, patjetër që mbi to ka vepruar e ka ndyrë djalli, që lë vend për tradhti e për kriminalitet dhe bën që të ndodhin mbrapshti, errësirë e varësi prej pamundësisë e mangësisë..

Por kjo urtësi nuk përshtatet e nuk zbatohet në botën e mendjes, sepse mendja është mjeti që shpreh bukurinë e plotë të emrave të Allahut të Lartësuar e dritave të Tij. Vetë bota e mendjes është bota e dritës dhe e plotësimit të mirëfilltë. Prandaj asnjë dorë kurrë s'mund të veprojë fushën e shenjtërisë së Allahut.

Prej këtij shpjegimi u mësua se ushtritë e mendjes janë ushtri hyjnore dhe ushtritë e injorancës janë ushtri djallëzore. Prandaj të metat e mangësitë i referohen djallit, kurse ajo që është e plotësuar, ajo që ka lidhje me të Vërtetin nga këndvështrimi i besimit të plotë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, vjen edhe baza e urtësisë: كُلّٞ مِّنۡ عِندِ ٱللَّهِۖ *"kul'lun min indi-l'làhi"*- "të gjitha vijnë prej Allahut."[2]

Për ta kuptuar më mirë këtë thënie po japim një shembull:

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 79.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 78.

Drita që hyn në shtëpi nga dritarja, është prej diellit. Nga njëra anë kjo dritë është e kufizuar me dritaren dhe nga ana tjetër, sikur të mos ekzistonte dielli, nuk do të ekzistonte as drita e as drita e kufizuar që hyn nëpërmjet dritares.

Ja edhe një shembull tjetër: Kur ne vëmë një pasqyrë me sipërfaqe në madhësinë e një krahu kundrejt diellit, drita që ajo reflekton do të pasqyrohet mbi murin përballë. Në të vërtetë, kjo dritë e pasqyruar është dritë e diellit, por është e kufizuar me pasqyrën. Me fjalë të tjera, sikur të mos ekzistonte dielli, kurrë nuk do të kishte as dritë e as dritë prej pasqyrës e as kufij të dritës së pasqyrës.

ARTIKULLI I KATËRT

SHPJEGIMI I DIÇKAJE NGA TË VËRTETAT: VËNIE PËRPARA, VËNIE PRAPA, ARSYE, INJORANCË, E TËRA DHE E PJESËSHMJA

E vërteta e vënies së mendjes së përgjithshme prapa, është vënia e saj përpara dhe kjo shpjegon shfaqjen e dritës së mendjes prapa perdes së të panjohurës në shfaqjen e vlerave të dukshme morale, bazuar në shkallën zbritëse, shkallë pas shkalle deri sa arrin në zgjidhjen e dëshmisë absolute, pasqyra e së cilës është natyra e përgjithshme. Mësuesi i parë, Aristoteli, ka thënë një shprehje të lartë: "Mendja është shpirti i qetë dhe shpirti është mendje lëvizëse." Kjo vënie përpara e mendjes është një argument që vërteton lidhjen e plotë dhe bashkimin e fuqishëm mes botëve, të shprehur qartë në fjalën e të Lartit: ٨٢ إِنَّمَآ أَمۡرُهُۥٓ إِذَآ أَرَادَ شَيۡـًٔا أَن يَقُولَ لَهُۥ كُن فَيَكُونُ *"...idhà eràde shej'en en jekùle lhù kun fejekùnu"* "Kur Ai dëshiron ndonjë send, mjafton të urdhërojë sendin bëhu dhe ai (sendi) bëhet."[1]

Ajeti i nderuar shpreh vërshimin ndriçues dhe shfaqjen hyjnore të Botës Tjetër. Në transmetimet e nderuara, në pamje të parë, duket se ka një kontradiktë. Në vend të shprehjes "vënia përpara" është përmendur shprehja "vënia prapa", ose shprehja "vënia prapa" është përmendur në vend të shprehjes "vënia përpara". Mbase kjo kontradiktë thekson se e vërteta e mendjes është pikërisht vënia prapa e saj dhe se kjo vënie prapa e mendjes shpreh pikërisht vënien përpara të saj. Me fjalë të tjera, kjo është

[1] . Sure "Ja-Sin", ajeti 82.

një lëvizje rrethore në kurbën ngjitëse e në kurbën zbritëse, por në lëvizjet rrethore fillimi e mbarimi janë vetëm një.

Nëse kjo lëvizje rrethore është shpirtërore, ose nga ana e faktit që për të Vërtetin e Lartësuar s'ka fillim, ashtu siç ka ardhur në hadithin e nderuar: "Në të vërtetë, barku i balenës ishte miraxhi për Junusin *(Paqja e Allahut qoftë për të!)*"[1], gjithashtu edhe ngjitja në qiej qe miraxh për vulën e profetëve *(Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* Pra, vënia përpara mbi të panjohurën absolute është vetë vënia prapa dhe vënia prapa është vetë vënia përpara.

Vënia përpara e mendjes së përgjithshme shpreh kthimin e natyrës së mendjes së përgjithshme në shembullin e përgjithshëm. Shembulli i përgjithshëm shpreh kthimin në shpirtin e përgjithshëm, shpirti i përgjithshëm shpreh kthimin në mendjen e përgjithshme dhe mendja e përgjithshme shpreh kthimin në asgjësimin e plotë. Këtë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar: كَمَا بَدَأَكُمْ تَعُودُونَ *"…kemà bede'ekum teùdùne"* "…ashtu siç u filloi te Ai do të ktheheni"[2] dhe ky kthim përfundon në Kiametin (përmbysjen) e madh.

[1] I ndjeri El Fejd *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)* thotë: "Miraxhi i Profetit *(Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është mrekullia më e madhe hyjnore për disa profetë që kanë pasur miraxh. Miraxhi i Junusit *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* ishte barku i balenës. Në këtë miraxh ai zbriti në tokën e shtatë, ku mori njoftime për përbërësit e tokës. Ja ky është vetë miraxhi.

[2] Sure "El-Araf", ajeti 29.

VËNIA PËRPARA E ARSYES DHE VËNIA E SAJ PARAPA NGA NJË KËNDVSHTRIM I DYTË

Mbase kjo vënie e arsyes përpara e prapa tregon për zbulimin nën emra të dukshëm e të padukshëm, gjithmonë në rrugën e ripërtëritjes së shembujve. Thuhet "ehlul-maërifeti (njerëzit që kanë arritur shkallën e njohjes):[1] *"Nga njëra anë, me këtë ne vërtetuam se koha ka ardhur më vonë për të gjitha vendet e banuara në mbretërimin e në sundimin, banorëve të karakterit njerëzor dhe fuqisë së madhështisë me një rrugë që nuk është në kundërshtim me pozitat e logjikës së shenjtë. Kjo është njëra prej mirësive të veçanta të mirësive të Allahut të Lartësuar për këtë send të çmuar dhe për këtë mirësi kaq të madhe falënderimi e lavdërimi i takon vetëm Allahut."*

Kjo kurbë zbritëse e ngjitëse është tjetër nga ajo që kanë përmendur të urtët e studiuesit.[2]

Vënia prapa e injorancës shpreh një zbritje të vërtetë të përfytyrimit të përgjithshëm në tabelën e përfytyrimeve të pjesshme, të errëta.

Vënia përpara e të vërtetë të panjohur nuk realizohet me anë të faktit se ajo është e kufizuar dhe se mbi ata janë zotëruese dispozitat e shumicës e të sheshimit, në një kohë kur e vërteta logjike është e pastër dhe në të mungojnë dukuritë e sheshimit. Për më tepër, errësira esenciale s'ka asnjë veprim mbi të. Gjithashtu, edhe drita e madhështisë dhe e bukurisë së

[1] Referoju librit "Shpjegimi i mendimeve kryesore", i autorit Dàùd El Kajserij: "Mendimi kryesor shi'i", f. 117; "Mendimi kryesor ismaijlij", f. 210; "Mendimi kryesor shi'i", f. 287; "Mendim kryesor Sulejmànij", f. 359.

[2] Mulla Sadri thotë: Fjala "ikbàl" *vënia përpara*, tregon lëvizjen ngjitëse dhe fjala "idbàr" – *vënie prapa,* tregon lëvizjen zbritëse. Njeriu i plotësuar zotëron të dyja lëvizjet, lëvizjen e vënies përpara ngjitëse dhe lëvizjen e vënies prapa zbritëse.

Allahut e mposhtin shprehjen e hollësishme të krijimit të zi. Prandaj s'ka asnjë pengesë kthimi në të vërtetën e panjohur e të asgjësimit në Qenien e Allahut të Lartësuar. Por kjo është e kundërta e së vërtetës së mendimit dhe e përfytyrimit që lidhet me errësirat e me dukuritë e shumicës, që shkojnë në drejtim të mosekzistencës, kufizimit e largimit prej sheshit të afrimit të përjetshëm dhe të shenjtërisë së përhershme. Kjo nuk ka të bëjë me asgjësimin në këtë prani shenjtërie. Prandaj për atë s'ka as fuqi të kontaktojë këtë vezullim ndriçues e vërshim të përhershëm dhe as përgatitje për të dyshuar në këtë punë hyjnore. Si rrjedhim, ai është larg pozitës së shenjtëruar të eulijave të afërm dhe është i izoluar prej pranisë së nderuar të atyre që kanë arritur shkallën e njohjes.

Përsa i përket vënies prapa të mendjes të pjesshme, kjo shpreh kthimin e vëmendjes te shumica dhe te shqetësimi i mendjeve me dukuritë për të arritur plotësimin, zhvillimin shpirtëror dhe përparimin e brendshëm, në atë mënyrë që pa këto është e pamundur ndodhja e shumicës. Ky është edhe kuptimi, ose njëri prej kuptimeve të "gabimit të Ademit" *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)*. Sikur Ademi *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* të mbetej nën fushën e tërheqjes së të panjohurës e të kësaj gjendjeje asgjësimi, nuk do të bëhej i mundur popullimi i botës dhe arritja e plotësimeve engjëllore. Sikur Ademi të mos i nënshtrohej ngasjes së djallit, ai nuk do të interesohej për shumimin, prandaj ai hëngri prej pemës së grurit, e cila përfaqëson botën tonë në Botën e Xhen'netit dhe me këtë interesim ai hapi portën e shumimit, rrugën e plotësimit e rrugën e kërkimit të plotësimit. Madje hapi portën e qartësimit e të kërkimit të qartësimit, krahas rrugës së dashurisë. Në të vërtetë, ky kthim i vëmendjes së tij, ishte një gabim i domosdoshëm, vendimtar e i paevitueshëm në rrugën e logjikës, në rrugën e sistemit më të plotësuar, në rrugën e fillimit të të gjitha mirësive, plotësimeve ishte sheshi për shtrirjen e mëshirës së përgjithshme dhe mëshirës më të plotë.

E vërteta e vënies prapa është rënia në perden e shtatë[1] dhe nëse nuk bie në këtë perde, është e pamundur grisja e këtyre perdeve.

Vënia përpara e mendjeve të pjesshme shpreh grisjen e shtatë perdeve që gjenden ndërmjet njerëzve dhe Allahut të Lartësuar. Këto perde, në origjinën e në dukuritë e tyre, herë shprehen me shtatëdhjetë perde e herë me shtatëdhjetë mijë perde, sipas shkallëve e pjesëve. Ky fakt shprehet edhe në hadithin: *"...për Allahun ka shtatëdhjetë mijë perde prej drite dhe njëmijë perde prej errësire..."*[2]

Njeriu ndjekës i një rruge, pasi pajiset me ligjet hyjnore, vesh rrobën e ligjit të fesë dhe merret me edukimin e të brendshmes së tij, me skalitjen e sekretit e me pastrimin e shpirtit e të zemrës së tij. Për rrjedhojë, gradualisht në pasqyrën e zemrës së këtij njeriu ndriçojnë shkëlqyeshëm dritat e së panjohurës hyjnore, që mundësojnë për ekzaltime të brendshme, dashuri të formësuar me krijimin. Ky njeri tërhiqet drejt botës së panjohur dhe me ato furnizime të brendshme të panjohura, pasi kalon nëpër këto etapa, fillon të ndjekë rrugën për te Allahu.

Atëherë zemra e tij kërkon të vërtetën dhe e analizon këtë rrugë. Orientimi i tij zhvishet prej natyrës dhe ecën në rrugën e së vërtetës, i orientuar me thëngjillin e zjarrit të dashurisë e me dritën e udhëzimit, njëra prej të cilave përfaqësohet me valëvitjen e dashurisë, kurse tjetra me vezullimin e shpejtë në drejtim të të Dashurit e bukurisë së bukurive të përjetshme. Ky njeri lan duart e fytyrën prej papastërtive të kthimit të vëmendjes kah tjetri dhe drejtohet drejt Qëllimit të qëllimeve, me një zemër të pastruar prej ndyrësirave e prej ligësive të djallit. Kjo është e vërteta e kthimit të vëmendjes në drejtin të atij që nuk është qëllim, të atij që është

---

[1] Për të marrë informacion për shtatë perdet e për kuptimet që ato kanë, lexo librat: "Sherhu usùlul-kàfij", i autorit Mulla Muham'med Sàlih El Màzendaràij (Allahu e mëshiroftë!), vëll. 9, f. 57 dhe librin "Mir'àtul-ukùl", i autorit të madh El Mexhlisij, vëll. 9, f. 71.

[2] "Bihàrul-Envàr", vëll. 55, f. 45, fundi i hadithit 13; "Elfejdu", El Kashànij, vëll. 5, f. 614; "Meusùatu atràfil-hadijthi- n'nebevij", vëll. 3, f. 395.

baza e bazave të pemës që lëshon tymin e së keqes, të ndryshimeve e të shumicës. Kjo është si ai peri i lidhur në dorë, për të mos harruar atë që thotë ajeti i nderuar: إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ *"in'nij vexh'xhehtë vexh'hij lil'ledhij fetare-s'semàvàti uel-erda…"* "Unë me veten time i drejtohen vetëm Atij që krijoi qiejt e tokën…"[1]

Atëherë ai është si miku i Allahut (Ibrahimi), kur ai u largua prej sendeve që perëndonin, sende që shprehin mangësi e dhimbje. Fytyra e zemra e tij arrin shkallën e plotësimit absolut dhe kur ai, me të gjithë qenien e vet, bëhet i asgjesueshëm prej botës e prej gjithçkaje që ka në botë, ai bëhet i përjetshëm me të Vërtetin e Madhëruar, bëhet realitet e vërteta e vënies përpara.

Prej këtij shpjegimi mësohet se është shumë e lehtë të realizohet vënia prapa për injorancën dhe ky është orientimi drejt popullimit të botës dhe vënia përpara plotësohet mbi pemën e keqe të natyrës, ndjekjes së epsheve, zhytjes në errësirat. Por kjo është e vërteta e injorancës. Vënia përpara në të vërtetën e injorancës realizohet vetëm me dy baza të nderuara: njëra prej të cilave është heqja dorë prej egoizmit dhe në përgjithësi heqje dorë prej kësaj bote. Njëkohësisht kjo heqje dorë mban në brendinë e saj edhe lënien e egoizmit vetjak.

Sipas shkallës që injoranca lartësohet në zhvillimet e saj, po aq shtohet në shpirt kjo veçori, domethënë, po aq shtohet dashuria për veten e vetëpëlqimi. Prej këtu Iblijsi (djalli), edhe pse lidhjet e tij vazhduan katërmijë vjet, nuk arriti asgjë më shumë se rrënjosjen e egoizmit dhe për të s'pati fryt tjetër përveç vetëpëlqimit e mendjemadhësisë. Iblijsi arriti deri aty sa t'i kundërvihet dhe të kundërshtojë urdhrin e Allahut të Lartësuar. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar: خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُۥ مِن طِينٍ *"…khalaktenij min nàrin ue khalaktehù min tijnin…"* "…mua më krijove nga zjarri dhe atë e krijove nga balta".[2] Për shkak të injorancës së tij, vetëpëlqimit të dashurisë

[1] Sure "En-Am", ajeti 79.
[2] Sure "El-Araf", ajeti 12.

për veten, Iblijsi nuk e pa dritën e Ademit dhe për rrjedhojë bëri një vlerësim të gabuar.

Baza tjetër është dashuria për plotësimin absolut, që gjendet në brendinë e njeriut, në origjinën e krijimit të tij. Por dashuria ndaj injorancës është e mposhtur dhe e sunduar, ajo ndizet e shuhet, kurse ekzistenca e qenies përjetësisht në Xhehen'nem është pasojë e ndezjes së dritës së krijimit. Kjo plotësohet në mënyrë absolute prej dëshirës për të qenë i përjetshëm në këtë tokë.

KUJTESË E NDERUAR DHE REALIZIM I KËNDSHËM I SHPJEGIMIT TË NDRYSHIMIT MES VËNIES PRAPA TË ARSYES E TË INJORANCËS

Të mësohet se ndërmjet vënies prapa të mendjes e vënies prapa të injorancës ka një dallim shumë të qartë, vënia prapa e mendjes shpreh orientimin drejt shumicës dhe botës së natyrës, që konsiderohet bindje e sinqertë dhe e pastër ndaj Allahut të Lartësuar. Nënshtrimi ndaj urdhrit për vënien prapa del prej burimit të madhështisë dhe nga kjo anë, vënia prapa nuk është as veprim në të vërtetën e mendjes e as i rrethuar prej pozitës së shenjtë të mendjes. Mbulimi i kësaj nuk është detyrim, ashtu sikurse thotë zotëruesi i mendjes së përgjithshme: "Prapa atij sendi s'pashë asgjë, përveç përpara pashë Allahun." Mbase qëllimi me këtë vënie përpara dhe hyrje në këtë botë, hyrje në shtëpinë e natyrës, është fjala e Allahut të Lartësuar, që e lexojmë në ajetin e nderuar: وَإِن مِّنكُمْ إِلَّا وَارِدُهَا *"Ue in minkum il'là vàriduhà…"* "Dhe s'ka asnjë prej jush që nuk do t'i afrohet atij (xheh'hen'nemit)…"[1] sepse bota e natyrës shëmbëllen një figurë të Xhehen'nemit, gjithashtu edhe xhehen'nemi shëmbëllen të brendshmen e botës së natyrës.

Prandaj edhe Sirati- ura nëpër të cilën do të kalojnë njerëzit për të hyrë në Xhen'net, është e ngritur mbi Xhehen'nemin. Ka të ngjarë që zjarri e rrethon këtë urë, në kuptimin që Sirati-ura është zgjatur prej brendisë së zjarrit dhe qëllimi më i lartë rezulton, që flakët e zjarrit janë të shuara për besimtarin. Kjo gjë thuhet në transmetimin: *"...zjarri i thotë besimtarit Ditën e Kiametit: "Kalo o besimtar, drita jote e shoi flakën time..."* Shuarja e flakës për

[1] Sure "Merjem", ajeti 71.

besimtarin i referohet faktit se për besimtarin ka një pjesë prej ndriçimit të mendjes dhe sipas pjesës që ka, do të jetë edhe masa e fikjes së flakëve të zjarrit.

Në këtë botë zjarri përfaqësohet me zjarrin e epsheve dhe zemërimin. Por meqenëse besimtari zotëron mendjen e përgjithshme, ai njëkohësisht është i ndotur me këtë botë e me botën e natyrës, prandaj qëllimi i kësaj pune është se drita e mendjes i mposht flakët në masën e sjelljes së tij e të shkallës së ushtrimit të tij. Prandaj edhe është shpjeguar me shprehjen e mësipërme.

Përsa i përket zotëruesve të mendjes së përgjithshme dhe krerëve të eulijave të plotësuar është thënë: *"Ne kaluam dhe ato ishin të shuara."* Kjo thënie vërteton se bota e natyrës s'ka asnjë ndikim në shpirtrat e plotësuara nga çdo anë, prandaj ata janë të siguruar plotësisht prej flakëve të Xhehe'nemtit të natyrës, sepse ata edhe natyrën e kanë bërë hyjnore, madje edhe djalli ka besuar me dorën e tyre.[1]

Për ta shfaqet hapur drita e mendjes së përgjithshme dhe e gjithë natyra është e nënshtruar ndaj gjykimit të tyre. Gjithashtu, edhe nata e botës së natyrës, që prej fillimit të saj deri në agimin e Ditës së Kiametit, është si Nata e Kadrit. Gjatë gjithë kësaj nate ata janë të shpëtuar prej dorës së djallit e prej rrjetave të tij, që janë natyra e punët e saj. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar: سَلَٰمٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطۡلَعِ ٱلۡفَجۡرِ *"Selàmun hije hat'tà matleil-fexhri"* "Ajo është paqe deri në agimin e mëngjesit."[2]

Nisur nga kuptimi i këtij ajeti, në lidhje me Xhehen'nemin, ka ardhur ajo që u tha më sipër: *"Ne kaluam dhe ato ishin të shuara."* dhe, në të drejtën e besimtarit zjarri thotë: *"Drita jote i shoi flakët e mia."*

---

[1] Tregon për hadithin profetik: "S'ka asnjë prej jush që të mos ketë një djall" dhe kur i thanë edhe për ty ka një djall o i Dërguar i Allahut, ai tha: "Po, por Allahu më ndihmoi dhe djalli që ishte me mua pranoi Islamin para meje.", "Avàli-l'lejàlij", vëll. 4, f. 97, hadithi 13; "Musnedi" i Ahmend bin Hanbelit, vëll. 1, f. 257, me pak ndryshim në transmetim.

[2] Sure"El- Kadr", ajeti 5.

Në përgjithësi, në të vërtetë, hyrja e mendjes në botën e natyrës, është hyrje krahas shpëtimit, ose me diçka afër shpëtimit dhe kjo për shkak të bindjes ndaj urdhrit e në zbatim të vendimit. Për mendjen e përgjithshme ka një shprehje prej shikimit të bukurisë së bukurive në pasqyrën e imtësive të shkoqitura në dimensionet e Njëtimit të Allahut, në shumicën dhe kthimin e shumicës e në gjykimin e Njëtimit të Allahut.

Nga kjo anë rezulton se shpëtimi absolut shprehet në fjalën "لاَ إِلَهَ إِلاَّ الله" *"Là ilàhe il'le-ll'llàh"*

"S'ka zot tjetër përveç Allahut", si dhe qëllimi final i të vërtetave të Njëtimit të Allahut (teuhidi).

Për shprehjen "لاَ إِلَهَ إِلاَّ الله" *"Là ilàhe il'le-ll'llàh"* "S'ka zot tjetër përveç Allahut", ka shkallë e gradë të shumta, madje aq sa është edhe numri i njerëzve.

Gjithashtu në Njëtimin absolut "لاَ إِلَهَ إِلاَّ الله" *"Là ilàhe il'le-ll'llàh"* "S'ka zot tjetër përveç Allahut" për të plotësuarit ka shpëtim absolut, që është shpëtimi prej shumicës, që është origjina e pemës së keqe.

Kjo shprehje në këtë gjendje, ashtu siç ka ardhur në transmetimet e shenjta, nuk mund të peshohet me asnjë send.[1]

Njëtimi (tehuidi) i besimtarëve e i mesatarëve është Njëtim i kushtëzuar, për rrjedhojë edhe shpëtimi me këtë Njëtim është i kushtëzuar e i kufizuar, për shkak të ruajtjes e largimit prej botës së natyrës që kishin ata me besim të plotësuar. Kjo u mësua të ishte për eulijatë e Allahut dhe i referohej dallimit të madh nëpërmjet shikimit të bukurisë së bukurive prapa perdes së errësirës nëpërmjet ndriçimit. I afërmi i Allahut, prijësi i besimtarëve, në meditimet që bënte gjatë muajit Shabàn e që janë emërtuar "Munàxhàt Sha'bànijeh", ka thënë: *"...dhe ndriço sytë e zemrave tona me dritën e shikimit në Ty derisa sytë e zemrave të grisin perden e dritës dhe të arrijnë në vetë madhështinë."*[2]

---

[1] Es'sej'jid ibni Tàùs, "Ikbàlul-aëmàl", f. 685.

[2] "Teuhijdu-s'sadùk", f. 18, K. "Thevàbul-muveh'hidijne, hadithi1-3.

Në raport me prijësin e besimtarëve të gjitha perdet ishin dritë, sepse perdja e errësirës kthehet te natyra dhe domosdoshmëritë e natyrës. Ai dhe pasardhësit e tij të ruajtur prej mëkateve, ishin të pastër prej ndotjeve të botës së natyrës e prej perdeve të saj. Madje natyra e dukuritë e saj, në raport me ata, ishte dritë, për shkak se orientimet e tyre të zemrës gjithmonë nuk ishin për ata orientim kah e panjohura hyjnore e qenieve dhe e botës, ishte e kundërta.

Atyre nuk ua tërhiqte vëmendjen asgjë përveç të panjohurave hyjnore. Prandaj edhe shikimi te ata gjithmonë ishte i pranishëm, në atë mënyrë që ata, sipas formës së krijimit, ranë në botën e sundimit e të shikimeve të imtësive, të cilat përsëri, për ta, ishin perde drite. Ata i çanë ato perde me sjelljen e tyre prej eulijave dhe u kthyen në botën e shenjtërisë, u zhveshën plotësisht dhe gjetën të vërtetën. Këtë e thotë ajeti i nderuar:

لِّمَنِ ٱلۡمُلۡكُ ٱلۡيَوۡمَۖ *"…limenil-mulkul-jeume…"* "…për cilin është sot pushteti…"[1]

Për ata Kiameti i madh do të jetë në këtë botë, për ata dielli do të lindë Ditën e Kiametit dhe atë ditë ata do të arrijnë në kuintesencën e Madhështisë, të asaj Madhështie që është bebja e syrit të tyre dhe me të cilën janë të lidhura shpirtrat e tyre. Me Madhështinë e shenjtërisë ata harrojnë çdo gjë tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar.

Allahu na furnizoftë ne dhe ju me një thëngjill ose me një urë prej dritës së tyre!

Në përgjithësi, vënia prapa e mendjes së përgjithshme shpreh hyrjen në shumicën e në shkoqitjen pa mbulesë dhe vënia përpara e mendjes shpreh grisjen e perdes e arritjen në thelbin e madhështisë. Vënia prapa e mendjes, në të vërtetë, është vënie përpara saj, ashtu siç qe hyrja në barkun e balenës miraxh për Junusin *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!).*

Vënia prapa të injorancës nuk është për shkak të bindjes ndaj urdhrave të Allahut të Lartësuar dhe nënshtrim ndaj urdhrit për vënien

[1] Sure "Gàfir, ajeti 16.

prapa. Në të kundërt, ishte për shkak të dashurisë ndaj vetes e vetëpëlqimit, djallëzisë e pangopësisë së epsheve.

Në këtë pikë, vënia prapa ishte e largët, e përzënë dhe e izoluar prej sheshit të shenjtërisë e të afrimit te i Larti, prandaj ata ranë në pusin e errët të botës së natyrës, në atë mënyrë që shpëtimi asnjëherë nuk ishte për ta një veprim i lehtë, sepse ata iu dorëzuan kësaj bote dhe ky dorëzim, nga ana e jashtme, është dorëzim ndaj Xhehen'nemit. Gjithë rrugëtimi i tyre ishte në natyrë dhe qëllimi më i lartë i rrugëtimit të tyre ishte prej vetes te vetja dhe prej një dëshirë në një dëshirë tjetër.

Gjithashtu, edhe udha e tyre e plotësimit ishte udhë drejt injorancës së plotësuar, por injoranca e plotësuar është përfytyrimi i përgjithshëm. Edhe për Iblijsin, që është prej botës së të padukshmëve, ka një zhveshje të botës së Berzahut e një pozitë shembullore, por ai është i rrethuar me dukuritë.

Prandaj ai *"në të drejtën e tij lëviz siç lëviz gjaku në trupin e njeriut"*. Iblijsi është i mbuluar, i përzënë e i mallkuar që me krijimin e tij, prandaj, edhe sikur të bëjë sexhde katërmijë vjet me radhë, kjo sexhde atë vetëm e largon prej sheshit të afrimit dhe e ndalon të arrijë të Dashurin, për shkak se adhurimi i tij është adhurim për dëshirat, për dashurinë ndaj vetes. Prandaj rezultati i të gjitha adhurimeve të tij janë mendjemadhësi e vetëpëlqim. Nga mendjemadhësia, në fund të fundit, ka kundërshtuar urdhrin e Allahut të Lartësuar: خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِن طِينٍ *"…khalaktenij min nàrin ue khalaktehù min tijnin"* "…mua më krijove prej zjarrit dhe atë e krijove prej baltës."[1]

Përzënia e Iblijsit prej afërsisë me shenjtërinë dhe pozitës së njerëzve, ishte për shkak të mendjemadhësisë së tij, për shkak të dashurisë që kishte për veten e vetëpëlqimin, prandaj dalja e tij përpara, sexhdeja e tij dhe lutja e tij, është vënie prapa, për shkak se ai nuk iu bind urdhrit për të dalë përpara" *"...pastaj i tha atij, dil përpara, por ai nuk doli përpara."*

[1] Sure "El-Araf", ajeti 12; Sure "Sad", ajeti 76.

FJALA E HOLLË E NJOHJES DHE E VËRTETA E BESIMIT

Mësoje se Ademi i parë dhe Iblijsi më i madh, të dy janë e vërteta e mendjes dhe e injorancës dhe për secilin prej tyre ka pasardhës e vende ku ata shfaqen në botën e kësaj toke. Të dyja grupimet kanë rol për të luajtur. Dallimi mes dy grupeve është i mundur, në përputhje me ajetet kuranore, të cilat janë si peshorja e madhe, kurse hadithet janë si peshorja e vogël. Mënyra e këtij peshimi është: njeriu e gjen veten në ajetet e Kur'anit Famëlartë, sidomos në tregimin e Ademit e të Iblijsit, në ajetet e nderuara që flasin për Ademin *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!)* prej fillimit të krijimit deri në fundin e rrugëtimit të tij.

Gjithashtu, njeriu e gjen veten edhe në ajetet që kanë ardhur për Iblijsin, në kohën kur ai ishte në botën e qiejve, derisa u përzu prej asaj bote, që të mësojë se prej cilës parti është ai. Rezultati më shembullor i këtij zbatimi është njëra prej edukatave të leximit, të cilat ne i kemi përmendur në "Kumtesë për edukatën morale të faljes së namazit".

Njeriu ka mundësi të ndryshojë jetën e tij e të tjetërsojë dukuritë djallëzore me dukuritë njerëzore. Derisa njeriu është në botën e natyrës, kjo botë është bota e ndryshimit dhe e tjetërsimit. Njeriu, në sajë të fuqisë së ndjenjave që ia ka dhuruar Allahu i Lartësuar, ka mundësi të ndryshojë edhe jetën e mangët materiale. Me këtë dhuratë Allahu ia ka bërë shumë të qartë rrugën e lumturisë e rrugën e mjerimit. Si rrjedhim, njeriu ka mundësi të ndryshojë mangësitë e tij me plotësime, të ulëtat e shpirtit të vet me cilësi të lavdëruara dhe të këqijat me të mira. Fjala mjaft e përhapur se morali i keq, apo cilësia e ulët, janë prej karaktereve që nuk ndryshojnë, është një fjalë pa asnjë bazë, madje është mangësi në njohje dhe në mendim.

Në të vërtetë mosndryshimi e mostjetërsimi i karaktereve s'ka lidhje me këtë kapitull, pasi njeriu, me anë të punës e ushtrimeve, ka mundësi të

ndryshojë e të tjetërsojë të gjitha cilësitë shpirtërore, madje deri edhe frikën, koprracinë, dëshirën e zjarrtë e lakminë, të gjitha këto njeriu ka mundësi t'i ndryshojë në trimëri, bujari, kënaqësi e madhështi shpirtërore. Për njeriun që ecën në rrugën e të Vërtetit dhe atij që kërkon lumturinë e shpëtimin gjatë këtyre pak ditëve, që janë ditët e jetës së tij në këtë botë, këto ditë janë si një shtyrje afati për njeriun dhe janë vendi e koha kur ai mund të bëjë ndryshimin e tjetërsimin, të bëjë përzgjedhjen e të zbatojë vullnetin.

Gjithsesi, njeriut i ka mbetur fare pak prej ditëve të jetës së kësaj bote. Gjatë këtyre ditëve ai duhet të punojë me ngulm që të gjejë veten të shpalosur në fletët e fjalës së Allahut e në hadithet e imamëve të ruajtur prej mëkateve, pasi vetëm këto të dyja janë peshoret për të vërtetën e për të gabuarën, janë rrugët për të dalluar lumturinë e mjerimin, derisa njeriu të njohë veten e të brendshmen e gjendjes së tij, se në cilën parti e në cilën ushtri është. A është prej partisë së të Gjithëmëshirshmit e ushtrive të mendjes, apo është prej partisë së djallit e ushtrive të injorancës?

Sikur njeriu të vërë veten në provë e ta ekspozojë atë para këtij hadithi të nderuar, që ne po mundohemi të shpjegojmë, do të gjejë se është prej ushtarëve të mendjes, sepse ushtritë e mendjes janë sunduese në mbretërinë e shpirtit të tij. Për këtë ai falënderon Allahun e Lartësuar e punon që të pastrojë shpirtin prej ushtrive të injorancës. Ai vë në zbatim dispozitën e mendjes e të ushtrive të mendjes. Këtij njeriu kurrë nuk i rritet mendja me plotësimin e tij të brendshëm, ose me bukurinë e tij, sepse mendjemadhësia është prej rrjetave më të mëdha të Iblijsit, rrjetë me të cilën ai jo vetëm që e pengon udhëtarin në rrugën e të Vërtetit, por edhe e spraps atë të tmerruar.

Dihet se njeriu, sa është në këtë botë, është në shtëpinë e mendjemadhësisë, edhe sikur të arrijë çdo gradë prej gradës shpirtërore të plotësimit, bukurisë, drejtësisë e devotshmërisë. Ai mund të kthejë e të ndryshojë krejtësisht, atëherë fundi i punës së tij patjetër është mjerimi e poshtërimi. Prandaj gjithmonë njeriu kurrë s'duhet të mbahet me të madh me plotësimin që ka arritur, të mos jetë i shkujdesur ndaj vetes e të mos lërë

pas dore kujdesin për gjendjet e tij. Në të gjitha gjendjet ai ka kujdesin e madh që të kapet me përkujdesjet e padukshme të të Vërtetit të Lartësuar dhe kurrë nuk mbështetet në vetveten, në sjelljet e tij, në praktikat e në diturinë që ka e në devotshmërinë e tij, sepse këto janë prej veseve më të mëdha shkatërruese të njerëzimit, janë cytje të djallit dhe janë vese që e bëjnë njeriun të harrojë deri vetveten. Allahu i Lartësuar në fjalën e tij të nderuar, thotë:

وَلَا تَكُونُواْ كَٱلَّذِينَ نَسُواْ ٱللَّهَ فَأَنسَىٰهُمۡ أَنفُسَهُمۡۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡفَٰسِقُونَ ١٩

"Ue là tekùnù kel'ledhijne nesù-ll'llàhe fe'ensàhum enfusehum, ulàike humul-fàsikùne"
"Mos u bëni si' ata që e harruan Allahun dhe Ai bëri që ata të harojnë vetveten; të këtillë janë të shprishurit." [1] Kur njeriu të ndiejë se ushtritë e injorancës e partia e djallit janë bërë zotëruese në brendësi të qenies e të mbretërisë së shpirtit të tij, patjetër duhet t'i nxjerrë ato jashtë me punë e ushtrime dhe të zbrazë shpirtin e tij për atyre ushtrive. Ai duhet të presë dorën e djallit të mallkuar, që ajo dorë të mos veprojë më mbi personin e tij.

Dashtë Allahu i Lartësuar dhe me mbarësinë e Tij, në këto faqe do të shpalosim shpjegimin e ushtrive të mendjes e të injorancës. Shpjegimi do të jetë në masë të kufizuar dhe të thjeshtë, të përshtatshëm për këtë përmbledhje. Gjithashtu, do të bëjmë të qartë mënyrën për mjekimin dhe pastrimin e shpirtrave e të zemrave.

Duhet ditur se çdo njeri patjetër duhet të jetë vetë mjekuesi i zemrës së vet e mjeku i shpirtit të tij, sepse "edukatorja kurrë nuk mund të jetë më e mëshirshme se nëna" dhe njeriu nuk lë t'i dalin prej dore ditët, rastet, koha e dhënë e gjendja e mirë. Prandaj njeriu gjithmonë zgjohet prej shkujdesjes në kohë domosdoshmërie e në kohë gjendje të shtrënguar, ndryshe atij nuk i sjell dobi asnjë ilaç.

I nderuar, derisa kjo mirësi e madhe hyjnore dhe jeta që të ka dhënë Allahu i Lartësuar do të vazhdojnë të jenë të pranishme në ty, derdh gjithë

[1] Sure "El Hashr", ajeti 19.

vullnetin tënd për ditët e sprovës e të dëmit dhe shpëtoje veten prej vështirësive e prej mjerimeve që ty të dalin përpara. Ti sot je në shtëpinë ku ndodh ndryshimi e tjetërsimi, je në shtëpinë ku ti mbjell dhe ku ke mundësi të arrish rezultatin e kërkuar.

Allahu mos e lejoftë që partia e djallit të bëhet zotëruese në ty dhe në këtë gjendje ti i kalon ditët e tua pa bërë asgjë në këtë botë. Mirëpo pas kësaj bote s'pranohet rregullimi e nuk sjell dobi as humbja e as pendimi. Këtë fakt e lexojmë në fjalën e të Lartit:

وَأَنذِرۡهُمۡ يَوۡمَ ٱلۡحَسۡرَةِ إِذۡ قُضِيَ ٱلۡأَمۡرُ وَهُمۡ فِي غَفۡلَةٖ وَهُمۡ لَا يُؤۡمِنُونَ ٣٩

"Ue endhirhum jeumel-hasreti idh kudijel-emru ue hum fij gafletin ue hum là juëminùne" "ti paralajmëroi ata për ditën e dëshpërimit, kur të përfundojë çështja, ndaj së cilës ata ishin të shkujdesur dhe ata nuk besojnë."[1]

Allahu i Lartësuar e di se si do të jetë ajo ditë, dita e dëshpërimit dhe e pendimit. Kurse në raport me ne, kjo ditë s'është më shumë se një njoftim që ne dëgjojmë, ashtu siç thuhet në vargjet e një poezie:

Dëgjojmë një njoftim për Kiametin,

Dhe trupin tënd e prek zjarri që nga larg.[2]

Dëshpërimet e pendimet s'kanë fund në atë ditë. Patjetër që Allahu i Lartësuar ka përgatitur për njeriun, në mënyrë të barabartë, rrugët morale të lartësimit, të plotësimit dhe të arritjes së lumturisë, qoftë lumturisë së brendshme që janë: mendja, fuqia për të dalluar, përgatitja për të arritur qëllimet e larta dhe dashurinë natyrore për të bukurën e plotësimin; qoftë lumturisë së dukshme: jeta, afati i mbarimit të jetës, mjedisi i përshtatshëm dhe gjymtyrë të shëndosha.

Kolonat mbajtëse të këtyre lumturive janë udhëzuesit për në rrugën e të Vërtetit, librat qiellorë, kushtetutat hyjnore e interpretuesit e këtyre

[1] Sure "Merjem", ajeti 39.

[2] Është përmbajtja e një poezie në gjuhën perse.

librave e kushtetutave. Por pavarësisht nga të gjitha këto, njeriu mohon mirësitë hyjnore që s'kanë fund, madje edhe tradhton gjërat që atij i janë lënë t'i ruajë dhe heq dorë prej ndjekjes së mendjes e ligjit të fesë, anon kah ndjekja e dëshirave shpirtërore dhe ndjekja e djajve xhin e njerëz, në vend që të ndjekë udhëzimin e Allahut të Lartësuar, të ndjekë Atë që ka në dorë mirësitë.

Prandaj njeriut vazhdimisht i tërhiqet vëmendja të zgjohet prej gjumit të rëndë në botën e natyrës, të shkundet prej shkujdesjes së gjithanshme, të heqë dorë prej dehjes e kënaqësive, në një kohë që ai i ka humbur të gjitha rastet e mirësitë hyjnore. Të gjitha këto i ofrohen njeriut si kompensim, që me këto cilësi të larta, që i janë dhuruar, të arrijë lumturitë e përjetshme, të kalojë jetën në qetësi dhe të gëzojë Xhenetin e mirësive të mëdha së bashku me profetët e eulijatë e nderuar. Por njeriu ka zgjedhur për veten e tij të jetë në dëshpërim të përhershëm e të jetë shok i xhinëve, i djajve dhe i atyre që do të futen në Xhehenem. Pikërisht për këtë, ai do të tubohet në fushën e gjykimit në errësirat e presioneve, të zjarrit, të prangave e të zinxhirëve të rëndë, të gjarpërinjve dhe të akrepave.

Fundi i rrugëtimit të tij është drejt greminës. Kjo njoftohet në fjalën e Allahut të Lartësuar: وَمَآ أَدۡرَىٰكَ مَا هِيَهۡ ١٠ نَارٌ حَامِيَةُۢ ١١ *"Ue mà edràke mà hijetun, nàrun hàmijetun"* "Ç'është ajo që të njoftoi si është ai, është zjarri me nxehtësinë më të lartë."[1]

Përfytyro gjendjen e këtij të mjeri në dëshpërimet që është, kur të shohë shokët, kolegët e bashkatdhetarët e tij që kanë arritur lumturitë e qëllimet e plotësuara, kurse ai mbeti prapa karvanit të të plotësuarve. Për rrjedhojë, iu bashkëngjit personave me mangësi e njerëzve të këqij. Prandaj për këtë njeri s'ka as rrugë mjekimi e as fashime për mangësitë e tij.

Sot, derisa ne do të vazhdojmë të jemi nën mbulesën e botës së natyrës e nën mbështjelljen e daljes së pasurisë, nuk do të kemi mundësi të përfytyrojmë gjendjet e kësaj bote. Të vërtetat e kësaj bote të panjohur, të

[1] Sure "El -Karia", ajetet 10-11.

banueshme, i ka shpjeguar Allahu i Lartësuar në librat qiellorë, me fjalën e profetëve të mëdhenj e me shpjegimet e ulijave të nderuar. Të gjitha këto, në këndvështrimin tonë, nuk janë prej gjërave të kuptueshme. Kur ne deklarojmë besimin në ato, nga ana e jashtme, ose kur ne besojmë në ato, me logjikë nga ana e argumentit, ose nga ana e adhurimit, të shpjeguara me fjalën e evlijave dhe të dijetarëve, në të vërtetë nuk e kemi besimin e zemrës, besim që është peshorja e plotësimit njerëzor. Nëse me këto këmbë të drunjta ne duam të kapërcejmë këtë rrugë të thepisur e të rrezikshme, kurrë nuk do të arrijmë qëllimin me këto mjete e me këto furnizime dhe do të mbetemi prapa atyre që kanë qëllim të arrijnë vendin ku zbritet në dashurinë.

Hadithi i nderuar, që po trajtojmë, e vë theksim mbi disa çështje, që ne i cekëm më sipër. Në fundin e hadithit lexojmë: *"Të gjitha këto cilësi të larta të ushtrive të mendjes janë së bashku vetëm në një profet, ose në një të porositur prej profetit, ose në një besimtar, zemrën e të cilit Allahu i Lartësuar e ka vënë në provë me besimin. Gjithashtu, edhe prijësi ynë nuk mund të mos ketë ndonjërën prej këtyre ushtrive, që i mundëson atij të plotësohet e të pastrohet prej ushtrive të injorancës. Atëherë ai arrin në gradën më të lartë së bashku me profetët e me të porositurit."*

Prej këtij hadithi të nderuar mësohet se besimtarët, me zemra të pastra e të hapura ndaj dritës së besimit, mblidhen së bashku. Por edhe njerëzit e tjerë, në të cilët është njëra ose më shumë prej ushtrive të mendjes, kanë mundësi që, me anë të ushtrimeve logjike e praktike, jo vetëm të plotësojnë veten e tyre dhe të pastrohen prej ushtrive të injorancës, por edhe të mos mbajnë asnjë përgjegjësi për ato ushtri. Gjithashtu, ata kanë mundësi të zbukurohen e të stolisen me ushtritë e mendjes dhe të arrijnë në gradën më të lartë të plotësimit e të jenë në fqinjësi me profetët e me eulijatë.

ARTIKULLI I PESTË

SHPJEGIM PËRMBLEDHËS I DISA FJALËVE TË HADITHIT TË NDERUAR

Disa fjalë të këtij hadithi kanë të bëjnë me qëllimin origjinal të shpjegimit të fjalës së Imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Njihni mendjen, ushtritë e saj dhe injorancën, ushtritë e saj, që të udhëzoheni në rrugën e drejtë." Prej këtij hadithi mësohet se njohja e mendjes dhe e ushtrive të mendjes, si dhe njohja e injorancës dhe e ushtrive të injorancës, është parathënie për udhëzimin në rrugën e drejtë. Por udhëzimi në rrugën e drejtë realizohet duke kërkuar rrugën e plotësimit të shpirtrave e të pastrimit të tyre.

Gjithashtu, edhe pastrimi i plotë i shpirtrave është një parathënie për të shkuar drejt udhëzimit, ose udhëzimit absolut, drejt njohjes së Allahut të Lartësuar. Pikërisht kjo njohje është baza e bazave. Njohja e Allahut vjen si rezultat i njohjes së mendjes, i njohjes së injorancës dhe i ushtrive të këtyre të dyjave dhe derisa nuk është arritur njohja me shkatërrueset e me shpëtuesit e shpirtit, si dhe me rrugët e distancimit prej njohjes dhe të zbukurimit me njohjen, shpirti kurrë nuk e arrin pastrimin, stolisjen e plotësimin.

Derisa shpirti nuk ka arritur pastrimin e brendshëm dhe derisa s'ka arritur në plotësimet e mesme, ai shpirt nuk do të jetë burim për daljen në dritë të emrave, të cilësive e të njohjes së vërtetë dhe kurrë nuk do të arrijë në njohjen e plotë, sepse të gjitha punët e formësuara dhe moralet shpirtërore janë parathënie për njohuritë hyjnore, të cilat gjithashtu janë parathënie për të arritur të vërtetën e teuhidit *(Allahu është Zoti Një e i Vetëm)* dhe i Vetëm është qëllimi më i lartë në rrugëtimin njerëzor e fundi i rrugës së njohjes.

Udhëzimi drejt mbretërisë më të lartë dhe prej saj në brendësinë e emrave, pastaj prej këtu drejt pranisë së identitetit, pa pasqyrën e shumicës, nuk arrihet ndryshe veçse me njohjen e ushtrive të mendjes e të injorancës: Sem'mà'ah ka thënë: *"Thashë: 'Kurban t'u bëfsha!' Këto nuk i dimë. Ne dimë vetëm aq sa ti na ke mësuar."*

Mëso se njohja e mendjes, njohja e injorancës dhe njohja e ushtrive të këtyre të dyjave është prej veçorive të diturive të fshehta hyjnore dhe e diturive të panjohura të Allahut. Kjo njohje, me të gjitha çështjet, me të gjitha shkallët, gradat, me të gjitha sekretet e të vërtetat, nuk është e lehtë të arrihet, me përjashtim "të miqve" të Allahut dhe dijetarëve të mirëfilltë, atyre që besojnë se Allahut është Një e i Vetëm. Gjithashtu, këtë e arrijnë edhe dijetarët e shkallës më të lartë dhe ata që kanë besimin e plotësuar, të cilët kanë dalë me dritën e njohjes, sjelljet e veta i kanë marrë prej veshjes njerëzore dhe kanë çarë e kanë grisur perdet e botëve të sundimit e të mbretërimit. Këta dijetarë kanë arritur në parimet e ekzistencës, kanë arritur në botën e panjohur e në dëshminë dhe janë njohur me këtë botë me praninë e tyre. Por kjo, siç u tha më sipër, bëhet realitet vetëm për të plotësuarit.

Le të dihet se raporti ndërmjet pranisë konkrete, që është e vërteta e njohjes, së bashku me dituritë e përgjithshme hyjnore, konsiderohen urtësi hyjnore. Por edhe këto janë vetëm njëra prej degëve të urtësisë e të diturisë së njohjes dhe degëve të tjera. Ky raport është si raporti ndërmjet përfytyrimit e shikimit të drejtpërdrejtë, ose si raporti mes iluzionit dhe ëndrrës.

Gjithashtu, edhe shikimi me sy, duke qenë zgjuar dhe ëndrra gjatë gjumit, që të dyja janë prani e shikim me syrin e të dukshmes e të brendshmes, shikim me anë të rrugës së pjesshme e të formësimit. Por kjo është e kundërta e iluzionit, fantazisë e imagjinatës, që në të vërtetë, është shikim iluzionar, është shikim prej së largu. Kështu janë edhe shikimet e pranishme. Të gjitha këto janë prej punëve që i kupton mendja me ndërmjetësinë e argumentit me rrugët e përgjithshme.

Me fjalë të tjera, shikimi shpreh vështrimin në të vërtetat e fshehta e të zhveshura me syrin e mendjes, por gjithashtu shpreh edhe shikimin në punët e dukshme me syrin e shpirtit. Derisa mendja është e kufizuar brenda koncepteve dhe të përgjithësimeve, për mendjen s'ka njohje me shikim e me prani.

Sikur të supozojmë se dituritë janë bërthama e objekteve që shihen me sy, atëherë qëndrimi në këtë koncept konsiderohet perde në syrin e shikuesit dhe derisa këto bërthama nuk janë prishur e nuk janë asgjësuar në tokën e zemrës, ato kurrë nuk mund të jenë parim për arritjen e objekteve të shikueshme me sy dhe derisa në depon e zemrës ka vend për një shikim të pavarur, kjo nuk çon në asnjë rezultat.

Në përgjithësi, marrja dituri për botët e panjohura të mbretërimit, në mënyrë të barabartë, qoftë mbretërimit më të lartë, prej të cilit janë botët e mendjes së përgjithshme, qoftë prej mbretërimit më të ulët, prej të cilit është Iblijsi, ushtritë e tij dhe mendja e pjesshme, arrihet vetëm prej eulijave të plotësuar, të cilët i marrin dituritë e tyre prej burimit të shpalljes hyjnore dhe prej vërshimit të përhershëm.

Sem'mà'ah tha: *"Ne dimë vetëm ato që na ke mësuar ti." Fjala e Imamit: "Pastaj bëri për mendjen shtatëdhjetë e pesë ushtri."*

Mëso se bërja e ushtrive të mendjes dhe bërja e ushtrive të injorancës, është e njëjtë me bërjen mendjes e të injorancës, edhe nëse qëllim janë mendja absolute e injoranca absolute. Është e qartë se këto ushtri anojnë kah mendja e pjesshme dhe kah injoranca e pjesshme, duke përjashtuar shembullin e interpretimit e të kthimit të së dukshmes në të padukshme dhe figurën në kuptim.

Mbështetur mbi këtë, rezulton se kemi të bëjmë me një shembull të shumicës, në të cilën s'ka botë, përveçse me shumicën konceptuale, që është e ngjashme me emrat e me cilësitë e në pozitën e të qenët "i Vetëm".

Më sipër u tha se bërja e ushtrive të mendjes dhe bërja e ushtrive të injorancës është e njëjta bërje e mendjes dhe e injorancës. Nëse qëllimi me bërjen është tharmi i krijimit, ai është krijim i Allahut të Lartësuar, gjithashtu edhe Njëtimi i Allahut (teuhidi) është njohje për të gjitha të mirat.

Kurse bërja e injorancës dhe e ushtrive të injorancës është ndjekje prej mundësive të bërjes së domosdoshmërive esenciale, por që në vetvete është prej çështjeve të diturive hyjnore, çështje që janë realizuar me "urtësinë më të lartë".

Këtu nuk është vendi për të studiuar këto çështje.

Nëse qëllimi me ushtritë janë efektet e këtyre cilësive e plotësimeve, atëherë injoranca është prej domosdoshmërive të ekzistencës, në raport me plotësimet logjike, ose ajo është arritje me ato që fiton njeriu më punën e tij e me ushtrime, por për këto ushtrime e për këtë punë këtu s'ka hyrje të plotë.

Megjithëkëtë ky cilësim i referohet të Vërtetit të Lartësuar, ose ushtrive të mendjes me ndërmjetësim, në kuptimin se të gjitha plotësimet e gjurmët e ekzistencës gjenden në bërjen hyjnore e në punën e njeriut dhe ka lidhje me përgatitjen, por është edhe argumentim me dituritë logjike. Në ushtritë e injorancës, bërja është vijuese dhe rastësore, ashtu siç thuhet në hadithin e nderuar: "Ushtritë e injorancës janë dhënë pas ushtrive të mendjes." Pikërisht kjo dhënie më vonë thekson këtë varësi rastësore, edhe pse zbatimi i saj është shumë larg prej kuptimit të njohjes.

Ajo që shprehet në mënyrë të hollësishme është se i Vërteti i Lartësuar, në Kur'anin Famëlartë, profetët e imamët në hadithet e nderuara, kanë shpjeguar shumë qartë të vërtetat e mendjes, me një gjuhë të njohur për masën e njerëzve, në prizmin e mëshirës për njerëzit dhe secili do të ketë pjesë në këto të vërteta, sipas shkallës së fuqisë së tij kuptuese. Njerëzit i zbresin të vërtetat e fshehta në pozitën e ndijimeve të trupave, me qëllim që edhe për masën e njerëzve, sipas fuqisë së tyre, të ketë pjesë prej botës së të fshehtave.

Por për këtë duhet të arrihet në vendtakimin e diturive, të përfitohet prej dijeve të Kur'anit Famëlartë e prej haditheve të ardhura prej imamëve të ruajtur prej mëkateve, me qëllim që njerëzit të falënderojnë për këtë mirësi e për këtë shpërblim kaq të madh. Vetëm kështu ata bëhen të qëndrueshëm në pozitat e tyre, përmbysin figurën në brendësi dhe e zhveshin mbështjelljen deri në thelbin. Këtë botë ata e përmbysin në Ahiretin, në atë mënyrë sa qëndrimi në kufijtë është rënie në punët shkatërruese, kurse kënaqja me figurën është mbetje prapa karvanit të atyre që çajnë rrugën përpara. Kjo e vërtetë hyjnore shumë e hollë, është dituria me interpretim, që arrihet me anë të përpjekjeve shkencore, me ushtrime logjike të mbushura me ushtrime praktike, me pastrimin e vetes e me pastrimin e zemrave dhe me shenjtërimin e shpirtrave. Allahu i Lartësuar e thotë shumë bukur në këtë ajet: وَمَا يَعۡلَمُ تَأۡوِيلَهُۥٓ إِلَّا ٱللَّهُۗ وَٱلرَّٰسِخُونَ فِي ٱلۡعِلۡمِ *"...ue mà jaëlemu teëvijlehù il'le-ll'llàhu uerr'rràsikhù fil-ilmi..."* "...kuptimin e tyre të saktë e di vetëm Allahu dhe dijetarët e vendosur në dituri"[1]

لَّا يَمَسُّهُۥٓ إِلَّا ٱلۡمُطَهَّرُونَ ٧٩ *"là jemes'suhù il'lelmutah'herùne"* "Atë nuk e prek askush përveç atyre që janë të patër"[2]

Profetët dhe të porositurit janë të vendosur në dituri dhe të pastruar prej mëkateve. Dituria e interpretimit në të gjitha shkallët e saj është e veçantë vetëm për ta, kurse dijetarët e umetit kanë një pjesë të mirë në dituri, sipas fuqisë së qëndrimit të tyre të patundur në dituri dhe pastërtisë së tyre. Prandaj është cituar prej Ibn Abasit *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!): "Unë jam prej të vendosurve në dituri."*

[1]Sure "Al- Imran", ajeti 7.
[2] Sure "El- Vakiah", ajeti 79.

SHPREHJE E HOLLË

Kufizimi i ushtrive të mendjes e i ushtrive të injorancës më këtë numër të veçantë, në të vërtetë është kufizim me të përgjithshmet, me më të rëndësishmet, sepse ushtritë e mendjes e ushtritë e injorancës, me rrugën e shkoqitjes së detajuar, të shpjeguara me shtatëdhjetë e pesë ushtri, shpjegon pozitën e kufizimit e të numërimit. Por ato janë më shumë se shtatëdhjetë e pesë, duke shtuar se ekziston mundësia që disa ushtri të kthehen në të tjera ushtri, me qëllim që numri të kthehet në shtatëdhjetë e pesë.

Por duke mbajtur shënim atë që u tha më lart, nuk lind nevoja për këtë angazhim e për këtë lodhje. Për shembull, e mira është ministri i mendjes, kurse e keqja është ministri i injorancës dhe se mendja është nëna e cilësive të larta, kurse injoranca është nëna e poshtërsive, ashtu si janë të numëruara këto dy lloj ushtrish në hadithin e nderuar. Kështu qëndron edhe drejtësia kundrejt padrejtësisë dhe që të dyja janë prej nënave, duke shtuar se shumë prej ushtrive vihen nën këto dy nëna, duke marrë shënim se shumë ushtri nuk janë përmendur.

Fjala bazë, për të gjitha këto është fjala e profetëve dhe fjala e eulijave, duke shtuar se fjala e Kur'anit Famëlartë nuk është si gjuha e të gjithë autorëve, të cilët merren me analizën, kontrollin, studimin e diskutimin e anëve të koncepteve të përgjithshme dhe në pozitën e degëzimeve, reduktimit e numërimit, punë që janë perde të trasha në rrugëtimin për te Allahu i Lartësuar. Janë këto perde që ia presin rrugën udhëtarit për arritur te i Larti.

Për të gjitha këto, Kur'ani Famëlartë është mbledhësi i të gjitha diturive dhe i të vërtetave të emrave e të cilësive, në atë mënyrë që, në asnjërin prej librave qiellorë e prej librave të tjerë nuk bëhet e njohur Qenia e Allahut të Lartësuar dhe e cilësisë së Tij, ashtu siç bëhen të njohura në

Kur'anin Famëlartë. Kur'ani Famëlartë është përmbledhësi i moraleve, është Libri që bën thirrje për kthimin te Allahu, për ringjalljen.

Gjithashtu Kur'ani bën thirrje për përkorshmëri, për heqjen dorë prej kësaj bote, për refuzimin e natyrës. Në të njëjtën kohë Kur'ani Famëlartë bën thirrje për të marrë sa më pak prej botës së tokës dhe për rrugëtimin drejt pozitës së të vërtetës. Nga kjo anë, për Kur'anin Famëlartë nuk mund të përfytyrohet asgjë e ngjashme në librat e tjerë, për faktin e dukshëm se Kur'ani Famëlartë nuk është si të gjithë librat e tjerë që botohen të ndarë në pjesë, kapituj, hyrje e mbyllje. Vetëkuptohet që ky dallim kaq esencial tregon fuqinë vepruese të Bërësit të Kur'anit.

Prandaj Kur'ani s'ka nevojë për këto mjete ndërmjetësuese që të shpalosë qëllimin e tij të lartë. Për të gjitha këto, ne vërejmë se Kur'ani Famëlartë, vetëm me një gjysmë rreshti, shpjegon një argument të plotë, argument që dijetarët e të urtët mundohen ta shpjegojnë me parathënie të shumta. Kjo për faktin se Allahu është Një e i Vetëm:

لَوْ كَانَ فِيهِمَآ ءَالِهَةٌ إِلَّا ٱللَّهُ لَفَسَدَتَاۚ *"leu kàne fijhimà àlihetun il'le-ll'llàhu lefesedetà…"* "Sikur në ato të dyja (në qiej e në tokë) të kishte zota të tjerë përveç Allahut, ato do të shkatërroheshin…"[1]

لَّذَهَبَ كُلُّ إِلَٰهٍۭ بِمَا خَلَقَ وَلَعَلَا بَعْضُهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍۚ *"…ledhehebe kul'lu ilàhin bimà khaleka ue lealà baëduhum alà ba'din…"* "…atëherë çdo zot do të veçohej me krijesat e tij dhe do të dominonin njëri mbi tjetrin…"[2]

Këto dy ajete janë një argument shumë i detajuar që vërtetojnë teuhidin *(Allahu është Zoti Një e i Vetëm),* prandaj kërkojnë faqe të shumta që të shpjegohen. Por këtë e kanë të qartë vetëm burrat që kanë arritur shkallën e interpretimit, prandaj askush tjetër përveç tyre s'ka të drejtë të veprojë me këto ajete, qoftë edhe me fjalë të lëshuara në mënyrë të përgjithshme, sepse çdo njeri kupton sipas fuqisë që i është dhënë. Kjo njoftohet edhe në fjalën e të Lartit:

[1] Sure "El-Enbijà", ajeti 22.
[2] Sure "El- Muminun", ajeti 91.

أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ ٱللَّطِيفُ ٱلْخَبِيرُ *"elà ja'lemu men khaleka ue huve-l'letijful-khabijru"* "A nuk di ti se Ai që krijoi është i Buti, i Gjithinformuari?"[1]

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنتُمْ *"ue huve meakum ejnemà kuantum"* "dhe Ai është së bashku me ju kudo që të jeni."[2]

فَأَيْنَمَا تُوَلُّواْ فَثَمَّ وَجْهُ ٱللَّهِ *"fe'ejnemà tuvelù fethem'me vexh'hu-ll'llàhi"* "nga çdo anë që të ktheheni, aty është Allahu"[3]

وَهُوَ ٱلَّذِي فِي ٱلسَّمَآءِ إِلَٰهٌ وَفِي ٱلْأَرْضِ إِلَٰهٌ *"ue huve-l'ledhij fis'semài ilàhun ue fil-erdi ilàhun"* "Ai në qiell është Zot dhe në tokë është Zot."[4]

هُوَ ٱلْأَوَّلُ وَٱلْآخِرُ وَٱلظَّٰهِرُ وَٱلْبَاطِنُ *"huvel-ev'velu uel'àkhiru uedh'dhàhiru uelbàtinu"* "Ai është i Pari e i Fundit, i Dukshmi e i Padukshmi."[5]

Çdo njëri prej këtyre ajeteve e vë theksin mbi dituritë e larta e mbi urtësinë që janë para natyrës dhe që janë të veçanta vetëm për Allahun e Lartësuar. Gjithashtu, edhe ai që lexon hadithet e nderuara, të ardhura me rrugët e Ehli Bejtit, të ruajturve prej mëkateve e të pastër, sidomos librin "Nehxhul-Belagah" dhe lutjet e transmetuara prej atyre të ndriturve, në mënyrë të veçantë librin "Es'sahijfetus'sexhàdij'jeh", pastaj i studion e mendon thellë mbi ato që lexon, gjen se në ato ka dituri, gjen se ato libra, me të vërtetë, janë të mbushura me dituri hyjnore.

Në këto libra lexuesi gjen emrat e cilësitë e Allahut të Lartësuar.

Gjithashtu do të gjejë së në to flitet edhe për punët e të Lartit, pa asnjë perde të shkaktuar prej terminologjisë e pa asnjë pengesë në të kuptuarit. Por ato të gjitha janë perde prej Bukurisë së bukurive.

---

[1] Sure "El- Mulk", ajeti 14.

[2] Sure "El- Hadijd", ajeti 4.

[3] Sure "El- Bekare", ajeti 115.

[4] Sure "Ez- Zukhruf ", ajeti 84.

[5] Sure "El- Hadijd ", ajeti 3.

Fjala e Imamit (paqja qoftë mbi të!) *"dhe kur injoranca pa se me çfarë e respektoi Allahu mendjen dhe se sa i dha asaj, në brendësinë e vet fshehu armiqësinë kundër mendjes."* Nëse qëllimi me injorancën është e vërteta e Iblijsit në botën e urdhrit dhe shikimi i injorancës në ushtritë e mendjes, të bashkuara me mendjen, janë të konsoliduara në mendjen, në atë mënyrë që është e pamundur të shihen pa parë bukurinë e mendjes. Injoranca s'ka mundësi të ketë informacion për ushtritë e mendjes. Prandaj patjetër ajo duhet të arrijë këtë informacion me rrugën e pasqyrimit të plotë të mangësive, ose me rrugën e krahasimit të mangësisë me plotësimin, me kuptimin e të kundërtës së saj. Gjithashtu, edhe mbajtja fshehur e armiqësisë shpreh kontradiktën e qenësishme ndërmjet këtyre dy të vërtetave, të cilat, janë shumë larg prej kuptimit të qartë të fjalëve të hadithit të nderuar. Kjo largësi reduktohet në kthimin e të dukshmes në të brendshmen dhe në mbështjelljen që mbulon bërthamën.

Nëse qëllimi me injorancën është dukuri e Iblijsit dhe padituri e injorantëve, atëherë kjo tregon përfytyrimin e ndërsjellë, që është subjekt i njërit prej dy kuptimeve vijuese:

Kuptimi i parë tregon kontradiktën mes fuqisë përfytyruese dhe fuqisë logjike të njeriut, gjithashtu, tregon se mendja e ushtritë e saj janë krijuar para injorancës e ushtrive të saj. Kështu që edhe vënia prapa e ushtrive të çdo njërës prej mendjes e injorancës, tregon përparësinë vetjake të botës së mbretërive më të larta mbi mbretëritë e më ulëtave.

Bazuar mbi këtë, të gjitha ushtritë e mendjes e ushtritë të injorancës janë të realizuara te njeriu me rrugën e vetëmbulimit të krijimit, sepse ushtritë e mendjes ekzistojnë në origjinë, kurse ushtritë e injorancës eksitojnë me anë të ndjekjes, me anë të shikimit të injorancës në mendjen e në ushtritë e mendjes. Por edhe kjo kontradiktë është e inkluduar në njërin prej këtyre dy kuptimeve.

Kuptimi i dytë, tregon dy kategori njerëzish, njëra kategori janë zotëruesit e lumturive e të punëve të jashtëzakonshme (qeramete), kategoria tjetër janë njerëzit e këqij, njerëzit me të meta. Por edhe kontradikta

ndërmjet këtyre dy kategorive është personale dhe e pranishme, kurse shikimi në këtë pozitë, është në kuptimin e njohjes së ndërsjellë, njohje e cila arrihet duke parë shenjat. Allahu është më i dituri.

Fjala e Imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Injoranca tha: 'O Zot, kjo është krijesë ashtu siç jam edhe unë!'"

Pretendimi i injorancës ndaj mendjes është si pretendimi për pozitë më të lartë nga ana e Iblijsit ndaj Ademit *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!)* kur Iblijsi i foli Allahut me mendjemadhësi: خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِن طِينٍ *"…khalaktenij min nàrin ue khalaktehu min tijnin"* "…mua më krijove nga zjarri dhe atë e krijove nga balta."[1]

Këto fjalë të Iblijsit janë për shkak të protestës së tij ndaj pozitës së mendjes dhe për shkak se Iblijsit i pëlqente vetja, Iblijsi adhuronte vetveten dhe kishte dashuri ndaj vetes. Dihet se perdja e dashurisë për veten është prej perdeve të trasha dhe ai që sprovohet me një perde të këtillë, kjo perde jo vetëm që e pengon të sprovuarin prej të gjitha të vërtetave, por e pengon të kuptojë edhe virtytet e të tjerëve e plotësimet e tyre, gjithashtu e pengon të shohë edhe të këqijat e mangësitë që ka në veten e tij. Kjo perde është trashëgimi prej Iblijsit. Kur kjo perde trashet për ndonjë njeri, ai shumë shpejt do të jetë në grupin e trashëgimtarëve të Iblijsit, pavarësisht se nga forma mund të jetë prej bijve të Ademit.

Kjo ndodh pasi peshorja në botën e njerëzve e të mbretërimeve, peshore me të cilën vlerësohen sendet, është lindja. I biri i mbretërimeve Isai, Mesijhu *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kurrë nuk depërton në mbretëritë e qiellit ai që nuk është lindur dy herë."* Kjo lindje e dytë është fillimi i mbretërimeve më të larta, që kalon prej tij me mbretëritë e qiellit, është përputhje me daljen prej perdes që ishte trashëgimi prej Iblisit dhe vërtetim i të vërtetave të emrave, që janë trashëgimi prej Ademit *(Paqja e Allahut qoftë*

[1] Sure "El-Araf", ajeti 12.

mbi të!) është vërtetim edhe me të vërtetat e ushtrive të mendjes. Ky vërtetim është prej komponentëve të vërtetimit të vërtetave të emrave.

Fjala e Imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Atë e krijove, e nderove, e forcove dhe unë jam e kundërta e saj, por unë s'kam fuqi të ndeshem me atë, prandaj më jep edhe mua ushtri, ashtu siç i dhe asaj."*

Studiuesit thonë se kjo fjalë e injorancës dhe kërkesa e saj për të pasur ushtri që të kundërshtojë mendjen, është në kuptimin e përgatitjes dhe jo në kuptimin e fjalës. Por ky shpjegim nuk është në përshtatje me atë që kemi përmendur më përpara, kur kemi thënë se bërja e mendjes dhe e ushtrive të saj, si dhe bërja e injorancës dhe e ushtrive të saj, nuk është në atë mënyrë që mendja bëhet e zhveshur prej këtyre ushtrive dhe pas bërjes së mendjes të bëhen ushtritë e saj.

Kështu qëndron çështja edhe për bërjen e injorancës e të ushtrive të saj. Madje bërja e mendjes është bërja e të gjithë punëve të domosdoshme për atë, ashtu siç vërtetohet në dituritë logjike, se çdo gjë e mundshme për mendjen e përgjithshme, është detyrim për atë, me të njëjtën bërje si bërja e parë. Prandaj është e pamundur për botën e mendjes të ketë një gjendje pritshmërie dhe përgatitje e fuqie. Kjo shprehje është në kuptimin se përgatitja është e zhveshur pak prej vërtetimit, përveçse kur qëllimi është në kuptimin e gjendjes.

Fjala e Imamit (paqja qoftë mbi të!): *"Ai tha: 'Po. Por, nëse pas kësaj do të kundërshtosh, të kam nxjerrë ty e ushtritë e tua prej mëshirës Sime'. Ai tha: 'E pranoj."*

Le të mësohet se ky kundërshtim e kjo nxjerrje jashtë mëshirës, janë në gjendjen e injorancës së përgjithshme, si dhe në mangësinë vetjake. Ashtu siç u theksua më sipër, "nxjerrja" është nxjerrja e krijimit prej fushës së shenjtërisë e madhështisë. Gjendjet e injorancës së pjesshme pas dhënies së ushtrive, që në krijimin me ekspozimin e me kundërshtimin, shprehin nxjerrjen jashtë prej fuqisë për të vepruar me anë të mangësisë e të përballimit me ushtritë e mendjes dhe, pas kësaj nxjerrjeje jashtë, njeriu

arrin në keqbërjen e plotë, del prej fushës së afrimit te i Vërteti i Lartësuar e prej mëshirës së Tij dhe i bashkohet partisë së djallit.

Fjala e Imamit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "...dhe i dha asaj shtatëdhjetë e pesë ushtri."

Mëso se dhënia e këtyre ushtrive për injorancën është për të përforcuar injorancën kundër mendjes e ushtrive të mendjes. Por kjo dhënie nuk është në kundërshtim me ndëshkimin e me largimin prej mëshirës, sepse këto ushtri, janë prej domosdoshmërive logjike, janë domosdoshmëri të bërjes e prej zhvillimeve të botës së natyrës, kontradiktës e kokëfortësisë. Por edhe kjo, në asnjërën anë, nuk është në kundërshtim me përzgjedhjen.

Sikur të mos ishin plotësimet, ushtritë e mendjes dhe ushtritë që qëndrojnë përballë ushtrive të mendjes në gjykimin e përzgjedhjes, shumica e këtyre ushtrive, nuk do të kishte plotësim, si për shembull e drejta që është prej cilësive të plotësuara, kur njeriu cilësohet me këtë cilësi, ai është përzgjedhës, domethënë, sikur ai të ndalojë mizorin nga padrejtësia, të ndalojë mizorin që ai të mos sulmojë.

Kjo gjendje e këtij njeriu e bën të detyrueshme që ai të jetë njeri i drejtë, por ai edhe mund të mos jetë i drejtë. Kështu qëndron puna me të gjitha cilësitë e plotësuara, të cilat së bashku me cilësitë që i qëndrojnë kundrejt, janë të fermentuara në vetë baltën e krijimit të njeriut dhe me ekspozimin para ushtrive kundërshtare. Njeriu është në dispozitën e përzgjedhjes që kur iu dha aktiviteti faktik për secilën prej këtyre cilësive.

Aktiviteti faktik i çdo njërës prej cilësive të të dy grupeve është fillimi i lumturisë ose i vështirësisë dhe janë këto aktivitete që e bëjnë detyrim hyrjen e njeriut në partinë e Mëshirëplotit e në ushtritë e mendjes, ose në partinë e djallit e në ushtritë e injorancës.

Nisur prej këtu, në hadithin e nderuar thotë: "...nëse pas kësaj do të kundërshtosh, do të nxjerrë prej mëshirës Sime ty e ushtritë e tua." Sikur kundërshtimin të mos e bënte detyrim për aktivitetin e shfaqjes së forcave

shpirtërore të ulëta, të cilat bëjnë të dallohet qartë se mbajtësi i këtyre cilësive të ulëta është larg prej sheshit të mëshirës e afrimit pranë madhështisë.

Sikur kundërshtimi të ishte shkak për daljen në dukje të poshtërsive të fermentuara në brumin e krijimit është shkak edhe për shfaqjen e këtyre poshtërsive në veprimtari e në punë, si dhe në tjetërsimin e brendësisë së njeriut në fytyrën e ushtrive të injorancës. Për rrjedhojë, ky njeri shumë shpjet do të largohet prej sheshit të mëshirës dhe mbase në të shuhet drita e krijimit hyjnor. Në këtë gjendje ai është i ngjashëm me djallin, prandaj do të jetë përjetësisht në Xhehenem dhe i larguar prej mëshirës.

Për të gjitha këto marrja me edukimin e shpirtit e me pastrimin e moraleve është dalje prej pushtetit e prej qeverisë së djallit. Kjo është prej detyrave më të mëdha e më të rëndësishme, pasi këto detyra e ngarkojnë njeriun me të gjitha detyrat logjike. Kjo kërkesë vërtetohet në vendin e saj në tri zhvillimet e shpirtit, domethënë rritja e pushtetit e i dashurisë për këtë botë, që është vendi ku kryhen adhurimet formale, kurse krijimi i mbretërimeve dhe i botës së ndarjes është vendi i adhurimeve të zemrës e i edukimit të brendshëm, ndërsa krijimi i madhështisë e i Botës Tjetër, Botës së Ahiretit, është vendi i shfaqjes së adhurimeve shpirtërore, veçimit e teuhidit *(Allahu është Zoti Një e i Vetëm)*. Të gjitha këto janë prej shfaqjeve madhështore të një shenjtërie të vetme dhe gradë të një vezullimi hyjnor.

Raporti i së panjohurës së shpirtit dhe i ndarësit të shpirtit, nuk është raport në mes së dukshmes e i daljes në shesh, por është raport mes shfaqjes e fshehjes së një sendi të vetëm.

Të gjitha dispozitat e këtyre tri zhvillimeve, kalojnë te mbajtësi i tyre, me rastin e zhvillimit e rritjes së tij. Për shembull, kur adhurimet trupore, të urdhëruara në ligjin e fesë, plotësohen me edukatën e jashtme e të brendshme, jo vetëm që sjellin edukimin e brendshëm, por mbjellin në shpirt farën e besimit që Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi).

Gjithashtu, edukimi i brendshëm shton fuqinë e adhurimit dhe e çon njeriun drejt të vërtetave të zhveshjes, bën të qartë sekretin e teuhidit të brendshëm e plotëson motivin e adhurimit. Nga kjo anë, njeriu, në tri zhvillimet e shpirtit, ka detyrë të jetë i vendosur dhe kurrë të mos jetë i shkujdesur në asnjë send prej këtyre tri zhvillimeve.

Vetëm një shikim i qëllimshëm i njeriut në gruan me të cilën ka të drejtë të martohet, ose një gabim i vogël i gjuhës së tij, mund ta pengojë njeriun për një kohë të gjatë që ai të arrijë sekretet e teuhidit e të vërtetave të tij, gjithashtu e ndalon njeriun të arrijë tërheqjet e të Dashurit e qëndrimin vetëm për vetëm me të Kërkuarin, në një kohë që këto dy gjendje janë kënaqësia më e madhe për ata që kanë arritur gradën e njohjes (el ma'rifetu). Qëndrimi në çdo njërën prej këtyre etapave, shkallëve, sjellja pa kujdes dhe interesimi i pakët ndaj të gjitha këtyre zhvillimeve, detyrimisht sjell privimin prej lumturisë absolute dhe e fusin njeriun në kurthet e Iblijsit.

Për shembull, ata që janë duke kryer ritualet e Haxhit e adhurimet e dukshme, kanë kujdes të madh gjatë kryerjes së këtyre adhurimeve e ritualeve, por ka mundësi që atyre djalli i zbukuron adhurimin e figurave e të pikturave, derisa ata, në shikimin e tyre, i konsiderojnë të gjitha plotësime të reduktuara.

Prandaj ata zbresin prej llogarisë së tyre të gjitha plotësimet e dituritë, madje kanë mendim të keq për ata që i përmbahen plotësimeve e diturive dhe me këtë mendim të zbukuruar arrijnë deri aty sa të akuzojnë për ateizëm të gjithë ata që i përmbahen plotësimeve e diturive, ose cilësojnë për misticizëm (tesav'vuf) njerëzit e moralshëm e ata që bëjnë ushtrime shpirtërore. Këta të mjerë i burgosin për vite e vite të shumta, i mbajnë lidhur me pranga e zinxhirë të fortë, për shkak të mënyrës së tyre të adhurimit dhe i akuzojnë për mashtrues, joshës, tundues e yshtës. Nga këto që u thanë, shikojmë se adhurimet në disa persona japin rezultat të kundërt nga rezultati që ato japin.

Namazi është e vërteta dhe esenca e kryeultësisë, përuljes, heqjes dorë prej dëshirave të shpirtit, është udhëtim për te Allahu i Lartësuar, është

miraxhi i besimtarit. Shikojmë se namazi, në disa, prodhon vetëpëlqim, mendjemadhësi.

Kjo mund të ndodhë edhe me ata që ndjekin rrugën e edukimit të brendshëm, rrugën e pastrimit e të zbukurimit të moraleve, pasi djalli bën që ata të bien në rrjetat e tij. Në sytë e tyre djalli pakëson rëndësinë e madhe të ritualeve, adhurimeve trupore, diturive zyrtare e diturive hyjnore. Për rrjedhojë, te ata, të gjitha plotësimet e lumturitë reduktohen vetëm në edukimin e brendshëm, ose përmblidhen vetëm me ushtrimet e me sjelljet. Për më tepër, djalli bën që ata të kenë mendim të keq për njerëzit e virtytshëm. Madje ata kanë mendim të keq edhe për vetë plotësimet, atakojnë dijetarët e ligjit të fesë, kolonat e fesë, dijetarët e fesë dhe dijetarët hyjnorë dhe thonë se ata kanë edukatë të keqe, pavarësisht se janë prej burrave më të pastër e me moralin më të lartë. Megjithëkëtë, krerët e këtyre të ndriturve i fusin në grupin e atyre që do të jenë banorë të Xhehenemit.

Vetëpëlqimi, që është fillimi i poshtërsive më të mëdha shpirtërore, mendjemadhësia dhe paragjykimi i robërve të Allahut, të gjitha këto janë prej trashëgimisë së djallit. Prandaj ata nuk vlerësojnë njeri tjetër përveç vetes së tyre e një pakice që janë si ata, të cilët i emërtojnë me termin "njerëz të Allahut". Gjithashtu, te ata s'ka mirësi, përveçse duke qëndruar në një zhvillim të vetëm.

Por vetëmbyllja, në një shkallë të vetme, sjell privimin prej të gjitha shkallëve, madje i privon ata edhe prej shkallës që pretendojnë se janë. E njëjta gjë është edhe kur një i urtë e një dijetar bie në çarkun që i ka ngritur djalli, duke qëndruar vetëm në ato që ai i sheh të logjikshme. Një person i tillë i shikon të tjerët me përbuzje, dijetarët e ligjit të fesë i konsideron të sipërfaqshëm dhe dijetarët e ligjit të Islamit i quan të përgjithshëm, pa thënë se ç'qëndrim mbajnë ata ndaj njerëzve të zakonshëm. Ky njeri e shokët e tij nuk janë vetëm vetvetja. Ata janë depo e koncepteve dhe e konsideratave të atilla, që i shumëzojnë të tjerët me zero.

Kjo sëmundje vjen vetëm prej anës së qëndrimit të lartpërmendur dhe pushtetit të Iblijsit. Sikur ata të ishin prej atyre që ruajnë praninë, që

ecin në zhvillimet, ose më e pakta, të ishin prej atyre që kanë dijeni për dituritë, për argumentin, për shkallët e së panjohurës, për praninë e shpirtit, zhvillimet e brendshme e të jashtme të shpirtrave, ose të ishin prej atyre që kanë dijeni për lidhjet që kanë shkallët njëra me tjetrën, për mënyrën e rrugëtimit për te Allahu i Lartësuar dhe për mënyrën e daljes prej burgut të vetvetes e të natyrës, kurrë nuk do të ishin sprovuar me kurthet e mëdha të Iblijsit.

Ata nuk do t'i burgoste errësira dhe nuk do të dëbonin njëri-tjetrin, por do të kishin mendim të mirë për njëri-tjetrin, do të përmirësonin në mënyrë të përkryer ato që janë të përbashkëta ndërmjet tyre si vëllezër në besim, do të përsosnin dashurinë e dashamirësinë islame. Këto janë prej parimeve, madje janë prej gjërave më të rëndësishme që mundësojnë arritjen e pastërtisë së brendshme, qartësinë e pastërtinë e shpirtit. Te ata nuk do të ketë më dashuri për vetveten, vetëpëlqim e mendjemadhësi, vese që janë prej rrënjëve të poshtërsive dhe prej ndotjeve të djallit.

Tani, me dashjen e Allahut të Lartësuar, me mbarësinë e me përkrahjen e Tij, do të futemi në qëllimin tonë esencial për shpjegimin e hadithit.

ARTIKULLI I GJASHTË

SHPJEGIMI I DISA USHTRIVE TË ARSYES E TË INJORANCËS

(KY ËSHTË EDHE QËLLIMI I KËSAJ KUMTESE)

QËLLIMI I PARË

SHPJEGIMI I TË MIRËS DHE I SË KEQES

E nisim shpjegimin e frazës: "prej shtatëdhjetë e pesë ushtrive që iu dhanë arsyes", duke ritheksuar se e mira është ministri i arsyes, si dhe bërja e të kundërtës së mendjes, domethënë bërja e së keqes, e cila është ministri i injorancës. Për këtë çështje kemi disa ndarje:

NDARJA E PARË

QËLLIMI I TË MIRËS DHE I SË KEQES

Mëso se kërkimi i të vërtetës të së mirës e të keqes dhe për esencën e këtyre të dyjave, është jashtë qëllimit tonë bazë. Megjithëse e mira dhe e keqja, në librat që janë qarkullim, janë shumë të njohura me përkufizime.

Në shumicën e tyre bëhet përkufizimi i të domosdoshmeve me sendet e duhura dhe i rrethanave anësore me penguesit.

Patjetër duhet ditur se qëllimi nuk është vetë e mira dhe e keqja, ashtu siç i kupton masa. Në të vërtetë, të dyja kanë një kuptim tjetër, të cilin do ta theksojmë më poshtë, sepse kuptimi si e kupton masa nuk është në përshtatje as me qeverisjen e mendjes e as me qenien e saj në ushtrinë e mendjes. Prandaj mund të thuhet se qëllimi me këtë cilësi është e vërteta e krijimit, që theksohet në ajetin e nderuar:

فِطْرَتَ ٱللَّهِ ٱلَّتِي فَطَرَ ٱلنَّاسَ عَلَيْهَاۚ ...*fitrete-ll'llàhi-l'letij fetare-n'nàse alejhà...*"
"...feja e Allahut në të cilën Ai krijoi njerëzit."[1]

Qëllimi më i lartë në këtë çështje është: e mira shpreh këtë cilësi që në brumin e krijimit, kurse e keqja shpreh atë cilësi të fshehur. Shpjegimi i përgjithshëm e i detajuar për këtë është: I Vërteti i Lartësuar, me kujdesin e me fuqinë e Tij, që kur gatoi brumin e baltës së Ademit i dha atij dy cilësi natyrale, njëra prej të cilave është origjinale dhe tjetra është e mbaruar. Këto dy cilësi janë ekuivalente të shkëlqimit të rrugëtimit e të valëvitjes së flamurit të ngjitjes në lartësi drejt arritjes te sendi origjinal, për te i cili është qëllimi.

Gjithashtu, këto dy cilësi janë origjina e të gjitha cilësive të tjera, të fiksuara në brumin e njeriut, domethënë se të gjitha cilësitë e tjera janë degë të këtyre dy cilësive. Njëra prej këtyre dy cilësive është origjinale. Ajo është me karakteristikë origjinale. Kjo është cilësia e dashurisë për të arritur plotësimin absolut, të mirën absolute dhe lumturinë absolute. Kjo cilësi gjendet në qenien e çdo njeriu në vargun e brezave njerëzorë, në mënyrë të barabartë për të lumturin e për të keqin, për të diturin e për injorantin, për të lartin e për të ulëtin.

Sikur njeriu të studiohet me rrënjë në vargun e brezave njerëzorë, në të gjitha grupet e shpërndara e në të gjithë popujt që gjenden në këtë botë, do të rezultojë se nuk do të gjendet as edhe një individ i vetëm që nga

[1] Sure "Err- Rrùm", ajeti 30.

natyra e tij e krijimit të mos jetë i orientuar drejt plotësimit dhe që, në sajë të cilësisë së krijimit të tij, të mos jetë i dashuruar pas së mirës e lumturisë.

Qëllimi me cilësitë e krijuara është punë që vjen prej këtyre dy cilësive dhe që ka lidhje me to, prandaj ato janë prej punëve shumë të qarta e më madhështore. Sikur të mos ishte kështu, atëherë ato nuk do të ishin prej cilësive natyrale të krijimit, ku njëra është cilësi origjinale dhe tjetra është cilësi, degë e varur është cilësia e neverisë që njeriu ka prej pakësimit. Prandaj njeriu largohet prej së keqes e vështirësive. Edhe kjo cilësi është e rrënjosur në brumin e krijimit me pengesë dhe ndjek cilësinë e përparësisë për të shkuar drejt plotësimit.

Edhe neveria prej pakësimit, gjithashtu, është e gatuar në brumin e njeriut dhe "më pas ne do të përmendim një shpjegim në këtë diskutim". Njëra prej këtyre dy cilësive natyrale, që ne përmendëm, është cilësi e brumosur. Ajo nuk është as e mbuluar e as e sunduar prej ligjeve të natyrës, por në të ka mbetur orientimi drejt shpirtërores e të ndriturës. Sikur kjo cilësi e krijuar, të orientohej drejt natyrës, të bëhej e sunduar prej ligjeve të natyrës dhe për të gjithë të ishte e mbuluar prej shpirtërores e botës origjinale të kësaj të fundit, me siguri që do të bëhej fillimi i së keqes, do të bëhej burimi për të gjitha vështirësitë e trysnitë.

Në vijim këtë çështje do ta sqarojmë në detaje.

Qëllimi me të mirën rezulton se ajo është ministri i mendjes, prandaj nën sundimin e kësaj cilësie janë të gjitha ushtritë e mendjes e të gjitha veprimet e tij, sepse e mira është cilësi e brumosur dhe e orientuar drejt shpirtërores e pozitës së saj origjinale, kurse qëllimi me të keqen rezulton se është ministri i injorancës. Prandaj nën sundimin e së keqes janë të gjitha ushtritë e injorancës, sepse e keqja është cilësi e sunduar prej natyrës dhe e mbuluar prej ligjeve të natyrës.

NDARJA E DYTË

QARTËSIMI I QËLLIMIT DHE SHPJEGIMI I TIJ

Mëso se për zemrën, që është qendra e së vërtetës së cilësive të krijuara, ka dy anë. Njëra anë e saj drejtohet kah bota e panjohur shpirtërore, kurse ana e saj e dytë orientohet kah bota konkrete e natyrës. Njeriu është bir i botës së natyrës e i krijuar për këtë botë. Këtë e thekson ajeti i nderuar: فَأُمُّهُۥ هَاوِيَةٌ *Feum'muhù hàvijetun"* "Vendi i tij do të jetë në Hàvijeh."[1]

Sikur njeriu të rritej me parimin e krijimit në mbështjelljen e natyrës e i penguar prej shpirtërores e cilësive dhe marrjes informacion për ligjet e natyrës pak e nga pak, ai do të zhytej në botën e natyrës, instinktet e tij do të rriten dhe për rrjedhojë, mbi njeriun do të jenë zotëruese lidhjet e natyrës.

Që në periudhën e fëmijërisë, te njeriu janë tri etapa, të shoqëruara me tri fuqi: fuqia djallëzore, e cila është pjellë e së gabuarës, fuqia e zemërimit dhe fuqia erotike. Sa herë që te njeriu të rritet kafshëria, te njeriu plotësohen e rriten ato fuqi dhe mbi atë do të bëhen sunduese ligjet e **natyrës e** të kafshërisë. Këtë të vërtetë e thekson fare qartë ajeti i nderuar:

لَقَدْ خَلَقْنَا ٱلْإِنسَٰنَ فِيٓ أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ٤ ثُمَّ رَدَدْنَٰهُ أَسْفَلَ سَٰفِلِينَ ٥ *"Lekad khalaknel-nsàne fij ahseni takvijmin. Thum'me redednàhu esfele sàfilijne."* "Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. Pastaj atë e zbritëm në më të ulëtin e të ultëve."[2]

Ajeti i nderuar tregon dritën e krijimit origjinal, tregon se njeriu u bë i arritur me dorën e të Vërtetit të Lartësuar dhe kjo arritje është forma më e bukur,

[1] Sure "El- Kàriah", ajeti 9.
[2] Sure "Et- Tijn", ajetet 4-5.

forma më e përsosur, sepse i Larti e formësoi njeriun në përputhje me plotësimin absolut dhe me bukurinë e plotë.

Kthimi në më të ulëtin e të ulëtëve tregon perden e natyrës, e cila është më e ulëta e të ulëtave. Kur këto mbulesa, errësira e turbullira bëhen zotëruese mbi shpirtin, në këtë gjendje të vështirë, ndonjë individ mund të shpëtojë veten me forcat e tij dhe të ecë në botën e tij origjinale, në sajë të cilësisë së krijimit të tij origjinal dhe të arrijë në plotësimin absolut, në dritën absolute, në bukurinë absolute e në madhështinë absolute.

Allahu i Lartësuar, me përkujdesjen e Tij të përhershme dhe me mëshirën e Tij të madhe, që të edukojë njerëzit ka dërguar profetët e Tij të mëdhenj dhe ka zbritur librat qiellorë, që të ndihmojë njerëzit nga jashtë, kundër natyrës së krijimit të tyre të brendshëm, që ata të shpëtojnë veten prej kësaj mbështjellje të trashë.

Gjithashtu, në përputhje me natyrën e pastër të krijimit e me cilësitë e lindura, për njeriun janë ndërtuar dispozitat qiellore, argumentet e shkëlqyera hyjnore dhe kushtetutat e profetëve të mëdhenj e të eulijave të nderuar.

Të gjitha dispozitat hyjnore, në tërësinë e tyre, ndahen në dy qëllime: njëri prej këtyre dy qëllimeve është origjinal e i pavarur, kurse qëllimi tjetër është degëzim e i mvarur. Të gjitha kushtetutat hyjnore kthehen te këto dy qëllime ose me ndërmjetësi ose pa ndërmjetësi.

Qëllimi i parë origjinal i pavarur është orientimi i natyrës së krijimit të pastër drejt plotësimit absolut, drejt të Vërtetit të Lartësuar, punëve e cilësive të Tij dhe lidhet me ndërmjetësim ose pa ndërmjetësim me studimet e fillimit e të ringjalljes dhe me kuptimet hyjnore, që janë: besimi në Allahun e Lartësuar, librat qiellorë, profetët, engjëjt dhe Ditën e Fundit.

Gjithashtu, besimi në kolonat e gradëve të rrugëtimit shpirtëror, si dhe shumë prej degëve të dispozitave, siç janë obligimi për faljen e namazit e për kryerjen e Haxhit.

Qëllimi i dytë është i rastësishëm e i mvarur, është nxitja e cilësive të krijimit kundër pemës së keqe të natyrës, e cila është nëna e mangësive, e pakësimeve dhe e sëmundjeve. Por me natyrën kanë lidhje shumë prej çështjeve të krijimit të Allahut, kolonat e thirrjeve kuranore, këshillat hyjnore e profetike, këshillat e imamëve, si dhe kolonat e kapitujve të ushtrimeve, të sjelljes dhe shumë prej degëve të saktësuara në ligjin e fesë, si: agjërimi, sadakatë e detyrueshme dhe të vullnetshme (farz e mustehab), devotshmëria dhe heqja dorë prej imoraliteteve e mëkateve. Këto dy qëllime janë në përputhje të plotë më natyrën e pastër të krijimit.

Ashtu siç e mësove, për njeriun ka dy cilësi, cilësia për ecur drejt plotësimit dhe cilësia e urrejtjes ndaj pakësimit, ndaj mangësisë. Të gjitha dispozitat e ligjit të fesë janë të lidhura me natyrën e pastër të krijimit dhe janë vënë që kjo natyrë e pastër të shpëtojë prej mbulimit të natyrës së errët.

NDARJA E TRETË

Shpjegimi që cilësia e krijuar, e pambuluar është ministri i mendjes, fillimi i mirësive, është vetë e mira dhe cilësia e mbuluar me natyrën është ministri i injorancës, fillimi i së keqes dhe vetë e keqja.

Le të mësohet se prej dëshirës për të arritur plotësimin absolut, dalin degëzimet e dëshirës për diturinë absolute, për fuqinë, për pozitën, për vullnetin e për cilësi të tjera të bukurisë e të madhështisë. Të gjitha këto gjendje, në brumin e krijimit të gjithë njerëzve dhe në lidhje me këtë dëshirë, nuk dallohet njëri grup prej grupit tjetër. Nëse në mes dy grupeve ka diferencim në shkallët e kësaj dëshire, ose ka ndryshim në përcaktimin e plotësimit absolut, atëherë ky ndryshim i dëshirave ka lidhje me shkallën e mbulimit të tyre me natyrën, me varësinë e këtyre dëshirave prej kësaj bote e me punët e saj të shumta, ka lidhje me kuptimin e ndërsjellë që ato kanë për të arritur shumicën, ose për të marrë fare pak prej shumicës, ose me mbulimin e shumtë ose të pakët.

Ndryshueshmëria e njerëzve, nga pikëpamja e mjedisit, zakoneve, shkollave juridike që ndjekin, besimeve dhe të ngjashme me këto, në të vërtetë, të gjitha këto kanë ndikim te njerëzit, nga ana e luajtjes së rolit. Kjo është e mvaruar me natyrën e krijimit e me shkallët e krijimit, por jo në origjinën e krijimit. Kjo ka bërë të ketë kundërshti të mëdha e të shumta.

Për shembull, një filozof i madh, me autoritet, që dashuron filozofinë, ka harxhuar gjithë jetën e tij në studimin e fushave të filozofisë. Pavarësisht nga autoriteti që ka në këto fusha, ai gjithnjë punon për zgjerimin e dijes në fushën e filozofisë dhe për këtë përballon lodhje të mëdha. Këtë ai e bën ngaqë është i pasionuar për ndikimin e pushtetit të tij.

Shembull i ngjashëm me këtë filozof kemi edhe tregtarin që ka dëshirë të madhe të grumbullojë sa më shumë pasuri. Në këtë drejtin s'ka asnjë dallim mes filozofit e tregtarit, për dëshirën e tyre, për të arritur

plotësimin. Por çdo njëri prej tyre e shikon plotësimin prej këndvështrimit të tij personal.

Edhe ndryshueshmëria në përcaktimin e këtyre të dyve ka si shkak mbulimin që ka rënë mbi natyrën e krijimit të këtyre dy personave, megjithëse në të vërtetë ky është një gabim në kriterin e të mbuluarit. Edhe ndryshueshmëria e këtyre dy personave në zakonet, edukatën e besimet, është i mbuluar prej të dashurit të tij absolut, sipas masës së trashësisë së perdes që ka. Çdo njëri prej tyre ka dashuri. Të dy e ndjekin atë që kërkojnë dhe të dy e kalojnë jetën duke arritur jo të dashurin e tyre të vërtetë, sepse të gjitha punët e tyre janë të kufizuara e të mangëta. Kurse i dashuri i kërkuar, nga vetë cilësia e krijimit të pastër, është absolut e i plotë. Ky është edhe shkaku që nuk shuhet zjarri i dashurisë së këtyre dy personave për të arritur atë që ka lidhje me këtë dashuri.

Gjithashtu, sikur atij t'i jepej pushteti që sjell mbretërimi, personi që ka dëshirë për pushtet, kujton se arritja e pushtetit i mundëson arritjen e të kërkuarit, prandaj ai s'ka ndonjë qëllim tjetër veç arritjes së të kërkuarit dhe kur ai e arrin këtë të kërkuar imagjinar, shumë shpejt do të kërkojë një pushtet e një mbretëri tjetër. Për rrjedhojë, kthetrat e dashurisë së tij do të jenë të varura me ndonjë të kërkuar tjetër. Sikur ai të zotëroje edhe këtë mbretëri, me siguri që do të lakmojë të arrijë edhe një mbretëri tjetër veç asaj që arriti. Madje edhe sikur nën pushtetin e tij të hynte i gjithë globi tokësor e fuqia këtij globi, ai përsëri do të mendojë se në rruzujt e tjerë ka mbretëri më të mëdha e më të larta, prandaj ai përsëri, patjetër do të ketë dëshirë të arrijë në ato mbretëri. Madje edhe sikur të ketë mundësi të veprojë në të gjitha botët e mbretërive, ndërkaq mëson për botën e mbretërive, nëse ai nuk beson në ato botë, do të uronte që ato lajme të ishin të vërteta dhe do të dëshironte që në dorën e tij të ishin të gjitha pushtetet e fuqitë për të cilat flitet.

Siç shihet, dashuria për pushtetin dhe instinkti për pushtet absolut nuk njeh kufi te njeriu, është një instinkt, prej të cilit ai nuk shmanget dhe pa ndier përpiqet të dalë prej kufizimit.

Është shumë e qartë se pushteti absolut nuk është kopje e pushteteve kalimtare të kësaj bote, sepse pushteti absolut është vetëm pushteti i Botës Tjetër. Pushteti absolut është vetëm pushteti hyjnor dhe njeriu që kërkon pushtetin hyjnor, që kërkon fuqinë hyjnore e diturinë hyjnore, kërkon Krijuesin e tij[1] dhe për këtë punon që të zbulojë të brendshmen e çdo grimce, me qëllimin që bukuria e së vërtetesës të jetë edhe më e bukur.[2]

Gjithashtu, edhe të këqijat që dalin në këtë botë prej të mjerit njeri, shkaku për këto të këqija është mbulimi i cilësisë së krijimit të pastër, e cila bëhet e keqe me demonstrim për shkak të lidhjes që ka e keqja e me mbulesat që e kanë rrethuar, për rrjedhojë, e keqja bëhet e keqe, pasi më parë ishte e mirë, madje ishte vetë e mira.

Sikur të zhdukeshin këto perde errësire e perde drite që janë në shpirtëroren tonë prej cilësisë së krijimit të pastër, krijesa e pastër e Allahut do të stolisej ashtu siç është formësuar me dorën e fuqisë hyjnore, atëherë te njeriu do të shfaqej dëshira e madhe për plotësimin absolut. Pa asnjë mbulesë e pa asnjë dyshim, do të çahej çdo gjë kalimtare e mbuluar e çdo idhull që gjenden në shtëpinë e zemrës. Ai do të linte gjithë shpirtin e vet e do të hiqte dorë prej dashurisë ndaj atij idhulli, çdo gjë e këtillë, që ekzistonte në të, do ta shkulte me këmbë. Menjëherë do të kapej pas të dashurit, do të shkonte në drejtim të të dashurit dhe, me dashje ose jo, të gjitha zemrat, në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, do të orientoheshin e do të kërkonin plotësimin e cilësisë së krijimit të tij. Për rrjedhojë, çdo gjë që ai ka prej kësaj cilësie krijimi dhe çdo gjë që del prej atij do të jetë e orientuar në rrugën e të Vërtetit dhe së vërtetës. Këto dy dashuri përfaqësojnë rrugën e arritjes në të mirën absolute e në bukurinë e të bulurit absolut. Pikërisht kjo cilësi e pastër e krijimit është fillesa për të mirat, është burimi për lumturitë dhe është vetë e mira.

Falënderimi është vetëm për Allahun e Lartësuar.

---

[1] Këto kuptime janë shkëputur prej vargjeve të poezisë, në gjuhën perse, "Nidhàmij El Kenxhij".

[2] Bën shenjë për karakteristikat e poezisë, në gjuhën perse, "Hàtiful-Esfehànij".

NDARJA E KATËRT

DOMOSDOSHMËRIA
E PËRMIRËSIMIT TË SHPIRTIT

Tani u mësua se të gjitha të mirat burojnë prej dritës së krijimit të pastër të Allahut, derisa ky krijim nuk është mbuluar me perdet e natyrës, derisa ky krijim i pastër nuk ka rënë në rrjetën e dëshirave që e rrethojnë, derisa ky krijim i pastër hyjnor është garantuesi për lumturinë absolute të njeriut, nuk është bërë skllav i Iblijsit.

Gjithashtu, dihet se të gjitha të këqijat burojnë prej cilësisë së krijimit, të mbuluar me perdet e errësirave të natyrës. Këto perde janë burimi i të gjitha brengave e të këqijave në këtë botë e në Botën Tjetër. Për të gjitha këto patjetër duhet të dihet se, kur njeriu tregon shkujdesje ndaj vetes, qoftë edhe fare pak, kur s'ka qëllim përmirësimin e pastrimin e vetvetes dhe ua lëshon frerin dëshirave të veta çdo ditë e më shumë, çdo orë për të shtohet një perde. Perdet shtohen njëra mbi tjetrën, derisa e shuajnë krejtësisht dritën e krijimit të pastër. Për rrjedhojë, nuk mbetet asnjë gjurmë prej dashurisë hyjnore.

Më pas, në këtë njeri të shkujdesur, vjen neveria ndaj të Vërtetit të Lartësuar, ka neveri ndaj çdo gjëje që ka lidhje me Kur'anin Famëlartë, me fenë e Allahut, me engjëjt e Tij, me profetët e mëdhenj, me evlijatë e nderuar dhe me të gjitha virtytet, në zemrën e tij hedh rrënjë armiqësia kundër të Vërtetit të Lartësuar, kundër engjëjve që janë pranë Allahut të Lartësuar. Para tij mbyllen të gjitha portat e lumturive, për atë zihet rruga për të qenë në paqe me Allahun e Lartësuar e me ndërmjetësuesit, me këto ai bëhet i përjetshëm në botën e natyrës, botë që në brendinë e saj është bota e ardhshme është Bota e Ahiretit. Por përjetshmëria në botën e natyrës

është përjetshmëri në ndëshkimin e Xhehenemit. Ky shtim i perdeve e ka shkakun te natyra, domethënë e ka në tri fuqitë. Fuqia e parë është fuqia djallëzorë. Prej degëve të kësaj fuqie djallëzore janë: sqima, mendjemadhësia, rendja për të qenë i parë, mashtrimi, ngritja e kurtheve, hipokrizia, rrena e të ngjashmet me këto vese të ulëta.

Fuqia tjetër është fuqia e zemërimit. Prej degëve të kësaj janë: mendjemadhësia, arroganca, krekosja, rebelimi, vrasja, imoraliteti, fyerja e njerëzve dhe të ngjashme me këto vese.

Pastaj kemi fuqinë erotike. Prej degëve të kësaj fuqie janë: kujdesi për të marrë sa më shumë, lakmia, koprracia e të ngjashme me këto vese të ulëta. Të gjitha këto vese nuk kanë kufi, në kuptimin se kur frerët e njeriut bien në dorën e djallit, ky njeri kurrë nuk ndalet në ndonjë cak dhe kurrë nuk do të jetë i kënaqur me gradën që ka arritur. Ai që ka objektiv arritjen e kryesisë, është i gatshëm të kundërshtojë të gjitha ligjet hyjnore e të gjitha ligjet e fesë. Për të arritur qëllimin e tij të pjesshëm, ai vret e grabit profetët, eulijatë, njerëzit e mirë dhe ata që kanë arritur gradën e njohjes së Allahut të Lartësuar.

Kështu janë dy fuqitë e fundit, kur u lëshohet freri.

Dihet se çdo gradë prej këtyre kënaqësive njerëzore, kënaqësi që i referohen tri fuqive të lartpërmendura, kur këto fuqi janë te njeriu, zemra e tij bëhet e mvarur ndaj këtyre kënaqësive tokësore, në atë masë sa janë edhe tri fuqitë djallëzore në të. Një njeri i tillë është fare i shkujdesur ndaj shpirtërores, ndaj të Vërtetit dhe së vërtetës.

Për shembull: çdo kënaqësi që njeriu e shijon në këtë botë, sikur njeriu të mos jetë i kufizuar me kufijtë hyjnorë, ato kënaqësi, padyshim do ta afronin atë edhe më shumë me këtë botë, lidhjet e tij me këtë botë do të shtoheshin dhe në të njëjtën masë në këtë njeri do të pakësoheshin marrëdhëniet e tij me shpirtëroren e me të Vërtetin. Prej zemrës së këtij njeriu zhduket dashuria hyjnore, për rrjedhojë, pas çdo kënaqësie ai kërkon një kënaqësi tjetër dhe shpirti i tij lakmues dëshiron forca të posaçme për

këto punë. Prandaj pas çdo perdeje që lëshohet para fytyrës së tij, para tij dalin perde të tjera të errëta. Për secilën prej këtyre tri fuqive, dalin qartë rrezet e shpirtit në drejtim të botës së natyrës. Kjo botë hyn në zemrën e në shpirtin e këtij njeriu aq shumë, sa e pengon atë të ecë në rrugën që e çon te Allahu i Lartësuar, në rrugën e kërkimit të Vërtetit të Gjithëfuqishëm.

Humbje e madhe e hidhërim, madje habi e trullosje kur krijimi i pastër që është mjeti ngjitës për miraxhin e eulijave, mjeti që mundëson arritjen pranë Allahut të Lartësuar, kjo cilësi e lartë që siguron kapitalin që i mundëson njeriut të shkujdesur të arrijë plotësimin absolut. Por kur kjo cilësi e lartë është e mbuluar me perdet e kësaj bote, e bën njeriun e shkujdesur të arrijë fundin e së keqes e fundin e largimit prej fushës së shenjtërisë madhështore. Por edhe humbja ka shkallët e saj. Këtë e njofton për këtë vetë i Vërteti i Lartësuar: *"Uel-asri in'nel-insàne lefij khusrin"* **"...betohem në kohën, në të vërtetë njeriu është në humbje të sigurt**"[1] domethënë, humbja më e madhe është kur kapitalin që i siguron njeriut lumturinë e përjetshme, ai e përdor për të ecur në rrugën që e çon atë në brengosje e në të këqijat e përjetshme. Ky kapital që atij ia ka dhënë i Vërteti, e çon atë në majën e plotësimit, por të këqijat e tërheqin atë drejt fundit më të thellë të mangësisë.

O i mjeri njeri! Sa e madhe do të jetë brenga jote ditën kur para syve tënd nuk do të jenë më perdet e natyrës, dita kur ti do të shohësh qartë se gjithçka që ti bëre me aq mundim në botën e tokës, do të jenë në rrugën e mjerimit tënd e të vështirësive të tua. Atë ditë do të shohësh se të është zënë rruga e mjekimit dhe s'ke asnjë fuqi, atë ditë do të shohësh se ti s'ke mundësi të bësh asgjë dhe se nuk do të gjesh asnjë shteg për t'i mbathur prej forcës mposhtëse të pushtetit hyjnor. Për këtë njofton i Larti me fjalën e Tij: يَٰمَعۡشَرَ ٱلۡجِنِّ وَٱلۡإِنسِ إِنِ ٱسۡتَطَعۡتُمۡ أَن تَنفُذُواْ مِنۡ أَقۡطَارِ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِ فَٱنفُذُواْۚ *"Jàma'sherel-xhin'ni uel-insi inis-tetaëtum e tenfudhù min aktàri-s'semàvàti uel-erdi fenfudhù…"*

[1] Sure "El-Asr", ajetet 1-2.

"O xhin e njerëz, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e tokës, bëjeni menjëherë…"[1]

Atë ditë s'ka më rrugë për rregullimin e mangësive të kaluara, s'ka më rrugë për të kërkuar ndjesë për kundërshtimin e urdhrave hyjnore. Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar: ءَآلْـَٔنَ وَقَدْ عَصَيْتَ قَبْلُ *"Al-àne ue kad asajte kablu"* "Tani (po beson), por më parë kundërshtove…"[2]

O i dashur, derisa perdet e trasha të natyrës nuk të kanë asgjësuar plotësisht dritën e krijimit të pastër, derisa ndyrësitë e mëkateve nuk e kanë larguar pastërtinë e brendshme të zemrës tënde, derisa ke akoma mundësi të punosh në këtë botë, e cila është fidanishtja ku mbillet Bota Tjetër, derisa njeriu ka mundësi të ndreqë çdo mangësi e të kërkojë falje për çdo faj, përvishu punës me vullnet, hap para vetes një portë që çon në rrugën e lumturisë dhe dije se, sikur në këtë rrugë të hidhje qoftë edhe një hap të vetëm dhe të hyje në paqe me të Vërtetin e Lartësuar, duke kërkuar ndjesë për të kaluarën, para teje do të hapen portat e lumturisë dhe ty do të vijnë përforcimet prej portës së padukshme.

Perdet e natyrës do të digjen njëra pas tjetrës, drita e krijimit të pastër do të mposhtë errësirat e fituara, do të dallohet qartë pastërtia e zemrës e do të shkëlqejë e brendshmja. Para teje do të hapen portat e mëshirës së Allahut të Lartësuar, fuqia tërheqëse hyjnore do të të tërheqë drejt botës së shpirtërores. Në zemrën tënde do të shkëlqejë dashuria e Allahut dhe në zemrën tënde do të digjet çdo dashuri tjetër përveç dashurisë së Allahut.

Kur Allahu i Lartësuar të shohë në ty pastërtinë e plotë e sinqeritetin, shumë shpejt Ai do të të udhëzojë ty ecjen në rrugën e së vërtetës, gradualisht do të errësojë syrin tënd që të mos e shohësh këtë botë dhe do të të japë dritë me veten e Tij. Ai do të bëjë që në zemrën tënde të

[1] Sure "Err- Rrahmàn", ajeti 33.
[2] Sure "Junus", ajeti 91.

mos ketë vend për asgjë tjetër përveç Atij dhe ty do të të çojë drejt vetes së Tij.

"يَا رَبِّ" *"Jà Rab'b"* "O Zot"

A është e mundur të zgjohet kjo zemër e mbuluar dhe e përmbysur? A është e mundur që ky i shkujdesur e i zhytur në errësirat e natyrës të ecë drejt Botës së Dritës? Po, kjo është e mundur. Vetëm Ti, me fuqinë Tënde, mund të thyesh idhujt që gjenden në këtë zemër dhe të heqësh pluhurin e trupit prej syrit.

"إِلَهِيْ" *"Ilàhij"* "Zoti im"

A e tradhtuam amanetin që Ti na ke lënë? Krijimin e pastër të Allahut ne e vumë nën veprimin e djallit të mallkuar, ne vetë u mbuluam që të mos e shohim krijimin e pastër hyjnor. Unë kam frikë të dal me këtë rrugëtim natyror, me këtë sjellje e me këtë veprim djallëzor pa krijimin e pastër hyjnor. Unë e kam vënë shtëpinë nën veprimin e djallit e të ushtrive të tij, të injorancës e të ushtrive të saj!

"يَا رَبِّ" *"Jà Rab'b"* "O Zot"

Ti na merr për dore aty ku ne nuk kemi fuqi të rezistojmë, na merr për dore me butësinë Tënde, vetëm Ti je Zotëruesi i mirësive të mëdha.

QËLLIMI I DYTË

SQARIMI I BESIMIT DHE I MOSBESIMIT

QËLLIMI ME BESIMIN (IMANIN)

Mësoje se besimi nuk është dituria e kuptimi, sepse dituria e kuptimi janë pjesë që i takojnë mendjes, kurse besimi është pjesë që i takon zemrës. Njeriu nuk është besimtar ngaqë ka dijeni për ekzistencën e Allahut, të engjëjve, të profetëve e të Ditës së Kiametit, pasi edhe Iblijsi kishte dijeni e i kuptonte këto punë. Por i Vërteti i Lartësuar e quajti Iblijsin mohues (kàfir).

Mbase diku ka ndonjë filozof që i argumenton degët e shkallët e besimit në Njëtimin e Allahut (teuhidit) me argumente filozofike. Por ky filozof, në brendinë e tij, nuk beson në Allahun, sepse dituria e tij nuk e kapërcen gradën e mendjes, të përgjithësimit e të arsyetimit që të kalojë në gradën e zemrës, të pjesores, vetëdijes e afrimit të qëllimit drejt intelektit.

أَبَىٰ وَٱسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ ٱلْكَٰفِرِينَ *"…ebà uestekbere ue kàne minel-kàfirijne"* "…ai, (Iblijsi) kundërshtoi, u mbajt me të madh, dhe, për këtë u bë prej mohuesve."[1]

Le të marrim një shembull:

Ne njerëzit, me anë të mendjes, arrijmë mësojmë se të vdekurit nuk e dëmtojnë njeriun, se të vdekurit në të gjithë botën nuk lëvizin as edhe sa një këmbë mize. Gjithashtu, dimë se të vdekurit, në errësirë, nuk përgjigjen. Megjithëkëtë në një natë të errët ne kemi frikë prej të vdekurve dhe kjo frikë te ne del mbi mendjen. Nga njëra anë zemra nuk beson në këtë të vërtetë

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 34.

logjike dhe mendja nuk arrin ta kuptojë këtë, por ata që e çojnë këtë kërkesë të dijes në zemër me anë të përsëritjes së punës dhe guxojnë të shkojnë për të vizituar varret në netët errëta, nuk kanë frikë prej të vdekurve, ata shkojnë të vizitojnë varret natën dhe ndihen të gëzuar me atë vend të qetë.

Ata të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, në mënyrë të barabartë e dinë se të vdekurit nuk dëmtojnë asnjë njeri, por ata janë të ndryshëm në këtë kërkesë. Prandaj dituria s'ka asnjë ndikim mbi kategorinë e parë, në një kohë që besimi (imani) i kategorisë së dytë i nxjerr ata prej vetmisë iluzionare. Nga kjo mësohet se dituria nuk është besimi. Gjithashtu, kjo kërkesë, sipas anës gjuhësore të fjalës është në përshtatje me kuptimin e besimit, sepse besim, nga ana gjuhësore do të thotë i besuar, miratim, siguri e qetësi zemre, veneracion e nënshtrim. Në gjuhën perse është në kuptimin e ndjekjes së një tjetri. Por dihet se ndjekja e tjetrit nuk është dituria e kuptimi.

SQARIMI E PLOTËSIMI I KËSAJ KËRKESE

Mëso se besimi, me njohuritë hyjnore e me bazat e doktrinës së vërtetë, në radhë të parë, realizohet vetëm duke u orientuar kah këto të vërteta me anë të mendimit, të ushtrimeve logjike, të ajeteve të Kur'anit, shpjegimeve dhe argumenteve logjikë. Por kjo etapë është në pozitën e parathënies së besimit. Nuk mjafton që mendja merr pjesën e saj prej këtyre diturive dhe që ajo nuk kënaqet me aq pak sa merr, sepse, siç dihet, mendja ka fare pak ndikim. Gjithashtu, edhe drita që del prej mendjes, është e pakët. Prandaj personi që ka marrë udhën për te Allahu, ka detyrë të merret me ushtrimet e zemrës dhe me të gjitha mundësitë që ka t'i çojë këto të vërteta në zemër, që ajo të besojë në to.

Nga ky këndvështrim, shkallët e besimit janë të ndryshme. Mbase ky është kuptimi i hadithit: "Dituria është dritë, të cilën Allahu e hedh në zemrën e kujt të dëshirojë" sepse dituria është prej Allahut të Lartësuar dhe, derisa dituria është në kufirin e mendjes, ajo është dritë, të cilën pas ushtrive të zemrës, Allahu i Lartësuar e hedh diturinë në zemrat e përshtatshme, e hedh në zemrat që besojnë Allahun. Për shembull, e vërteta e teuhidit *(Allahu është Zoti Një e i Vetëm)* është origjina e bazave të diturive dhe prej kësaj origjine dalin degët e shumta të besimit e të njohurive hyjnore, të cilësive shpirtërore të plotësuara e të cilësive ndriçuese të zemrës, derisa ato janë në kuptimin e mendjes. Megjithëkëtë nuk realizohet asgjë vetëm duke u bazuar në njërën prej këtyre degëve, pasi të veçuara ato nuk e çojnë njeriun në asnjërën prej këtyre të vërtetave.

Për shembull, mbështetja (et'tevek'kul) në Allahun e Lartësuar është njëra prej degëve të besimit, sepse Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid). Ne shumë herë, me anë të argumentit, ose me anë të punëve të ngjashme me argumentin, i plotësojmë kushtet e mbështetjes sonë në Allahun e Lartësuar. Megjithëkëtë, e vërteta e mbështetjes në Allahun nuk është arritur te ne. Të gjithë e dimë se nuk është e mundur të veprohet në mbretërinë e

të Vërtetit të Lartësuar pa lejen e Tij të përjetshme dhe pa shenjën e Qenies së Tij të shenjtëruar, dritëdhënëse. Gjithashtu, askush nuk e mposht dot vullnetin e drejtë të Qenies së shenjtëruar.

Pavarësisht nga kjo, ne përsëri e kërkojmë plotësimin e nevojave prej banorëve të kësaj toke, prej atyre që kanë pasuri e prej atyre që kanë mundësi. Ne e anashkalojmë të Vërtetin e Lartësuar, duke u mbështetur në botën e natyrës, me gjendjet e me punët e saj, në një kohë që mbështetja jonë në të Vërtetin e Lartësuar qëndron qindra herë më lart se mbështetja në natyrën.

Kjo ndodh sepse e vërteta reale e besimit nuk ka arritur në zemrat tona. Edhe i urti e filozofi thotë: "S'ka ndikues tjetër në ekzistencë përveç Allahut."

Por edhe ky filozof e kërkon plotësimin e nevojën prej ndonjë tjetri e jo prej Allahut. Kur adhuruesi i përkushtuar në meditimet e tij përdor shprehjet:

"لاَ حَوْلَ وَلاَ قُوَّةَ إِلاَّ بِاللهِ" *"là haule ulà kuv'vete il'là bil'làh"* "S'ka forcë e fuqi tjetër përveç Allahut" dhe "لاَ إِلَهَ إِلاَّ الله" *"là ilàhe il'le-ll'llàh"* "S'ka zot tjetër përveç Allahut", syri i tij shikon në duart e njerëzve. Kjo ndodh sepse argumenti i tij kurrë s'ka dalë jashtë kufirit të mendjes e prej kuptimit të saj, kurrë nuk ka arritur në zemër. Përmendja (ziqri) e Allahut nuk është më shumë se lëvizje e gjuhës dhe zemra nuk ka shijuar asgjë. Të gjithë ne i lutemi Allahut të Lartësuar me cilësitë e Tij të larta. Ne i drejtohemi me frazën:

مُقَلِّبَ الْقُلُوبِ وَالأَبْصَار

"mukal'libel-kulùbi uel-ebsàr" "Përmbysës i zemrave e i shikimeve" dhe

الخَيْرُ كُلُّه بِيَدِهِ وَالشَّرُّ لَيْسَ إِلَيْهِ

"elkhajru kul'luhù bijedihi uesh'sherr'rru lejse ilejhi" "E mira e gjitha është në dorën e Tij dhe e keqja s'ka të bëjë me Atë."

Megjithëkëtë priremi të orientohemi kah zemrat e njerëzve, gjithmonë urojmë që të mirat të jenë në dorën e njerëzve. Të gjitha këto janë për shkak se zemra s'ka dituri për të vërtetat logjike, ose lutjet e thirrjet tona janë vetëm lëvizje e gjuhës, që kurrë s'kanë arritur në shkallën e përmendjes (ziqrit) së vërtetë. Ne e dimë se Kur'ani Famëlartë ka zbritur prej gurrës së shpalljes hyjnore, që të plotësohet njerëzia e që njeriu të shpëtojë prej burgut të errët të natyrës. Dimë se premtimi e kërcënimi i Kur'anit është i vërtetë dhe i qartë, dimë se e vërteta e Kur'anit është e qëndrueshme dhe se në të gjitha shkallët e Kur'anit s'ka asgjë që mund të jetë në kundërshtim me realitetin. Megjithatë ky libër i madh hyjnor nuk ndikon në zemrat e ashpra as edhe aq pak sa ndikon çdo libër me tregime.

Në të vërtetë, zemrat tona nuk janë të lidhura me premtimet e Kur'anit, që ne t'i zhveshim ato prej kësaj bote të ulët e prej këtij krijimi që do të zhduket, sepse ne nuk i kemi lidhur ato me krijimin e qëndrueshëm. As kërcënimet e Kur'anit nuk ndikojnë në zemrat tona, që ne të ruhemi e të mos bëjmë punë të ndaluara prej Allahut dhe të mos e kundërshtojmë Atë, në dorën e të Cilit janë të gjitha mirësitë.

E gjitha kjo ndodh për shkak se e vërteta e Kur'anit dhe drejtësia e tij s'kanë arritur në zemrat tona. Ne nuk besojmë Kur'anin, për rrjedhojë, edhe kuptimi i mendjes është me ndikim shumë të pakët. Bazuar mbi këtë vlerësim, te ne njerëzit, janë të gjitha mangësitë, të gjitha kundërshtimet e të gjitha rebelimet, si dhe privimi ynë prej të gjitha diturive e prej të gjitha sekreteve. Nga ana e kësaj shprehjeje të hollë, duhet të lexojmë hadithin e sqaruar në këtë përmbledhje.

NDARJA E TRETË

VËRTETIMI I KËTIJ QËLLIM ME ARGUMENT TRANSMETUES

Allahu i Lartësuar ka përmendur në Kur'anin Famëlartë cilësi të veçanta për besimtarët. Gjithashtu, edhe në hadithet e nderuara, të ardhura me rrugët e Ehli Bejtit të pastër e të ruajturve për mëkateve, kanë ardhur cilësi me të cilat është përshkruar besimtari. Prej këtyre cilësive ne s'kemi asgjë, megjithëse ne themi që besojmë në Allahun e Lartësuar, besojmë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, besojmë edhe në shtyllat e tjera të besimit dhe besimin tonë në këto shtylla e mbështesim në argumente. Por e gjitha kjo është vetëm ana që tregon se besimi nuk është ai që kuptohet me mendjen.

Dhe për këtë, Allahu i Lartësuar, në librin e Tij, në Kur'anin Famëlartë njofton:

إِنَّمَا ٱلْمُؤْمِنُونَ ٱلَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ ٱللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ ءَايَٰتُهُۥ زَادَتْهُمْ إِيمَٰنًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ٢

"In'ne-melmuëminùne-l'ledhijne idhà dhukire-ll'llàhu vexhilet kulubuhum, ue idhà tulijet alejhim àjàtuhù zàdethum ijmànen ue alà rab'bihim jetevek'kelùn"

"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, të cilëve kur përmendet Allahu atyre u rrënqethen zemrat dhe kur atyre u lexohen ajetet e Tij, atyre u shtohet besimi dhe, ata mbështeten vetëm në Zotin e tyre."[1] ...deri në frazën:

[1] Sure "El-Enfâl", ajeti 2.

أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُؤْمِنُونَ حَقًّا *"ulàike humul-muëminùne hak'kan…"* "të këtillë janë besimtarët e vërtetë…"[1]

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar i ka përmendur këto cilësi ekskluzive të besimtarëve duke njoftuar se besimtarët i kanë këto cilësi, kurse ata që nuk i kanë këto cilësi, nuk janë besimtarë. Në fundin e ajetit të mësipërm, Allahu i Lartësuar njofton se ata janë besimtarë të vërtetë dhe, prej cilësive të tjera që Ai ka përmendur për këta besimtarë në ajetin e parë, Allahu i përshkruan ata me dy cilësi, cilësia e parë ishte: "…atyre u rrëqethen zemrat kur u përmendet Allahu…" dhe cilësia tjetër e tyre ishte: "…dhe kur atyre u lexohen ajetet e Tij…". Këto ajete i shtojnë atyre besimin. Cilësi tjetër e tyre ishte se ata mbështeten vetëm në Allahun e Lartësuar.

Tani ju që pretendoni se jeni besimtarë dhe keni kuptuar me mendje të gjitha shtyllat e besimit, gjithashtu keni gjetur ose keni endur argumente për të gjitha cilësitë, vështroni në gjendjen tuaj dhe shihni se cila prej këtyre cilësive të veçanta gjendet në zemrat tuaja. Kur ju përmendi Allahun e Lartësuar dhe kur dëgjoni që Ai përmendet (bëni ziqër ose dëgjoni ziqër), ku është ajo frikë te ju, që ishte karakteristikë dalluese për besimtarin? Ajo zemër që nuk e kupton madhështinë e të Vërtetit të Lartësuar, aty nuk hyn madhështia e Lartësisë së Allahut. Prandaj ajo zemër nuk frikësohet prej përmendjes së Tij.

Besimtar është personi, zemra e të cilit e kupton praninë e të Vërtetit të Lartësuar, ka dijeni se Qenia e shenjtëruar është e përjetshme dhe ka gjetur madhështinë e Qenies së shenjtëruar. Nga vetë natyra e pastër e krijimit të tij, njeriu, në praninë e pushtetit të Gjithëpushtetshmit është i ulët e i frikësuar, edhe nëse nuk sheh mangësi në veten e tij. Megjithëkëtë ai e shikon veten sikur është shërbëtor. Gjithashtu, njeriu e ka të qartë se të gjitha fuqitë që ai ka, janë të mangëta, prandaj ato dhe nuk i mundësojnë atij që të dijë plotësisht të vërtetën për Qenien e shenjtë dhe si është Ajo. Personi me më shumë mundësi të nderuara dhe njeriu më i ditur, personi më afër Allahut të Lartësuar është i Dërguari i Allahut, vula e të dërguarve.

[1] Sure "El-Enfâl", ajeti 4.

Me gjithë këto mirësi të mëdha që kishte, ai ka thënë: "Ne nuk të adhuruam Ty ashtu siç duhet të adhurojmë dhe ne nuk të njohim ty ashtu siç je Ti në të vërtetë."

Kur shqiponja s'ka mundësi të fluturojë në ndonjë vend, atëherë si do të jetë puna për mizën e pafuqishme? Kjo cilësi, që ishte prej cilësive ekskluzive të besimtarit, nuk gjendet te ne. Gjithashtu te ne nuk gjenden as cilësitë e tjera dalluese, si shtimi i besimit dhe leximi i ajeteve të nderuara të Kur'anit. Kur ne na lexohen këto argumente të shkruara, ose strukturale, këto ajete, në vend që të na e shtojnë besimin, na shtojnë vetëm mbulim e mosnjohje.

Sa herë gjatë ditëve të jetës sonë e kemi lexuar Kur'anin Famëlartë, që është mrekullia hyjnore më e madhe, sa herë kemi dëgjuar të këndojnë të tjerët Kur'anin Famëlartë, megjithëkëtë drita e Kur'anit Famëlartë nuk ka lindur në zemrat tona dhe këto ajete të Kur'anit nuk e kanë tërhequr vëmendjen tonë. Tani mendo seriozisht dhe shiko në fillimin e në fundin e ajetit nr. 44 të sures "Fus'silet", në të cilin Allahu i Lartësuar urdhëron:

قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ ءَامَنُواْ هُدًى وَشِفَآءٌ وَٱلَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ فِيٓ ءَاذَانِهِمْ وَقْرٌ وَهُوَ عَلَيْهِمْ عَمًى أُوْلَٰٓئِكَ يُنَادَوْنَ مِن مَّكَانٍۭ بَعِيدٍ ٤٤

"…kul huve lil'ledhijne àmenù huden ue shifàun, uel'ledhijne là juëminùne fij àdhànihim vakrun ue huve alejhim amen, ulàike junàdùne min mekànin beijdin"

"…thuaj: ai (Kur'ani) është për besimtarët udhëzues e shërues; kurse për jobesimtarët, në veshët e tyre ka shurdhim dhe ai për ata është verbërim; të këtillët ngjajnë me ata që thirren prej një vendi të largët."[1]

Ku është ky udhëzim e ky shërim i sëmundjeve të brendshme që besimtarët i arrijnë prej ajeteve të Kur'anit Famëlartë? Si është puna me ne që këto argumente nuk ndikojnë te ne dhe nuk hyjnë në veshët tanë, madje për ne ato bëhen perde mbi perde? Patjetër kjo vjen për shkak se drita e besimit

[1] Sure "Fus'silet",ajeti 44.

s'ka hyrë në zemrën tonë, dijet tona kanë mbetur brenda cakut të dijeve dhe nuk janë reflektuar mbi tabelën e zemrës.

Në Kur'anin Famëlartë ka shumë ajete, në të cilat Allahu i Lartësuar njofton:

وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ

"ue alà rab'bihim jetevek'kelùne" "...ata mbështeten vetëm në Zotin e tyre."[1]

Prandaj ne themi: E vërteta e mbështetjes është një shprehje që tregon mbështetjen e të gjitha punëve vetëm në Garantuesin dhe mbështetje në kujdestarinë e Tij, të mos shihet asgjë përveç Atij, gjithashtu do të thotë: Të mos shpresohet prej ndonjë tjetri përveçse prej Tij. Por kjo mbështetje është e ndërtuar mbi katër punë që janë kolonat e mbështetjes së plotë vetëm te Allahu:

E para, besimtari e di që Mbështetësi ka dijeni për nevojën e njeriut.

E dyta, besimtari e di që Allahu është i fuqishëm të plotësojë çdo nevojë.

E treta, besimtari e di që te Allahu ka mëshirë për atë që i mbështet Atij.

E katërta, koprracia është larg fushës së Allahut.

Dhe tani le t'i referohemi gjendjes sonë: A janë arritur në veten tonë këto katër dituri, që kanë lidhje me Qenien e Allahut të Lartësuar? Të gjithë ne shohim një botë me grimcat e qenieve, gjithashtu ne shohim se dituria e Tij ka rrethuar të gjitha qeniet, dimë që fuqia e Tij e plotë është vepruese në tokë e në qiej, dimë që mëshira e Tij është e përgjithshme dhe përfshin të gjitha qeniet. Ne shohin se Ai është pa asnjë mangësi, gjithashtu dimë që koprracia është prej mangësive. Veç këtyre që u thanë, shohin se ne kemi

[1] Sure "Shura", ajeti 36

dituri për secilën prej shtyllave të mbështetjes. Megjithëkëtë mbështetja s'ka asnjë ndikim mbi ne.

Ne kërkojmë mbështetje te njerëzit dhe shpresojmë më shumë prej krijesave. Ne nuk i kërkojmë nevojat tona prej Krijuesit, por i kërkojmë që ato të na plotësohen prej të pafuqishmëve, ne e shtrijmë dorën lakmitare te ata që janë më të ulët, ne gjithmonë përpiqemi të tërheqim zemrat e njerëzve, megjithëse e dimë që i Vërteti është *"Ndryshuesi i zemrave"*. E gjitha kjo vjen për shkak të asaj që u tha më sipër, se dituria që kemi për këto kolona, nuk është se ne besojmë në ato kolona, sepse ne nuk i analizojmë këto kolona në zemrat tona, prandaj s'ka asgjë në zemra prej këtyre kolonave dhe derisa nuk i analizojmë ato, ne kurrë nuk do të arrijmë rezultat prej dijes sonë.

Bazuar mbi këtë shpjegim, mësojmë të vërtetën e thënies: "Këmba e atyre që kërkojnë argumente është prej druri, por këmba prej druri nuk qëndron dot mbi tokë." Në veten tonë ne i kemi gjetur kolonat e mbështetjes me anë të diturisë së fituar, me anë të studimit e të kërkimit të argumentit të përsosur, madje ne nuk kemi asnjë dyshim te argumentet që kemi arritur. Megjithëkëtë, në zemrat tona s'ka asnjë rreze prej dritës së mbështetjes, te ne s'ka asnjë ndikim nga pastërtia e prerjes së shpresës prej njerëzve dhe bashkimit me të Vërtetin e Lartësuar, edhe pse kjo veçori e besimit te ne është gjithashtu me bollëk.

Ja kështu veçoritë e besimit dhe shenjat dalluese të tij nuk gjenden te ne, madje as vetë besimi nuk gjendet te ne. Ajetet kur'anore që e dëshmojnë këtë fakt janë më shumë, sa nuk mund të citohen në këtë përmbledhje. Por duhet theksuar se ajetet kur'anore që ne kemi përmendur janë vetëm një model me të cilin konkludohet për ekzistencën e ajeteve të tjera.

Përsa i përket haditheve të nderuara, ato janë të shumta, me të cilat do të zbukurojmë këto fletë, duke përmendur vetëm disa prej tyre, gjithnjë duke shpresuar që me mirësinë e Librit Hyjnor, Famëlartë e shpirtit të

shenjtëruar të imamëve, të hyjë në zemrat tona të ashpra e të errësuara drita dhe me këtë dritë të shpëtojmë prej perdeve të errëta të botës së natyrës.

Në librin e nderuar "El-Kàfij" në një kapitull besimi është së bashku me Islamin dhe në një kapitull tjetër Islami nuk është së bashku me besimin, ashtu siç e lexojnë në hadithin e përcjellë prej Sem'mà'ah: *"I thashë Ebù Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!) Imam Sadikut: 'Më flit për Islamin e për imanin (besimin). A janë të ndryshëm?' Ai foli: 'Islami është dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe vërtetimi i të Dërguarit të Allahut. Me këtë dëshmi sigurohet jeta, bëhen martesat e rregullohen trashëgimitë, me këtë dëshmi vepron bashkësia e njerëzve; kurse imani (besimi) është udhëzimi i rrënjosur në zemrat për cilësitë e Islamit dhe për punët që realizohen me këtë udhëzim..."* hadithi vazhdon.

Prej këtij hadithi të nderuar duket qartë se Islami është dëshmia se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe besimi në mesazhin, kurse imani (besimi) është drita e udhëzimit që shkëlqen në zemrat për cilësitë e Islamit. Sikur këto cilësi të rrënjoseshin në zemër dhe Islami të arrinte në zemër, atëherë kemi në zemër besimin. Por patjetër që Islami bën detyrim edhe punën. Prej haditheve të shumta del qartë se puna me shtyllat e Islamit vjen prej besimit. Nga njëra anë, nuk është se puna me shtyllat e Islamit ka hyrë në të vërtetën e besimit dhe nga anë tjetër, tregon se besimi e bën detyrim punën me shtyllat, ashtu siç u tha më sipër.

Në hadithin e nderuar, të ardhur në librin "El-Kàfij" thuhet: *"Kur njeriu bën njërin prej mëkateve të mëdha ose të vogla që Allahu i Lartësuar i ka ndalur, ai njeri është jashtë besimit, prej tij ka rënë emri besimtar, por ai vazhdon të quhet mysliman. Nëse ai pendohet e bën teube, i kërkon Allahut faljen e mëkatit dhe kthehet në rrethin e besimit..."*

Gjithashtu, në librin e nderuar "El-Kafij" lexojmë një hadith të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Babai im thoshte: 'Në zemrën e çdo besimtari ka dy drita, njëra dritë është frikë dhe drita tjetër është shpresë. Sikur drita e frikës të peshohej, ajo nuk do të peshonte më shumë se drita e shpresës, gjithashtu, nëse do të peshohej drita e shpresës, ajo nuk do të peshonte më shumë se drita e frikës."*

Në një hadith tjetër lexojmë: *"Besimtari nuk është besimtar, derisa të ketë frikë e të ketë shpresë. Por ai nuk mund të ketë shpresë, derisa të punojë për ato që ka frikë e që shpreson."*

Në hadithet e nderuara janë përmendur cilësitë e besimtarëve, të cilët janë përshkruar me cilësitë që pamë në ajetin e sipërm: mbështetja vetëm te Allahun (et'tevek'kul), dorëzim i plotë, kënaqësi, frikë, shpresë dhe me cilësi të tjera të ngjashme.

Është e sigurt se personi që nuk i ka këto cilësi, nuk është prej besimtarëve, pasi dituria e kuptimi që gjenden te ne, njerëzit nuk janë besimi, veçse kur ne i përmbahemi këtyre cilësive të përmendura e punëve të mira. Vetëm Allahu i Lartësuar është më i dituri.

NDARJA E KATËRT

SHJEGIMI: BESIMI ËSHTË NË PËRPUTHJE TË PLOTË ME NATYRËN E PASTËR TË KRIJIMIT DHE MOHIMI ËSHTË JASHTË RRUGËS SË NATYRËS SË PASTËR TË KRIJIMIT

Në ndarjen e mëparshme u tha se në qëllimin me natyrën e pasur të krijimit ka punë me të cilat janë përshtatur të gjithë njerëzit. Gjithashtu, u shpjegua se mbi ato punë nuk kanë ndikim as adhurimi, as rruga që ndiqet, as mjedisi e as moralet; gjithashtu u shpjegua se ato punë nuk i ndryshon as barbaria, as qytetërimi, as jeta nomade e as jeta në ngulmimet, as dituria, as injoranca, as besimi, as mohimi dhe as punë të tjera që renditen në specien njerëzore.

Ato punë që kanë ndryshuar njeriun, nuk janë prej punëve që e kanë origjinën në natyrën e pastër të krijimit, por ato janë vetëm ndryshime në kriterin, prandaj ne themi se bazat e besimit dhe kolonat e tij shprehin diturinë, shprehin besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), shprehin shenjtërinë, shprehin besimin në të dërguarit, besimin në Ditën e Ringjalljes pas vdekjes dhe besimin në engjëjt e në librat hyjnorë.

Të gjitha këto janë prej cilësive të natyrës së krijimit të pastër. Disa prej këtyre punëve janë origjinale, si dituria e besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) dhe besimi në disa punë të tjera që janë degë të punëve që u thanë. Por studimi i detajuar i kësaj çështje është jashtë qëllimit

është pjesë e studimeve shkencore me pjesë hyrëse të gjata. Prandaj në këto fletë ne nuk do të futemi në këto studime, megjithëkëtë patjetër do t'i përmendim ato në formë përmbledhëse.

Le të dihet se orientimi kah Plotësimi absolut dhe dashuria ndaj këtij Plotësimi, është prej natyrës së pastër të krijimit, ashtu siç u përmend më sipër dhe tani themi: për Plotësimin absolut e për Bukurinë absolute kanë dashuri të gjithë njerëzit, pasi këto dy epitete janë i Vërteti i Lartësuar. Është vërtetuar me argument se Qenia e shenjtë është e vërteta e thjeshtë dhe e vërteta e thjeshtë patjetër duhet të jetë Plotësim absolut e Bukuri absolute, kurse të gjitha qeniet e tjera janë shkëlqim prej shkëlqimeve të punës së Tij e rrjedhje prej vërshimit të Tij të shenjtë.

Por për secilën prej këtyre punëve e vërshimeve ka kufizim, ka kufi të shfaqjes dhe kjo shfaqje është zbritje prej Plotësimit absolut, është zbritje prej të Dashurit dhe i Dashuri i vërtetë është Qenia e shenjtë, e Cila patjetër duhet të jetë Një dhe i pakushtëzuar, ndryshe Ajo del prej së vërtetës së thjeshtë, sepse i kushtëzuari nuk mund të konsiderohet plotësim absolut. Prandaj njerëzit gjatë gjithë brezave e dashurojnë Qenien, në sajë të natyrës origjinale të krijimit të tyre të pastër. Njerëzit janë të vetëdijshëm që kjo Qenie është Një dhe e Vetme për të gjitha plotësimet, ndryshe ajo do të dilte prej plotësimit absolut. I Dashuri është plotësimi absolut, ashtu siç shpjegohet në suren e uruar "Et'teuhid", (sure "El-Ikhlàs"). Në këtë sure të nderuar shpjegohet qartë raporti i cilësive të veçanta të të Vërtetit të Lartësuar.[1]

Kjo sure e uruar është vërtetim për identitetin absolut, i Cili është Një e i Vetëm, është Gjithëpërfshirësi. Ai është i Pastërti prej mangësive. Të gjitha këto cilësi të larta janë shpjeguar në këtë sure të bekuar në mënyrën

[1] Aludon për hadithin e ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* në të cilin tregohet se jehuditët e pyetën të Dërguarin e Allahut *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Na thuaj rrjedhën e trungut të zotit tënd." Ata ia bënë këtë pyetje tri herë dhe ai nuk iu përgjigj atyre. Ndërkaq zbritu surja "El-Ikhlàs" (Kul huve-ll'llàhu ehad deri në fund).

më të shkëlqyer. Por këtë shpjegim arrijnë ta kuptojnë vetëm ata që thellohen.

Për të gjitha këto që u thanë më sipër fraza "فِطْرَتَ ٱللَّهِ" *"fitrete-ll'llàhi"* "krijimi i pastër i Allahut"

Në ajetin فِطْرَتَ ٱللَّهِ ٱلَّتِي فَطَرَ ٱلنَّاسَ عَلَيْهَاۚ *"…fitrete-ll'llàhi-l'letij fetare-n'nàse alejhà."* "Krijimi i pastër i Allahut, me të cilin Ai krijoi njerëzit…"[1]

Në hadithet e nderuara, herë është komentuar me diturinë e Allahut, herë me krijimin me besimin në Njëtimin e Allahut (teuhid) dhe herë tjetër me Islamin.

Në disa transmetime të ardhura prej Imam Bàkirit (paqja qoftë mbi të!) lexojmë: "Krijimi i pastër i Allahut, me të cilin Ai krijoi njerëzit…" është: "S'ka zot tjetër përveç Allahut, Muham'medi është i Dërguari i Allahut, kjo është e vërteta e teuhidit, është vërshimi absolut dhe është hija e të Vetmit absolut. Nga vetë natyra e pastër e krijimit të tij, njeriu është i orientuar kah plotësimi absolut, është e orientuar kah Qenia Një dhe e Vetme. Por për këto fjalë ka edhe një shpjegim tjetër, prej të cilit patjetër duhet të qëndrojmë larg.

Tani u mësua se njohja e besimi në Allahun, Zotin Një e të Vetëm (teuhid), janë prej punëve të natyrës së pastër të krijimit. Gjithashtu, edhe dashuria për të qenë i qëndrueshëm përjetësisht, është brumosur në natyrën e pastër të krijimit të të gjithë njerëzve; gjithashtu, arritja e qëllimit më të lartë tregon se perdja e mosnjohjes që ka mbuluar të shkujdesurit ndaj kësaj natyre origjinale të krijimit të pastër, vjen prej dyshimit në zbatim, tregon se rezultat tjetër i kësaj perdeje është edhe lidhja me këtë botë, dashuria për këtë botë, është edhe neveria prej vdekjes.

Natyrisht kjo neveri ndaj vdekjes padyshim vjen për shkak se besimi në botën pas vdekjes dhe në jetën e qëndrueshme e të përjetshme nuk ka hyrë në zemrat e të mbuluarve me perdet e shkujdesjes e me perden e

[1] Sure "Er- Rrùm, ajeti 30.

mosdijes, të cilët mendojnë se vdekja është asgjësim, por vetë cilësia e natyrës së pastër të krijimit jo vetëm që është kundër asgjësimit, ka neveri ndaj tij, por ka edhe dëshirën e madhe të jetë i përjetshëm.

Në të mbuluarit me këto perde ka hyrë neveria e frika prej vdekjes, megjithëkëtë natyra e krijimi të pastër origjinal dëshiron përjetësinë, kurse dëshira për të qenë i përjetshëm ka detyrimisht lidhje me ringjalljen e me botën pas vdekjes, pasi në këtë jetë, botë kurrë nuk mund të jetë e përjetshme, për faktin se kjo jetë do të zhduket. Prandaj edhe natyra e pastër e krijimit ka frikë prej kësaj bote të zhdukshme. Përsa i përket cilësisë së dytë të panjohur të krijimit, për të qenë i përjetshëm, kjo cilësi është vetë natyra e pastër të krijimit, është cilësia e besimit në Botën Tjetër, besimit në botën pas vdekjes, besim që siç u tha, vjen prej cilësive të natyrës së pastër e krijimit.

Po kështu, në krijimin e pastër të njerëzve është e brumosur edhe dashuria për qetësi e për liri. Qëllimi me dashurinë për lirinë, është për lirinë absolute të punëve, të cilësive të natyrës së krijimit. Gjithashtu, qëllim është dashuria për vënien në jetë të vullnetit, por qetësia e liria absolute janë të pamundura të realizohen në këtë botë, pasi në këtë botë ato nuk ekzistojnë në asnjë formë, madje edhe qetësia e plotë është e përzier me vështirësi e lodhje, qoftë për arritjen e saj, qoftë për përgatitjen e punëve të shumta paraprake që kërkohen për arritjen e kësaj qetësie. Gjithashtu, vështirësi ka edhe në kohën e arritjes e pas arritjes së kësaj qetësie.

Le të marrim një shembull: Prej kënaqësive trupore, kah të cilat priret shpirti dhe që njeriu i konsideron prej rrugëve të pushimit, duke ditur se kënaqësia e kënaqësive është kënaqësia e ushqimit, së cilës ne banorët e kësaj toke, të mbuluar me perdet e mosnjohjes, i japim kësaj kënaqësie rëndësi shumë të madhe.

Nëse shikojmë më hollësi, do të vërejmë se, edhe për arritjen e kushteve paraprake për të pasur një ushqim të shijshëm në këtë botë, patjetër duhet të përballojmë vështirësi të shumta, që fillojnë që me përgatitjet e duhura e vazhdojnë deri në kohën e arritjes, duke shtuar edhe

punë të tjera që njeriu duhet të bëjë për të siguruar atë ushqim. Sikur njeriu t'i numëronte të gjitha këto vështirësi, mundime e lodhje, me siguri që do të ishte një pësimin shumë i madh. Por vështirësitë nuk mbarojnë me kaq. Njeriu patjetër duhet të përballojë vështirësi e lodhje edhe për gatimin e ushqimit e përpunim e lëndëve ushqyese dhe jo vetëm kaq, sepse njeriut do të përballojë vështirësi e lodhje të shumta deri në kohën e ngrënies.

Qëllimi më i lartë është se njeriu, për të gëzuar kënaqësinë e ngrënies, nuk shikon fare sa lodhje e sa vështirësi duhet të përballojë për të arritur këtë kënaqësi. Por edhe pas ngrënies për njeriun fillon lodhja për tretjen e ushqimit të ngrënë dhe për shtytjen e ushqimit të marrë, procese që në vetvete janë pësim i rëndë. Sikur vështirësitë të mos ishin të përgjithshme dhe njeriu të mos ishte adaptuar me to, asnjë njeri nuk do të ishte i gatshëm të përballonte qoftë edhe një pjesë prej këtyre vështirësive. Ja, kjo është gjendja e kënaqësive në këtë botë.

Tani vështro me kujdes. Njeriu, në çdo ditë të jetës së tij ka lidhje me dhimbjet, vështirësitë që e shoqërojnë atë në të gjitha punët që bën për të arritur qetësinë absolute. Por qetësia absolute, që njeriu e dëshiron kaq shumë, nuk është e lehtë të arrihet në këtë botë. Në të vërtetë, qetësia absolute ekziston vetëm në botën e mbretërimeve, ashtu siç njoftojnë për këtë të vërtetë të gjitha fetë qiellore. Nga vetë natyra e krijimit të tij, njeriu është orientuar të kërkojë qetësinë në të gjitha vendet e botës, pa punë e pa lodhje dhe të shijojë kënaqësi pa asnjë vështirësi.

Gjithashtu, njeriu dëshiron edhe lirinë, dëshiron lirinë që të bëjë gjithçka që ai do, ashtu siç dëshiron që edhe vullneti i tij të vihet në jetë në atë mënyrë, që para pushtetit të tij të mos ketë pengesë dhe para fuqisë së tij të mos ketë konkurrues. Dihet që në këtë botë nuk ekziston vënie në jetë të fuqisë e të vullnetit në këtë formë, qoftë edhe fare pak prej kësaj mundësie. Është e qartë se kjo ndodh për shkak se karakteret jotoleruese në këtë botë refuzojnë të jenë nën vullnetin e njeriut.

Padyshim, një pushtet i këtillë ekziston vetëm në botën e pasnatyrës, ekziston vetëm në Xhenet, ekziston vetëm për banorët e bindur të shtëpisë

së lumturisë së përjetshme. Njeriu, nga natyra e pastër e krijimit të tij, beson në të padukshmen dhe ka dashuri të madhe të arrijë të Dashurin faktik. Dashuri faktike për të Dashurin faktik janë të pandara prej të dashurit faktik, sepse dashuria faktike dhe i Dashuri faktik përputhen dhe janë të barabarta në fuqinë e në punën e të dashuruarit, të cilin vetë natyra e pastër e krijimit të tij e orienton atë kah i dashuri.

Njeriu s'ka iluzione se po mendon gabim dhe se shpirti është orientuar kah mentalitetet e kah përfytyrimet iluzionare, që s'kanë asnjë bazë, sepse mentalitetet është e pamundur të jenë dëshira të shpirtit, për shkak se të gjitha mentalitetet janë të kufizuara, kurse shpirti është i dashuruar me ato që janë të pakufizuara. Duke marrë në konsideratë se kjo cilësi e krijimit është e pandarë me ekzistencën e njeriut, gabimi e shkarja nuk mund t'i referohen as shpirtit e as ekzistencës, ashtu siç mësohet prej shkencave të larta, të mbështetura mbi argumente të shumta. Këto faqe nuk janë të mjaftueshme që të nxënë këto argumente, qoftë edhe në masë të pakët. Veç kësaj, kjo çështje është jashtë qëllimit të vendosur, ne nuk kemi parë në të gjitha cilësitë e natyrës së pastër të krijimit.

Nga sa u shpjegua, u mësua se mendimi është burim për neverinë ndaj natyrës së pastër të krijimit dhe se mendimi është prej cilësive të mbuluara të krijimit dhe nuk është prej cilësive të fermentuara në brumin e krijimit të pastër të njeriut.

Falënderimi fillim e mbarim i takon vetëm Allahut të Lartësuar.

NDARJA E PESTË

NË RRUGËN E ARRITJES SË BESIMIT

Tanimë u mësua se besimi nuk është dituria dhe ato njohuri që janë në brendësinë tonë prej të vërtetave të Njëtimit të Allahut (teuhidit), të emrave e të cilësive, janë pjesë e diturisë. Por në zemrat tona, prej këtyre diturive që u thanë, s'ka asnjë ndikim e asnjë njoftim. Gjithashtu u mësua se, derisa këto punë nuk kanë arritur në zemër dhe derisa njeriu nuk beson në ato punë, natyrisht që ndikimi i këtyre punëve në zemër është fare pak.

Që të arrijë besimin, njeriu patjetër duhet të punojë, por Allahu mos e lejoftë, sikur ai të dilte prej kësaj bote pa e njohur Allahun, që është bota e ndryshimit dhe e ndërrimit, është vendi e koha ku njeriu ka mundësi të ndryshojë të gjitha fuqitë, cilësitë e gjendjet e zemrës, sikur njeriu të dalë prej kësaj bote pa besim, për atë do të ishte humbja më e madhe dhe pjesa që i takon atij do të ishin vetëm pendime pafund, sepse në Botën Tjetër njeriu nuk mund të ndryshojë asnjë gjendje prej gjendjeve të zemrës.

Asnjë njeri nuk do të ketë mundësi të arrijë besimin në Botën Tjetër, nëse besimin nuk e ka arritur tani që është në botën e tokës. Prandaj njeriu ka detyrë të përfitojë prej ditëve të tij të numëruara të jetës së tij, që të arrijë besimin me çdo çmim të mundshëm, me qëllim e fundit, që zemra e tij të jetë e kënaqur me besimin.

PLOTËSIM I NDARJES SË PESTË

Plotësimi nuk realizohet që në fillim, nëse njeriu e nis rrugën drejt plotësimit pa qëllimin e pastër për të fituar dituri, që me anë të diturisë të arrijë të vërtetat e besimit. Prandaj njeriu e përshtat mendjen me anë të përsëritjes dhe duke mbajtur në kujtesë sinqeritetin e vullnetin, derisa sinqeriteti të futet në zemër.

Nëse në punën e njeriut s'ka sinqeritet, patjetër që në zemrën e tij do të ndërhyjë dora e Iblijsit dhe Iblijsi do të veprojë kundër tij e do të shtojë në zemrën e tij dashurinë e admirimin për vetveten. Prandaj ky njeri nuk arrin asnjë njohuri, madje nuk mund të arrijë as të dijë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), domethënë se pa sinqeritet njeriu i largohet të vërtetës së besimit e njohjes dhe patjetër i largohet edhe fushës së afrimit te Allahu i Lartësuar.

Shiko gjendjen e Iblijsit, shiko ku e çoi atë dashuria e mbivlerësimi që kishte për veten e tij. Prandaj Iblijsit nuk i solli dobi dituria që kishte, dituria nuk e udhëzoi Iblijsin të futej në rrugën e lumturisë.

Baraspesha në ushtrimet e së vërtetës dhe të gabuarës, në kuptimin e njohjes së hollësishme, është ose orientimi kah mbivlerësimi e dashuria ndaj vetes, ose orientimi kah e vërteta dhe kërkimi i të Vërtetit.

Një namaz që falet për dëshira të kësaj bote, ose dëshira për dëshira të Botës Tjetër, nuk është namazi që quhet mir'axh për besimtarin dhe nuk është afrim që kërkojnë të devotshmit[1], por është namaz i falur që njeriu të

[1] Cituar prej fjalës së Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)* i cili ka thënë: "Namazi ka dy afrime dhe çdo afrim është devotshmëri."; "Vesàilu-sh'shij'ah, vëll. 3, f. 30; Libri "Namazi", K. 12, Paragrafi 1-2.

jetë pranë mirësive të mëdha të Xhen'netit. Natyrisht që një namaz i falur me këtë qëllim, e largon njeriun prej fushës së afrimit hyjnor.

Dituria rreth qenies së Allahut, Zoti Një e i Vetëm, ditura që ka si qëllim dukjen para njerëzve të zakonshëm e në kuvendet e dijetarëve, është e zhveshur prej dritës hyjnore, është ushqim i përgatitur për shpirtin lakmues, është ushqim i vënë në dorën e djallit. Një dituri e tillë e nxjerr njeriun jashtë besimit në Allahun, Zotin Një e të Vetëm dhe e afron atë drejt vënies shok Allahut. Dashtë Allahu, më poshtë, në kapitullin "Sinqeriteti", do të shpjegojmë shkallët e të vërtetave të kësaj diturie.

Vetëm pas arritjes së sinqeritetit, në tërësi njeriu mund të kalojë në të vërtetën, ashtu siç njoftohet në Kur'anin Famëlartë në ajetet 159-160 të sures "Es'Saf'fât"

سُبۡحَٰنَ ٱللَّهِ عَمَّا يَصِفُونَ ١٥٩ إِلَّا عِبَادَ ٱللَّهِ ٱلۡمُخۡلَصِينَ ١٦٠

"Subhàne-ll'llàhi am'mà jesifùne. Il'là ibàde-ll'llàhil-mukhlesijne" "Allahu është i pastër nga gjërat që ata ia përshkrujanë. Me përjashtim të robëve të sinqertë të Allahut (ata nuk i përshkruajnë shok Allahut)."

Robtë e sinqertë janë të pastër prej shkallëve të idhujtarisë, të dyzimit e bërjes së punës për t'u dukur në sytë e të tjerëve. Robtë e sinqertë të Allahut janë pastruar prej ndyrësirave të natyrës. Ata e dinë që Allahu i Lartësuar është krejtësisht i pastër nga ato që injorantët i përshkruajnë Atij.

Në të gjitha gjendjet, sinqeriteti në punët për arritjen e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, është arritur është rruga më e rëndësishme. Prandaj, në kapitullin e ardhshëm, do të flasin për mënyrën e arritjes së këtij besimi.

Pas ndotjes me ndyrësitë e natyrës, njeriu pendohet e kërkon falje për mëkatet e për shkeljet që ka bërë dhe natyrisht që pendimi i tij e kërkesa e tij për faljen e mëkateve është bërë me sinqeritet dhe sipas kushteve të duhura.

Me lejen e Allahut, edhe këtë çështje do ta cekim edhe në kapitullin e pendimit (teubes). Kur zemra e njeriut s'ka asgjë prej ndyrësirave e ndotjeve të botës së natyrës, atëherë njeriu është i përgatitur të përmendë Allahun e të lexojë Librin e Tij. Por derisa ndyrësitë e ndotjet e botës së natyrës janë në zemrën e njeriut, për atë njeri nuk është e lehtë të përfitojë prej përmendjes së Allahut e prej leximit të Kur'anit Famëlartë, ashtu siç theksohet në librin hyjnor, në suren e bekuar "El Vàkiah" në ajetet 77-79:

إِنَّهُۥ لَقُرْءَانٌ كَرِيمٌ ٧٧ فِي كِتَٰبٍ مَّكْنُونٍ ٧٨ لَّا يَمَسُّهُۥٓ إِلَّا ٱلْمُطَهَّرُونَ ٧٩

"In'nehù lekur'ànun kerijmun fij kitàbin meknùnin là jemes'suhù il'lel-mutt'ah'hrùne" "Me të vërtetë ai është Kur'ani Famëlartë. Ai është në një libër të ruajtur. Atë e prekin vetëm të pastrit.", kurse në ajetin 13 të sures "Elgàfir lexojmë:

هُوَ ٱلَّذِي يُرِيكُمْ ءَايَٰتِهِۦ وَيُنَزِّلُ لَكُم مِّنَ ٱلسَّمَآءِ رِزْقًا وَمَا يَتَذَكَّرُ إِلَّا مَن يُنِيبُ ١٣

"Huve'ledhij jurijkum àjàtihi ue junez'zilu lekum mine-s'semài rizkan ue mà jetedhek'keru il'là men junijbu" "Është Allahu Ai që ju tregon ju argumentet e Veta, Ai sjell për ju furnizim prej qiellit, por askush nuk merr mësim përveç atij që është kthyer te Ai."

Vetëm pasi zemra përgatitet për të përmendur Allahun dhe për të lexuar Kur'anin Famëlartë, ajo zemër mëson ajetet që flasin për Njëtimin e Allahut, mëson frazat e përmendjes së Allahut të lartësuar (frazat e ziqrit) që tregojnë Njëtimin e Allahut e dëlirjen e Tij prej mangësive, e gjitha kjo me praninë e zemrës e me pastërti të plotë, në kuptimin që zemra konsiderohet një fëmijë i pafuqishëm për të folur.

Allahu dëshiron ta bëjë këtë fëmijë të flasë. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe ai i përsërit në veshin e kësaj fëmije frazën: "Allahu është Zoti, Një e i Vetëm", me synimin që fëmija hap pas hapi do ta mësojë këtë të vërtetë absolute. Me këtë rrugë zemra e qetësuar e merr mësimin që Allahu është Zoti Një e i Vetëm. Me zemër në dorë ai i lexon zemrës ajetet e Librit dhe e vazhdon leximin e ajetve derisa të hapen veshët e zemrës.

Sikur për këtë mësimdhënie të zgjidhej një kohë nga fundi i namazit të natës, ose një kohë pas lindjes së diellit, ose pas faljes së namazit të sabahut, patjetër që do të ishte shumë më mirë, pasi në këto kohë njeriu është me pastrim të plotë dhe zemrën e ka të orientuar plotësisht kah Kur'ani Famëlartë dhe kah përmendja e Allahut të Lartësuar.

Këto janë kohët me të mira për t'i lexuar zemrës ajetet e Kur'anit dhe frazat e përmendjes së Allahut të Lartësuar në formën e mësimdhënies. Këto të vërteta i lexojmë në frazën e parë të ajetit 18 të sures "El- Hashr":

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱتَّقُواْ ٱللَّهَ *"Jà ej'juhe-l'ledhijne àmenù-t'tekù-ll'llàhe…"* "O që keni besuar, mbajeni parasysh frikën ndaj Allahut." deri në ajetin e fundit të kësaj sureje të nderuar. Patjetër gjatë leximit të ajeteve, lexuesi mendon rreth kuptimit të fjalëve të Allahut Të lartësuar, që ai lexon në këto ajete dhe krahas kësaj, ai mban në mendje Allahun e Lartësuar, merr në llogari vetveten, për të gjitha shkallët e besimit që përfshihen në frazën Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe të emrave e të cilësive të Tij. Këto janë kohët kur shpirti është zbrazur prej shqetësimeve të kësaj bote, prandaj janë kohët më të përshtatshme për mësimin e zemrës. Këto kohë, siç thamë më sipër, janë: fundi i natës, ose koha mes agimit e lindjes së diellit e të kohëve të tjera që u përmendën.

Duke përmendur Allahun arrihen rezultate të mira. Kur përmendet Allahu, duhet të mbahet parasysh se fjala më e nderuar për të përmendur Allahun e Lartësuar është fraza më gjithëpërfshirëse: "لاَ إِلَهَ إِلاَّ الله" *"Là ilàhe il'le-ll'llàh"* "S'ka zot tjetër përveç Allahut!"

Në këto seanca të përmendjes së Allahut, njeriu vjen me zemër të plotë dhe shpreson që Allahu i Lartësuar do ta marrë për dore.

Por njeriu, në asnjë gjendje, nuk duhet të harrojë se ai vetë ka mangësi e pamundësi, gjithashtu duhet të mbajë parasysh mëshirën e fuqinë e të Vërtetit të Lartësuar. Prandaj le të shtrijë dorën para Qenies së Shenjtë dhe furnizimin ta kërkojë vetëm prej Saj. Kur njeriu merret për një farë

kohe më këtë punë, shpirti i tij do të mësohet e i bëhet zakon të përsërisë frazën: "Allahu është Zoti Një e i Vetëm", atëherë drita e Njëtimit të Allahut (teuhidit) do të ndriçojë në zemrën e tij. Ai nuk duhet të lërë pas dore kushtet e përgjithshme të përmendjes së Allahut të Lartësuar.

Këto kushte ne i kemi renditur në librin "Àdàbu-s'salàt". Janë të njëjtat kushte si për leximin e Kur'anit, ashtu edhe për përmendjen e Allahut të Lartësuar. Megjithëkëtë, i nderuar lexues, mbaje parasysh se do të përfitosh prej këtyre kushteve vetëm aq sa është transmetuar prej dritës së të devotshmëve.

Imam Aliu ka thënë: *"Shiko në atë që thuhet dhe mos shiko se kush e ka thënë."*[1] Sikur njeriu të marrë në llogari veten natë e ditë, qoftë edhe vetëm për pak minuta, me zemër në dorë dhe duke e orientuar zemrën, derisa zemra të jetë e gatshme për të arritur dritën e besimit e për të kërkuar besimin, ndikimet e besimit në atë shpirt do të jenë të bukura dhe njeriu, me dashjen e Allahut, shumë shpejt do të arrijë rezultatin.

I nderuar lexues, gëzimi me këto kuptime, në fillim të punëve, mund të jetë i vështirë, pasi djalli, me cytjet e tij i shton vështirësitë edhe më shumë dhe bën që njeriu të humbë shpresën për arritjen e gjendjeve të gëzueshme. Djalli, me cytjet e tij, e bën të rëndë në sytë e njeriut ecjen në rrugën e Botës Tjetër e të orientimit kah Allahu. Ai hedh dyshime në zemrën e njeriut, se këto kuptime janë vetëm për njerëz të mëdhenj, prandaj ato punë s'kanë lidhje me të. Sikur djalli të kishte mundësi, do të dëshironte që njeriu të kishte neveri prej orientimit kah Allahu e prej ecjes në rrugën e Botës Tjetër. Gjithsesi, djalli mundohet shumë që ta largojë njeriun sa më shumë nga rruga e orientimit kah Allahu i Lartësuar dhe të bëjë që njeriu të mos e kërkojë Allahun e të mos kërkojë mbrojtjen e Tij.

[1] Kjo është fjala e prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Klasifikimi i më të mirave të gjykimit", f. 58, nr. 612.

Dyshimi që hedh djalli te njeriu, që e bën njeriun të mos kërkojë ruajtje e mbrojtje prej Allahut të Lartësuar, është prej kurtheve që ai shpirt i keq i ngre njeriut në rrugën e tij të orientimit kah Allahu i Lartësuar. Por njeriu, i mbushur me besim të sinqertë, nuk i kushton rëndësi cytjeve të djallit dhe nuk mendon se rruga për arritjen e besimit është një punë e vështirë. Natyrisht, në fillim ai do të mendojë se kjo është një punë e vështirë, por, kur njeriu futet në këtë rrugë, Allahu i Lartësuar ia bën të lehtë atij rrugën e lumturisë dhe ia afron atë.

Bazuar mbi këtë rregull, që u përmend pjesërisht, por që s'ka komplikime e që nuk është në kundërshtim me asnjë punë dhe nuk dëmton asnjë send, veprimi më i mirë e puna më e preferuar është që kërkuesi i të Vërtetit të vijë me këtë rregull për disa ditë dhe, vetëm atëherë kur të mendojë e të shikojë ndryshim në qartësinë e në pastërtinë e zemrës së vet, ka arritur ndriçimin e tij të brendshëm. Ky ndriçim i shton atij guximin për të shkuar edhe më përpara në këtë rrugë.

Dihet se këto punë bëhen në mënyrë graduale dhe realizohen gjatë rrjedhës së kohës, gjithnjë duke vënë parasysh se janë punë të një rëndësie tepër të lartë. Ka shumë rëndësi që këto punë kaq të larta njeriu t'i marrë me rëndësinë që ato kanë, sepse këto punë nuk janë të natyrës së dëmeve që sjellin punët e botës së tokës, për të cilat njeriu thotë: "Nëse nuk e zgjidh sot, zgjidhja do të jetë nesër dhe, nëse nuk e zgjidh as nesër, do ta zgjidh pasnesër..."

Njeriu e di mirë se kjo zvarritje ndaj kryerjes së këtyre punëve nuk ka ndonjë rëndësi të madhe dhe, ai vazhdon me këtë mënyrë zvarritjeje, derisa puna merr fund me këtë mënyrë veprimi.

Kurse punët e orientimit kah Allahu i Lartësuar janë ose lumturi e përjetshme, ose vështirësi që s'kanë fund, ndryshe nuk mund të jetë. Megjithëkëtë, i varfëri njeri i shkujdesur interesohet më shumë për punët e kësaj bote.

Çdo njeri sheh dhe di mirë se banorët e kësaj bote në punët e tyre kanë hequr dorë prej orientimit kah Allahu i Lartësuar, për rrjedhojë ndahen prej kësaj bote krejtësisht të humbur dhe përsëri njeriu vazhdon të derdhë tërë mundin e tij për të mbledhur e për të grumbulluar sa më shumë prej punëve të kësaj bote, madje në këtë rrugë ai përballon vështirësi të mëdha e poshtërime të shumta, përballon sprova të rënda e lodhje, madje në këtë rrugë s'ka kujdes se po turpërohet. Ndërkaq manifeston se është i pafuqishëm e shumë përtac për të arritur besimin, që është garantuesi për lumturinë e tij të përjetshme. Pavarësisht nga këshillat e profetëve, eulijave e mësimeve të librave qiellorë, njeriu nuk heq dorë nga pafuqishmëria e nga shkujdesja e tij. Ai nuk mendon për ditët kur do të shohë pësimin, poshtërimin e vështirësitë e mëdha. Në zemrën e tij të ashpër nuk kanë ndikim as këshillat e Kur'anit Famëlartë, as premtimet e as kërcënimet e Kur'anit, në një kohë që këto këshilla, premtime e kërcënime të Kur'anit ndikojnë edhe në gurin e fortë. Madje, para madhështisë së Kur'anit Famëlartë, nënshtrohen e përulen të gjitha malet e botës.

Për këtë të vërtetë, Allahu i Lartësuar njofton:

لَوْ أَنزَلْنَا هَٰذَا ٱلْقُرْءَانَ عَلَىٰ جَبَلٍ لَّرَأَيْتَهُۥ خَٰشِعًا مُّتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ ٱللَّهِ ۚ وَتِلْكَ ٱلْأَمْثَٰلُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ ٢١

"Leu enzelnà hadhel-Kur'àne alà xhebelin lere'ejtehù khàshian mutesad'dian min khashjeti-l'làhi, ue tilkel-emthàlu nadribuhà lin'nàsi leal'lehum jetefek'kerùne"

"Sikur Ne ta zbrisnim këtë Kur'an mbi ndonjë mal, atë (malin) do ta shihje të strukur e të çarë prej frikës së Allahut; këto shembuj Ne ua shpjegojmë njerëzve që të mendojnë."[1]

O njeri me zemër të ashpër, mendo dhe shiko se cila sëmundje e bëri zemrën tënde më të ashpër se guri i fortë?! Shiko, cila sëmundje bëri që zemra jote nuk pranon Kur'anin e Allahut, Kur'anin që zbriti për të të

[1] Sure "El-Hashr", ajeti 21.

shpëtuar ty prej ndëshkimit e prej errësirave. Po, litarët e djallit në shikimin tënd e bëjnë shumë të ndritshme këtë botë me argjendin e me floririn e saj. Janë litarët e djallit ata që të kanë mbyllur ty rrugët e dëgjimit e të shikimit dhe të kanë përmbysur zemrën. Dhe tani mendo për ajetin e nderuar:

وَلَقَدْ ذَرَأْنَا لِجَهَنَّمَ كَثِيرًا مِّنَ ٱلْجِنِّ وَٱلْإِنسِ ۖ لَهُمْ قُلُوبٌ لَّا يَفْقَهُونَ بِهَا وَلَهُمْ أَعْيُنٌ لَّا يُبْصِرُونَ بِهَا وَلَهُمْ ءَاذَانٌ لَّا يَسْمَعُونَ بِهَآ ۚ أُوْلَٰٓئِكَ كَٱلْأَنْعَٰمِ بَلْ هُمْ أَضَلُّ ۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْغَٰفِلُونَ ١٧٩

"Lekad dhereënà lixhehen'neme kethijren minel-xhin'ni uel-insi, lehum kulùbun là jefkahùne bihà, ue lehum aëjunun là jubsirùne bihà, ue lehum àdhànun là jesmeùne bihà, ulàike kel-en'àmi bel hum edal'lu, ulàike humul-gàfilùne"
"Shumë nga xhinët e njerëzit Ne i krijuam për Xhehenem; ata kanë zemra, por me to nuk kuptojnë, ata kanë sy, por me to nuk shohin, ata kanë veshë, por me to nuk dëgjojnë, ata janë si kafshët, madje janë edhe më të humbur, të këtillë janë të shkujdesurit.[1]

Shiko me kujdes, a gjenden në ty shenjat e atyre që janë krijuar të jenë në Xhehenem? Zemra e vetëprivuar prej dritës së mendimit e prej diturive në fushën e ligjit të fesë, zemra e vetëprivuar prej kthimit të së dukshmes e të se brendshmes së kësaj bote, s'ka asnjë dallim prej asaj cope mishi që formon zemrën e kafshës.

Syri që nuk sheh gjë tjetër përveç figurës së kësaj bote dhe është i verbër të shohë eksperiencat dhe diturinë, veshi që s'dëgjon gjë tjetër përveç zërave të kësaj bote dhe veçohet që të mos dëgjojë këshillat hyjnore e që të mos pranojë urtësinë e këshillat, nuk mund të jenë ndryshe prej syve e prej veshëve të kafshëve.

Njerëzit që nuk i kanë këto tri mirësi të mëdha, janë kafshë në formën e njeriut, madje ata janë edhe më të humbur se kafshët, sepse këta

[1] Sure "El-Araf", ajeti 179.

njerëz, megjithëse kanë privilegjin të kenë Kur'anin, librat qiellorë dhe orientimin e udhëzimin e profetëve, nuk e kalojnë as shkallën e kafshërisë, madje janë më poshtë se grada e kafshërisë. Kafshëria është qëllimi më i lartë në rrugëtimin e kafshës, por i mjeri njeri, në mesin e rrugëtimit të tij, e ka humbur rrugën dhe nuk ka arritur në shkallën e rrugës njerëzore. Ai e ka humbur kapitalin e lumturisë së tij, e kalon jetën me humbje e me falimentim. Ka humbur rrugën e njerëzimit, prandaj është më i humbur se kafsha.

Gjithashtu, kur njeriu del jashtë veprimeve hyjnore e logjike dhe hyn në veprimet djallëzore të injorancës, cilësitë kafshërore janë më shumë nga sa janë në të gjitha kafshët. Dy fuqitë me të cilat është pajisur njeriu, fuqia e zemërimit dhe fuqia e dëshirave, vënë në lëvizje botën. Por janë po këto dy fuqi që mund të shkatërrojnë edhe vetë njeriun, madje këto dy fuqi mund të asgjësojnë të gjitha sendet dhe të tronditin themelet e qytetërimit e të fesë.

Çdo person, nën shtytjen e zemërimit, ose nën shtytjen e dashurisë, për të qenë kryetar, guxon të shkatërrojë bazat e qindra mijëra familjeve e të nxjerrë në rrugë të madhe një shoqëri të tërë, ndërsa në asnjë kafshë zjarri i zemërimit nuk shkakton flakë dhe dëshirat e saj nuk shkaktojnë nxehtësi.

Por njeriu, me zemërimin e me dëshirat e tij nuk njeh kufi, prandaj asnjë send nuk e shuan dëshirën e babëzinë e tij. Një njeri i tillë, me gabimin e tij, me djallëzinë e tij, me kurthet e tij, me mashtrimet e me tradhtitë e tij çon në varreza familje të tëra e i asgjëson ata me erërat e tij të furishme. Sikur qiejt e toka të bëheshin një kafshatë për këtë bishë-njeri, kurrë nuk do ta shuanin zjarrin e babëzisë së tij, ose sikur në dispozicion të një njeriu të tillë të viheshin mbretëritë e mbarë botës, përsëri dëshirat e tij vetjake nuk do të ishin më të pakta.

Prandaj ky njeri nuk ndryshon prej kafshëve. Kur kafsha ha diçka, asaj i shuhet dëshira e ngrënies dhe shumë rrallë ndodh që ndër kafshët të ketë edhe të atilla që të mbledhin e të grumbullojnë ushqime. Gjithsesi,

edhe ky instinkt në këto kafshë është i kufizuar, gjithashtu dhe lakmia që ato shfaqin për të grumbulluar ushqim është shumë e dobët.

Është e vërtetë që milingona gjatë pranverës e verës mbledh ushqim, por ajo e mbledh ushqimin për shkak se dimri ia zë rrugët për të gjetur furnizim, prandaj milingona mbledh ushqim gjatë stinëve të nxehta. Sikur milingona të kishte mundësi të dilte prej strehës së saj edhe gjatë stinës së dimrit, ashtu siç del gjatë stinës së pranverës, as ajo nuk do të shqetësohej për mbledhjen e depozitimin e ushqimit.

Njeriu s'ka asnjë dijeni për ndonjë bazë mbi të cilën të mbështesë babëzinë e tij për grumbullimin e furnizimeve. Është normale që njeriu të grumbullojë furnizime për konsum dhe për të siguruar jetesën, por njeriu vazhdon të mbledhë e të grumbullojë furnizime edhe pasi i ka siguruar sasitë e nevojshme të ushqimeve për të përballuar jetesën. Atij i shtohet edhe më shumë dëshira e babëzia për të grumbulluar sa më shumë. Vetëkuptohet se njeriu, që ia ka lëshuar frerët vetvetes, është më i humbur e shumë më i ulët se kafshët. Kafsha ka një qëllim dhe duhet ta arrijë atë, kurse i mjeri njeri nuk njeh fund në qëllimin e tij për të mbledhur e për të grumbulluar. Patjetër që edhe njeriu ka një qëllim të lartë, që duhet ta arrijë, por ai e ka humbur rrugën që e çon te ai qëllim.

Qëllimi për të vizituar Qaben është Allahu i Lartësuar. Në këtë qëllim kemi kërkuesin e të Vërtetit, kemi dhe këtë kërkesë hyjnore, e cila është prej dritës së natyrës së pastër të krijimit të Allahut. Kërkuesi i të Vërtetit s'ka qëllim tjetër përveç këtij qëllimi. Ky kërkues nuk ka dijeni për rrugën e tij, prandaj ai vjen rrotull qëllimeve të gabuara si të çmendurit. Por në këtë kërkues kurrë nuk shuhet zjarri i kërkesës së tij. Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

أَلَا بِذِكۡرِ ٱللَّهِ تَطۡمَئِنُّ ٱلۡقُلُوبُ ٢٨ *"…elà bidhikri-l'làhi tatmein'nu;-kulùbu"*

"…dëgjoni me vëmendje, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat."[1]

[1] Sure "Er-Rrad", ajeti 28.

QËLLIMI I TRETË

SHPEGIMI: VËRTETIMI DHE MOHIMI E TIJ - MOHIMI NË KËTË SHPJEGIM JANË DISA NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME VËRTETIMIN E ME MOHIMIN

Mëso se vërtetimi në këtë pozitë shpreh pranimin e të Vërtetit dhe besimin në Të. Kurse mohimi shpreh mosnjohjen e të Vërtetit, largimin prej Tij dhe mosnënshtrimin ndaj Tij. Vërtetimi është prej ushtrive të mendjes dhe ka lidhje me tharmin e pastër të krijimit të fermentuar në brumin e njeriut, kurse mohimi është prej ushtrive të injorancës dhe ka lidhje me krijimin e mbuluar me perde.

Dhe tani sqarimi i këtij përgjithësimi:

Meqenëse njeriu është gatuar me dorën e fuqisë së të Vërtetit të Madhëruar dhe ka zbritur prej botës së pastërtisë e të shenjtërisë, që në fillim të krijimit njeriu është me cilësi ndriçuese, të gdhendura në të, në atë mënyrë që ai është i orientuar kah bota e panjohur. Ashtu siç u mësua më sipër, njeriu e kërkon të Vërtetin dhe e dashuron Atë, gjithashtu njeriu ka lidhje me të vërtetat e besimit, me të vërtetat që kanë lidhje me botën e

dritës, me botën e pastërtisë e të shenjtërisë dhe nuk ka lidhje me format e injorancës, punët e gabuara, me punët e kota e me gënjeshtrat.

Në vendin e duhur është pohuar se patjetër duhet të këtë lidhje të ndërsjellë ndërmjet diturisë, dijetarit dhe asaj që dihet. Dituria është ushqimi i dijetarit, por ushqimi patjetër duhet të jetë në përshtatje me të ushqyerin. Kjo është argumentuar në kapitullin "Bashkimi ndërmjet dijetarit e asaj që dihet dhe bashkimi ndërmjet të mençurit e logjikës".

Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar na njofton në ajetin 24 të sures së nderuar "Abese":

فَلۡيَنظُرِ ٱلۡإِنسَٰنُ إِلَىٰ طَعَامِهِۦٓ ٢٤ *"Feljendhuril-insànu ilà taàmihi"* "Le të shikojë njeriu në ushqimin e tij."

Njeriu detyrimisht duhet të shikojë në ushqimin që merr.

Në librin "El Kàfij" lexojmë transmetimin që Zejd Shih'hàmi ka përcjellë prej Ebu Xhaferit (Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* për fjalën e Allahut të Lartësuar: **"Le të shikojë njeriu në ushqimin e tij."** Shish'hàmi thotë: "Unë pyeta: 'Si është ushqimi i njeriut?'" Imami i nderuar tha: "Dituria që ai merr dhe prej kujt e merr."

Tregohet se sheh Mufijdi *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)* ka përcjellë një transmetim prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Derisa njeriu është në cilësinë origjinale të krijimit të tij, ai priret kah bota e dritës dhe e pastërtisë, ka lidhje me dituritë e vërteta, me njohuritë hyjnore, me të vërtetat shpirtërore dhe me botët e panjohura. Fasada e shpirtit është si pasqyra e lëmuar ndriçuese. Ajo fasadë zemre është larg ndotjes nga ndyrësitë, në të është gdhendur bota e panjohur. Por të gjitha këto janë prej kategorisë së diturive të vërteta. Në këtë zemër janë skalitur origjina e njohurive dhe ajo zemër i pranon këto dituri, për shkak se ai vetë është në përshtatje me to. Gjërat e gabuara, gënjeshtrat dhe krahasimet e gabuara e të trasha janë prej shfryrjeve djallëzore, janë prej botës së errësirave e ndyrësirave, kurse cilësia e krijimit të pastër, me të cilën është gatuar brumi i njeriut është larg këtyre

të fundit. Kjo natyrë krijimi nuk orientohet kah ndyrësitë. Ajo as nuk ka lidhje e as nuk barazohet me papastërtitë. Kjo cilësi e pastër e krijimit as nuk i pranon ato e as nuk impresionohet prej tyre. Sikur kjo natyrë e pastër e krijimit të mbetej e ruajtur deri në fundin e jetës së njeriut dhe sikur te ajo të mos arrinte dora e Iblijsit, kjo krijesë e pastër kurrë s'do të pranonte punë që kundërshtojnë të Vërtetin dhe asnjëherë nuk do të largohej prej të Vërtetit. Në këtë krijesë të pastër do të shndrisnin mësimet e Kur'anit Famëlartë, mësimet e profetëve të mëdhenj dhe mësimet e eulijave të nderuar, ashtu siç janë të zbritura në materialin e shpalljes hyjnore e në materialet e diturive të vërteta. Këto dituri do të shndrisnin në atë pa asnjë ferrë prej veprimeve të shpirtit e pa asgjë prej shakarave të iluzioneve, të cilat ka mundësi të kalojnë në formën e mbulesave të errësirës mes njeriut dhe të Vërtetit të Lartësuar.

Por kur kjo natyrë e pastër e krijimit, që është shpirtërore te njeriu, të mbulohet me perde dhe të bëhet errësirë për shkak të shqetësimit të njeriut për botën e natyrës, mbi këtë njeri bëhet sunduese pushteti i dëshirave, injoranca, zemërimi e djallëzitë. Ai ndihet mirë me kënaqësitë e kësaj bote e me pasuritë e shumta. Patjetër që orientimi i brendshëm i kësaj natyre të pastër të krijimit do të largohet prej botës shpirtërore të mbretërimeve, do të ndërpritej lidhja e tij me botët e dritës, për rrjedhojë, ai do të ketë lidhje me botën e xhinëve, djajve dhe do të nënshtrohet para pushtetit të iluzioneve, të mashtrimeve, të përfytyrimeve, të cilat për njeriun janë një djall i vogël.

Gjithashtu, të gjitha të vërtetat e dituritë hyjnore, si dhe çdo gjë që i takon botës së dritës e botës së pastërtisë e të shenjtërisë, në shijen e natyrës së pastër të krijimit do të ndiheshin të hidhura dhe në veshët e kësaj krijese të pastër do të kishte një rëndim që e ndalon të dëgjojë.

Çdo gjë që është prej botës së errësirave dhe ndyrësirave, çdo gjë që është prej botës së besimeve të kota e të gabuara, prej botës së iluzioneve mashtruese, prej sofizmave e gënjeshtrave, do të ketë shije të ëmbël në shpirt dhe për atë do të ishin të asimilueshme. Një krijesë e tillë është si

pasqyra e palëmuar, e cila nuk pasqyron figurat ndriçuese e ato me gdhendje të bukura, kurse ato që janë prej anës së gënjeshtrës së trashë, grumbullohen njëra mbi tjetrën mbi këtë pasqyrë të palëmuar. Kështu hyn në shpirt gjendja e mohimit dhe për rrjedhojë zemra nuk i nënshtrohet më asnjë të drejte e asnjë të vërtete. Një zemër e këtillë nuk nënshtrohet as ndaj gjërave që janë domosdoshmëri të natyrës së krijimit. Në çdo të krijuar ekziston cilësia e kalimit prej çdo sistemimi të shkëlqyer te Organizuesi e Bërësi i këtij sistemi. Vetë natyra e pastër e krijimit e ndien se ka një Shpikës, pasi kjo natyrë e pastër krijimi është cilësi e mahnitshme shumë e hollësishme, prandaj në mendjen e njeriut nuk ka asnjë dyshim e asnjë ngurrim që kjo botë e mahnitshme ka nevojë të ketë një Bërës. Zbulimi i fuqisë së rrymës elektrike, shpikja e radios, shpikja e telefonit pa tel e të tjera shpikje të mahnitshme, bëjnë që njeriu, nga vetë origjina e pastër e brumit të krijimit të tij, të kërkojë shpikësin e zbuluesin e këtyre prodhimeve dhe, me dashjen ose pa dashjen e tij, i sjell atij në kujtesë që t'i nderojë e t'i respektojë ata.

Sikur dikush të thotë se këto shpikje s'kanë nevojë as për ndonjë zbulues e as për një mjeshtër që t'i punojë dhe se të gjitha këto është e mundur të kenë bërë vetveten, patjetër që kjo hamendje është e gabuar dhe tingëllon shumë e rëndë në veshët e çdo njeriu, sepse këto fjalë jo vetëm që nuk janë të asimilueshme për shpirtin e njeriut, por kanë edhe shije të hidhur. Prandaj është shumë më mirë të heshtet dhe të mos i kthehet përgjigje kujtdo që thotë të tilla fjalë.

Sistemi i mahnitshëm i botës dhe vepra madhore e bërjes së kësaj bote i habit mendjet. Zbulimi i fuqisë së rrymës elektrike, të cilën njerëzit e prodhojnë në një punishte fare të vogël, që është truri i njeriut, patjetër që mendjet e filozofëve të mëdhenj në të gjithë botën mbeten të hutuara para çdo grimce prej grimcave me të cilat është ndërtuar konstrukti njeri, i cili, në botën e gjithësisë, nuk është më shumë se një grimcë pa vlerë. Edhe pse shkencëtarët e fushës së mjekësisë e të anatomisë kanë mijëra vite që merren me studime të hollësishme mbi ndërtimin e dukshëm të njeriut, përsëri ata s'kanë arritur të argumentojnë të vërtetën e krijimit të njeriut.

Po, krahas këtij përshkrimi, në botën e njerëzve gjenden mizorë e injorantë, në zemrat e të cilëve s'ka nënshtrim ndaj fushës së madhe, në zemrat e tyre s'ka vend për të madhëruar Bërësin e tij, Zotin e tij, Atë që e bëri njeriun të ekzistojë. Mbi zemrat e tyre të ashpra ka rënë pluhuri i dyshimit, i turbullimit e i ngurrimit. Të gjitha këto e kanë bërë këtë njeri të jetë i shkujdesur ndaj punëve të natyrës së pastër të krijimit, kanë bërë që ai të mos jetë i nënshtruar ndaj domosdoshmërive dhe të mos shikojë gjërat e mahnitshme të mendjes.

Në ajetin e nderuar lexojmë: قُتِلَ ٱلۡإِنسَٰنُ مَآ أَكۡفَرَهُۥ ١٧ *"Kutilel-insàne mà ekferehù"* "Mallkuar qoftë njeriu, ç'gjë e bëri atë të mohojë."[1]

E gjitha kjo vjen për shkak të shqetësimit të njeriut për botën e natyrës e me nënshtrimin e tij ndaj pushtetit të iluzionit e të djallëzisë. Për rrjedhojë, në këtë njeri ka humbur drita e krijimit të pastër dhe është shkëputur lidhja e tij me të vërtetat. Këtë çështje e njofton Allahu i Lartësuar në ajetin 20 të sures "El-Ahkaf":

وَيَوۡمَ يُعۡرَضُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ عَلَى ٱلنَّارِ أَذۡهَبۡتُمۡ طَيِّبَٰتِكُمۡ فِي حَيَاتِكُمُ ٱلدُّنۡيَا وَٱسۡتَمۡتَعۡتُم بِهَا فَٱلۡيَوۡمَ تُجۡزَوۡنَ عَذَابَ ٱلۡهُونِ بِمَا كُنتُمۡ تَسۡتَكۡبِرُونَ فِي ٱلۡأَرۡضِ بِغَيۡرِ ٱلۡحَقِّ وَبِمَا كُنتُمۡ تَفۡسُقُونَ

"Ue jeume juëredu-l'ledhijne keferù ale-n'nàri edh'hebtum taj'jibàtikum fij hajàtikumu-d'dun'jà, ue istaëseme bihà, feljeume tuxhzeune adhàbel-hùni bimà kuntum testekbirùne fil-erdi bigajril-hak'ki ue bima kuntum tefsukune"

"Dhe ditën kur mohuesit do të jenë pranë zjarrit, (atyre u thuhet): ju i shfrytëzuat e i përjetuat të mirat në jetën e tokës, prandaj sot do të merrni ndëshkimin përçmues për shkak të mendjemadhësisë që treguat në tokë pa të drejtë dhe për shkak të mëkateve që keni bërë."

Edhe ndonjë të mirë që mund të kenë bërë mohuesit në botën e tokës gjatë jetës së tyre, kënaqësinë e asaj të mire ata e kanë shijuar në botën

[1] Sure "Abese", ajeti 17.

e tokës dhe janë zhytur në llumin e epsheve. Drita e krijimit të pastër të Allahut, që zbriti prej pozicionit të shenjtërisë ishte prej ushqimeve qiellore që i vihej njeriut përpara. Por njeriu e humbi këtë mirë, për shkak të orientimit të tij kah bota e tokës dhe për shkak se ishte i kënaqur kur i plotësoheshin kërkesat e tij në botën e tokës.

Në përgjithësi, nga vetë urtësia e argumentit rezulton: Patjetër duhet të këtë përshtatshmëri mes ushqimit e të ushqyerit. Natyra e pastër e krijimit, që kurrë nuk del prej cilësisë së saj të dritës, e vërteton të Vërtetin e Lartësuar dhe është e nënshtruar ndaj së vërtetës, kurse mbi krijesën e mbuluar është sunduese injoranca e djallëzia. Këtë krijesë të mbuluar me perde e shoqëron mohimi, pasi vërtetimi është prej ushtrive të mendjes dhe mohimi është prej ushtrive të injorancës.

NDARJA E DYTË

NDREQJA E SHPIRTIT PREJ MOHIMIT

Mëso se njeriu, derisa është në këtë botë, në botën e materies e të ndryshimit, ka mundësi të ndryshojë gjendjen e mohimit, e cila është prej gjendjeve më të zeza të shpirtit, sepse mohimi detyrimisht çon në poshtërim e në humbje të përjetshme. Në këtë botë njeriu ka mundësi të dalë prej pushtetit të injorancës e të djallit dhe të hyjë nën urtësinë e mendjes e të Gjithëmëshirshmit. E gjitha kjo realizohet me dituri dobisjellëse dhe me punë të mirë.

Dituri dobisjellëse është mendimi në gjërat e bukura të sendeve të punuara dhe në hollësitë e sekreteve të ekzistencës. Ky mendim hap për mesatarët disa porta të njohjes, edhe sikur ata të jenë prej të mbuluarve plotësisht, megjithëse kjo e mirë e zemrës është e keqe për ata që janë afër të Vërtetit.

Rrugët e mendimit në madhështinë e punimit të sendeve janë aq të shumta, sa nuk numërohen. Por rruga më e afërme për të menduar mbi madhështinë e krijimit është vetvetja, është njohja e vetvetes, është njohja me bërjen e trupit e me punët e trupit, është njëra prej rrugëve më të afërta për të njohur Allahun e Lartësuar: *"Kush njeh vetveten, ka njohur Zotin e tij."*

Tani do të shikojmë procesin e tretjes në këtë krijesë të mahnitshme, që është trupi i njeriut. Ne shohim se njeriu, nga ana fiziologjike, është një prej kafshëve, se çdo kafshë, sipas ngjashmërisë që ka me cilësinë me të cilën është krijuar, ha një ushqim të veçantë. Kjo do të thotë se trupi i asaj kafshe ka nevojë pikërisht për atë lloj ushqimi. Por kjo

kafshë mund ta gjejë atë ushqim. Është po kjo kafshë që ka neveri e refuzon ato lëndë ushqyese që nuk i përshtaten trupit të saj, për shkak se ato lëndë janë të dëmshme për të. Sikur kafsha të vonohet për plotësimin e nevojës që ka për ushqim, stomaku e aparati tretës i saj do të vihej para një gjendjeje që ngjason me një pickim të veçantë, që shpreh se kafsha është e uritur. Sikur të mos ishte kjo thirrje e natyrshme, e shkaktuar prej atij pickimi, do të ishin të gjitha mundësitë që kafsha të ngordhte prej urisë. Pa këtë ndjesi kafsha nuk do të dilte të kërkonte ushqim, ashtu siç ndodh në karakteret e devijuara prej normales.

Përveç kësaj, në sipërfaqen e gjuhës së kafshës ka një fuqi verifikuese, me të cilën kafsha, sipas llojit të ushqimeve, dallon ushqimet që i sjellin dobi dhe ato që e dëmtojnë. Gjithashtu, në sipërfaqen e gjuhës së kafshës gjenden edhe zona ndjeshmërie, me anë të të cilave kafsha shijon ushqimet që janë të dobishme për të. Kjo fuqi në këtë pjesë të gjuhës është si një "ryshfet" që i është dhënë njeriut për të ruajtur trupin e shëndetin e tij. Sikur të mos ishte ky "ryshfet-organ", njeriu nuk do të merrte shumë prej ushqimeve të dobishme, për rrjedhojë trupi i tij gradualisht do të shkatërrohej e do të prishej.

Gjithashtu, çdo kafshë ka dhëmbë që janë në përshtatje me llojin e ushqimit, për të cilin kafsha ka nevojë dhe është ushqim që i përshtatet trupit të saj. Bishat që e kanë mishin ushqimin më dobisjellës për trupin e tyre, kanë dhëmbë të mprehtë, që janë të përshtatshëm për të prerë mishin. Kafshët barngrënëse ushqim më të përshtatshëm për trupin e tyre kanë bimësinë, kanë dhëmbë me sipërfaqe të gjerë dhe kjo i mundëson të ushqehen me lloje të ndryshme bimësh.

Disa kafshë të tjera ushqehen me mish e me bimë, domethënë se kafshët e këtij lloji, në marrjen e ushqimit janë me dy përshtatje, siç është njeriu, i cili ushqehet me mish e me bimësi, prandaj te njeriu janë të dyja llojet e dhëmbëve.

Pasi ushqimi bie në gojë, njeriu fillon menjëherë përtypjen e tij me anë të dhëmbëve. Ky ushqim i përtypur njomet me porcione të vogla sekrecionesh që dalin prej gjëndrave, që gjenden poshtë gjuhës (gjëndrat e pështymës). Këto sekrecione marrin pjesë në procesin e tretjes. Kjo do të thotë se gjatë procesit të tretjes ushqimet kanë nevojë të njomen. Pas bluarjes e njomjes në gojë, ushqimi, nëpërmjet ezofagut, kalon në stomak, ku fillon procesi i plotë i tretjes së ushqimit. Ushqimi, pasi kalon prej gojës, tërhiqet nga forca e gravitetit drejt mureve të stomakut. Në stomak vazhdon procesi i tretjes, derisa ushqimi arrin në fazën e gatimit dhe, pasi plotësohet puna e tretjes në stomak, pjesa e ushqimit që është e përshtatshme të jetë pjesë e trupit, tërhiqet prej tubave të hollë të zorrëve, ku ushqimi përsëri vazhdon të përpunohet. Nga zorrët ky ushqim i përpunuar shkon drejt mëlçisë, kurse pjesa tjetër e ushqimit del jashtë. Pjesa e ushqimit që mbeti pas përpunimit në stomak, futet në kanalin që gjendet në pjesën e fundit të stomakut, që quhet portë, e cila, në rastet kur nuk është e nevojshme, është e mbyllur. Prej kësaj porte ushqimi shtyhet në drejtim të duodenit dhe prej duodenit në zorrët e holla. Të gjitha këto shpjegohen me hollësi në pjesën e anatomisë.[1]

Pjesa e ushqimit të përpunuar e të rafinuar, që është e përshtatshme për trupin, shtyhet drejt mëlçisë. Në mëlçi, ushqimi i bërë si emulsion, ngjan me lëngun e një lloj gjelle që përgatitet me miell bollguri e me kos. Mëlçia pastaj fillon të punojë dhe, pasi përfundon puna e mëlçisë, dalin katër përzierjet, të cilave u thuhen "katër kimuset", e ngjashme me një lëndë qumështore të hollë.

Pjesa më e rëndësishme e më e mirë e kësaj përzierjeje për të ushqyer trupin është gjaku, i cili shtyhet në drejtim të venave dhe prej këtej shtyhet nëpër arteriet e nëpër kapilarët që shpërndahen në të gjitha skajet e trupit. Këtu realizohet procesi i tretë i tretjes së ushqimit. Pjesa e rafinuar e

[1] Ibn Sijnà, "El Kànùnu fit'tib'bi", vëll. 3, Dega 13, Artikulli "Gjendjet e ezofagut dhe bazat e punës së stomakut", f. 283 -286.

ushqimit në këtë fazë, bëhet plotësisht e përshtatshme dhe më pas ajo depërton nëpër tuba shumë elastikë, depërton nëpër arteriet. Këtu fillon faza e katërt e procesit të tretjes. Në këtë fazë të procesit dalin edhe mbetjet, të cilat, me anë të fuqisë gjeneruese të përgatitur, fillon një proces tjetër i tretjes. Një pjesë e gjakut të filtruar kthehet në zemër, ku përsëri filtrohet dhe, pasi avullojnë edhe gazrat, që janë në përbërjen e gjakut, këto gaze përqendrohen në pjesën e majtë të zemrës dhe pastaj, nëpërmjet kanaleve, arterieve të veçanta, gjaku tanimë i rafinuar plotësisht, shkon në drejtim të trurit, që siç dihet është qendra e kuptimit.

Hollësitë e të gjitha këtyre proceseve janë jashtë qëllimit të këtyre fletëve dhe askush s'ka mundësi të mbledhë të gjitha anët e këtij procesi.Dhe tani shiko me syrin e studiuesit e të medituesit, mendo se në cilën "uzinë" punohen e në cilën "rafineri" të përpunimit të thellë rafinohen lëndët e botës së natyrës, shiko se cila është uzina e rafineria që i punon e i ndan këto lëndë dhe pastaj prej asaj përzierjeje ndan një lëndë të vetme me pjesë të ngjashme, por me kaq hollësi e me kaq përpikëri dhe me këto pjesë, në njërin vend të trupit të njeriut, formon lëndë kaq të forta, kurse në një vend tjetër të trupit formon lëndë tepër delikate, siç është perdja e syrit, truri në kokë, apo palca në kocka. Si është e mundur që të gjitha këto lëndë në një vend të trupit bëhen të palëvizshme dhe në një vend tjetër bëhen të lëvizshme dhe të gjitha këto me një sistem kaq të organizuar e kaq të hollësishëm? Si mund të mos vërtetojë natyra e pastër e krijimit se ajo nuk është e ndotur me ndyrësi?

Le të supozojmë se i gjithë ky sistem i përpiktë nuk është bërë prej Organizuesit të plotësuar, prej Atij që ka dijeni për të gjitha të mirat e të këqijat. Edhe pse shkencëtarët që studiojnë anatominë e të gjitha gjymtyrët e njeriut kanë mijëra vjet që e harxhojnë jetën e tyre në këto fusha studimi dhe i kanë studiuar të gjitha gjymtyrët e njeriut deri në imtësi, s'kanë arritur të mbledhin së bashku të gjitha të vërtetat e hollësitë e kësaj mrekullie. Pavarësisht nga përparimi i madh që ka bërë shkenca në ditët e sotme, përsëri mendjet e dijetarëve vazhdojnë të jenë të pafuqishme e të mangëta për të arritur në njohurinë e plotë të krijesës njeri.

Vallë a nuk ka nevojë ora e vogël me ato pjesët e saj të thjeshta për një mjeshtër të ditur? Po krijesa njerëzore me këtë madhështi, me këto gjymtyrë e pjesë që nuk mund të numërohen dhe secila prej këtyre pjesëve është në formën më bukur e më të plotë të punimit e të interesit, a nuk paska nevojë për një Bërës të urtë e të ditur?

Aparati i radios që i merr valët zanore të shpërndara në hapësirë dhe ia dorëzon ato veshit të dëgjuesit, patjetër që ka një bërës të ditur, i cili di të sistemojë pjesët e radios me përpikëri dhe ashtu siç kërkohet për këtë aparat. Po aparati i shpirtit të njeriut, që i merr valët e imta të holla të logjikës e të ndjenjave prej Mbretit të mbretërive dhe të gjitha këto valë ia dorëzon mendjes së njeriut, vallë a nuk ka nevojë për një Rregullues të urtë e të gjithëditur?

Sikur të supozohet që një njeri është i mbuluar me perdet e shkujdesjes *(Allahu mos e lejoftë!),* ky njeri nuk është gjë tjetër veçse një kafshë me fytyrë njeriu dhe kjo për shkak të sëmundjes që ka ai në zemër, e cila është vendi ku dalin të gjitha sëmundjet e brendshme. Padyshim që ky njeri është jashtë natyrës së pastër të krijesës njerëzore, prandaj ai patjetër duhet të mjekohet prej kësaj sëmundjeje të brendshme. Ky i vdekur, nga forma e tij, është i gjalli, për të cilin Allahu i Lartësuar e njofton të Dërguarin më të nderuar, në ajetin 22 të sures "Fàtir: وَمَآ أَنتَ بِمُسۡمِعٖ مَّن فِي ٱلۡقُبُورِ ٢٢ *"…ue mà ente bimusmi'in men fil-kubùri"* "…dhe ti nuk mund të bësh të dëgjojë atë që është në varr."

Kafsha që kullot në natyrë është kafsha që ha prej natyrës. Allahu i Lartësuar i thotë të Dërguarit të Tij: ذَرۡهُمۡ يَأۡكُلُواْ وَيَتَمَتَّعُواْ وَيُلۡهِهِمُ ٱلۡأَمَلُۖ *"dherhum jeëkulù ue jetemet'teù ue julhihumul-emelu"* "Lëri ata të hanë e të dëfrehen dhe le t'i mbajë shpresa..."[1]

Në një vend tjetër, në lidhje me këtë kafshë, Allahu i Lartësuar njofton:

إِنۡ هُمۡ إِلَّا كَٱلۡأَنۡعَٰمِ بَلۡ هُمۡ أَضَلُّ سَبِيلًا ٤٤ *"in hum kel-en'àmi bel hum edal'lu sebijlen"*

"…ata janë si kafshët, madje ata e kanë humbur rrugën edhe më shumë."[2]

[1] Sure "El-Hixhr", ajeti 3.

[2] Sure "El-Furkàn", ajeti 44

Kurse puna e mirë që sjell dobi për të ndërruar gjendjet e shpirtit të errësuar e mohimin e tij, bëhet me dritë e me vërtetim dhe është dy llojesh:

Njëri prej këtyre dy llojeve janë punët e zemrës dhe lloji tjetër janë punët shabllon.

"Punët e zemrës" janë punët që kanë lidhje me cilësinë e pastër të krijimit në gjendjen e tyre fillestare, janë punët që kanë lidhje me shpirtëroren, me të cilën është krijuar njeriu, si dhe punët që kanë lidhje me kolonën e këtyre punëve që është pendimi (teube) me kushtet e brendshme e të jashtme të pendimit.

Dashtë Allahu, në këtë kumtesë, më pas, do të shpjegojmë të vërtetën e pendimit, punët paraprake që mundësojnë pendimin dhe kushtet e pendimit.

Disa prej këtyre gjërave të kërkuara, në lidhje me pendimin, ne i kemi përmendur në librin "Sherhul-erbeijne hadijthen" (Shpjegimi i dyzet haditheve).

"Punët shabllon" janë punët që i kujtojnë shpirtit gjendjet e tij, janë punët që e zgjojnë shpirtin prej gjumit të rëndë e prej dehjes së natyrës. Kjo arrihet vetëm duke e përmendur Allahun e Lartësuar me fjalët që kanë ardhur prej imamëve të pastër të Ehli Bejtit, duke i përsëritur këto fjalë me kushtet që ato kërkojnë dhe me zemër të hapur.

Patjetër që kjo punë, domethënë përsëritja e frazave të përmendjes së Allahut do të jetë me qëllim që t'i kujtohet njeriut që ai të zgjohet, pikërisht në kohët kur njerëzit merren më pak me punët e kësaj bote, siç janë kohët nga pjesa e fundit e natës, ose koha mes agimit e lindjes së diellit.

Në librin "Usùlul-Kàfij" transmetohet: "Allahu i Lartësuar i tha Isàit *(Paqja e Allahut qoftë për të!): "O Isa, më kujto Mua në shpirtin tënd që edhe Unë të të kujtoj ty, me kujto Mua në prani të njerëzve tuaj dhe Unë do të të kujtoj ty në prani të njerëzve më të mirë; O Isa, për Mua zbute zemrën tënde, më përmend Mua shumë*

kur je në vetminë tënde dhe mësoje se Unë gëzohem shumë kur ti, për hirin Tim, kujdesesh për të tjerët dhe në këtë të jesh i gjallë e jo i vdekur."[1]

Po, me përmendjen e vërtetë të Allahut të Lartësuar grisen perdet që janë midis robit e të Vërtetit, hiqen pengesat që pengojnë praninë e të Lartit, largohet ashpërsia e zemrës dhe shkujdesja e robit; për rrugëtarin hapen portat e mbretërive më të larta, për atë hapen portat e butësisë së të Vërtetit të Lartësuar, hapen edhe portat e mëshirës së Tij, por me kushtin që, në këtë përmendje të të Vërtetit, zemra të jetë e gjallë dhe jo e vdekur dhe robi, që është së bashku me të vdekurit, të mos jetë i kënaqur. Çdo gjë tjetër përveç Allahut e shenjtërisë së Tij, është prej të vdekurve. Gjithashtu edhe zemra që është së bashku me njerëzit, afrohet drejt të vdekurve dhe ha prej të vdekurve.

Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُۥ *"…kul'lu shej'in hàlikun il'là vexh'hehù…"* "…të gjitha sendet do të zhduken, me përjashtim të Atij…."[2]

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Fjala më e drejtë që ka thënë ndonjë poet, është fjala që ka thënë Lebidi: 'Bëni kujdes, çdo gjë ku nuk është Allahu, është e gabuar."*

Lidhja e zemrës me të gjitha qeniet, cilado qoftë, është shkujdesje ndaj Allahut. S'ka më të mirë se përmendja e Allahut, edhe dashuria e tyre është dashuri për Allahun. Ata, të veçantët e të Vërtetit, në mënyrë absolute, "janë asgjësuar" në bukurinë e më të Bukurit; ata e kanë kapërcyer unin dhe veten e kanë vënë poshtë këmbëve të tyre; ata kanë shtruar para tyre dy qeniet dhe kanë refuzuar dy krijesat, që janë emrat e lartë të Allahut dhe argumentet e Tij të plota.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 364, K. "Ziqri në fshehtësi".
[2] Sure "El-Kasas", ajeti 88.

Në përgjithësi, ringjallja e zemrës ka lidhje me përmendjen e Allahut dhe në mënyrë të veçantë përsëritja e emrit të bukur "jà Haj'j jà Kaj'jùm" ("O i Gjallë, o Përjetësim!"). Ashtu siç u tha më sipër, përmendja e Allahut (ziqri) bëhet me zemër në dorë.

Citohet prej atyre që quhen "Ehlu-dh'dhikri uelmaërifeh" (ata që bëjnë ziqër të plotë dhe kanë arritur shkallën e njohjes) se bërja sexhde çdo ditë e çdo natë dhe përsëritja sa më shumë e frazës:

"لاَ إِلَهَ إِلاَّ أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِيْنَ"

"là ilàhe il'là ente, subhàneke in'nij kuntu mine-dh'dhàlimijne" "S'ka tjetër përveç Teje, Ti je i Gjithëfuqishmi dhe unë jam prej të padrejtëve."[1] është veprim shumë dobisjellës për lartësimin shpirtëror. Gjithashtu, prej disave që ndjekin rrugën e Ahiretit tregohet se, kur ai dëgjoi prej mësuesit dobinë e madhe që sjell sexhdeja, bënte sexhde çdo ditë e çdo natë dhe, këtë frazë ziqri të nderuar, ai e thoshte 1000 herë. Prej disa të tjerëve është cituar se këtë frazë ziqri ai e thoshte deri edhe 3000 herë.[2]

Prej imam Zejnel-Abidijn Ali bin Hasenit, që është zotëria i atyre që bëjnë sexhde, citohet se ai pa një rrasë guri të ashpër dhe mbi atë rrasë guri vuri ballin në sexhde, qau dhe tha 1000 herë:

"لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ حَقًّا حَقًّا، لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ تَعَبُّدًا وُ رَقًّا، لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ إِيْمَانًا وَ تَصْدِيْقًا"

"là ilàhe il'le-ll'llàhu hak'kan hak'kan, là ilàhe il'le-ll'llàhu teab'buden ue rek'kan, là ilàhe il'le-ll'llàhu ijmànen ue tasdijkan" "S'ka zot tjetër përveç Allahut me të drejtë, me të drejtë! S'ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton adhurim e përulje! S'ka zot tjetër përveç Allahut me besim të plotë e me vërtetim!"[3]

---

[1] Sure "El-Enbijà", ajeti 87

[2] "Elmuràkabàt", autori: dijetari njohësi i shquar Mirza Xhevàd Melekij Et'tebrijzij.

[3] "Vesàilu-sh'shij'ah" vëll. 6, f. 382; "Kitàbu-s'salàti", K. 23; "Sexhdja", vëll. 15.

Sexhdet e gjata që bënte i nderuari ynë Mùsà bin Xhafer (paqja qoftë mbi të!) janë të njohura.[1]

Argumenti i nderuar, Ibni Ymejr, në sexhdet e gjata kishte si shembull zotërinë tonë të nderuar.

Prej Fadil bin Shadhanit transmetohet: "Hyra në Irak, ku pashë një burrë që po i fliste mikut të vet me këto fjalë: "Ti je një burrë që ke familje për të mbajtur dhe patjetër duhet të fitosh për ta. Unë nuk jam i sigurt se ti nuk do të verbohesh për shkak të sexhdeve të gjata që bën."

Atëherë burri iu kthye: "Ore i mjerë! Nëse do të ishte verbuar dikush prej sexhdeve të gjata, patjetër do të ishte verbuar Ibn Ebu Umejri. Si mendon ti për një burrë, i cili e bën sexhden e falënderimin pas faljes së namazit të sabahut dhe nuk e ngre kokën prej kësaj sexhdeje pa ardhur koha për faljen e namazit të mesditës?! Është thënë se sexhdeja e gjatë është prej fesë së imamëve dhe prej rrugëve të atyre që janë të kthyer te Allahu."[2]

Po, atyre që e kanë arritur gradën të njohin Allahun e Lartësuar, që ndiejnë kënaqësinë e shoqërimit me Qenien e Shenjtë dhe që janë të dashuruar pas kësaj Qenieje, kjo lloj pune nuk i shkakton atyre as lodhje e as vështirësi. Shoqëria me të Dashurin e dashuria ndaj të Dashurit, kurrë nuk sjellin lodhje e mërzitje, veçanërisht kur i Dashuri është Ai, të Cilin e dashurojnë të gjithë dhe të gjitha dashuritë rrjedhin prej dashurisë së Tij.

Esh'shirazij *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)* thotë: "Në zemrat tona s'ka vend për asnjë tjetër vetëm për të Dashurin. Ti jepi armikut të gjitha botët, ne na mjafton i Dashuri."[3]

---

[1] Historia e Imamit Mùsà bin Xha'fer, f. 116, hadithi 29.

[2] O baba i Muham'medit, ke detyrim të bësh sexhde të gjata, sepse kjo është prej rrugëve të atyre që janë kthyer te Allahu.

[3]Përmbajtja e një poezie në gjuhën perse.

Ata që kanë pirë prej kupës së të Dashurit dhe kanë arritur jetën e përhershme prej ujit të jetës, mendojnë se botët janë të përshtatshme për armikun dhe ai i meriton të gjitha botët.

Miku i Mëshirëplotit, profeti i Allahut, Ibrahimi *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* në zemrën e tij kishte vetëm Allahun e Lartësuar, kur tha:

إِنِّي وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ *"Innij vexh'xhehtu vexhhij lil'ledhij fetare-s'semàvàti uel-erda…"* "Vërtetë, unë i jam drejtuar vetëm Atij që ka krijuar qiejt e tokën…."[1]

Ai i tha këto fjalë kur Xhibrili besnik, engjëlli i ngarkuar me kumtimin e shpalljes dhe të diturisë së lartë, e pyeti: "A ke ndonjë nevojë se unë për këtë kam ardhur te ti?"

Ata, të gjitha nevojat që kanë, i mbështesin vetëm në të Dashurin. Ata s'kanë nevojë tjetër përveç Atij dhe për të dashuruarin me të Bukurin s'ka qëllim tjetër përveç Kibles së vërtetë, por *"Ka vetëm një Kible të dashurisë."*

Po, ne të verbuarit, të shurdhuarit dhe të mbuluarit me perde prej të gjitha pozitave, gjejmë strehë në dëshirat kafshërore dhe i mbushim mendjen vetes në mesin e të gjitha lumturive me sende prej kuptimeve që s'kanë asnjë fuqi, kur duhet të shpresojmë që i Dashuri të na marrë për dore me mëshirën e Tij dhe të na nxjerrë prej këtyre perdeve të trasha e prej errësirave të grumbulluara njëra mbi tjetrën. Vetëm Ai i jep gjallëri zemrave tona me dashurinë e Tij, prandaj i dashuruari nuk i pret lumturitë prej ndonjë tjetri përveç Atij dhe i lidh ato vetëm me Qenien e Tij të shenjtë.

[1] Sure "En'-Am", ajeti 79.

QËLLIMI I KATËRT

SHPRESA, E KUNDËRTA E SAJ, HUMBJA E SHPRESËS NË KËTË QËLLIM KEMI KATËR NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIM: SHPRESA ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES, KURSE PREREJA E SHPRESËS E DËSHPËRIMI JANË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS E IBLIJSIT

Mëso se kur mendja është e mbushur me dritën e pastër të krijimit e me pastërtinë e brumit me të cilin është gatuar, njeriu arrin të kuptojë shijen morale dhe njeh se i Vërteti i Lartësuar është absolutisht i plotësuar dhe se mbi Qenien e Tij, mbi cilësitë e Tij, mbi emrat e Tij e mbi punët e Tij s'ka as kufizim e as kushtëzim.

Mbi mangësitë e mbi kufizimin e mundshëm, shkëlqen mëshira e Qenies së Shenjtë. Kjo mëshirë është e pakufizuar me ndonjë kufi dhe e pakushtëzuar me ndonjë kusht. Kjo njohuri e njeriut është e shoqëruar me shpresën e plotë e të sigurt në të Vërtetin e Lartësuar dhe në mëshirën e Tij,

sepse vetë natyra e pastër e krijimit e thërret njeriun drejt plotësimit absolut e drejt mëshirës së gjerë. Kjo është thirrja që e çon njeriun drejt shpresës së plotë.

Gjithashtu, kur natyrës së pastër të krijimit perdet i pengojnë dritën që ka vetë natyra origjinale e pastër e krijimit të tij, nuk e lënë të shohë Allahun e Lartësuar me plotësimet, me cilësitë e Tij dhe mëshirën e Tij të gjerë. Gjithashtu, këto perde herë-herë arrijnë deri në atë cak sa njeriu e humb shpresën prej mëshirës së Allahut. Prerja e shpresës prej mëshirës së Allahut do të thotë se mëshira e tij është e kufizuar, për rrjedhojë ky kufizim i shpresës do të jetë i shoqëruar edhe me kufizimin e emrave e në cilësitë e Tij, njëjtë siç pretendojnë idhujtarët kufizimi i Qenies së Shenjtë.

Tani u mësua se shpresa është prej natyrës së pastër të krijimit dhe prerja e shpresës është në kundërshtim të plotë me natyrën e pastër të krijimit, me të cilën është gatuar njeriu, domethënë prerja e shpresës është vetë mbulimi.

Gjithashtu, u mësua se kriter për arritjen e shpresës është mendimi i mirë për Allahun e Lartësuar dhe kriter i prerjes së shpresës prej mëshirës së Allahut të Lartësuar është mendimi i keq për Qenien e Shenjtë. Në të vërtetë, kriteri për arritjen e mendimit të mirë, ose për arritjen e mendimit të keq, vjen ose nga dituria për gjerësinë e mëshirës, të besimit e të plotësimit të emrave, të cilësive e të punëve, ose vjen nga mospasja dituri për këto, domethënë se burimi për mendimin e mirë, ose për mendimin e keq është ose njohja e Qenies së Shenjtë, ose mospasja dijeni rreth Saj.

Vetë natyra e pastër e brumit me të cilin është krijuar njeriu, nuk është e mbuluar dhe se mbulimi vjen për shkak të orientimit kah natyra, kah pema e keqe, që është pema e ndaluar, e përmendur në botën e lëshimeve. Bazuar mbi këtë shpjegim, pezullohet njohja e të Vërtetit që ka njeriu nga vet natyra e pastër e krijimit dhe injoranca bëhet sunduese mbi natyrën e pastër origjinale, me të cilën ai është krijuar.

Sikur njeriu të mos orientohej kah pema e keqe e natyrës, ai kurrë nuk do të ishte i mbuluar për të mos parë Allahun e Lartësuar. Në shpirtin e tij do të shndrisnin emrat e bukur me cilësinë e tyre të brendshme pa asnjë kufizim e pa asnjë kushtëzim. Është kjo shndritje që sjell lidhjen e zemrës, gëzim e shpresë është shpresa e fshehtë dhe e konsoliduar. Por në gjendjen e orientimit kah pema e keqe, e ndaluar, në këtë dituri, njeriu arrin aq sa është masa e orientimit në emrat, në cilësitë e në punë. Por për shkak të këtij orientimi, arrihet mospasja dijeni për gjerësinë e mëshirës, derisa njeriu del plotësisht jashtë natyrës së pastër të krijimit dhe në të bëhen sunduese rregullat që imponon mbulimi dhe pasqyrën e zemrës së tij e rrethon errësira e turbullira, aq sa e privon njeriun nga njohja e botës së të fshehtave, e privon edhe prej ndriçimit të emrave e të punëve dhe e mbulon njeriun prej pasqyrimit të ndriçimit të mëshirës, për rrjedhojë, mbi zemrën e tij bëhet sundues dëshpërimi e prerja e shpresës prej mëshirës së Allahut, aq sa njeriu e izolon veten prej gjerësisë së mëshirës së të Vërtetit të Lartësuar.

Allahu na ruajttë, ky është poshtërimi më i madh.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIM: DALLIMI MIDIS SHPRESËS E JOSHJES

Mëso se njeriu, për shkak të dashurisë ndaj vetes e admirimit që ka për veten e tij, harron dhe është krejtësisht i pakujdesshëm ndaj vetes, madje arrin deri aty sa edhe mangësitë e të metat që ka, mendon se janë të mira e të plotësuara. Ngjashmëria mes cilësive të shpirtit është shumë e madhe. Të paktë janë ata që kanë aftësinë e fuqinë të bëjnë dallimin e drejtë e të saktë. Kjo cilësi është një prej kuptimeve të harrimit të vetvetes, ose një prej shkallëve të uljes, që vjen prej harrimit të të Vërtetit të Lartësuar.

Këtë të vërtetë Allahu i Lartësuar e thekson në ajetin 19 të sures "El-Hashr:

وَلَا تَكُونُواْ كَٱلَّذِينَ نَسُواْ ٱللَّهَ فَأَنسَىٰهُمۡ أَنفُسَهُمۡۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡفَٰسِقُونَ ١٩

"Ue là tekùnù kel'ledhijne nesu-ll'llàhe fe'ensàhum enfusehum, ulàike humul-fàsikùne"
"...mos u bëni si ata që e harruan Allahun dhe Allahu bëri që ata të harrojnë vetveten, të këtillë janë mëkatarët."

Tani nuk do të futemi në shpjegimin e detajuar të kësaj çështjeje.

Prej punëve që kanë burim të ngjashëm dhe që njeriu mburret me ato për shkak të mbulimit që e ka zënë, është edhe dallimi mes joshjes e shpresës dhe mes shpresës e besimit në të Vërtetin e Lartësuar.

Dihet se joshja është prej ushtrive të shumta të Iblijsit, joshja është e kundërta e shpresës, e cila është prej ushtrive të logjikës e prej ushtrive të Gjithëmëshirshmit. Natyrisht që këto dy punë, shpresa e joshja janë të ndryshme dhe dallohen sipas kritereve e sipas shenjave që ato lënë.

Kriteri i shpresës është dituria për gjerësinë e mëshirës e besimi në vërshimin e bollshëm dhe besimi që emrat e cilësitë janë të plotësuara. Kurse kriteri i joshjes është mosdhënia rëndësi punëve hyjnore, mospasja dijeni për botët e panjohura, për formën e punëve të fshehta, për domosdoshmëritë e cilësive hyjnore të shpirtit. Gjithashtu ndryshojnë edhe gjurmët që lënë shpresa e joshja. Për atë që s'ka dituri për gjerësinë e mëshirës, për bollëkun e mirësive që jep i Vërteti dhe nuk beson në mirësitë e Tij, patjetër që këto dituri arrihen në gjendjen e shpresës dhe janë këto dituri që i bëjnë thirrje të pastrojë punët e moralet e tij, të jetë i përkushtuar në bindjen ndaj urdhrave të të Lartit, ndaj urdhrave të Atij, në dorën e të Cilit është furnizimi me mirësitë. Kurse i joshuri, realisht, ka rënë në kurthin e djallit e të lakmisë së shpirtit. Prandaj ai mbetet prapa në fushën e fitimit të diturive dhe në arritjen e moraleve të nderuara e të punëve të mira.

Ata që shpresojnë edhe kur punët i bëjnë në mënyrën më të plotësuar, nuk mbështeten në punët që bëjnë e në gjendjet që kalojnë, sepse ata e kanë gjetur madhështinë e të Vërtetit. Ata e dinë mirë se të gjitha sendet janë vogëlsira para madhështisë së Tij dhe se çdo plotësim është pavlerë kundrejt fuqisë e madhështisë së Tij, prandaj ata mbështeten vetëm në mëshirën e Qenies së Shenjtë, në bollëkun e vërshimit të kësaj Qenieje.

Kurse të joshurit, kanë mbetur prapa të gjitha plotësimeve. Ata e shtyjnë veten të rreshtohen në radhën e kafshëve më të ulëta. Ata janë të shkujdesur ndaj të Vërtetit të Lartësuar e ndaj mëshirës së Tij dhe i kthejnë shpinën dy frazave madhështore:

"إِنَّ اللهَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِيْنَ "

"in'ne-ll'llàhe erhamu-rr'rràhimijn" "Allahu është më mëshiruesi i mëshiruesve." dhe "أَللهُ أَكْبَر" *"Allahu ekber"* "Allahu është më i madhi!"

Këto fraza madhore në shpirtin e tij janë vetëm lëvizje të gjuhës e asgjë më shumë.

Djalli e nxit njeriun të bëjë mëkate të mëdha, të lërë pa kryer detyrat madhore, me të cilat është ngarkuar t'i kryejë. Njëkohësisht e mëson të joshurin të thotë "اللهُ أَكْبَر" *"Allahu ekber"* "Allahu është më i madhi!" në rastet kur duhet të kërkojë ndjesë. Sikur të gjente vetëm një grimcë prej madhështisë së Allahut të Lartësuar, do të ishte e pamundur për atë të kundërshtonte hapur Allahun, në prani të krijesave e në prani të Tij dhe nuk do të harronte mirësitë e shumta që Ai i ka dhënë.

Njerëz të kësaj kategorie e përmendin Allahun e Lartësuar me nderim, me përkushtim dhe e madhërojnë Atë. Ata e pohojnë mëshirën e të Vërtetit të Lartësuar për veten e tyre e për të tjerët, por punët e tyre nuk ngjasojnë me punët e atyre që i kanë zemrat të stolisura me madhështinë e të Vërtetit, pasi në zemrën e tyre ka rënë një rreze prej dritës së madhe të mëshirës së Allahut të Lartësuar.

Të joshurit janë të shkujdesur ndaj punëve që kanë të bëjnë me botën e ardhshme, madje ata përtojnë t'i kryejnë ato punë. Megjithëkëtë, punën e tyre e quajnë shpresë të sigurt, sepse ata e përfytyrojnë shpresën në formën e mbështetjes në madhështinë e të Vërtetit, në një kohë kur për punët që kanë të bëjnë me botën e tokës, tregojnë kujdesin më të madh dhe nxitohen të mbledhin e të korrin sa më shumë. I joshuri vepron sikur Allahu i Lartësuar është i Madhi vetëm në botën e ardhshme. Gjithashtu, i joshuri beson se për Allahun s'ka madhështi në punët që i përkasin botës së tokës.

Njerëz të kësaj kategorie, në punët e kësaj bote, mbështeten plotësisht mbi veten e tyre dhe mbi njerëzit dhe janë krejtësisht të shkujdesur ndaj të Vërtetit, madje arrijnë deri aty sa nuk e përmendin fare emrin e Tij dhe, në lidhje me punët të botës së ardhshme, pretendojnë se ata mbështeten vetëm në Allahun e Lartësuar, por kjo mbështetje e tyre nuk është gjë tjetër veçse joshje.

Në përgjithësi, ata që shpresojnë, nuk i lënë punët mangët, por punojnë më shumë se të tjerët dhe nuk mbështeten në punët që bëjnë. Esencën e punës që bëjnë e mbështesin vetëm në të Vërtetin e Lartësuar dhe mangësitë e veta ata i shikojnë si mëshirë e madhe prej të Lartit.

Të joshurit merren me lojëra të kota dhe dyshojnë në ditët kur duhet të hedhin farën, duke i kaluar ditët e jetës së tyre në përtaci, duke thënë: "Allahu është më i madhi, Ai ka fuqi të japë edhe pa punuar e pa mbjellë asnjë farë", në një kohë që ata që shpresojnë kanë dyshime në një fermer, i cili e punon tokën, i mbjell farat në kohën e duhur, i vadit të mbjellat dhe e kërkon rritjen e bimës prej të Vërtetit të Lartësuar. Ai që shpreson, e shikon daljen dhe pjekjen e frutave si rezultat i fuqisë së të Vërtetit të Lartësuar.

"Kjo botë është ferma në të cilën mbillet bota e ardhshme". Kështu e ka argumentuar vula e profetëve, Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Të joshur janë ata që nuk punojnë, megjithatë kërkojnë kënaqësinë e Allahut dhe rezultatin e mirë. Kurse ata që punojnë dhe mbështeten në punën e tyre, janë prej atyre që admirojnë veten, harrojnë veten dhe janë të shkujdesur ndaj të Vërtetit, ndërsa ata që punojnë, përçmojnë veten e punët që bëjnë dhe mbështeten në të Vërtetin e në mëshirën e Tij të madhe, këta janë ata që shpresojnë.

Karakteristika dalluese e atyre që shpresojnë është se mbështeten vetëm në të Vërtetin e Lartësuar. Sytë e tyre janë të mbyllur ndaj të gjitha gjërave që ka në këtë botë dhe janë të hapura vetëm para Bukurisë së bukurive. Ata e bëjnë punën dhe detyrën e ngarkuar. Dituria që ata kanë, i shtyn të lëvizin e të shkojnë në drejtim të punës. Gjithashtu, dituria që kanë, i ndalon ata të mbeten prapa e të kundërshtojnë.

Në librin "El Kàfij" lexojmë një transmetim, të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, *"Besimtari nuk është besimtar, derisa të ketë frikë e të*

shpresojë dhe ai nuk ka frikë e nuk shpreson derisa punon për ato që ai ka frikë e për ato që ai shpreson."

Gjithashtu, në librin "El Kafij" lexojmë një transmetim të ardhur prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* thotë: 'Allahu i Lartësuar ka thënë: *"Ata që mbështeten në Mua, për të arritur shpërblimin Tim, nuk mbështeten në punët që bëjnë. Sikur ata të kishin punuar e të kishin lodhur veten e tyre gjatë jetës së tyre duke më adhuruar Mua, do të ishin të mangët. Me adhurimin e tyre ata nuk e kanë arritur esencën e adhurimit që duhet të bëhet për Mua për ato që ata kërkojnë te Unë: bujarinë Time, mirësitë e mëdha që gjenden vetëm te Unë dhe gradat e larta pranë Meje. Ata le të besojnë e të shpresojnë në bujarinë e në mëshirën Time. Ata le të kenë mendim të mirë për Mua që të jenë të sigurt e të qetësuar. Në këtë gjendje mëshira Ime arrin te ata. Gjithashtu, te ata arrijnë mirësitë e Mia dhe kënaqësia Ime, te ata arrin falja e mëkateve dhe toleranca Ime. Unë jam Allahu, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Me këto cilësi Unë kam emërtuar Veten."*[1]

Hadithet, në lidhje më këtë çështje, janë të shumta, prandaj o i shtrenjti im, lexoi gjendjet e vetes tënde dhe dalloi se cilat janë kriteret, gjendjet dhe frutat e gjendjeve të tua!

Shiko se në cilën kategori jemi ne. A na bëjnë ne madhështia e Tij, mëshira e Tij e madhe, falja e mëkateve nga ana e Tij, gjerësia e tolerancës e falja e Tij? A na bëjnë ne këto, të shpresojmë prej Qenies së Shenjtë, apo ne jemi vënë në sprovë me joshjet e djallit e të shkujdesur ndaj të Vërtetit të Lartësuar e ndaj cilësive të bukurisë së madhështisë së Tij? A jemi vënë në sprovë me neglizhimin ndaj punëve të botës së ardhshme?

Respektimi ndaj mirësidhënësit e respektimi për ardhjen e çdo personi të ftuar, është prej cilësive të natyrës së pastër të krijimit. Paria e kësaj bote që adhurojnë Mirësidhënësin në këtë botë, ose atyre që kanë fuqi, forcë e madhështi në këtë botë, u është mbushur mendja se janë të mëdhenj e mirësidhënës. Për të gjitha këto, natyra e pastër e krijimit i ka lënë ata të

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 58, K. "Mendimi i mirë për Allahun", hadithi 1.

mbuluar në respektin e tyre. Sikur ti të zbukuroje zemrën tënde me madhështinë e të Vërtetit, me gjerësinë e mëshirës së Tij, me dhënien e madhe të mirësive e të faljes së mëkateve nga ana e Tij, me gjithëpërfshirjen e faljes së Tij, atëherë natyra e pastër e krijimit, e fermentuar në brumin me të cilin ti je gatuar, të bën thirrje të respektosh e të madhërosh praninë e Atij që përfshin të gjithë botën, atëherë prej teje kurrë nuk do të dilnin kundërvajtje për shkak të mbulimit me perdet e shkujdesjes, pasi mbulimi është shkaku i joshjes e i tundimit.

I shtrenjtë, vështro me kujdes, zgjohu prej gjumit të rëndë, ruhu prej joshjes e prej tundimit të djallit, sepse kjo joshje e shkatërron përjetësisht njeriun, e le atë prapa karvanit të udhëtarëve, e privon atë prej fitimit të diturive hyjnore, të cilat janë kënaqësia e atyre që quhen njerëz të Allahut.

Dhe mëso se në të joshurin nga mendjemadhësia nuk ndikojnë porositë hyjnore, nuk ndikojnë as thirrjet e profetëve e as këshillat e eulijave, sepse joshja nga mendjemadhësia i shkul të gjitha rrënjët dhe është prej kurtheve të mëdha të Iblijsit dhe prej litarëve të hollë që lidhin shpirtin.

Janë pikërisht këto kurthe e litarë që e bëjnë njeriun të jetë i shkujdesur, të mos mendojë rreth vetes së tij, rreth sëmundjeve që ka dhe që e bëjnë atë të harrojë. Mjekët psikologë s'kanë fuqi ta shërojnë këtë të shkujdesur, prandaj ai le të bëjë kujdes të përmirësohet para se të ndodhet në kohën e dëshpërimit, në kohën kur të shohë të mbyllur plotësisht rrugën e mjekimit.

Për këtë njofton Allahu i Lartësuar në Librin e Tij Famëlartë:

وَأَنذِرۡهُمۡ يَوۡمَ ٱلۡحَسۡرَةِ إِذۡ قُضِيَ ٱلۡأَمۡرُ وَهُمۡ فِي غَفۡلَةٖ وَهُمۡ لَا يُؤۡمِنُونَ ٣٩

"Ue endhirhum jeumel-hasreti idh kudijel-emru ue hum fij gafletin ue hum là ju'minùne"

"Paralajmëroi ata për ditën e dëshpërimit, kur të përfundojë puna, ndaj së cilës ata janë të shkujdesur."[1]

[1] Sure "Merjem", ajeti 39.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIM: DALLIMI MES FRIKËS, QË ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES E TË MËSHIRËPLOTIT DHE PREJES SË SHPRESËS, QË ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS E TË DJALLIT

Mësoje se kriteret e frikës prej të Vërtetit të Lartësuar dhe kriteret e dëshpërimit e të prerjes së shpresës janë të ndryshme, gjithashtu edhe ndikimet e frutat e tyre janë të ndryshme e të dallueshme qartë njëra nga tjetra.

Frika vjen ose prej shkëlqimit të madhështisë së të Vërtetit të Lartësuar, ose prej ashpërsisë së dënimit të Tij, ose prej llogarisë së imët, ose prej kërcënimit me ndëshkimin e me dënimin, ose prej mangësisë që ka vetë njeriu, ose pafuqisë së tij për të bërë punët. Megjithëkëtë s'ka asgjë për këto që u thanë, që është në kundërshtim me shpresën dhe me besimin. Rezultati i kësaj shprese është kryerja e punëve dhe vijimësia në bindje e nënshtrim ndaj të Vërtetit.

Qëllimi më i lartë është puna më e mirë ndaj secilit kriter. Kush thirret të punojë për të parë madhështinë e Lartësinë e të Vërtetit, qëllimi më i lartë i punës së tij është madhërimi i të Madhit, Madhështorit. Gjuha e gjendjes së punës së tij thotë: "Të gjeta Ty që e meriton adhurimin, prandaj unë të adhuroj vetëm Ty!"

Frika e kësaj kategorie njerëzish është ndryshe nga frika e të tjerëve, gjithashtu edhe puna e kësaj kategorie është ndryshe nga puna e të tjerëve. Puna e kësaj kategorie s'ka lidhje me Xhenetin e me zjarrin. Kjo kategori njerëzish nuk shikon në shpërblimin e në dënimin për punët, sepse atë e shtyn frika prej ndëshkimit, dënimit, gjendjes së rëndë e llogaridhënies.

Qëllimi i punës së këtij njeriu është që të shpëtojë prej këtyre tmerreve dhe të arrijë në ato që janë e kundërta e këtyre që u thanë.

Atë që e shtyn të këtë frikë e të punojë për shkak të mangësive që ka në veten e tij, është qëllimi për të hequr këto mangësi me aq sa është e mundur dhe të arrijë plotësimin me aq sa ka mundësi.

Kurse prerja e shpresës dhe dëshpërimi prej mëshirës së të Vërtetit e prej faljes së Tij gjithëpërfshirëse jo vetëm që është prej mëkateve më të mëdha, por është edhe mosbesim në emrat e Allahut e të punëve të Tij të padukshme, është mosbesim i plotë në Allahun e Lartësuar, është injorancë për pozitën e lartë të Shenjtërisë së Tij.

Rezultat i këtij mosbesimi është dëshpërimi, prerja e shpresës dhe privimi, është ndalimi për të punuar, heqja dorë nga serioziteti, shkëputja e lidhjeve të robërisë ndaj Allahut, lëshimi i frerëve të dëshirave e të epsheve. Ja kështu, pak e nga pak, njeriu i largohet të Vërtetit të Lartësuar e izolohet prej mëshirës së Tij.

Prej kurtheve të mëdha të Iblijsit është se, ai në fillim, e tërheq njeriun drejt mendjemadhësisë. Me këtë mjet, Iblijsi e bën njeriun të lëshojë krejtësisht frerët. Gjithashtu, Iblijsi, në fillim e tërheq njeriun drejt mëkateve të vogla, derisa e çon në mëkatet e mëdha dhe prej mëkateve të mëdha e çon në mëkatet e mëdha shkatërruese. Pasi Iblijsi luan me njeriun në këtë rrugë për aq kohë sa ai dëshiron, e nxit njeriun të pretendojë se ai shpreson mëshirën, edhe pse është në mesin e mendjemadhësisë. Më në fund, nëse Iblijsi sheh te njeriu dritë dhe mendon se ai do të pendohet e do të bëjë kthesë, atëherë, me kurthet e tij, e tërheq atë drejt dëshpërimit dhe bën që njeriu të presë shpresën prej mëshirës së Allahut të Lartësuar. Në këtë

gjendje Iblijsi i afrohet njeriut me kurthet e tij dhe i thotë: "Puna jote mbaroi e nuk mund të bëhet kthesë, që pas kësaj të të pranohet përmirësimi."

Ky është kurthi më i madh, është kurthi me të cilin Iblijsi e largon njeriun prej portës së Allahut dhe i mban dorën, që njeriu të mos kapet pas mëshirës hyjnore. Pikërisht këtu është fillimi për shkatërrimin e çuditshëm dhe për ligësitë që nuk mund të numërohen. Në këtë gjendje, të mashtruarit dëmtojnë vetveten e të tjerët më shumë se kushdo tjetër. Kjo gjendje është kulmi i injorancës e fundi i të keqes.

Prandaj njeriu patjetër duhet të kërkojë mjekim prej këtij mëkati shumë të madh e shkatërrues. Duhet të mendojë menjëherë mëshirën e gjerë të Allahut, butësinë e Tij të padukshme e kënaqësitë që jep përmendja e Qenies së Shenjtë. Allahu i Lartësuar, për njeriun ka bërë butësi e mëshirë të posaçme, përveç mëshirës së tij të përgjithshme, në të cilën edhe njeriu ka pjesën e tij së bashku me të gjitha kafshët. Kjo është mëshira që hyn në jetën e tij kafshërore, ose në pozitën e tij bimore, pasi edhe në këto pozita të mëshirës së përgjithshme për njeriun ka nderime të veçanta. Janë pikërisht këto nderime të veçanta që e dallojnë atë prej të gjitha kafshëve.

Uji e ajri janë boshti rreth të cilave rrotullohet jeta e kafshëve dhe e bimëve. Të dyja këto janë prej mirësive të mëdha, ndaj të cilave njeriu është fare i shkujdesur. Ne, njerëzit, nuk i llogarisim këto dy mirësi të mëdha, për shkak se jemi brenda këtyre dy mirësive.

Njeriu, para se të lindë, Allahu i Lartësuar për atë ka përgatitur ushqim dhe ky ushqim, në këtë kohë është ushqimi më i përshtatshëm për njeriun. Allahu i Lartësuar ka bërë që në zemrën e dy prindërve të tij të ketë dashuri për të më shumë nga sa është kjo dashuri te kafshët për të vegjlit e tyre. Të dy prindërit punojnë, lodhen për të fituar, që të kenë sa më shumë mundësi të kujdesen sa më mirë për mirërritjen e fëmijës së tyre dhe në sajë të kësaj lidhjeje të fortë dashurie, të dy prindërit i shërbejnë fëmijëve të tyre

me gjithë shpirt dhe kurrë nuk e përmendin këtë shërbim e nuk lakmojnë që kundrejt këtij shërbimi të kenë ndonjë shpërblim, apo diçka të ngjashëm.

Nëna kalon net të shumta, që nuk numërohen në lodhje të mëdha dhe askush s'ka mundësi të bëjë atë që bën nëna për fëmijën, sado i madh të jetë shpërblimi. Gjatë kohës që nëna pranon këto lodhje të shumta, nga thellësia e zemrës së saj përpiqet të sigurojë qetësi të plotë për fëmijën e saj. Nëna përballon peshën e rëndë të pagjumësisë, përgjon çdo lëvizje të fëmijës pa mbyllur sy, qëndron zgjuar duke u kujdesuar për fëmijën. Nëna kurrë nuk fle pa e zënë gjumi fëmijën e pa u qetësuar fëmija i saj.

Ky është pasqyrimi i dashurisë hyjnore për njeriun dhe kjo dashuri dallohet qartë në zemrat e nënave.

Prej respekteve të veçanta për njeriun është se Allahu i Lartësuar e ka vënë gjirin e nënës në atë mënyrë që fëmija e kap me nderim e me respekt kur nëna e mëkon atë.

Këto dhe mijëra shembuj të tjerë të respektit gjatë ditëve të foshnjërisë dhe të fëmijërisë, madje gjatë gjitha viteve të jetës, janë mëshirë. Fjala do të zgjatej shumë nëse do të merremi me shpjegimin e këtyre formave të mëshirës hyjnore.

Mirësia më e madhe dhe respekti më i plotësuar është mirësia e edukimit moral, një mirësi e veçantë për njeriun, mirësi që është plotësuar me rrugën e dërgimit të librave qiellorë e profetëve *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*. Gjithashtu, Allahu i Lartësuar ka dërguar çdo gjë që i siguron njeriut lumturinë e përjetshme e qetësi të përhershme dhe që e udhëzon njeriun të ecë në rrugën e lumturisë së përjetshme dhe të plotësimeve njerëzore.

Këto mirësi të ndryshme e të shumta, të dukshme e të padukshme, Allahu i Lartësuar ia ka dhënë njeriut pa bërë ai më përpara as ndonjë punë e as

ndonjë adhurim. Të gjitha këto mirësi janë fillestare[1] të gjitha janë mëshirë e hapur, të cilën Allahu i Lartësuar e zbriti para njëmijë e katërqind e ca vitesh, kur, Ai me mëshirën e Tij, zbriti Kur'anin Famëlartë, zbriti këtë libër madhor që përmban gradën më të lartë të dijeve hyjnore dhe që është garantuesi më i lartë për lumturitë fetare e për lumturitë e kësaj bote. Të gjitha këto mirësi janë shpjeguar në dorën e një të dërguari të veçantë, që është Vula e të dërguarve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).* Allahu dërgoi më të nderuarin e më të madhin e të gjitha krijesave, dërgoi atë që është më i afërmi i të gjitha krijesave te Allahu i Lartësuar. Kur'anin Famëlartë, Allahu i Lartësuar ia zbriti profetit të Tij me anë të Xhibrijlit, besnikut, engjëllit më të nderuar prej engjëjve të Allahut. Të gjitha këto mirësi të mëdha janë në respekt për njeriun.

Me çfarë shërbimi paraprak, me çfarë shpërblimi, me çfarë adhurimi, ose ç'forma bindjesh janë dhënë të gjitha këto mirësi e mëshira? Janë verbuar sy e zemër që i gjejnë e i shohin këto mirësi dhe pastaj dëshpërimi troket mbi këtë zemër, derisa e humb shpresën. O i mjeri njeri, Xhehenemi dhe ndëshkimet e ndryshme në botën e mbretërive, Ditën e Kiametit, janë figura të punëve e të moraleve të tua.

Ti o njeri, me dorën tënde, ia dhe vetes këtë poshtërim e mjerim, ti vazhdove të punosh për të shkuar me këmbët e tua drejt Xhehenemit, ti e përgatite Xhehenemin me punën tënde. Prandaj Xhehenemi s'është gjë tjetër veçse e brendshmja e punëve të tua që nuk priteshin prej teje. Gjithashtu, edhe errësirat e egërsia në botën e Berzahut, të varrit dhe të Ditës së Kiametit, s'janë gjë tjetër veçse hije të errësirës së moraleve të liga të njeriut dhe i besimeve të tij të gabuara. e Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

فَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ٧ وَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ ٨

[1] Tregon për lutjen e Imam Zejnelabidijnit *(Paqja qoftë mbi të!)* në "Es'sahijfetu-s'sexhàdij'jeh" "Çdo mirësi është fillim."

"Femen ja'mel mithkàle dherr'rretin khajren jerehù. Ue men jaëmelu mithkàle dherr'rretin sherr'rren jerehù" "Dhe kush punon një të mirë që peshon sa një grimcë, atë do të gjejë. Dhe kush punon një të keqe që peshon sa një grimcë, atë do të gjejë."[1]

Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* thotë: *"Ky është ajeti më i fortë, më i përsosur."* Nga fjalët e këtij ajeti të nderuar kuptohet qartë se do të shikohet në punën e mirë e në punën e keqe.

Në ajetin 30 të sures "Al- Imran", Allahu i Lartësuar njofton:

يَوْمَ تَجِدُ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ مُّحْضَرًا وَمَا عَمِلَتْ مِن سُوٓءٍ

"Jeume texhidu kul'lu nefsin mà amilet min khajrin muhdaren ue mà amilet min sùin..." "Ditën kur njeriu do të gjejë pranë punët e mira ose të këqija që ka bërë…"

Sikur të mos ishin punët e njeriut, nuk do të ishte forma e tyre e fshehtë, e keqe, nuk do të ishte Xhehenemi dhe e gjithë bota e panjohur do të ishte e ftohtë. Në të njëjtën kohë, ana e padukshme e Xhehenemit është një formë e butësisë dhe e mëshirës hyjnore, është mjekimi i vetëm për të pastruar besimtarët mëkatarë dhe për t'i çuar ata në lumturinë e përjetshme, sepse natyra e pastër e krijimit të njeriut është si floriri, i cili është mashtrues kur përzihet me bakër, prandaj patjetër ky flori duhet shkrirë me squfur e me zjarr që të pastrohet prej elementëve mashtrues: "Njerëzit janë minerale, si minerali i floririt e minerali i argjendit."

Domethënë, Xhehenemi është për atë person, natyra e pastër e krijimit të tij nuk iu mbulua krejtësisht dhe ai nuk arriti në shkallën e mohuesit e të hipokritit, prandaj edhe Xhehenemi është mëshirë në formën e zemërimit.

[1] Sure "Ez'-Zelzeleh", ajetet 7-8.

NDARJA E KATËRT

MËNYRA E BASHKIMIT TË FRIKËS ME SHPRESËN

Frika dhe shpresa mund të bashkohen në dy mënyra. Njëra mënyrë është e posaçme për të plotësuarit dhe për krerët e dijetarëve është bashkim mes shkëlqimeve të së mirës e butësisë, që përmbajnë emrat e bukurisë (xhemal), si dhe bashkim mes shkëlqimit imponues, që përmbajnë emrat e madhështisë (xhelal), ose bashkim mes mëshirës e shkëlqimit të madhështisë.

Kjo sepse, nga natyra origjinale, e pastër e krijimit, zemrat e eulijave janë të ndryshme e të diferencuara. Disa zemra janë më afër horizonteve të mëshirës dhe janë më shumë në përshtatje me të. Në këto zemra duket qartë shkëlqimi i emrave të bukurisë e të mëshirës. Janë këto emra që e bëjnë të dukshëm shkëlqimin e mëshirës e të bukurisë, siç ishte zemra e Isait *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për të!),* zemra e Profetit tonë *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).* Në këto zemra shpresa është sunduese mbi frikën dhe shkëlqimet e bukurisë janë sunduese mbi shkëlqimet e madhështisë.

Disa të tjerë janë më afër horizonteve të madhërisë e të madhështisë, siç ishte zemra e Jahjasë *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për të!).* Në këto zemra frika është sunduese mbi shpresën dhe shkëlqimet e madhërisë janë sunduese mbi shkëlqimet e bukurisë.

Ka edhe zemra ku të dy shkëlqimet janë së bashku. Sa më afër horizonteve të mosteprimit të jenë këto zemra, aq më të plotësuara janë, derisa arrijnë në cakun ku duken qartë shkëlqimet e bukurisë e të madhërisë,

derisa arrijnë në cakun e vijës së mesit të vërtetë të këtyre dy cilësive. Në këtë cak, as madhëria nuk është sunduese mbi bukurinë e as bukuria nuk është sunduese mbi madhërinë.

Vula e profetëve është njeriu me këtë zemër bashkuese unike. Ai është rrethi i plotësimit, në të cilin janë së bashku vilajeti absolut dhe profetësia absolute. Ai është vetëm Vula e profetësisë dhe pika e referimit të kthimit të kujdestarive. Frika e shpresa, që vijnë prej shkëlqimeve të emrave, nuk ndërpriten për shkak të ndërprerjes prej botës së natyrës dhe kthimit në dy shpirtëroret e nderuara. Këto shkëlqime dalin në dukje në çdo krijesë sipas ciklit, prandaj këto dy cilësi kanë një ndikim të veçantë.

Në komentin e librit "Usùlul-Kàfij" prej filozofit të madh islam, të urtit me besim rrezatues (*Allahu qoftë i kënaqur prej tij!),* në paragrafin e fundit të hadithit të nderuar është përmendur: "Frika në botën e ardhshme nuk është prej plotësimeve të qëndrueshme dhe ajo ndërpritet me ndërprerjen prej kësaj bote."[1]

Qëllimi me këtë frikë nuk është frika e ardhur prej shkëlqimeve të madhërisë, sepse këto shkëlqime, pas largimit të shqetësimeve me natyrën do të jenë më të larta e më të plotësuara, sepse shpirtrat, sa më shumë të jenë në mbështjelljen e natyrës, aq më të privuar do të jenë prej këtyre shkëlqimeve. Por kjo nuk është frikë e ardhur prej rrënjëve të ndëshkimit e prej llojit të dënimit, prandaj kjo frikë nuk është në kontradiktë me këtë botë. Shpresohet që shkëlqimi i butësisë e i mëshirës do të jetë sundues mbi shkëlqimin e madhërisë e të madhështisë, në raport me të gjithë njerëzit e me të gjithë shpirtrat e plotësuar.

Bazuar mbi këtë shpjegim, frika ndërpritet. Studimet e hollësishme kanë vërtetuar se, në raport me njerëzit e ditur dhe me ata që kanë arritur gradën e njohjes (arifijn), rezulton se çdo emër është bukuri (xhemal) dhe çdo emër bukuri, në të brendshmen e tij është madhëri (xhelal). Gjithashtu, çdo emër madhëri, në të brendshmen e tij është bukuri dhe ky është shkaku

[1] Esh'shiràzij, "Sherhu Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 418.

që, pas shkëlqimeve të madhërisë, arrihet qetësia e prehja dhe frika e arritur prej madhështisë shndërrohet në siguri e qetësi. Ndërkaq frika e ardhur prej shkëlqimeve fillestare të emrave të madhërisë ndërpritet, për rrjedhojë vjen qetësia, siguria e dashuria.

Vetëm Allahu e di më mirë.

Le të mësohet se ajo që u tha për ndërprerjen e frikës është ndryshe nga ndërprerja që ka përmendur ky filozof dhe që e kanë përmendur disa interpretues e dijetarë të nderuar të hadithit. Në të vërtetë, ajo që është përmendur prej tij nuk është ndërprerje, por kthim në të dukshmen prej të brendshmes, është kthim i figurës në kuptim.

Hollësitë për këtë çështje janë jashtë qëllimit të këtyre faqeve.

Ana tjetër e bashkimit mes frikës e shpresës, shpjegohet shumë qartë në hadithet e nderuara dhe në lutjet e transmetuara, domethënë se njeriu gjithmonë duhet të jetë mes dy shikimeve. Në radhë të parë, njeriu patjetër duhet të shikojë në mangësitë e në varfërinë e vetes. Me këtë shikim ai do të gjejë se ka mangësi në veprim. Gjithashtu, me këtë shikim, njeriu do të mësojë se prej vetes së tij s'ka as fuqi, as forcë, as plotësim e as madhështi, pasi plotësimi, bukuria, mirësia e hijeshia janë prej të Vërtetit të Lartësuar. Me këtë shikim ai do të arrijë në pohimin se të gjitha falënderimet e lavdërimet janë vetëm për Qenien e Shenjtë të të Vërtetit.

Me këtë shikim në pasqyrën e mundësive njeriu shikon për veten e tij mangësinë e plotësimit e pamundësinë e bukurisë së përjetshme dhe këtë ai e shikon ashtu siç duket drita e diellit në pasqyrën e kufizuar dhe ashtu si shikohen në atë pasqyrë edhe turbullirat e kufizuara të turbullta.

Gjithashtu, me këtë shikim arrihet frika në adhurimet e në bindjet. Pa mendo si do të jetë puna me gabimet e me mëkatet?! Te dijetarët e lartë, që kanë arritur gradën e njohjes (àrifijn), shumica e adhurimeve tona janë për të arritur dobi personale, domethënë janë përfitime për vetë personin që i bën, janë adhurime për të ngopur epshet. Prej kësaj kategorie adhurimesh nuk arrihet gjë tjetër përveç turbullirë dhe errësirë. Me këtë shikim arrihet

frikë dhe me një shikim të dytë njeriu patjetër shikon gjerësinë e mëshirës së të Vërtetit, gjerësinë e dritës së Tij gjithëpërfshirëse dhe të plotë, shikon mirësitë e mëdha që s'kanë fund dhe bujaritë e përhershme. Vetëm me këtë shikim arrihet shpresa.

Njeriu gjithnjë duhet të jetë mes dy shikimeve: shikimin e mundshëm për poshtërim dhe varfëri, si dhe shikimin që sjell mëshirë e mirësi. Me këtë shikim bashkohen shpresa e plotë me frikën e plotë.

Këtë të vërtetë e lexojmë në librin e haditheve të nderuara "El-Kàfij", në hadithin e ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ç'ishte në porosinë e Lukmanit?" Ai tha: "Në atë porosi kishte gjëra të mahnitshme, por më e mahnitshme në atë porosi ishte kur ai i tha djalit të vet: 'Kije frikë Allahun e Lartësuar, duke menduar se edhe sikur të paraqitesh me punët e mira të të gjithë njerëzve e xhinëve, Ai do të të ndëshkojë. Në të njëjtën kohë shpreso në Allahun, duke menduar se edhe sikur të paraqitesh me fajet e të gjithë njerëzve e xhinëve, Ai do të të mëshirojë."* Më pas Ebù Abdullau *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Babai im thoshte: 'S'ka asnjë besimtar në zemrën e të cilit të mos ketë dy drita: drita e frikës dhe drita e shpresës. Sikur të peshoheshin, njëra dritë nuk do të peshonte më shumë se tjetra."*[1]

Në lutjet (duatë) e Imam Zejnel-Abidijnit *(Paqja qoftë mbi të!)*, puna e frikës dhe e shpresës theksohet shumë herë. Kjo gjë theksohet edhe në lutjen e Ebu Hamzait, i cili ishte në shkallën më të lartë të dukshme të robërisë, aq e lartë ishte shkalla e robërisë së tij, sa në të gjithë njerëzit nuk mund të dalë prej tyre një lutje e ngjashme me lutjen e tij, nga ana e gjuhës së robërisë dhe e edukatës para Allahut, që të shprehë me kaq devocion gradën e robërisë ndaj Allahut të Lartësuar: *"Ty të lutem i trembur, me shpresë e i frikësuar, kur shikoj në mëkatet e mia, o Zoti im, kam shumë frikë. Por, kur shikoj në bujarinë Tënde, bëhem lakmitar. Nëse Ti më fal, Ti je mëshiruesi më i mirë, nëse më ndëshkon, Ti nuk je i padrejtë."*[2]

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 55, K. "Frika dhe shpresa".

[2] "Misbàhu-t'tehexh'xhidi e silahu-muteab'bidi" – "Llamba e atij që fal namaz natën dhe arma e adhuruesit", f. 526; Është fjala për Ebu Hamza Eth'themalij.

QËLLIMI I PESTË

SHPJEGIMI: DREJTËSIA DHE PADREJTËSIA NË KËTË SHPJEGIM KA DISA NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME DREJTËSINË E ME PADREJTËSINË

Drejtësia shpreh kufirin mes teprimit dhe lënies mangët, drejtësia është nëna e virtyteve morale dhe se drejtësia absolute është tërësia e virtyteve të brendshme e të dukshme të zemrës: shpirtërore, psikologjike e trupore.

Drejtësia absolute është vijë e drejtë në të gjitha nivelet, në mënyrë të barabartë në nivelet ku plotësohet shfaqja e emrave, e cilësive dhe e verifikimit me këto. Drejtësia është ndershmëria absolute e normaliteti absolut. Kjo drejtësi është e posaçme për njeriun e plotësuar, Zoti i të cilit është emri më i madh i Allahut. Kjo drejtësi është për njeriun, i cili, në lidhje me emrat e të Lartit, thotë ajetin më poshtë:

مَّا مِن دَآبَّةٍ إِلَّا هُوَ ءَاخِذُۢ بِنَاصِيَتِهَآۚ إِنَّ رَبِّي عَلَىٰ صِرَٰطٖ مُّسۡتَقِيمٖ ٥٦ *«...mà min dàb'betin il'là huve àkhidhun binàsijetihà, in'ne rab'bij alà siràtin mustekijmin»*

«…s'ka asnjë gjallesë që Ai nuk e ka nën sundim. Padyshim, Zoti im është i drejtë."[1]

Mbase[2] njeri i plotë është vetëm Vula e të Dërguarve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*, sepse ai është dërguar në rrugën e drejtë dhe në majën e maturisë.

Qëllimi më i lartë është: Allahu i Lartësuar është në rrugën e pavarësisë dhe i Edukuari *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është në rrugën e patronazhit.

Në këtë shpjegim padrejtësia shpreh faktin kur nënshtrimi me forcë është sundues mbi butësinë dhe butësia është sunduese mbi nënshtrimin me forcë. Me fjalë të tjera, është shfaqja e emrave të madhërisë (xhelal), ose shfaqja e emrave të bukurisë (xhemal).

Ka mundësi që lutja e eulijave në ajetin e nderuar: ٱهۡدِنَا ٱلصِّرَٰطَ ٱلۡمُسۡتَقِيمَ

"Ihdina-s'siràtal-mustekijme" "Na udhëzo në rrugën e drejtë."[3], të jetë në këtë pozitë.

Drejtësia në zemrat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes (maërifet) është në pozitën e shkëlqimeve të diturive hyjnore dhe shkëlqimeve të teuhidit (Allahu është Zoti Një e i Vetëm). Në këto zemra drejtësia është mosmbulimi i të Vërtetit të Lartësuar me krijesat dhe mosmbulimi i krijesave me të Vërtetin.

Me fjalë të tjera, drejtësia këtu është shikimi i Njëshit në shumicën dhe shikimi i shumicës te Njëshi. Ky shikim është i posaçëm për të plotësuarit e njerëzve të Allahut, kurse teprimi e lënia mangët në këtë pozitë është mbulimi i të Vërtetit me krijesat dhe mbulimi i krijesave me të

[1] Sure "Hud", ajeti 56.

[2] Fjala "mbase" ne tekstin arabisht ka ardhur me fjalën "رُبَّ" *"rub'be"* e cila në gjuhën arabe ka shumë kuptime. Prandaj lexo në burimet gjuhësore.

[3] Sure "El-Fatiha", ajeti 6.

Vërtetin. Ka mundësi që kërkesa e njerëzve të Allahut në ajetin e nderuar të mësipërm të jetë arritja e kësaj pozite.

Drejtësia është në nivelin e doktrinave dhe të vërtetave të besimit, në atë mënyrë që drejtësia në këto të vërteta shpreh kuptimin e të vërtetave të ekzistencës, ashtu si ato janë prej qëllimit më të largët prej plotësimit të emrave deri në kufirin e fundit të kthimit të së dukshmeve në dukuri. Kjo është e vërteta e plotë.

Drejtësia është në nivelin e moraleve shpirtërore, që janë natyra e tri fuqive: e fuqisë së dëshirave, të zemërimit dhe të fuqisë djallëzore. Pjesa e fundit e fuqive është qëllimi në hadithin e nderuar[1], ashtu siç kuptohet prej fjalëve të këtij hadithi, prandaj ai e ka numëruar këtë fuqi prej ushtrive të mendjes. Këtë fundit do ta trajtojmë në detaje në këtë pjesë.

Njeriun, që prej krijimit të tij natyror, pas fuqisë së mendjes, e shoqërojnë tri fuqi:

Fuqia e parë, prej këtyre fuqive, është fuqia e ushqimit të iluzioneve, që quhet fuqia djallëzore. Kjo fuqi gjendet te fëmija që në fillim. Me këtë fuqi njeriu gënjen, mashtron, thur kurthe e bëhet dinak.

Fuqia e dytë është fuqia e zemërimit, e cila quhet shpirti bishë. Është fuqia që i duhet njeriut për të sprapsur dëmtuesit dhe për të larguar gjërat që e pengojnë të arrijë gjërat që atij i sjellin dobi.

Fuqia e tretë është fuqia e dëshirave, e cila quhet shpirti kafshëror. Kjo fuqi është parësore dhe manifestohet me babëzinë për të marrë sa më shumë ushqime e pije të dobishme e të shijshme deri edhe plotësimin e dëshirave erotike.

Këto tri fuqi ndryshojnë sipas ndryshimit të viteve të jetës. Sa më shumë shtohet rritja natyrale te njeriu, aq më të plotësuara do të jenë këto fuqi dhe aq më shumë do të zhvillohen nga dita në ditë, duke i mundësuar

[1] Hadithi "xhunudul akl uel xhehl".

njeriut që, me çdo njërën prej këtyre fuqive, të arrijë cakun e plotësimit, kur asnjëra prej këtyre tri fuqive nuk është zotëruese mbi dy të tjerat. Mund të ndodhë që njëra fuqi është zotëruese mbi tjetrën. Por mund të ndodhë që edhe dy prej këtyre tri fuqive të jenë sunduese mbi fuqinë e tretë. Nga gjendja e këtyre fuqive dalin në dukje shtatë metamorfozat hyjnore:

Njëra prej këtyre formave është forma kafshërore, e cila shfaqet kur e brendshmja e vetes shfaqet në formën e kafshërores dhe është sunduese. Atëherë njeriu, në formën e panjohur të hyjnores së Botës Tjetër, përfaqësohet në formën e njërës prej kafshëve që janë në përshtatje me të brendshmen e tij, si lopë, ose si gomar, etj.

Kur veprimi i njeriut është prej bishe, domethënë, kur shpirti i bishës është zotërues te ai njeri, forma e tij në botën e panjohur hyjnore do jetë në formën e njërës prej bishave, si tigër, ujk, etj.

Kur te njeriu, fuqia djallëzore është zotëruese mbi të gjitha fuqitë e tjera dhe puna e tij e fundit është punë djallëzore, e brendshmja e tij do të jetë në formën e njërit prej djajve. Kjo është origjina e metamorfozave dhe e kopjeve hyjnore.

Nga bashkimi i dy prej tri fuqive arrihen tri forma: lopë tigër, lopë djall, tigër djall. Prej bashkimit të tri fuqive arrihen forma të dyzuara të ndryshme "lopë-djall-tigër". Në këtë kuptim është edhe hadithi i ardhur prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*: *"Disa njerëz do të tubohen në një formë dhe më e mira do të jetë në formën e lopëve e të derrave."*[1]

Gjithashtu mëso se kur në këto tri fuqi teprohet, ato prishin pozitën e njeriut dhe herë e nxjerrin atë jashtë të vërtetës njerëzore, herë e nxjerrin jashtë virtyteve njerëzore. Edhe kur ato janë mangët, përsëri janë prishëse për pozitën e njeriut dhe bëjnë që njeriu të jetë prej krijesave më të ulëta.

Kur teprimi e mangësia janë të përziera pa zgjedhjen e personit, në këtë gjendje mangësia është prej origjinës së krijimit, prandaj në shumicën e

rasteve ka mundësi që mangësitë natyrore të ndryshojnë me anë të ushtrimeve, të hulumtimeve. Në punët e zemrës e në punët e dukshme, sa më pak të jetë njëra cilësi prej cilësive të natyrës, në kuptimin e cilësive të pandryshueshme, nëse nuk themi që në të s'ka asgjë prej cilësive, atëherë ai njeri nuk e pranon ndryshimin.

Drejtësia, siç u tha më sipër, shpreh kufirin e mesatares mes teprimit e mes lënies mangët. Gjithashtu edhe tejkalimi i masës e lënia mangët janë prej cilësive të mëdha njerëzore. Madje prej filozofit të madh, Aristotelit, citohet: "Drejtësia nuk është pjesë e virtytit. Ajo është bashkimi i të gjitha virtyteve. E kundërta, padrejtësia nuk është pjesë prej poshtërsisë, por është e gjitha poshtërsi."

NDARJA E DYTË

DREJTËSIA E PADREJTËSIA NË LIBRAT E MORALIT

Dijetarët e mëdhenj kanë thënë se kategoritë e virtyteve janë katër: urtësia, trimëria, pastërtia morale dhe drejtësia.

Për shpirtin ka dy fuqi, fuqia e të kuptuarit dhe fuqia e lëvizjes. Çdonjëra prej këtyre dy fuqive kanë nga dy degë. Fuqia e të kuptuarit ndahet në mendjen teorike dhe në mendjen praktike.

Gjithashtu edhe fuqia e lëvizjes ndahet në fuqinë e sprapsjes që është degë e zemërimit dhe fuqia e tërheqjes, e cila është dëshira; baraspesha në çdonjërën prej këtyre katër fuqive dhe lënia e tyre jashtë ekzagjerimit dhe lënies mangët është virtyti.

Urtësi do të thotë nivelim i fuqisë teorike dhe edukim i saj. Drejtësi do të thotë nivelim i fuqisë praktike dhe edukim i saj. Trimëri do të thotë nivelim i fuqisë së zemërimit dhe edukim i saj. Pastërti morale do të thotë nivelim i fuqisë së dëshirave dhe disiplinim i dëshirave.

Për drejtësinë ka një përkufizim tjetër: drejtësi do të thotë nivelim i të gjitha fuqive të brendshme e të jashtme, shpirtërore e vetjake. Me këtë përkufizim filozofi i lartpërmendur ka thënë: "Drejtësi janë të gjitha virtytet, sepse ajo është pjesë prej virtyteve."

Po me këtë kriter, edhe padrejtësia ka dy përkufizime. Njëri kuptim qëndron përballë drejtësisë, në kuptimin e veçantë dhe kuptimi tjetër qëndron përballë drejtësisë, në kuptimin e përgjithshëm që u shpreh në thënien e filozofit: të gjitha poshtërsitë.

Që të dihet edhe më mirë, drejtësia është caku mes ekzagjerimit e lënies mangët. Sikur këtë përkufizim ta vinim në peshoren e përfytyrimit të ndjenjave, do të kishim një vijë të drejtë lidhëse mes pikës së robërisë ndaj Allahut dhe pozitës së afrimit te Allahu.

Rruga që përshkon njeriu i plotësuar, që niset prej pikës së mangësisë së robërisë deri në plotësimin e madhështisë së Allahut, është drejtësia, vija e drejtë dhe ecja me maturi. Në Kur'anin Famëlartë dhe në Sun'netin ka shenja të shumta në këtë kuptim. Gjithashtu, edhe rruga e drejtë që e kërkon njeriu gjatë faljes së namazit, është pikërisht ecja me maturi.

Në hadithet e nderuara tregohet se rruga e drejtë është më e hollë se fija e flokut dhe më e mprehtë se tehu i shpatës. Në kuptimin se caku i maturisë në drejtësinë është mesatarja e vërtetë. Prej kësaj del qartë përfytyrimi i drejtësisë në botën e daljes sheshit të të vërtetave.

Citohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* sipas përcjelljes së Xhabir bin Abdullah El-Ensarij: "Po rrinim te Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!),* ai bëri një vijë të drejtë para vetes dhe tha: "Kjo është rruga e Allahut!"

Pastaj bëri dy vija nga e djathta e tij dhe dy vija të tjera nga e majta e tij. Për këto dy të fundit tha: "Kjo është rruga e djallit!"

Pastaj vuri dorën e tij mbi vijën e mesit dhe lexoi ajetin e nderuar:

وَأَنَّ هَٰذَا صِرَٰطِي مُسْتَقِيمًا فَٱتَّبِعُوهُ

"Ue en'ne hadhà siràtij mustekijmen fet'tebiuhu…" "Kjo është rruga (feja) Ime e drejtë, prandaj ndiqeni atë…"[1]

Maturia e qëndrimi i drejtë nuk është i caktuar e nuk arrihet me lehtësi, me përjashtim për njeriun e plotësuar, njeriun që nuk devijon prej

[1] Sure "En'am", ajeti 153.

mesatares dhe nuk priret që prej fillimit të rrugëtimit të tij në drejtim të pikës së fundit të cakut ku do të shkojë. Kjo është vija Ahmedije dhe vija e plotë e Muhamedit, me të gjithë kuptimin e kësaj fjale. Kurse rrugëtarët e tjerë ecin duke ndjekur të tjerët dhe nuk kanë ecje origjinale.

Dihet se vija e drejtë që lidh dy pika nuk është me shumë se një, atëherë virtyti në përgjithësi dhe ecja në rrugën e drejtë me maturi, nuk shtojnë asgjë mbi njëshin. Kurse poshtërsitë janë të shumëllojshme, madje poshtërsitë s'kanë fund. Megjithëkëtë, kategoritë e përgjithshme të poshtërsive janë klasifikuar në tetë kategori.

Gjithashtu, çdo njëri prej katër virtyteve ka dy anë. Njëra anë është kufiri i ekzagjerimit dhe ana tjetër është kufiri i lënies mangët. Prej këtu, kategoritë e poshtërsive janë tetë. Çdo njëra prej këtyre punëve janë përmendur në librat e dijetarëve[1] e të moralistëve, me të gjitha llojet që vijnë prej këtyre kategorive.

Shpenzimi i jetës në anët e përkufizimit, të studimit e të marrjes në llogari për të gjitha kategoritë e poshtërsive nuk ndihmojnë as në rrugëtimin njerëzor e as në plotësimin e njeriut.

[1] Ibni Asàkir, "Tehdhijbul-akhlàk", f. 38-39; "Akhlàku-n'nàsirij", f. 112-122; "Xhàmiu-s'seàdàt", vëll. 1, f. 94 dhe vëll. 1, f. 99-108.

NDARJA E TRETË

MBI ARRITJEN E VIRTYTIT TË DREJTËSISË

Baraspesha e fuqive vetjake, me të cilat lidhet qëllimi më i lartë i plotësimit njerëzor dhe fundi i rrugës së plotësimit, në një kuptim të vetëm, është prej punëve më të rëndësishme. Por prej punëve që bën njeriu, ka edhe punë të atilla, që patjetër sjellin shkujdesjen ndaj baraspeshës e qëllimit për të arritur plotësimin njerëzor; në të njëjtën kohë, punët e ardhura prej shkujdesjes janë një humbje e madhe dhe sjellin vështirësi që s'mund të ndreqen.

Derisa njeriu është në botën e natyrës, ai ka mundësi që me frerët e mendjes e të ligjit, të vërë në vijë të drejtë fuqitë e tij të panënshtruara dhe të frenojë shpirtin e vet të alarmuar. Kjo punë në fillimet e rinisë është shumë e lehtë të arrihet, sepse drita e natyrës së pastër të krijimit në këtë moshë nuk është mposhtur akoma dhe shpirti nuk e ka humbur pastërtinë e tij. Te i riu akoma nuk janë rrënjosur as moralet e virtytshme e as cilësitë e përçmuara.

Shpirti i fëmijës është si faqja e fletores, pa asnjë shënim e pa asnjë figurë. Prandaj ajo faqe pranon me lehtësi çdo gdhendje që bëhet mbi të dhe, pasi e pranon atë gdhendje, ajo që u gdhend, nuk mund të shuhet me lehtësi. Kjo dukuri vërehet shpesh në faktin se informacionet e moralet e fituara në fillimet e fëmijërisë mbeten deri në fundin e moshës së thyer dhe rrallë ndodh që ato të harrohen.

Për të gjitha këto, rritja dhe edukimi i fëmijëve është prej detyrave më të rëndësishme që u janë besuar dy prindërve. Sikur të mos tregohej kujdes për rritjen e fëmijës nuk do të ishte çudi që ky fëmijë të tërhiqej drejt

poshtërsive të shumta dhe puna e tij të përfundonte deri në të më të keqen e përjetshme.

Të gjithë duhet të dinë se edukimi vetëm i një fëmije nuk llogaritet një edukim, po kështu edukimi i keq vetëm i një fëmije dhe shkujdesja ndaj të drejtës që ka fëmija, nuk llogaritet se është vetëm një shkujdesje, sepse ka ndodhur që, edhe përmirësimi i edukimit të vetëm i një fëmije, ka sjellë përmirësimin e një grupi, madje ka sjellë edhe përmirësimin e të gjithë popullit e përmirësimin e një mbretërie. Po kështu, edhe një njeri i prishur mund të sjellë prishjen mbretërisë e të mbarë popullit.

Është plotësisht e vërtetë që drita e një personi, siç ishte filozofi i madh islam Khavàxhah *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)* ndihmoi popullin dhe fenë. Ose si dijetari i madh El-Hilij, që ndriçoi mbretërinë e popullin. Këto drita mbeten të përjetshme.

Është dëshmuar se errësirat dhe ligësitë e një personi të vetëm, siç që Muavije bin Ebu Sufjani dhe krerët e padrejtësisë, u bënë farëra që mbollën vështirësi të mëdha për popuj e për mbretëri gjatë gjithë mijëvjeçarit.

Fakti që fëmijët gjithmonë, ose në shumicën e rasteve janë së bashku me të dy prindërit, shtron detyrën që të dy prindërit duhet të merren konkretisht me edukimin e fëmijës së tyre.

Sikur të supozojmë se të dy prindërit nuk cilësohen për morale të virtytshme e për punë të mira, ata të dy, patjetër, në sytë e fëmijëve, duhet të duken si njerëz të mirë, pasi vetëm kështu fëmijët do të jenë të edukuar e të kulturuar. Madje ka ndodhur që edhe kjo sjellje e sipërfaqshme nga ana e dy prindërve ka qenë fillimi i përmirësimit edhe për vetë prindërit, sepse dihet që alegoria është "ballkoni i së vërtetës" dhe natyrshmëria është rruga e vulosjes së karakterit.

Po kaq i vërtetë është edhe fakti se ligësia e dy prindërve ndikon të fëmijët më shpejt se çdo send tjetër. Jo rrallë ndodh që një fëmijë, i cili

praktikisht ka marrë edukatë të keqe prej dy prindërve të tij, i mbetet atij deri në fundin e jetës dhe ai nuk mund të bëjë kthesë që të përmirësohet, sado që të lodhen mësuesit e edukuesit.

Dy prindërit e mirë e me edukatë të bukur janë prej mbarësive e lumturive të caktuara dhe nuk janë me përzgjedhjen e njeriut. Prindërit e mirë e të edukuar janë një fatbardhësi për fëmijët. Por nga ana tjetër, edhe ligësia e dy prindërve dhe edukata e tyre e keqe është prej caktimeve për vështirësitë që e shoqërojnë njeriun pa zgjedhjen e tij.

E gjitha kjo është në përputhje me etapat e mëparshme të edukimit. Në ato etapa ishte e mundur ose të mbilleshin farat e lumturisë së njeriut, ose të hidheshin farat e vështirësive e të ligësive së tij. Prej kujdeseve të kësaj natyre, për shembull, janë zgjedhja e një gruaje të mirë, të moralshme e që sjell gëzim, ose zgjedhja e ushqimeve të përshtatshme e të shumëllojshme për gruan jo vetëm para kohës së shtatzënisë, por edhe gjatë saj. Ky kujdes për të voglin vazhdon gjatë kohës kur mëkohet me gjirin e nënës, pa folur për punë të tjera të ngjashme, përshkrimi i të cilave, në mënyrë të hollësishme, kërkon një kumtesë më vete.

Unë e shpresoj mbarësinë vetëm prej të Vërtetit të Lartësuar, që kjo kumtesë, me dashjen e Allahut, të dalë në formën e një studimi të pavarur.

Pas kësaj etape, përveç edukimit të fëmijës, nga ana e të dy prindërve, për fëmijën vjen kontakti i tij i jashtëm me mësuesit e me edukuesit. Që në fillim, në këtë etapë të jetës, siguruesi për edukimin, shëndetin ose për shthurjen e fëmijës është babai. Kjo siguri, nga ana e babait, për fëmijën fillon me zgjedhjen e një mësuesi fetar me besim të pastër e me morale të mira, pastaj vjen zgjedhja e shkollës dhe e një mësuesi të veçantë që do të vijë në shtëpi. Ky mësues patjetër duhet të jetë i përshtatshëm nga ana fetare e morale dhe të jetë njeri i edukuar. Të gjitha këto zgjedhje kanë ndikim të përgjithshëm e të plotë për edukimin fillestar të fëmijës. Ndodh shpesh që për fëmijën, që në këtë etapë të jetës, të marrë formë harta e lumturisë dhe e së keqes. Gjithashtu edhe ilaçi i dhënë prej

mësuesve mund të jetë ose shërues për sëmundjen, ose mund të jetë helm vrasës, prandaj përgjegjësia për edukimin e fëmijës bie vetëm mbi prindërit.

Pasi fëmija e kapërcen këtë etapë, gradualisht hyn në moshën e pubertetit e të pjekjes. Gjatë ditëve të rinisë, vjen etapa e pavarësisë së mendimit dhe e mënyrës së shikimit. Në këtë etapë njeriu ose bëhet garantues për lumturinë e tij, ose i përgatit vetes më të keqen. Gjatë ditëve të rinisë, njeriu e merr vetë në dorë detyrën për të mbjellë farat që i mundësojnë atij arritjen e lumturisë, duke shtuar se kjo punë në këtë moshë është më e thjeshtë e më e lehtë.

Gjithashtu edhe stabiliteti e aftësia për të vetëvendosur është më e madhe, sepse në këtë etapë të jetës në faqen e shpirtit të njeriut s'ka gdhendje dhe shpirti i tij është më afër thjeshtësisë. Prandaj edhe kur ndodh që në këtë moshë njeriu manifeston morale të liga, zakone e punë të këqija, ato akoma nuk janë ngulitur në shpirtin e tij, për rrjedhojë, ai ka mundësi ta pastrojë shpirtin e tij sipas masës së kontrollit e vendosmërisë.

Në këtë moshë njeriu i ka të gjitha mundësitë të shkulë rrënjët e moraleve të liga, ashtu siç shkulet një bimë e keqe që ka mbirë rishtas dhe që akoma nuk ka lëshuar rrënjë të forta në tokë, prandaj ajo bimë shkulet me lehtësi. Por kur shkujdesja vazhdon për një kohë dhe njeriu nuk ka hyrë në rrugën e përmirësimit e nuk ka hequr dorë prej lëndës shkatërruese, atëherë pesha e shthurjes ritet gradualisht, e keqja bëhet pemë e madhe, rrënjët e saj futen thellë në tokën e zemrës, madje futen aq thellë, saqë, shumë rrallë, njeriu e gjen rrugën ta zhdukë këtë pemë të keqe në moshë të madhe. Megjithëkëtë njeriu përsëri i ka të gjitha mundësitë të arrijë përmirësimin me ushtrime të shumta. Por mund të ndodhë që njeriut nuk i mjafton e gjithë jeta që ai të përmirësojë veten, sepse tashmë pema e së keqes është rritur e i ka ngulur mirë rrënjët e saj në tokë dhe është forcuar aq shumë, sa nuk është e munduar që të shkulet nga rrënjët, qoftë me mundime të shumta.

Shirazi në një poezi të tij thotë:

Një pemë e mbjellë tani

Shkulet me fuqinë e një njeriu.

Kur ajo lihet për një kohë,

forcohet dhe s'mund të shkulet.

Ndodh që i riu manifeston morale të këqija, si koprraci, ose smirë. Por në këtë moshë ligësitë nuk kanë lëshuar rrënjë në të, prandaj është i mundur përmirësimi i këtij të riu me rrugën e pakësimit të lodhjes dhe me zëvendësimin e moralit të keq me morale të mira.

Kur i riu lihet jashtë kujdesit, ai do ta kalojë jetën pa e vrarë mendjen. Prandaj që ky i ri të përmirësohet, patjetër ka nevojë për ushtrime të vështira, për përpjekje të mëdha e të gjata, sa edhe jeta deri në çastin e vdekjes nuk i japin këtij njeriu asnjë rast të përmirësohet e të pastrohet, për rrjedhojë ai kalon në botën e përtejvarrit me ato morale të errëta e me ato turbullira ideore, të cilat do të jenë fillesa për shtrydhjen e tij në varr dhe ai të jetë në errësirë jo vetëm në botën e përtejvarrit, por edhe Ditën e Gjykimit.

Patjetër që të rinjtë duhet të bëjnë pastrimin e vetvetes, derisa janë në moshën e rinisë, sepse në këtë moshë pastërtia e brendshme dhe natyra e pastër e krijimit vazhdojnë të jenë të ruajtura në gjendjen e tyre origjinale, prandaj të rinjtë i shkulin me lehtësi moralet e këqija nga rrënjët dhe i largojnë cilësitë e errëta prej zemrave të tyre.

Është fakt se lumturia e njeriut është në rrezik të madh edhe nga ekzistenca e vetëm një morali të keq. Dihet se gjatë ditëve të rinisë, vullneti është i fortë dhe vendosmëria e të riut është e fuqishme, prandaj edhe përmirësimi është më i lehtë e më i thjeshtë të arrihet. Kurse në etapën e pleqërisë, vullneti dobësohet, gjithashtu edhe vendosmëria ka shteruar, për rrjedhojë mposhtja e moraleve të liga është edhe më e vështirë të arrihet.

Patjetër edhe ata që kanë hyrë në moshën e mesme nuk duhet të jenë të shkujdesur për të përmirësuar e për të pastruar veten, nuk duhet të shprehin keqardhje që kanë morale jo të mira, sepse derisa është në këtë botë, që është shtëpia e ndryshimit dhe e tjetërsimit, shtëpia e lëndës dhe e përgatitjes, njeriu ka mundësi ta përmirësoje veten, qoftë edhe me shumë lodhje. Ka mundësi të shërojë sëmundjet kronike të shpirtit, edhe kur ato sëmundje kanë arritur një shkallë të lartë përforcimi. Megjithatë është e mundur që lënda e atyre sëmundjeve të shkulet dhe, derisa njeriu është në këtë botë, s'ka asnjë sëmundje të shpirtit që nuk mund të shërohet e të përmirësohet, madje edhe nëse ato sëmundje janë rrënjosur e janë përforcuar në shpirt dhe janë bërë sunduese mbi atë shpirt.

Qëllimi qëndron në ndryshimin sa të rënda e sa të shumta janë ushtrimet shpirtërore. Sa më të rënda të jenë ato, aq më i fortë do të jetë njeriu dhe aq më shumë ai do të ndiejë nevojën për vështirësi fizike e për ushtrime shpirtërore. Kjo për faktin se njeriu në këtë gjendje të gjitha punët i bën me zgjedhjen e vet, siç janë adhurimet, etj.

Allahu mos e lejoftë! Sikur njeriu të lërë këtë jetë dhe të kalojë në Botën Tjetër me veset e liga e me moralet e këqija, madje edhe sikur drita e besimit të krijimit të pastër të jetë e ruajtur në brendësi të tij, përmirësimi i vetes e pastrimi i shpirtit, në këtë gjendje, janë punë jashtë zgjedhjes së tij. Por edhe para se shpirti të dalë prej trupit, në çastin kur njeriu mbetet pa aftësinë për të zgjedhur, përsëri njeriut i lihet edhe një rrugë tjetër për t'u pastruar, siç janë vështirësitë e trysnitë që njeriu kalon gjatë agonisë e në çastin e marrjes së shpirtit, duke shtuar se njeriu, në çastet e agonisë, sheh edhe ashpërsinë e engjëjve të ngarkuar më detyrën e marrjes së shpirtrave. Dihet se ata janë urdhëruar prej të Vërtetit të Lartësuar të jenë të ashpër e të egër.

Edhe errësira e varrit e shtrëngimi i varrit, si dhe ndëshkimet e tjera të varrit, janë prej botës së të panjohurave. Kjo tregohet në një transmetim të ardhur prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të*

e mbi familjen e tij!): "Varri është ose një lulishte prej lulishteve të Xhen'netit, ose një gropë prej gropave të zjarrit."[1]

Në një në një transmetim të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Në varr mbi mohuesin sundojnë nëntëdhjetë e nëntë mostra. Sikur edhe një mostër e vetme prej atyre mostrave, të lëshonte një frymë mbi tokë, në të nuk do të mbinte asnjë bimë."*[2]

Ata që kanë arritur gradën e njohjes (ma'rifetit) thonë: "Ndëshkuesit që e sundojnë njeriun në varr, janë dukuritë e tij të liga. Janë moralet e liga që ai i ka pasur në këtë botë, ato që ushtrojnë trysni mbi njeriun dhe e mundojnë atë. Por shpirti, në mbështjelljen e natyrës, është i shkujdesur prej gjërave hyjnore, për shkak të mbulimit që natyra ka hedhur mbi atë shpirt, prandaj mbi atë shpirt gjithashtu nuk shfaqet plotësisht fuqia e hyjnores.

Nga kjo anë njeriu është i shkujdesur prej llojeve të ndëshkuesve që gjenden në brendësi të shpirtit të tij, madje i shkujdesuri as që i ndien ato lloje ndëshkuesish. Kur cilësia e pastër e krijimit të njeriut shndërrohet në cilësitë e botës së varrit e të pasvarrit dhe njeriu mbështillet me qilimin e së dukshmes, atëherë del sheshit faqja e brendshme e tij, e fshehta e shpirtit bëhet dëshmuese, cilësitë e brendshme bëhen të ndjeshme, të prekshme e të dukshme në formën që është në përshtatje me atë shpirt.

Në këtë gjendje njeriu e sheh veten që është vënë në sprovë, e sheh veten të rrethuar me lloje të shumta vështirësish e ndëshkuesish, e sheh veten të rrethuar nga errësira, turbullira dhe egërsitë. Nëse turbullirat shpirtërore dhe të panjohurat që ishin anës natyrës së pastër të krijimit zhduken me këto trysni e vështirësi të mëdha, me atë pastrim e me atë ndëshkim në varr që ai pësoi në jetën e pasvarrit, në Ditën e Kiametit ai njeri arrin drejt lumturisë, arrin në pozitën e respektuar që i është premtuar atij nën kujdeset e ndërmjetësuesve. Por *(Allahu mos e lejoftë!)* nëse rrënjët e moraleve të liga, errësirat dhe turbullirat shpirtërore mbeten, njeriu patjetër

[1] "Bihàrul-Envàr", vëll. 6, f. 205; Libri "El Adlu uel-Miàdu", K. 7.

[2] Bihàrul-Envàr", vëll. 6, f. 218, Libri "El Adlu uel Miàdu", K. 8, Biseda 13.

do të pësojë tmerret e ndëshkimet e Ditës së Kiametit dhe do të kalojë nëpër pesëdhjetë vendqëndrimet.[1] Ai do të gjendet nën trysninë e nën shtypjen e rëndë të ndëshkimit, derisa puna e tij përfundon në ndëshkimin e Xhehenemit të ashpër.

Në këto vendqëndrime të egra nuk është sunduese drita e cilësisë së pastër të krijimit, prandaj puna përfundon në Xhehenem dhe, ashtu siç thuhet, "ilaçi i fundit" është djegia në zjarr.[1]

Njeriu mbyllet në brendësi të shtresave të Xhehenemit në llojet e ndryshme të ndëshkimit. Në këtë gjendje ai do të vazhdojë derisa cilësia e pastër e krijimit të tij të dalë prej mashtrimit dhe të dalë sheshit floriri i pastër i kësaj cilësie krijimi, atëherë ai të bëhet i përshtatshëm për shtëpinë e respektit të të Vërtetit të Lartësuar.

Kjo njoftohet në Kur'anin Famëlartë:

وَنَزَعْنَا مَا فِي صُدُورِهِم مِّنْ غِلٍّ إِخْوَٰنًا عَلَىٰ سُرُرٍ مُّتَقَٰبِلِينَ ٤٧

"Ue nezaënà mà fij sudùrhim min gil'lin ihkvànen alà sururin mutekàbilijne" "Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çdo lloj urrejtje dhe ata, të mbështetur, qëndrojnë si vëllezër përballë njëri-tjetrit."[2]

Kjo lloj zhveshje është e ndryshme te personat e ndryshëm, gjithnjë sipas shkallës së ndryshimit që ata kanë në plotësimin e në mangësinë e cilësive të tyre.

[1] Bihàrul-Envàr", vëll. 5, f. 126, Libri "El Adlu uel Miàdu", K. 6, Biseda 3-5.

[2] Sure "Hixher" ajeti 47

QËLLIMIMI I GJASHTË

KËNAQËSIA DHE ZEMËRIMI NË KËTË TEMË KA DISA NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI PREJ KËNAQËSISË DHE ZEMËRIMIT

Mëso se mbetja i kënaqur shpreh gëzimin e robit ndaj Allahut të Lartësuar, ndaj madhështisë së punëve të Tij dhe ndaj madhështisë së vullnetit e caktimeve të Tij. Grada më e lartë prej kësaj kënaqësie është prej shkallëve më të larta të plotësimit njerëzor, është pozita më e madhe që arrijnë personat që kanë tërheqje e dashuri për Allahun e Lartësuar.

Dijetari i madh, ndjekësi i kësaj rruge El-Ensàrij *(Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!)* ka dhënë një përkufizim për këtë përmbajtje: "Mbetja e/i kënaqur (ridà) është emër që shpreh qëndrimin e robit të sinqertë në qëllimet hyjnore, në atë mënyrë që ai nuk ndjek vullnetin e tij, nuk prek, nuk dëshiron të ecë përpara ose të mbetet prapa në ndonjërën prej punëve. Ai nuk kërkon më shumë, nuk kërkon as ndërrimin e gjendjes. Me fjalë të tjera, për robin s'ka vullnet nga ana e tij dhe vullneti e dëshirat e tij asgjësohen në vullnetin e të Vërtetit. Nga kjo anë, ai është në fillimet e shkallëve të para të

veçanta, që janë shkallët më të vështira për të zakonshmit." (Fjala e tij përfundon e shpjeguar me pak ndryshim.)[1]

Në këndvështrimin e autorit të këtij libri, ky përkufizim nuk është i saktë, sepse, sikur qëllimi të varej prej qëndrimit të vullnetit të robit, i bazuar mbi qëllimet e të Vërtetit, asgjësimi i vullnetit është prej fillimit të pozitave të asgjësimit dhe s'ka lidhje me pozitën e mbetjes i kënaqur. Nëse qëllimi është mosekzistenca e vullnetit të robit kundrejt vullnetit të të Vërtetit, atëherë kjo është pozita e dorëzimit pa pozitën e mbetjes i kënaqur

Në tërësi, pozita e mbetjes i kënaqur shpreh gëzimin që ndien robi prej të Vërtetit, prej qëllimeve, prej vendimit e prej caktimit të Tij. Ky gëzim është i shoqëruar edhe me gëzimin që robi ndien prej njerëzve. Kjo gjendje gëzimi shënon arritjen e gëzimit të përgjithshëm. Kjo pozitë mund të jetë edhe qëllimi i shehut kryetar në shenjat që ai jep kur shpjegon pozitat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes (àrifijn). Gjithashtu, edhe studiuesi i dëgjuar, Khavàxheh Nesijrul-d'dijn Et'tùsij *(Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!),* ka përputhur shprehjen e shehut në lidhje me nocionin e mbetjes i kënaqur: *"Ai që ka arritur gradën e njohjes (àrif) është i gëzuar, i afrueshëm, i buzëqeshur. Nga kryeultësia e tij vlerëson lart të voglin, ashtu siç vlerëson lart edhe të madhin. Gëzohet prej përtacit njëlloj siç gëzohet prej të zgjuarit. Si të mos jetë i gëzuar kur ai është i lumturuar me të Vërtetin dhe me çdo send? Në atë send ai sheh të Vërtetin. Si të mos jetë ai në baraspeshë, kur të gjithë te ai janë të barabartë?! Por ata që duhet të kenë pjesë në mëshirë, merren me punë të gabuara."*[2]

Studiuesi Et'tùsij, gjithashtu, thotë: *"Këto dy cilësi, dua të them gëzimi i përgjithshëm dhe barazimi i të gjithë njerëzve, janë dy ndikues për një moral të vetëm, që quhet mbetja i kënaqur (ridà)."*[3]

[1] Në origjinal, e njëjta fjalë e Imamit.
[2] Studiuesi Et'Tùsij, "Sherhul-ishàràti uet'tenbijhàti", vëll. 3, f.391.
[3] I njëjti burim dhe e njëjta faqe.

Nëse fjala e Imamit ka kuptim tjetër, ai kuptim thekson pozitën sipër pozitës së mbetjes i kënaqur, që është pozita e teuhidit vetjak ose teuhidit praktik. Prandaj shqetësimi për të dhënë përgjigje e për të sjellë argumente në këto pozita, nuk ka lidhje me këtë kumtesë, sepse marrja me këtë studim e pengon rrugëtarin që të ai të vazhdojë rrugën.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: KËNAQËSIA ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE E SHOQËRON NATYRËN E PASTËR TË KRIJIMIT, KURSE ZEMËRIMI ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS DHE E SHOQËRON NATYREN E MBULUAR TË KRIJIMIT

Më sipër u mësua se njeriu ka dashuri për të Vërtetin e Lartësuar, nga vetë natyra e pastër e krijimit të tij. Njeriu me natyrë të pastër krijimi shikon se vetëm Ai është plotësimi absolut dhe, nëse njeriu për këtë s'ka dijeni, kjo i vjen atij për shkak se drita e natyrës së krijimit të tij është e mbuluar. Kurse njeriu i pambuluar, e sheh të Vërtetin e Lartësuar në pozitën e plotësimit absolut dhe për atë është bërë prezent prania e plotë e pozitës së të Plotësuarit të Shenjtëruar, prandaj çdo gjë që del prej Tij, ai e sheh të plotësuar. Ai sheh bukurinë e të Vërtetit dhe plotësimin e Tij të shfaqet në të gjitha qeniet,

Gjithashtu e sheh Qenien e Shenjtë të plotë e absolute. Ai sheh të plotësuara cilësitë e bukurisë e cilësitë e madhështisë. Po kështu, ai sheh të bukura e të plotësuara punët e të Vërtetit. Ai sheh se "prej të bukurit absolut nuk mund të vijë gjë tjetër përveç absolutes së bukur". Për këtë ai e madhëron Atë me syrin e zhveshur dhe me praninë e Tij.

Dashuria e kënaqësia (ashk e ridà) që njeriu ndien në drejtim të Qenies së Shenjtëruar, i gjen në gjitha sistemet e ekzistencës, sepse ato detyrimisht janë shoqëruese të plotësimit absolut, prandaj ai kënaqet e gëzohet prej të gjitha dritave me masën e dritave të ekzistencës së tij e të plotësimit të tij personal.

Shoqërues i kësaj dashurie vetjake dhe i kësaj kënaqësie të ardhur prej natyrës së pastër të krijimit, është zemërimi e moskënaqësia nga ana e tjetërsimit, e cila është mangësi, errësirë dhe mosekzistencë.

Një rob me natyrë të pastër krijimi shikon me syrin e kënaqësisë e të gëzimit. Ai sheh që gjithçka është prej të Vërtetit të Lartësuar. Ai sheh se gjithçka del vetëm prej Qenies së Shenjtëruar. Ai është i kënaqur prej të Vërtetit të Lartësuar e prej punëve të Tij. Është i zemëruar me gjithçka tjetër, përveç Allahut e me gjithçka që nuk kanë lidhje me Të.

Personi me natyrën e mbuluar të krijimit, e dallon plotësimin në punë të tjera, prandaj edhe kënaqësia e gëzimi i tij janë të lidhura me ato punë sipas masës së mbulimit që ai ka prej të Vërtetit të Lartësuar.

Një person i këtillë është i pakënaqur e i zemëruar prej Allahut e prej punëve të Tij, në atë masë sa është edhe mbulimi i botës që ka rënë mbi të dhe mbi shpresat e shuara të shpirtit të tij. Prandaj, kur mbi shpresat e mbi punët e tij ndodh ndonjë pengues, sipas natyrës së krijimit që ai ka, zemërohet me atë që e solli atë ndalim mbi shpresat e mbi punët e tij dhe me zemërimi e tij arrin deri aty, sa ai mendon keq për të Vërtetin, edhe pse nuk e shpreh me fjalë zemërimin që ndien.

Shehu i shtrenjtë, njohësi i Allahut, Muhamed Ali Shàh Àbàdij *(Allahu e vazhdoftë hijen e tij mbi kokat e ndjekësve të tij!)* ka thënë: *"Shkakun e dashurisë së madhe që ka njeriu për këtë botë, e sheh vetëm atëherë kur ai del prej kësaj bote. Vetëm atëherë ai e shikon me syrin e pambuluar se i Vërteti i Lartësuar, engjëjt e Tij dhe argumentet e Tij ia rrëmbejnë atij të dashurin e vet dhe i ndajnë të dy. Atëherë, ai, me natyrën e krijimit që ka, zemërohet kundër atyre dhe del prej kësaj bote me armiqësinë ndaj të Vërtetit të Lartësuar e ndaj engjëjve të Tij të shenjtë."*

Diçka e përafërt me këtë përmbajtje ka ardhur edhe në hadithin që gjendet në librin "El-Kàfij", që ne e kemi shpjeguar në hadithim 28 të librit "Dyzet Hadithe". Në përgjithësi, mllefi e zemërimi kundër të Vërtetit të Lartësuar është prej ushtrive të Iblijsit e të injorancës dhe është shoqërues i natyrës së mbuluar të krijimit. Allahu të na ruajë prej tij!

NDARJA E TRETË

SHPJEGIMI I SHKALLËVE TË KËNAQËSISË

Le të dihet mirë se kënaqësia e cilësi të tjera shpirtërore të plotësuara kanë gradë të shumta e shkallë të ndryshme. Disa prej të cilave i përmendim në vijim.

Shkalla e parë: Kënaqësia që Allahu është Zoti, do të thotë kënaqësia me pozitën që Zoti është i Vërteti i Lartësuar. Kjo kënaqësi realizohet kur robi, në rrugën e kërkimit të kënaqësisë, e ve veten e tij në sundimin e të Vërtetit të Lartësuar. Në këtë rrugë ai e nxjerr veten prej pushtetit të djallit dhe është i kënaqur e i gëzuar që Zoti është Allahu i Lartësuar.

Dihet se djalli vepron në mënyrë të barabartë mbi robin, mbi zemrën, mbi shpirtin dhe mbi trupin e tij. Në këtë gjendje robi është jashtë pushtetit të hyjnores, është jashtë edukimit hyjnor dhe s'ka mundësi të thotë: "Jam i kënaqur që Allahu është Zoti!"

Shkalla e parë e kënaqësisë është që robi të jetë i kënaqur me edukimin hyjnor, pas hyrjes në hyjnoren e Allahut dhe, shenja dalluese e kënaqësisë është se ai nuk ndien vështirësi nga detyrimet që është ngarkuar të plotësojë. Ai jo vetëm që është i kënaqur e i gëzuar të plotësojë urdhrat hyjnore, por i mirëpret ato me shpirt e me zemër.

Edhe ndalesat ligjore te ai janë të urryera. Ai është i kënaqur me pozitën e tij të robërisë dhe është i kënaqur që ka për kujdestar të Vërtetin e Lartësuar. Sikur askush në këtë botë të mos hynte në edukimin e të Vërtetit të Lartësuar dhe sikur askush të mos t'ia dorëzojë veten pozitës së hyjnores, pushteti hyjnor nuk do të zinte vend në zemrën e në të gjitha gjymtyrët e mbretërisë së këtij robi, për rrjedhojë, ai nuk e pastron dot veten e tij prej

veprimeve djallëzore dhe, nuk dihet nëse ai do të kishte fuqi në botën e varrit e në botën e përtejvarrit (berzah) të thoshte: "Allahu i Lartësuar është Zoti im!"

Mbase veçimi i këtij emri ndër emrat e tjerë është një shprehje e hollë, që tregon se e pritura është hyrja nën edukimin e Zotit të botëve, është plotësimi. Gjithashtu, edhe thënia: *"Jam i kënaqur me Islamin për fe, me Muhamedin profet e të dërguar, me Kur'anin për libër, me Aliun, Prijës të besimtarëve dhe me fëmijët e tij, imamë, të ruajtur prej mëkateve."*[1] do të jetë veçse pretendim nëse nuk është e shoqëruar me vepra.

Allahu mos e lejoftë! Sikur robi të mos jetë i mbrojtur, edhe një pretendim i thjeshtë do të konsiderohej hipokrizi e gënjeshtër. Ai që nuk është nën pushtetin e rregullave fetare islame, nuk është i kënaqur me ato rregulla dhe nuk është i gëzuar me dispozitat e Islamit, aq më shumë sikur në ato dispozita të ketë dëm për vetë atë ose për familjen e tij, në asnjë rast ai s'ka të drejtë të pretendojë këtë fjalë.

Gjithnjë, *(Allahu mos e lejoftë!)* edhe ai që gjen në brendësi të zemrës së tij kundërshtim për ndonjërën prej dispozitave Islame, ose brengoset e hidhërohet prej asaj dispozite, ose njëra prej dispozitave nuk do të jetë sipas asaj që ai dëshiron, ky person nuk është i kënaqur me fenë islame, prandaj ai s'ka asnjë të drejtë të ngrejë këtë pretendim të rremë. Kështu maten e vlerësohen edhe etapat e tjera.

Kënaqësia me profetësinë e me imamatin nuk është thjesht që ne të jemi të kënaqur me imamët, udhëzues të umetit në rrugën e lumturisë, në një kohë kur ne nuk punojmë as për të arritur lumturinë e as për plotësimin njerëzor, për të cilin jemi udhëzuar. Prandaj e brendshmja e pretendimit të një kënaqësie të këtillë, është tallje e mirëfilltë.

[1] Marrë prej librit "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f.398, Libri "Ed'duàu", K. 52, Hadithi 6.

I shtrenjtë, pretendimi i pozitave e i gradave është një punë e lehtë dhe mbase kërkesa bëhet e paqartë për vetë njeriun, aq sa nuk merret vesh nëse ai është kalorësi që ka dalë në shesh me këtë pretendim, pasi cilësimi me të vërtetat dhe arritja e pozitave nuk realizohen me pretendime, sidomos pozita e kënaqësisë, që është prej pozitave më të rënda e më të vështira.

Shkalla e dytë, është mbetja i kënaqur me vendimin e me caktimin e të Vërtetit të Lartësuar, domethënë, robi ndien kënaqësi me të gjitha ngjarjet që i ndodhin, të ëmbla e të hidhura dhe ai është i gëzuar me ato që i ka dhënë Allahu i Lartësuar, qofshin ato dhënie pësime, sëmundje, humbje e të dashurve, ose e kundërta e këtyre që u thanë. Te ai janë të barabarta vështirësitë, sëmundjet e të ngjashme me këto. Ai është i kënaqur edhe me ato që qëndrojnë kundrejt këtyre që u përmendën. Të gjitha këto ai i konsideron në mënyrë të barabartë mirësi të dhëna prej të Vërtetit të Lartësuar. Ai është i kënaqur e i gëzuar me të gjitha sa i ndodhin.

Kjo gjë transmetohet edhe prej detit të diturive, Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!) që në atë kohë ishte akoma në moshën e fëmijërisë: "Atë e pyeti Xhàbir bin Abdullah El-Ensàrij: "Si të duket gjendja jote?"

Ai iu përgjigj: "Varfëria për mua është më e dashur se të jem i pasur. Për mua sëmundja është me dashur se shëndeti, për mua vdekja është më e dashur se jeta. Përsa na përket neve të Ehli Bejtit, gjithçka që na vjen prej Allahut, si: varfëri, pasuri, sëmundje, shëndet, vdekje e lindje, të gjitha këto për ne janë ato që ne i duam më shumë."[1]

Kjo pozitë nuk arrihet ndryshe veçse duke njohur pozitën e butësisë së të Vërtetit të Lartësuar ndaj robit, si dhe duke njohur pozitën e mëshirës së Tij për robin dhe me besimin e plotë se të gjitha sa i ka dhënë i Vërteti i Lartësuar në këtë botë, janë për edukimin e njerëzve, për të arritur plotësimin e cilësive shpirtërore të njerëzve dhe për ngritjen e cilësisë së pastër, të fermentuar në krijimin e tyre në cilësi efektive.

[1] "Xhàmiu-s'Seàdàt", vëll. 3, f. 285.

Ndodh që njeriu, me anë të varfërisë e të mjerimit, arrin në pozitën e plotësimit të vetvetes. Gjithashtu, ndodh që njeriu, nëpërmjet sëmundjes e pafuqisë, arrin lumturitë e përjetshme. Të gjitha këto arrihen kur robi është në fillesat e rrugëtimit të tij. Nëse robi arrin pozitën e dashurisë e të tërheqjes dhe, pasi ka pirë prej kupës së dashurisë qoftë edhe një gllënjkë, atëherë çdo gjë që atij i vjen prej të Dashurit të tij, është vetë i Dashuri i tij.

Helmi nga ana jote e përparme është ilaç

Dhe tejkalimi i masës prej gojës tënde është mirësi.1

Kjo pozitë, domethënë pozita e dashurisë dhe e tërheqjes, patjetër duhet të llogaritet prej fillesave të shkallës së tretë të kënaqësisë, është shkalla në të cilën robi e shpreh kënaqësinë me kënaqësinë e Allahut.[2]

Natyrisht, kënaqësia e robit nuk buron prej vetes së tij, por është e varur prej kënaqësisë së të Vërtetit të Lartësuar. Gjithashtu, edhe vullneti i robit është varur prej vullnetit të Allahut. Kjo ka ardhur në hadithin: *"Kënaqësia e Allahut është kënaqësia e neve të Ehli Bejtit."*[3]

Nëse ka mundësi që kënaqësia të jetë shenjë për një pozitë më të lartë, ajo pozitë shpreh afrim te punët me të cilat robi është ngarkuar të kryejë (farzet) dhe kjo është vazhdimësi pas asgjësimit.

[1] Përmbajtja e një poezie të Saadi Shirazit, në librin e tij në gjuhën perse "Kul'lij'jàtihi".

[2] Mulla Abdu-rr'rrez'zàk Elkashànij, "Sherhu menàzilu-s'sàirijne", f. 209.

[3] "Biharul-Envàr", vëll. 44, f. 367; "Tàrijhkhu Husejn(a.s.)", K. 37, Hadithi 2.

NDARJA E KATËRT

PARIMET E POZITËS SË KËNAQËSISË

Pozitat e kënaqësisë janë prej ndikimeve të diturive hyjnore e prej ndikimeve të punëve të Allahut. Kështu janë të gjitha pozitat e veçanta, prandaj është rasti të theksojmë disa parime të kënaqësisë. Fillimi i kënaqësisë prej të Vërtetit të Lartësuar është dituria që ka robi se punët e të Lartësuarit janë të bukura. Më poshtë do të shpjegojmë pozitën e bukurisë së të Vërtetit dhe bukurinë e cilësive e të punëve të Tij. Gjithashtu do të përmendim edhe shkallët e njohjes që ka robi, në lidhje me të Vërtetin.

Shkalla e parë e kësaj njohjeje që arrin robi është dituria se i Vërteti i Lartësuar është i bukur, se të bukura janë edhe cilësitë e punët e Tij, duke marrë në konsideratë argumentin shkencor dhe përfundimtar. Kjo shkallë e diturisë që ka robi është çelësi për hapjen e diturive sipas llojit të zakonshëm. Sikur dikush të arrijë në pozitat e larta të njohjes jo me këtë rrugë, kjo do të ishte prej arritjeve të rralla. Prandaj nuk mund të jetë kriter për cilësinë. Por qëndrimi në këtë shkallë të diturisë numërohet prej mbulesave të mëdha e të trasha, aq sa për këtë çështje thuhet: *"Dituria është mbulesa më e madhe."*

Ditura, e mbështetur me argument, është pjesë e mendjes, por prej kësaj diturie nuk dalin moralet shpirtërore, pasi ato janë të varura prej diturive. Mbase për këtë shkak gjejmë se shumë prej krerëve të dijetarëve të kësaj shkalle, domethënë shkollës së studimit shkencor, nuk kanë mundur të arrijnë në dy pozitat, në pozitën e kënaqësisë e në pozitën e dorëzimit, ose në pozita të tjera shpirtërore, në pozitat e moraleve shpirtërore e në pozitat e diturive hyjnore, por kanë mbetur përjetësisht nën mbulesën e dijeve që kanë arritur.

Shkalla e dytë, arritja në zemër e shkallës së bukurisë së të Vërtetit të Lartësuar dhe bukurisë së cilësive dhe punëve të Tij, në atë mënyrë që robi beson se i Vërteti i Lartësuar është i bukur. Ky besim arrihet me përqendrimin e mendimit në mirësitë e mëdha hyjnore dhe me nënshtrimin e zemrës para ndikimeve të bukurisë së Tij, derisa zemra, në mënyrë graduale, të pranojë cilësinë e bukurisë së të Vërtetit të Lartësuar.

Kjo është pozita e besimit (imanit). Kur robi arrin në këtë pozitë dhe me zemrën e tij ai beson në këtë të vërtetë, në atë zemër rrezaton pozita ndriçuese e kënaqësisë, mendimi i mirë dhe gëzimi. Ky është fillimi i pozitës së kënaqësisë dhe para këtij fillimi, në atë zemër, s'ka asnjë gjurmë të kësaj shkalle.

Kjo është arsyeja që në transmetimet e ndryshme kënaqësia është shpjeguar si njëra prej kolonave të besimit. Këtë e lexojmë në librin e nderuar "El-Kàfij", në transmetimin e ardhur prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!): "Besimi është katër kolona: kënaqësi me vendimin e Allahut, mbështetje në Allahun, lënia e punës në dorën e Allahut dhe dorëzim para urdhrit të Allahut."

Shkalla e tretë, robi që ka marrë këtë rrugëtim arrin shkallën e qetësimit të zemrës e të bindjes së plotë. Pikërisht shkalla e qetësimit të zemrës dhe e bindjes së plotë është kënaqësia e plotësuar. Kur robi e arrin qetësimin e zemrës dhe bindjen e plotë, ai arrin pozitën e bukurisë së të Vërtetit të Lartësuar, atëherë pozita e kënaqësisë në zemrën e robit është e plotësuar në gradën më të lartë. Mbase dhe ajeti i nderuar në suren "El-Fexhr" thekson pikërisht këtë kuptim:

يَٰٓأَيَّتُهَا ٱلنَّفْسُ ٱلْمُطْمَئِنَّةُ ٢٧ ٱرْجِعِيٓ إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ٢٨

"Jàej'juhe-n'nefsul-mutmein'nutu irxhi'ij ilà rab'biki ràdijeten merdij'jeten" "O shpirt i bindur plotësisht. Kthehu te Zoti yt i kënaqur e i pranuar."[1]

[1] Sure "El-Fexhr", ajetet 27-28.

Kthimi te Zoti është prej pozitave të plotësuara të besimtarëve të sinqertë dhe atyre me shpirtra të qetësuara e të bindura plotësisht. Këta janë të kënaqur e të pranuar dhe te ata është prerë lakmia e babëzia e të zemëruarve.

Shkalla e katërt, është shkalla e shikimit, është pozita e atyre që kanë arritur gradën e njohjes (maërifetit), dijetarëve që i kanë larguar zemrat e tyre prej botës dhe prej errësirës. Ata e kanë pastruar shtëpinë e zemrës prej pluhurit të orientimit kah ndonjë tjetri dhe jo kah Allahu i Lartësuar. Ata e kanë shkundur pluhurin e shumicës prej zemrës, prandaj në zemrat e tyre shkëlqen i Vërteti i Lartësuar me ato shkëlqime që janë në përshtatje me cilësitë e Tij. Zemrat e tyre janë shumë të kënaqura me Qenien e Tij dhe në zemrat e tyre s'ka vend për asgjë tjetër përveç Allahut.

Kjo pozitë ka tri shkallë: *shkalla e parë* është shikimi i shkëlqimit të punëve. Me plotësimin e kësaj shkalle arrihet pozita e kënaqësisë me gjykimin e Allahut. *Shkalla e dytë* është shikimi i shkëlqimit të cilësive e të emrave. *Shkalla e tretë* është shikimi i shkëlqimit të Vetes. Të dyja këto pozita janë më të larta se termi kënaqësi e të ngjashme me kënaqësinë. Në këtë pozitë, shpirti i kënaqësisë, domethënë e vërteta e dashurisë dhe e tërheqjes, ekziston në formë të plotë.

Në hadithet e nderuara vihet theksi mbi plotësimin e pozitës së kënaqësisë. Kjo thuhet në transmetimin e ardhur prej Ebu Abdullahut, Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Njeriu që e njeh më mirë Allahun, është ai që është më i kënaquri me vendimin e Allahut të Madhëruar."*[1]

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 49; Libri "El-ijmànu uelkufru", K."Kënaqësia me vendimin", Hadithi 3.

NDARJA E PESTË

SHPJEGIMI: VËNIA NË PROVË E BESIMTARËVE

Ashtu siç ishte kënaqësia prej ushtrive të mendjes e të Mëshirëplotit si domosdoshmëri e natyrës së pastër të krijimit, po kështu edhe zemërimi është prej ushtrive të injorancës e të Iblijsit dhe prej domosdoshmërive të natyrës injorante të krijimit të mbuluar. Zemërimi vjen prej mangësisë së njohjes së pozitës se Zoti është Allahu i Lartësuar dhe nga padija për madhështinë e Allahut të Lartësuar.

Kjo padije është prej frutave të këqija të dashurisë ndaj vetes dhe e dashurisë për këtë botë. Dashuria për këtë botë sjell verbërim e shurdhim. I dashuruari me këtë botë nuk sheh gjë tjetër përveç dëshirave e interesave të kësaj bote. Ai i largohet sprovave që janë përmirësuese për shpirtrat, që janë edukuese për zemrat e që janë shkallë nëpër të cilat ngjiten lart dijetarët, kurse i zemëruari kënaqet e gëzohet me lehtësirat që i ofron kjo botë. Kjo është forma me e keqe e vënies në sprovë.

Tani do të përmendim disa transmetime të nderuara që flasin për këtë çështje, duke shpresuar në bekimin e mbartësve të shpalljes së zbritur, do të zbuten zemrat e ashpra e do të zgjohen zemrat e shkujdesura. Edhe nëse këtë çështje e kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar në librin "Dyzet hadithe", në kapitullin "Vënia në sprovë e besimtarëve dhe sekreti i këtij sprovimi", këtu do të përmendim shkurtimisht dhe pa u zgjatur shumë vetëm disa transmetime, me qëllim që të përfitohen sa më shumë dobi.

Në librin e nderuar "El-Kàfij", përcjellës të besueshëm transmetojnë prej Ebu Abdullahut, Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Njerëzit që janë vënë*

më shumë në sprovë me pësime të rënda janë profetët, pastaj ata që erdhën pas tyre dhe pastaj të ngjashmit e të ngjashmit me të parët."[1]

Prej Ebu Abdullahut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Shpërblimi i madh në të vërtetë është së bashku me sprovën e madhe."*[2]

"Për Allahun e gjithëfuqishëm, në tokë ka robër prej robërve të Tij më të sinqertë dhe çdo gjë e rrallë që zbret prej qiellit Ai e largon atë prej tyre dhe e hedh mbi të tjerët dhe, s'ka ndonjë katastrofë që Ai të mos e largojë atë prej tyre."[3]

Hadithet që flasin për çështjen që po trajtojmë, janë të shumta, domethënë për çështjen që Allahu i Lartësuar i ve në sprovë miqtë e besimtarët e Tij në këtë botë. Duhet ditur se këtë vënie në sprovë të besimtarëve Allahu e bën nga dashuria që ka për ta dhe nga kujdesi që ka ndaj tyre.

Kolona e sekretit për këtë vënie në sprovë është: sikur ata të viheshin të zgjidhnin në ankandin e mirësive do të anonin kah kjo botë dhe duke marrë parasysh origjinën e tyre, kënaqësitë e dëshirat e kësaj bote, jo vetëm që do të ndikonin në cilësitë e zemrave të tyre, por do të shtonin lidhjen e tyre me këtë botë dhe dashurinë e madhe që kanë për këtë botë. Për rrjedhojë, ata në mënyrë të dhunshme, do të braktisnin të Vërtetin e Lartësuar, do të vinin rrotull respektit të Tij dhe për shkak të cilësive të shpirtrave të tyre e përmirësimit të sëmundjeve të zemrave, me siguri do të vonoheshin që të fitonin virtytet shpirtërore.

Në përgjithësi, sikur dikush, në një farë mase do të shikonte me imtësi gjendjen e të kamurve, me siguri do të konstatonte se gjendja e kamur e pasuria, shëndeti e paqja, siguria e mirëqenia, sikur këto gjendje të ishin mbledhur vetëm te një njeri, zemra e tij do të kishte fare pak mundësi

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 196; Libri "El-ijmànu uel-kufru"; K. "Ashpërsimi i sprovës për besimtarin".

[2] I njëjti burim, në të njëjtin kapitull.

[3] I njëjti burim, në të njëjtin kapitull.

që ta ruante atë prej korrupsionit, prej sëmundjeve shpirtërore dhe që të ndalonte shpirtin e tij prej tiranisë.

Pikërisht për këtë shprehje kaq të hollë Xhabir bin Abdullahu *(Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!)* i tha Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Gjendja e varfërisë për mua është më e dashur se të jem i kamur dhe sëmundja për mua është më e dashur se shëndeti."*

Ai i tha këto fjalë, sepse nuk ishte i qetësuar e nuk kishte garanci në veten e tij se do ta ruante veten ashtu sikur ishte në mirëqenie e i shëndetshëm. Gjithashtu, nuk ishte i qetësuar e i siguruar prej tiranisë së shpirtit të tij.

Por Imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!), pozita e të cilit qëndron mbi mendjet e njerëzve, shpalosi pozitën e kënaqësisë me ato që ishin në përshtatje me horizontet e Xhabirit, me diturinë që ai kishte dhe me aftësimin e tij për të rrugëtuar për te Allahu i Lartësuar, si dhe për të nxjerrë në dukje tërheqjen e tij prej dashurisë hyjnore.

Për të gjitha këto, Imami tha: *"Përsa na përket neve të Ehli bejtit, ato që bien mbi ne prej Allahut, si: varfëri, skamje, sëmundje, shëndet, vdekje e lindje, janë më të dashura për ne."* Po, të dashurit e Allahut (eulijatë), i shohin sprovat si dhurata hyjnore dhe gjendjen e rënduar e shohin si kujdes prej të madhit Zot. Ata janë të kënaqur prej Allahut të Lartësuar dhe nuk kërkojnë ndonjë tjetër përveç Atij. Ata i drejtohen vetëm Qenies së Shenjtëruar. Ata nuk shikojnë në asnjë tjetër përveç Atij dhe, kur ata kërkojnë shtëpinë e bujarisë së të Vërtetit të Lartësuar, këtë kërkesë e bëjnë për shkak se ajo që ata kërkojnë, vjen vetëm prej të Lartit dhe nuk vjen prej anës së linjave shpirtërore të vetë njeriut.

Ata janë të kënaqur me vendimin e Allahut. Nga ana e lidhjes me të Vërtetin e Lartësuar, dashuria hyjnore është bërë burim për dashurinë e emrave të të Lartit, për cilësitë, për ndikimet dhe për punët e Tij.

NDARJA E GJASHTË

SHPJEGIMI: MERITA E KËNAQËSISË DHE QORTIMI I ZEMËRIMIT NË HADITHE

Në librin "El-Kàfij", me mbështetësit e tij, prej Ebu Abdullahut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kryet e bindjes ndaj Allahut është durimi dhe kënaqësia prej Allahut me ato që robi i do ose i urren. Robi nuk është i kënaqur prej Allahut në ato që ai do ose i urren, veçse kur ajo është mirësi për atë që ai do, ose e urren."*[1]

Gjithashtu, transmetohet nga ai: *"Njeriu që ka më shumë dituri për Allahun, është personi që është më i kënaqur me vendimin e Allahut të Lartësuar."*[2]

Dhe: *"Allahu i Lartësuar thotë: 'Robi im besimtar, s'ka ndonjë send që Unë e largoj prej tij dhe të mos e bëj atë send mirësi për robin. Prandaj ai le të jetë i kënaqur me vendimin Tim, le të durojë sprovën Time, le të falënderojë për mirësitë e Mia, Unë e shkruaj atë o Muhamed prej të sinqertëve te Unë.'"*[3]

Prej këtyre transmetimeve mësohet se pozita e të sinqertëve është prej shkallëve më të larta të pozitave njerëzore. Gjithashtu mësohet se kjo pozitë arrihet me kënaqësi, me durim e me falënderim. Dihet se pozita e kënaqësisë është më e lartë se pozita e durimit dhe pozita e falënderimit.

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f.49; Libri "El-ijmànu uelkufru", K. "Err'rridà bilkadài", hadithi 1.

[2] I njëjti burim dhe i njëjti kapitull.

[3] I njëjti burim dhe i njëjti kapitull, f.50-51.

Prej Ebu Abdullahut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"A nuk ishte i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) që thoshte për një send që kaloi: 'Sikur të ishte tjetër dhe jo ai.'"*[1]

Tregohet se Am'màri *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!),* ditën e Betejës së Sifijnit tha: *"O Zoti im, padyshim që vetëm Ti e di, sikur unë të di që kënaqësia Jote është që unë të flak veten time në këtë det, patjetër që do ta bëja. O Zoti im, padyshim që vetëm Ti e di, sikur unë të di që kënaqësia Jote është që unë të vë majën e shpatës në barkun tim dhe unë të ushtroj forcë mbi shpatën derisa maja e saj të dalë prej kurrizit tim, patjetër që do ta bëja. O Zoti im, unë di vetëm ato që Ti më ke mësuar se unë sot nuk do të bëja një punë me të cilën fitohet kënaqësia Jote se sa të luftoj këta mëkatarë."*[2]

Kjo është pozita e arritjes së kënaqësisë së të Vërtetit të Lartësuar. Por ka mundësi të jetë pozitë tjetër nga pozita e kënaqësisë. Gjithashtu, ka mundësi të jetë pozita e kënaqësisë së robit, ose asgjësimi i kënaqësisë së robit në kënaqësinë e të Vërtetit.

Në hadith tregohet se Musai *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* ka thënë: *"O Zoti im, më trego cili prej njerëzve të Tu është më i dashur te Ti dhe cili është njeriu që bën më shumë adhurim." Allahu i Lartësuar e urdhëroi të shkojë në një fshat, në breg të detit dhe i tregoi emrin e fshatit. Ai arriti në atë vend dhe aty gjeti një burrë gërmuq lebroz që po madhëronte Allahun e Lartësuar.* Musai *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* i tha Xhebrailit: *"O Xhebrail, ku është ai burri që unë iu luta Allahut të shoh?"* Xhebraili tha: *"Ky është o bisedues me Allahun!"*

Musai *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* tha: *"O Xhebrail, unë do të desha ta shikoja këtë me trup të drejtë e të shëndetshëm."*

Xhebraili tha: *"Ky është më i dashur te Allahu. Ai bën adhurim më shumë se të shëndetshmit me trup të drejtë dhe unë jam urdhëruar t'ia verboj të dy sytë. pastaj të dëgjoj çfarë thotë ai."*

---

[1] "Usùulul-Kàfij", vëll. 2, k. "Err'ridà bil kadài", f. 52.
[2] Nasr bin Mezàhim Elmunkirij, "Vak'atu Sif'fijn", f. 320.

Xhebraili bëri shenjë në drejtin të syve të atij burrit dhe pa se lotët po rridhnin nëpër faqet e tij. Ndërkaq burri tha: *"Ti më dhe kënaqësi me dy sytë aq sa Ti deshe, Ti më more dy sytë kur deshe dhe me le mua në Ty shpresën e gjatë, o Mirëbërës, o Lidhës (jà bàrr, jà Vesùl!)"*

Musai *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* i tha atij: *"O rob i Allahut, unë jam burrë që më pranohet lutja. Nëse ti dëshiron që unë t'i lutem Allahut të Lartësuar për ty, Ai do të kthejë çdo gjë që ke humbur prej gjymtyrëve e organeve të tua trupore dhe Allahu i Lartësuar do të të shërojë prej sëmundjes që ke, unë do ta bëja."*

Burri *(Allahu e mëshiroftë!)* tha: *"Nuk dua asgjë nga këto që më thua. Zgjedhja e Tij për mua është më e dashur se ajo që unë do të zgjidhja për veten time."*

Atëherë Musai *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* i tha: *"Të dëgjova kur the: 'O Mirëbërës, o Lidhës (jà bàrr, jà Vesùl), si është kjo mirësi e kjo lidhja që të çon ty te Zoti yt?"*

Burri tha: *"Në këtë vend askush tjetër përveç meje nuk e njeh Atë." ose ka thënë: "Në këtë vend askush tjetër përveç meje nuk e adhuron Atë."*

Atëherë Musai *(Paqja e Allahut qoftë për të!)* tha: *"Ky është më adhuruesi i banorëve të kësaj toke!"*[1]

Po, njerëzit që kanë një thëngjill prej dashurisë hyjnore dhe zemrat e tyre janë të ndriçuara me dritën e diturive, gjithmonë janë të gëzuar me të Vërtetin e Lartësuar e me kënaqësinë e Tij. Ata nuk janë mbytur në errësirat e kësaj bote ashtu siç jemi ne. Ata nuk janë ndikuar prej kënaqësive të kësaj bote e prej dëshirave të kësaj shtëpie që do të asgjësohet. Zemrat e tyre janë të hapura për të Vërtetin e Lartësuar, për emrat e Tij e për cilësitë e Tij. Ata i kanë vënë drynin zemrave të tyre dhe kanë mbyllur sytë e tyre për çdo gjë, me përjashtim të Allahut të Lartësuar.

[1] Transmetimi në libër ka ardhur me kuptim dhe ne e kemi marrë prej burimit të këtij transmetimi, prej librit "Sefijnetul-bihàr", vëll. 1, f. 524, K. "Err'rridà".

I dashur, Allahu i Lartësuar e zbaton vendimin e Tij në mënyrë të barabartë, qoftë kur jemi të zemëruar me vendimin e Tij, qoftë kur jemi të kënaqur me vendimin e Tij, sepse caktimet hyjnore s'kanë lidhje më kënaqësinë e me zemërimin tonë. Ajo që mbetet për ne prej zemërimit e prej mllefit, është pakësim në pozitën tonë është zhveshje prej gradëve, është ulje në sytë e eulijave dhe të hyjnorëve, është zhveshja e besimit prej zemrave.

Kjo tregohet në transmetimet e ardhura prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Hasan bin Aliu u takua me Abdullah bin Xhaferin dhe i tha: "O Abdullah, si mund të jetë besimtari besimtar, kur ai është i zemëruar me pjesën që i ka rënë dhe e urren pozitën e tij, kur gjykatësi për të është Allahu?!"*[1]

Në një transmetim tjetër, të ardhur prej Ebu Abdullahut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"I thashë atij, se me ç'gjë mësohet se besimtari është besimtar. Ai tha: "Me dorëzimin te Allahu dhe me kënaqësinë me ato që bien mbi të, gëzim ose zemërim."*[2]

Prej Ebu Xhaferit *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Njeriu që ka më shumë të drejtë prej të gjithë njerëzve të Allahut që të dorëzohet plotësisht ndaj asaj që ka vendosur Allahu i Gjithëfuqishëm, është ai që e njeh Allahun e Lartësuar. Ai është i kënaqur me vendimin, edhe kur vendimi është kundër tij dhe për këtë Allahu e zmadhon shpërblimin për të. Kurse ai që zemërohet prej vendimit dhe vendimi mbi atë zbatohet, Allahu i Lartësuar e pakëson shpërblimin për të."*[3]

[1] "Usùulul-Kàfij", vëll. 2, f. 51; Libri: "El-ijmànu uelkufru", K. "Err'rridà bilkadài", Hadithi 11; Hadithi ishte i shpjeguar në tekst dhe ne e morëm prej burimit të tij.
[2] I njëjti burim dhe i njëjti kapitull, f. 52.
[3] I njëjti burim dhe i njëjti kapitull, f. 51.

QËLLIMI I SHTATË

FALËNDERIMI DHE E KUNDËRTA, MOSMIRËNJOHJA NË KËTË QËLLIM KA DISA NDARJE

NDARJA E PARË

Ç'KUPTOJMË ME FALËNDERIM?

Falënderimi, sipas vendeve ku përdoret, shpreh konceptimin e mirësisë dhe vënien e saj në dukje, shpreh kthimin përmbys të asaj që vihet në dukje. E kundërta e falënderimit është mosmirënjohja, që shprehet me mbulimin e me harrimin e të mirës. Edhe kafsha është falënderuese ndaj pronarit të saj.

Thuhet se origjina e fjalës falënderim ka lidhje me shprehjen "sy i mbushur". Në këtë kuptim falënderimi është plotësim i përmendjes së mirësibërësit për mirësinë që ai ka bërë.[1]

[1] Ebù Kàsim, i njohur me emrin Ràgib El-Isfehànij, "El Mufredàtu fij garijbil-Kur'àn", f. 265.

Të tjerë kanë thënë se falënderimi shpreh qëndrimin përballë mirësisë me fjalë, me punë e me qëllim.[1] Falënderimi qëndron mbi tri kolona.

Kolona e parë është njohja e mirësibërësit dhe pohimi i cilësive të tij, që janë në përshtatje me atë dhe njohja e mirësisë.

Kolona e dytë, gjendja e ardhur si fryt i kësaj mirësie, është nënshtrim, kryeultësi dhe gëzim për mirësinë, sepse ajo tregon kujdesin e Mirësibërësit.

Kolona e tretë është punë, e cila është fryt i kësaj gjendjeje.

Edhe puna është tri pjesë: me zemër, domethënë qëllimi për ta nderuar Mirësidhënësin dhe për ta lavdëruar atë. Me punë, domethënë shpallja hapur e qëllimit për të falënderuar dhe për të madhëruar Allahun e Lartësuar, duke e pastruar Atë prej të metave (duke thënë 'subhàne-ll'llà') dhe duke pohuar se nuk zot tjetër përveç Allahut (duke thënë 'là ilàhe il'le-ll'llàh').

Gjithashtu puna është edhe me gjymtyrët, domethënë përdorimi i mirësive të Allahut të Lartësuar, të dukshme e të padukshme, në bindje të Allahut të Madhëruar.

Shkruesi i këtij libri thotë se falënderimi shpreh vlerësimin e mirësive të mirësibërësit dhe ky kuptim, në një mënyrë, bëhet i dukshëm në zemër; herë tjetër bëhet i dukshëm me fjalë; herë tjetër bëhet i dukshëm me anë të gjymtyrëve. Kuptohet se ky vlerësim vihet në vijë të drejtë me njohjen e Mirësibërësit dhe me njohjen e mirësisë së tij.

Këtë do ta mësojmë në vijim.

[1] Kjo shprehje është marrë prej fjalorit "Lisànul-arab", vëll. 7, f. 170.

NDARJA E DYTË

SHKALLËT E FALËNDERIMIT

Shkallët e falënderimit janë të ndryshme sipas shkallëve të njohjes së Mirësibërësit, por edhe njohja e Mirësibërësit është e ndryshme, sipas ndryshimit të shkallëve të plotësimit njerëzor. Këtu ka një dallim të madh mes atij që është në kufijtë e kafshërisë. Ai ecën në shkallët e kafshërisë dhe s'ka asnjë dijeni tjetër përveç mirësive kafshërore, që shprehen në plotësimin e dëshirave dhe në arritjen e qëllimeve e dëshirave kafshërore. Një njeri i këtillë është i kënaqur me veten e tij, me pozitën dhe me dëshirat e tij kafshërore, që shprehen me ushqimet, me veshjet e me martesën kafshërore. Një njeri i këtillë nuk i njeh shkallët e tjera të ekzistencës, nuk njeh elementet rregulluese e shkallët e plotësimit, nuk njeh asgjë tjetër përveç shkallëve të horizonteve të natyrës e horizonteve të kësaj bote. Ai kurrë s'ka trokitur ndonjëherë në botët e panjohura, prandaj nuk dallon dot atë që del prej kësaj mbulese. Kurse ai që ka hyrë në pozitat e tjera, në zemrën e tij ka arritur një shkëlqim prej praparojës së botës së fshehtë.

Gjithashtu, ka një dallim të madh mes atij që shikon në mënyrë të pavarur në shkaqet e dukshme e të brendshme, në shkaktarët e ndërmjetësuesit dhe mes atyre që kanë dituri për lidhjet mes të Vërtetit e njerëzve, të cilët fillimin dhe përfundimin e shkallëve të ekzistencës e kthejnë te i Vërteti i Lartësuar, me dritën e zemrave të tyre. Pas perdeve të dritës e të errësirë ata shikojnë shkëlqimin e Shkaktuesit të shkaqeve.

Kur falënderimi për mirësitë hyjnore realizohet me të gjitha shkallët e tij, që prej shkëlqimit të ekzistencës së parë, ai sheh shtrirjen e madhe të mëshirës së Allahut. Ai sheh nga shkëlqimi i fundit deri në shkëlqimin e marrjes në dorë të mirësive, por në brendësi të mirësive ka pushtet e nënshtrim. Kjo zemër që ndjek këtë rrugë e shikon praninë, madje vetë

zemra e tij nxjerr në dukje shkëlqimin e mëshirës gjithëpërfshirëse, mëshirës së plotë, pushtetin e nënshtrimin.

Këtë të vërtetë nuk e arrin askush përveç të plotësuarve prej eulijave, megjithëse, në fakt, këtë të vërtetë nuk e ka arritur askush përveç Vulës së Profetëve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).* Në të vërtetë, edhe eulijatë e arrijnë këtë shkëlqim në sajë të ndjekjes së përpiktë.

Pikërisht për këtë, i Vërteti i Lartësuar thotë:

وَقَلِيْلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّكُورُ

"…ue kalijlun min ibàdije-sh'shekùru" "…pak prej robërve të Mi janë falënderues."[1]

Po, ata që s'kanë dituri për shkëlqimet e Atij që është Një e i Vetëm, qeniet i shikojnë sikur janë origjinale, ata bëhen mosmirënjohës ndaj mirësive hyjnore. Gjithashtu, edhe ata që nuk shohin shkëlqimin e emrave e të cilësive, zemrat e tyre nuk janë pasqyra në të cilat bëhen zgjidhje.

Kurse ata që s'kanë dituri për shkëlqimet e punëve, që s'kanë dituri për teuhidin e punëve e të cilësive të të Vërtetit, jo vetëm që janë mosmirënjohës për mirësitë, por janë edhe të shkujdesur që të mendojnë për mirësitë.

Këtë e njofton Allahu i Lartësuar: وَذَرُوا الَّذِيْنَ يُلْحِدُونَ فِي أَسْمَآئِهِ *"…ue dheru-l'ledhijne julhidùne fij esmàihi…"* "… dhe leni ata që bëjnë shtrembërime me emrat e Tij… "[2]

Kurse te ata që janë mbledhur së bashku pesë zgjidhjet hyjnore dhe kanë verifikuar sekretet e fshehura njerëzore, e arrijnë në shtëpinë e madhe të botës së përtejvarrit, ku shijojnë mirësitë e brendshme e të jashtme. Ata

[1] Sure "Sebe", ajeti 13.
[2] Sure "El-Aràf", ajeti 180.

falënderojnë të Vërtetin me të gjitha mënyrat e falënderimit dhe e lavdërojnë Atë me të gjitha fjalët e lavdërimit, sepse falënderimi është lavdërim për mirësitë që u ka dhënë Mirësidhënësi i Lartësuar.

Kur mirësitë janë të dukshme, për to mirësi ka një falënderim. Nëse mirësitë janë prej mirësive të brendshme, për ato mirësi ka një falënderim tjetër. Nëse mirësitë janë dituri të vërteta, për ato ka një falënderim ndryshe. Nëse mirësitë janë nga ana e shkëlqimit të punëve, falënderimi për ato është në një formë tjetër. Nëse mirësitë janë prej shkëlqimit të cilësive e të emrave, kanë një falënderim të një lloji tjetër dhe, nëse mirësitë janë nga ana e shkëlqimeve të Qenies së Shenjtë, falënderimi për ato është në një mënyrë tjetër.

Meqenëse këto lloje mirësish arrihen prej pak njerëzve të sinqertë, kuptohet që edhe falënderimi e lavdërimi për të Adhuruarin nuk është punë e lehtë të bëhet, me përjashtim të një pakice prej eulijave.

Kjo njoftohet në ajetin e nderuar: وَقَلِيْلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّكُوْرُ *"…ue kalijlun min ibàdije-sh'shekùru"* "…pak prej robërve të Mi janë falënderues."

Disa studiues që kanë arritur gradën e njohjes (àrifijn) kanë thënë: "Falënderimi është prej pozitave të përgjithshme, sepse falënderimi përmban pretendimin për shpërblimin e Mirësidhënësit me mirësitë e Tij. Por kjo do të thotë të tregohet edukatë e keqe.

Sikur robi praktikant të shohë se i Vërteti i Lartësuar vepron në mbretërinë e Tij si të dojë, njëkohësisht sheh edhe për veten e tij mundësi veprimi, ai nuk mendon se është i aftë të falënderojë, sepse robi dhe veprimet e tij janë prej tërësisë së mbretërive hyjnore, por duke pasur parasysh se falënderimi përmban detyrimin për shpërblim, kjo, siç u tha më sipër, është edukatë e keqe, vetëm kur robi është i urdhëruar të falënderojë, në atë mënyrë që bërja e falënderimit është kryerja e një urdhri hyjnor.

Prandaj falënderimi i eulijave, në kuptimin e vërtetë të falënderimit,[1] është bindje.

Por dihet që pretendimi për bindje përfshin edhe pretendimin e jo eulijave, të cilët arrijnë zgjidhjet dhe janë të kujdesshëm të qëndrojnë në pozitat e vetmisë e të shumicës. Ata arrijnë gradën më të madhe në jetën e ndërmjetme (Berzakh).

Nga kjo anë, shehu, dijetari e studiuesi, Khavàxheh El-Ensàrij, megjithëse ka thënë se falënderimi është prej pozitave të përgjithshme, në shkallën e tij të tretë ka thënë: "Robi të mos shohë asnjë tjetër përveç Mirësidhënësit. Kur Mirësidhënësi sheh adhurim, Allahu e shton mirësinë. Kur Allahu e sheh robin të dashuruar, ia bën të ëmbël vështirësinë dhe, kur robi mendon të veprojë vetëm me mendimin e tij, nuk sheh prej Tij as mirësi e as vështirësi."

Prej këtyre frazave të nderuara mësohet se kjo pozitë, pozita e falënderimit, si të gjitha pozitat e atyre që ndjekin një rrugë, në etapat e para të rrugëtimit merrnin pjesë të zakonshmit e të veçuarit, ose etapa e parë e rrugëtimit është e veçantë për të zakonshmit. Pastaj në etapat e fundit, rrugëtimin e vazhdojnë vetëm të veçantët, të zgjedhurit, kurse të tjerët nuk kanë pjesë në këtë etapë.

[1] Abdu-rr'rridà Elkàshànij, "Sherhu Menàzili-s'sàirijne", f. 212-213.

NDARJA E TRETË

FALËNDERIMI ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE E SHOQËRON NATYRA E PASTËR E KRIJIMIT MOSMIRËNJOHJA ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS

Falënderimi është prej cilësive të pastra të krijimit, të cilat Allahu i Lartësuar i ka regjistruar me lapsin e fuqisë së Tij në zemrat e të gjithë njerëzve. Të gjithë njerëzit, në këtë dukuri, janë pjesëmarrës e të afërm njëri me tjetrin. Kjo do të thotë se madhërimi e lavdërimi i takojnë vetëm Mirësidhënësit të Lartësuar. Kushdo që i referohet natyrës së pastër të krijimit të tij, gjen se madhërimi i Mirësidhënësit dhe dashuria për Atë janë të saktësuara e të theksuara qartë në Librin e Tij Famëlartë.

Të gjitha falënderimet e madhërimet, me të cilat i drejtohen banorët tokës mirësidhënësve dhe të parëve të tyre në këtë botë, është vetëm cilësi hyjnore. Edhe nderimet e falënderimet e respekti me të cilin i drejtohen nxënësit, dijetarëve e mësuesve, janë prej kësaj natyre të pastër krijimi. Sikur dikush të mos jetë mosmirënjohës për mirësinë, ose e le falënderimin për Mirësidhënësin, ai është artificial, është kundërshtar i natyrës së pastër hyjnore të krijimit të tij, është jashtë cilësive njerëzore dhe jashtë natyrës njerëzore.

Për të gjitha këto, specia njerëzore, në përgjithësi, duke marrë parasysh natyrën e pastër të krijimit, i qorton rëndë mosmirënjohësit për

mirësitë, i përgënjeshtron ata dhe i konsideron jashtë cilësive të qenies njerëzore.

Ajo që ne përmendëm më sipër, i referohet falënderimit vetëm për Mirësidhënësin pa asnjë kusht dhe është e barabartë qoftë kur falënderimi është real, qoftë kur falënderimi bëhet me mënyrë metaforike. Duhet ditur se kjo cilësi e ardhur prej natyrës së pastër të krijimit, është cilësi e pambuluar me mbulesat e shkujdesjes dhe është fermentuar në brumin me të cilin është krijuar njeriu. Pikërisht ky individ e falënderon Qenien e Shenjtë. Ky falënderim i tij është lavdërimi për Mirësidhënësin absolut, i Cili e ka shtrirë mëshirën e Tij në shtëpinë e realizimit të punëve dhe në të gjitha grimcat e gjallesave që përfitojnë prej tryezës së mirësive të Tij. Në sajë të mëshirës së Tij gjithëpërfshirëse, do të vazhdojë furnizimi i krijesave me ushqim prej Qenies së Tij të Shenjtë.

Meqenëse Qenia e Tij e Shenjtë është e plotësuar me plotësimin absolut, për më tepër ky plotësim absolut është i shoqëruar me mëshirën absolute dhe me furnizimin absolut, të gjitha mirësitë që vijnë prej qenieve, janë hija e mëshirës së Tij dhe shkëlqejnë prej cilësisë së Tij furnizuese. Asnjë qenie s'ka plotësim, s'ka cilësinë e bukurisë, s'ka cilësinë e dhënies së mirësive e cilësinë e furnizimit me ushqim prej vetes së saj që në fillimin e qenieve e deri në përjetësi.

Kushdo që, sipas asaj, duket që ka mirësi e plotësim, në të vërtetë, është pasqyra e cilësisë së furnizimit të Qenies së Shenjtë e të plotësuar.

Ky kuptim, në mënyrë në plotë, është shprehur në ajetin e nderuar:

إِنَّ اللَّهَ هُوَ الرَّزَّاقُ ذُو الْقُوَّةِ الْمَتِيْنُ

"In'ne-ll'llàhe huverr'rrz'zàku dhul-kuv'vetil-metijnu" "Allahu është Furnizues i madh e Zotëruesi i fuqisë."[1]

[1] Sure "Edh'dhàrij'jàt", ajeti 58.

Në ajetin e nderuar fuqia për furnizim i adresohet vetëm të Vërtetit të Lartësuar.

Akoma më domethënëse është ajo që përfitohet prej kërkesave, me anë të çelësit hyjnor: اَلْحَمْدُ للهِ رَبِّ الْعَالَمِيْنَ *"Elhambu lil'làhi rab'bil-àlemijne"* "Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve.",[1] domethënë se të gjitha falënderimet i adresohen vetëm Allahut të Lartësuar dhe janë të orientuara vetëm për Qenien e Tij të Shenjtë.

Kjo dallohet akoma më qartë kur vëmë në konsideratë lidhjen që ka fraza e parë e ajetit të parë të sures "El-Fatiha": "بِسْمِ اللهِ" *«bismil'làhi"* "Me emrin e Allahut!" me frazën:

"اَلْحَمْدُ للهِ"

"Elhamdu lil'làhi" "Falënderimi i takon vetëm Allahut!"

Ky falënderim është sjellja e morali i eulijave, që kanë arritur gradën e njohjes dhe e dijetarëve të mëdhenj, që shohin në thellësi të çështjeve. Në këtë shprehje kaq domethënëse ka sekrete, zbulimi i të cilave nuk mund të jetë pa rrezik.

Në tërësi, natyra e pastër e krijimit që nuk është e mbuluar me perdet e dukurive të krijesave, sendin që i është lënë në mirëbesim për ta ruajtur, ajo ia dorëzon të zotit në gjendjen që ai send është. Kjo natyrë e pastër krijimi falënderon të Vërtetin për çdo mirësi. Gjithashtu, prej natyrës së pastër të krijimit të pambuluar vijnë të gjitha falënderimet prej çdo falënderuesi, vijnë edhe të gjitha lavdërimet prej çdo lavdëruesi.

Në çdo titull qofshin e prej çdo personi dhe për çdo mirësi që të jetë, të gjitha këto falënderime e lavdërime i adresohen vetëm Allahut të Lartësuar. Nëse të mbuluarit mendojnë se po falënderojnë e po lavdërojnë

[1] Sure "El-Fatiha", ajeti 2.

dikë tjetër e jo të Lartësuarin, mund të thuhet se qëllimi më i lartë me dërgimin e profetëve ka qenë heqja e kësaj mbulese dhe ngritja e perdeve që pengojnë shkëlqimin e Bukurisë së përjetshme. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

وَإِن مِّنْ شَيءٍ إِلاَّ يُسَبِّحُ بِحَمْدَهِ وَلَكِن لاَّ تَفْقَهُونَ تَسْبِيْحَهُمْ

"…ue in min shej'in il'là juseb'bihu bihamdihi ue làkin là tefkahùne tesbijhahum…"
"…s'ka asnjë send që nuk e madhëron e nuk e falënderon Atë, por ju nuk e kuptoni madhërimin që ato bëjnë…"[1]

I mjeri njeri, i mbuluar, në të cilin natyra e pastër e krijimit është prapa perdeve të dukurive të errëta, që kanë shuar për të dritën e dhuruar prej Allahut që kur ai është krijuar dhe e ka rrethuar atë me errësira morale të shumta, mohon dhe është mosmirënjohës për të gjitha mirësitë hyjnore. Çdo mirësi ai ia adreson një qenieje tjetër si ai dhe orientimi i tij në shpresën që ai ka është në banorët e kësaj bote. Dora e lakmisë së tij është shtrirë të kërkojë prej të varfërve si ai vetë, megjithëse varfëria është e rrënjosur ndër ta.

O i mjeri njeri, i mbuluar, o njeri që e kalove jetën tënde i mbuluar me mirësitë e Allahut, që kurrë nuk mbarohen, ti që përfitove prej mëshirës gjithëpërfshirëse të Tij që s'ka kufi e cak, nuk e njeh Atë që e ka në dorë mirësinë për ty, por shkon si ai që nuk shikon natën se ku shkel dhe falënderon mendjemëdhenjtë. Me këtë veprim ti ke shfaqur nënshtrimin tënd për dikë prej banorëve të tokës.

Padyshim që edhe falënderimi i krijesave është detyrim i patjetërsueshëm, ashtu siç kanë thënë: *"Kush nuk falënderon të krijuarin, nuk ka falënderuar Krijuesin."*[2]

---

[1] Sure "El-Isra", ajeti 44.
[2] Kjo shprehje, me këto fjalë, nuk gjendet në asnjërin prej librave të hadithit, por një e ngjashme me këtë shprehje është cituar prej të Dërguarit të Allahut: "Kush nuk falënderon njerëzit, nuk ka falënderuar Allahun!" "Kenzul-Um'màl" vëll. 3, Hadithi 6443.

Allahu i Lartësuar duhet falënderuar, sepse është Ai që i ka vendosur rrugët për ardhjen e mirësisë e të mëshirës dhe nuk është mirësia për të cilën falënderohet ajo që e mbulon Krijuesin e furnizuesin e vërtetë, ndryshe kemi mosmirënjohje për mirësinë ndaj Atij që e ka në dorë të japë e të dhurojë mirësi.

Në përgjithësi themi se falënderimi është prej domosdoshmërive të natyrës së pastër të krijimit dhe mosmirënjohja është prej mbulimit të natyrës së pastër të krijimit. Mosmirënjohja është prej ushtrive të Iblijsit e të injorancës. Me këtë shpjegim hapen portat e diturive, me kushtin e kthimit në natyrën e pastër të krijimit dhe të daljes prej mbulimit e vetëmbulimit.

NDARJA E KATËRT

CITIMI I DISA HADITHEVE TË NDERUARA QË FLASIN PËR FALËNDERIMIN

Muham'med bin Jakubi, me mbështetësit e tij, transmeton prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!), "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *'Kush ha dhe falënderon, për atë ka shpërblim si shpërblimi i atij që kryen agjërim të vullnetshëm. Kush fal dhe falënderon, për atë ka shpërblim si shpërblimi i atij që e përballon sprovën me durim. Kush jep dhe falënderon, për atë ka shpërblim si shpërblimi i atij që është i privuar dhe kënaqet me pak.'*[1]

Me të njëjtën rrugë përcjellje, lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Allahu s'ka hapur për robin një portë që ai të falënderojë dhe të mos ketë depozituar për atë një portë për t'i dhënë atij më shumë.'*[2]

Një shembull i ngjashëm ka ardhur edhe në "Nehxhul-Belàgah": "*Kur Allahu hap për robin portën e falënderimit, Ai nuk e mbyll për atë portën e shtimit.'*[3]

Po kështu ka ardhur edhe në Kur'anin Famëlartë: "وَلَئِنْ شَكَرْتُمْ لأَزِيْدَنَّكُمْ" *"Ue lein shekertum leezijden'nekum…"* "Nëse ju falënderoni, patjetër Unë do t'ua shtoj."[4]

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 77; K. "Esh'shukru", Hadithi 1.
[2] Burimi i mësipërm, në të njëjtën faqe.
[3] Es'sej'jin Err'rredij ,"Nehxhul-Belàgah" , f. 758.
[4] Sure "Ibrahim", ajeti 7.

Prej këtij hadithi mësohet se Allahu i Lartësuar e ka hapur portën e falënderimit. Për hapjen e kësaj porte kërkohet falënderim dhe ky falënderim, ashtu siç u mësua në ndarjen e mëparshme dhe ashtu siç është e qartë te ata që kanë arritur gradën e njohjes (maërifetit), te të cilët, falënderimi, gjuha, zemra, mendja dhe trupi i falënderuesit, janë prej mirësive hyjnore dhe detyra për të falënderuar Atë është një detyrim prej të cilit askush nuk mund të dalë jashtë. Por, si është e mundur që dikush të kryejë detyrën për të falënderuar me dorë e me gjuhë?[1]

Shehu Muham'med bin El Hurr El-Amilij, në librin e tij "El-Vesàil", transmeton prej Muham'med bin Idrijs, cituar prej librit "Elujùnu uelmehàsinu" të autorit El Mufijd *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)*: "Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Allahu s'ka dhënë ndonjë mirësi për një rob dhe ai falënderon për atë mirësi, ky falënderim e bën detyrim që Ai t'ia shtojë, para se falënderimi të dalë prej gjuhës së robit."*

Prej këtij hadithi mësohet se falënderimi është prej detyrave të zemrës, para se gjuha të lakojë falënderimin, ashtu siç u theksua më sipër. Janë të shumta hadithet e nderuara që flasin për këtë çështje.

Gjithashtu Ebu Abdullahu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ai që s'ka me se të shpërblejë në të njëjtën masë, le të zgjasë gjuhën e tij për të falënderuar."*[2]

Gjithashtu ka thënë: *"Prej të drejtës së falënderimit për Allahun është që ti të falënderosh personin që e bëri atë mirësi të vijë te ti me dorën e tij."*[3]

Prej këtij hadithi e prej asaj që ne theksuam në ndarjen e mëparshme për falënderimin e të krijuarit, kjo është për shkak se ai i krijuar ishte rruga për atë mirësi hyjnore. Por nëse dikush nuk e ka kujdesin të falënderojë atë që e ka në dorë dhënien e mirësisë dhe falënderon të krijuarin, duke pandehur se i krijuari është i pavarur për të dhënë mirësi,

[1] Është përmbajtja e një poezie të Sadi Shirazit.

[2] "Vesàilu-sh'shij'ath", vëll. 16, f. 311; K. 8, Hadithi 8.

[3] "Vesàilu-sh'shij'ath", vëll. 16, f. 311; K.8.

kuptohet se ky person është prej mosmirënjohësve ndaj mirësive të Allahut. Kjo kërkesë s'ka nevojë as të shpjegohet e as për dëshmitarë, pasi ajo është prej gjërave shumë të qarta dhe të argumentuara.

Në librin "El Vesàil" dhe prej kuvendeve të shehut, me përcjellësit e tij, prej Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Ditën e Kiametit robi sillet dhe qëndron para Allahut të gjithëfuqishëm dhe Allahu urdhëron që ai rob të çohet në zjarr, atëherë robi do të thotë: 'O Zot, urdhërove për mua të më çojnë në zjarr, por unë kam lexuar Kur'anin."*

Allahu i Lartësuar i thotë: *"O rob, Unë të dhashë mirësi dhe ti nuk falënderove për mirësinë Time!"*

Robi i thotë: *"O Zot, më dhe një mirësi dhe unë të falënderova, më dhe atë mirësinë tjetër dhe unë për atë mirësi të falënderova!"*

Dhe robi vazhdon të përmendë mirësitë dhe falënderimet me aq sa është numri i mirësive. Allahu i Lartësuar i thotë: *"Të drejtën the o robi Im, por ti nuk falënderove atë që e solli mirësinë te ti me duart e tij dhe, Unë jam betuar që të mos e pranoj falënderimin e robit për një mirësi që i dhashë atij, derisa robi të falënderojë atë që e çoi atë mirësi prej krijesave të Mia te ai."*[1]

Hadithet që flasin për këtë çështje janë aq shumë, sa këto faqe nuk i nxënë.

[1] "Vesàilu-sh'shijah", vëll. 16, f. 312, K. 8, Hadithi 12.

QËLLIMI I TETË

DËSHIRA DHE HUMBJA E SHPRESËS NË KËTË ÇESHTJE KEMI DY NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME DËSHIRËN DHE ME HUMBJEN E SHPRESËS

Para kësaj është përmendur shpresa e prerja e shpresës, por ka mundësi që transmetuesi të mos jetë plotësisht korrekt, pasi në hadithin e nderuar ka parregullsi, për të cilat shpresohet të jenë vetëm nga kjo anë, pasi është e mundur të bëhet dallimi mes shpresës e dëshirës, sepse shpresë do të thotë: shpresohet mëshira krahas punës, kurse dëshira është shpresë pa punë, ose mosshikim i punës. Nëse dëshira është shpresë pa punë, atëherë është shumë larg që dëshira të numërohet prej ushtrive të mendjes, sepse në transmetimet e nderuara për dëshirën ka ardhur qortim, ulje e përgënjeshtrim.[1]

Prandaj dëshira ka mundësi të jetë shpresë pa e parë punën. Kjo është prej pozitave të atyre që kanë arritur shkallën e njohjes së Allahut, të cilët e kanë lënë veten e punën e tyre dhe kanë emigruar prej banesës së

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 241; K. "Et'tameu".

ekzistencës së tyre, kanë lënë shtëpinë e të tashmes së tyre dhe egoizmin e tyre, kanë shkelur me këmbë mbi kokën e pasurisë së gjithësisë, janë çliruar prej dy krijimeve dhe i kanë hapur sytë e tyre vetëm mbi të Dashurin. Ata nuk shikojnë as veten e as punët e tyre, megjithëkëtë zemrat e tyre janë të mbushura me gjallëri. Në ato zemra shkëlqen mëshira e të Vërtetit të Lartësuar. Gjithsesi, edhe me këto cilësi këmba e tyre në rrugëtimin për te i Vërteti i Lartësuar dhe te mëshira e Tij është e thyer, ndërsa dora e dëshirës së tyre është shtrirë të kërkojë të Dashurin e mëshirën e Tij, dora e tyre nuk është e shtrirë të kërkojë prej ndonjë tjetri përveç Atij.

Bazuar mbi këtë shpjegim, dëshpërimi e humbja e shpresës kundrejt kësaj dëshire është më gjithëpërfshirëse se prerja e shpresës, sepse kundrejt më të veçantës humbja e shpresës është më e përgjithshme. Realisht dëshpërimi për humbjen e mëshirës është më i përgjithshëm dhe bën që njeriu të mos jetë prej atyre që numërohen prej të bindurve (Ehlu-t'tàati), ose ai është prej këtyre të fundit, por është i vetëkënaqur me bindjen e tij dhe shpreson në punën e tij. Mirëpo kjo sjellje në moralet e atyre që kanë arritur gradën e njohjes (ma'rifet) dhe burimin e njohjes më të ëmbël, konsiderohet dëshpërim prej mëshirës dhe kufizim i gjerësisë së mëshirës.

Siç u shpjegua, dëshira është prej ushtrive të mendjes dhe është në përputhje me kërkesat e cilësisë së pastër të krijimit, kurse e kundërta e saj është prej ushtrive të injorancës dhe në kundërshtim me kërkesën e cilësisë së pastër të krijimit. Kjo është shumë e qartë, sepse lënia e mosshikimit të punës dhe orientimi kah gjerësia e mëshirës, është cilësi e pastër e krijimit, është dashuri e plotësuar dhe është neveri prej lënies mangët. Kjo cilësi e mbarë familjes njerëzore është saktësuar dhe është shkruar me dorën e fuqisë:

"فِطْرَةَ اللهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا"

"…fitrete-ll'llàhi-l'letij fetare-n'nàse alejhà…" "…feja e Allahut, në të cilën Ai i krijoi njerëzit…"[1]

Gjithashtu, orientimi kah e tashmja e vetvetes dhe drejtimi kah egoizmi e degët e tij, prej të cilave është admirimi i punës, është prej gabimeve të injorancës e të mbulimit të cilësisë së pastër të krijimit. Një njeriu të këtillë i pëlqen vetja, nxiton të punojë për veten e tij, ka dashuri të madhe për veten dhe i pëlqen të jetë i pavarur me mendimin e tij. Duke u kthyer në kapitullin "Shpresa dhe prerja e shpresës", bëhen të qarta shumë studime që i referohen kapitullit të dëshirës e të humbjes së shpresës.

[1] Sure "Er-Rrum", ajeti 30.

NDARJA E DYTË

NDIKIMI I DËSHIRËS, I HUMBJES SË SHPRESËS

Kemi mundësi që shpresën e dëshirën ta dallojmë në një formë tjetër, domethënë kur qëllimi me dëshirën është shpresa për faljen e mëkateve, ose falje për mangësitë në përgjithësi, ashtu siç thotë i Larti me gjuhën e Ibrahim Khalijlit (Hazretit Ibrahim (Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për të!):

"وَالَّذِي أَطْمَعُ أَنْ يَغْفِرَ لِي خَطِيئَتِي يَوْمَ الدِّينِ"

"Ul'ledhij atmeu en jagfire lij khatij'etij jeume-d'dijni" "Ai, te i Cili shpresoj të më falë mëkatet e mia në Ditën Gjykimit."[1]

Fjala *shpresë* shpreh shpresën për shpërblimin e Allahut dhe shikimin në gjerësinë e mëshirës së Tij. Gjithashtu, mund të jetë e kundërta, ose kundër kësaj, por kjo gjë dallohet sipas ballafaqimit. Në të gjitha gjendjet, shpresa prej Qenies së Shenjtë, dëshira për Atë, shkëputja e shpresës prej njerëzve dhe lidhja me të Vërtetin e Lartësuar, janë prej domosdoshmërive të cilësisë së pastër të krijimit, janë vende ku duhet falënderuar Qenia e Tij e Shenjtëruar, përfshirë edhe të ruajturit prej mëkateve.

Në lidhje me këtë çështje, Allahu i Lartësuar thotë:

"إِنَّ رَحْمَتَ اللهِ قَرِيْبٌ مِّنَ الْمُحْسِنِيْنَ ۚ وَادْعُوهُ خَوْفاً وَطَمَعاً"

[1] Sure "Es'-Ahuara" ajeti 82.

"…ued'ùhu khaufen ue tamean, in'ne rahmete-ll'llàhi karijbun minel-muhsinijne"
"…dhe lutuni Atij duke pasur frikë e duke shpresuar. Me të vërtetë, mëshira e Allahut është afër punëmirëve."[1]

Kur i Larti përshkruan cilësitë e besimtarëve thotë:

تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفاً وَطَمَعاً وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ

"Tetexhàfà xhunubuhum anil-medàxhi'i jed'ùne rab'behum khaufen ue tamean ue mimà rezaknàhum junfikùne" "I heqin trupat e tyre prej shtrojave për t'iu lutur Zotit të tyre nga frika e duke shpresuar dhe japin prej atij furnizimi që Ne u kemi dhënë."[2]

Gjithashtu, shpresa në të Vërtetin e Lartësuar, dëshira për mëshirën e Tij të gjerë dhe informacioni për vërshimin e shkëlqimit të Qenies së Tij të Shenjtëruar, të gjitha këto janë prej degëve të besimit (imanit), janë prej domosdoshmërive të cilësisë së pastër të krijimit, prandaj edhe ndërprerja e dëshirave prej ndonjërës prej krijesave, mbyllja e syve për të mos parë ato që kanë njerëzit ndër duart e tyre dhe dëshira e varur te ndonjë tjetër dhe jo te Allahu i Lartësuar, të gjitha këto janë prej degëve të vënies shok Allahut (shirk), janë në kundërshtim me cilësinë e pastër të krijimit dhe domosdoshmërish vijnë prej mbulimit.

Në librin e nderuar "El Kàfij", me përcjellësit e tij prej imam Sexh'xhàdit *(Paqja qoftë mbi të!)* (imam Zejnel-Abidijn), lexojmë: *"Pashë të mirën, të gjithë të mirën e pashë të mbledhur në atë pjesë të dëshirave që janë në duart e njerëzve."*[3]

Në librin "Elvesàil" prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të)*, lexojmë porosinë që i la Muham'med bin El Hanefij'jeh: *"Nëse*

[1] Sure "El-Aràf" ajeti 56.
[2] Sure "Es'-sexhdeh" ajeti 16.
[3] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 242; K. 127, Hadithi 2.

dëshiron të mbledhësh të mirat e kësaj bote dhe të Botës Tjetër, priti shpresat nga ato që janë në dorën e njerëzve."[1]

Gjithnjë në librin "Elvesàil", Ebù Xhaferi tregon: "Erdhi një burrë te i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe i tha: *"O i Dërguar i Allahut, më mëso diçka!"* Profeti i tha: *"Duhet të dëshpërohesh nga ato që janë në duart e njerëzve. Ja kjo është kamja reale."* Burri tha: "Më thuaj më shumë o i Dërguari i Allahut!" Profeti i tha: *"Ruhu prej dëshirës, sepse dëshira është varfëri para syve!"*[2]

Prej Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!), prej prindërve të tij, transmetohet: "Prijësi i besimtarëve është pyetur: *"Ç'është ajo që e bën besimin të qëndrueshëm?"* Prijësi i besimtarëve iu përgjigj: *"Frika nga Allahu."* Burri e pyeti: *"Si largohet kjo?"* Imam Aliu u përgjigj: *"Shpresa."*[3]

Në "Nehxul-Belàgah lexojmë: *"Vendet ku ndeshen më shumë mendjet, janë nën vezullimin e dëshirave."*[4]

Në librin "El-Vesàil", prej Ahmed bin Fehdit lexojmë: "Është transmetuar nga Ebù Abdullahu (paqja qoftë mbi të!) për fjalën e të Lartit të Gjithëfuqishëm:

"وَمَا يُؤْمِنُ أَكْثَرُهُمْ بِاللهِ إِلاَّ وَهُم مُّشْرِكُونَ "

"Ue mà ju'minu ektheruhum bil'làhi il'là ue hum mushrikùne" "Shumica e tyre nuk beson në Allahun, veçse duke i vënë Atij shok."[5] se ka thënë: *"Kjo është si fjala e atij burrit që thotë: 'Sikur të mos ishte filani, patjetër do të kisha vdekur. Ose, sikur të mos ishte filani, unë nuk do të kisha bërë mirë as këtë e as atë tjetrën; ose,*

[1] "El Vesàil", vëll. 16, f. 24, K. 67, Hadithi 5
[2] Burimi i mësipërm, i njëjti vëllim, f. 25, K. 67, Hadithi 6.
[3] Burimi i mësipërm, vëll. 16, f. 25, K. 67, Hadithi 7.
[4] "Nehxhul-Belàgah", "El Hikmetu", 220.
[5] Sure "Jusuf", ajeti 106.

sikur të mos ishte filani, me siguri që njerëzit e familjes sime do të kishin humbur. A nuk e sheh se ai në të vërtetë i ka vënë shok Allahut në mbretërinë e Tij?"[1]

Ky hadith i nderuar është prej esencave të diturive hyjnore dhe prej bazave të vërtetave të teuhidit *(Allahu është Zoti Një e i Vetëm).* Ky hadith ka dalë prej mineralit të shpalljes hyjnore e prej depos së diturisë hyjnore, është siguruesi i besimit të veçantë që Allahu është Zoti Një e i Vetëm, ka dalë prej unitetit në shumicën, që është kënaqësia e zemrave të eulijave.

Këto hadithe të nderuara janë garant për edukimin e shpirtrave e për ushtrimet e zemrave, sepse varësia e lidhja e zemrës me të krijuarin dhe shkujdesja ndaj të Vërtetit të madhëruar, është prej mbulesave të trasha, të cilat shuajnë dritën e diturisë, turbullojnë zemrën dhe e errësojnë atë. Këto mbulesa të trasha janë prej kurtheve më të mëdha që ngre i keqi, Iblijsi. Këto janë kurthe të mëdha që Iblijsi i ngre shpirtit dhe janë pikërisht këto kurthe që e largojnë njeriun prej sheshit të shenjtë të të Vërtetit dhe e ngurtësojnë atë prej diturive të vërteta.

Nga përmbajtja e transmetimeve të nderuara mësohet se të gjitha mirësitë janë të mbledhura në prerjen e shpresës prej njerëzve[2], sepse prerja e shpresës prej njerëzve është rruga që përfundon te i Vërteti i Lartësuar dhe hap portën e arritjes te Ai. Njëkohësisht është vendmbledhja e të gjitha mirësive, është qendra e të gjitha begative që janë të fermentuara në cilësinë e pastër të krijimit të njeriut. Pikërisht me këtë cilësi të pastër është krijuar njeriu.

[1] "El Vesàil", vëll. 15, f. 215, K. 12; Ibni Fehd Elhalij, "Ud'detu-d'dàij", f. 89.
[2] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 119, K. "El-Istijfàë ani-n'nàsi"; I njëjti burim në f. 241, K. "Et'tameu".

QËLLIMI I NËNTË

MBËSHTETJA "ET'TEVEK'KUL" DHE E KUNDËRTA E SAJ, DËSHIRA E ZJARRTË

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI I KUPTIMIT TË FJALËS "TEVEK'KUL"- MBËSHTETEJE

Mëso se për fjalën *"tevek'kul"–"mbështetje",* nga ana gjuhësore, si dhe në njoftimet, në transmetimet dhe në thëniet e njerëzve të mëdhenj, kanë ardhur kuptime të përafërta, prandaj nuk është e nevojshme të analizojmë të gjitha këto kuptime, por do të theksojmë vetëm disa prej kuptimeve të fjalës *"tevek'kul"-"mbështetje"*.

Kuptimet e nxjerra nga rrënja e fjalës *"tevek'kul"-"mbështetje"* dhe argumentet e saj tregojnë se kjo fjalë do të thotë: *mbështetja e punës në një të besueshëm*, pasi njeriu e sheh veten të pafuqishëm për ta bërë atë punë. Gjuhëtarët, si Elxheuherijj, në fjalorin e tij "Es'sihàhu"[1] dhe në fjalorë të tjerë kanë thënë se *"tevek'kul"-"mbështetje"*, do të thotë nxjerrja në dukje e pafuqisë dhe mbështetja në një tjetër.

[1] El Xheuherij, "Sihàhu-l'lugati", vëll. 5, f. 1844-1845.

Ka shumë mundësi që ky të jetë kuptimi bazë i kësaj fjale, në kuptimin e pafuqisë, siç thonë për shembull: burrë që ka lënë punën e tij në dorën e tjetrit, porse lënia e punës në dorën e tjetrit tregon pafuqi. Disa prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul-maërifeh) kanë thënë: "tevek'kul"-"mbështetje", është në kuptimin: lënia e të gjithë punës në dorën e Zotëruesit të punës.[1]

Disa të tjerë kanë thënë: *"tevek'kul"-"mbështetje"* në Allahun, do të thotë: robi për gjithçka që shpreson të ketë, i ka prerë shpresat prej krijesave. Gjithashtu, disa prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes (àrifijn) kanë thënë: *"tevek'kul"-"mbështetje"*, do të thotë: shtrirja e trupit në adhurim dhe lidhja e zemrës me të Lartësuarin.[2]

Edhe në transmetimet e nderuara ka përkufizime të tjera për fjalën *"tevek'kul"- "mbështetje"*. Disa prej këtyre kuptimeve do t'i përmendim në vijim.

[1] Abdu-rr'rrezàk Elkashànij, "Sherhu Menàzili-s'sàirijn,"f. 171.
[2] Abdul-kerijm Elkajsharij, "Err'rrisàletul-kashijrij'jeh", f. 263.

NDARJA E DYTË

KOLONAT E "TEVEK'KUL"- "MBËSHTETEJES"

"Mbështetja"-"tevek'kul", pas besimit (imanit) realizohet vetëm pasi robi ka arritur katër punë, të cilat për *"mbështetjen"-"tevek'kul"* janë në pozitën e kolonave:

E para: Besimi se garantuesi mbi të cilin ai e mbështet punën ka dijeni për nevojën që ka i mbështeturi.

E dyta: Besimi se garantuesi ka fuqi të plotësojë nevojën që ka i mbështeturi.

E treta: Besimi që garantuesi nuk është koprrac.

E katërta: Besimi se garantuesi ka dashuri e mëshirë për të mbështeturin.

Në rastin e ndodhjes së ndonjë parregullsie në njërën prej këtyre katër punëve, *"mbështetja"-"tevek'kul"*, kurrë nuk arrihet, domethënë nuk arrihet mbështetja te garantuesi, sepse, sikur të supozohet se garantuesi është injorant që s'ka dijeni për punët e të mbështeturit dhe nuk di se ku është e si është nevoja që ka i mbështeturi, kurrë nuk është e mundur mbështetja mbi një garantues të këtillë. Gjithashtu, kur supozojmë se garantuesi është i ditur dhe dituria e tij është e plotësuar, por ky garantues s'ka fuqi të plotësojë nevojën e të mbështeturit, vetëkuptohet që i mbështeturi përsëri kurrë nuk do të mbështetej në një garantues të këtillë.

Gjithashtu, kur i mbështeturi beson në fuqinë e garantuesit, por ka mundësi që garantuesi të jetë koprrac, përsëri nuk mund të arrihet mbështetja në një garantues të këtillë. Sikur të plotësohen tri prej këtyre

katër punëve, por nuk është plotësuar kolona e mëshirës dhe e dashurisë për të mbështeturin, robi kurrë nuk do të mbështetej mbi një garantues të këtillë, për rrjedhojë *"mbështetja"-"tevek'kul"* nuk realizohet.

Megjithëkëtë ndodh që *"mbështetja"-"tevek'kul"* nuk realizohet, edhe kur plotësohen këto punë që janë baza për këto katër kolona.

Ajo që ne thamë se besimi në këto katër punë, të cilat janë kolona në kapitullin "Mbështetja-"tevek'kul", përsëri *"mbështetja"-"tevek'kul"* nuk arrihet, sepse besimi dhe dituria në këtë çështje s'kanë asnjë ndikim.

Dhe tani shkoqitja e këtij përgjithësimi: njeriu ka mundësi të vërtetojë me anë të studimit shkencor të argumentuar çdo njërën prej këtyre katër kolonave, pastaj të gjitha shkallët e studimit t'ia nënshtrojë krahasimit logjik dhe t'i vërtetojë ato. Por kjo dituri e mbështetur mbi argumentet, s'ka asnjë ndikim mbi vetë studiuesin nga çdo anë qoftë.

Mbase një filozof i fuqishëm vërteton me anë të diturisë së argumentuar se i Vërteti i Lartësuar ka dijeni për të gjitha grimcat e ekzistencës, se Ai sheh të gjitha krijesat e padukshme e të dukshme dhe se të gjitha këto janë të pranishme në procesverbalin e të Vërtetit të Lartësuar.

Gjithashtu, ai filozof ka vërtetuar zhveshjen e plotë të të Vërtetit me të gjitha llojet e zhveshjes dhe ka vërtetuar edhe përhershmërinë e Qenies së Shenjtë me argumente të përsosura e të formës së prerë. Por kjo dituri e formës së prerë nuk ka fare ndikim mbi atë. Le ta ilustrojmë këtë me një shembull: Një njeri në vetmi të plotë, larg syve të njerëzve, përgatitet të kryejë një mëkat. Por me ardhjen e një fëmije që është në gjendje të kuptojë, ai turpërohet dhe largohet prej punës së keqe, megjithëse ai e di se aty është i pranishëm i Vërteti i Lartësuar. Madje janë të pranishëm edhe engjëjt e Tij, si dhe për gjendjen e tij kanë dijeni edhe eulijatë (të dashurit e Allahut) e plotësuar. Është vërtetuar plotësisht se kjo gjendje në peshoren e argumentimit shkencor, nuk ka ngjallur në këtë burrë ndjenjën e turpit, nuk e ka larguar atë prej punëve të këqija.

Megjithëse ai e ka ruajtur fshehtësinë nga të tjerët dhe e ka respektuar praninë e të tjerëve, ka pasur në mendje edhe Mirësidhënësin. Por respektimi i të gjitha këtyre që u thanë, vijnë prej cilësisë së pastër të krijimit të familjes njerëzore, prandaj këto nuk janë gjë tjetër veçse dituri figurative të argumentuara, janë nga ato dituri që i memorizon mendja, por prej këtyre diturive të memorizuara nuk arrihet të mësohet as mënyra e as gjendja.

Shembull tjetër: Mbase gjendet një i urtë i famshëm që e ka kaluar të gjithë jetën e tij duke vërtetuar gjerësinë e fuqisë hyjnore, gjithashtu ka vërtetuar edhe kuptimin e sentencës: "S'ka ndikues tjetër në gjithësi përveç Allahut.". Madje këtë sentencë ai e ka vërtetuar me argumente të formës së prerë. Në atë studim ai i ka vënë cakun veprimit të qenieve të larta e të ulëta, i ka vënë cakun fuqive të panjohura e të njohura të mbretërisë së ekzistencës së veçantë të Qenies së Shenjtë të Zotëruesit. Në studimin e tij ky i urtë i ka përshkruar të gjitha botët me cilësinë e pafuqisë dhe të nevojës për të Vërtetin në sheshin e shenjtërisë.

Gjithashtu, ky i urtë ka shpjeguar qartë me studim të argumentuar të vërtetën e krijimit, ashtu siç e lexojmë në ajetin e nderuar:

يَآ أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَآءُ إِلَى اللهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيْدُ

"Jà ej'juhe-n'nàsu entumul-fukràu ile-ll'llàhi uell'llàhe huvel-ganij'jul-hamijdu" "O njerëz, ju keni nevojë për Allahun dhe Allahu s'ka nevojë për ju, Ai është i Pasuri, i Falënderuari."[1]

Me këtë studim ai e ka vënë teuhidin e punëve (besimi në punët e Allahut) në peshoren shkencore. Por, pavarësisht nga këto cilësi, njeriu shkon dhe e lyp plotësimin e nevojave prej një të krijuari të varfër dhe i shtrin dorën të kërkojë prej një tjetri dhe nuk i kërkon të Pasurit të Lartësuar.

[1] Sure "Fatir", ajeti 15.

E gjitha kjo vjen vetëm për shkak se, as kuptimi i mendjes e as dituria e argumentuar, s'kanë ndikim në gjendjet e zemrës. Prapa këtij fshati ka fshatra të tjerë dhe pas këtij qyteti ka shumë qytete të dashurisë (ashkut) dhe ne të gjithë jeni në njërën kthesë të rrugicës.

Kjo që u tha nuk është e përveçme për një filozof, ose për një të urtë, ose për një dijetar që njeh terminologjinë, i cili mbase është njeri me shije, por që flet pa u menduar gjatë për zhveshjen, për veçimin, për Njëtimin e Allahut dhe për Njëshin. Mbase ky dijetar është vënë në sprovë me këtë sëmundje, megjithëse është jurist i së drejtës islame (fekijh), ose është dijetar në fushën e hadithit dhe është adhurues i përkushtuar që gjen kënaqësinë nga ndikimi që kanë mbi atë imamët e ruajtur prej mëkateve dhe transmetimet e ardhura prej tyre, mbase ai di përmendësh edhe hadithet që flasin për *"teve'k'kul"-"mbështetjen"* në Allahun dhe lënien e punës në dorën e Allahut, ose mund të jetë dijetar i besueshëm në dituritë që ka për Allahun dhe është i kënaqur me vendimin e Allahut.

Të gjitha këto dhunti ai i shikon se janë prej "mineralit të shpalljes", beson në kuptimet që ato kanë dhe është i nënshtruar ndaj këtyre diturive, siç ishte dituria e argumentuar. Megjithatë ai është vënë në provë me këtë sprovë të madhe. E gjitha kjo sprovë nuk ndodh prej ndonjë gjëje tjetër përveçse prej faktit se dijet që ata kanë nuk i kapërcejnë caqet e mendjes e të vetes, dituritë që ata kanë fituar nuk kanë arritur në zemrat e tyre, e cila është vendi i dritës së besimit.

Derisa dituritë janë në këtë cak, prej këtyre diturive nuk mund të arrihen gjendjet e zemrës dhe gjendjet shpirtërore. Prandaj ai që i ve vetes qëllim të arrijë në pozitën e mbështetjes, lënies së punës në dorën e Allahut, besimit, dorëzimit e pjesë të tjera prej asaj diturie, e cila në terminologjinë e atyre që kanë arritur gradën e njohjes quhet veprim, patjetër që duhet të kapërcejë shkallën e diturisë së argumentuar dhe të kalojë në shkallën e besimit (imanit). Ai nuk duhet të kënaqet me dituritë e pastra formale, por të arrijë në pozitat që e çojnë atë në kolonat e në veprimet paraprake që

mundësojnë arritjen e këtyre të vërtetave në zemrën e tij, pasi vetëm me këtë rrugë ai mund të arrijë gjendje që dëshiron.

Më parë kemi trajtuar, në mënyrë të përgjithshme, rrugët për arritjen e këtyre diturive dhe dërgimin e tyre në tabelën e zemrës.

Dhe tani po i përmendim në mënyrë të përmbledhur:

Le të dihet se, pasi mendja, në sajë të diturisë së argumentuar, ka kuptuar, për shembull kapitullin e *"Mbështetjes"-"tevek'kul"*, ai që ecën në këtë rrugë ka detyrim të interesohet për të vërtetat që ai i kuptoi me mendjen e tij. Këto të vërteta ai patjetër duhet t'i çojë në zemër, por e gjitha kjo realizohet vetëm kur personi që ka vendosur të ecë në këtë rrugë, e lufton veten ditë-natë. Çdo orë ai duhet ta shqetësojë veten sa më pak me botën e natyrës e të shumicës dhe të zbrazë zemrën prej saj.

Në këtë orë, në orën e ndarjes së vetes prej botës, duhet të merret me përmendjen e Allahut të Lartësuar me zemër të hapur dhe duke menduar në frazat e ziqrit që aq shpesh përmenden në transmetimet, si për shembull ziqri madhor:

"لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ" *"là ilàhe il'le-ll'llàh"* "S'ka zot tjetër përveç Allahut!", që është fraza më madhore e ziqrit e fraza më e nderuar e përmendur në transmetime.[1]

Në kohën kur zemra është zbrazur prej problemeve të kësaj bote, ai e lexon këtë frazë me afrim të plotë të zemrës, me qëllim që ta mësojë zemrën. Prandaj ai e përsërit këtë frazë ziqri të nderuar dhe ia lexon atë zemrës së tij. Me këtë frazë ziqri, ai e ndërgjegjëson veten, kërkon sigurinë, qetësinë e zemrës së tij dhe mendon thellë në kuptimin e kësaj fraze ziqri të nderuar. Ky mësim vazhdon derisa zemra arrin në një gjendje meditimi e

[1] "Kenzul-Um'màl", vëll. 2, f.217, Hadithi 3835; "Merdàtul-ibàd", f. 267, "Lutja më e mirë është: "S'ka zot tjetër përveç Allahut!"; Ziqri më i preferuar është: "S'ka zot tjetër përveç Allahut!"

butësie. Atëherë ajo zemër flet me ziqirin e fshehtë dhe me ndërmjetësinë e ndihmave të panjohura edhe gjuha do të ndjekë zemrën.

Kur njeriu merret me këtë punë tepër të nderuar, por patjetër me kushtet e me edukatën e jashtme e të brendshme gjatë orëve që ai i ka të lira, në kuptimin e që është shkëputur prej interesave të kësaj bote, zemra bëhet marrëse këshillash. Dhe, siç u tha më sipër, gjuha e ndjek zemrën. Në këtë gjendje ndodh që, edhe kur njeriu është në gjumë, gjuha e tij lakon fjalët e ziqrit të nderuar, derisa arrin në një cak, në të cilin shpirti përsërit Njëtimin e Allahut, përsërit të vërtetën madhore se vetëm Ai është Një.

Ndodh që shqetësimi i madh të bëhet binjak me pastërtinë e shpirtit e me sinqeritetin e qëllimit, atëherë njeriun s'ka gjë që e ndalon të bëjë ziqër, mbi atë vetë e mbi të gjitha punët e tij bëhet sunduese drita e Njëtimit të Allahut (teuhidi).

Kjo është rruga nëpër të cilën gjerësia e mëshirës së të Vërtetit të Lartësuar dhe butësia e dashamirësia e Tij arrijnë në zemrën e tij, vetëm në sajë të një ziqri të fuqishëm, në sajë të mendimit rreth të gjitha lutjeve me të cilat krijesat i drejtohen vazhdimisht të Vërtetit të Lartësuar. Atëherë zemra, në mënyrë graduale, arrin një model prej dashurisë hyjnore.

Sa më i fortë të jetë ziqri, sidomos në kohët kur zemra është e zbrazur prej interesave të kësaj bote, dashuria shtohet, derisa ai vetëndërgjegjësohet se vetëm i Vërteti i Lartësuar është akoma më mëshiruesi, më i buti e më i dashuri se çdo gjë tjetër që gjendet. Në këtë gjendje ai shikon me dritën e vështrimit të zemrës të vërtetën e frazës:

"أَرْحَمُ الرَّحِمِيْنَ" *"Erhamu-rr'rràhimijne"* "Më i mëshirshmi i mëshiruesve."

Me këtë rrugë arrijnë në zemrën e tij edhe kolonat e tjera të *"mbështetjes"- "tevek'kul"*. Kjo është rruga e ziqrit të fuqishëm, është rruga e ushtrimeve të zemrës, përderisa zemra ndien kënaqësi me këto të vërteta. Në gjendjen kur në brendësi të zemrës shkëlqejnë domosdoshmëritë e këtyre diturive, atëherë në cilësitë e shpirtit duket e qartë drita e *"tevek'kul"*-

"mbështetjes" së Allahut, shkëlqen drita e lënies së punës në dorën e të Vërtetit, shkëlqen siguria e të ngjashme me të.

Fëmija e merr bisedën e ekzistencës prej gjirit të natyrës. Kjo është nëna që e mëkon fëmijën me qumështin e gjirit të saj. Më pas ai fëmijë bëhet i aftë për ushqimet shpirtërore, jo lëndore dhe qëndron më lart se pozita e lidhjeve.

Gjithashtu ai është edhe burim për *"tevekkul"-"mbështetjen"* te Allahu i Lartësuar, derisa kalon në pozita të tjera. Nga dita në ditë në të shtohet ndarja prej natyrës e prej pozitës së kësaj bote, derisa arrihet lidhja me të vërtetën dhe me pozitën e qenies njeri, me pozitën e shenjtërisë dhe me pasojat. Në këtë gjendje në zemër, në radhë të parë, shkëlqen drita e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (et'teuhijdul-fiëlij), shkëlqen një model prej teuhidit (besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm), drita e besimit në emrat e Tij. Më pas ky besim vjen edhe për cilësitë e Tij. Sa më shumë që shkëlqen kjo dritë, aq më shumë largohet nga mendja mali i dashurisë për veten e i admirimit të vetes, largohet egoizmi dhe e tashmja, derisa ky mal del fare nga mendja. Atëherë mali thërrmohet nën shkëlqimin e plotë të Zotit të njeriut dhe me këtë arrihet tronditja e përgjithshme.

Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

فَلَمَّا تَجَلَّى رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكّاً وَخَرَّ موسَى صَعِقاً

"…felem'mà texhel'là rab'buhù lilxhebeli xhealehù dek'ken ue kharr'rre Mùsà saikan…"

"…dhe kur drita e Zotit të tij shkëlqeu mbi malin, mali u thërrmua dhe Musait i ra të fikët…"[1]

Por, mjerisht, shkrimtari i kapur pas degëve të pemës së keqe dhe gjetheve të asaj peme që varen në pusin e natyrës së errët, mbeti i kënaqur

[1] Sure "El-Araf", ajeti 143.

prej të gjitha pozitave morale, prej shkallëve të plotësimit njerëzor me fjalë e me terma të mangëta. Ai e ngushtoi jetën e tij dhe e konsumoi atë në pështjelljen e termave.

Të ndërgjegjësuarit sigurisht që kanë dalë jashtë kësaj bote dhe kanë lënë çdo gjë që ka në të. Ata janë tërhequr prej varësive dhe kanë arritur jetën njerëzore, madje pse jo edhe jetën hyjnore. Ata kanë shpëtuar prej prangave e prej zinxhirëve të natyrës: "قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ"

"Kad eflehal-muëminùne" "Është e sigurt që besimtarët kanë shpëtuar."[1]

Ky shpëtim absolut është shpëtim edhe prej burgut të natyrës e prej llojeve të këtij burgu, prandaj:

وَالَّذِيْنَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ

"Uel'ledhijne hum ani-l'lagvi muëridùne" "...të cilët i shmangen kotësive."[2]

Largimi prej fjalëve e prej punëve të kota është vetëm njëra prej cilësive të besimtarëve, kurse jeta e kësaj bote është mashtrim e kotësi:

"وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلاَّ لَعِبٌ وَلَهْوٌ" *"Ue mel-hajàtu-d'dun'jà il'là leibun ue lehvun…"*

"Jeta e kësaj bote s'është gjë tjetër veçse përjetim e mashtrim…"[3]

Të mjerët ne që jemi si krimbi i mëndafshit. Ne endim rreth vetes fillin e shpresave, të dëshirave, të lakmisë, të dashurisë për këtë botë e për gjërat e bukura të kësaj jete. Ne e shkatërrojmë veten tonë në mbështjelljen e këtyre fijeve që endim.

[1] Sure "El-Muminun", ajeti 1.
[2] Sure "El-Muminun", ajeti 3.
[3] Sure "En-Am", ajeti 32.

O Zoti im, shpresoj që vërshimi Yt të na marrë për dore! Në këtë gjendje që jemi shpresoj të na përfshijë mëshira Jote e gjerë.

Ne jemi rrëzuar, por shpresojmë që me udhëzimin Tënd të hapet për ne porta e udhëzimit në rrugën e drejtë, në rrugën e shpëtimit, sepse vetëm Ti je: "إِنَّكَ رَؤُوفٌ رَّحِيمٌ" *"…in'neke reùfun rahijmun…"* "…Padyshim, vetëm Ti je i Buti, i Dhembshuri."[1]

[1] Sure "El-Hashr", ajeti 10.

NDARJA E TRETË

ANALIZA E KËTIJ KAPITULLI DHE KËSHILLA E DIJETARËVE

I dashur, nëse je prej atyre që sjellin argumente, ose je prej filozofëve, atëherë argumenti i dy frazave: "çdo i zhveshur është i mençur"[1] dhe "natyrshmëria e së vërtetës është i gjithë plotësimi"[2], zbulojnë për ty grimcat e qenieve në praninë e diturive që janë prapa botëve të padukshme deri në fundin e botës së ndijimit e të dëshmisë, zbulojnë për ty diturinë e thjeshtë të rrethimit të përjetshëm pa asnjë devijim në shumicë e në kufizim, por pa damkën e mbulimit e të kushtëzimit, që në kohët pafundësisht të hershme deri në përjetësi.

Mbase ajo që thekson argumenti: "çdo i zhveshur është i mençur" dhe në një anë tjetër fraza "natyrshmëria e së vërtetës është i gjithë plotësimi", e shpjegon qartë fjala e të Lartit: أَلاَ يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ اللَّطِيْفُ الْخَبِيْرُ *"Elà men khaleka ue huve-l'letijful-khabijru"* "A nuk e di se Ai që krijoi, Ai është i Buti, i Gjithinformuari."[3]

Kur të kuptosh argumentin e fortë filozofik, se të gjitha grimcat e qenieve përgjithmonë janë vetë prania e të Vërtetit dhe, te bota, me të gjitha pjesëzat e saj, është prania e shenjtë e të Vërtetit, do të vërtetohet se bota është lidhja me të Vërtetin e varësia prej Tij. Është vërtetuar edhe dituria konkrete e të Vërtetit.

---

[1] "El-Esfârul-erbeah", vëll, 3, f. 447.
[2] "El-Esfârul-erbeah", vëll, 2, f. 368 dhe vol. 6, f. 110.
[3] Sure "El-Mulk", ajeti 14.

Këtë e thekson vetë Allahu i Lartësuar në librin e Tij:

وَعِنْدَهُ مَفَاتِحُ الْغَيْبِ لاَ يَعْلَمُهَا إِلاَّ هُوَ *"Ue indehù mefàtihul-gajbi là jaëlemuhà il'là huve…"* "Te Ai janë çelësat e fshehtësisë dhe atë nuk e di askush përveç Atij…"[1]

Nëse je prej atyre që kanë arritur shkallën e njohjes dhe ke ecur në rrugën mbi të cilën kanë ecur dijetarët e mëdhenj, shumë shpejt do të vërtetosh diturinë vetjake të të Vërtetit të Lartësuar, atëherë do të shikosh diturinë e Tij faktike të shkëlqejë në të gjitha grimcat e qenieve.

Nëse je prej atyre që besojnë librat qiellorë dhe fjalët e mbajtësve të revelatës, me domosdoshmërinë e të gjitha feve, ke arritur një vërtetim të diturisë rrethuese së përhershme, ke arritur në diturinë me të cilën vërtetohet se i Vërteti i Gjithëfuqishëm ka dijeni për grimcat e qenieve të padukshme e të dukshme dhe se dituria e Tij gjithëpërfshirëse kuptohet prej Kur'anit Famëlartë.[2]

Gjithashtu, nëse je në ndonjërën prej shkallëve të diturisë, të njohjes, të adhurimit, ose të besimit dhe e ke kuptuar fuqinë e Qenies së Shenjtë, atëherë ke kuptuar jo vetëm pushtetin gjithëpërfshirës të Qenies së Shenjtë, por ke kuptuar edhe plotësimin e sundimit të Saj, ke kuptuar edhe sa e plotë është fuqia mposhtëse e Qenies së Shenjtë.

Gjithashtu, me diturinë që ke arritur, ke vërtetuar me argument se Qenia e Shenjtë është e përjetshme, ose këtë e ke vërtetuar në sajë të vëzhgimit, të njohjes, me studime e me ndërgjegje, me adhurim e me besim. Njëkohësisht ke kuptuar se Qenia e Shenjtë është krejtësisht e pastër prej mangësive, prej kufizimit, prej të metave e kushtëzimit. Ke kuptuar se Qenia e Shenjtë nuk mban përgjegjësi për anët e mangësive e të mosekzistencës.

---

[1] Sure "En-Am", ajeti 59

[2] Lexo në suren "Ta-Hà", ajeti 98; suren Et-Talak", ajetin 12; suren "El-Hadijd", ajetin 3; suren "Junus", ajetin 61 dhe suren "Sebe", ajetet 2-3.

Ke kuptuar se Qenia e Shenjtë është pa asnjë cilësi të keqe, si: koprraci, smirë, dëshira e të ngjashme me këto cilësi të këqija, cilësi në të cilat mangësitë e të metat dallohen në mënyrën më të plotë. Ke kuptuar se Qenia e Shenjtë është në plotësimin absolut, është i Bukuri që s'ka kufizim. Ti mund të shikosh me sytë e tu sa të plota janë mirësitë e Allahut në lidhje me të gjitha të mundshmet.

Padyshim që mirësitë e Allahut janë të gjithhershme, janë që në zanafillën e fillimeve[1] dhe s'kanë të përparshme me shërbimin. Mëshira e plotë e Qenies së Shenjtë shkëlqen dhe është e shtrirë në të gjitha të mundshmet në mënyrë të barabartë, qofshin të mundshme të bindura, qofshin kundërshtuese, qofshin të lumtura, qofshin të këqija, qofshin besimtare, qofshin mohuese.

Mëshira gjithëpërfshirëse është absolute vetëm për Atë, i Cili ka përgatitur për njerëzit para se ata të krijoheshin të gjitha mjetet e jetës materiale e morale, për këtë botë e për Botën Tjetër. Për këtë njeri mendjemadh Ai ka nënshtruar lëndët e botës së natyrës dhe forcat materiale e morale. Është mëshira e plotë dhe e posaçme e Qenies së Shenjtë ajo që e ka bërë njeriun të jetë i krijuar prej trupave më të ulët të natyrës, gjithashtu në sajë të mëshirës së plotë Qenia e Shenjtë ka bërë që njeriu të jetë i mbjellë me farërat e ekzistencës së tij me lëndën e kësaj natyre të ndotur, e cila për botën është në pozitën e këpucëve. Njëkohësisht e ka bërë njeriun të jetë i denjë të lëvizë drejt kërkimit të plotësimit të pafund dhe të kërkojë deri arritjen e gradës së asgjësimit absolut.[2]

O njeri i mjerë e i pafuqishëm, qëkur ishe i panjohur në mosekzistenë dhe ishe i fshehur në gropën e thellë të mospërmendjes, as

---

[1] Shkëputur prej lutjes së Imam Sexhadit në "Es'sahijfetu-s'sexhàdij'jeh", për pohimin dhe kërkimin e teubes: "Të gjitha mirësitë e Tua janë fillim!"

[2] Tregon për ajetin 6 të sures "El-Inshikàk": "هَلْ أَتَى عَلَى ٱلْإِنْسَانِ حِيْنٌ مِّنَ الدَّهْرِ لَمْ يَكُنْ شَيْئاً مَّذْكُوراً" *"Hel età alel-insàni hijnun mine-d'dehri lem jekun shej'en medhkùren"* "A nuk ka kaluar një periudhë kohe për njeriun kur ai nuk ishte diçka që përmendej."

prej teje e as prej prindërve të tu s'ka as një gjurmë para se të të krijonte Bujari.

Këtë e njofton ajeti i nderuar:

هَلْ أَتَى عَلَى ٱلْإِنْسَانِ حِيْنٌ مِّنَ الدَّهْرِ لَمْ يَكُنْ شَيْئاً مَّذْكُوراً

"Hel età alel-insàni hijnun mine-d'dehri lem jekun shej'en medhkùren" "A nuk ka kaluar një periudhë kohe për njeriun kur ai nuk ishte diçka që përmendej?!"[1]

Cila Fuqi e plotësuar dhe cila mëshirë e gjerë të shpëtoi ty prej asaj errësire pa anë e pa fund? Cila dorë të veshi ty me rrobën e ekzistencës dhe të dha mirësinë e plotësimit e të bukurisë?

Ajo ditë erdhi me ty pas shumë etapash e shkallësh, derisa ti erdhe në shtyllën kurrizore të prindërve të tu. Ishe prej grimcave të ndotura e të ndyra. Cila dorë e fuqishme të çoi ty në mitrën e nënës dhe të dha ty këtë lëndë unike të thjeshtë e këtë formë të mahnitshme? Me ç'lloj shërbimi e adhurimi u bëre i merituar të kesh fytyrën njerëzore? Me ç'punë i arrite këto mirësi të dukshme e të brendshme? Me ç'punë e me çfarë kërkese bëre që ti u rrite në botën e mitrës dhe u orientove në sheshin e kësaj bote? Me çfarë merite e pune bëri Ai zemrën e këtij njeriu që shqyen si bishë individët e species së vet, por njëkohësisht bëri që edhe të ketë mëshirë, pasi më parë ishte i keq e i ashpër? Për të plotësuar mirësinë për ty, o njeri, Allahu bëri që nëna jote të të rritë në gjirin e saj pas dhimbjeve të lindjes e pas vuajtjesh e lodhjesh të shumta. Kjo mëshirë e përgjithshme dhe kjo mëshirë e plotësuar, prej cilit është? Me cilën kërkesë dhe me sa përpjekje e arrite? Cili është Ai që shndërroi gjakun e ndotur para se ti të vije në këtë botë me qumësht të mirë e të shijshëm, atë qumësht që u bë prej ushqimeve më të përshtatshme për stomakun tënd të dobët? Me ç'përpjekje e me ç'punë të krijesave u përgatitën të gjitha këto?

[1] Sure "El-Insan", ajeti 6.

I dashur, cila ishte merita, serioziteti e puna që ti bëre të meritosh zbritjen e shpalljes hyjnore, të meritosh zbritjen e mëshirës më të madhe hyjnore, më të lartën mirësi të Zotit, mirësinë e udhëzimit në rrugën e drejtë, udhëzimin në rrugën e lumturisë? Cili fitim e cila punë, ose cila aftësi e cili adhurim përgatiti për ne njerëzit këtë mirësi të madhe? Me cilin shërbim paraprak ne njerëzit u bëmë që të meritojmë ekzistencën e profetëve të mëdhenj dhe të dërguarve të nderuar? Cila mirësi hyjnore e jashtme dhe e brendshme është e atillë që del jashtë cakut të numërimit e numrave? Cili prej robërve, ose cila krijesë ka dorë dhe është ortak në këtë mirësi? O njeri i mbuluar e i zhytur në mirësitë fillestare të Allahut, ti je i mbështjellë në mëshirën gjithëpërfshirëse, por ti e humbe Atë që e ka në dorë mirësinë për ty dhe tani, që arrite moshën e pjekurisë në të cilën ti i dallon punët, ti kapesh pas çdo fije bari dhe mbështetsh në çdo themel të dobët.

Sot, patjetër duhet të mendosh për mirësitë e mëshirat hyjnore, duhet patjetër të ndërpresësh kërkesat drejtuar një të krijuari të pafuqishëm, patjetër duhet të mendosh vetëm në butësitë e të Vërtetit të Lartësuar, butësi të përgjithshme e të veçanta. Duhet të ndalosh rrugëtimin për të shkuar te të tjerët dhe të udhëtosh vetëm për të trokitur në portën e të Lartit. Mos u mbështet në asnjë kolonë përveç kolonës së patundshme të mëshirës hyjnore.

Si është puna me ty, o njeri, që je kaq i shkujdesur ndaj Atij që e ka në dorë mirësinë për ty dhe shkon e mbështetesh mbi veten tënde e mbi punën tënde, mbështetesh mbi të krijuarit e mbi punën e tyre? Kështu "fiton" këtë idhujtari të padukshme, të dallueshme qartë.

A ke gjetur në mbretërinë e të Vërtetit të Lartësuar dikë që të veprojë në këtë mbretëri përveç Qenies së Shenjtë të të Vërtetit? A ke gjetur ndonjë që i plotëson nevojat përveç Atij? A e ke gjetur dorën e mëshirës së Tij të shkurtër e të mbyllur? A mos mendove se rrethi i kësaj mëshire nuk të përfshin ty? Apo mendove se Ai është i shkujdesur ndaj teje e ndaj nevojave

që ti ke? Mos vallë mendon se fuqia e Tij dhe pushteti i Tij janë të kufizuara? Mos vallë ti thua se Ai është, koprrac mashtrues e kurnac?

O ti shkrimtar me zemër të vdekur, o i sprovuar me dëshirat e shpirtit, o ti i lidhur me ujin e me tokën, deri kur dhe ku? Ti je i verbër nga brenda, zemra të është verbuar, sepse ti je i shkujdesur ndaj Atij që e ka në dorë të të japë ty të gjitha mirësitë. Ti je i mbuluar prej njohjes së bukurisë e të madhështisë së Tij.

Deri kur do të vihesh në provë me kurthet e Iblijsit e me hamendjet e shpirtit? Zgjohu prej gjumit të rëndë, lëre shikimin e dyzuar e çoje në zemrën tënde dritën e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (dritën e teuhidit) dhe lexoje në brendësi të shpirtit të vërtetën e frazës:

وَلاَ حَوْلَ وَلا قُوَّةَ إِلاَّ بِاللهْ

"ue là haule ue là kuv'vete il'là bil'lah" "S'ka forcë e fuqi përveçse me Allahun!"

Priti dorën xhinëve, djajve e njerëzve prej veprimit në mbretërinë e të Vërtetit të Lartësuar dhe mos i mbyll sytë që të kërkosh plotësimin e dëshirës prej një të krijuari të pafuqishëm e të mjerë:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ ضُرِبَ مَثَلٌ فَٱسْتَمِعُواْ لَهُۥٓ إِنَّ ٱلَّذِينَ تَدْعُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ لَن يَخْلُقُواْ ذُبَابًا وَلَوِ ٱجْتَمَعُواْ لَهُۥ وَإِن يَسْلُبْهُمُ ٱلذُّبَابُ شَيْـًٔا لَّا يَسْتَنقِذُوهُ مِنْهُ ضَعُفَ ٱلطَّالِبُ وَٱلْمَطْلُوبُ ٧٣ مَا قَدَرُواْ ٱللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِۦٓ إِنَّ ٱللَّهَ لَقَوِيٌّ عَزِيزٌ ٧٤

"Ja Ej'juhe-n'àsu duribe methelun festemiù lehù, in'ne-l'ledhijne ted'ùne min dùnil-l'làhi len jakhlukù dhubàben ue levi-xhtemeù lehù, ue in jeslubhumu-dh'dhubàbu shej'en là jestenkidhùhu minhu, daufe-t'tàlibu uelmatlùbu. Mà kaderu-ll'llàhe hak'ka kadrihi, in'ne-ll'llàhe lekavij'jun azijzun"

"O njerëz, ja një shembull dhe dëgjojeni me vëmendje, ato (idhujt) që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk krijojnë dot asnjë mizë edhe sikur të mblidhen të gjithë për ta krijuar atë. Nëse miza u rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk e shpëtojnë dot atë (sendin) prej mizës, i pafuqishëm është

lutësi e i luturi. Ata nuk madhëruan Allahun me të drejtën që i takon Atij të madhërohet, Allahu është i Fuqishmi, Ngadhënjyesi."[1]

O Zot, padyshim, forca e madhështia janë të posaçme vetëm për madhërinë Tënde, fuqia e pushteti reduktohen vetëm në Personin Tënd të Shenjtë. Ne të varfrit e pafuqishëm prej varësisë së madhe që kemi me këtë botë jemi të hutuar, prej dritës së cilësisë së pastër të krijimit jemi të braktisur e të mbuluar, sepse ne e harruam natyrën e pastër të krijimit tonë. Ajo krijesa e pafuqishme dhe e mjerë, së cilës, nëse miza i rrëmben diçka, ajo s'ka fuqi t'ia kthejë vetes atë që i rrëmbeu miza.

Sikur të gjithë njerëzit të mblidheshin së bashku, nuk do të kishin fuqi të vepronin as mbi një mizë, për shkak se zemrat tona janë lidhur me të krijuarin. Ne jemi mbështetur mbi të krijuarin dhe jemi larguar prej sheshit të Shenjtërisë Tënde, jemi larguar prej mbështetjes në Qenien Tënde të Shenjtë.

O Zoti ynë, zemrat tona të shpërndara bëji të bashkuara në një vend të vetëm. Këtë sy të devijuar bëje të shohë drejt, bëj që në zemrat tona të shkëlqejë besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), se Ai është vetëm Një, se vetëm Ai është i zhveshur prej mangësive e të metave. Bëje malin e egoizmit tonë e të tashmen tonë të shtypur, inekzistente, na ço në kufirin e asgjësimit, derisa të jemi të zbrazur prej shikimit të mbështetjes. "Padyshim që vetëm Ti je ndihmësi më i mirë."

[1] Sure "El-haxh'xh", ajete 73-74.

NDARJA E KATËRT

NJOHJA E DISA GRADËVE E SHKALLËVE TË *"MBËSHTETJES" –"TEVEK'KUL"*

Mësoje se ndryshimi i shkallëve të *"mbështetjes"–"tevek'kul"* ndryshon sipas njohjes me shkallët e kësaj mbështetjeje. Kur njeriu e arrin *"mbështetjen"-"tevek'kul"* me rrugën e diturisë, atëherë ai gjykon për domosdoshmërinë e *"mbështetjes"-"tevek'kul"* me dituri e me argument.

Më sipër pamë se kjo shkallë nuk mund të quhet "mbështetje"-"tevek'kul".

Sikur njeriu të besojë në kolonat e lartpërmendura të mbështetjes, atëherë ai është në pozitën e mbështetjes dhe kjo pozitë, për këtë njeri, është shkalla e parë e mbështetjes, kur besimtari shikon se të gjitha sendet janë krijuar për të dhe ai vetë është krijuar për të adhuruar të Vërtetin e Lartësuar.

Allahu e dëshmon këtë pozitë të përgjithshme për njeriun në ajetin e nderuar:

لَقَدۡ خَلَقۡنَا ٱلۡإِنسَٰنَ فِيٓ أَحۡسَنِ تَقۡوِيمٖ ٤ ثُمَّ رَدَدۡنَٰهُ أَسۡفَلَ سَٰفِلِينَ ٥

"Lekad khalaknel-insàne fij ahseni takvijmin. Thum'me rednàhu esfele sàfilijne" "Padyshim Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në më të ulëtin e të ulëtëve."[1] Ajeti tjetër i Kur'anit Famëlartë e

[1] Sure "Et-Tijn", ajetet 4-5.

dëshmon këtë të vërtetë: وَعَلَّمَ ءَادَمَ ٱلْأَسْمَآءَ كُلَّهَا *"Ue al'leme Àdemel-esmàe kul'lehà…"* "Ai (Allahu) i mësoi Ademit të gjitha emrat…"[1]

Fjala e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* është vazhduese e këtyre ajeteve:

A pretendon se ti me të vërtetë je një trup i vogël

dhe te ty është mbështjellë bota më e madhe?

Të gjitha qeniet e botës së padukshme e të botës së dukshme, janë të krijuara për ta çuar këtë qenie të respektuar në pozitën e saj, ashtu siç ka ardhur në hadithet e nderuara: *"O bir i Ademit, unë i krijova sendet për ty dhe ty të krijova për veten Time."*

Kur njeriu mendon se sendet janë krijuar për atë dhe ka gjetur mënyrën e përdorimit të tyre për të mirën e tij e për çuarjen e vetes në plotësimin që ai meriton, atëherë njeriu e shikon të Vërtetin dhe di t'i përdorë dituritë në rrugën e përmirësimit. Në këtë pozitë, ai, me dritën e besimit, ka kuptuar edhe kolonat e tjera të mbështetjes. Prandaj për këtë qëllim madhor ai mbështetet vetëm në të Vërtetin e Lartësuar dhe merr për garant vetëm Qenien e Personit të Tij të Shenjtë.

Dhe, kur njeriu arrin në gradën e besimit deri në kufirin e qetësisë së zemrës, te kjo zemër ka rënë krejtësisht lëkundja e turbullimi. Zemra e tij ka gjetur qetësinë në të Vërtetin e Lartësuar e në veprimin e Tij, derisa njeriu vazhdon në këto kufi dhe ky realitet është pozita e shumicës. Në këtë pozitë njeriu sheh veprues dikë tjetër dhe jo Allahun e Lartësuar. Kur kjo pozitë tejkalohet me dritën e njohjes, ai gjen shkëlqim prej shkëlqimeve të besimit faktik se Allahu është Zoti Një e i vetëm (teuhid) dhe rrëzon veprimin e të gjitha qenieve, syri i tij nuk shikon asnjërën prej qenieve, syri i tij merr dritë në mbështetjen e të Vërtetit të Lartësuar.

Kur njeriu e kapërcen pozitën e shikimit të pranishëm, dëshmon shkëlqimin e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm. Por në këtë pozitë

[1] Sure "El-Bbekare", ajeti 31.

njeriu kupton se mbështetja e tij është me defekte, sepse mbështetje do të thotë vërtetim i punëve për veten e tij dhe bërjen e të Vërtetit garantues të punëve që kthehen te vetja e tij, prandaj delegimi i punëve (teukijl), mbështetja (tevek'kul) dhe përfaqësimi (vekàleh), nuk është në kundërshtim me fitimin.

Në të kundërt, lënia e fitimit dhe e vetëveprimit për shkak të mbështetjes, vjen prej mangësisë e prej injorancës.

Në të vërtetë, mbështetje do të thotë heqje dorë prej mbështetjes në shkaqet dhe kthim i shkaqeve te Bërësi i shkaqeve, por kjo gjithashtu nuk është në kundërshtim me rënien në shkaqet.

Kurse ajo që kanë thënë disa se prej gradave të *"mbështetjes"-"tevek'kul"* (mbështetjes së veçantë) është se ai që mbështetet, ecën nëpër shkretëtirë e nëpër stepa pa furnizime e pa mjet hipje, ngaqë ai, në këtë rrugëtim, mbështetet në Allahun e Lartësuar, me qëllim që të përmirësojë pozitën e *"mbështetjes"–"tevek'kul"*.

Këtë e lexojmë në transmetimin e përcjellë prej Ibràhijm Elkhavàs se Husejn bin Mensùr e pa atë të ecë nëpër stepat e thata dhe e pyeti për gjendjen. Ai i tha: *"Udhëtoj nëpër stepat e thata pa ujë e pa ushqim, që të vë në provë veten time, nëse unë kam apo nuk kam "mbështetje"-"tevek'kul" te Allahu."*

Atëherë Husejni tha: *"Kur ti e shpenzon jetën tënde në përjetimin e të brendshmes tënde, do të arrish në asgjësimin, në besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm."*[1]

Këta dy persona treguan se nuk kishin dijeni as për pozitën e teuhidit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm dhe as për pozitën e mbështetjes, sepse që të dy menduan se shëtitja nëpër shkretëtirë dhe dervishizmi janë "mbështetja"-"tevek'kul".

[1] Abdulkerijm Elkashijrij, "Err'rrisàletul-Kashijrij'jrtu", f. 264.

Lënia e punës dhe mosvënia në punë e fuqive që të ka dhënë i Vërteti i Lartësuar me pretendimin e teuhidit, vijnë prej injorancës për pozitën e teuhidit (besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm) dhe prej injorancës për pozitën e mbështetjes (tevek'kul), sepse e vërteta e teuhidit (besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm) është dituria për të vërtetën e të gjitha veprimeve morale dhe shikimi i bukurisë së të Vërtetit në pasqyrën e shumicës.

Po mbulimi në shumicën është në kundërshtim me teuhidin (besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm), pasi mbulimi nuk është vendqëndrim për qenien e njeriut në shkretëtirë, ose në ndonjë vend tjetër.

Ai që merr rrugën për te Allahu i Lartësuar, me qëllim që të përmirësojë pozitën e mbështetjes, duhet të shkëputet prej shkaqeve të dukshme dhe të mos kërkojë plotësimin e nevojave prej shkaqeve të dukshme e të mos e lërë punën.

Mund të përmendim thënien e Maksùd Khavàxheh Àrif El-Ensàrij: *"...dhe, grada e dytë e mbështetjes, krahas rrëzimit të kërkesës dhe mbylljes së syrit prej shkaqeve, është meditim për përmirësimin e mbështetjes."*[1], edhe pse shpjeguesi Elkàshànij në shpjegimin e tij nuk e ka kuptuar jo në këtë drejtim.

Në mënyrë të përgjithshme, bashkimi i kërkesës me punën në nevojat e vetvetes dhe nevojat e besimtarëve, ashtu siç është bërë e ditur, nuk është në kundërshtim me mbështetjen.

[1] Abdu-rr'rrez'zàk Elkàshànij, "Sherhu Menàzilu-s'sàirijne, f. 174.

NDARJA E PESTË

SHPJEGIMI: "MBËSHTETJA" – "TEVEK'KUL" ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE PREJ DOMOSDOSHMËRIVE TË NATYRËS SË PASTËR TË KRIJIMIT SHPJEGIMI PËR DËSHIRËN QË ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS E PREJ USHTRIVE TË IBLIJSIT DHE PREJ DOMOSDOSHMËRIVE TË NATYRËS SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Mësoje se prej shprehjeve pikante dhe të vërtetave që janë saktësuar me lapsin e fuqisë së përjetshme në natyrën e pastër të krijimit të mbarë familjes njerëzore dhe prej dispozitave të cilësisë së tharmuar në krijimin e njeriut, është edhe cilësia e të pasurit nevojë. Sikur të mblidheshin bashkë të gjithë njerëzit, pa përjashtim, e pa asnjë ndryshim në mendime, bazuar në të vërtetën e vetes dhe në origjinën e ekzistencës e të plotësimit të njeriut, secili prej njerëzve do të shikonte se ka nevojë dhe është i varfër, do të shihte se e vërteta e vetes së tij është e varur dhe e lidhur. Sikur të supozojmë se njeriu formon një varg pafund me nevojat që ka, çdo pjesë e këtij vargu pambarim, me një gjuhë të vetme, do të shpallnin hapur varfërinë e tij, do të pohonin hapur se ai ka nevojë, madje pasja nevojë është dispozitë vepruese në të gjitha qeniet e mundshme në të gjithë botën.

Sikur të formoheshin vargje pambarim prej kafshësh, bimësh, trupash të ngurtë, mineralesh, elementesh dhe të supozohet se njëri për këtyre individëve e pyet tjetrin: "A jeni të pavarur, nuk keni nevojë për ekzistencën, për plotësimin e për ndikimin që keni?", të gjithë do të përgjigjeshin, secili me gjuhën e gjendjes me të cilën është krijuar: "Ne kemi nevojë, jemi të pafuqishëm, jemi të varfër dhe jemi të lidhur."

Pas kësaj, sikur të pyetet një individ prej këtyre vargjeve pambarim të qenieve, me qëllim për të marrë informacion: "O varg pambarim prej të lumturve, o ti varg pambarim i atyre që jeni në vështirësi, o ti varg pambarim kafshësh dhe o ti varg pambarim bimësh, metalesh, elementësh, xhinësh, engjëjsh e të tjera qenie që i kalojnë pyetësit në mendje prej tërësisë së vargut të qenieve të mundshme, ju të gjithë sa jeni, a keni nevojë për një qenie tjetër? Çdo individ i atyre vargjeve pambarim do të përgjigjej me gjuhën e gjendjes me të cilën është krijuar: "Të gjithë ne kemi nevojë për një Qenie që nuk ka nevoja siç kemi ne dhe nuk është e varfër siç jemi ne.

Ne jemi nën ombrellën e një të Ploti që nuk është i ngjashëm me ne në vargun e të mundshmeve, kemi nevojë për një Qenie që të mos jetë nën ombrellën e një tjetri, por që është plotësisht i pavarur dhe i plotësuar. Ai që s'ka asnjë send prej vetes së tij, nuk është i pavarur në qenien e tij, në cilësitë e tij e në punët e tij. Ai ka nevojë e është i varfër nga të gjitha anët e ekzistencës. Një nevojtar i këtillë s'ka fuqi të plotësojë nevojat tona, s'ka fuqi të mbyllë mungesat tona dhe s'ka fuqi të na nxjerrë ne prej hiçit."

Sikur ne të detajojmë këtë natyrë krijimi dhe të shpjegojmë qartë dispozitën e saj, padyshim që do të vërtetohej se të gjitha emrat e cilësitë që gjenden në shtëpinë e vërtetimit, do të rezultojë se të gjitha këto janë prej plotësimeve absolute dhe të qëndrueshme vetëm në Personin e Shenjtë që është absolutisht pa nevoja.

Prej domosdoshmërive të natyrës së pastër të krijimit të njeriut është shpresa në Allahun e Lartësuar, frika prej madhështisë së Tij, mbështetja, dorëzimi, besueshmëria te Allahu i Lartësuar. Atëherë mësohet

se ai me të meta i drejtohet të Plotësuarit absolut që t'ia heqë të metën e t'i plotësojë nevojën që e ka nga vetë natyra e krijimit të tij dhe si specie.

Mbështetja te Allahu (tevek'kul) është prej ushtrive të mendjes dhe prej domosdoshmërive të cilësisë së pastër të krijimit, në atë mënyrë që e vërteta e dëshirës, shpreh shtrëngimin e fortë të rrethimit të kësaj bote e të punëve të saj dhe kapjes së shumtë pas shkaqeve. Në këtë gjendje shtrëngimi prej botës e prej punëve të saj, vetvetiu zemra orientohet kah banorët e kësaj bote, kah shumica dhe këtë kërkesë e lidh me padijen që ka për pozitën e Shenjtë të të Vërtetit të gjithëfuqishëm, e lidh me padijen që ka për fuqinë e Tij të plotë dhe për butësinë e për mëshirën e Tij.

Një individ i këtillë është i mbuluar e s'ka dijeni për të Vërtetin e Lartësuar, prandaj ai i drejtohet shkaqeve të zakonshme dhe i shikon shkaqet e zakonshme sikur ato janë të pavarura, për rrjedhojë kapet pas atyre shkaqeve me punë e me zemër dhe ndërpret lidhjen me të Vërtetin. Por me këtë ndërprerje të lidhjes ai largon prej vetes qetësinë e sigurinë dhe vendin e qetësisë e të sigurisë te ai e zë trazira e lëkundjet. Kur njeriu nuk i plotëson nevojat që ka prej shkaqeve të zakonshme, flakët e zjarrit të dëshirës së tij të tejndezur nuk shuhen, atëherë në të shtohet gjendja e trazimit, shtohet gjendja e rrethimit dhe e kapjes pas kësaj bote e pas mbështetjes në banorët e botës, derisa njeriu mbytet në tërësinë e kësaj bote.

Dihet se dëshira me kërkesat e saj është bashkëshoqëruese e mbulimit të cilësisë së krijimit, është prej ushtrive të injorancës, është prej ushtrive të Iblijsit, është vetë e keqja, është prej domosdoshmërive të ligësisë, që përfundon vetëm në ligësi. Sado pak të afrohet njeriu me këtë botë, ajo e largon atë prej të Vërtetit të Lartësuar e prej kapjes pas Qenies së Tij të Shenjtë. Pikërisht kapja pas kësaj bote e bën njeriun të distancuar prej të Vërtetit të Lartësuar.

NDARJA E GJASHTË

LAVDËRIMI I MBËSHTETEJES TE ALLAHU DHE QORTIMI I DËSHIRËS NË HADITHE

Allahu i Lartësuar, duke përshkruar cilësitë e besimtarëve në suren "El-Enfal" thotë:

إِنَّمَا ٱلْمُؤْمِنُونَ ٱلَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ ٱللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ ءَايَٰتُهُۥ زَادَتْهُمْ إِيمَٰنًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ ٢

"In'nemel-muëminùne-l'ledhijne idhà dhukire-ll'llàhu vexhilet kulùbuhum ue idhà tulijet alejhim àjàtuhu zadet'hum ijmànen ue alà rab'bihim jetevek'kelùne"

"Besimtarë të vërtetë janë ata që u rrëqethen zemrat kur atyre u përmendet Allahu dhe kur atyre u lexohen ajetet e Tij, atyre u shtohet besimi, ata janë mbështetur vetëm në Zotin e tyre", deri sa përfundon në frazën:

أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُؤْمِنُونَ حَقًّا *"ulaike humul-muëminùne hak'kan…"* "Të këtillë janë besimtarë të vërtetë…"[1]

Allahu i Lartësuar njofton në mënyrë të përmbledhur se besimtarët janë brumosur me këto cilësi, kurse të tjerët që nuk i kanë këto cilësi, nuk janë besimtarë.

Prej tërësisë se cilësive të besimtarëve, të përmendura në ajetin e nderuar, rezulton se besimtarët bazohen e mbështeten në Zotin e tyre, punët e tyre i lënë në dorën e Tij, zemrat e tyre janë të lidhura me Qenien e Tij të Shenjtë. Kurse ata që ia kanë dhënë zemrat e tyre një tjetri dhe jo

[1] Sure "El-Enfal", ajetet 2 dhe 4.

Allahut, pika e mbështetjes së tyre është në një qenie tjetër dhe jo i Vërteti i Lartësuar.

Për më tepër, ata edhe punët e tyre ia referojnë një tjetri dhe jo Allahut të Lartësuar. Gjithashtu edhe shpëtimin e vetes e kërkojnë prej atij tjetrit e jo prej të Lartit. Të këtillë s'kanë asgjë prej të vërtetës së besimit e dritës së besimit. Ky ajet i nderuar dhe ajetet e tjera me këtë përmbajtje, janë dëshmuese të asaj që kemi thënë më sipër. Patjetër kjo gjendje është për shkak se, kur njeriu nuk ka arritur në shkallën e besimit, ai kurrë nuk arrin në gradën e mbështetjes (tevek'kul). Në lidhje me këtë çështje i Larti njofton në suren "Et-Tegàbun:

اَللَّهُ لآ إِلَهَ إِلاَّ هُوَ وَعَلَى اللهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ

"All'llahu là ilàhe il'là huve ue ale-ll'llàhi feljetevek'kelil-mu'minùne" "Allahu, s'ka zot tjetër përveç Tij, prandaj besimtarët le të mbështeten vetëm në Allahun."[1] dhe ajo që ka përmendur i Larti për atë që e bën fjalën madhore "تَوْحِيْدْ" *"teuhijd"* "Njëtim i Allahut", hapin e parë. Pas këtij hapi Ai urdhëron, duke e vënë theksin mbi faktin se besimtarët mbështeten në Allahun e Lartësuar. Pikërisht cilësia e tyre e mbështetjes në të Vërtetin ka mundësi të jetë një tregues për një shkallë më të lartë se pozita e parë dhe për arritjen e kësaj shkalle Allahu i urdhëron besimtarët të mbështeten te Ai. Veç kësaj, në ajetin e mësipërm, pamë se mbështetja në Allahun ishte prej cilësive të veçanta të besimtarëve.

Ka mundësi që përmendja e fjalës "تَوْحِيْدْ" *"teuhijd"* "Njëtim i Allahut" të theksojë atë që thamë me sipër se, pas pozitës së besimit e plotësimit të besimit, shkëlqen teuhidi faktik në zemrën e atij që ka marrë rrugën për te Allahu dhe, në sajë të këtij shkëlqimi, ai kupton se nuk ka asnjë qenie prej qenieve që adhurohen të jetë vepruese në mbretërinë e të

[1] Sure "Et'-Tegabun", , ajeti 13.

Vërtetit të Lartësuar, sepse vetëm Ai është Vepruesi i vetëm dhe vetëm Ai është Ndikuesi, prandaj askush në botën e ekzistencës përveç të Vërtetit nuk mund të sjellë as dëm e as dobi.

Me këtë besim praktikuesi arrin në një shkallë më të lartë të mbështetjes, ashtu siç e ka shpjeguar vetë i Larti në suren "Al- Imran":

فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى ٱللَّهِۚ إِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلْمُتَوَكِّلِينَ ١٥٩

"…feidhà azemte fetevek'kel ale-ll'llàhi, in'ne-ll'llàhe juhib'bul-mutev'ek'kilijne" "dhe, kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, padyshim që Allahu i do ata që i mbështeten."[1]

Ka shumë mundësi që kjo gradë të jetë shumë më e lartë se pozita e mbështetjes, gradë të cilën ne nuk e kemi përmendur me përpara. Kjo gradë është mbështetja që praktikuesi e arrin pas pozitës së asgjësimit, kthimit në mbretërinë e të Vërtetit dhe qëndrimit me Allahun. Praktikuesi në këtë pozitë është në gjendjen kur ai bie në shumicën dhe është i zhytur në teuhidin e grupit, është një gjendje kur ai i sheh veprimet e qenieve me detaje e me imtësi. Në këtë gjendje ai nuk sheh ndonjë qenie tjetër që të jetë vepruese përveç të Vërtetit.

Këtu qëndron edhe shkaku që i Vërteti i Lartësuar e urdhëroi të Dërguarin e Tij me këtë pozitë: إِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلْمُتَوَكِّلِينَ *"…in'ne-ll'llàhe juhib'bul-mutevek'kilijne"* "...padyshim që Allahu i do ata që i mbështeten." Me këtë frazë të ajetit Ai ka saktësuar gradën e dashurisë për ata që mbështeten te Allahu i Lartësuar.

Prej teksteve është edhe transmetimi i ardhur prej argumentit të besueshëm të Islamit, shehut të nderuar Elkelijnij *(Allahu e mëshiroftë!)* i cili citon fjalën e Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!): "Pasuria e madhështia

[1] Sure "Al-Imran", ajeti 159.

shëtisin dhe, kur ato të dyja dalin triumfuese në pozitën e mbështetjes, të dyja hedhin hapin e parë."[1]

Pasuria, mospasja nevojë, madhështia e shpirtit dhe plotësimi shpirtëror, të gjitha këto vijnë në sajë të mbështetjes në të Vërtetin e Lartësuar. Ai që i afrohet të Pasurit absolut, ai që arrin të këtë lidhje zemre me Allahun e Lartësuar dhe nuk shikon të plotësojë dëshirat e tij prej një të krijuari nevojtar, përjeton në zemrën e tij mospasjen nevojë prej një të krijuari dhe që të bëhet i kamur me këtë të krijuar. Ky person përjeton në zemrën e tij madhështi, respekt e bujari.

Në lidhje me varfërinë e plotë, poshtërimin, pamundësinë, qëndrueshmërinë ndaj dëshirës e lakmisë dhe shpresën prej një të krijuari, Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَن يَتَوَكَّلْ عَلَى ٱللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُۥٓ

"…ue men jetevek'kel ale-ll'llàhi fehuve hasbuhù…" "…dhe kush mbështetet në Allahun, Ai i mjafton atij…"[2]

Në këtë ajet të nderuar i Larti e veçon mbështetjen në Allahun (tevek'kul) dhe përjashton mbështetjen mbi një të krijuar. Mbështetja në Allahun e Lartësuar është maja më e lartë e madhështisë shpirtërore dhe e mospasjes nevojë prej ndonjë tjetri. Gjithashtu, me argument të ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: *"Atij që i janë dhënë tri, nuk i ndalohen tri: atij që i është dhënë lutja, i është dhënë edhe pranimi i lutjes; atij që i është dhënë falënderimi, i është dhënë edhe shtimi; atij që i është dhënë mbështetja në Allahun (tevek'kul), i është dhënë mjaftimi me këtë mbështetje." Pastaj ai tha: "A e ke lexuar në librin famëlartë të Allahut:* وَمَن يَتَوَكَّلْ عَلَى ٱللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُۥٓ *"…ue men jetevek'kel ale-ll'llàhi fehuve hasbuhù…"* "…se kush mbështetet në Allahun, ai i mjafton atij…";

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 32, K. 32 prej librit "El-ijmànu uelkufru", Paragrafi 3.
[2] Sure "Et-Talàk", ajeti 3.

dhe: لَئِن شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ *"…ue lein shekertum le'ezijden'nekum…"* "…nëse ju falënderoni, patjetër Unë do t'ua shtoj (të mirat)…"[1]

dhe: ٱدْعُونِيٓ أَسْتَجِبْ لَكُمْ *"…ud'ùnij estexhib lekum…"* "…më thirrni Mua dhe Unë u përgjigjem…"[2][3]

Citohet prej Musa bin Xhaferit *(Paqja qoftë mbi të!)*, përcjellësi i transmetimit: "e pyeta atë për fjalën e Allahut të Lartësuar:

وَمَن يَتَوَكَّلْ عَلَى ٱللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُۥٓ *"…ue men jetevek'kel ale-ll'llàhi fehuve hasbuhù…"*

"…dhe kush mbështetet në Allahun, Ai i mjafton atij…" dhe ai tha: *"Mbështetja në Allahun ka shkallë, prej të cilave është mbështetja në Allahun në të gjitha punët tuaja; me ato që të bëhen, ti je i kënaqur prej Allahut dhe ti e di mirë se për ty e mira e nderimi, në të gjitha këto, gjykimi i takon vetëm Allahut, prandaj ti mbështetesh në Allahun e Lartësuar. Me këtë mbështetje ti e le të gjithën në dorën e Allahut, beson vetëm në Allahun dhe përveç Allahut nuk ke siguri e nuk ke besim në asnjë tjetër."*[4]

Në këtë hadith të nderuar janë përmendur dy kolona prej kolonave të mbështetjes në Allahun e Lartësuar (tevek'kul). Njëra prej këtyre dy kolonave është që njeriu të dijë se Allahu i Lartësuar kurrë nuk e pakëson dërgimin e të mirës e të virtytit te ai. Kolona e dytë është se gjykimi në të gjitha punët i takon vetëm të Vërtetit të Lartësuar, se Ai e askush tjetër është Zotëruesi i fuqisë së plotë gjithëpërfshirëse dhe se të gjitha punët janë vetëm në dorën e Allahut të Lartësuar.

Mbase imam Musa bin Xha'fer *(Paqja qoftë mbi të!)* në këtë hadith ka theksuar qartë të gjitha kolonat e mbështetjes në të Vërtetin (tevek'kul) e Lartësuar, për faktin kur shpjegon lënien e të gjitha punëve në dorën e të

[1] Sure "Ibrahim", ajeti 7.
[2] Sure "Gafir", ajeti 60.
[3] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 32, K. 32 prej librit "El-ijmànu uelkufru", Paragrafi 6.
[4] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 53, K. 32.

Vërtetit të Lartësuar. Por kjo lënie e punëve në dorën e Tij kërkon që Ai të ketë dituri për të gjitha punët, krahas faktit tjetër se Ai kurrë nuk e pakëson të drejtën që i takon robit, kurrë nuk tregohet koprrac ndaj robit dhe kurrë nuk ia ndalon atij furnizimin.

Në librin "Mustedrekul-Vesàili", prej thënieve të quajtura "Xha'ferij'àt", me përcjellës të besuar prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!), lexojmë se ai ka thënë: *"Besimi mbështet mbi katër kolona: mbështetja (tevek'kul) në Allahun, lënia e punëve në dorën e Tij, dorëzim para urdhrit të Allahut të Lartësuar dhe mbetja i kënaqur me vendimin e Allahut."*[1]

Duhet të dihet se besimi është me një shkallë dhe kjo shkallë është origjinë e kolonë për të këtilla cilësi shpirtërore, si dhe për gjendjet e mira të zemrës. Këtë gjë e kemi përmendur edhe më përpara.

Të gjitha këto që u thanë janë prej kolonave të besimit (imanit) dhe vetëm me këto punë besimi mbetet i ruajtur. Në të vërtetë, me ekzistencën e këtyre moraleve, në kuptimin se me arritjen e njërës prej shkallëve të besimit, arrihen këto cilësi. Kur në shpirt arrihen këto cilësi e virtyte, ato lartësohen me njeriun në një shkallë më të plotësuar të besimit. Shkalla më e lartë e besimit vjen prej shkallës së plotësuar të këtyre cilësive. Ja kështu, secila prej shkallëve mbështetet në shkallën tjetër. Ky shpjegim mbledh së bashku përmbajtjen e shumë ajeteve të nderuara të Kur'anit Famëlartë dhe shumë prej transmetimeve të nderuara.

Në librin "El Mustredek", sipas përcjelljes së Ebu Besijrit, prej Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!) lexojmë: *"Ai më tha mua: 'S'ka asnjë send që nuk ka një kufi." Unë i thashë: "Cili është kufiri i mbështetjes (tevek'kul) te Allahu?" Ai më tha: "Bindja." Kur unë e pyeta se cili është kufiri i bindjes, ai u përgjigj: "Të mos kihet frikë asgjë së bashku me Allahun."*[2]

[1] En'nùrij, "Mustedrekul-Vesàili", vëll. 11, f. 215; K. "Xihàdu-n'nefsi", hadithi 1 dhe "El Xha'ferij'àt", f. 232, K. "Elbirru ue sekhàu-n'nefsi".
[2] "Mustedrekul-Vesàili", vëll. 11, f. 215, K. 11, Hadithi 2.

Kufiri i sendit është aty ku përfundon sendi. Mbase qëllimi këtu është që mbështetja (tevek'kul) përfundon në bindjen e thellë e në diturinë e vërtetë, njëkohësisht edhe vetë i mbështeturi është në pozitën e bindjes së thellë e të diturisë së vërtetë. Gjithashtu, edhe bindja e thellë e dituria e vërtetë përfundojnë në Njëtimin praktik të Allahut të Lartësuar (et'teuhijdul-fiëlij), në atë mënyrë që i mbështeturi nuk shikon as dëmtues, as dobisjellës, as ndikues e as caktues tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar.

Ka shumë mundësi që mbështetja në të Vërtetin (tevek'kul) të jetë e mbështjellë dhe e kufizuar me bindjen e thellë e me diturinë e vërtetë, sepse pa realizimin e bindjes së thellë e të dijes së vërtetë (jekijn), konkretisht nuk realizohet mbështetja (tevek'kul) në të Vërtetin.

Por, vetë bindja e thellë e dituria e vërtetë janë frutat e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) dhe janë të kufizuara në këtë besim.

Mbase çdo njëri prej këtyre dy kuptimeve është i saktë sipas ndryshueshmërisë së shkallëve. Në librin "El Mustedrek", sipas përcjelljes së Ebu Dherr'rrit *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)* lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* i ka thënë atij: *"O Ebu Dherr'rr, që të jesh më i fuqishmi i njerëzve, mbështetu te Allahu."*[1]

Në të njëjtin libër prej Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Kush dëshiron të jetë njeriu më i devotshëm, le të mbështet te Allahu."*[2]

Gjithnjë në "Elmustedrek" lexojmë: *"Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) e pyeti Xhibrijlin për komentimin e fjalës mbështetje (tevek'kul). Ai tha: "Është prerja e shpresës prej të krijuarve, të dijë se i krijuari as nuk dëmton e as nuk sjell dobi, as nuk jep e as nuk ndalon dhënien."*[3]

---

[1] "Mustedrekul-Vesàili", vëll. 11, f. 216, K. nr. 11, Hadithi 3.

[2] I Njëjti burim, f. 217, Hadithi 6.

[3] "Mustedrekul-Vesàili", vëll. 11, f. 218, Hadithi 13.

Ky është interpretimi i njërës prej domosdoshmërive të mbështetjes në Allahun (tevek'kul), në të njëjtën kohë është prej punëve paraprake të realizimit të mbështetjes (tevek'kul), në kuptimin që njeriu, derisa nuk heq dorë prej orientimit kah njerëzit, derisa nuk largohet prej shtëpisë së natyrës e të shumicës, kurrë nuk do ta forcojë zemrën e tij, që të orientohet kah i Vërteti i Lartësuar dhe kurrë nuk do të arrijë në shtëpinë e shpirtërores e të unitetit.

Në lidhje me këtë çështje, në librin "Irshàdul-kulùb", prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!), prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: "Duke njoftuar punët e miraxhit, ai ka thënë: *"O Zot, cila është puna më e vlerësuar?" Allahu i Gjithëfuqishëm tha: "O Ahmed, s'ka asgjë më të vlerësuar te Unë se sa mbështetja te Mua dhe se sa kënaqësia me atë që Unë kam pjesëtuar."*[1]

Hadithet që flasin për çështjen e mbështetjes (tevek'kul) te Allahu janë të shumta.[2]

Këtu do ta mbyllim këtë kapitull. Vetëm prej Allahut të Lartësuar kërkojmë mbarësinë për arritjen e kësaj karakteristike të veçantë dhe të gjithë punën e mbështesim vetëm në të Vërtetin e Lartësuar.

Veç kësaj, këtë mbështetje e bëjmë në mbyllje të këtyre etapave që s'kanë mbarim, ashtu siç i pamë më sipër në ajetet e nderuara:

وَمَن يَتَوَكَّلْ عَلَى ٱللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُۥٓ *"…ue men jetevek'kel ale-ll'llàhi fehuve hasbuhù…"*
*"…*dhe kush mbështetet në Allahun, Ai i mjafton atij*…"* dhe

[1] I njëjti burim, f. 220, Hadithi 18; Ed'delejmij, "Irshàdul-kulùb", vëll. 1, f. 198, K. 55.

[2] Lexo "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 83, K. "Et'tefvijdu uet'tevek'kelu alejhi"; "Bihàrul-Envàr", vëll. 68, f. 98.

إِنَّ اللَّهَ بَالِغُ أَمْرِهِ قَدْ جَعَلَ اللَّهُ لِكُلِّ شَيءٍ قَدْراً *"...in'ne-ll'llàhe bàligu emrihi kad xheale-ll'llàhu likul'li shej'in kaden"* "…Padyshim që Allahu e realizon punën e Tij dhe për çdo send Allahu ka caktuar një kohë."

PLOTËSIM

Tani u mësua e vërteta e mbështetjes në Allahun e Lartësuar (tevek'kul), u mësua edhe dëshira që ishte e kundërta e mbështetjes. Ne dimë sa e ulët është dëshira si njëra prej ushtrive të mëdha të injorancës dhe e ushtrive të Iblijsit. Gjithashtu, u mësua se ndikimi i kurtheve të Iblijsit mbi bijtë e Ademit, është fare i pakët të jetë si ndikimi i tij mbi ta.

Ndikimi i Iblijsit vjen prej paditurisë për të Vërtetin e Lartësuar, vjen prej paditurisë për Njëtimin e Allahut (teuhijd), për emrat, për cilësitë dhe për rrjedhën e vendimit hyjnor.

Ai që ka këtë moral të keq e këtë karakteristikë të veçantë shkatërruese, është i shkujdesur ndaj Allahut të Lartësuar, ndaj fuqisë e mirësive të Tij. Ai s'ka pjesë në sjelljen e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, prandaj ai arrin vetëm në kufirin e vënies shok Allahut (shirk), e në kufirin e mohimit (kufr), sepse të gjitha punët e tij paraprake e të gjitha themelet e tij janë vendosur mbi injorancën. Mirëpo injoranca, ashtu siç kemi thënë më sipër, është mbulim i cilësisë së krijimit. Prandaj këto vese të liga numërohen prej shoqëruesve të cilësisë së mbuluar të krijimit dhe prej ushtrive të injorancës. Kjo karakteristikë shkatërruese e orienton njeriun drejt kësaj bote. Ajo bën që rrënjët e dashurisë për këtë botë të zënë vend në zemrën e tij.

Gjithashtu, kjo karakteristikë ia zbukuron atij në zemër gjërat e bukura të kësaj bote dhe bën që ai të ketë morale jo të lavdërueshme e të manifestojë sjellje jo të kënaqshme, siç janë koprracia, babëzia, zemërimi, moskryerja e të drejtave hyjnore të obliguara, prerja e lidhjeve me të afërmit,

heqja dorë prej lidhjes me vëllezërit besimtarë e të ngjashme me këto, në atë mënyrë që çdo njëra prej këtyre sjelljeve të liga bëhet dhe është një shkak i pavarur për shkatërrimin e njeriut.

Tani do të përmendim disa ajete të Kur'anit Famëlartë dhe disa transmetime të nderuara, që flasin për këtë çështje, duke shpresuar që të tërhiqet vëmendja e shpirtit lakmues për këtë botë.

Allahu i Lartësuar thotë:

كَلَّآ إِنَّهَا لَظَىٰ ١٥ نَزَّاعَةً لِّلشَّوَىٰ ١٦ تَدْعُواْ مَنْ أَدْبَرَ وَتَوَلَّىٰ ١٧ وَجَمَعَ فَأَوْعَىٰٓ ١٨
۞إِنَّ ٱلْإِنسَٰنَ خُلِقَ هَلُوعًا ١٩ إِذَا مَسَّهُ ٱلشَّرُّ جَزُوعًا ٢٠ وَإِذَا مَسَّهُ ٱلْخَيْرُ مَنُوعًا ٢١

"Kel'là, in'nehà ledhà. Nez'zàaten lish'shevà. Ted'ù men edbere ue tevel'là. Ue xhemea fe'euà. In'nel-insàne khulika helùan. Idhà mes'sehu-sh'sherr'rru xhezùan. Ue idhà mes'sehul-khajru menùan"

"Jo, kurrsesi, ajo (paraja) është flaka (e Xhehen'nemit). Ajo heq kapakët e kokës. Ajo e tërheq (drejt vetes) atë që është zmbrapsur e larguar (prej besimit) dhe që ka grumbulluar (pasuri) dhe e ka fshehur. Vërtet njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Dhe, kur atë e godet një e keqe, ai ankohet së tepërmi. Dhe, kur atij i vjen e mira, ai bëhet shumë koprrac."[1]

I Madhëruar e i Lartë është vetëm Allahu. Me këto fraza të shkurtra nuk është e mundur të shpjegohen e të vishen me rrobën e komentimit me ndonjë shpjegim tjetër më të përsosur. Nëse do të shpjegoheshin me ndonjë tjetër komentim, padyshim që do të ishin me mangësi në hollësitë e shprehjeve e në ndikimin që këto shprehje kanë në shpirt.

Fjala e parë e këtij ajeti "كَلَّآ" *«Kel'là"* "Jo, kurrsesi" ka lidhje me ajetet e mëparshme, në kuptimin se asnjë send s'ka mundësi të shpëtojë njeriun prej ndëshkimit në atë ditë të ashpër, edhe sikur ai, për të shpëtuar veten, të japë për kompensim të gjithë njerëzit e familjes dhe fëmijët e vet.

[1] Sure "El-Mearixh", ajetet 15-21.

Madje edhe sikur të japë çdo gjë është në këtë botë, përsëri asgjë nuk e shpëton atë.

Zjarri i Xhehenemit është i tejndezur. Nga flakët e zjarrit të Xhehenemit mishi, lëkura, nervat e damarët do të ndahen prej kockës disa herë dhe pastaj ato zënë vend përsëri. Kjo është ajo shkëndija që e tërheq drejt vetes atë që i ka kthyer shpinën të Vërtetit dhe që ka mbledhur pasuri dhe e ka fshehur atë. Fakti që njeriu është krijesë me dëshira, bën që, kur atë e prek e keqja, ai tregohet i paduruar dhe, kur është në gjendje të mirë, ai nuk jep prej asaj që i është dhënë. Gjithashtu, ai nuk plotëson detyrimet e urdhëruara hyjnore. Natyrisht që një njeri i tillë, as krijesave nuk ia jep të drejtën që i takon.

Le të mësohet se, kur natyra e krijimit është e mbuluar, ajo i bëhet njeriut një natyrë e dytë. Këtë e shpjegon ajeti i sipërm: إِنَّ ٱلۡإِنسَٰنَ خُلِقَ هَلُوعًا *"In'nel-insàne khulika helùan"* "Vërtetë njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm" dhe kjo nuk është në kundërshtim me atë që brumi me të cilin është gatuar njeriu është paqe e shpëtim.

Edhe transmetimet e nderuara për këtë çështje janë të shumta. Por ne do të mjaftohemi të përmendin vetëm disa prej tyre.

Në librin "El Kàfij", me përcjellës prej Ebù Abdullahut, Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ebù Xhaferi (a.s.) ka thënë: "Ai që dëshiron këtë botë, është i ngjashëm me krimbin e mëndafshit, i cili, sa më shumë të shtojë nga mëndafshi që nxjerr dhe me të cilin pështjell veten, aq më larg mundësisë për të dalë jashtë do të jetë, derisa të vdesë i mbyllur."*

Gjithashtu, përcjellësi tregon se Ebu Abdullahu *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Pasuria më e madhe është kur njeriu nuk bëhet rob i dëshirave."[1]

Prej imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!), në librin "Elvesàil", lexojmë: *"Ai që ka dëshira, është privuar prej dy cilësive që i shoqërojnë dy punë: ai është i privuar prej kënaqjes me atë që ka dhe për këtë atij i hiqet qetësia. Gjithashtu*

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 238, K. 116, Hadithi 7.

është i privuar prej kënaqësisë prej vendimit të Allahut dhe për këtë ai e humb bindjen e thellë dhe diturinë e vërtetë."[1]

Në librin "Mustedrekul-Vesàili", prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Biri i Ademit thinjet dhe njëherësh me atë thinjen dy karakteristika: dëshira për pasuri dhe dëshira për të jetuar."*[2]

Kur është pyetur Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, se cila karakteristikë është më shumë e ulët, ai ka thënë: *"Dëshira për pasuri."*[3]

Në librin "Tuhuful-ukùl", prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*, në porosinë që ai i la Imam Hsejnit *(Paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë*: "O bir, dëshira është fillimi i lodhjes. Ajo është kali që ti i ke hipur. Dëshira të thërret që të sulesh në mëkatet dhe babëzia është bashkimi i të gjitha të këqijave e të metave."*[4]

[1] "Vesàilu-sh'shij'ah", vëll. 16, f. 20, K. 64, Hadithi 4

[2] "Elmustedrek", vëll. 12, f. 59, K. 64, Hadithi 2.

[3] I njëjti burim, f. 59, Hadithi 4.

[4] "Tuhuful-ukùl", f. 60

QËLLIMI I DHJETË E I NJËMBËDHJETË

DHEMBSHURIA E MËSHIRA DHE E KUNDËRTA E KËTYRE TË DYJAVE, ASHPËRSIA E ZEMRIMI NË KËTË KAPITULL KA DISA NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI I DHEMBSHURISË DHE I ASHPËRSISË

Gjuhëtarët e letrarët mendojnë se fjala "رَأْفَةٌ" *"re'fetun"* "dhembshuri", shpreh kuptimin: *mëshira e plotësuar* dhe shtojnë se dhembshuria është më e butë se mëshira. Kurse El-Xheuherij'ji ka thënë: "Dhembshuria është më e fuqishme se mëshira."

Në rrethet akademike thonë se fjala *i dhembshuri* do të thotë me mëshirë të fuqishme dhe se dhembshuria është më e butë se mëshira. Disa studiues e filozofë kanë thënë se dhembshuria e mëshira janë të përafërta. Kurse e kundërta e dhembshurisë dhe e mëshirës janë ashpërsia e zemërimi. Gjithashtu, dhembshuria e mëshira janë komentuar me zemërbutësinë.

Ashtu siç është mëshira një gjendje morale për zemrën, domethënë për shpirtin, dhembshuria është një gjendje trupore për zemrën. Po kështu

edhe zemërimi është një gjendje shpirtërore, ashtu siç është edhe ashpërsia një gjendje rubineti për zemrën.[1]

Me kaq e përfundojmë fjalën për shpjegimin e kuptimit gjuhësor të fjalës dhembshuri.

Dhembshuria e ashpërsia janë dy gjendje trupore rubinet për zemrën, megjithëse nga ana e dukshme ky shpjegim nuk rezulton të jetë i vërtetë, sepse çdo njëra prej këtyre dy gjendjeve janë prej punëve morale e nuk kanë të bëjnë me punët trupore, por janë shoqëruese të kuptimit e rregulluese të kuptimit, ato janë të pastra e shumë larg horizontit të punëve të trupit e punëve trupore.

Dhembshuria është më afër horizontit trupor se mëshira, thënë ndryshe: mëshira është prej cilësive të shpirtit nga ana e fshehtësisë së saj hyjnore. Kurse dhembshuria është prej cilësive të shpirtit dhe shpreh anën e tij të dukshme dhe ka mundësi që të shprehet me pozitën e zemrës.

Le të bëhet e ditur se butësia, si shoqëruese e impersionimit, s'ka të bëjë me të vërtetën e dhembshurisë e të mëshirës. Këto të vërteta, si të gjitha të vërtetat ekzistuese, ndryshojnë sipas ndryshimit të formës së krijimit, shkallëve e pozicioneve.

Gjithashtu, të ndryshme janë edhe dispozitat e dhembshurisë me kërkesën. Po kështu, edhe e vërteta e diturisë, e fuqisë së jetës, janë prej bazave të cilësive të plotësuara ekzistenciale.

Dispozitat e këtyre cilësive ndryshojnë sipas shkallëve dhe etapave ngritëse e zbritëse të shkallëve të diturisë, të fuqisë e të jetës, detyrimisht të përjetshme e të përhershme nga pozitat zbritëse impresionuese ripërtëritëse, të ardhura e të drejtuara me tjetrin. Ky ndryshim është prej rrjedhojave të ndryshimit në të vërtetën e ekzistencës. Dhe, nga parashtrimi i kësaj të vërtete, rezulton edhe kjo ekspoze e gjerë. Patjetër kjo është argumentuar dhe është vërtetuar në vendin përkatës.[2]

---

[1] Sadrud'dijn Esh'shijràzij, vëll. 1, f. 435.
[2] Lexo "El-Esfârul-erbeah", vëll. 1, f. 71, Pjesa 7.

Bazuar mbi këto që u thanë, e vërteta e dhembshurisë, e mëshirës, e simpatisë e të ngjashme më këto, janë të ndryshme në gjykimin e në ndikimin që ato kanë sipas krijimit të ekzistencës dhe sipas shkallëve zbritëse e ngjitëse. Kështu është edhe në krijimin zbritës të natyrës së shoqëruar me impresionimin e me ndikimin. Por kjo nuk është domosdoshmëri që të jetë gjykim në të gjitha krijesat, prandaj ne kemi nevojë për interpretimin e këtyre emrave që thuhen në lidhje me Personin e Qenies së Shenjtëruar të të Vërtetit të Lartësuar, sipas renditjes së gjurmëve që ato lënë.

Ose ne mund të themi se kuptimi i fjalës dhembshuri e të Vërtetit të Lartësuar dhe simpatia e Tij, është trajtimi i besimtarëve me dhembshuri e me simpati prej personit të shenjtëruar të të Vërtetit të Madhëruar. E njëjta gjë është edhe në lidhje më emrat e bukurisë.

Por këto interpretime, duke shtuar edhe ftohtësinë që ato kanë në brendësi, janë interpretime në kundërshtim me argumentin. Është e habitshme që studiuesi e filozofi i madh, pika referuese për teologët *(Allahu e shenjtëroftë sekretin e tij!),* ka rënë në pozitën e këtij interpretimi të ftohtë dhe, në librin "Sherhu Usùlul-Kàfij", thotë: "Kur Allahu përshkruhet me cilësinë e dhembshurisë e të mëshirës, duhet të mbahet parasysh se, prej emrave të Tij, janë edhe dy emrat e bukur "i Dhembshuri" e "Mëshirëploti".

Por ky përshkrim, me këto dy cilësi, vjen në një anë më të lartë e më të nderuar dhe shpreh dukuritë e ndikimet. Po kështu qëndron çështja edhe me zemërimin që i atribuohet Atij, duke vënë në konsideratë çdo gjë del prej Tij, në lidhje me armiqtë e Tij."[1]

Fraza: "...përshkrimi i personit të Tij të Shenjtëruar, nga një anë më e lartë e më e nderuar.", tregon atë që kemi përmendur. Kurse fraza tjetër e tij "kur vihet në konsideratë ana e dukshme", tregon të njëjtën gjë me mënyrën e alegorisë popullore.

Bazuar mbi këto që u thanë, është më mirë që fraza të ishte "ose ishte", pasi kjo tregon një ekspoze, kurse me frazën "dhe ishte", puna bëhet më e lehtë.

[1] "Sherhu Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 435.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: NDIKIMI I DHEMBSHURISË

Mëso se mëshira, dhembshuria, simpatia e të ngjashme me këto, janë prej shkëlqimeve të emrave të bukur hyjnorë, janë cilësi, të cilat Allahu i Lartësuar i ka dhënë në përgjithësi për kafshët e për njeriun, me veçantinë për të ruajtur llojet e kafshëve dhe për të ruajtur llojin e familjes njerëzore e sistemin e saj. Ky është shkëlqim prej mëshirës gjithëpërfshirëse, mbi të cilën është themeluar sistemi i botës së ekzistencës.

Sikur të mos ishte kjo mëshirë e kjo simpati te kafshët e te njerëzit, me siguri që do të këputeshin lidhjet e jetës individuale e shoqërore. Me këtë dhembshuri e me këtë mëshirë kafsha ruan të vegjlit e saj e kujdeset për ta.

Gjithashtu edhe njeriu, me këtë dhembshuri e me këtë mëshirë, ruan familjen e tij. Edhe mbreti i drejtë, në sajë të kësaj dhembshurie e mëshire, ruan mbretërinë e tij.

Sikur të mos ishte kjo mëshirë dhe kjo dhembshuri, e shoqëruar me keqardhje, nëna kurrë nuk do të përballonte vështirësitë e lodhjet e mëdha për ruajtur e për të rritur të vegjlit e saj.

Kjo është forca tërheqëse e mëshirës dhe e dhembshurisë hyjnore. Drejt kësaj mëshire e kësaj dhembshurie tërhiqen zemrat dhe me këtë mëshirë e dhembshuri, në sajë të natyrës së pastër të krijimit, zemrat ruajnë sistemin e kësaj bote.

Kjo mëshirë e kjo dhembshuri na ka hedhur në vështirësi të mëdha e në lodhje pafund ne mësuesit shpirtërorë dhe, në radhë të parë, të gjithë profetët e mëdhenj, të gjithë eulijatë e nderuar dhe të gjithë ata që kanë

arritur gradën e njohjes së Allahut. Të gjitha këto vështirësi e lodhje janë përballuar me qëllimin e lartë, për të lumturuar specien tonë njerëzore dhe për të sjellë gëzim të përhershëm në familjen njerëzore.

Padyshim që zbritja e shpalljes hyjnore dhe zbritja e Librit qiellor Famëlartë, janë forma të dhembshurisë e të mëshirës, madje edhe të gjitha dispozitat ligjore, duke përfshirë llojet e qortimeve e të dënimeve, deri edhe ekzekutimet e të ngjashme me këto. Të gjitha janë e vërteta e dhembshurisë dhe e mëshirës që shkëlqejnë mbi formën e zemërimit e të hakmarrjes.

Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

وَلَكُمۡ فِي ٱلۡقِصَاصِ حَيَوٰةٞ يَٰٓأُوْلِي ٱلۡأَلۡبَٰبِ *"Ue lekum fil-kisàsi hajàtun jà ulil-elbàbi…"*

"O ju që e keni mendjen në kokë, në masën e dënimit me ekzekutim për ju ka jetë."[1]

Edhe Xhehenemi është mëshirë në formën e zemërimit për ata që e kanë përgatitjen për të arritur lumturinë. Sikur të mos ishin pastrimet e ripastrimet që arrihen në Xhehen'nem, njerëzit kurrë nuk do ta shihnin fytyrën e lumturisë.

Në tërësi, personi që s'ka në zemrën e tij dhembshuri e mëshirë për robërit e Allahut, detyrimisht duhet nxjerrë jashtë fushës së bashkësisë njerëzore. Ai është i privuar edhe nga e drejta për t'u ngritur në gradën dhe familjen njerëzore.

Ata që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul-ma'rifeh), thonë: "Shtrirja e qilimit të ekzistencës dhe plotësimi i ekzistencës, të dyja janë me emrin e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit."[2]

Këto dy emra të bukur janë prej gurrës së emrave, janë prej emrave rrethues e të gjerë. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

---

[1] Sure "El-Bekareh", ajeti 179.

[2] Ibni Arebij, "Elfutùhàtul-Mek'kejeh", vëll. 1, f. 102.

وَرَحْمَتِي وَسِعَتْ كُلَّ شَيْءٍ *"…ue rahmetij vesiat kul'le shej'in…"* "…dhe, mëshira Ime ka përshirë të gjithë sendet…"[1], si dhe në ajetin tjetër:

رَبَّنَا وَسِعْتَ كُلَّ شَيْءٍ رَّحْمَةً وَعِلْمًا *"…rab'benà vesi'te kul'le shej'in rahmeten ue ilmen…"* "… Zoti ynë, të gjitha sendet i ke përfshirë me mëshirë e me dituri…"[2]

Nga kjo anë të dy këto emra të bukur e madhështorë janë vënë në krye të sures së parë të Librit Hyjnor, janë ndjekës të emrit më të madh (el-ismul-a'dham) dhe tregojnë se fillimi i ekzistencës është e vërteta e mëshirës gjithëpërfshirëse dhe e mëshirës së plotë. Këto dy emra tregojnë se mëshira e ka parakaluar zemërimin.

Nga ky kuptim, ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë: "Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, u shfaq ekzistenca."[3]

Emri mëshirë është degë prej dhembshurisë, simpatisë e veti të tjera të ngjashme. Këto dy emra ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ *(Err'rrahmànu, err'rrahijmu)-i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti*) tregojnë cilësi e punë. Emri mëshirë është emri me të cilin i Vërteti i Lartësuar, në shumicën e rasteve, prezanton Veten e Tij dhe frazën (Bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm) e ka përsëritur në çdo sure të Kur'anit Famëlartë, me qëllim që të shtohet lidhja e robërve me mëshirën e pamatë të Qenies së Shenjtë, pasi kështu lidhja me mëshirën e të Vërtetit do të jetë burim për edukimin e shpirtrave dhe për zbutjen e zemrave të ashpra.

Nuk është e mundur që zemrat e njerëzve të tërhiqen dhe ata të ndalohen prej tiranisë me këtë butësi e mëshirë të gjerë, ashtu siç nuk është e mundur hedhja e dashurisë mes njerëzve vetëm thjesht me shqiptimin e këtyre dy fjalëve. Prandaj profetët e mëdhenj janë shfaqja konkrete e mëshirës së të Vërtetit të Lartësuar.

---

[1] Sure "El-Araf", ajeti 156.

[2] Sure "Gafir", ajeti 7.

[3] "Elfutùhàtul-Mek'kejeh", vëll. 1, f. 102.

Këtë e njofton i Larti me dërgimin e Profetit të Tij më të nderuar *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) në* fundin e sures "Et-Teube":

لَقَدْ جَآءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُم بِٱلْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ١٢٨

"lekad xhàekum resùlun min enfusikum azijzun alejhi mà anit'tum harijsun alejkum bilmuëninijne reùfun rahijmun"

"U erdhi i Dërguari prej mesit tuaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja. Ai dëshiron që ju të udhëzoheni në rrugën e drejtë. Ai ndien dhimbje e mëshirë për besimtarët."[1]

Kjo mëshirë e madhe dhe kjo dhembshuri e depozituar në zemrën e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është e mjaftueshme për të gjithë familjen njerëzore. Këtë e lexojmë në fillimin e sures "Esh-shuarà", ku Allahu i Lartësuar njofton:

لَعَلَّكَ بَٰخِعٌ نَّفْسَكَ أَلَّا يَكُونُواْ مُؤْمِنِينَ ٣ *"Leal'leke bàkjiun nefseke el'là jekùnù muëminijne"* "A mos ti (o Muham'med) do të stërmundosh veten nga që ata nuk bëhen besimtarë?"[2] Si dhe fjala e të Vërtetit në fillimin e sures "El-Kehf":

فَلَعَلَّكَ بَٰخِعٌ نَّفْسَكَ عَلَىٰٓ ءَاثَٰرِهِمْ إِن لَّمْ يُؤْمِنُواْ بِهَٰذَا ٱلْحَدِيثِ أَسَفًا ٦

"Feleal'leke bàkhiun nefseke alà àthàrihim in lem juëminù bihadhel-hadijthi esefen"

"Mos vallë ti (o Muham'med) do të stërmundosh veten nga hidhërimi për ata, nëse ata nuk i besojnë kësaj fjale (Kur'anit)?"[3]

O i Gjithëfuqishëm, që nuk të mungon asgjë e nuk ke nevojë për asgjë! Sa i rëndë ishte urdhri Yt për të Dërguarin e Allahut *(Paqja dhe bekimet*

[1] Sure "Et-Teube", ajeti nr. 128.
[2] Sure "Esh-Shuara", ajeti 3.
[3] Sure "El-Kehf", ajeti 6.

e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!). Sa shumë hidhërohej ai për gjendjen e atyre që nuk besonin dhe të atyre që e mohonin të Vërtetin e Lartësuar, sa shumë vështirësi kalonte ai për lumturinë e robërve të Allahut! Por Allahu i Lartësuar e gëzon atë dhe e ruan zemrën e tij që kishte aq shumë dhembshuri për shkak të ndërprerjes së lidhjeve që shpallnin kundër tij idhujtarët e mohuesit. Megjithëkëtë ai ishte shumë i hidhëruar dhe ndihej shumë keq për gjendjen e atyre injorantëve të ligj.

Me cilësinë e mëshirës, Allahu i Lartësuar përshkruan edhe besimtarët në fillimin e sures së uruar "El-Fet'h":

مُّحَمَّدٌ رَّسُولُ ٱللَّهِۚ وَٱلَّذِينَ مَعَهُۥٓ أَشِدَّآءُ عَلَى ٱلْكُفَّارِ رُحَمَآءُ بَيْنَهُمْۖ

"Muham'medun resulu-ll'llàhi uel'ledhijne meahù eshid'dàun alel-kuf'fàri ruhamàun bejnehum" "Muham'medi, i Dërguari i Allahut dhe ata që janë së bashku me të, janë të ashpër kundër jobesimtarëve dhe janë të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit…"[1]

Në lidhje me këtë çështje kanë ardhur edhe shumë transmetime të nderuara, që flasin për këto cilësi të lavdëruara. Tani, me lejen e Allahut të Lartësuar, do të sjellim disa prej këtyre transmetimeve:

Në librin "El-Vesàil" dhe në pjesën "El-Haxh'xhu" prej librit të nderuar "El-Kàfij", prej Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!) lexojmë fjalët që ai u thoshte shokëve të tij të ngushtë: *"Kijeni frikë Allahun dhe të jini vëllezër të mirë që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut, të mbani lidhje njëri me tjetrin, të mëshironi njëri-tjetrin, të furnizoni njëri-tjetrin, takohuni njëri me tjetrin dhe përmendeni në mesin tuaj punën tonë dhe gjallërojeni atë."*[2]

Me përcjellësit e tij prej Ebu Abdullahut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Myslimanët kanë detyrim të hulumtojnë në çështjen e mbajtjes së lidhjeve të ndërsjella, të bashkëpunimit të ndërsjellë, të simpatisë së ndërsjellë, të gëzojnë nevojtarët dhe të kini simpati ndaj njëri-tjetrit, derisa të jini ashtu siç ka urdhëruar Allahu i Lartësuar:*

[1] Sure "El-Fet'h", ajeti 29.
[2] "Vesàilu-sh'shij'ah", vëll. 8, f. 552, Hadithi 1.

"رُحَمَآءُ بَيۡنَهُمۡ" *"ruhamàu bejnehum"* "të mëshirshëm në mes tyre...", *të mëshironi njëri-tjetrin, të jini të dëshpëruar për ato punët që ju nuk i dini nëpër të cilat kanë kaluar grupi i ensarëve në kohën e të Dërguarit të Allahut ."*[1]

Prej kuvendeve të shehut, Hasan bin Muham'med Et'tùsij, me përcjellës prej Aliut (paqja qoftë mbi të!), lexojmë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Allahu i Lartësuar është Mëshirëplotë dhe Ai e do çdo njeri që mëshiron."*[2]

Në librin "Mustedrekul-Vesàil", dijetari i madh El-Hilij, në librin e tij "Err'rrisàletu-s'sa'dij'jeh", ka cituar prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): "Betohem në Atë që e ka në dorë shpirtin tim, se Allahu e hedh mëshirën vetëm mbi atë që mëshiron të tjerët."*

Ata i thanë: "O i Dërguari i Allahut: "Të gjithë ne jemi të mëshirshëm." Atëherë ai tha: "Nuk është i mëshirshëm ai që ka mëshirë vetëm për veten e tij e për familjen e tij, por i mëshirshëm është ai që mëshiron të gjithë myslimanët. Allahu i lartësuar thotë: "Nëse ju doni mëshirën Time, atëherë mëshironi!"[3]

Në "El Xha'ferij'jàt" transmetohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): "Ai që nuk mëshiron njerëzit, atë nuk e mëshiron Allahu."*[4]

Në librin "Avàli-l'leàlij", lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Të mëshirshmin e mëshiron i Gjithëmëshirshmi. Mëshironi çdo gjë që është në tokë që ju t'u mëshirojnë ata që janë në qiell."*[5]

---

[1] "Vesàilu-sh'shij'ah", vëll. 12, f. 215, Hadithi 2, si dhe burime të tjera.

[2] Shehu Et'tùsij, "El-Emànij", Kuvendi 18.

[3] "Mustederul-Vesàil", vëll. 9, f. 54; "Err'rrisàletu-s'saëdij'jeh", f. 165.

[4] "Elxhaëferij'jàt", f. 167, K. "Sifetul-mut'tekijne".

[5] "Mustedrekul-Vesàil", vëll. 9, f. 56; "Avàli-l'leàlij", vëll. 1, f. 361.

NDARJA E TRETË

DALLIMI MIDIS ASHPËRSISË DHE ZEMËRIMIT

Ashpërsia shpreh vrazhdësinë e zemrës, ngurtësinë e fortësinë e saj.

Për zemrën e ashpër përdoren edhe fjalët: zemërgur, zemërhekur, zemërvrazhdë, zemërngushtë, etj.[1]Kundrejt kësaj zemre të ashpër qëndrojnë zemërbutët. Këtë e lexojmë në suren e nderuar "Ez-Zumer":

Për zemrën e ashpër përdoren edhe fjalët: zemërgur, zemërhekur, zemërvrazhdë, zemërngushtë, etj.[1] Kundrejt kësaj zemre të ashpër qëndrojnë zemërbutët. Këtë e lexojmë në suren e nderuar "Ez-Zumer":

أَفَمَن شَرَحَ ٱللَّهُ صَدۡرَهُۥ لِلۡإِسۡلَٰمِ فَهُوَ عَلَىٰ نُورٖ مِّن رَّبِّهِۦۚ فَوَيۡلٞ لِّلۡقَٰسِيَةِ قُلُوبُهُم مِّن ذِكۡرِ ٱللَّهِۚ أُوْلَٰٓئِكَ فِي ضَلَٰلٖ مُّبِينٍ ٢٢

"Efemen shereha-ll'llàhu sadrehu lil-islàmi fehuve alà nùrin min rab'bihi, fevejlun lilkàsijeti kulùbuhum min dhikri-l'làhi, ulàike fij dalàlin mubijnin"

"Atij që Allahu ia ka hapur zemrën për (të pranuar) Islamin, ai është në një dritë të sigurt prej Zotit të vet dhe, mjerë për ata që nga zemërashpërsia nuk e përmendin Allahun; të këtillë janë në një humbje të qartë."[2]

Për atë me zemër të gjerë, Allahu ka bërë që zemërgjeri patjetër e pranon të Vërtetin, kurse zemërashpri nuk e pranon të Vërtetin. Pas këtij

[1] "Sihàhu-l'lugati", vëll. 6, f. 2462.
[2] Sure "Ez-Zumer", ajeti 22.

ajeti të nderuar, Allahu i Lartësuar e ka përmendur butësinë e zemrës kundrejt të vërtetës së ashpërsisë.

Këtë e lexojmë në fjalën e të Lartit:

ٱللَّهُ نَزَّلَ أَحۡسَنَ ٱلۡحَدِيثِ كِتَٰبٗا مُّتَشَٰبِهٗا مَّثَانِيَ تَقۡشَعِرُّ مِنۡهُ جُلُودُ ٱلَّذِينَ يَخۡشَوۡنَ رَبَّهُمۡ ثُمَّ تَلِينُ جُلُودُهُمۡ وَقُلُوبُهُمۡ إِلَىٰ ذِكۡرِ ٱللَّهِۚ

"All'llàhu nezele ahsenel-hadijthi kitàben muteshàbihen methànije taksheirr'rru minhu xhulùdu-l'ledhijne jakhsheune rab'behum thum'me telijnu xhulùduhum ue kulùbuhum ilà dhikri-l'làhi"

"Allahu zbriti fjalën më të bukur, (zbriti) librin të ngjashëm në mrekulli (këshilla) të përsëritura herë pas herë, prej të cilave (prej dëgjimit të kësaj fjale) u rrëqethen lëkurët atyre e kanë frikë Zotin e tyre dhe pastaj atyre, me përmendjen e Allahut, u zbuten lëkurët e zemrat."[1]

Midis ashpërsisë e zemërimit ka një dallim të qartë. Ashpërsia është ashtu siç thamë më sipër. Kurse zemërimi është lëvizje dhe një gjendje shpirtërore, e cila shkakton në zemër vlimin e gjakut për revansh. Kur kjo gjendje forcohet, atëherë kjo lëvizje bëhet më e shpejtë, në zemër ndizet zjarri i zemërimit, damarët e gjakut e truri i tij mbushen prej një tymi të errët e të turbullt dhe, për shkak të këtij tymi, mendja devijon e nuk është në gjendje të kuptojë e të mendojë. Në këtë gjendje zemërimi, këshillat e sugjerimet nuk sjellin dobi për të zemëruarin, madje e ndezin edhe më shumë zjarrin e zemërimit.

Dijetarët kanë thënë: "Në këtë gjendje njeriu ngjason me një shpellë, në të cilën është ndezur një zjarr i madh, për rrjedhojë shpella është e mbushur me flakë e me tym. Prej atyre që janë mbyllur në këtë shpellë, dalin thirrje alarmi e zëra të egër. Shpella është e pështjellë prej flakëve të zjarrit dhe në çdo kohë në shpellë shtohet tymi. Në këtë kohë ilaçi është shumë i vështirë, sepse ky zjarr nuk mund të shuhet dhe, çdo gjë që hidhet për të shuar flakët e këtij zjarri, flakët e zjarrit ndizen edhe më shumë, flakët e

[1] Sure "Ez'Zumer", ajeti 23.

hanë zjarrin dhe e bëjnë atë pjesë-pjesë, kështu lënda e zjarrit shtohet edhe më shumë. Për të gjitha këto njeriu, në gjendjen e marrjes flakë të zemërimit të tij, është i verbër e nuk e shikon rrugën e drejtë e rrugën e udhëzimit në të vërtetën. Në këtë gjendje ai është i shurdhur ndaj këshillave, madje këshillat në këtë gjendje bëhen shkak për të shtuar zemërimin e tij e materialin e ndezur të tymit të tij, prandaj për këtë person, në këtë gjendje, s'ka ilaç."[1]

Këtë fjalë të nderuar ne e kemi cituar në rastin e zemërimit prej fjalës së të urtit Ibn Meskujeh dhe pohojmë se nuk kemi gjetur për këtë pjesë fjalë më të bukur e më të mirë se fjala e këtij dijetari të urtë.

Nga sa u tha deri tani, u mësua se ashpërsia e zemërimi janë dy gjendje të zemrës, që s'kanë asnjë lidhje njëra me tjetrën, edhe pse në hadithin e nderuar dhembshuria e mëshira janë vënë kundjet ashpërsisë së zemërimit. Në realitet, nuk kemi ballafaqim të vërtetë, pasi qëllimi me fjalën ballafaqim kupton që dy të ballafaquarit të jenë komplementarë të njëri-tjetrit, sepse dhembshuria është e shoqëruar me butësinë dhe është butësia ajo që qëndron përballë ashpërsisë, kurse mëshira është e shoqëruar me butësinë dhe është butësia ajo që qëndron përballë zemërimit.

[1] Autori *(Allahu qoftë i kënaqur prej tij!)* ka cituar prej librit të autorit Ibn Meskujeh "Tehdhijbul-akhlàk", f. 5, K. "Nxitimi e frika". Libri është i përkthyer dhe ne e kemi marrë prej përkthimit në gjuhën arabe.

NDARJA E KATËRT

DHEMBSHURIA ËSHTË PREJ DOMOSDOSHMËRIVE TË NATYRËS SË PASTËR TË KRIJIMIT DHE PREJ USHTRIVE TË ARSYES

Mëso se mëshira, dhembshuria e butësia, çdo njëra prej këtyre cilësive është prej domosdoshmërive të natyrës së pastër të krijimit dhe prej ushtrive të mendjes e të Mëshirëplotit, sepse simpatia, mëshira dhe dashuria e ndërsjellë janë të gatuara në natyrën e pastër të krijimit të familjes njerëzore.

Sikur mizori të arrijë në çdo cak prej caqeve të padrejtësisë, ai sipas natyrës së pastër të parë të krijimit, në vetvete, është i mëshirshëm, i dashur e i dhembshur ndaj atyre që janë poshtë tij, ndaj të pafuqishmëve, ndaj të varfëve e ndaj fëmijëve, sepse mëshira e dhembshuria janë të depozituara në zemrën e çdo njeriu, me qëllim që njeriu të ndiejë dhembshuri e të ketë mëshirë ndaj çdo gjallese.

Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun prej të vërtetës së mëshirës së Tij, domethënë se njeriu është një formë e mëshirës hyjnore. Allahu i Lartësuar, në Librin e Tij Famëlartë, thotë:

ٱلرَّحۡمَٰنُ ١ عَلَّمَ ٱلۡقُرۡءَانَ ٢ خَلَقَ ٱلۡإِنسَٰنَ ٣ *"Err'rrahmànu. Al'lemel-Kur'àne. Khalekal-insàne"* "I Gjithëmëshirshmi. Ai ia mësoi Kur'anin. Ai e krijoi

njeriun."[1] domethënë se krijimi i njeriut është i lidhur me emrin "ٱلرَّحۡمَٰنُ" (E*rr'rrahmàn)* "i Gjithëmëshirshmi".

Pikërisht për shkak të kësaj lidhjeje, edhe mizori e zemërashpri, nga vetë natyra e krijimit të tij, ka neveri ndaj padrejtësisë e ndaj ashpërsisë, prandaj ai, edhe sikur të jetë i shkujdesur prej padrejtësisë së tij e prej ashpërsisë së vet, në sajë të natyrës së pastër të krijimit, në vetvete, e kundërshton ashpërsinë që ndien mbi veten e tij prej një tjetri, ashtu siç kundërshton edhe padrejtësitë që i bëhen prej një tjetri.

Qenia njeri, bën që njeriu të dëshirojë drejtësinë, mëshirën e dhembshurinë. Madje mizori ka dëshirë që edhe padrejtësia të ecë krahas drejtësisë, ashtu siç ka dëshirë që edhe ashpërsia të jetë në formën e mëshirës vullnetarisht ose me imponim. Kështu ai i jep padrejtësisë fytyrën e mëshirës, sepse natyra e pastër e krijimit të tij ka neveri prej padrejtësisë. Kjo do të thotë se njeriu, nga vetë natyra e qenies së tij, është i orientuar kah mëshira e dhembshuria. Prandaj njeriu e ka detyrim të afrohet kah drejtësia, qoftë si emër, qoftë si formë.

Gjithashtu, njeriu dëshiron të përfitojë prej drejtësisë, qoftë si emër, qoftë si formë. Kjo kërkesë, domethënë: mëshira, dhembshuria, drejtësia, dashuria e të ngjashme me këto, të gjitha janë prej domosdoshmërive të natyrës së pastër të krijimit, kurse të kundërtat e këtyre cilësive janë në kundërshtim më natyrën e pastër të krijimit, domethënë janë prej domosdoshmërive të mbulimit të cilësisë së krijimit.

Pasi i referohemi ekzistencës e gjendjeve të njerëzve në familjen njerëzore, nuk lind më nevoja të sjellim argumente dhe të zgjatemi në shpjegime.

Nëse të gjitha këto kërkesa janë prej kapitullit të diturisë së emrave nën vështrimin e një peshoreje të plotë shkencore dhe të një argumenti logjik e filozofik të plotë, rezulton se, kur ky punim nuk ishte i përgatitur

[1] Sure "Er-Rrahman", ajetet 1-3.

për një shpjegim të këtillë, lind nevoja e referimit në origjinën e çështjes, që të mësojmë se të gjitha punët e mira e të gjitha plotësimet i referohen emrave hyjnorë dhe të gjitha janë me bërjen e Qenies së Shenjtë.

Gjithashtu edhe cilësitë që qëndrojnë kundrejt cilësive të lartpërmendura i referohen emrave të pastër dhe bërjes së rastësisë, sepse natyra e pastër e krijimit është formë e plotësimit dhe e mëshirës së plotë. Veç kësaj, vetë sistemi i ekzistencës është i ndërtuar mbi plotësimin e mbi të mirën, kurse mangësitë, të metat e të këqijat vijnë nga mosekzistenca dhe kanë lidhje me cilësinë e krijimit, të buluar dhe me largimin prej burimit të dritës e të madhështisë.

NDARJA E PESTË

FRYTET E FUQISË SË ZEMËRIMIT

Mëso se fuqia e zemërimit është njëra prej mirësive të mëdha hyjnore për kafshën dhe në veçanti për njeriun. Në të vërtetë, kjo fuqi e nderuar është e ngarkuar të ruajë mbijetesën e individit e të llojit, të ruajë sistemin e familjes dhe të sigurojë mbijetesën e individit e të shoqërisë.

Derisa njeriu është në botën e lëndës e të natyrës, në sajë të kundërshtive e të përplasjeve në këtë botë, si dhe në sajë të fuqisë së pranimit, impresionit e të ndikimit mbi natyrën e tij, ai gjithmonë do të jetë në një fazë pjekje e analize, në atë mënyrë që, sikur te ai të mos arrijë zëvendësuesja e asaj prej secilës ai është sintetizuar, atë shumë shpejt do ta sulmojnë prishësit e brendshëm dhe me shpejtësi do ta vrisnin atë.

Derisa njeriu është në botën e kësaj toke, ai ka përballë armiq e prishës dhe sikur ai të mos i ndalonte këto armiq e prishës, padyshim që ata do ta asgjësonin njeriun.

Gjithashtu individi, kafshë e njeri, është i ekspozuar ndaj prishësve e dëmtuesve të jashtëm e të brendshëm, çka bën që sistemi i familjes njerëzore dhe sistemi i shoqërisë e i qytetërimit të virtytshëm njerëzor, të gjendet përballë tyre. Nëse njeriu nuk mbrohet ndaj këtyre prishësve e kundërshtarëve, padyshim që sistemi i botës e i qytetërimit të virtytshëm do të shkrihej. Me siguri që bota e qytetëruar, shumë shpjet do të shpërbëhej e do të asgjësohej.

Nga kjo anë, kujdesi hyjnor dhe mëshira gjithëpërfshirëse dhe e plotë kërkojnë që fuqia e nderuar e zemërimit, në përgjithësi, të vihet te kafsha dhe në veçanti te njeriu, me qëllim që kafsha e njeriu të sprapsin prej vetes të gjithë dëmtuesit e brendshëm e të jashtëm.

Në mënyrë të veçantë, njeriu të sprapsë prishësit e sistemit të familjes, të shoqërisë e të qytetërimit të virtytshëm, si dhe të sprapsë të gjithë kundërshtarët që vihen kundër tij. Mbrojtja e familjes prej faktorëve shkatërrues, mbyllja e pikave të largëta dhe mbrojtja e kufijve të mbretërisë, mbrojtja e sistemit të popullit, ruajtja e nacionalitetit dhe qëndrimi në rojë prej sulmit të të këqijve kundër qytetërimit të virtytshëm, si dhe lufta në rrugën e Allahut kundër armiqve të njerëzimit e të fesë, nuk realizohet ndryshe veçse nën hijen e kësaj fuqie të dhuruar prej Allahut të Lartësuar.

Kjo cilësi e rrallë qiellore është gatuar me dorën e të Vërtetit të Lartësuar, në natyrën e pastër të krijimit të njeriut dhe pikërisht këtë cilësi të rrallë i Gjithëfuqishmi e depozitoi te njeriu. Nën hijen e kësaj fuqie e të kësaj force hyjnore, gjen zbatim ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, përfshirë dënimet fizike, deri dënimet kapitale e qortimet, si dhe politikat hyjnore, të cilat ruajnë sistemin e botës. Madje nën zjarrin e kësaj fuqie të nderuar, realizohet lufta kudër unit dhe ndalimi i ushtrive të injorancës e të Iblijsit.

Gjithsesi, fuqinë e zemërimit e shoqërojnë shumë prej cilësive të këqija e shumë prej moraleve të urryera, si: frika, dobësia, përtacia, mendjemadhësia, durimi i pakët, paqëndrueshmëria, kërkimi i qetësisë e amullia.

Prandaj padrejtësia ndaj vetes është e barabartë me padrejtësinë ndaj të tjerëve, madje është edhe më e keqe. Gjithashtu, edhe miratimi i punëve të liga e imoraliteteve, sjell për njeriun jo vetëm dorëzimin para skandaleve, por sjell edhe mungesën e xhelozisë te njeriu, për të ruajtur veten, familjen e popullin e tij.

Duke përshkruar cilësitë e besimtarëve, Allahu i Lartësuar thotë:

أَشِدَّآءُ عَلَى ٱلۡكُفَّارِ رُحَمَآءُ بَيۡنَهُمۡۖ *"…eshid'dàun alel-kuf'fàri ruhamàu bejnehum…"*

"…të ashpër ndaj mohuesve e të mëshirshëm në mes tyre…"[1]

[1] Sure "Et-Fet'h", ajeti 29.

Natyrisht që kjo do të thotë që gjendja e maturisë kërkon që mëshira e dhembshuria të jenë në vendin e duhur, po kështu edhe shtrëngimi e zemërimi patjetër duhet të jenë në masën e duhur. Në transmetimet e nderuara ka ardhur përçmimi për zemërimin që nuk është në vendin e duhur dhe neveria ndaj një zemërimi të këtillë.

Muham'med bi Jaëkub, ka përcjellë prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)*: "Allahu i Lartësuar i shpalli profetit Shuajb *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!):* "Unë do të ndëshkoj prej popullit tënd njëqind mijë vetë, dyzet mijë janë prej të këqijve dhe gjashtëdhjetë mijë janë prej të mirëve."

Atëherë profeti Shuajb *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* tha: "O Zot, mirë për të këqijtë, po si është puna me të mirët?"

Atëherë i Larti i gjithëfuqishëm i shpalli: "Ata mikluan mëkatarët dhe nuk u zemëruan për gjërat që shkaktojnë zemërimin Tim."[1]

Në librin "El-Vesàil", prej Muhasin El-Berkij, prej Ali bin Husejnit *(paqja qoftë mbi të!)* transmetohet: "Musa bin Imran *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* tha: "O Zot, kush i shkatërron ata që strehohen nën hijen e Arshit Tënd, ditën kur s'ka hije tjetër përveç hijes Tënde?"

Atëherë Allahu i Lartësuar i shpalli: "Zemrat e tyre janë të pastra, toka është dy duart e atyre që përmendin madhështinë Time kur ata përmendin Zotin e tyre. Ata mjaftohen me bindjen ndaj Meje, ashtu siç mjaftohet foshnja e vogël me qumështin, ata strehohen në xhamitë e Mia, ashtu siç strehohen shqiponjat në çerdhet e veta, si dhe ata zemërohen kur shpallet e lejuar shkelja e gjërave që Unë i kam ndaluar në mënyrë të prerë, ashtu si tigri kur shmanget."[2]

Në kapitullin "Moralet e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)*" prej Imam Bakirit transmetohet: "Ai

[1] "Furù'ul-kàfij", vëll. 5, Libri "El-emru bil-maërùfi uen'enhju anil-munkeri", Hadithi 1, f. 57

[2] "Mehàsinul-Berkij", vëll. 1, f. 80, K. 10.

kurrë nuk ka kërkuar ndihmë për veten e tij në të gjitha gjendjet e errëta që ka kaluar, derisa shkelej ndonjëri prej ndalimeve të Allahut, vetëm atëherë ai menjëherë zemërohej për hir të Allahut të Lartësuar."

Prej kësaj që u tha më sipër mësohet se zemërimi që qëndron kundrejt mëshirës, është prej ushtrive të injorancës e prej ushtrive të Iblijsit dhe nuk është gjendja e maturisë për cilësinë e zemërimit që është nën sistemin e mendjes e nën sistemin e Allahut e të ligjit të shenjtë qiellor, por qëllimi me zemërimin që qëndron kundrejt mëshirës, është gjendja e tejkalimit të masës në zemërimin.

Në ndarjen e ardhshme do të flitet për këtë lloj zemërimi.

NDARJA E GJASHTË

ANORMALITETI I FUQISË SË ZEMËRIMIT

Më sipër u mësua se Allahu i Lartësuar i dha njeriut fuqinë e zemërimit për të ruajtur sistemin dhe për të arritur lumturinë në këtë botë e në Botën Tjetër. Por, sikur njeriu të mos e konsumojë këtë mirësi hyjnore në vendin e duhur dhe sikur ai të mos zemërohet aty ku duhet të zemërohet për të ruajtur këtë bazë, ai njeri është mosmirënjohës ndaj mirësisë që i ka dhënë i Vërteti i Lartësuar.

Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar: وَلَئِن كَفَرْتُمْ إِنَّ عَذَابِي لَشَدِيدٌ ٧ *"…ue lein kefertum in'ne adhàbij leshedijdun"* "…nëse jini mosmirënjohës (dijeni) se dënimi Im është shumë i ashpër."[1]

Por më e zezë e më keq është atëherë kur njeriu e konsumon këtë fuqi hyjnore në kundërshtim me qëllimin hyjnor, kur e konsumon atë kundër sistemit të familjes e kundër qytetërimit të virtytshëm njerëzor. Një njeri i këtillë nuk është vetëm mosmirënjohës për mirësinë, por është edhe shkatërrues i vetë kësaj mirësie, për rrjedhojë, te ky mosmirënjohës fuqia e zemërimit, që është prej ushtrive të Allahut dhe kundër ushtrive të injorancës e kundër ushtrive të djallit, bëhet prej ushtrive të mëdha të djallit, bëhet kundërshtuese e ashpër kundër ushtrive të mendjes e kundër ushtrive të të Vërtetit të Lartësuar, derisa cilësia e zemërimit në një individ të këtillë mosmirënjohës gradualisht hyn nën sundimin e djallit e të injorancës.

Supozohet që kjo fuqi të jetë një qen i mësuar për mendjen e për të ruajtur urdhrat e të Vërtetit. Mirëpo ajo, në këtë mosmirënjohës, u bë qen i mësuar për djallin, në kuptimin se në gjendjen e tjetërsimit të kësaj cilësie,

[1] Sure "Ibrahim", ajeti 7.

ky qen i mësuar nuk e dallon më mikun prej armikut, për pasojë i shqyen të gjithë dhe trondit e shemb sistemin e botës e të familjes njerëzore.

Ndodh që në sajë të fuqisë së zemërimit e gjitha bota të përmbyset në njërin prej këtyre llojeve, sepse cilësia e kullufitjes te njeriu nuk është më e egër se te bishat. Fuqia e zemërimit te bishat ka një kufi të caktuar. Ajo mbaron dhe ndalon, kurse fyti i njeriut, edhe sikur të gëlltisë të gjithë botën, përsëri nuk mbetet i kënaqur, flakët e zjarrit të babëzisë së tij nuk qetësohen, madje nga kjo anë ferri i zemërimit të tij ka mundësi të djegë të gjithë botën.

Tani që autori po i mbush këto fletë me bojën e penës së tij, zjarri i luftës mes aleatëve e gjermanëve vazhdon të jetë i ndezur dhe flakët e këtij zjarri ngrihen lart në të gjitha qytetet evropiane. Ky zjarr përvëlues s'është gjë tjetër veçse tymi i zjarrit të nxehtë të një njeriu bishë, të një njeriu të keq, i cili, nën parullën e udhëheqjes së Gjermanisë, e bëri të keqe të gjithë botën dhe në veçanti popullin e tij të mjeruar dhe të gjithë i vuri para kësaj prove shkatërruese.

Natyrisht që tani ai po shkon drejt shkatërrimit e asgjësimit, drejt prishjes së sistemit botëror dhe drejt përhapjes së djallëzisë, injorancës e manisë për të kullufitur sa më shumë. Këto vegla, mjete e shpikje që Allahu i Lartësuar ia ka dhënë Evropës, janë bërë trullosëse të mendjeve. Në ditët e sotme, sikur të përfitohej ndonjë dobi prej këtyre shpikjeve me anë të sistemimit të mendjes nën flamurin e fesë hyjnore, me siguri që e gjithë bota do të bëhej dritë e drejtësi, njëkohësisht edhe dijetari do të kishte mundësi të siguronte lumturinë e tij të përjetshme në sajë të lidhjeve të mira. Por duhet pohuar me keqardhje se këto forca të shpikura janë vënë nën sundimin e injorancës, janë vënë nën sundimin e djallit e të dashurisë për veten, prandaj në këtë gjendje të gjitha shpikjet përdoren kundër lumturisë së species njerëzore dhe në kundërshtim me sistemin e qytetërimit të virtytshëm.

Nuk ishte në brumin e këtij dijetari që të ndikonte në favor të botës, pasi, në të vërtetë, ai me shpikjet e tij e hodhi botën në errësirë e në mjerim,

për rrjedhojë njeriu ecën në rrugën e së keqes e të poshtërimit. Por ku do të përfundojë?! Kur do të shpëtojë kjo shoqëri e varfër prej dorës së individëve kafshë me fytyrë njeriu, madje edhe kafsha do të kishte turp prej fytyrës së tyre. Kur do të plotësohet kjo nevojë dhe kur kjo botë e errët do të ndriçohet me dritën hyjnore, me dritën e një të nderuari që do të kryejë përmirësimin e plotë? "O Zoti im, shpejtoje daljen e tij të nderuar dhe të kujtdo që është mbi ne me shfaqjen e tij!"

NDARJA E SHTATË

PËRMENDJA E DISA HADITHEVE TË NDERUARA QË FLASIN PËR KËTË ÇESHTJE

Në librin "El-Vesàil", prej librit "El-Kàfij", prej Ebu Abdullahut *(paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Zemërimi e prish besimin ashtu siç e prish uthulla mjaltin."[1]

Në librin "Elmustedrek" prej "El-xha'ferij'àt", prej Ali bin Ebu Talibit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Zemërimi e prish besimin ashtu siç e prish mjaltin lënia për një kohë të gjatë dhe ashtu siç e pish uthulla mjaltin."[2]

Mëso se të varfrit e vënë në provë tani janë nën mbulesën e natyrës dhe nën perden e jetës së ulët e të errët të kësaj bote. Ata janë të mbuluar, s'kanë dijeni për të fshehtat, s'kanë dijeni për cilësitë e shpirtit, s'kanë dijeni për dëmtuesit, prishësit e shkatërruesit. Për shkak të zemërimit ne nuk e verifikojnë dot mënyrën e zhdukjes së besimit dhe nuk e konstatojmë që besimi i njeriut u prish e është asgjësuar. Kur zemërimi nuk është në vendin e vet, ne nuk e kuptojmë me dritën e syrit të zemrës se zemërimi është e kundërta e besimit.

[1] "El-Vesàil", vëll. 15, f. 358; K. "Ebvàbu xhihàdu-n'nefsi".

[2] "Mustedrekul-Vesàil", vëll. 22, f. 7, K. 53 prej kapitujve "Ebvà xhihàdu-n'nefsi". Ky hadith është cituar me rrugë të ndryshme. Lexo "El-Bihàr", vëll. 73, f. 266.

Mjekët psikologë dhe kardiologë, të cilët, me dritën hyjnore gjithëpërfshirëse dhe me syrin vëzhgues që depërton në brendësi të sistemeve e të cilësive, kanë diagnostikuar sëmundjet e zemrës dhe kanë gjetur edhe ilaçin për mjekimin e këtyre sëmundjeve, kanë gjetur se cilët janë përmirësuesit e përkeqësuesit e këtyre sëmundjeve.

Në të vërtetë, ata janë dërguar prej Qenies së Shenjtë hyjnore që të zbulojnë të vërtetat dhe për të bërë të dukshme të brendshmet e trupit të njeriut, si dhe për të na zgjuar ne që jemi në gjumë. Duke na njoftuar për të brendshmen e zemrave tona, ata zbulojnë edhe cilësitë e shpirtrave tanë. Ata e dinë se shpirti ynë prishet me shpejtësi ashtu siç e prish mjaltin uthulla e lënia për një kohë të gjatë. Këta dy faktorë, ëmbëlsinë e shijen e këndshme të mjaltit e shndërrojnë në të hidhur e i japin mjaltit shije acidi të padëshiruar prej shpirtit.

Po kështu edhe zjarri i zemërimit dhe tymi i këtij zjarri e prishin dritën e besimit, madje e shuajnë fare atë dritë. Sikur zemërimi të mos bënte gjë tjetër përveç prishjes së këtij kapitali të jetës shpirtërore të njeriut, domethënë, sikur zemërimi të mos prishte gjë tjetër përveç besimit e ta bënte besimin pa vlerë, duke i hequr njeriut shkaqet e lumturisë, atëherë njeriu do të hyjë në Botën Tjetër më duar bosh. Kjo do të ishte e mjaftueshme.

Ka mundësi që njeriu, që edhe në këtë botë të jetë në rreziqe e të bjerë nën ndikimin e elementëve e të faktorëve shkatërrues, të cilët detyrimisht sjellin për njeriun gjendje të vështirë në të dyja botët.

Shumë pak gjëra e çojnë njeriun në vështirësi e në shkatërrim. Një prej tyre është edhe zjarri i zemërimit, që ndizet me shpejtësinë e vetëtimës.

Gjithashtu ndodh që njeriu, për shkak të zemërimit, arrin deri aty sa vetëm brenda një çasti del prej fesë së Allahut dhe guxon të trimërohet para Allahut të Lartësuar e para profetëve të mëdhenj; gjithashtu ndodh që nën avullin e zemërimit njeriu bëhet vrasës. Kjo është cituar prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* në librin "El-Kàfij": "Babai im thoshte: "A ka më të

fuqishëm se zemërimi? Në të vërtetë, në gjendje zemërimi burri vret njeriun. Allahu e ka ndaluar rreptësisht vrasjen e njeriut. Gjithashtu, në gjendje zemërimi burri flet keq për gruan e ndershme."[1]

Në librin "El-Vesàil" prej El-Khas'sàl, prej Ebu Abdullahut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "Apostujt e pyetën Isanë *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!):* "Cila gjë është më e ashpër?"

Isai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* iu përgjigj: "Gjëja më e ashpër nga të gjitha gjërat është zemërimi i Allahut të Gjithëfuqishëm."

Ata përsëri e pyetën: "Me çfarë të ruhemi prej zemërimit të Allahut?"

Isai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* tha: "Mos u zemëroni!"

Ata përsëri e pyetën: "Si është fillimi i zemërimit?"

Isai *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* tha: "Mendjemadhësia, prepotenca dhe poshtërimi i njerëzve."[2]

Ky hadith i nderuar na bën të kuptojmë me rrugën e insinuatës se brendia e zemërimit është një formë e zjarrit të zemërimit hyjnor.

Ky tym i nxehtë përvëlues fillon të dalë prej brendësisë së zemrës. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

نَارُ ٱللَّهِ ٱلۡمُوقَدَةُ ٦ ٱلَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى ٱلۡأَفۡـِٔدَةِ ٧ *"nàru-ll'llàhil-mùkadeti el'letij tet'taliu alel-efideti"* "Është zjarri i tejndezur i Allahut, që depërton në brendësi të zemrës."[3]

Mbase ajeti tregon një formë të këtij zjarri, që del prej brendësisë së zemrës dhe që e kontrollon zemrën. Tani ne dëgjojmë një lajm për zemërimin, por s'kemi mundësi të shpjegojmë formën e vërtetë të këtij zjarri ashtu siç ai është. Gjuha e kësaj bote dhe enciklopedia e natyrës e ka

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 229, Libri "El-Ijmànu uelkufru", K. "Zemërimi".
[2] "El-Vesàil", vëll. 15, f. 362, K. 53, prej kapitujve "Xhihàdu-n'nefsi".
[3] Sure "El-Humezeh", ajetet 6-7.

të pamundur të shpjegojë si janë të vërtetat e të fshehtave të botës së panjohur dhe të asaj që gjendet prapa natyrës.

Gjithçka që dëgjojmë për ato që kanë të bëjnë me lumturinë e me vështirësinë, ne i kuptojmë ato ose me rrugën e krahasimit me këtë botë, ose me rrugën e krahasimit me dëshirat e me zakonet tona. Por Bota Tjetër dhe cilësitë hyjnore nuk mund të maten me peshoren e kësaj bote e peshoren e pasurisë.

Gjithçka që ne shikojmë prej zjarrit, është zjarr i ngjitur me trupin e me pjesën e jashtme të trupit, por ajo që ne gjejmë është më lart e më shumë se kaq.

Sikur i gjithë zjarri i kësaj bote të mblidhej palë-palë njëri mbi tjetrin, nuk do të kishte mundësi të digjte zemrën e njeriut, sepse zemra është prej gradëve të cilësive hyjnore dhe zjarri i pronësisë nuk arrin deri në zemër, zjarri i pronësisë nuk del jashtë kufirit të trupit pronësor të kësaj bote dhe nuk e djeg as të brendshmen e as të jashtmen, as shpirtin, as zemrën, as trupin. Kurse zjarri i zemërimit është zjarri i cilësive hyjnore. Ky zjarr del vetëm prej brendësisë së zemrës dhe është ky zjarr që depërton jashtë me rrugët e shqisave.

Isai *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!)* ka thënë: "Ai që ka dëshirë të ruhet prej zjarrit të zemërimit hyjnor dhe të mos vihet në provë me zjarrin e tejndezur të Allahut, ka detyrë të ruajë veten prej zjarrit të zemërimit që ka marrë flakë."

Në hadithin e nderuar, të transmetuar në librin "El-Kàfij", prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "Ky zjarr është një thëngjill i ndezur prej djallit në zemrën e njeriut, prandaj, kur ndonjëri prej jush zemërohet, atij i skuqen sytë, i shtrëngohen nofullat dhe djalli hyn në gojën e tij. Kur ndonjëri prej jush ka frikë veten e vet prej zemërimit, menjëherë le

të qëndrojë ndenjur në tokë dhe, nëse ai e tremb djallin me këtë veprim, djalli patjetër do të largohet prej tij."[1]

Prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "Zemërimi është mjeti që e djeg dijetarin, prandaj ai që nuk e frenon zemërimin e tij, nuk e zotëron mendjen e vet."[2]

Prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "Kush frenohet e nuk zemërohet me njerëzit, Allahu i Lartësuar e largon prej tij ndëshkimin e Ditës së Kiametit."[3]

Hadithet e nderuara, që flasin për këtë çështje, janë të shumta dhe është e pamundur të përfshihen të gjitha në këtë përmbledhje të shkurtër.

[1] "El-Kàfij", vëll. 2, f. 231, Libri "El-ijmànu uelkufru", K. "Elgadabu".
[2] I njëjti burim e i njëjti kapitull.
[3] I njëjti burim e i njëjti kapitull.

NDARJA E TETË

KUJTESË E SHKURTËR PËR MJEKIMIN E ZEMËRIMIT

Mëso se në librin e dyzet haditheve, në shpjegimin e hadithit 7, kemi trajtuar në mënyrë të detajuar edhe temën e zemërimit dhe mjekimit të zemërimit, prandaj në këtë libër që kemi në dorë, do të përmendim shkurtimisht vetëm disa prej asaj që është thënë në librin e sipërpërmendur. Këtë e bëjmë me qëllim që edhe këtu të mos mbetemi pa përfituar ndonjë dobi.

Mëso se mjekimi i ndezjes së shpirtit patjetër duhet bërë me shuarjen e shkëndijës së fuqisë së zemërimit, ndryshe është shumë e vështirë të ndalohet ndezja e këtij zjarri egërsirë e përvëlues. Nëse ky zjarr ndizet, është e pamundur të ndalohet shpërthimi i tymit të errët vrasës. Edhe mjekët psikologë e kanë të pamundur të shuajnë këtë zjarr gjatë kohës së mjekimit, sepse ata, sa herë që nxitojnë ta bëjnë këtë mjekim në këtë kohë, kalojnë në këshilla e predikime, ndërkaq ky thëngjill djallëzor ndizet edhe më shumë.[1]

Në gjendje zemërimi të menjëhershëm, i zemëruari patjetër duhet të largojë djallin, njëkohësisht në kohën që atij i ndizet zjarri i zemërimit, patjetër duhet të përgatisë veten për gjendjen e largimit dhe le të mendojë rreth përfundimit të keq që vjen prej asaj gjendjeje. Sikur në të zemëruarin të ketë mbetur ndjenja e dallimit, ai patjetër duhet ta largojë vlimin e zemrës që vjen duke u shtuar dhe menjëherë duhet të ndryshojë zemërimin e tij,

[1] Kjo shprehje është marrë prej fjalës së Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)*: "Në të vërtetë, ky zemërim është një thëngjill prej shejtanit." ,"Usùul-kàfij", vëll. 2, f. 231.

duke ndryshuar gjendjen e tij, me qëllim që të mos shtohet më shumë shkëndija e këtij zjarri shkatërrues.

Gjithashtu, i zemëruari ka detyrë të nxjerrë veten e tij jashtë prej betejës në të cilën gjenden shkaqet e zemërimit, pasi kështu ai shpëton veten e të tjerët prej frikës së shkatërrimit. Shndërrimi i gjendjes së të zemëruarit bëhet duke u ulur ndenjur kur ai është më këmbë, ose duke u shtrirë kur ai është ndenjur, ose duke përmendur Allahun e Lartësuar. Madje disa e kanë bërë detyrim përmendjen e Allahut në kohën e zemërimit.[1]

Në librin "El-Kàfij", transmetohet prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)*: "Allahu i Lartësuar u ka shpallur disa profetëve të Tij: "O bir i Ademit, më përmend Mua në zemërimin tënd, që Unë të të përmend ty në zemërimin Tim. Ty unë nuk do të të shkatërroj me ata që do të shkatërroj dhe, kur të bëhet ndonjë padrejtësi, të jesh i kënaqur me ndihmën Time për ty, sepse ndihma Ime për ty, është shumë më e mirë se ndihma që ti i jep vetes tënde."[2]

Në hadithin e nderuar, i transmetuar në librin "El-Kàfij", që pamë në ndarjen paraardhëse, prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)*, lexojmë: "Ky zjarr është një thëngjill i ndezur prej djallit në zemrën e njeriut, prandaj kur ndonjëri prej jush zemërohet, atij i skuqen sytë, i shtrëngohen nofullat dhe djalli hyn në gojën e tij. Kur ndonjëri prej jush ka frikë veten e vet prej zemërimit, menjëherë le të qëndrojë ndenjur në tokë. Nëse ai e tremb djallin me këtë veprim, djalli patjetër do të largohet prej tij."[3]

Gjithashtu prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: "Burri do të zemërohet dhe kurrë nuk do të jetë i kënaqur, derisa të futet në zjarr. Çdo burrë që zemërohet me të tjerët dhe është më këmbë, sapo t'i fillojë zemërimi menjëherë le të ulet. Me këtë ulje prej tij largohet ndyrësia e djallit

[1] "El-Vesàil", vël. 15, K. "Vuxhùbu dhikri-l'làhi indel-gadabi", f. 364.
[2] "Usùlul-kàfij", vëll. 2, f. 260.
[3] "Usùlul-kàfij", vëll. 2, f. 2231.

dhe, çdo burrë që zemërohet me të afërmin e vet, menjëherë le t'i afrohet atij dhe le ta lëmojë atë, sepse mitra kur lëmohet, qetësohet."[1]

Me rrugë të përgjithshme, citohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* se, kur ai zemërohej dhe ishte më këmbë, menjëherë ulej ndenjur. Nëse zemërohej kur ishte ulur, menjëherë shtrihej dhe kështu zemërimi menjëherë largohej prej tij.[2]

Ajo që thamë deri tani kishte të bënte me rastin kur i zemëruari mjekon vetveten. Kurse për mjekimin e tjetrit, kur ju doni të mjekoni dikë kur është në gjendje zemërimi dhe zemërimi i tij është ndezur flakë, shuarja e zemërimit të tij në këtë gjendje është punë shumë e vështirë, nëse zjarri i zemërimit të tij nuk shuhet me ndonjërën prej rrugëve që u thanë më sipër, para se zjarri i Xhehen'nemit te ai njeri të ndizet flakë.

Një ndër rrugët për shuarjen e zemërimit te ai njeri, është edhe rruga e frikësimit të tij. Në mënyrë të veçantë, kur i zemëruari është i fuqishëm dhe ka forcë, pasi në sajë të frikësimit, në brendësinë e tij, zemërimi shuhet për shkak të frikës. Gjithsesi, duhet theksuar se frikësimi nuk duhet bërë në gjendjen kur zemërimi është ndezur e ka marrë flakë, sepse frikësimi në këtë gjendje nuk mund të jetë pa rrezik për të zemëruarin.

Në përgjithësi, mjekimi i zemërimit në gjendjen kur ai ka shpërthyer, është punë shumë e vështirë. Allahu na ruajttë prej këtij zemërimi.

[1] I njëjti burim, f. 229.
[2] "Kenzul-um'màl", vëll. 7, f. 141.

MJEKIMI I ZEMËRIMIT BËHET NË GJENDJE QETËSIE SHPIRTËRORE PRERJA E LËNDËS SË ZEMËRIMIT DHE MJEKIMI I SHKAQEV TË NDEZËZVE TË ZEMËRIMIT

Shkaqet që e ndezin zemërimin janë të shumta. Prandaj ne do të përmendim disa, më të rëndësishmet, prej këtyre shkaqeve. Një prej këtyre shkaqeve dhe mbase më i rëndësishmi është kjo botë, të cilën duhet ta emërtojmë "nëna e sëmundjeve", sepse prej kësaj bote gjenerohen shumë prej sëmundjeve shpirtërore. Madje prej saj gjenerohen të gjitha sëmundjet shpirtërore. Kjo mësohet prej transmetimeve të shumta. Në një prej tyre thuhet: "Dashuria për këtë botë është kreu i të gjitha mëkateve e gabimeve."

Dashuria për pasuri e dëshira për autoritet, dashuria për të pasur sa më shumë fuqi e sa më shumë ndikim, si dhe dashuria për të ngrënët, veshjet, martesën e për dëshira të tjera të ngjashme, të gjitha këto janë prej degëve të dashurisë për këtë botë dhe të dashurisë për veten. Prandaj të gjitha shkaqet që sjellin ndezjen e zemërimit, patjetër duhet t'i referohen dashurisë për këtë botë.

Kur njeriu bëhet i varur prej punëve të kësaj bote, dashurinë për këtë botë e ka varur në qafë si medaljon. Sikur në këtë njeri të ndodhë edhe forma më e ulët e problemeve për shkak të punëve të lartpërmendura, menjëherë gjaku i zemrës së tij arrin pikën e vlimit për të sprapsur problemin, fuqia e zemërimit merr zjarr e sulet ashtu siç sulen qentë mbi kërmën. Kur qentë e kanë stomakun bosh, garojnë njëri me tjetrin dhe çdo qen mundohet të largojë të tjerët prej kërmës. Kështu fillon beteja. Për këtë

çështje, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!), ka thënë: "Kjo botë është kërmë dhe ata që e kërkojnë këtë botë janë qenë."[1]

Mbase, ana e përngjasimit në metaforën e Prijësit të besimtarëve, të Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!), shpreh vlimin e fuqisë së zemërimit në shpirtin e njeriut, në atë mënyrë që kjo fuqi është në rangun e qenit, ose është vetë qeni.

Në përgjithësi, mjekimi i domosdoshëm për shumicën e punëve të këqija qëndron në mjekimin e dashurisë për këtë botë dhe kurimin e dashurisë ndaj vetes. Me mjekimin e këtyre dy dashurive shpirti do të jetë i qetë e i sigurt, zemra qetësohet dhe në zemër hyn siguria. Në këtë gjendje njeriu nuk i kushton asnjë kujdes punëve të kësaj bote, në këtë gjendje ai arrin deri në atë gradë sa nuk tregon interes për asnjë lloj ushqimi e pijesh. Kur atë e shtrëngon ndonjëra prej punëve të kësaj bote, ai e pret atë me gjakftohtësi dhe e përballon me injorim.

Kjo ndodh për shkak se i dashuri i tij nuk janë ushqimet e banorëve të kësaj bote, pasi kjo gjë nuk i intereson atij.

Shkulja e rrënjëve të dashurisë për këtë botë, është punë shumë e vështirë, sidomos në fillim të nisjes së rrugëtimit për te i Vërteti Fuqiplotë. Por dihet se çdo punë e vështirë bëhet e lehtë në sajë të këmbënguljes e të vendosmërisë. Megjithatë fuqia e vullnetit qëndron mbi çdo punë të vështirtë e të rëndë, njëkohësisht vendosmëria i afron të gjitha rrugët e largëta dhe bën që çdo lartësi të ngjitet me lehtësi.

Ai që ka nisur rrugëtimin për te Allahu i Lartësuar, patjetër duhet të parashikojë që në fillim të punës duhet të jetë i prerë për këtë lëndë, që të sprapsë këtë sëmundje shkatërruese dhe, në mënyrë graduale, të shpenzojë kohën, mendimin dhe të shtojë ushtrimet e përpjekjet. Në këtë rrugëtim ai i pret të gjitha degët e dashurisë për këtë botë dhe i shkul shumë prej rrënjëve të kësaj dashurie, sepse vetëm kështu ai mund të ketë sukses në arritjen e qëllimit, prandaj ai patjetër duhet të dijë se dashuria për këtë botë dhe

[1] "Gararul-Muhkim", f. 137, me disa ndryshime të vogla.

dashuria për veten, në rrugëtimin e njeriut për të Allahu i Lartësuar, është një ferrë që e pengon të arrijë çdo qëllim e çdo person që ai synon të arrijë.

Nëse ai është prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes (ehlul-maërifeh), nëse është tërheqës e joshës, për këtë njeri dashuria për këtë botë është perdja më e madhe që e ndalon të shohë bukurinë e të Dashurit.

Methnàviu në fillimin e një poezie thotë:
Nëna e idhujve është vetja jote.[1]

Bashkëbiseduesi me Allahun e Lartësuar, Profeti Musa *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!),* pavarësisht se ishte në pozitën e lartë të profetësisë dhe pavarësisht nga dituria e madhe që i ishte dhënë pas atyre ushtrimeve të shumta, kur vuri këmbën e tij në vendin e shenjtorëve dhe të dashuruarve me të Vërtetin, në kohën kur nxitonte të takohej me të Dashurin, prej Allahut të Lartësuar i erdhi urdhri:
إِنِّيٓ أَنَا۠ رَبُّكَ فَٱخۡلَعۡ نَعۡلَيۡكَ إِنَّكَ بِٱلۡوَادِ ٱلۡمُقَدَّسِ طُوٗى ١٢ *"…fakhlaë naëlejke in'neke bilvàdil-mukad'desi tuven"* "…hiqi këpucët se je në luginën e shenjtë Tuva."[2] dhe e ndaloi atë prej dashurisë për familjen e për fëmijët.

Bëj kujdes, kur në ty është dëshira e hyrjes në luginën e dashurisë, dije se kjo është lugina e shenjtorëve të sinqertë, prandaj hyrja në këtë luginë nuk mund të realizohet krah për krah me dashurinë për një tjetër, megjithëse dashuria e Musait nuk ishte si dashuria e të ngjashmëve me ne. Ka mundësi që shprehja "hiqi këpucët", në ajetin e nderuar ka ardhur në kuptimin se këpucët janë në fundin e të gjitha gjymtyrëve dhe heqja e këpucëve është punë fare e lehtë.

Në tërësi, dëshira për njohjen e Allahut nuk mund të qëndrojë në zemër përkrah dashurisë për këtë botë dhe përkrah dashurisë për veten, për faktin e qartë se, edhe kur dëshira për njohjen e Allahut është në pozitën e edukimit të brendshëm, në pozitën e pastrimit të zemrës dhe për vënien në vijë të drejtë moralet, përsëri dëshira për njohjen e të Vërtetit nuk mund të qëndrojë krah për-krah me dashurinë për këtë botë e përkrah dashurisë për

[1] Poezia është në gjuhën perse.
[2] Sure "Ta-Ha", ajeti 12.

veten, për shkak të prerjes së lëndës të të gjitha veprimeve shkatërruese shpirtërore dhe për shkak të stolisjes me virtyte.

Fillimi i të gjitha rregullimeve qëndron në balancimin e tri fuqive: fuqia e shpresave djallëzore, fuqia e dëshirave kafshërore dhe fuqia e zemërimit grabitqar.

Dashuria për këtë botë i nxjerr këto tri fuqi jashtë kufirit të balancimit. Ndezja e zjarrit të dëshirave dhe ndezja e zemërimit janë prej ndikimeve të dashurisë për veten dhe e dashurisë për këtë botë. Me këto ndikime, fuqia e shpresave djallëzore del jashtë sekretit të balancimit dhe merret me planifikime djallëzore.

Kur njeriu është në lidhje me jetën në Botën Tjetër dhe me lulishten e punëve me anë të rrugës së devotshmërisë e të punëve të mira dhe njëkohësisht e dashuron shumë këtë botë, ai nuk është në përshtatje në asgjë me shkallët e këtyre që u thanë më sipër.

Dashuria për këtë botë e bën njeriun të ketë dëshirë të madhe që të mos ndalet as para punëve të ndaluara prej Allahut dhe e largon atë prej detyrimeve me të cilat e ngarkon njeriun ligji i fesë. Gjithashtu, dashuria për këtë botë e bën njeriun që ai të mos kryejë detyrimet që plotësohet me anë të pasurisë, bën që ai të mos e nxjerrë zekatin, të mos japë një të pestën e fitimit, të mos kryejë detyrën e Haxhit, apo detyra të tjera të ngjashme dhe, këto punë ai i le nga dëshira e madhe që ka për të grumbulluar sa më shumë pasuri. Njëkohësisht, i dashuruari me këtë botë, në rrugën e zhvillimit të trupit le detyrimet e urdhëruara që kryhen fizikisht, siç është agjërimi, falja e namazit e të ngjashme me këto dy adhurime.

Në tërësi, këto janë nëna e sëmundjeve, me të cilat njeriu vihet në provë me llojet të ndryshme sprovash dhe me rrugën e dashurisë për këtë botë, puna e njeriut përfundon me shkatërrimin e tij të përjetshëm. Prandaj njeriu ka detyrim të qëndrojë syhapur dhe të mos e shkojë kot këtë jetë që atij ia ka dhënë Allahu i Gjithëfuqishëm për të arritur lumturinë e përjetshme. Gjithashtu, njeriu kurrë s'duhet të heqë dorë prej këtij afati kohor pa ndonjë çmim e pa ndonjë kompensim, ndryshe do të sprovohet me humbje e me dëmtim.

I dashur njeri, prej përmirësimit e prej degjenerimit tonë, ose prej lumturisë e prej vështirësive tona asnjë dobi e asnjë dëm nuk arrin te i Vërteti i Lartësuar *(Allahu na ruajt nga ky mendim),* ose te profetët e mëdhenj kumtues të shpalljes, ose te eulijatë (të dashurit e Allahut)e nderuar.

Sikur të prishet e gjithë bota, asnjë defekt nuk ndodh në mbretërinë e të Vërtetit të Lartësuar, sikur të përmirësohej e gjithë bota, në mbretërinë e të Vërtetit të Lartësuar nuk ndodh asnjë zgjerim.

Njerëzit dhe çdo gjë që ka lidhje me njerëzit, përballë madhështisë së cilësive hyjnore, s'kanë asnjë fuqi të ndjeshme që përmirësimi e degjenerimi i tyre të jetë objekt për t'u shikuar.

Zbritja e revelatës dhe e urdhrave hyjnorë me këto parapërgatitje, mundi e lodhja e profetëve dhe sakrificat e të dashurve të Allahut (eulijave), të gjitha këto janë për përmirësimin tonë. Ata na kanë mësuar si është fundi i keqbërësve. Ata kanë dituri për krijesat e padukshme dhe kanë qëllim të na zgjojnë ne që jemi në gjumë dhe të na mësojnë ne detyrat tona.

Ne, të mjeruarit, zgjohemi prej këtij gjumi të rëndë në një kohë kur puna ka dalë prej duarve tona dhe ne s'kemi më mundësi të drejtojmë punën tonë.

Prandaj për ne në atë ditë (Ditën e Gjykimit) s'ka asgjë tjetër përveç humbjes e pendimit dhe asgjë nuk sjell dobi për ne. Këtë e njofton Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij: وَأَنذِرۡهُمۡ يَوۡمَ ٱلۡحَسۡرَةِ إِذۡ قُضِيَ ٱلۡأَمۡرُ وَهُمۡ فِي غَفۡلَةٖ *"Ue endhirhum jeumel-hasreti idh kudijel-emru ue hum fij gafletin…"* "Paralajmëroi ata për ditën e dëshpërimit kur të marrë fund çështja (e gjykimit të punëve), pasi ata janë të pakujdesshëm…"[1]

[1] Sure "Merjem", ajeti 39

QËLLIMI I DYMBËDHJETË

DITURIA, E KUNDËRTA, INJORANCA NË KËTË KAPITULL KEMI KATËR NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME DITURINË E INJORANCËN

Mëso se dituria e injoranca, në këtë temë, janë bërë prej ushtrive të mendjes e prej ushtrive të injorancës, por që të dyja nuk janë as vetë mendja e as vetë injoranca, sepse, siç kemi thënë më përpara, mendja në njeriun shpreh mendjen e zhveshur dhe përballë kësaj mendjeje qëndron fuqia e imagjinatës, e cila gjithashtu është më pak se zhveshja mendore. Në të vërtetë, fuqia e mendjes shpreh mendjen e përgjithshme, e cila është mendja e botës së madhe, përballë së cilës qëndron injoranca, e cila është iluzioni në përgjithësi. Mundet që kjo punë, në gjuhën e ligjit të pastër të fesë, është shprehur me djallin. Hollësitë në lidhje me këto dy çështje ne i kemi përmendur më përpara.

Në këtë pozitë, dituria e injoranca, të dyja shprehin të vërtetën e punëve që u thanë më sipër. Puna e mendjes është dituria, sepse mendja

është e vërteta e zhveshur dhe e pa mbuluar. Gjithashtu, është vërtetuar me argument se kjo e vërtetë është racionale dhe erudite."[1]

Injoranca, edhe nëse është e zhveshur dhe erudite, sepse në të është zotëruese ana e mbretërisë së natyrës, të gjitha konceptet e injorancës vijnë nga ana e mosnjohjeve të përbëra, që nuk janë në përputhje me sistemin e përgjithshëm e me bukurinë hyjnore.

Dituria e injoranca, nga afërsia që ka me daljen e transmetimit prej pozitës së shenjtë, ka mundësi që, e para, të shprehë diturinë për Allahun e Lartësuar dhe për punët që kanë lidhje me qenien e Tij, si dhe diturinë për cilësitë e Tij, nga këndvështrimi se ato janë prej argumenteve e prej shenjave hyjnore; kurse, e dyta, injoranca, qëndron në pozitat e mbuluara.

Nga sa u tha, rezulton se konceptet logjike janë koncepte që kanë lidhje me të Vërtetin e Gjithëfuqishëm, kurse konceptet e injorancës janë djallëzore dhe kanë lidhje me pemën e keqe, e cila është origjina e origjinave të injorancës dhe e rrugëve të gabuara.

Shpjeguar më me hollësi nga ky përgjithësim arrihet në deduksionin: për të gjitha qeniet e mundshme ka dy anë e dy orientime: ana dritë, realizim e plotësim. Kjo është ana e orientimit të padukshëm hyjnor, kurse ana tjetër është errësirë, emërtim, jo esenciale e mangësi, është orientimi vetjak i sendeve.

Në orientimin e parë, sendet janë prej punëve hyjnore dhe të argumenteve që vërtetojnë se Allahu është Zoti Një e i Vetëm. Mbase qëllimi në hadithin e nderuar, i transmetuar në librin "El-Kàfij", i ardhur prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!):* **"Në të vërtetë, dituria është tri kategori: argument ekzakt…",** kërkon të shpjegojë se prej argumenteve ekzakte është dituria për sendet me orientimin dritë, e shoqëruar me njohjen e Allahut të Lartësuar. Në këtë orientim, puna e mendjes është të kuptojë këtë anë dritë, e cila është argument hyjnor. Kurse puna e iluzionit dhe e injorancës dhe

[1] "El-Esfârul-erbeah", vëll. 3, f. 447, Etapa e dhjetë.

emërtimi i sendeve, është injoranca e përbërë, është mirazh i gabuar, në të cilin s'ka asgjë nga e vërteta: **"Dëgjoni me vëmendje, çdo send është i gabuar, përveç Allahut të Lartësuar."**[1]

Është përcjellë prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!):* **"Poezia më e sinqertë që kanë thënë arabët, është kjo poezi."**[2]

[1] Është plotësimi i një strofe: *"dhe çdo mirësi është e pamundur të mos zhduket";* marrë prej divanit të Lebidit, f. 148.
[2] El-Fejd el-Kashànij, "Ilmul-jekijn", vëll. 1. 106.

NDARJA E DYTË

DITURIA ËSHTË VIRTYTI MË I BUKUR

Mëso se diturìa është prej plotësimeve me të bukura dhe prej virtyteve më të mëdha: diturìa është prej emrave hyjnorë më të nderuar dhe prej cilësive të Qenies së Shenjtë, me të cilën Ajo është prezent. Në sajë të begatisë së diturisë është realizuar sistemi i ekzistencës dhe është modeluar e padukshmja dhe ajo që shihet. Të gjitha qeniet realizohen gjithnjë e më shumë në sajë të kësaj të vërtete të nderuar. Diturìa është në pozitën e të Vërtetit dhe në gradën e shenjtërisë, detyrimisht më e afërt; madje diturìa dhe ekzistenca janë në të njëjtën vazhdë. Sa herë bie një rreze prej ekzistencës, në të njëjtën shkallë bie edhe një rreze prej dritës së diturisë. Gjithashtu, edhe boshllëku prej çdo të vërtete të diturisë, është boshllëk prej çdo të vërtete të ekzistencës dhe, ai që është bosh prej diturisë, në mënyrë absolute, është inekzistent. Kjo çështje është vërtetuar me argumente të fuqishme, që theksojnë në mënyrë të prerë se bota e ekzistencës është bota e diturisë. Asnjë grimcë prej grimcave të qenieve, madje edhe prej trupave të ngurtë e prej bimëve, nuk është pa dituri dhe çdo njëra prej grimcave të të gjitha qenieve, sipas shkallës së ekzistencës së saj, ka pjesën e vet të diturisë.

Edhe pse prej thënieve të disa filozofëve të mëdhenj, në kapitullin e unitetit të inteligjentit me të logjikshmen, nga ana e jashtme e këtyre thënieve duket se bota e natyrës është e zhveshur prej universales dhe prej informacionit[1], kurse, në raport me ne, këto thënie të filozofëve, nuk janë shpjegim i plotë.

Këtë çështje ne e kemi vërtetuar me argumente brilante e të fuqishme dhe kemi thënë se është prej punëve të besimit te Allahu, Zoti

[1] Ibn Sijnà, "El-Ishàràtu uet'tenbijhàtu", vëll. 3, f. 292.

Një e i Vetëm (teuhid). Kësaj kërkese, i Vërteti i Lartësuar i kushton një kujdes shumë të madh në shumë ajete të Kur'anit Famëlartë. Në Librin e zbritur, i Vërteti njofton hapur lidhjen e diturisë së qenieve me vetë të Vërtetin e Gjithëfuqishëm dhe me madhërimin që i bëjnë Atij qeniet.

Të mbuluarit nuk e gjejnë këtë kërkesë në argumentet, ose në këndvështrimin e unitetit, prandaj ata madhërimin e kanë mbartur në kuptimin e madhërimit konstruktiv.[1] Por ashtu siç është e qartë, këtu nuk kemi të bëjmë me madhërim konstruktiv.

"مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ" *«men fi-s'semàti"* **"kush është në qiej"**, në kuptimin e qenieve të arsyeshme.

Ata që kanë arritur gradën e njohjes, të vërtetën e kanë kuptuar me shikimin e prezencës. Nëse do t'i referohemi atyre, do të gjejmë se ata kanë deklaruar hapur se shikimi i prezencës nuk e pranon shpjegimin me madhërimin konstruktiv, ose me përmendjen konstruktive (thënien "subhane-llàh" e ziqrin e qenieve sipas gjuhës së gjendjes në të cilën ato janë krijuar).

Në përgjithësi, dijetarët e mendimtarët mosekzistencën e kanë bërë argument kundër ekzistencës, megjithëse ata nuk e kanë kuptuar as diturinë e engjëjve të Allahut dhe as diturinë e të Vërtetit të Lartësuar.

Në tërësi: njeriu jeton me një horizont të kufizuar në ekzistencën e tij dhe kjo ndodh për shkak se njeriu është i zhytur brenda në natyrën, për rrjedhojë ai është i mbuluar (s'ka dijeni) për gjithçka që nuk është e natyrës. Njeriu nuk i kupton botët që janë sipër tij e botët që janë poshtë tij, madje njeriu s'ka dijeni të plotë as për vetë qenien e tij.

---

[1] "Et'tefsijrul-Kebijr", vëll. 29, f. 206-207. Ne themi se mbartja e madhërimit të lartpërmendur, në ajetin e nderuar, qëndron në madhërimin me fjalë dhe ky është qëllimi i fjalës së të Vërtetit: "مَا فِي السَّمَاوَاتِ" *"mà fi-s'semàti"* **"çka në qiej",** kurse në fjalën "مَا" *«mà"* **"çka"** të ajetit, ne e mbartin në kuptimin "مَنْ" *"men"*

Kjo mospasje dijeni është edhe shkaku që njeriu thotë se kjo lëkurë e kjo kockë e ky trup janë me natyrë hyjnore, por konceptet që merren me anë të ndijimeve e me anë të fantazisë, e bëjnë njeriun të jetë i shkujdesur që ai të mësojë të vërtetën rreth esencës e origjinës së vet, prandaj njeriu priret vetëm nga kjo anë dhe e konsumon të gjithë vullnetin e dëshpërimin e vet për interesa pronësore, me qëllim që të kënaqë e të sistemojë kërkesat e barkut e të seksit përkatës dhe duke qenë i shkujdesur për të ditur edhe si është vetja e tij, patjetër që ai jo vetëm që nuk ka dijeni për qëllimet njerëzore, por nuk hedh asnjë hap që të mësojë këto qëllime.

Po, një njeri i këtillë nuk njeh asgjë tjetër përveç jetës kafshërore dhe nuk merakoset për asgjë tjetër përveç qëllimeve kafshërore.

Në tërësi, dituria dhe në mënyrë të veçantë dituria rreth Allahut, rreth emrave të Tij, rreth cilësive të Tij dhe rreth argumenteve që vërtetojnë Qenien e Tij të Shenjtë, domethënë dituria që ka lidhje me të Vërtetin e Lartësuar është prej virtyteve më të bukura.

Dituria e rritur me anën e rrugës së argumenteve dhe të rrugëve të nxjerrjes së argumenteve, si dhe dituria rreth elementeve shkatërruese dhe elementeve shpëtuese, dituria për ligjet e për etikën e legjislacionit të pastër hyjnor, është prej kërkesave të patjetërsueshme, sepse me këtë dituri arrihet dituria për Allahun dhe kjo dituri është qëllimi origjinal dhe qëllimi kryesor.

Të gjitha dituritë e legjislacionet e vërteta, të gjitha punët e obliguara dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me diturinë rreth feve, pa ndërmjetësim, ose me ndërmjetësim, të gjitha kthehen te dituria për Allahun. Dituria për Allahun, në shembullin e argumentit, nuk është qëllim origjinal, por është peshorja në plotësimin për njohjen e Allahut dhe shkalla e fundit e kësaj njohjeje, konsiderohet asgjësimi absolut. Natyrisht ky asgjësim nuk mund të realizohet ndryshe veçse me heqjen dorë prej të dukshmeve, me refuzimin e pluhurit të egoizmit dhe të gjendjes së tanishme. Allahu na furnizoftë ne dhe të gjithë besimtarët me këtë dituri.

NDARJA E TRETË

DITURIA ËSHTË PREJ SHOQËRUESVE TË CILËSISË SË PASTËR TË KRIJIMIT DHE PREJ USHTRIVE TË ARSYES

INJORANCA ËSHTË PREJ SHOQËRUESËVE TË CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT DHE PREJ USHTRIVE TË IBLIJSIT

Mëso se ky referim, në cilësinë e krijimit të njeriut, ka lidhje me ato që kemi thënë më sipër se të gjithë njerëzit dëshirojnë të arrijnë plotësimin absolut dhe e urrejnë mangësinë.

Duke qenë se dituria është e barabartë me plotësimin absolut, atëherë rezulton se dashuria e madhe për arritjen e plotësimit, është dashuri e madhe edhe për arritjen e diturisë. Gjithashtu, rezulton se injoranca është binjake me mangësinë dhe, gjithnjë duke iu referuar cilësisë së pastër të krijimit të njeriut, del qartë se vetë dituria, në formën e saj të përgjithshme, është burimi që lidhet me cilësinë e pastër të krijimit, kurse injoranca është burimi i neverisë ndaj mangësisë.

Qëllimi më i lartë në këtë punë është ndryshimi në verifikimin e diturive, por edhe ky ndryshim, gjithashtu, është mbulim i cilësisë së krijimit. Me fjalë të tjera, dituria absolute është burim i dashurisë së madhe të cilësisë së krijimit, domethënë: është lidhja e pandarë që dituria ka me

cilësinë e pastër të krijimit. Është domosdoshmëri të mësohet se dituria, në kuptimin e përhapur që ka ndër njerëzit e zakonshëm, shpreh diturinë për konceptet dhe titujt, kurse dituria e skicuar nuk është burim për dashurinë e madhe të cilësisë së krijimit, sepse këto punë, nëse do të ishin të orientuara me cilësinë e krijimit, dihet se vetë orientimi është prej anëve të mangëta dhe, sa herë që në cilësinë e krijimit ka mangësi, atëherë ajo është jashtë kufirit të dashurisë së madhe dhe jashtë cilësisë së pastër të krijimit. Të gjitha dituritë, pjesore dhe të përgjithshme racionale, nuk janë burim për dashurinë e madhe të cilësisë së pastër të krijimit, madje as edhe dituria për Allahun e Gjithëfuqishëm, për punët e Tij personale e të cilësive e të veprave të Tij, sepse burimi i lidhjes së cilësisë së krijimit e dashuria e saj, është njohja në shembullin e shikimit të objektit që është prezent. Por kjo arrihet me heqjen e perdes mbuluese, pasi të gjitha perdet e mbulesat kanë të bëjnë me mangësinë e me mosekzistencën. Kurse cilësia e pastër e krijimit arrin te i dashuri i saj e te i kërkuari prej saj, kur hiqen të gjitha perdet errësuese të dritës, atëherë ajo sheh bukurinë absolute pa asnjë mbulesë të ardhur prej të emërtuarave. Në këtë shikim arrihet prezenca e çdo plotësimi dhe cilësia e pastër e krijimit arrin te i dashuri i saj.

Për këtë lidhje njofton i Vërteti me fjalën e Tij: أَلَا بِذِكْرِ ٱللَّهِ تَطْمَئِنُّ ٱلْقُلُوبُ *"…elà bidhikril'làhi tatmein'nul-kulàbu"* "…dëgjoni me vëmendje, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat."[1] dhe "وَإِلَى اللهِ الْمَصِيْرُ" *"…ue ile-ll'llàhil-mesijru"* "…vetën te Allahu është e ardhmja."[2], domethënë, vetëm te Allahu është kthimi dhe e ardhmja.

Prej shpjegimeve dhe prej kërkesave të mësipërme, del qartë se dituria është prej shoqërueseve e prej domosdoshmërive të cilësisë së pastër të krijimit, në kuptimin, nëse cilësia e krijimit nuk është e mbuluar dhe kurrë s'ka hyrë në mbulesën e natyrës, ajo do të orientohet kah dituria absolute dhe, kur ajo mbulohet, patjetër që sipas masës së mbulimit, po kaq e vonuar do të jetë ajo prej njohjes, derisa arrin në pozitën kur do të jetë injorancë absolute.

[1] Sure "Er-Rrad", ajeti 28.

[2] Sure "Al-Imràn", ajeti 28 dhe sure "En-Nur", ajeti 42.

NDARJA E KATËRT

KUJTESË NË LIDHJE ME DISA MIRËSI TË DITURISË NË HADITHE

Përshkrimi i plotë i virtyteve të diturisë është jashtë kuadrit të fuqisë dhe nuk hyn në peshoren e shkrimit të kësaj përmbledhje, sepse Kur'ani Famëlartë ka treguar interes të madh ndaj diturisë, dijetarëve dhe njerëzve të mësuar, aq sa njeriu, në kuadrin e këtij interesi të Kur'anit për diturinë, mbetet në mëdyshje se në cilin prej ajeteve të Kur'anit të kapet. Në Kur'an lexojmë nderimin e Ademit *(Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për të!):* " **وَعَلَّمَ آدَمَ الأَسْمَآءَ كُلَّهَا**" *"ue al'leme Àdemel-esmàse kul'lehà…"* "dhe Ai (Allahu) i mësoi Ademit të gjitha emrat (e sendeve)…"[1]

Kur'ani Famëlartë e bëri mësimin e emrave për Ademin shkak që ai të renditej më lart se kategoritë e engjëjve të Allahut dhe me këtë nderim vërtetoi virtytin e Ademit mbi të gjitha krijesat, duke e pajisur atë me dituri dhe me mirësinë e mësimit të emrave.

Pozitën e lartë që ka e vërteta e diturisë, e bën të qartë fakti që, për të theksuar pozitën e lartë të diturisë, Allahu i Lartësuar i la të mangët engjëjt e Tij në fushën e emrave të sendeve. Me këtë mirësi të madhe ai nderoi vetëm Ademin.

Nga sa u tha më sipër, mësohet se dituria për emrat është mirësia më e madhe nga të gjitha mirësitë dhe se kjo dituri nuk është dituria që arrihet me rrugën e argumentimit dhe në asnjë mënyrë nuk është dituria për konceptet, përgjithësimet e konsideratat, sepse në diturinë për emrat që iu

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 31.

mësua Ademit, i Vërteti i Lartësuar ka vënë një shkak që e bën Ademin të jetë krenar dhe që ai të respektohet prej krijesave të tjera.

Qëllimi me diturinë, në këtë kapitull, është dituria për të vërtetën e emrave dhe për të parë asgjësimin e njerëzve në të Vërtetin, me të cilin vihet në vijë të drejtë e vërteta e emrave. Nga ana tjetër, Iblijsi shikonte në baltën e në Ademin, në zjarrin dhe në veten e vet në mënyrë të pavarur. Por ky shikim është thelbi i injorancës, është rruga e humbjes së qartë dhe baza e krahasimit.

Iblijsi, edhe pse ishte në një pozitë shumë të respektuar, nuk e dinte se edhe në mënyrën e shikimit ka krahasues dhe se kjo mirësi, gjithashtu, është prej qëllimit të plotësimit e të madhështisë, sepse shikimi i të Vërtetit të Lartësuar, është një pozitë e veçantë dhe nuk është shikim vetëm me fjalë, ashtu siç është thjesht portretizim me fjalë përshkrimi i engjëjve. Por është shikim personal i mirëfilltë, veç kësaj vetë plotësimi i ekzistencës është argument që vërteton unitetin, ashtu siç është pohuar për këtë çështje në vendin e duhur[1] pa përmendur cilësi të tjera të veçanta.

Gjithashtu, pozita e dhembshurisë së Allahut vërtetohet edhe për dijetarët dhe ky plotësim është i atillë që s'ka plotësim tjetër më lartë se ky, plotësim për të cilin Allahu ka bërë të veçantë diturinë e interpretimit të Kur'anit. Këtë e deklaron vetë Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij:

"وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيْلَهُ إِلاَّ اللَّهُ وَالرَّاسِخُونَ فِي الْعِلْمِ" *"ue mà jaëlemu teëvijlehù il'le-ll'llàhu uerr'rràsikhùne fil-ilmi"* "por përveç Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë dhe të vendosurit në dituri…"[2] pa përmendur veçori të tjera, të cilat Allahu i Lartësuar i ka përmendur në lidhje me diturinë dhe në lidhje me dijetarët, si: besimi, teuhidi, frika, përulja, nënshtrimi e virtyte të tjera të ngjashme, të përmendura në Kur'anin Famëlartë.

---

1 Lexo "Tefsijrul-Kur'ànil-kerij", autori Muhjud'dijn bin Arebij. Në origjinë ky interpretim është prej interpretimeve të Mulla Abdu-rr'rrez'zàk Elkàshànij, vëll. 1, f. 173, si dhe "Et'tefsijru-s'sàfij", autori Elfejd, vëll. 1, f. 299.

2 Sure "Al-Imràn", ajeti 7.

Përsa u përket transmetimeve që flasin për virtytet e diturisë, ato janë të shumta dhe është e pamundur të njihemi me të gjitha, prandaj, cilido që ka dëshirë të njihet me këto transmetime, i rekomandojmë të lexojnë librat e sahabëve.[1]

Gjithashtu edhe Dëshmori Seijd *(Allahu e mëshiroftë!),* në librin e tij "Menij'jetul-murijd", ka transmetuar një pjesë të mirë prej këtyre transmetimeve, prandaj i rekomandojmë studiuesve të lexojnë edhe këtë kumtesë hyjnore dritëdhënëse.

[1] "El-Kàfij", vëll. 1, libri "Fadlul-ilmi"; "Bihàrul-Envàr", vëll. 2, K. 8, f. 1-25.

QËLLIMI I TREMBËDHJETË

KUPTIMI, E KUNDËRTA, IDIOTËSIA NË KËTË KAPITULL KEMI TRI NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME KUPTIMIN DHE ME IDIOTËSINË

Fjala kuptim, herë thuhet për shpejtësinë e transmetimit e të arsyetimit, herë thuhet për pastërtinë e brendshme dhe për mprehtësinë e personit, dy cilësi këto që detyrimisht sjellin shpejtësinë e transferimit. Përballë së parës qëndron idiotësia dhe përballë së dytës qëndron trazira shpirtërore, por që të dyja i shoqëron çmenduria e idiotësia. Sido që të jetë gjendja e idiotësisë, kjo fjalë, në përgjithësi, thuhet përballë kuptimit, ose është shoqëruese përballë kuptimit.

Ka mundësi që këtu qëllimi me kuptimin të jetë vënia në konsideratë e daljes së tij prej pozitave të revelatës, të profetësisë dhe të edukuesve të njerëzve e të njerëzimit, si dhe gjendja e pastërtisë së brendshme për të kuptuar gjërat shpirtërore. Ashtu siç është idiotësia një gjendje turbullire dhe errësire për shpirtin dhe, pikërisht kjo gjendje, sjell pamundësinë për të kuptuar të vërtetat shpirtërore dhe kërkesat e njohjes.

Është detyrë të dihet se shpirti njerëzor, në fazën e parë është i qartë e i pastër si një pasqyrë, pa asnjë lloj turbullire e pa asnjë lloj errësire. Kur

kjo pasqyrë e pastër ndriçuese vihet përballë botës së dritave e sekreteve që janë në përshtatje me esencën e vetë pasqyrës, atëherë në mënyrë graduale, ajo do të lartësohet prej pozitës së mangësisë ndriçuese dhe do të ngjitet në drejtim të plotësimit shpirtëror e drejt dritës, derisa të çlirohet krejtësisht prej të gjitha llojeve të turbullirave dhe errësirave, domethënë, njeriu del përfundimisht prej fshatit të errësuar të natyrës dhe e braktis shtëpinë e ndërtuar të shpirtit.

Në këtë gjendje pjesa e tij është shikimi i bukurisë së më të Bukurit dhe shpërblimin që i takon njeriut për këtë lartësim e ka marrë përsipër vetë Allahu i Lartësuar.

Mbase ajeti i nderuar vijues tregon pikërisht për këtë kuptim:

۞وَمَن يُهَاجِرۡ فِي سَبِيلِ ٱللَّهِ يَجِدۡ فِي ٱلۡأَرۡضِ مُرَٰغَمٗا كَثِيرٗا وَسَعَةٗۚ وَمَن يَخۡرُجۡ مِنۢ بَيۡتِهِۦ مُهَاجِرًا إِلَى ٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ ثُمَّ يُدۡرِكۡهُ ٱلۡمَوۡتُ فَقَدۡ وَقَعَ أَجۡرُهُۥ عَلَى ٱللَّهِۗ وَكَانَ ٱللَّهُ غَفُورٗا رَّحِيمٗا ١٠٠

"…ue men jakhruxhu min bejtihi muhàxhiren ile-ll'llàhi ue resùlihi thum'me judrikhul-meutu fekad veka'a exhruhù ale-ll'llàhi, ue kàne-ll'llàhu gafùren rahijmen"

"…dhe ai që del prej shtëpisë së vet për të emigruar te Allahu dhe te i Dërguari i Tij, por më pas ai vdes (në këtë rrugëtim), shpërblimi për atë është te Allahu."[1] gjithashtu edhe ajeti tjetër:

ٱللَّهُ وَلِيُّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ يُخۡرِجُهُم مِّنَ ٱلظُّلُمَٰتِ إِلَى ٱلنُّورِۖ

"Ell'llàhu veliju-l'ledhijne àmenù jukhrixhuhum mine-dh'dhulumàti ile-n'nùri…"

"Allahu është ndihmësi i besimtarëve, Ai i nxjerr ata prej errësirave në dritë…"[2]

Po, për atë që në brendësinë e vet ka administrues e veprues të Vërtetin e Lartësuar dhe në mbretërinë e ekzistencës së tij s'ka asgjë tjetër përveç të

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 100.
[2] Sure "El-Bekare", ajeti 257.

Vërtetit të Lartësuar, atëherë trualli i tij i errësuar shndërrohet në dritë hyjnore.

Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar وَأَشۡرَقَتِ ٱلۡأَرۡضُ بِنُورِ رَبِّهَا *"Ue eshrekatil-erdu binùri rab'bihà…"* "dhe toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet…"[1] Një person i tillë shpëton prej të gjitha llojeve të errësirave e turbullirave dhe përfundimisht arrin në dritën absolute, e cila është e barabartë me unitetin absolut. Ka shumë mundësi, që parë nga kjo anë, i Gjithëfuqishmi e ka përmendur dritën në numrin njëjës, kurse errësirën e ka përmendur në numrin shumës.

Kur pasqyra e pastër e shpirtit vihet përballë botës së turbullirës dhe errësirës, si dhe përballë shtëpisë së natyrës, e cila është më e ulëta e të ulëtëve, atëherë për shkak se natyra është në kundërshtim me esencën e vetë ekzistencës së saj, që është prej botës së dritave, atëherë turbullira e botës së natyrës ndikon gradualisht në atë, derisa e bën errësirë dhe turbullirë të plotë, duke dalë zotërues në faqen e pasqyrës (pasqyra e vetes së tij) pluhuri e mbulesa e trashë e natyrës. Është ky pluhur e kjo mbulesë ajo që e verbon njeriun të kuptojë shpirtëroret, e pengon të kuptojë dituritë hyjnore dhe ia mbulon atij shpirtëroret, duke e privuar atë prej argumenteve e prej shenjave të Allahut. Me shtimin e këtij mbulimi e të kësaj idiotësie, nga dita në ditë, shpirti bëhet një Xhehen'nem prej llojit të Xhehen'nemit.

Për këtë njofton ajeti i nderuar: فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٞ فَزَادَهُمُ ٱللَّهُ مَرَضٗاۖ *"fij kulùbihin meredun fezàdehumu-ll'llàmeredan…"* "Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe Allahu ua shton atyre sëmundjen më shumë…"[2]

Dhe:

وَٱلَّذِينَ كَفَرُوٓاْ أَوۡلِيَآؤُهُمُ ٱلطَّٰغُوتُ يُخۡرِجُونَهُم مِّنَ ٱلنُّورِ إِلَى ٱلظُّلُمَٰتِۗ

[1] Sure "Ez-Zumer", ajeti 69.
[2] Sure "El-Bekare", ajeti 10.

"…uel'ledhijne keferù eulijàuhumu-ttàgùtu jukhrixhùnehum mine-n'nùri ile-dh'dhulumàti…" "…ata që nuk besuan, ndihmësit e tyre janë djajtë të cilët i nxjerrin ata (mohuesit) prej dritës për në errësirë…"[1], si dhe ajeti tjetër:

وَجَعَلْنَا عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ أَكِنَّةً أَن يَفْقَهُوهُ وَفِيٓ ءَاذَانِهِمْ وَقْرًا *"Ue xhealnà alà kulùbihim ekin'neten en jefkahùhu ue fij àdhànihin vakren…"* "Ne kemi vënë mbulesë në zemrat e tyre që ata të mos e kuptojnë atë (Kur'anin) dhe në veshët e tyre kemi vënë mbyllëse (që të mos e dëgjojnë)."[2]

Në shumë ajete të Kur'anit vihet theksi mbi këto dy pozita, të cilat janë vendi ku bie kujdesi i vetë të Vërtetit, sepse qëllimi origjinal, në të gjitha legjislacionet hyjnore, është përhapja e diturive. Por dituria nuk arrihet me ndonjë rrugë tjetër përveç rrugës së mjekimit të shpirtrave, largimit të shpirtrave prej errësirës së natyrës dhe shpëtimi i shpirtrave, duke i orientuar ato për në botën e dritave.

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 257.
[2] Sure "El-Isra", ajeti 46.

NDARJA E DYTË

NË LIDHJE ME KOMENTIMIN E KËTIJQËLLIMI DHE KËSHILLËS NË KËTË KAPITULL

I nderuar! Zgjohu pak prej gjumit të rëndë dhe merr rrugën e të dashuruarve të respektuar, laji duart e fytyrën prej pluhurit të kësaj bote, botës së errësirës, turbullirës e djallëzisë dhe jo vetëm që vëre këmbën në lagjen e të dashuruarve, por lëviz për te i Gjalli i dashur.

I dashur, shumë shpejt do të mbarojnë ditët e pakta të kohës hyjnore që na janë dhënë, pasi të gjithëve, me dashje e padashje, do të na marrin prej kësaj bote. Nëse do të shkosh si i preferuar, atëherë për ty ka gëzim, lulishte e respekt të Allahut. Nëse do të shkosh me imponim, atëherë për ty do të ketë zhveshje, trullosje, trysni, errësirë dhe turbullirë.

Shembulli ynë në këtë botë është si shembulli i një peme të shkulur në tokë. Sa më e afërt të jetë koha e mbjelljes, aq më e lehtë do të jetë puna për shkuljen e asaj peme. Një proverb thotë: "Sikur pema të ndiente dhimbjet e ndëshkimit, sa më të vogla e sa më të njoma të jenë rrënjët e pemës, edhe dhimbja e ndëshkimi që ajo do të ndiente, do të ishte shumë më pak. Pema e mbjellë në kohët e vona, shkulet me një tërheqje të vogël e pa asnjë lodhje, por, kur kanë kaluar disa vite nga mbjellja e pemës dhe rrënjët e asaj peme kanë depërtuar në thellësi të tokës, natyrisht që pema gjatë këtyre viteve i ka forcuar fibrat e saj kryesore e dytësore në brendësi të vetes dhe është forcuar, prandaj për heqjen e kësaj peme lind nevoja për sëpatën, për të prerë rrënjët e saj e për ta copëtuar atë. Atëherë, sikur pema

të kishte ndijim ndaj dhimbjeve kur ajo shkulet, sa do të ishte dallimi mes këtyre dy pemëve.

Rrënja e dashurisë për këtë botë dhe për veten është në pozitën e rrënjës kryesore dhe degëve të kësaj peme. Po kështu janë edhe dëshirat, lakmia, dashuria për familjen, për fëmijët, për pasurinë, për autoritet e për të ngjashme me këto. Sa më afër kohës së mbjelljes në shpirt të këtyre veseve, aq më e lehtë do të jetë edhe shkulja e këtyre veseve, gjithashtu aq më e lehtë do të ishte puna edhe për engjëjt e Allahut të ngarkuar me detyrën e marrjes së shpirtrave, pasi kjo punë nuk do të kërkonte as mundim e as nuk do të jetë e nevojshme që mbi shpirtrat e njerëzve të ushtrohet ndonjë trysni. Por, *(Allahu mos e lejoftë!),* sikur rrënjët e këtyre veseve të forcohen në botën e natyrës dhe sa më shumë të jenë shtrirë rrënjët e këtyre veseve, natyrisht që shtrirja e rrënjëve të veseve nuk do të jetë si shtrirja e rrënjëve të pemës, sepse rrënjët e veseve nuk përhapen në një pjesë të caktuar toke, por përhapen në të gjithë botën e natyrës.

Pema, sado e madhe të jetë, nuk zë më shumë tokë dhe nuk lëshon rrënjë në të gjithë tokën, kurse pema e dashurisë për këtë botë i lëshon rrënjët në të gjithë botën e natyrës, në të jashtmet e në të brendshmet dhe të gjithë botën e quan hapësirë personale.

Për të gjitha këto që u thanë, shkulja e dashurisë për botën e natyrës nga rrënjët, pa e prishur atë, është krejtësisht e pamundur, prandaj njeriu le të mësojë se, me dashurinë për këtë botë e për veten e vet, është në një rrezik shumë të madh, megjithatë ai ka mundësi e kohë të shikojë e të verifikojë botën e padukshme dhe me siguri do të vërejë se kanë mbetur disa gjëra prej jetës hyjnore. Patjetër që për atë është ngritur deri në një farë caku edhe ajo perdja e cilësive hyjnore. Në këtë gjendje njeriu sheh ato që janë përgatitur për atë në atë botë, sheh perdet që e ndajnë atë prej të dashurit të vet dhe, ky i dashuri është i Vërteti i gjithëfuqishëm, ai sheh perdet që e ndajnë atë prej nëpunësve të Allahut të Lartësuar.

Gjithashtu, ai e sheh qartë se ato perde e tërheqin atë drejt shkallëve më të ulëta të kësaj bote. Përfundimisht njeriu del prej kësaj bote së bashku

me mllefin e me armiqësinë ndaj të Vërtetit të Lartësuar, ndaj të emëruarve prej Tij dhe ndaj engjëjve të Tij dhe, dihet si do të jetë gjendja e një personi të këtillë.

Ky kuptim ka ardhur edhe në librin "El-Kàfij", në të cilin përcjellësi i transmetimit thotë: "Pyeta Ebu Abdullahun, Imam Sadikun (paqja qoftë mbi të!): "Ai që dëshiron të takojë Allahun edhe Allahu dëshiron ta takojë atë? Ai që e urren takimin me Allahun edhe Allahu e urren takimin me atë?"

Ai tha: "Po, ne e urrejmë vdekjen. Në të vërtetë, ngado që të shkosh, kjo të del para syve. Kur njeriu shikon Atë që e do, për atë s'ka asgjë më të dashur se Ai që sheh, prandaj ai nxiton të shkojë sa më shpejt te Ai. Edhe Allahu i Lartësuar e dëshiron takimin me atë njeri. Pikërisht në këtë çast ai e dëshiron takimin me Allahun. Por, kur njeriu sheh diçka që e urren, për atë s'ka gjë më të urryer se takimi me Allahun dhe Allahu i Lartësuar e urren takimin me atë njeri."[1]

Nga sa u tha, mësohet se njeriu, para se të dalë prej kësaj bote, sheh me sytë e tij disa prej pozitave të tij dhe disa prej gradave e shkallëve zbritëse të tij. Njeriu del prej kësaj bote ose me lumturinë e plotë dhe, forma më e plotësuar e kësaj lumturie është dashuria e Allahut të Lartësuar, ose me të keqen më të madhe dhe e brendshmja e kësaj të keqeje të plotë e të madhe është urrejtja e të Vërtetit të Lartësuar. Ky kuptim përmendet në shumë njoftime e transmetime dhe në shumë zbulesa të të mëdhenjve.

Gjithashtu, edhe në rastin kur njeriu supozon se dashuria për këtë botë e të bën të detyrueshme që ai të shprishet dhe në këtë shprishje ai shikon fundin e përfundimin e keq që e pret, përsëri ai ka detyrë të mos rrijë në qetësi asnjë çast të vetëm, por të veprojë me ngulm, derisa të shkulë prej zemrës së tij dashurinë për këtë botë e dashurinë për veten, pasi njeriu, gjatë

[1] "Furù'ul-Kàfij", vëll. 3, f. 134, libri "El-xhenàiz", K. "Mà juàjinul-muëminu uelkàfiru".

gjithë jetës së tij ka mundësi të jetë në përshtatje me këtë kërkesë, me anën e ushtrimeve në fushën e diturisë dhe me punë.

Po, hyrja në çdo pozitë prej pozitave të atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe që kanë përshkuar një etapë të këtij rrugëtimi, në fillim këto dy punë duken të komplikuara dhe shumë të vështira, duke shtuar se edhe djalli e uni i njeriut e përforcojnë këtë kuptim, dy faktorë që e ndalojnë njeriun që ai të hyjë në rrugën e njohjes. Por, pasi ai hyn në këtë rrugë, gradualisht ky rrugëtim për atë bëhet gjithnjë e më i lehtë dhe për çdo hap që njeriu hedh në rrugën e të Vërtetit dhe të Botës Tjetër, udhëzimi i dritës hyjnore e ndriçon atë të hedhë hapin tjetër dhe ia bën atij rrugëtimin që ka nisur, shumë të thjeshtë e shumë të lehtë.

NDARJA E TRETË

KUPTIMI ËSHTË SHOQËRUES I CILËSISË SË PASTËR TË KRIJIMIT DHE ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES IDIOTËSIA ËSHTË SHOQËRUESE E CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT DHE ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS

Sikur qëllimi me kuptimin të ishte zgjuarsia e madhe dhe shpejtësia e transferimit, ose pastërtia e brendshme, e shoqëruar me shpejtësinë e mendimit e me transferimin, fakti që mendimi është prej cilësisë së pastër të krijimit, tregon se mendimi është prej vërshimit të mirësive në ekzistencën dhe se plotësimi i ekzistencës është nga ana e Allahut të Lartësuar. Por çdo send që është prej Kësaj prezence, është i pastër, i papërzier, i plotë e i plotësuar, ashtu siç është përmendur e është vërtetuar ky kuptim kur është folur për mendimin; kurse ndyrësitë e turbullirat, mangësitë e të ngjashme me këto të fundit janë prej anës së rastësisë dhe prej anës së përzierjes së punëve të rralla dhe prej mbulimit të cilësisë së krijimit.

Nëse qëllimi me kuptimin është pastërtia e plotë e të brendshmes, për të kuptuar bukurinë e më të Bukurit dhe të cilësive shpirtërore, atëherë kjo është shumë e qartë, sepse cilësia e pastër e krijimit të personit është e orientuar drejt plotësimit absolut dhe është e dashuruar me bukurinë absolute.

Sikur të mos ishin mbulesat e natyrës, kurrë nuk do të ishte orientimi rastësisht drejt ndonjë tjetri përveç bukurisë së Qenies absolute. Çdo gjë që s'ka lidhje me Qenien e Shenjtë, syri i zemrës së tij kurrë nuk do të jetë i hapur për të parë fytyrën e ndonjërës prej qenies, gjithashtu në pasqyrën e të brendshmes së tij e në shpirtin e tij, plotësisht të pastër, kurrë nuk do të vizatohej figura e ndonjë tjetri përveç të Vërtetit të Lartësuar, përveç emrave të Tij, cilësive e shenjave të Tij, për faktin se të gjitha këto janë shenja të Tij. Ky është kuptimi i shërimit të zemrës.

Ka shumë mundësi që edhe ajeti i nderuar: سَلَٰمٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطۡلَعِ ٱلۡفَجۡرِ *"Selàmun hije hat'tà matleil-fexhri"* "...ajo është paqe deri në daljen e agimit."[1] të theksojë këtë kuptim.

Kjo sure e nderuar e Kur'anit Famëlartë e thekson pozitën e lartë të profetësisë e të parësisë (vilajetit). Kjo është sureja e Ehli Bejtit, ashtu siç thuhet në transmetimin. Gjithashtu, ka mundësi që ky ajet i nderuar të tregojë shpëtimin absolut për të parin absolut, që prej fillimit të daljes në natën e mbulimit të cilësisë së krijimit dhe kjo është Nata e Kadrit, për të parin absolut deri në daljen e agimit absolut, është kthim në të parin e plotësuar që arriti deri në pozitën: "...قَابَ قَوْسَيْنِ أَوْ أَدْنَىٰ" *"...kàbe kausejni eu ednà"* "...ishte afër sa (madhësia) e dy harqeve, ose edhe më afër."[2] Kjo është lënia e mbulimit.

Prej Ebu Abdullahut, Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!), në librin "El-Kàfij", në lidhje me interpretimin e fjalës së të Lartit:

"إِلاَّ مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيْمٍ" *"Il'là men ete-ll'llàhe bikalbin selijmin"* "...përveç atij që i vjen Zotit të tij me zemër të shëndoshë."[3], lexojmë: "...zemër e shëndoshë është ajo që e takon Zotin e vet dhe në atë zemër s'ka asnjë tjetër përveç Atij."

[1] Sure "El-Kadr", ajeti 5.
[2] Sure En-Nexhm", ajeti 9.
[3] Sure "Esh-Shuara", ajeti 89.

Gjithashtu, prej Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!) lexojmë: "Ajo është zemra e shëruar prej dashurisë për këtë botë.", duke vënë në konsideratë se e vërteta e kësaj bote shpreh çdo gjë përveç Allahut të Lartësuar dhe, nga kjo anë, ky kuptim nuk gjendet në asnjërin përveçse në të parin absolut.

Interpretimi i këtij ajeti të nderuar përfshin në një kuptim të vetëm të dyja anët që përmenden në ajetin e nderuar të sures "El-Kadr".

Nga sa u tha, u mësua se idiotësia është prej ushtrive të injorancës, është prej ushtrive të Iblijsit dhe prej shoqëruesve të cilësisë së mbuluar të krijimit. Kur mbulohet cilësia e krijimit, ajo e pengon të kuptohet i Vërteti dhe qeniet shpirtërore që janë ushtritë hyjnore, për rrjedhojë kjo cilësi e mbuluar e krijimit orientohet kah kjo botë e kah vetvetja dhe mbetet në perden e së tashmes e të egoizmit, prandaj kjo është një e tashme e kësaj bote.

Gjithashtu, kjo nuk është as në të vërtetën e vetes së tij, prandaj ai mbetet prapa prej të gjitha shkallëve morale e shpirtërore dhe prej të gjitha dijeve hyjnore. Kjo është shkalla më e lartë e idiotësisë, domethënë kur dikush vetëmbulohet dhe është i shkujdesur ndaj vetes dhe ndaj cilësive të tij shpirtërore. Allahu na ruajttë prej kësaj idiotësie.

QËLLIMI I KATËRMBËDHJETË

DËLIRËSIA, E KUNDËRTA E SAJ, POSHTËRSIA NË KËTË KAPITULL KEMI PESË NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI I KUPTIMIT TË FJALËS *DËLIRËSI*

Siç kemi theksuar më sipër, pas fuqisë së mendjes, njeriut i janë dhënë edhe tri fuqi: fuqia e dëshirave të kota, e quajtur fuqia djallëzore, fuqia e zemërimit, e quajtur fuqia copëtuese dhe e treta, fuqia e dëshirave, e quajtur shpirti kafshëror.

Peshorja në llojet e virtyteve dhe të veseve të ulëta janë këto fuqi, prandaj çdo anë e tejkalimit të kufirit e të lënies mangët dhe të kufirit të maturisë, në të dyja këto, ka një cilësi prej cilësive shpirtërore.

Bazuar mbi këtë shpjegim, cilësia kafshërore ka anën e tejkalimit të kufirit që shprehet me pangopësinë. Me fjalë të tjera, është mungesa e përmbajtjes në dëshirat e në cilësitë kafshërore, domethënë njeriu bën të pamundurën, e tejkalon çdo kufi, me qëllim që të arrijë kënaqësinë e asaj që ai dëshiron në çdo vend e me çdo mjet.

Në të vërtetë, lëshimi i frerit të dëshirave ekziston në të gjitha fuqitë njerëzore që ka të bëjë me degën, me të cilën ajo cilësi ka lidhje, në kuptimin se, për shembull: në esencë, natyra e fuqisë së dëshirave është

arritja e shijimit të plotësimit të dëshirave pa asnjë lloj frenimi, edhe kur dëshirat e tij janë në kundërshtim me ligjin e me logjikën, por në këtë rrugë ai synon vetëm plotësimin e dëshirave personale dhe, në këtë rrugë, ai nuk ndalet as në llojet e ushqimeve e të pijeve haram, as në martesën haram, përfshirë martesën me femra të gjakut, madje deri edhe me nënën. Në të vërtetë, dëshira e papërmbajtur shpreh plotësimin e dëshirës deri në ekstrem dhe në këtë rrugë njeriu ka pasion të papërmbajtur për të shijuar kënaqësinë që synon qoftë edhe duke e tejkaluar sistemin logjik e ligjor, ose duke dalë edhe më shumë prej peshores së punëve, për të cilat është detyrim që njeriu të vetëfrenohet.

Gjithashtu, shpirti kafshëror ka anën e tij të lënies mangët, që shprehet me qetësimin dhe kjo anë gjen shprehje me frenimin e fuqisë së dëshirave që ato të mos dalin jashtë cakut të maturisë, domethënë që plotësimi i kërkesave të kësaj fuqie të jetë në masën e duhur, por pa e lënë pas dore këtë fuqi të nderuar që i është dhënë njeriut për të ruajtur veten dhe specien.

Kur kjo fuqi është në baraspeshë në peshoren e logjikës e të ligjit, ajo qëndron jashtë anës së teprimit e të lënies mangët, domethënë qëndron jashtë cakut të ekzagjerimit e të minimizimit dhe është bërë e atillë që kjo fuqi lëviz në kuadrin e logjikës e të ligjit, ka rënë në veprimin e punonjësve hyjnorë dhe ka dalë jashtë kuadrit të dëshirave të kota e të veprimeve të djallit e mashtrimeve të tij.

Në këtë gjendje, kjo fuqi arrin një gjendje qetësie e sigurie, arrin masën e veprimit mesatar e të ecjes në mesin e rrugës, atëherë kjo fuqi ka marrë ngjyrën e punëve logjike, madje të punëve hyjnore dhe shprehet me fjalën dëlirësi e virtyt.

Prej këtyre shpjegimeve u mësua edhe kuptimi i poshtërisë që në transmetimin e nderuar është vënë si e kundërt përballë virtytit e dëlirësisë. Në të vërtetë, poshtërsia është njëra anë e tejkalimit të kufirit logjik e ligjor, ose e lënies mangët dhe e teprimit deri në ekstrem.

Këtë anë të poshtërsisë po e veçojmë për shkak se njerëzit, sipas kategorive përkatëse, janë vënë në sprovë me këtë anë. Shumë rrallë ndodh që ndonjëri të dalë jashtë cakut të poshtërsisë me zgjedhjen e vet për të kaluar në anën e

lënies mangët e të minimizimit. Gjithashtu, ka mundësi që, në rrugën e poshtërsisë, njeriu merr përsipër anën e tejkalimit të cakut e të lënies mangët, pasi vetë fjala poshtërsi është në kuptimin e grisjes e të shqyerjes së mbulesës.

Gjithashtu, fjala grisje e shqyerje shpreh tejkalimin e cakut të maturisë e demaskimin dhe, ky kuptim është i përgjithshëm për të dyja anët, domethënë se prishja e masës së maturisë është veprimi jashtë cakut logjik e ligjor dhe është i përgjithshëm për të dyja anët.

PLOTËSIM

Nga ato që u thanë në këtë ndarje e në ndarjet e mëparshme dhe nga ato që do të thuhen në ndarjet vijuese, rezulton se dëlirësia është prej cilësisë së natyrës së pastër të krijimit, është shoqëruese e cilësisë së pastër të krijimit, për rrjedhojë dëlirësia është prej ushtrive të mendjes.

Kurse poshtërsia është shoqëruese e cilësisë së mbuluar të krijimit, për rrjedhojë është prej ushtrive të Iblijsit e të injorancës. Drejtësia në fuqitë është në pozitën e llojit për dëlirësinë si cilësi e natyrës së pastër të krijimit, kurse padrejtësia, ashtu siç është thënë më sipër, është në kundërshtim me cilësinë e pastër të krijimit. Po kështu, përulja e bindja e plotë dhe ndjekja e të plotësuarve janë nga cilësia e pastër e krijimit dhe janë në kundërshtim me padrejtësinë.

Atëherë, dëlirësia e turpi janë prej cilësisë së pastër të krijimit të të gjithë familjes njerëzore, kurse poshtërsia, mëkati e paturpësia janë në kundërshtim me cilësinë e pastër të krijimit, prandaj dashuria e flaktë për dëlirësinë e për turpin, është e gatuar në brumin e cilësisë së pastër të krijimit të familjes njerëzore, e cila njëkohësit është e gatuar edhe me neverinë e madhe për poshtërsinë e paturpësinë.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIM: FRYTET E FUQISË SË DËSHIRAVE

Mëso se fuqia e dëshirave është prej fuqive të nderuara, që Allahu i Lartësuar ka dhënë për kafshën e për njeriun për të ruajtur personin e tij dhe qëndrimin në botën e natyrës, si dhe për të ruajtur specien. Sikur në njeriun të mos ishte kjo fuqi, patjetër që shumë shpejt njeriu do të zhdukej si specie, për shkak të faktorëve të brendshëm e të jashtëm dhe për shkak të moszëvendësimit të asaj që çlirohet. Është fakt se arritja e lumturisë së përjetshme nuk mund të realizohet pa qëndrimin e njeriut në këtë botë dhe pa qenë njeriu pjesë e natyrës së kësaj toke. Me fjalë të tjera, lumturia e përjetshme e njeriut dhe jeta e tij shpirtërore, janë peng i kësaj fuqie të nderuar.

Gjithashtu, kjo fuqi ka një ndikim të plotë në formimin e familjes së respektuar, në formimin e sistemit të qytetarisë së virtytshme dhe për edukimin e shpirtrave të mangët. Këtu duhet shtuar se lumturia e njeriut është e lidhur me këtë fuqi. Prandaj lumturia e njerëzve është e ngjitur me këtë tryezë qiellore.

Fuqia e dëshirave është garantuese e lumturisë individuale, derisa njeriu do të vazhdojë të mos i tejkalojë kufijtë e maturisë, derisa të mos dalë prej peshores logjike e hyjnore, pa harruar se mos arritja prej tij e lumturisë së lartpërmendur, sjell gjendje të keqe për vetë atë dhe për të gjithë njerëzit.

Padyshim, nëse njeriu do të vërë në punë fuqinë e dëshirave vetëm për disa ditë, ose vetëm për disa orë dhe, nëse fuqia e dëshirave nuk mbahet nën fre, shumë shpejt do të shpërbëhet sistemi i nderuar i familjes, ndër

njerëzit do të përhapej përjetësisht e keqja e mjerimi. Ka shumë mundësi që të zhduket jo vetëm nderi i tij, por edhe nderi i familjes së tij. Shumica e gjendjeve të rënduara, të pësimeve dhe të skandaleve ndodhin në ato grupe shoqërore ku kjo fuqi është vepruese pa asnjë kontroll.

Kur njeriu vigjilent mendon edhe fare pak e kupton shumë mirë të ligën që ai po bën duke prishur virtytin e dëlirësinë me fuqinë që atij ia ka dhënë Allahu i Lartësuar për të ruajtur sistemin e familjes dhe që nderi i saj të jetë i qëndrueshëm, njëkohësisht në sajë të kësaj fuqie sigurohet lumturia në këtë botë e në Botën Tjetër. Përfitimi i njeriut prej kësaj fuqie vjen në sajë të kundërshtimit të qëllimit dhe të asaj që është qëllim.

Cili delikt do të ishte më i rëndë dhe cila tradhti do të ishte më e madhe se kur kjo fuqi, që është dhënë për të ruajtur specien, përdoret për të ndërprerë vijimësinë e species dhe kjo për shkak të përdorimit të kësaj fuqie jo në vendin e duhur dhe në kundërshtim me peshoren e logjikës? Por edhe sikur pas këtyre delikteve të mbeteshin pasardhës, patjetër që mbi ata do të binin lloje të shumta katastrofash e do të goditeshin me lloje të panumërta sëmundjesh.

Në ditët e sotme, mjekët pas eksperimenteve shkencore kanë arritur në përfundimin se shumica e sëmundjeve e kanë origjinën në sëmundjet gjenetike të të sëmurit, ose ato sëmundje ai i ka të trashëguara prej prindërve e prej gjyshërve të tij, por që kanë arritur te i sëmuri me rrugën e trashëgimisë. Ky pësim mund të jetë vetëm njëra e keqe ndër njëmijë të këqijat e kësaj bote që dalin e përhapen kur fuqisë së dëshirave i lëshohet freri pa asnjë kushtëzim.

Sikur njeriu të orientohej qoftë edhe me pak konstatime në lidhje me të këqijat që arrihen në botën prapa natyrës, sipas fjalës së mjekëve psikologë, të lidhur me revelatën hyjnore dhe të dijetarëve teologë, patjetër do të gjejë se të këqijat e kësaj bote janë më me pak rrezik në raport me të këqijat që qëndrojnë përballë rreziqeve tokësore. Por, që të shpjegohet kjo kërkesë deri në një farë kufiri, ka nevojë të trajtohet në një kapitull më vete.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIM: NDIKIMI I PUNËVE NË ZEMËR

Patjetër duhet të dihet se çdo punë e mirë e çdo punë e keqe, në mënyrë të barabartë, në zhvillimin e cilësive dhe në botën e fshehtë kanë një formë hyjnore të panjohur. Kjo e vërtetë është shprehur me fjalët e njerëzve që shohin me sytë e zemrës, të atyre që kanë arritur të marrin dituri hyjnore, shenjat që jepen në Librin hyjnor Famëlartë, domethënë shenjat që jepen për këtë çështje në këtë Libër qiellor ndriçues, si dhe në thëniet e transmetimeve të ardhura prej Ehli Bejtit, prej familjes ku është zbritur revelata hyjnore.

Në të gjitha këto, ndikimi i punëve në zemër është shprehur me frazën: "Xheneti i punëve dhe Xhehenemi i punëve" dhe me frazën tjetër "në fillim toka e cilësive ishte e pastër dhe atë e populloi puna e pasardhësve të Ademit".

Në Kur'anin Famëlartë zbulohet sekreti i kësaj të vërtete me shprehje të ndryshme, ashtu siç e lexojmë në fjalën e të Lartit në ajetin 30 të sures "Al-Imran":

يَوْمَ تَجِدُ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ مُّحْضَرًا وَمَا عَمِلَتْ مِن سُوٓءٍ تَوَدُّ لَوْ أَنَّ بَيْنَهَا وَبَيْنَهُۥٓ أَمَدًا بَعِيدًا

"Jeume texhidu kul'lu nefsin mà amilet min khajrin muhdaren ue mà amilet min sùin teved'du leu en'ne bejnehà ue bejnehù emeden beijden…" "Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vetes punën që bëri, të mirë e të keqe; do të dëshironte që në mes asaj e në mes tij të kishte në kohë shumë të gjatë…"

Ky ajet i nderuar i Kur'anit Famëlartë është një deklaratë në të cilën shpallet se njeriu në atë ditë do t'i shohë punët e veta të formësuara, të

mirën e të keqen dhe këtë të vërtetë e dëshmon fjala e vetë njeriut në fundin e frazës së këtij ajeti, ku shpallet se njeriu ka dëshirë të madhe që në mes tij e mes punëve të tij të këqija të ishte një largësi sa më e madhe në kohë.

Gjithashtu, njerëzit Ditën e Gjykimit do të shohin punët e tyre dhe këtë të vërtetë e dëshmojnë qartë tri ajetet e fundit të sures "Ez-Zelzeleh":

يَوۡمَئِذٖ يَصۡدُرُ ٱلنَّاسُ أَشۡتَاتٗا لِّيُرَوۡاْ أَعۡمَٰلَهُمۡ ٦ فَمَن يَعۡمَلۡ مِثۡقَالَ ذَرَّةٍ خَيۡرٗا يَرَهُۥ ٧ وَمَن يَعۡمَلۡ مِثۡقَالَ ذَرَّةٖ شَرّٗا يَرَهُۥ ٨

"Jeumeidhin jasduru-n'nàsu eshtàten lijureu aëmàlehum. Femen jaëmel mithkàle dherr'rretin khajren jerehù. Ue men jaëmel mithkàle dherr'rretin sherr'rren jerehù"

"Atë ditë njerëzit do të dalin të ndarë në grupe për të parë punët e tyre. Kush bëri një punë të mirë që peshon sa një grimcë, atë do të shohë. Kush bëri një punë të keqe që peshon sa një grimcë, atë do të shohë."[1]

Në këto ajete të nderuara të Kur'anit Famëlartë tregohet qartë se njerëzit do të shohin punët e veta të formësuara në zhvillimin që ato kishin. Kjo kërkesë, domethënë forma e fshehtë e punëve te ata që kanë arritur gradën e njohjes, është prej aksiomave të vërtetura.[2]

Gjithashtu punët kanë edhe formësim hyjnor dhe çdo punë më vete ka një ndikim në zemrën e njeriut. Pikërisht ky ndikim, në transmetime, është shprehur me frazën: "shprehje e hollë e bardhë, ose e zezë". Sikur njeriu të bëjë një punë të mirë, në përputhje me kushtet e formësimit të saj e me kushtet morale të zemrës dhe me shabllone ditëdhënëse, ajo punë futet në të brendshmen e zemrës. Prandaj ajo punë është pastërti e brendshme dhe e afron njeriun me njohjen e Allahut e me besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), derisa të vërtetat e këtij besimi dhe sekretet që mbart ky besim të rrënjosen zemër. Pastaj prej zemrës ky besim depërton në të gjitha pjesët e tjera të trupit. Atëherë toka e natyrës do të jetë ndriçuese e do të shkëlqejë prej dritës hyjnore. Pikërisht ky është qëllimi më

[1] Sure "Ez-Zelzele", ajetet 6-8.
[2] Lexo "El-Esfâru-El-Erbeah", vëll. 9, f. 296, Ndarja nr. 21, K. 11.

i lartë i lumturisë së njeriut. Por, detajimi dhe shkoqitja me hollësi e kësaj çështjeje del jashtë kuadrit të këtyre faqeve.

Gjithashtu, çdo punë e keqe ka jo vetëm një turbullirë, e cila arrin në zemër, por ka edhe një errësirë që e largon njeriun prej pozitës së shenjtërisë e afrimit te i Vërteti i Lartësuar. Pikërisht kjo errësirë e punës së keqe e privon njeriun prej diturive hyjnore dhe e afron atë me botën e natyrës e me këtë botë, brendia e së cilës është zjarr i tejndezur e greminë, derisa zemra asgjësohet, asgjësohen edhe të gjitha punët e fshehta të zemrës në këtë botë e në botën e natyrës. Përfundimi, prej asaj zemre ngrihet sundimi i hyjnores dhe i njerëzores.

Për të gjitha këto, njeriu patjetër duhet të dijë se ka katër fuqi. *Fuqia e parë* prej këtyre fuqive është fuqia e të menduarit; *e dyta* është fuqia e zemërimit; *e treta* është fuqia e dëshirave kafshërore dhe *e katërta* është fuqia djallëzore, ose fuqia e dëshirave të kota. Në Botën Tjetër fytyra e njeriut, ditën kur fytyrat e panjohura, së bashku me cilësitë shpirtërore do të bëhen të dallueshme, nuk do të jenë jashtë tetë figurave, sepse pozita e trupores dhe forma e dukshme e njeriut në Botën Tjetër, si dhe zhvillimet përtej botës së natyrës, të gjitha këto janë të varura prej fytyrës së shpirtërores dhe pozitës së shpirtit.

Ajo botë nuk është si kjo botë, ku natyra është e kundërta e të brendshmes, domethënë se në këtë botë cilësitë trupore kundërshtojnë cilësitë e shpirtit. Kjo kërkesë është argumentuar në diturinë e lartë.

Kur njeriu ecën në këtë botë në rrugën e drejtë, në rrugën e njerëzores dhe i ve në vijë të drejtë tri fuqitë e i bën ato të jenë të varura prej cilësive shpirtërore e prej mendjes, atëherë rrugëtimi i të brendshmes e të jashtmes është nën sundimin e ligjit hyjnor. Atëherë e brendshmja e tij arrin cilësinë e drejtqëndrimit, për rrjedhojë të drejta do të jenë fytyra e shpirtit dhe e brendshmja e fytyrës njerëzore.

Forma trupore e njeriut në atë botë do të jetë e drejtë, e drejtë do të jetë edhe ana e dukshme e fytyrës njerëzore. Kjo do të thotë se në atë botë

fytyra e njeriut do të jetë e bukur. Kur cilësia hyjnore e shpirtit dhe zhvillimet e saj logjike ndjekin njërën prej tri fuqive të tjera dhe kur njëra prej fuqive del mbi dy fuqitë e tjera e i vë ato të dyja nën sundimin e vet, patjetër cilësitë e brendshme do të jenë të varura prej kësaj fuqie, kurse forma e cilësive të fshehta do të jetë në fytyrën e ndonjërës prej bishave. Kur sunduese është fuqia e zemërimit, cilësitë e brendshme do të jenë në fytyrën e ndonjërës prej kafshëve. Kur sunduese bëhet fuqia e dëshirave, e gjithë mbretëria e cilësive bëhet mbretëri e dëshirave, ose me fytyrën e ndonjërit prej djajve dhe, kur sunduese bëhet fuqia e iluzioneve, domethënë e dëshirave të kota djallëzore, e gjithë mbretëria e cilësive hyn nën veprimin e djallit.

Ky ishte formësimi i thjeshtë i cilësive, kur dy prej këtyre tri fuqive kanë pushtet në këtë mbretëri. Njeriu në gjendje zemërimi të plotë, është edhe në gjendje të plotë të dëshirave; ose krahas gjendjes në djallëzinë e plotësuar, ai është edhe në gjendjen e dëshirave të plota, ose është në gjendjen e zemërimit të plotë.

Nga dyzimi i këtyre dy fuqive bëhet e dukshme forma e cilësisë së dyzuar, cilësi që nuk është as thjesht bishë, as thjesht kafshë e as thjesht djall. Nga strukturimi i çdo dy fuqive prej këtyre tri fuqive arrihen disa formësime dhe, kur çdo njëra prej tri fuqive arrin të jetë e plotësuar te njeriu, atëherë e brendshmja e tij ndjek të tria fuqitë. Për rrjedhojë prej këtyre arrihet një fytyrë të përbërë prej tri fuqive. Në këtë botë njeriu ka mundësi që në të njëjtën kohë të ketë më shumë se një fytyrë, ose për çdo gjendje të këtë një fytyrë, domethënë: njeriu herë ka fytyrën e bishës, herë tjetër ka fytyrën e kafshës dhe herë tjetër ka fytyrën e djallit.

Tani u mësua se fytyra njerëzore mund të jetë njëra prej këtyre tetë fytyrave, pasi format e fytyrave të tjera, nuk janë forma të fytyrave njerëzore. Gjithashtu edhe vija e drejtë mes dy pikave nuk është më shumë se një vijë, ashtu siç është theksuar në ajetet e Kur'anit Famëlartë, për shembull në ajetin 153 të sures "En-Am", lexojmë fjalën e të Lartit:

وَأَنَّ هَٰذَا صِرَٰطِي مُسْتَقِيمًا فَٱتَّبِعُوهُ ۖ وَلَا تَتَّبِعُوا۟ ٱلسُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَن سَبِيلِهِۦ

"Ue en'ne hàdhà siràtij mustekijmen fet'tebiùhu ue là tet'tebiu-s'subule feteferr'rreka bikum an sebij'ihi…"

"Dhe kjo është rruga Ime e drejtë (feja Ime e drejtë), pra ndiqeni këtë rrugë dhe mos ndiqni rrugë të tjera se ato u ndajnë prej rrugës së Tij…"

Prej Abdullah bim Mes'ud është përcjellë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* bëri në tokë një vijë të drejtë me dorën e tij dhe pastaj tha: "Kjo është rruga e drejtë e Allahut."

Pastaj bëri disa vija nga e djathta e nga e majta e tij dhe tha: "Në këto rruga s'ka as edhe një rrugë që në atë të mos jetë sundues një djall, i cili bën thirrje të ndiqet rruga e tij."

Pastaj lexoi ajetin e mësipërm:

وَأَنَّ هَٰذَا صِرَٰطِي مُسْتَقِيمًا فَٱتَّبِعُوهُۖ وَلَا تَتَّبِعُواْ ٱلسُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَن سَبِيلِهِۦۚ

"Ue en'ne hàdhà siràtij mustekijmen fet'tebiùhu ue là tet'tebiu-s'subule feteferr'rreka bikum an sebij'ihi…"

"Dhe kjo është rruga Ime e drejtë (feja Ime e drejtë), pra ndiqeni këtë rrugë dhe mos ndiqni rrugë të tjera se ato u ndajnë prej rrugës së Tij…"[1]

[1] Es'sejùtij, "Ed'durr'rrul-Menthùr", vëll. 3, f. 56, fillimi i ajetit 153 i sures "En-Am".

NDARJA E KATËRT

KËSHILLË PËR PËRMIRËSIMIN E SHPIRTIT

I dashur, sikur njeriu të synojë të arrijë të vërtetën e këtyre kërkesave me peshoren e argumentit te ata që dinë të argumentojnë dhe të shohë të dukshmen me dritën e zbulimit të atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe në përputhje jo vetëm me shenjat, por edhe me fjalët e qarta të Librit hyjnor e me thëniet e hadithеve të nderuara, të ardhura prej Ehli Bejtit, shtëpisë ku u zbrit shpallja, ka detyrë të mos qëndrojë i qetë derisa të përmirësojë shpirtin e tij.

Por e keqja qëndron se të gjitha argumentet e qarta në librat qiellorë dhe në të gjitha hadithet e nderuara, të ardhura prej Ehli Bejtit, prej të ruajturve prej mëkateve dhe në thëniet e profetëve të mëdhenj e prej eulijave të nderuar, përfshirë edhe të gjitha argumentet e dijetarëve, filozofëve dhe ushtrimet e atyre që praktikojnë ushtrime shpirtërore, nuk janë të pranishme në zemrat tona të ngurta e të ashpra, qoftë edhe si mundësi e pakët. Prandaj puna jonë është si puna e atyre që mendojnë se janë të vetëdijshëm dhe përfundimisht i përgënjeshtrojnë të gjitha këto.

Allahu të na mbrojë nga ky mendim!

I dashur, çdo njërin prej nesh, kur e njofton një fëmijë dhjetë vjeç se zjarri ka rënë në shtëpinë e tij, ose djali i tij ka rënë në ujë dhe tani po mbytet, pas këtij lajmi, a nuk do të linim edhe punën më të rëndësishme dhe menjëherë do të nxitonim pas atyre lajmeve që na copëtojnë zemrat, apo ne nuk do të interesoheshim dhe do të rrinin ulur, me qetësi të plotë zemre? Tani çfarë pune ka ndodhur?! Të gjitha argumentet, njoftimet që marrim e dëshmitë që ne i shohim me sytë e ballit, të gjitha këto s'kanë ndikim te ne as aq sa njoftimi i atij fëmijës dhjetë vjeç.

Sikur të gjitha këto të kishin ndikuar te ne, patjetër që ne nuk do të ishim të qetë. Si mund të shërohet kjo verbëri e të brendshmes dhe e zemrës? Vallë, kjo sëmundje e zemrës ka nevojë për një mjek dhe për ilaç? A ka këtu një rrugë për të mjekuar këtë mbulim e këtë errësirë? A është e mundur të themi për cilindo që nuk interesohet për njoftimet e profetëve e të librave qiellorë, qoftë edhe aq sa ai interesohet për njoftimin e një fëmije që akoma s'ka arritur moshën e pjekurisë se ai është besimtar dhe se në atë janë vërtetuar cilësitë e besimit? Nëse ti gjen nga ato që u përmendën, duke iu referuar gjendjeve nëpër të cilat ti kalon, atëherë dije mirë se tymi i dëshirës dhe i zemërimit, padyshim ka verbuar sytë tanë të brendshëm, ka bllokuar kanalet e kuptimit tonë dhe se veprimi i djallit e i egoizmit ka shurdhuar veshët tanë.

Për rrjedhojë, ne s'kemi mundësi të kuptojmë të vërtetat, ashtu siç i shpjegon i Larti gjendjet e disave prej nesh në ajetin 179 të sures së bekuar "El-Araf":

وَلَقَدۡ ذَرَأۡنَا لِجَهَنَّمَ كَثِيرٗا مِّنَ ٱلۡجِنِّ وَٱلۡإِنسِۖ لَهُمۡ قُلُوبٞ لَّا يَفۡقَهُونَ بِهَا وَلَهُمۡ أَعۡيُنٞ لَّا يُبۡصِرُونَ بِهَا وَلَهُمۡ ءَاذَانٞ لَّا يَسۡمَعُونَ بِهَآۚ أُوْلَٰٓئِكَ كَٱلۡأَنۡعَٰمِ بَلۡ هُمۡ أَضَلُّۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡغَٰفِلُونَ ١٧٩

"Ue lekad dhere'nà lixhehen'neme kethijren minel-xhin'ni uel-insi lehum kulùbun là jefkahùne bihà ue lehum aëjunun là jubsirùne bihà ue lehum àdhànun là jesmeùne bihà, ulàike kel-en'àmi bel hum edal'lu, ulàike humul-gàfilùne"

"Ne i kemi krijuar shumë prej xhinëve e prej njerëzve për Xhehenemin; ata kanë zemra (mendje) me të cilat nuk kuptojnë, ata kanë sy me të cilët nuk shohin, ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë; ata janë si kafshët, madje janë edhe më të humbur (se kafshët), të këtillë janë të shkujdesurit."

Shenja që vërteton se njeriu është prej atyre që do të jenë në Xhehenem është mospërdorimi i zemrës për qëllimet që është krijuar. Zemra (mendja) është krijuar për të studiuar legjislacionin dhe për të sistemuar veprimin në përputhje me argumentet që gjenden në faqen e madhe të krijimit dhe në faqet e Librit të shkruar.

Gjithashtu, ai nuk i përdor sytë e veshët sipas qëllimit për të cilin ia ka dhuruar Allahu i Lartësuar, domethënë ai nuk i përdor sytë e veshët për të parë e për të dëgjuar të vërtetat hyjnore dhe që të mos kalojë në horizontet kafshërore, ndryshe nuk arrin as pozitën më të vogël të njerëzores, që është pozita e sistemimit logjik. Një njeri i këtillë, realisht është kafshë, edhe pse nga forma e nga cilësitë e kësaj bote duket si njeri, por në të vërtetë, ai është më i humburi i të gjitha kafshëve, kur e krahasojmë me ndonjërën prej cilësive të kafshëve.

Nëse njeriu i largohet rrugës së drejtë, menjëherë ai del sipër kafshëve, bishave e djajve në të gjitha aspektet e kafshërisë, makutërisë, për të vrarë sa më shumë dhe mbi të gjitha djallëzitë. Padyshim kjo ndodh sepse fuqitë e tij janë lënë të veprojnë pa asnjë lloj freri, në një kohë që qeniet e tjera janë të kufizuara e të kushtëzuara. Dëshira kafshërore te njeriu s'ka fund, zjarri i zemërimit të njeriut arrin të djegë të gjithë botën, kurse djallëzia e njeriut dhe punët e tij dhelparake kanë bërë që të gjithë banorët e botës të jenë në vështirësi të mëdha, në varfëri e në mjerim.

I dashur, këto ajete hyjnore dhe këto mësime të zbritura prej Zotit të botëve, kanë ardhur për të na zgjuar ne të mjerëve që jemi në gjumë dhe për të na tërhequr vëmendjen ne të mjeruarve të shkujdesur. Tregimet kuranore janë një përmbledhje e diturive të të gjithë profetëve, janë esenca e rrugës në të cilën kanë ecur të gjithë eulijatë dhe janë orientimi që ata kanë dhënë.

Shpjegimi i sëmundjes dhe i ilaçit për çdo të metë shpirtërore e për çdo sëmundje të shpirtit, si dhe drita e rrugës së udhëzimit hyjnor e njerëzor, nuk janë tregime e shpjegime për historinë e botës dhe qëllimi me këto tregime nuk është thjesht që të tregohen ngjarjet e tyre, megjithëkëtë krahas madhështisë së këtyre ajeteve të zbritura, në asnjë rast nuk mund të zvogëlohet edhe rëndësia që ato kanë për të shpjeguar historitë e atyre që kanë kaluar. Prandaj, nga ky këndvështrim, ajetet e Librit Famëlartë janë një informim i mirëfilltë edhe për shkencën e historisë.

I dashur, dalloje qëllimin e Allahut të Lartësuar në punën e El-Mes'ùdij'jit, Taberij'jit dhe të të ngjashmëve me këta të dy. Mos e shiko Kur'anin Famëlartë vetëm nga ana historike, letrare dhe e lartësisë gjuhësore, sepse kjo mënyrë shikimi në të është forma e një perdeje të trashë.

Kur'ani Famëlartë është Libër udhëzues moral dhe direktivë hyjnore. Kur'ani s'ka lidhje më qëllimet e banorëve të kësaj bote, sepse të gjitha qëllimet e kësaj bote janë qëllime kafshërore. Kur një njeri i zakonshëm ndjek një qëllim, rezultati i qëllimit që ai ndoqi ka të bëjë me këtë botë, për rrjedhojë, njeriu nuk del jashtë horizontit të kafshërisë, madje derisa njeriu vazhdon të jetë i lidhur me qëllimet e dëshirave e të kënaqësive të kësaj bote e të Botës Tjetër, padyshim që ai mbetet në horizontin e kafshërores dhe hyn në kuptimin e frazës së ajetit të nderuar:

"أُوْلَٰٓئِكَ كَٱلْأَنْعَٰمِ" "ulàike kel-en'àmi" "ata janë si kafshët", domethënë janë sipas disa prej llojeve të kafshëve.

Në të vërtetë, njeriu nuk kupton asgjë prej vuajtjeve të profetëve e të eulijave, sepse të gjitha jetët hyjnore, të gjitha fletët qiellore dhe të gjitha njoftimet e hadithet nuk janë dëshira të barkut e të epshit. Përfytyro një njeri që mendon se të gjitha qëllimet hyjnore dhe qëllimet e profetëve të mëdhenj janë për kënaqësitë e barkut e të epshit dhe se të gjitha adhurimet e marrja e diturive janë mjete për të arritur këto kënaqësi, patjetër që një njeri i këtillë është prej kafshëve, megjithëse ai, pa asnjë të drejtë, pretendon se është prej bijve të Ademit.

Njeriu patjetër duhet të mësojë kuptimin e emrave, sepse Allahu i Lartësuar e ka bërë mësimin e emrave prej veçorive të Ademit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!). Me virtytin e mësimit të emrave, Allahu i Lartësuar e privilegjoi Ademin mbi të gjitha qeniet dhe e përshkroi atë me cilësinë e veçantë të mësimit e të diturive. Patjetër që strehimi në qëllimet e barkut dhe të epshit, janë prej qëllimeve kafshërore e prej veçorive kafshërore, të cilat natyrisht nuk mund të jenë faktorë për virtyt.

NDARJA E PESTË

DISA TRANSMETIME PËR MIRËSINË E VIRTYTIT

Muhamed bin Jakubi, prej Ebu Xhaferit (Paqja qoftë mbi të!), transmeton: "S'ka ndonjë adhurim më të mirë se virtyti i ruajtjes së barkut dhe organit gjenital."[1]

Me këtë përmbajtje kanë ardhur shumë transmetime.

Muhamed bin Ali bin Hysejn, prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), tregon porosinë që i dha Muhamed bin El-Hanefij'jeh: "Ai që nuk ia dorëzon veten dëshirave, ka arritur ecjen në rrugën e drejtë."[2]

Arritja e ecjes në rrugën e drejtë dhe plotësimi njerëzor janë peng i ndalimit të vetes prej dëshirave e prej kënaqësive. Ata që ndjekim dëshirat, mbeten prapa në arritjen e ecjes në rrugën e drejtë dhe në rrugën e udhëzimit në rrugën e drejtë. Gjithashtu, sytë e tyre janë të verbuar për të parë rrugën e të Vërtetit të Lartësuar.

Në librin "El-Vesàil", prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!), lexojmë: "Në të vërtetë, prej ndjekësve të Xhaferit është ai që e mban të virtytshëm barkun dhe organin e tij gjenital, është i vendosur në luftën e tij në rrugën e Allahut, punon për Krijuesin e tij, shpreson në shpërblimin e Tij

[1] "Usùlul-Kàfij", vol. 2, f. 65; K."El-If'fetu", Hadithi 7.
[2] "Vesàilu-sh'shijah", vëll. 15, f. 250; K. "Vuxhùbul-if'feti".

dhe ka frikë prej dënimit të Tij. Kur të shohësh të këtillë, ata janë prej ndjekësve të Xhaferit."[1]

Të pavirtytshmit nuk janë prej ndjekësve të Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), edhe pse veten e llogarisin se janë prej ndjekësve të tij. Ata që ndjekin shpirtin kafshëror dhe lëvizin siç lëvizin kafshët, janë ndjekës të shpirtit kafshëror dhe janë jashtë mendimit të ndjekësve të Imami Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Si ka mundësi që të këtillë të cilësohen ndjekës të hyjnores? Ndjekësit e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) janë të ngjyrosur me ngjyrën e Allahut: "وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللهِ صِبْغَةً" "…ue men ahsenu mine-ll'llàhi sibgaten" "…dhe kush ngjyros (me fe) më mirë se Allahu."[2]

Ata jo vetëm që janë të pastër e të pastruar prej ndotjeve të dëshirave dhe pisllëqeve të zemërimit e djallëzisë, por e kanë zgjidhur edhe lidhësen e mendjes prej zemrave të tyre! Po:

﴿وَإِنَّ مِن شِيعَتِهِۦ لَإِبۡرَٰهِيمَ ٨٣ إِذۡ جَآءَ رَبَّهُۥ بِقَلۡبٖ سَلِيمٖ ٨٤﴾ *"Ue in'ne min shij'atihi leibràhijme. Idh xhàe rab'behù bikalbin selijmin"* "Edhe Ibrahimi ishte prej ndjekësve të tij, kur erdhi te Zoti i tij me zemër të pastër."[3]

Në transmetimet e nderuara shpjegohet se edhe Ibrahimi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ishte me cilësitë e ndjekësve të Prijësit të besimtarëve, sepse ai erdhi te Zoti i tij me zemër të shëndoshë.[4] Zemër e shëndoshë është zemra që s'ka asnjë të adhuruar tjetër përveç Allahut Fuqiplotë dhe që nuk është e lidhur me asgjë tjetër, përveç se me të Vërtetin e Lartësuar.

---

[1] Burimi i mësipërm, f. 251.

[2] Sure "El-Bekare", ajeti 138.

[3] Sure "Es-Saf'fat", ajetet 83-84.

[4] Transmetohet prej zotërisë sonë, Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): "وَإِنَّ مِن شِيعَتِهِ لَابْرَاهِيمَ" "Ue in'ne min shij'atihi leibràhjme" "Edhe Ibrahimi ishte prej ndjekësve të tij", domethënë: Profeti Ibrahim (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ishte me cilësitë e ndjekësve të Aliut (Paqja qoftë mbi të!). Tefsiri "El-Burhan", vëll. 4, f. 20, fundi i ajetit 83 i sures "Es-Saf'fat".

Në tefsirin "El-Burhàn", në një hadith të gjatë lexojmë: "Një burrë i tha Ali bin Husejnit (Paqja qoftë mbi të!): "O bir i të Dërguarit të Allahut, unë jam prej ndjekësve tuaj të sinqertë…"

Ai (Paqja qoftë mbi të!) i tha: "Atëherë ti qenke si Ibrahi, miku i Allahut. Allahu thotë:

"وَإِنَّ مِن شِيعَتِهِ لَأَبْرَاهِيمَ. إِذْ جَاء رَبَّهُ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ" "Ue in'ne min shij'atihi leibràhijme. Idh xhàe rab'behù bikalbin selijmin" "Edhe Ibrahimi ishte prej ndjekësve të Tij, erdhi te Zoti i tij me zemër të pastër." Nëse zemra jote është si zemra e tij, atëherë ti je prej ndjekësve tanë…"[1] Hadithi vazhdon.

[1] Tefsiri "El-Burhan", vëll. 4, f. 22.

QËLLIMI I PESËMBËDHJETË

PËRKORJA, E KUNDËRTA, DËSHIRA

NDARJA E PARË

KUPTIMI: PËRKORJA DHE DËSHIRA

Nga ana gjuhësore, fjala "ez'zuhd", përkorje, shpreh heqjen dorë prej një sendi, largimin prej atij sendi, mosprirjen kah ai send dhe mungesën e dëshirës për atë send.

Gjithashtu, në kuptimin e pavarësisë e të përbuzjes, fjala "ez'zuhd"përdoret edhe në kuptimin: u mjaftua me lëvizjen e syrit, ose u përmbajt prej një sendi, në kuptimin që e dëshiron atë send, por heq dorë prej tij. Fjala "ez'zuhd"përdoret edhe në kuptimin e largimit prej një sendi dhe në kuptimin e e neverisë ndaj atij sendi.[1]

Autori i librit thotë: "Sikur fjala "ez'zuhd", si terminologji ,të shprehë heqjen dorë prej kësaj bote me qëllimin për të arritur Botën Tjetër, kjo përmbajtje llogaritet prej punëve të gjymtyrëve. Kur fjala "ez'zuhd"shpreh mospasjen dëshirë e mosprirjen kah kjo botë dhe vendosmërinë për heqjen dorë prej saj, kjo llogaritet prej punëve të varura. Ka mundësi që heqja dorë të jetë ose nga ana e mospasjes dëshirë, ose nga ndonjë anë e kufizuar e dëshirës, ose e prirjes.

[1] El-Xheuherij, "Sihàhul-'lugati", vëll. 2, f. 481.

Tani supozimet u bënë katër:

Supozimi i parë: "ez'zuhd"shpreh mungesën e dëshirës absolute për këtë botë në mënyrë të barabartë, e braktis faktikisht ose jo.

Supozimi i dytë: heqja dorë prej kësaj bote faktikisht, në mënyrë të barabartë ka ose jo dëshirë.

Supozimi i tretë: mosprirja e shoqëruar me heqjen dorë.

Supozimi i katërt: heqja dorë është nga ana e mospasjes dëshirë.

Ka shumë mundësi që peshorja të anojë më shumë kah supozimi i tretë dhe pas supozimit të tretë vjen supozimi i katërt e pas të katërtit vjen supozimi i parë. Kurse supozimi i dytë është i përjashtuar, sepse sipas shpjegimit që i bëjnë gjuhëtarët fjalës "ez'zuhd", kuptimi i kësaj fjale është e kundërta e dëshirës.[1]

Gjithashtu, me këtë kuptim fjala përmbajtje është interpretuar edhe në hadithin e nderuar dhe padyshim që dëshira për një send shpreh prirjen shpirtërore dhe jo punën e jashtme. Nga kjo anë mund të thuhet se përmbajtja shpreh edhe mungesën e dëshirës e të prirjes dhe kjo përmbajtje është e krahasueshme me një lloj heqje dorë e braktisje, edhe nëse s'ka lidhje me këto dy të fundit. Ky është supozimi i pestë për kuptimin e fjalës përmbajtje.

Në tërësi, mungesa e dëshirës dhe e prirjes janë prej cilësive shpirtërore dhe konsiderohen në kuptimin e përmbajtjes.

[1] "El-Kàmùsul-muhijt".

NDARJA E DYTË

SHKALLËT DHE GRADAT E PËRKORJES

Le të dihet se për përkorjes "ez'zuhd", si për të gjitha cilësitë shpirtërore, ka shkallë, gradë e pozita njerëzore të panumërta, që nuk hyjnë brenda kuadrit të vënies në konsideratë të pjesëzave.

Këtu do të theksojmë disa prej shkallëve të "ez'zuhd", me aq sa është në përshtatje për këto faqe.

Shkalla e parë: "zuhdi"i njerëzve të zakonshëm shpreh braktisjen e kësaj bote për të arritur mirësitë e Botës Tjetër. Në të vërtetë, kjo shkallë merret prej besimit në disa pozita të Botës Tjetër dhe personi që është në këtë pozitë, është rob i dëshirave të asgjesueshme e të urryera, por në këtë person ato janë nën sundimin e logjikës dhe heqjes dorë prej dëshirave të ulëta e të urryera, me synim arritjen e kënaqësive të përhershme të nderuara.

Kjo është heqja dorë prej dëshirës për hir të një dëshire dhe kjo braktisje e kësaj bote konsiderohet frikë prej ndëshkimit në Botën Tjetër. Në këtë pozitë, sikur të kishte tolerancë në përkorjen absolute, kjo heqje dorë e kjo braktisje do të ishte për shkak të frikës.

Në transmetimin e cituar në librin "Ujùnu Akhbaru Rr'rridà", prej Sadikut (Paqja qoftë mbi të!), lexojmë, se kur ai është pyetur për përkorjen "ez'zuhd" në këtë botë, ka thënë: "Ai që heq dorë prej asaj që është hallall në këtë botë për shkak të frikës se do të japë llogari edhe për atë hallall, gjithashtu ai heq dorë prej asaj që është haram në këtë botë për shkak të dënimit që do të këtë për atë haram."[1]

[1] Shehu Sadùk, "Ujùnu Akhbàru-Rr'rridà", vëll. 1, f. 243.

Shpjegimet e imamëve (Paqja qoftë mbi ta!) që janë zotërinjtë e fesë dhe edukuesit e shpirtrave, ndryshojnë sipas ndryshimit të koncepteve të ndryshme të pyetësve, në kuptimin se ata kanë shpjeguar pozitat e njerëzores për çdo person më vete, ashtu si ishte në përshtatje me pozitën e me gradën e pyetësit.

Ai që ka dituri për pozitat e shpirtit dhe mënyrat e fjalëve të njerëzve të Allahut në zbulimin e qëllimeve të tyre, patjetër duhet të orientohet prej shprehjes së hollë, që në këtë çështje të mbledhë së bashku brendinë e fjalëve të profetëve e të eulijave.

Shkalla e dytë: Përkorja e të veçantëve që shprehet me braktisjen e dëshirave kafshërore dhe kënaqësive që sjellin dëshirat, me qëllimin që të arrihet në pozitat e logjikes e të shkallëve të njerëzores. Kjo shkallë arrihet me anë të diturisë e të besimit në disa gradë të larta prej shkallëve të Botës Tjetër. Atëherë dëshirat kafshërore dhe kënaqësitë e trupit, në sajë të kësaj diturie e të këtij besimi, bëhen të urryera e gjëra pa rëndësi në shikimin e tij. Ky është fillimi i braktisjes dhe burimi i largimit të shpirtit prej këtyre që u thanë. Kënaqësitë logjike e shpirtërore dhe kuptimet e thjeshta të shpaluara me revelatë, gjithmonë kanë qenë e janë objekt i studimit të filozofëve e i dijetarëve të mëdhenj. I pari që është interesuar për këtë çështje, ishte filozofi e mësuesi i madh i lashtësisë, Aristoteli. Kjo shkallë është komentuar e është studiuar edhe prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes e të ndërgjegjësimit, përfshirë edhe krerët e dijetarëve të diturive të vërteta, të cilët kanë shpjeguar se braktisja e kënaqësive, edhe nëse është shpirtërore, hapi i shpirtërores deri në mesataren, nuk është përkorje e vërtetë, pasi përkorje e vërtetë është heqja dorë prej një kënaqësie e dëshire për hir të një dëshire e të një kënaqësie tjetër.

Shkalla e tretë: Përkorja e më të veçantëve prej të veçantëve, që shprehet me braktisjen e kënaqësive shpirtërore e me heqjen dorë prej dëshirave logjike, me qëllimin për të arritur bukurinë e më të bukurës hyjnore deri në të vërtetat e diturive, që kanë të bëjnë me Zotin e botëve. Kjo është pozita e parë prej pozitave të eulijave dhe të dashuruarve, është

prej gradëve të larta të përmbajtjes. Përkorja e vërtetë e atij që arrin në këtë pozitë, arrihet sipas pozitës së tij të parë. Përkorja e vërtetë shpreh mospasjen nevojë as për kënaqësitë e as për të kthyer kokën për të vështruar në kënaqësitë. Pas kësaj pozite, vijnë pozitat e tjera të eulijave. Këtu nuk është i mjaftueshëm vendi që të përmenden.

Me këtë pozitë ne mjaftohemi duke përmendur vetëm këto tri shkallë të përkorjes, të cilat, në vërtetë, janë nënat e të gjitha shkallëve të përkorjes.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIM: POZITA E PËRKORJES (ZUHD) NË RAPOART ME SJELLJEN NJERËZORE DHE PLOTËSIMIN SHPIRTËROR

Në një kapitull më përpara kemi shpjeguar se të gjitha thirrjet hyjnore dhe të gjitha legjislacionet e plotësuara hyjnore, qoftë në zbulimin e të vërtetave të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid) edhe në zbulimin e sekreteve të faktit që Allahu është Një e i Vetëm dhe i zhveshjes prej çdo lloj të adhuruari tjetër, qoftë në shtrimin e virtyteve të mirësive morale, ose në ligjërimin e dispozitave hyjnore, të gjitha këto nuk mund të jenë pa dy qëllime. Njëri prej këtyre dy qëllimeve është qëllimi për veten e për pavarësinë dhe tjetri është qëllimi për shpalosjen e ndjekjen.

Atëherë cili është qëllimi për veten dhe cili është qëllimi më i lartë me dërgimin e me thirrjeve të profetëve (Paqja qoftë mbi ta!)? Cili është qëllimi me luftën e të plotësuarve e të eulijave dhe me zbulimet e tyre?

Njeriu natyral, mishtor, kafshëror, njerëzor, është edhe njeriu hyjnor e shpirtëror. Te njeriu, horizonti i shumicës arrin në horizontin e unitetit dhe e para bashkohet me të fundit. Kështu është edhe plotësimi i së vërtetës e i njohjes që theksohet në hadithin e nderuar: "Isha një thesar i fshehur dhe desha që të njihem, prandaj krijova njerëzit."[1]

Në një hadith tjetër thotë: "Gjëja e parë në fe është njohja e Tij."[2]

Të gjitha punët e zemrës dhe të gjitha punët shabllone, të gjitha punët shpirtërore e trupore, janë për të arritur në këtë qëllim të shenjtë dhe

[1] "Meusùatu atràful-hadijthi-n'nebevij'ji-sh'sherijf", vëll. 6, f. 507.
[2] "Nehxhul-Belàgah", f. 39, Hytbeja 1.

për qëllimin e përhapjes së diturive hyjnore. Por ky qëllim vetjak, i pavarur, nuk mund të arrihet pa dy punë: e para është afrimi te Allahu i Lartësuar dhe dyta është largimi prej çdo gjëje që adhurohet në vend të Vërtetit të Lartësuar dhe braktisja e çdo gjëje tjetër përveç Atij. Nga kjo anë, të gjitha thirrjet hyjnore, janë ose thirrje për afrim te i Vërteti i Lartësuar, ose janë thirrje për t'iu larguar çdo gjëje tjetër përveç Atij. Të gjitha punët e zemrës dhe të gjitha punët shabllone, të dukshme e të padukshme, janë për afrimin te Allahu Fuqiplotë ose për të kërkuar ndihmën e Tij, ose janë për të braktisur moskërkimin e ndihmës prej askujt tjetër përveçse prej Tij.

Në këtë hadith që po shpjegojmë dhe në hadithe të tjera, Allahu thotë: "Ne i thamë mendjes afrohu dhe ajo u afrua, Ne i thamë asaj tërhiqu prapa dhe ajo u tërhoq prapa."[1]

Patjetër që urdhri hyjnor me afrimin e me largimin tregon këtë kuptim, domethënë se të gjitha urdhrat e të gjitha ndalimet hyjnore kanë lidhje më këto dy kërkesa.

Kur mësohet kjo kërkesë, në të vërtetë është mësuar pozita e përkorjes (zuhd) dhe e braktisjes së kësaj bote, me përjashtim të Allahut të Lartësuar. Kjo është përkorja (zuhd) e vërtetë, në raport me sjelljen njerëzore. Është vërtetuar se braktisja e të tjerëve, me përjashtim të të Vërtetit të Lartësuar është parathënia për të arritur bukurinë e më të Bukurit dhe zhytjen në detin e diturive të Njëtimit të Allahut (teuhid). Përkorja (zuhd), në vetvete, nuk është prej plotësimeve e prej pozitave shpirtërore, që të jetë burim orientimi e pavarësie, ashtu siç është theksuar shumë herë në hadithet e nderuara.

Në librin "El-Vesàil", prej librit madhor "El-Kàfij" lexojmë: "Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Prej ndihmuesve moralë të fesë është përkorja (zuhd) në këtë botë."[2]

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 8, libri: "El-aklu uelxhehlu". Në origjinal ka ardhur me foljen "ai ka thënë" dhe ne e kemi cituar me këtë mënyrë folje, me qëllim që të ruajmë besnikërinë e përkthimit.

[2] "Usulul-Kàfij", vëll. 2, f. 104, K. "Dhem'mu-d'dun'jà uez'zuhdu fijhà".

Është përcjellë prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: "Zemrat tuaja e kanë të ndaluar të njohim ëmbëlsinë e besimit, derisa ato të jenë të përmbajtura në këtë botë.[1] Çdo zemër në të cilën ka dyshim, ose idhujtari, ajo është e rrëzuar. Në të vërtetë, qëllimi i tyre me përkorjen (zuhd-in) në këtë botë, është që zemrat e tyre të jenë të zbrazura për Botën Tjetër."[1]

Është e qartë se ky hadith i nderuar, që në fillim qartëson se zemra e shëndoshë është zemra që ka kontakt me Allahun e Lartësuar dhe s'ka kontakt me asnjë tjetër përveç Tij.

Gjithashtu edhe fjala e Imamit (Paqja qoftë mbi të!), në hadithin e mësipërm: "Çdo zemër në të cilën ka dyshim, ose idhujtari, ajo është e rrëzuar.", nuk tregon gjë tjetër përveç orientimit se qëllimi me përkorjen në këtë botë është që zemra të jetë e zbrazur për Botën Tjetër. Nga brendia e këtij hadithi bëhet e qartë se qëllimi me Botën Tjetër në këtë pozitë është arritja në portën e Allahut, është arritja për të takuar bukurinë e më të Bukurit. Përkorja (ez zuhdu) e vërtetë shpreh faktin se në zemër nuk ka as dyshim e as idhujtari dhe se në zemër s'ka asgjë tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar.

Me përcjellës prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë: "Kur besimtari e ka hequr prej vetes këtë botë, ai është ngjitur në lartësi, ka gjetur ëmbëlsinë e dashurisë së Allahut dhe nuk interesohet për asgjë tjetër përveç Atij."[2]

Në librin "Misbàhu-sh'sherij'ati" lexojmë se imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Përkorja (zuhd) është çelësi për hapjen e portës së Botës Tjetër dhe siguri prej zjarrit. Përmbajtja është kur ti heq dorë prej të gjitha sendeve dhe je i shqetësuar vetëm me Allahun e Lartësuar, pa ndier asnjë keqardhje për ato që ke humbuar dhe s'ke asnjë krekosje ngaqë ke hequr dorë prej atyre sendeve." Hadithi vijon.

[1] I njëjti burim, i njëjti kapitull, f. 105.
[2] "Vesàilu-sh'shij'ah", Libri "Xhihàdu-n'nefsi", K. 66, f. 13, Hadithi 8.

NDARJA E KATËRT

SHPJEGIM: DËSHIRA PËR KËTË BOTË SJELL MBULIMIN PREJ TË VËRTETIT TË LARTËSUAR

Mëso se dëshira për këtë botë sjell mbulim prej të Vërtetit të Lartësuar dhe vonim në rrugëtimin drejt Tij. Qëllimi me termin "kjo botë" është çdo gjë që e preokupon njeriun dhe e ndalon atë prej të Vërtetit të Lartësuar, në kuptimin që kjo realizohet më shumë në botën e cilësive. Nga ky këndvështrim, kjo botë ka më shumë të drejtë të emërtohet me emrin "dun'jà", që do të thotë më e ulëta.

Për këtë kuptim tregon edhe hadithi nderuar, i transmetuar në librin "Misbahu-sh'sherij'ati", ku lexojmë se përkorje (ez zuhdu) do të thotë: "Heqja dorë prej të gjitha sendeve që të preokupojnë, por jo prej Allahut."

Ata që kanë arritur gradën e njohjes, e kanë interpretuar mbulimin, ndriçimin dhe errësimin me hadithin: "Allahu i Lartësuar ka shtatëdhjetë mijë mbulesa prej drite dhe shtatëdhjetë mijë mbulesa errësirë." me ekzistencën e sendeve, me botët e këtyre sendeve dhe me të dukshmen e botëve e të sendeve.

Preokupimi me çdo njërën prej këtyre e privon njeriun dhe e mbulon atë prej fytyrës së më të Bukurit.

Kjo thuhet në hadithin e nderuar, në kapitullin "Sexhdja": "Sexhdeja mbi turben[1] e Ebu Abdullahut, imam Huseini, (Paqja qoftë mbi të!) gris shtatë mbulesa."[2]

---

[1] Turbe është guri që prodhohet nga dheu i Qerbelasë në të cilën ka rënë dëshmor imam Huesini *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe përdoret për të bërë sexhde.

[2] "Vesàilu-sh'shij'ah",vëll. 5, f. 366, "Kitàbu-s'salàti", K. 16 prej kapitujve të "Mà jesxhudu alejhi".

Ka mundësi që mbi këto shtatë mbulesa të jenë edhe shtatë mbulesa të tjera, ashtu siç del qartë ky interpretim në hadithin e shkaqeve, i përcjellë prej Hish'shàm bin Elhakem, i cili tregon: "I thashë Hasen Ebù Mùsàsë (Paqja qoftë mbi të!): "Cili është shkaku që e bëri tekbirin e fillimit (tekbijrul-iftitàhi) me vlerën e shtatë tekbireve…?"
Ai vazhdoi: "O Hish'shàm, Allahu i Lartësuar qiejt i krijoi shtatë, shtatë krijoi edhe tokat, shtatë krijoi edhe mbulesat dhe, kur bëri të udhëtojë natën Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) dhe ishte afër Allahut sa madhësia e dy harqeve, ose edhe më afër, ia ngriti atij njërën mbulesë, atëherë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!), tha: "Allahu Ekber!" dhe vazhdoi të thotë fjalët që thuhen në fillim të namazit. Kur Allahu i ngriti atij edhe një mbulesë të dytë, ai përsëri tha: "Allahu Ekber!".
Ai vazhdoi kështu derisa numri i mbulesave të hequra arriti shtatë dhe ai për çdo mbulesë që i hiqej thoshte: "Allahu Ekber!" derisa u bënë shtatë herë. Ky është shkaku që tekbiri i fillimit në namaz ka vlerën e shtatë tekbireve."[1]

Në të gjitha gjendjet, ekzistenca e çdo qenie, ose ekzistenca e çdo bote, është mbulesë dhe emërtohet gjithashtu mbulesë. Këto mbulesa e pengojnë njeriun të shohë bukurinë e të Dashurit. Prandaj lidhja e varësia me çdo gjë tjetër, por jo me Allahun është një ferrë në rrugën e udhëtimit për te i Larti.

Ai që ka marrë rrugën për te Allahu i Lartësuar dhe që kërkon të arrijë takimin me Allahun, ngjitja në shkallët e diturive hyjnore patjetër që ia heq atij këtë ferrë prej rrugës me anën e ushtrimeve të ligjëruara.

Është e pamundur ngritja lart drejt plotësimeve shpirtërore dhe arritja e takimit me bukurinë e më të Bukurit, kur ka varësi edhe me diçka tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar, ose kur personi është ndjekës i dëshirave dhe i epsheve.

[1] "Ilelu-sh'sherài'I", vëll. 2, f. 27, K. 30, shtypur në shtypshkronjën "Et-Alemij".

NDARJA E PESTË

SHPJEGIM: PËRKORJA (EZ ZUHDU) ËSHTË PREJ NATYRËS SË PASTËR TË KRIJIMIT DHE PREJ SHOQËRUESEVE TË CILËSISË SË BRUMIT ME TË CILIN ËSHTË GATUAR NJERIU KURSE DËSHIRA ËSHTË PREJ SHOQËRUESËVE TË MBULIMIT TË NATYRËS SË KRIJIMIT

Më sipër u mësua se njeriu, në sajë të cilësisë së pastër hyjnore të krijimit, me të cilën është krijuar e gjithë familja njerëzore, së bashku me të janë krijuar edhe dy cilësi, njëra është origjinale, kurse cilësia tjetër është degë. Të gjitha cilësitë e tjera, me të cilat është krijuar njeriu burojnë prej këtyre dy cilësive.

E para: cilësia e dashurisë për plotësimin absolut. Kjo cilësi është origjinale, e pavarura

E dyta: neveria për mangësinë, që është cilësi degë.

I Vërteti i Madhëruar e ka krijuar njeriun për veten e Tij, ashtu siç ka ardhur në hadithin kudsi: "O bir i Ademit, sendet i krijova për ty dhe ty të krijova për veten Time!"[1]

[1] El-Fejd El-Kàshànij, "Ilmul-jekijn", vëll. 1, f. 381.

Referencat për këtë kuptim janë të shumta në Kur'anin Famëlartë dhe në hadithet e nderuara. Të gjitha këto referenca tregojnë se njeriu u krijua me këto dy cilësi në bërjen hyjnore e konstruktive të tij dhe me ndërprerjen e njërës prej këtyre dy cilësive, me tjetrën ai lidhet me bukurinë e më të Bukurit. Të gjitha cilësitë e tjera te njeriu i referohen këtyre dy cilësive të pastra të natyrës së pastër të krijimit të njeriut dhe janë degë të këtyre dy cilësive bazë.

Gjithashtu edhe dispozitat e ligjit hyjnor absolutisht të pastra, janë në përputhje me formën e natyrës së pastër të krijimit.

Për të gjitha këto, përkorja (ez zuhdu) shpreh neverinë për mangësinë dhe largimin prej çdo gjëje tjetër përveç largimit prej të Vërtetit të Lartësuar. Kuptohet që kjo cilësi i referohet cilësisë së pastër të brumit të natyrshëm, me të cilin është gatuar njeriu dhe është prej dispozitave degë të cilësisë së krijimit të Allahut.

Edhe dëshira për sende të tjera dhe jo për të Vërtetin, pavarësisht së është mbulesë për shkak të cilësisë së krijimit, por pas mbulimit me mbulesën e natyrës, për shembull njeriu e mendon të Dashurin e vet në një përngjasim me njërën prej degëve të natyrës dhe me këtë përngjasim e çon varësinë e dashurisë së tij te ky i përngjasuar, njëkohësisht e lidh zemrën e tij me atë të përngjasuar, për rrjedhojë ai vonohet prej bukurisë së më të Bukurit, privohet prej takimit me Allahun dhe mbulohet prej Tij.

Përkorja (ez zuhdu) e vërtetë është prej ushtrive më të mëdha të mendjes dhe prej është prej ushtrive të mëdha të të Gjithëmëshirshmit, i Cili me ndërmjetësimin e përmbajtjes (zuhd) bën që njeriu të fluturojë drejt botës së shenjtërisë e të pastërtisë, madje e ngre krejtësisht prej kësaj bote.

Për njeriun, në këtë gjendje arrihet plotësimi që përfundon te Allahu i Lartësuar. Edhe dëshira për këtë botë e për gjërat e bukura të kësaj bote, edhe orientimi e dashuria për zbukurimet marramendëse të kësaj bote, është prej ushtrive më të mëdha të Iblijsit e prej ushtrive më të mëdha të injorancës, është prej kurtheve më të imta të vetes, në atë mënyrë që njeriu

privohet me mbulimin për shkak se u vu në provë me dashurinë për këtë botë. Rezultat i këtij mbulimi, për shkak të dashurisë për këtë botë, është se ai humb rrugën e udhëzimit e të orientimit për të arritur në rezultatin e njerëzores dhe të përfitojë prej frytit të pemës së kujdestarisë. Kur njeriu gjendet në këtë kërkesë dhe kur ai vështron me syrin e kujdesit të madh e me syrin e zemrës në të gjithë punën e tij, nga fillimi deri në fund, menjëherë do të shikojë se për atë është e domosdoshme të heqë dorë prej rrugës që ka nisur dhe, me aq sa ka mundësi, menjëherë të largojë prej rrugës së tij këtë ferrë, ferrën e dashurisë e dëshirën për këtë botë dhe dashurinë e dëshirën për gjërat e kësaj bote.

Menjëherë të largojë këtë gabim shkatërrues, që në të vërtetë është kryet e çdo gabimi dhe nëna e të gjitha sëmundjeve. Njeriu patjetër duhet të heqë këtë gabim prej shtëpisë së zemrës së tij dhe të pastrojë këtë shtëpi prej ndyrësirave, sepse shtëpia e zemrës është vendbanimi për të Dashurin, është vendi i shkëlqimit për të Kërkuarin, sepse dashuria e dëshira për këtë botë, është prej ushtrive të Iblijsit e prej kurtheve të djallit. Me këtë pastrim, njeriu i pret dorën xhinit të keq kryengritës, zemërimit, ndalon zemërimin të hyjë në shtëpinë e Allahut. Me këtë pastrim, njeriu i rrëzon të gjitha idhujt prej kuadrit të zemrës, që, siç u tha, është shtëpia e Allahut e sallonet e Tij. Vetëm kështu njeriu mund të shohë të Zotin e shtëpisë në shtëpinë e tij dhe të ndriçojë atë shtëpi me shkëlqimet e Tij.

O Allah, o Zoti ynë, ne jemi vënë në provë më rrjetat e ngatërruara të shpirtit e me rrjetat e djallit. Ne nuk gjejmë rrugëdalje prej këtij vrapi të furishëm dhe ne s'kemi fuqi të kundërshtojnë e të polemizojmë me atë. Sa herë që ne i shpëtojmë një kurthi, vihemi në provë me më shumë kurthe të imta e më të perfeksionuara, vetëm nëse na merr për dore dhembshuria Jote e pambarueshme. Vetëm ajo na çon ne drejtë të mirës absolute, vetëm dhembshuria Jote na pastron ne prej pusit të natyrës, të gremisë dhe të errësirës. "O Zotëria im! Mëshiro! Kapitali i njeriut është shpresa dhe arma e tij është qarja."

NDARJA E GJASHTË

CITIMI I ARGUMENTEVE TEKST NË KËTË KAPITULL

Argumentet tekst për këtë kapitull janë më shumë nga sa mund të futen në këtë përmbledhje, prandaj do të mjaftohemi të përmendim vetëm disa prej tyre. Ndër këto argumente është fjala e të Lartit:

لِّكَيْلَا تَأْسَوْاْ عَلَىٰ مَا فَاتَكُمْ وَلَا تَفْرَحُواْ بِمَآ ءَاتَىٰكُمْ *"Likejlà teëseu alà mà fàtekum ue là tefrehù bimà àtàkum…"* "Që ju të mos dëshpëroheni për ato që u dolën prej duarsh dhe të mos gëzoheni për ato që Ai ka dhënë për ju."[1]

Në librin "El-Vesàil" lexojmë se një burrë ka pyetur Ali bin Husejnin (Paqja qoftë mbi të!) për përkorjen (ez zuhdu) dhe ai tha: "Dëgjoni me vëmendje, përkorja ka ardhur në një ajet të Librit të Allahut, që ju të mos dëshpëroheni për ato që u dolën prej duarsh dhe të mos gëzoheni për ato që Ai ka dhënë për ju."[2]

Edhe ky transmetim është një dëshmues tjetër, që vërteton atë që thamë më sipër, se përkorja (ez zuhdu) është prej cilësive shpirtërore shoqëruese të punës dhe jo të heqjes dorë.

Atëherë përkorja (ez zuhdu) është zemra e zbrazur prej dashurisë për këtë botë dhe mosinteresimi për punët që orientojnë për në këtë botë e për gjërat e bukura të kësaj bote. Atëherë si mund të ketë keqardhje për humbjen e gjërave të dashura të kësaj bote dhe si mund të ketë gëzim për ardhjen e gjërave të bukura të kësaj botë?

---

[1] Sure "El-Hadijd", ajeti 23.

[2] "Vesilu-sh'shij'ati", vëll. 16, f. 12, K. 62 prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi".

Në zemrën e të përkorurit (zàhid) arrihet gjendja e shkujdesjes dhe e mosinteresimit për këtë botë, në atë mënyrë që ai nuk interesohet fare as për këtë botë e as për gjërat e bukura të kësaj bote, prandaj si mund të ndiejë ai keqardhje kur gjërat e kësaj bote i dalin prej duarve të tij, ose si mund të jetë ai i gëzuar kur ata i vijnë.

Allahu i Lartësuar, duke përshkruar Karunin, thotë:

فَخَرَجَ عَلَىٰ قَوْمِهِۦ فِى زِينَتِهِۦ ۖ قَالَ ٱلَّذِينَ يُرِيدُونَ ٱلْحَيَوٰةَ ٱلدُّنْيَا يَٰلَيْتَ لَنَا مِثْلَ مَآ أُوتِىَ قَٰرُونُ إِنَّهُۥ لَذُو حَظٍّ عَظِيمٍ ٧٩ وَقَالَ ٱلَّذِينَ أُوتُوا۟ ٱلْعِلْمَ وَيْلَكُمْ ثَوَابُ ٱللَّهِ خَيْرٌ لِّمَنْ ءَامَنَ وَعَمِلَ صَٰلِحًا ۚ وَلَا يُلَقَّىٰهَآ إِلَّا ٱلصَّٰبِرُونَ ٨٠

" Fekharexhe alà kaumihi fij zijnetihi, kàle-l'ledhijne jurijdùnel-hajàte-d'dun'jà jà lejte lenà mithle mà ùtije Kàrùne in'nehù ledhù hadh'dhin adhijmin. Ue kale-l'ldhijne ùtùl-ilme vejlekum thevàbu-ll'llàhi khajrun limen àmene ue amile sàlihan ue là julek'kàha il'le-s'sàbirùne"

"Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolitë e veta dhe, ata që dëshironin jetën e kësaj bote thanë: "Ah si kur të na jepeshin edhe ne ato që i janë dhënë Karunit, me të vërtetë ai është me fat të madh. Dhe atyre që u ishte dhënë diturit thanë: "Të mjerët ju, shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri punë të mirë, por këtë nuk e arrin askush përveç të durueshmëve…"[1]

Ata që u gëzuan me jetën e kësaj bote kishin qëllim vetëm këtë botë dhe gjërat e bukura të kësaj bote, por kur ata panë Karunin me stolitë e tij, shpresat e tyre u ngjitën lart dhe u bënë ziliqarë për stolitë e Karunit. Por dijetarët, të cilëve u është dhënë prej të Vërtetit të Lartësuar dituria për gjërat e padukshme, u thanë atyre se nuk bën të interesoheshin kaq shumë për gjërat e bukura të kësaj bote, por të kërkonin shpërblimin te Allahut. Gjithashtu dijetarët i thanë atyre se këto shpërblime të Allahut arrihen vetëm me durim.

[1] Sure "El-Kasas", ajetet 79-80.

Ky ajet i nderuar tregon pozitën e parë të përmbajtjes (zuhd), por ka mundësi që ajeti gjithashtu të mos i referohet pozitës së përmbajtjes. Ne i kemi përmendur këto fjalë sipas asaj që kanë thënë disa studiues, shpjegues të hadithit.

Transmetohet se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) është pyetur për kuptimin e shpjegimit të fjalës së të Lartit: فَمَن يُرِدِ ٱللَّهُ أَن يَهۡدِيَهُۥ يَشۡرَحۡ صَدۡرَهُۥ لِلۡإِسۡلَٰمِ *"Femen juridi-l'làhu en jehdijehù jeshrah sadrehù lil-islàmi…."* "Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin…"[1]

Kur profetin e pyetën se si është ky shpjegim, tha: "Kur drita hyn në zemër, zemra për atë dritë zgjerohet dhe është e hapur."

Përsëri u pyet: "O i Dërguar i Allahut, a ka ndonjë shenjë për këtë?"

Ai tha: "Po, largimi prej shtëpisë së mashtrimit dhe afrimi kah shtëpia e përjetshme, si dhe përgatitja për vdekjen para ardhjes së vdekjes."[2]

Dihet se derisa zemra është e hapur drejt botës së natyrës të errët dhe pusit të ngushtë e të errësuar të kësaj bote. Derisa zemra është nën mbështjelljen e kësaj bote e nën mashtrimin e saj, ajo është e ngushtë dhe e errët, nuk e pranon as dritën e udhëzimit për në rrugën e drejtë dhe as shkëlqimin me bukurinë e Madhështorit.

Sipas masës së largimit të zemrës prej kësaj bote e prej gjërave të bukura të kësaj bote, në atë masë arrihet edhe zgjerimi i zemrës, në atë masë e pranon zemra dritën morale, derisa zemra largohet krejtësisht prej shtëpisë së mashtrimit, derisa zemra e braktis këtë shtëpi dhe zhvishet krejtësisht prej saj. Atëherë ajo zemër bëhet e merituar të shkëlqejë me dritën absolute dhe me bukurinë e më të Bukurit. Shpresohet që përgatitja për vdekjen të jetë më përgjithësuese se vdekja kafshërore natyrale dhe pastaj ajo zemër është e shpalosur për të gjitha gradat e përkorjes (ez zuhdu).

---

[1] Sure "En-Am", ajeti 125.
[2] Et'tabresij, "Muxhmeul-Bejàn", vëll. 4, f. 561.

Prej transmetimeve po përmendim transmetimin e përcjellë prej Muhamed bin Jakubit (Paqja qoftë mbi të!) prej Ebu Abullahut (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka thënë: "Kush është i përmbajtur në këtë botë, Allahu e forcon urtësinë në zemrën e tij, bën që gjuha e tij të flasë me urtësi, që ai të shohë të metat e kësaj bote e sëmundjet e saj, të dijë ilaçet për shërimin e sëmundjeve të kësaj bote dhe Allahu e nxjerr atë prej kësaj bote të shëndoshë për në shtëpinë e paqes."[1]

Me përkorjen (ez zuhdu) në këtë botë dhe me braktisjen e kësaj bote, në zemrën e të përmbajturit stabilizohet drita e urtësisë. Kjo dritë bëhet për atë udhëheqëse në rrugën e lumturisë e të arritjes në pozitën e plotësimit njerëzor, ajo që është në zemrën e tij rrjedh në drejtim të gjuhës së tij, ashtu siç thuhet në kapitullin e sinqeritetit: "S'ka ndonjë rob që ka qenë i sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar dyzet mëngjese dhe që të mos kenë rrjedhur burimet e urtësisë prej zemrës së tij për në gjuhën e tij."[2]

Sinqeriteti merr pjesë së bashku me përkorjen e vërtetë në heqjen dorë prej shpresave e qëllimeve të kësaj bote. E vërteta e urtësisë është e kundërta e errësirës, është e kundërta e dashurisë për veten dhe e admirimit të vetes. Derisa dashuria për këtë botë e për gjërat e bukura të kësaj bote do të vazhdojnë të jenë të pranishme në zemër, atëherë zemra është e mbuluar dhe nuk i sheh të metat e kësaj bote, sepse perdet e dashurisë për këtë botë, janë perdet më të trasha, ashtu siç është thënë: "...dashuria për një send verbëron dhe shurdhon."[3]

Derisa dashuria e dëshira për këtë botë do të vazhdojnë të jenë në zemër, atëherë të gjitha të metat e kësaj bote duken të mira dhe të gjitha të këqijat e kësaj bote duken të bukura e shumë të bukura.

Kur brenda në zemër s'ka asgjë prej dashurisë për këtë botë dhe njeriu braktis të kuqen e të verdhën e kësaj bote (paratë prej floriri e

[1] "Usùulul-Kàfij", vëll. 2, f. 104, K. "Dhem'mu-d'dun'jà", Hadithi 1.
[2] "Bihàrul-Envàr", vëll. 67, f. 242, Hadithi 10.
[3] "Bihàrul-Envàr", vëll. 74, f. 165, Hadithi 2.

argjendi), Allahu i Gjithëfuqishëm bën që ne të kuptojmë të metat e kësaj bote dhe bën që ne të shohim sëmundjen e ilaçin.

Kur kjo mbulesë e trashë griset, atëherë të metat që shkëlqenin në formën e të mirës dhe të bukurës dalin jashtë perdes. Kur njeriu njeh sëmundjen e ilaçin, rruga për atë ndriçohet dhe për atë bëhet e lehtë rruga e përmirësimit, në këndvështrimin se "dashuria për këtë botë është kryet e çdo gabimi" dhe, me këtë përkorje, krahas përmbajtjes në këtë botë, arrihet shpëtimi dhe paqja e shpirtit.

Kur te njeriu arrihet përkorja (ez zuhdu) e vërtetë, ai del prej kësaj bote për të shkuar në shtëpinë e paqes i shëndoshë e i shpëtuar, në tërë kuptimin që ka fjala shpëtim. Ai del prej kësaj bote pa asnjë të metë, sepse të gjitha të metat janë pasoja të varësive dhe, kur varësitë nuk janë me asnjë tjetër përveçse me të Gjithëfuqishmin, atëherë arrihet shpëtimi absolut.

Me përcjellësit e tij, prej Hafs bin Gaj'jàth, prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!), lexojmë se Gaj'jàthi tregon: "E dëgjova atë të thotë "Të gjithë të mirën Ai e bëri në një shtëpi dhe çelës për hapjen e kësaj shtëpie Ai bëri përkorjen (zuhd-in) në këtë botë."

Pastaj shtoi se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: "Burri nuk e gjen ëmbëlsinë e besimit derisa të mos tregojë interes për ato që ha në këtë botë."

Pastaj Ebu Abdullahu (Paqja qoftë mbi të!) tha: "Zemrat tuaja janë të privuara të njohin ëmbëlsinë e besimit derisa ju të jeni të përkorur në këtë botë."[1]

Prej këtij hadithi mësohet se arritja e të mirave dhe e lumturive, nuk është punë e lehtë pa u prerë marrëdhëniet me këtë botë dhe pa qenë të përkorur në këtë botë, sepse origjina e origjinave të vështirësisë dhe e mbulimit është lidhja me këtë botë dhe dashuria e dëshira për këtë botë.

[1] "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 16, K. "Xhihàdu-n'nefsi", Hadithi 5.

Gjithashtu mësohet se përkorja është çelësi për hapjen e portës së mirësive dhe, siç kemi përmendur më sipër, përkorja (ez zuhdu), në vetvete, nuk është qëllim, po kështu edhe çelësi nuk është qëllim në vetvete. Por përkorja në këtë botë shërben vetëm për të hapur portën, për rrjedhojë me përkorjen hapet porta e lumturisë dhe e njohjes.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) shkurtimisht shpjegoi shkallën e parë të përkorjes dhe shkallën e parë të punëve të mira, pastaj citoi fjalën e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): "Burri nuk e gjen ëmbëlsinë e besimit derisa të mos tregojë interes për ato që ha në këtë botë." Derisa njeriu nuk del jashtë pozitës së kafshërisë, pozitës së ngopjes të barkut e plotësimit të epshit, njeriu nuk arrin në pozitën e shpirtërores e në pozitën e njerëzores.

Ne tani jemi në pozitën e kafshëve shtëpiake e të kafshëve të egra, prandaj nuk e njohim të vërtetën e besimit, nuk njohim të vërtetën e Islamit, ose i njohim vetëm si emër e si shkronja. Në këtë kuptim, ne nuk e njohim ëmbëlsinë e besimit. Derisa zemra s'ka vënë në përdorim shqisën e shijimit, shijimi i ëmbëlsisë prej kësaj zemre nuk është aspak punë e thjeshtë dhe e lehtë, derisa zemra do të jetë në pozitën e kafshërores, për njeriun s'do të ketë zemër, derisa për atë të ketë edhe shijim.

Përcjellës prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!), në librin "Aliu (Paqja qoftë mbi të!)", citojnë fjalën e tij: "Kjo botë është e ngjashme me gjarprin, mbi të cilin, mbi çdo gjë të butë që e lëmon atë, gjendet helmi i mbledhur në dhëmbët e tij. Burri i mençur ruhet prej helmit, por shkon drejt gjarprit fëmija që nuk di asgjë."[1]

Prijësi i besimtarëve kishte dijeni për pozitat shpirtërore dhe ishte udhëzues për në rrugën e njerëzores. Ai kishte dituri për të brendshmen e të jashtmen e sendeve, e njihte këtë botë më mirë se të gjithë njerëzit e tjerë, gjithashtu ai e dinte se bota me të jashtmen e saj ishte mashtrim e kënaqësi. Por çdo kënaqësi është vonim prej lumturive e zhytje në veprime

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Dhem'mu-d'dun'jà", Hadithi 22.

shkatërruese, por këtë të vërtetë nuk e njeh, nuk ka dituri dhe nuk e beson as i shkujdesuri e as injoranti.

Në të vërtetë, një fëmijë e dallon sendin vetëm nga ana e jashtme e tij dhe, kur fëmija shikon një gjarpër të bukur, ai vrapon drejt gjarprit me dashuri e dëshirë të plotë. Sa herë që fëmija paralajmërohet për rrezikun prej gjarprit, ai nuk e beson paralajmërimin. Prandaj i mjeri nxiton drejt shkatërrimit të vetvetes.[1]

Të gjithë prijësit e tarikatit, ata që ecin në rrugën e udhëzimit të drejtë, udhëheqësit e njerëzisë, librat qiellorë, fletët që iu shpallën profetëve të mëdhenj, njoftimet e eulijave të nderuar, këshillat e atyre që kanë arritur gradën e njohjes dhe këshillat e dijetarëve, nuk kanë ndikuar dhe kurrë nuk do të ndikojnë në zemrat tona, në zemrat e të shkujdesurve e të injorantëve.

Ana e jashtme e kësaj bote është e bukur, zbukurimet e gjërat e bukura të kësaj bote, bëjnë që ne të jemi të shkujdesur ndaj helmit vrasës që është në të brendshmen e kësaj bote. E brendshmja e kësaj bote do të zbulohet një ditë, por deri atëherë ne nuk do të kemi mundësi të ruhemi prej të këqijave që na vijnë prej saj, sepse fytyra e vërtetë e kësaj botë është e gdhendur në brendësi të saj, për rrjedhojë edhe cilësia e pastër dhe pastruese e krijimit është e ndotur me ndyrësinë e kësaj bote dhe është bërë si monedha e floririt fallco, e përzier me metale të tjera. Prandaj ajo monedhë kurrë s'mund të jetë flori i pastër, derisa monedha të shkrihet në zjarr.

Cilësia e natyrës së pastër të krijimit njerëzor është si metali i pastër i floririt e i argjendit: "njerëzit janë metale si metali i floririt e i argjendit."[2] Në cilësinë e pastër të krijimit të njeriut s'ka asgjë tjetër përveç dashurisë për të Vërtetin e Lartësuar. Kjo dashuri është plotësimi absolut. Por në këtë dashuri për Allahun janë përzier edhe dashuri për të tjerë, prandaj dashuria për të Vërtetin e Lartësuar ka dalë jashtë pastërtisë. Më e keqe e më e

[1] Brendia e një poezie të Sadi Shirazit, në gjuhën perse.
[2] "Musnedi" i Imam Ahmed bin Hanbelit, vëll. 2, f. 529.

madhe është përzierja e dashurisë për të Vërtetin, me dashurinë për këtë botë e me dashurinë për natyrën. Kur ndodh kjo përzierje e kjo ndotje, atëherë mbi sipërfaqen e zemrës mbizotëron ndyrësia.

Edhe pse sipërfaqja e zemrës, sipas cilësisë së krijimit, është krejtësisht e pastër, në atë nuk shkëlqen e vërteta, ashtu siç ajo është. Madje në sipërfaqen e kësaj zemre nuk janë gdhendur asgjë prej të vërtetave, ose të vërtetat në sipërfaqen e asaj zemre janë gdhendur të shtrembëruara. Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e të Lartit:

فَأَمَّا ٱلَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمۡ زَيۡغٞ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَٰبَهَ مِنۡهُ ٱبۡتِغَآءَ ٱلۡفِتۡنَةِ وَٱبۡتِغَآءَ تَأۡوِيلِهِۦۖ

"…fe'em'me-l'ledhijne fij kulùbihim zejgun fejet'tebiùne mà teshàbehe minhub-tigàel-fitneti uebtigàe teëvijlihi…" "…ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e gabuara, ata ndjekin atë që nuk është e qartë dhe për shkak të hutimit, ata e kërkojnë shpjegimin në të atë që nuk është e qartë…"[1]

Në zemrat e shtrembëruara janë përzier dëshirat njerëzore, dashuria për veten e dashuria për këtë botë. Këto zemra e interpretojnë Librin hyjnor dhe ajetet e shkruara konstruktive sipas dëshirave të tyre vetjake. Ky është interpretim me opinion. Në këtë mënyrë interpretimi vepron djalli dhe interesat njerëzore, prandaj mënyra e interpretimit me opinion është e gabuar dhe e ndaluar rreptësisht.

Interpretimi i Librit hyjnor shpreh kthimin e formës në kuptim dhe veshjen e jashtme në esencialen, por kjo punë nuk është e lehtë të shkojë drejt plotësimit, me përjashtim të atyre që, në veten e tyre, nuk kanë devijuar dhe në zemrën e tyre s'ka asgjë tjetër përveç dritës së të Vërtetit të Lartësuar. Ata kanë arritur në pozitën e dashurisë absolute e të asgjësimit absolut. Kjo është pozita e interpretimit. Kjo pozitë është vetëm për të Dërguarin më të nderuar dhe për zëvendësit e tij të shenjtëruar, të cilët janë të pajisur me dituri të palëkundshme dhe kanë arritur shkallën e njohjes. Për këtë njofton i Larti me fjalën e Tij: وَمَا يَعۡلَمُ تَأۡوِيلَهُۥٓ إِلَّا ٱللَّهُۗ وَٱلرَّٰسِخُونَ فِي ٱلۡعِلۡمِ

[1] Sure "Al-Imran", ajeti 7.

"…ue mà ja'lemu te'vîjlehù il'le-ll'llàhu uerr'rràsikhùne il-ilmi…" "…por interpretimin e tij nuk e di askush përveç Allahut dhe të pajisurve me dituri…"[1]

Mjafton për këtë kërkesë sqarimi i teksteve që sollëm dhe kërkoj ndjesë që nuk mund të sjellim më shumë.

Falënderimi e lavdërimi, fillim e mbarim, janë vetëm për Allahun e Lartësuar.

[1] Sure "Al-Imran", ajeti 7. Prej Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) "Ne të pajisurit me dituri ne e dimë interpretimin e tij", "Usùlul-Kàfij", vël. 1, f. 166, Libri "Elhuxh'xhetu", K. 22.

QËLLIMI I GJASHTËMBËDHJETË

SJELLJA E BUTË, E KUNDËRTA, BRUTALITETI

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI: Ç'DO TË THOTË SJELLJE E BUTË DHE ARROGANCË

Sjellja e butë (në gjuhën arabe rifk) është e kundërta e dhunës, në kuptimin e zemërgjerësisë. Nga ana gjuhësore, kur thuhet tregoi sjellje të butë ndaj dikujt, është në kuptimin: e trajtoi me butësi, e ndihmoi dhe i solli atij dobi.[1]

Gjithashtu përdoret edhe për sjelljen e butë me personin që ke në krah, ose jo.[2] Në tërësi, grupi emëror sjellje e butë, është e kundërta e brutalitetit. Ky grup përdoren edhe në kuptim: burri punën e bëri të mirë. Në një hadith të nderuar lexojmë: "Kur sjellja e butë është brutalitet, atëherë brutaliteti është sjellje e butë."[3]

Kjo do të thotë se, kur sjellja e butë në punë është e padobishme, atëherë detyra jote është të sillesh me brutalitet. Në raste të tjera, kjo fjalë është edhe në kuptimin që brutaliteti është nxitim, do të thotë se nxitimi është i atillë që nuk sjell dobi, atëherë ke detyrë të sillesh me të butë.

Qëllimi me këtë është që sjellja e butë dhe sjellja e ashpër të përdoren në vendin e duhur. Kur sjellja e butë përdoret jo aty ku duhet, ajo

[1] Fjalori "El-munxhid".
[2] Fjalori "Lisànul-areb", vëll. 5, f. 273.
[3] "Nehxhul-Belàgah", f. 402.

është brutalitet. Gjithashtu, edhe brutaliteti, kur përdoret jo në vendin e duhur, është sjellje e butë. E afërt në kuptim me këtë është edhe fjala e Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!): "Ndodh që ilaçi është sëmundje dhe sëmundja ilaç."[1] [2]

Është çudi që ka artificializëm në kuptimin e këtij hadithi, megjithëse hadithi është plotësisht i qartë, sepse është në kuptimin: kur sjellja e butë e zemërgjerësia janë shkak për brutalitet e për vështirësi, atëherë patjetër duhet hequr dorë nga zemërgjerësia dhe të veprohet me korrektësi, që në këtë rast është esenca e zemërgjerësisë.

Për shembull: dora e gangrenizuar, duhet prerë patjetër, por kur prerja e kësaj dore bëhet me delikatesë, kjo mënyrë trajtimi sjell vështirësi dhe bëhet shkak për dhembje edhe më të mëdha. Prandaj prerja e kësaj dore, në këtë gjendje, duhet bërë me shpejtësi e me korrektësinë e duhur. Pikërisht ky veprim i ashpër, në këtë rast është esenca e sjelljes së butë dhe zemërgjerësisë.

Fjala brutalitet, në gjuhën arabe "el khark", nga ana gjuhësore, është në kuptimin e kundërt me sjelljen e butë e me zemërgjerësinë. Gjithashtu kjo fjalë në gjuhën arabe ka ardhur edhe në kuptimin e dobësisë mendore, mendjelehtësisë, injorancës, dhunës, papastërtisë, mëkatit e nxitimit.

Në një hadithin e nderuar lexojmë: "Brutaliteti është fatkeqësi dhe sjellja e mirë është lumturi."[3]

Fjala "kharkun"-"brutalitet" e arabishtes përdoret e dhe në kuptimin: grisi rrobë, domethënë e bëri rrobën copë-copë.[4] Në raste të tjera, kjo fjalë përdoret edhe në kuptimin habi e frikë, si për shembull në kuptimin: e bëri të habitet, e frikësoi.

Është e qartë se kuptimet e ndryshme të kësaj fjale janë marrë nga marrëdhënia që kanë fjalët në origjinë dhe i referohet një pune të caktuar dhe patjetër sipas vendeve ku përdoret kjo fjalë.

---

[1] "Nehxhul-Belàgah", f. 402.
[2] "Muxhmeul-Bahrejn", vëll. 5, f. 171.
[3] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 97; Libri "El-Ijmànu uel-kufru", K. "Err'rifku", Hadithi nr. 4.
[4] Fjalori "El-Muhijt".

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: NDIKIMI I SJELLJES SË BUTË NË PUNËT E NJERIUT

Mëso se sjellja e butë dhe zemërgjerësia kanë ndikim të madh në realizimin e punëve jo vetëm në fushën e marrëdhënieve me njerëzit, por edhe në realizimin e punëve që kanë të bëjnë me këtë botë, ose me punë që kanë lidhje me fenë, ose me punët që kanë lidhje me udhëzimin e orientimin e njerëzve, ose në fushën e urdhërimit për punë të mirë dhe për ndalimin e punës së keqe, ose për punë që kanë të bëjnë me ushtrimet shpirtërore dhe me rrugëtimin për te Allahu i Lartësuar. Edhe hadithi që pamë në ndarjen e parë të këtij kapitulli "Brutaliteti është fatkeqësi dhe sjellja e mirë është lumturi" tregon disa prej këtyre punëve.

Le të marrim si shembull fushën e realizimit të disa punëve që kanë të bëjnë me këtë botë: Për njeriun është e pamundur të nënshtrojë e të zbusë qëndrimin e njerëzve dhe të fitojë zemrat e tyre, kur ai vepron e sillet ata me ashpërsi e me dhunë.

Gjithashtu për njeriu është e pamundur që ai të jetë në pajtim të plotë me të tjerët në të gjitha punët. Sikur të supozohet se dikush e bindi një njeri me rrugën e ashpërsisë e të pushtetit, derisa zemra e këtij nuk është e kënaqur, njeriu nuk ka siguri se ky i nënshtruar nuk do të tradhtojë. Prandaj vetëm sjellja e butë e dashuria e bëjnë zemrën të nënshtruar. Me nënshtrimin e zemrës nënshtrohen të gjitha fuqitë e jashtme e të brendshme, prandaj fitimi i zemrave është punë më e respektuar dhe më e lartë se nënshtrimi i mbretërive.

Të gjitha shërbimet që sjell miqësia e sakrifica kanë lindur prej fitimit të zemrave, madje me fitimin e zemrave bëhet e mundur edhe fitorja mbi mbretëritë. Të gjitha fitoret islame ndodhën sapo u fituan zemrat për sistemin islam, ndryshe të gjitha përparimet me punën e njeriut, me pajisjet e me numërim, do të ishin të pamundura.

Në tërësi, sjellja e butë e zemërgjerësia, në paraqitjen e qëllimeve, ka ndikim më shumë se çdo veprim tjetër, qoftë për qëllimet që kanë të bëjnë me këtë botë, qoftë për qëllimet që kanë lidhje me Botën Tjetër, qoftë për qëllimet që lidhen me orientimin dhe udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë. Pa sjelljen e butë e pa zemërgjerësinë në çështjet shumë të rëndësishme, nuk realizohet ky qëllim i nderuar.

Allahu i Lartësuar, pasi urdhëroi Musain e Harunin të shkonin te Fir'auni dhe t'i bënin atij thirrje të besonte e ta udhëzonin atë në rrugën e drejtë, nga tërësia e direktivave që i Larti i dha atyre të dyve ishte:

ٱذۡهَبَآ إِلَىٰ فِرۡعَوۡنَ إِنَّهُۥ طَغَىٰ ٤٣ فَقُولَا لَهُۥ قَوۡلٗا لَّيِّنٗا لَّعَلَّهُۥ يَتَذَكَّرُ أَوۡ يَخۡشَىٰ ٤٤

"Idh'hebà ilà fir'aune in'nehù tagà. Fekùlà lehù kaulen lenjinen leal'lehù jetedhek'keru eu jakhshà" "Shkoni të dy te Fir'auni se ai vërtet e ka tepruar në mizori. I flisni atij me fjalë të buta se ndoshta ai mendohet ose do të ketë frikë."[1]

Zemra e ashpër e Fir'aunit dhe egoizmi i tij kishin arritur deri aty sa të pretendojë se është zot, prandaj fitimi i zemrës së tij me sjellje të butë e me zemërgjerësi ishte rruga më e mirë. Ky është shkaku që i Larti i urdhëroi dy profetët: "Shkoni të dy te Fir'auni", shkoni te ky tiran e shtypës dhe flisni me të me butësi e me zemërgjerësi, se ka të ngjarë që fjala e butë i kujton atij Allahun e i kujton frikën për Ditën e Llogaridhënies.

Ky është ligj i përgjithshëm për të gjithë udhëzuesit në rrugën e të Vërtetit, i Cili hap para tyre rrugën e fitimit të zemrave, ashtu siç e lavdëron Allahu i Lartësuar të Dërguarin e Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin

[1] Sure "Ta-Ha", ajetet 43-44.

mbi të e mbi familjen e tij!) në ajetin e nderuar: ''إِنَّكَ لَعَلَى خُلُقٍ عَظِيْمٍ''

"Ine'neke lealà khulukin adhijmin" "...me të vërtetë ti je me një moral shumë të lartë."

Patjetër për një qëllim madhor si ky kërkohet një moral shumë i lartë, ndryshe puna e thirrjes nuk mund të realizohet, domethënë se i pajisuri me moral të lartë ka edhe fuqinë për të rezistuar para të gjitha punëve të mëdha e të lodhshme.

Por sa e vështirë e sa e rëndë ishte dhe është puna e udhëzuesve në rrugën e të Vërtetit në fushën e trajtimit te njerëzve në përgjithësi dhe bashkëjetesës me injorantët e me ata që bëjnë thirrje për marrëzira?

Patjetër që udhëzuesit në rrugën e Allahut duhet të ishin e duhet të jenë të pajisur me moralet më të mira e më të mëdha, gjithashtu fuqia e mirësjelljes, zemërgjerësia, marrëdhëniet e mira dhe bashkëjetesa mes tyre ishte e duhet të jetë deri në cakun që u mundëson udhëzuesve në rrugën e Allahut të rezistonin e të rezistojnë para të gjitha injorancave të injorantëve dhe para të gjithë atyre që s'kishin e s'kanë mendje.

Vuajtjet nga dhimbjet, turbullirat, vështirësitë e jetës dhe sëmundjet nervore, janë në kundërshtim të plotë me punën e nderuar të udhëzimit në rrugën e Allahut të Lartësuar. Gjithashtu edhe ashpërsia, dhuna e nxitimi janë në kundërshtim me detyrën e atyre që udhëzojnë në rrugën e Allahut. Ky kuptim theksohet shumë herë në transmetimet e nderuara.[1]

Në fushën e urdhërimit për punë të mirë dhe ndalimin e punës së keqe, sjellja e butë dhe zemërgjerësia janë prej cilësive më të rëndësishme. Kur njeriu ka qëllim të ndalojë dikë të mos bëjë një mëkat, ose kur sheh dikë që le një detyrim të urdhëruar në ligjin e fesë dhe për këtë përdor gjuhë të ashpër e vepron me dhunë, ka shumë mundësi që puna e këtij udhëzuesi për ndalimin e një mëkati të vogël të përfundojë në një mëkat të madh dhe nga mosplotësimi i një detyrimi të përfundojë në mohim.

[1] Lexo "Usùulul-Kàfij", vëll. 2, f. 95-96.

Urdhërimi e ndalimi për njeriun janë të hidhura e jo të këndshme dhe bëjnë që në të urdhëruarin të vihen në lëvizje zemërimi e fanatizmi. Prandaj ai që urdhëron për punë të mirë e për ndalimin e punës së keqe, patjetër që këtë hidhësi e këtë pakënaqësi ta kthejë në ëmbëlsi me anë të shpjegimit, sjelljes me butësi, me zemërgjerësi e me moral të lartë, pasi vetëm kështu fjala e tij do të jetë ndikuese dhe do të zbusë e do të nënshtrojë zemrën e mëkatarit e të kundërshtuesit.

Në një transmetim të ardhur në librin "El-Khisàl" e autorit, shehut Saduk (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë se Hidri, në fundin e këshillës që i dha Musa bin Imranit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i tha: "Kurrë mos e turpëro ndonjërin për ndonjë faj, sepse te Allahu i Gjithëfuqishëm tri punë janë më të dashura: qëllimi me pasurinë, falja kur është fuqia dhe sjellja e butë me robërit e Allahut. Cilido që është sjellë me butësi ndaj një tjetri në këtë botë, Allahu i Lartësuar do të sillet butë me të në Ditën e Kiametit dhe, kryet e urtësisë është frika ndaj Allahut të Lartësuar."

Në fushën e ushtrimeve të shpirtit dhe ecjes në rrugën e të Vërtetit të Lartësuar, butësia ndaj vetes e zemërgjerësia, gjithashtu, janë prej cilësive shumë të rëndësishme. Ndodh që ashpërsia ndaj vetes, sidomos në fillimin e punës e në veçanti në rini, sjell neverinë për ushtrimet shpirtërore dhe për ecjen në rrugën e të Vërtetit, prandaj ndodh që ata largohen me vrap nga pesha e rëndë e Të Vërtetit.

Shumë të rij, pasi janë marrë për një kohë me punë serioze dhe kanë vazhduar me korrektësi të plotë në punët e lejuara, ndodh që të devijojnë plotësisht dhe të mos e vrasin mendjen për fenë. Në transmetimet e nderuara vihet theksi mbi shumë prej punëve të lartpërmendura.[1] Me dëshirën e Allahut, disa prej këtyre punëve do t'i përmendim në vijim.

[1] "El-Khisàl", vëll. 1, f. 111.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIMI: SJELLJA E BUTË DHE ZEMËRGJËRËISA JANË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE PREJ SHOQËRUESVE TË CILËSË SË PASTËR TË KRIJMIT BRUTALITETI E DHUNA JANË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS E TË IBLIJSIT DHE JANË PREJ SHOQËRUESËVE TË CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Ky kuptim realizohet pasi kemi mësuar se sjellja e butë, zemërgjerësia dhe bashkëveprimi me dashamirësi, janë prej shkëlqimeve të mëshirës gjithëpërfshirëse dhe prej punëve të kësaj mëshire. Një zemër ku shkëlqen mëshira, i sheh të gjithë robërit e Allahut me mëshirë e me dashamirësi. Një zemër e tillë bashkëpunon njerëzit me butësi e me zemërgjeri në të gjitha punët e në çdo etapë. Një zemër e tillë sillet me butësi edhe ndaj krijesave të tjera jo njerëz, siç janë kafshët, si dhe me njerëzit që i ka nën pushtetin e vet, siç janë shërbyesit e robërit dhe në mënyrë të veçantë një zemër e këtillë sillet me butësi ndaj të afërmve e ndaj fqinjëve.

Në përgjithësi, një zemër e këtillë i trajton të gjithë njerëzit e bashkëpunon me ta me butësi, me mëshirë, me simpati e me zemërgjerësi. E njëjta gjë ndodh me këtë zemër edhe në fushën e orientimit e të mësimit të njerëzve dhe në fushën e zbatimit të urdhrit hyjnor, për të urdhëruar punën e mirë e për të ndaluar punën e keqe. Kjo punë e nderuar, në radhë të parë, kërkon që ndaj personave që u bëhet kjo thirrje, patjetër duhet të

mëshirohen e të shikohen me dashamirësi e me simpati. Edhe aty ku gjendet fare pak ndriçim prej dritës së Mëshirës gjithëpërfshirëse, thirrja për punë të mirë e për të ndaluar punën e keqe nuk mund të realizohet me asnjë rrugë tjetër përveçse me rrugën sjelljes së butë e të zemërgjerësisë dhe larg prej ashpërsisë, dhunës e veprimeve të ngjashme.

Tani që u shpjegua kjo parathënie, mësohet se sjellja e butë është prej cilësisë së pastër të brumit me të cilin është krijuar njeriu, u mësua se kjo cilësi është prej shoqëruesve të cilësisë me të cilën Allahut i Lartësuar ka krijuar njeriun. Të gjitha zemrat e familjes njerëzore janë krijuar me mëshirë sipas cilësisë së pastër me të cilën ato janë krijuar dhe, nga ky këndvështrim, e gjithë bota është mëshirë gjithëpërfshirëse. Gjithnjë nga ky këndvështrim, ata që kanë arritur gradën e njohjes kanë thënë: "ekzistenca u bë e dukshme me: "بِسْمِ اللهِ الرَّحْمنِ الرَّحِيْمْ" "bismil'làhi-rr'rrahmàni-rr'rrahijm" "Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!"[1]

Mëshira gjithëpërfshirëse dhe mëshira e plotë është çelësi i ekzistencës. Kjo mëshirë është edhe çelësi i librit të shkruar, kurse zemra e ndotur me zemërim e armiqësi ndaj robërve të Allahut, i trajton e bashkëpunon me ata me dhunë e me brutalitet, i trajton me sjellje që nuk janë prej cilësisë së pastër të krijimit hyjnor. Kjo ndodh sepse zemra është e ndotur jo vetëm me dashurinë për këtë botë e me dashurinë për gjërat e bukura të kësaj bote, por është e ndotur edhe me dashurinë për veten e me kërkesat që ka vetja e njeriut, është e ndotur edhe me admirimin e vetes. Me të gjitha këto ndyrësi zemra është bërë e mbuluar prej origjinës së pastër të krijimit. Por, zemrën e shoqëron edhe dashuria për të Vërtetin e Lartësuar dhe, ashtu siç e mësuam më sipër, kjo dashuri për të Vërtetin është prej cilësisë origjinale të krijimit, domethënë është krijuar me dashurinë për punët e për krijesat, është krijuar e shoqëruar me dashurinë, me sjelljen e butë e me zemërgjerësinë. Për të gjitha këto, sjellja e butë është prej shoqëruesve të cilësisë së pastër të krijimit. E kundërta e kësaj cilësie të pastër të krijimit është mbulimi i saj.

[1] Shehu Muhedin bin Arabij, "El-Futùhàtul-Mek'kijeh".

NDARJA E KATËRT

DISA NJOFTIME TË NDERUARA QË FLASIN PËR KËTË ÇESHTJE DHE SHPJEGIMI I KËTYRE NJOFTIMEVE

Prej Muhamed bin Jakubit (Paqja qoftë mbi të!) me përcjellësit e tij, prej Ebu Xhaferit (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë se ky i fundit ka thënë: "Allahu është i Buti, Ai e do butësinë dhe jep për sjelljen me butësi atë çka nuk e jep për dhunën."[1]

I Vërteti i Lartësuar, në punën e Tij, i trajton me butësi e afrimitet krijesat e Veta në të gjitha punët e tyre, madje deri edhe në vënien e legjislacioneve, sepse udhëzimi në rrugën e lumturisë e të plotësimit është esenca e sjelljes me butësi. Gjithashtu, edhe dënimi i mizorëve dhe zbatimi i dënimeve fizike të ndryshme, përfshirë edhe qortimet, janë plotësimi i sjelljes me butësi dhe i përmirësimit, kurse moszbatimi i dënimit është brutalitet e shkatërrim edhe për atë që e meriton dënimin. Këtë e pamë në hadithin që trajtuam në ndarjen e mëparshme: "Kur sjellja e butë është brutalitet, brutaliteti është sjellje me butësi."

Madje te ata që kanë dituri për qëllimet e larta dhe për parimet, dënimi në Botën Tjetër është sjellje me butësi. Thënia e mësipërme se Allahu i Lartësuar "jep për sjelljen me butësi atë çka nuk e jep për dhunën", dëshmon për këtë çështje, të cilën e kemi shpjeguar në ndarjen e dytë.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 97, Libri "El-Ijmànu uel-Kufru", K. "Err'rrifku", Hadithi 5.

Gjithashtu në një hadith tjetër, të transmetuar në librin "El-Kàfij", përcjellësi tregon se ka dëgjuar Ebu Abdullahun (Paqja qoftë mbi të!) të thotë: "Ai që sillet me butësi në punën e tij, arrin të marrë prej njerëzve atë çka ai dëshiron."[1]

Prej të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi të familjen e tij!) lexojmë: "Në sjelljen e butë ka shtim e begati dhe ai që privohet nga sjellja e butë, ai është privuar nga e mira."[2]

Prej Muhamed bin Jakubit, me përcjellësit e tij, transmeton se Ebu Xhafri (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Allahu, kujt i ka dhënë sjelljen e butë, i ka dhënë edhe besimin."[3]

Prej Ebu Xhaferit (Paqja qoftë mbi të!) lexojmë: "Për çdo send ka një bravë dhe brava e besimit (imanit) është sjellja me butësi."[4]

Këto dy hadithe të nderuara tregojnë që kemi thënë më përpara se sjellja me butësi dhe zemërgjerësia janë prej cilësive shumë të rëndësishme për ushtrimin e vetes dhe rrugëtimin për te Allahu i Lartësuar.

Kur ti sillesh butë ndaj vetes tënde gjen kënaqësi për adhurimet e për bindjet dhe me anë të kësaj dashurie dhe lidhje gjen dashurinë për të Vërtetin e Lartësuar dhe kënaqësi që je pranë Tij. Pikërisht kjo është hapja e portës së diturive hyjnore dhe burimi i besimit.

Kurse dhuna e brutaliteti ka shumë të ngjarë që të bëhen shkak që adhurimi e bindja ndaj urdhrave të Allahut të bëhen veprime të hidhura e të papërshtatshme në kënaqësinë e shpirtit dhe kjo pastaj do të jetë shkak për të larguar zemrën prej të Vërtetit të Lartësuar.

---

1 "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Err'rrifku", Hadithi 16.
2 I njëjti burim, f. 97, Hadithi 7.
3 I njëjti burim, f. 96, Hadithi 2.
4 I njëjti burim, f. 96, Hadithi 1.

Më sipër u tha se "brava" e besimit është sjellja me butësi dhe se kur sjellja me butësi është pjesa që i ka rënë njeriut, pjesë që i takon atij do të jetë edhe besimi.

Prej Muhamed bin Jakubit, prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!), lexojmë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) ka thënë: "Në dy shokë shpërblimin më të madh e më të dashur te Allahu është për atë që ka sjellje më të butë ndaj shokut të vet."[1]

Prej Umer bin Handhaleh, prej Ebu Abdullahut (Paqja qoftë mbi të!) transmetohet: "O Ymer, mos i rëndoni përkrahësit tanë dhe silluni me butësi ndaj atyre, sepse njerëzit nuk mbajnë ato që mbani ju!"[2]

Ky hadith është një ligj i përgjithshëm për të veçantët, sepse njerëzit janë të ndryshëm nga ana e mbajtjes së diturive e të njohurive, gjithashtu, janë të ndryshëm edhe nga ana e mbajtjes së barrës së punëve të zemrës e të punëve shabllone. Nuk është e mundur përhapja e çdo diturie te secili individ, veçanërisht në fushën e njohurive, pasi sekretet e njohurive janë të atilla që patjetër duhet të jenë të mbyllura e të depozituara në ata që kanë arritur gradën e njohjes, kurse paudhësitë, çuarja e të tjerëve në rrugën e paudhësive e në mohim, në një farë mënyrë, janë shpjeguar në këtë kapitull.

Njerëzit, në përgjithësi, edhe ata që kanë dituri për punët e jashtme, bëjnë kujdes shumë të madh ndaj diturive hyjnore dhe ruhen shumë që të mos minimizojnë dituritë e të vërtetat, për të cilat, nga njëra anë, disa prej krerëve të përdorimit të terminologjisë e të etikës, ose ata që kanë dituri në fushën e njohurive të formësuara, janë turpëruar kur kanë shpjeguar qëllimet e nderuara me fjalë jo të mira dhe shpjegimet e tyre kanë dalë jashtë terminologjisë së Kur'anit e të hadithit, megjithëse këto qëllime gjenden në Librin e Allahut e në hadithet e ardhura prej imamëve të udhëzuar në rrugën e drejtë në mënyrën më të plotë.

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Err'rrifku", Hadithi 15.
[2] "Reudatul-Kàfij", vëll. 8, f. 275, Hadithi 522.

Ata i kanë shprehur këto qëllime në një mënyrë jo të kënaqshme, për rrjedhojë janë bërë shkak për neveri në karakteret e atyre që merren me dituritë e dukshme, të cilët nuk kanë mundur të ndajnë esencën prej veshjes, të vërtetën prej formës dhe kuptimin prej fjalës, prandaj janë bërë kundërshtarë të origjinës së kërkesës.

Mbase këtë kuptim e theksojnë transmetimet që flasin për ndarjen e besimit në shtatë pjesë, ose në dhjetë gradë, ose në dyzet e nëntë pjesë dhe kanë thënë: "Atij që ka dy hise, mos i ngarkoni dy hise dhe atij që ka dy hise, mos i ngarkoni një hise të tretë."[1]

Ndryshimi i shkallëve në punët, në fuqinë e në dëshirën, në shumicën e herëve është në kundërshtim me shkallët e besimit. Prandaj në hadithet e nderuara përmendet një shembull për afrimin: "Një burrë kishte komshi një kristian, të cilit i bëri thirrje të pranojë Islamin, duke ia paraqitur të bukur, ashtu siç është i bukur Islami. Kristiani iu përgjigj thirrjes së tij. Në mëngjes burri erdhi e trokiti në portën e shtëpisë së komshiut. Ai e pyeti: "Kusht është?" Burri iu përgjigj se jam filani. Përsëri e pyeti: "Ç'nevojë ke?" Burri i tha: "Merr abdes, vishu dhe eja me ne të shkojmë të falim namaz."

Ai mori abdes, u vesh dhe shkuan së bashku. Falën aq namaz sa kishte dashur Allahu i Lartësuar, pastaj falën namazin e sabahut dhe qëndruan derisa u gdhi. Kur u gdhi, ai që ishte kristian u ngrit të shkonte në shtëpinë e vet, por ai burri i tha: "Ku po shkon? Dita është e shkurtër, deri në mesditë ka mbetur fare pak kohë." Kështu ai qëndroi me atë burrin derisa falën namazin e drekës. Pastaj burri i tha se koha në mes namazit të drekës e namazit të pasdites është fare pak dhe e mbajti derisa falën edhe namazin e pasdites. Pas faljes së namazit, ai u ngrit të shkonte në shtëpinë e vet, por burri i tha: "Tani është fundi i ditës, prandaj në fillim të kësaj kohe të pushojmë."

[1] Prej hadithit të Imam Sadikut(Paqja qoftë mbi të!) . Lexo në librin "Usùlul-Kàfij",, vël. 2, f. 35, Hadithi 1.

Dhe e mbajti derisa falën namazin e mbrëmjes. Pas faljes së namazit, ai desh të largohej për në shtëpinë e vet, por burri i tha: "Ka mbetur vetëm namazi i darkës." Dhe ai qëndroi. Falën namazin e darkës dhe pastaj u ndanë. Të nesërmen në mëngjes burri shkoi e trokiti në portën e komshiut të tij dhe, kur ai pyeti se kush është, ai u përgjigj se ishte filani. Por përsëri e pyeti se ç'nevojë kishte. Burri i tha të merrte abdes, të vishej dhe të shkonin së bashku që të falnin namazin e mëngjesit. Atëherë ai tha: "Kërkoj prej kësaj feje atë që më shkarkon. Jam njeri i varfër dhe kam familje për të mbajtur."

Atëherë Ebù Abdull'llahu (Paqja qoftë mbi të!) tha: "Burri e futi atë në një send dhe ashtu siç e futi e nxori prej atij sendi."[1]

Nëpërmjet këtyre haditheve Imami (Paqja qoftë mbi të!) porosit për sjellje të butë e për zemërgjerësi ndaj robërve të Allahut dhe porosit që njerëzit të mos ngarkohen më shumë nga sa ata kanë fuqi të mbajnë, ndryshe ata do të largohen prej kësaj barre.

Kanë ardhur transmetime të shumta që lavdërojnë sjelljen me butësi dhe e konsiderojnë atë veprim të preferuar. Gjithashtu kanë ardhur edhe shumë transmetime që dënojnë brutalitetin e dhunën dhe i konsiderojnë poshtërsi. Prej transmetimeve të llojit të dytë përmendim transmetimin e ardhur në librin "El-Kàfij", me përcjellës j Bakirul-Ulùmi, - njeriu me dituri të gjëra (me këtë epitet thirrej Ebu Xhafer Muhamed bin Ali Zejnul-abidijn bin Husejn, el Bakir (Paqja qoftë mbi të!): "Atij që i është bërë për pjesë brutaliteti, është i mbuluar prej besimit."[2] "Sikur brutaliteti të ishte njeri, ai do të shihte se Allahu s'ka krijuar ndonjë send më të keq se ai."[3]

[1] "El-Kàfij", vëll. 2, Libri «El-Ijmànu uel-Kufru», K. "Derexhàtul-ijmàni", f. 36-37, Hadithi 2.
[2] I njëjti burim, f. 242, Hadithi 1.
[3] Burimi i mëparshëm, Hadithi 2, f. 242.

QËLLIMI I SHTATËMBËDHJETË

TMERRIMI, E KUNDËRTA, GUXIMI NE KËTË KAPITULL KEMI TRI NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIM: Ç'DO TË THOTË TMERR?

Tmerrimi (në gjuhën arabe-ruhbetun) është në kuptimin e frikësimit, për shembull thuhet: e tmerroi se do t'i nxjerrë syrin. Nëse germa e parë e kësaj fjale "r", do të lexohet me zanoren "e", tregon frikën në shkallën më të lartë. Nga ky kuptim ka lindur fjala *murgëri,* që përmblidhet në kuptimin e largimit prej njerëzve, të heqjes dorë prej kënaqësive të kësaj bote dhe marrjen vetëm me adhurim. Në Islam murgjëria është e ndaluar. Kjo thuhet në hadithin: *"S'ka murgjëri në Islam."*[1]

Fjala *murgjëri,* do të thotë heqje dorë nga qëndrimi në mesin e njerëzve, heqje dorë prej grave dhe ndalimi i fuqive hyjnore, të cilat Allahu i Lartësuar ia ka dhënë njeriut për të punuar. Prandaj murgjëria është injoranca në shkallën më të lartë dhe sjell shkatërrime të shumta.

Frika prej të Vërtetit të Lartësuar është prej ushtrive të mendjes dhe prej përmirësuesve të shpirtrave. E kundërta e kësaj frike është guximi për t'u ngjitur kundër të Vërtetit. Ky guxim është prej ushtrive të injorancës. Në

[1] "Meusùatë atràfil-hadijthi-n'nebevij'ji-sh'sherijf", vëll. 7, f. 249.

këtë kuptim guximi nuk është në përshtatje me *murgjërinë*, madje qëndrimi në vetmi (khalvet) në fjalët e atyre që kanë arritur gradën e njohjes nuk shpreh veçimin e largimin prej njerëzve, edhe nëse qëndrimi në vetmi, në terminologjinë e tyre, disa herë shpreh mosshqetësimin e zemrës me asgjë tjetër, përveçse me të Vërtetin e Lartësuar, ose nga ana e cilësisë, që shqetësimi vetëm me të Vërtetin disa herë nuk mund të arrihet ndryshe veçse me njërën shkallë të veçimit e të heqjes dorë nga përzierja me të tjerët. Por në këtë kuptim, qëndrimi i përkohshëm në vetmi (khalvet) nuk është murgjëri, madje është një kërkesë që anon më shumë nga ana ligjore dhe logjike.

Në tërësi, tmerrimi është prej ushtrive të mendjes, shpreh frikën ndaj të Vërtetit të Lartësuar, nuk është në kundërshtim as me shpresën e as me mëshirën. Prandaj edhe shpresa është prej ushtrive të mendjes. Përballë shpresës qëndron mbajtja e shpresës, të cilën e kemi shpjeguar në kapitujt e mëparshëm.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: SHKALLËT E NDRYSHME TË FRIKËS

Le të mësohet se ndryshimi i shkallëve të frikës, me një përngjasim të përgjithshëm, ka lidhje me ndryshimin e shkallëve të njerëzve e të rrugëtuesve për te Allahu, gjithashtu ka lidhje edhe me shkallët e ndryshimit të diturive.

Shkalla e parë e frikës, është frika prej dënimit e prej ndëshkimit. Kjo është frika e masës së njerëzve dhe në një farë mase, edhe e të frikësuarve. Me këtë shkallë të frikës ka lidhje frika për humbjen e rrobave dhe frika për mosarritjen e kënaqësive të dëshiruara. Kjo shkallë e frikës nuk llogaritet frikë prej Allahut të Lartësuar. Gjithashtu, edhe adhurimi i kryer nën trysninë e kësaj frike, nuk është adhurim i sinqertë. Në hadithet e nderuara, ky adhurim është emërtuar adhurim i robërve e i punëtorëve me mëditje.[1]

Derisa njeriu është rob lufte i vetes së tij e i dëshirave të tij, ai e do veten dhe e admiron veten. Për shkak të kësaj, në tërësi ai ka një ngjyrë të unit, që është ngjyra djallëzore. Prandaj as adhurimi e as bindja e tij nuk është adhurim për Allahun, por as frika e dëshirat e tij s'kanë lidhje me të Vërtetin e Lartësuar. Për rrjedhojë, të gjitha punët e tij, që shihen dhe punët e tij morale, punët e tij të zemrës dhe punët shabllone e punët shpirtërore, të gjitha, kanë ngjyrë vetjake djallëzore.

Shkalla e dytë e frikës, është frika prej dënimit. Kjo kategori e të frikësuarve ka frikë të largohet prej hapësirës së shenjtë të Ndihmuesit. Kanë frikë, sepse bëhen subjekt për dënim e për mungesën e butësisë. Këta e kanë larguar veten prej orientimit kafshëror, prej dëshirave dhe prej natyrës, por kënaqësitë morale gjenden në kënaqësitë e shpirtrave të tyre,

[1] "Vesàilu-sh'Shij'ati", vëll. 1, f. 59-60, K. 9, Hadithet 1-3.

kur ata kërkojnë afrimin te pozita. Derisa kjo kërkesë do të vazhdojë të gjendet, shpirti i kërkuesit nuk do të jetë as i pastër prej ngjyrosjes me unin e as nuk do të jetë pa ngjyrosjen djallëzore. Sikur adhurimet e bindjet të realizoheshin me këtë qëllim, synimi në këtë qëllim nuk është feja e Allahut, e cila patjetër duhet të jetë e pastër prej këtyre gjembave e ferrave. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar: ''أَلاَ لِلَّهِ الدِّينُ الْخَالِصُ'' *"elà lil'làhi-d'dijnul-khàlisu…"* **"Dëgjoni me vëmendje, adhurimi i sinqertë është vetëm ai që bëhet për hir të Allahut…"**[1]

Shkalla e tretë e frikës, është frika më e veçantë e të veçantëve, është frika prej mbulimit. Ata nuk orientohen kah dhëniet, ata i merr malli për praninë dhe kënaqësia e tyre është shkëputja e tyre prej të dyja botëve. Derisa mbetje të unit të vetes e të egoizmit do të vazhdojnë të gjenden te ata dhe ata duan me gjithë shpirt të arrijnë shikimin e praninë është e pamundur që dashuria për Allahun të jetë pjesë e tyre. Sinqeriteti i vërtetë, pa dyshim, është pozita e lartë madhore, të cilën e arrijnë vetëm më të sinqertët e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, kurse dora e dëshirave e të ngjashmëve me ne të mbuluarve është e shkurtër për t'u zgjatur deri te Ai.

Shkalla e katërt e frikës, është frika dashurve të Allahut, të cilët janë të pastër e të pastruar prej ngjyrës së të tanishmes e të egoizmit dhe janë të ngjyrosur me ngjyrën e Allahut. Këtë të vërtetë e lexojmë në ajetin e nderuar: ''وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللهِ صِبْغَةً'' *"…ue men ahsenu mine-ll'llàhi sibgaten…"* **"…dhe kush ngjyros** (me fe) **me mirë se Allahu…"**[2]

Te ata nuk arrin frika, se në zemrat e tyre krejtësisht të pastra, nuk do të arrijnë shkëlqimet e bukurisë e të madhështisë. Le të mësohet se në çdo bukuri e në çdo madhështi ka një madhështi të padukshme. Për këtë shkak, prej shkëlqimit të bukurisë, arrihet të ketë tmerr e frikë. Por kjo frikë prej madhështisë, në të tërësi, ka arritur të tri shkallët, sepse arrihet prej shkëlqimit të punëve, të emrave, të cilësive dhe të vetes. Sqarimi me hollësi e këtyre punëve është jashtë kuadrit të këtyre faqeve. Tmerri i vërtetë e frika

[1] Sure "Ez-Zumer", ajeti 3.
[2] Sure "El-Bekare", ajeti 138.

e vërtetë shprehin këtë shkallë të fundit, në të cilën s'ka vend as për veten e as për egoizmin.

Përballë çdo shkalle të kësaj frike të madhe, qëndron një shkallë e guximit sipas kësaj radhe: kundrejt shkallës së parë të frikës, qëndron guximi për të mëkatuar; përballë shkallës së dytë të frikës, qëndron guximi për të kaluar në shkarjet dhe përballë shkallës së tretë të frikës, qëndron guximi për të hyrë në mbulesën me dashje; kurse përballë shkallës së katërt të frikës, qëndron guximi për admirimin e vetes dhe për marrjen e ngjyrës së vetes djallëzore, si vete, cilësi e punë.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIMI: TMERRI E FRIKA JANË PREJ CILËSIVE TË PASTRA TË KRIJIMIT DHE JANË PREJ USHTRIVE TË ARSYES E TË GJITHËMËSHIRSHMIT GUXIMI ËSHTË PREJ MBULIMIT TË CILËSISË SË KRIJIMIT DHE PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS E TË DJALLIT

Patjetër duhet të dihet se madhërimi dhe tmerrimi prej Madhështorit, janë prej punëve të cilësisë së pastër të krijimit, me të cilën u krijua e gjithë familja njerëzore. Sikur të inspektoheshin të gjitha zemrat, nuk do të gjendej asnjë zemër në kundërshtim me cilësinë e pastër të krijimit, edhe pse ndërmjet zemrave ka ndryshim në burimet e në kriteret. Por në origjinën e kësaj të vërtete, zemrat nuk janë të ndryshme.

Tmerri e frika që arrijnë në zemrat prej të fuqishmëve e prej mbretërve tiranë, edhe kur ka siguri prej dëmit që vjen prej tyre, është rezultat i cilësisë së krijimit për të madhëruar të mëdhenjtë. Prandaj në audiencë të mbretit të drejtë, personat prej të cilëve s'ka dalë asnjë mëkat e asnjë padrejtësi ndihen të vegjël e të frikësuar, madje edhe të tmerruar, kurse ata që kanë arritur madhështinë e mendjemadhësinë e të diturit, përballë kësaj gjendjeje, nga vetë natyra e krijimit, janë të frikësuar,

megjithëse janë të siguruar plotësisht prej dëmit që mund t'i vijë prej të fuqishmit ose prej mbretit. Megjithëkëtë në zemrat tona, në zemrat e ne të mbuluarve s'ka as frikë e as tmerrim prej të Vërtetit të Lartësuar. Kjo "trimëri" vjen, sepse ne nuk e kuptojmë madhështinë e Tij, gjithashtu ky moskuptim, nga ana jonë, vjen për shkak se cilësia e krijimit është e mbuluar me mbulesën e trashë të natyrës dhe nga kjo mbulesë njeriu guxon të ngrihet kundër Ndihmuesit.

Përsa u përket atyre që kanë dalë jashtë mbulimit të natyrës, në zemrat e tyre ka shkëlqyer madhështia e të Vërtetit, zemrat e tyre dridhen prej madhështisë së Madhështorit dhe prej fuqisë së Tij mposhtëse. Ata nuk orientohen drejt ndonjë dobie ose ndonjë dëmi dhe nuk mendojnë as për Xhehenemin e as për Xhenetin.

Ata janë të strukur prej frikës së Allahut dhe ngjyra e fytyrës së tyre zverdhet edhe më shumë kur falin namaz. Dihet se namazi është vendtakimi i prezencës së eulijave dhe miraxhi i afrimit të tyre, megjithëkëtë atyre u dridhen muskujt e gjoksit dhe janë të shkujdesur ndaj vetes së tyre.

Natën e miraxhit, i Dërguari më i nderuar (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* e humbte vetëdijen sa herë që shikonte bukuritë e madhështisë. Atë nuk e bënte që të përmendej asgjë prej shkëlqimeve të njerëzve e prej mëshirës, atje nuk kishte frikë prej asnjë sendi përveç madhështisë, kurse për ndëshkimin ose për dënimin, atje nuk kishte as emër e as formë. Në trupin e tij sunduese ishte cilësia e lartë e dashurisë, me tërë kuptimin e vërtetë të kësaj fjale dhe me tërë kuptimin e vërtetë të cilësisë së krijimit që kanë fjalët tmerr e frikë, pas asnjë ferrë mbulese. Atje urtësia e cilësisë së pastër të krijimit nuk ishte ndryshe nga vendimi i të Vërtetit.

Nisur nga këto që u shpjeguan, duhet të dihet patjetër se guximi në çdo shkallë qoftë, nuk mund të gjendet pa mbulesë në cilësinë e krijimit dhe shndërrimin e frikës prej të Vërtetit të Lartësuar, sipas masës së mbulimit, në frikë e në tmerre të tjera që i mbledh së bashku frika, e cila vjen si

rezultat i shikimit të drejtpërdrejtë të madhështisë e sundimit mbi shkëlqimet, deri në shkallën e fundit që janë shkëlqimet e cilësive.

Fakti që shkëlqimet e cilësive janë shkallët e fundit, është se shkëlqimet autentike janë në pozitën e asgjësimit të tmerrit e të zhdukjes së frikës.

Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

لَهُمُ ٱلۡبُشۡرَىٰ فِي ٱلۡحَيَوٰةِ ٱلدُّنۡيَا وَفِي ٱلۡأٓخِرَةِۚ لَا تَبۡدِيلَ لِكَلِمَٰتِ ٱللَّهِۚ ذَٰلِكَ هُوَ ٱلۡفَوۡزُ ٱلۡعَظِيمُ ٦٤

"Elà in'ne eulijàe-ll'llàhi là khaufun alejhim ue là hum jahzenùne"

"Dëgjoni me vëmendje, për miqtë e Allahut s'ka frikë dhe ata nuk do të jenë të hidhëruar."[1]

Grupi emëror *miqtë e Allahut* (eulijatë) përfshin të gjithë eulijatë, të cilët kanë arritur gradën e asgjësimit të plotë, kanë arritur gjendjen e shkëputjes prej vetes dhe kanë njohur të gjitha shkallët e frikës.

Përsa i përket asaj frike që arrihet në gjendjen e mbulimit, është frikë prej veprimit të vetes e prej veprimit të djallit. Kjo frikë është thelbi i guximit për të kundërshtuar të Vërtetin, sepse frika prej ndonjë tjetri dhe jo frika prej të Vërtetit, nuk është frikë e vërtetë. Nisur nga këtu, frika që kishin profetët e plotësuar dhe euljiatë e mëdhenj pas gjendjes së ndërgjegjësimit, ndryshon shumë prej frikës së të mbuluarve. Dallimi është i qartë mes frikës e dëshirës së tyre dhe mes frikës e dëshirës së të tjerëve.

[1] Sure "Junus", ajeti 62.

QËLLIMI I TETËMBËDHJETË

MODESTIA, E KUNDËRTA, MENDJEMADHËSIA NË KËTË KAPITULL KEMI SHTATË NDARJE

NDARJA E PARË

Ç'DO TË THOTË MODESTI E MENDJEMADHËSI?

Përballë modestisë është vënë mendjemadhësia. Prandaj është e domosdoshme që modestia të numërohet prej cilësive shpirtërore, ashtu si duhet numëruar prej cilësive shpirtërore edhe mendjemadhësia; kurse mburrja është nxjerrja në sheh e mendjemadhësisë, në një kohë që modestia është nxjerrja në shesh e mirënjohjes. Nga ana gjuhësore është vënia në dukje e gjendjes së të voglit.

Në të gjitha gjendjet, njeriu e admiron vetveten dhe e do veten e tij. Por kjo dashuri e tepruar për veten është shkak që ai është mbuluar për të parë të metat e mangësitë e tij dhe, për rrjedhojë, ai nuk sheh punët e tij të këqija. Ka mundësi që punët e tij të këqija ai i sheh si punë të mira, madje virtytet e punët e mira që gjenden te ai, i shikon të shumëfishuara. Me këtë mënyrë shikimi, ka mundësi që ai jo vetëm që është i mbuluar për të parë punët e mira te të tjerët, por edhe punët e këqija të të tjerëve i shikon të shumëfishuara.

Një person i këtillë, mendon se vetë është i plotësuar dhe te të tjerët shikon vetëm mangësi. Në këtë vlerësim atë e ndihmon edhe dashuria e tepruar për veten dhe kështu te ai krijohet gjendja e admirimit të vetes. Pas admirimit të vetes, në brendësi të shpirtit, ai e lartëson veten mbi të tjerët, për rrjedhojë arrihet një gjendje lartësimi e madhështie. Prandaj ai e shikon veten se është më i madhi i njerëzve. Pikërisht kjo gjendje është mendjemadhësi. Kur kjo gjendje e zemrës bëhet e dukshme në cilësitë e trupit, ai bëhet tiran, vetëlartësohet dhe këtë lartësim ua demonstron të tjerëve. Pikërisht kjo është mburrja.

Kur ai del prej kësaj mbulese dhe e sheh veten e tij ashtu siç është në të vërtetë, madje e shikon veten me syrin e gjetjes së të metave dhe ka mendim të keq për veten e tij, i duket vetja i përçmuar, i poshtër. Për rrjedhojë, ai e prek poshtërsinë dhe varfërinë e vetes së tij. Kur një person e shikon veten në këtë mënyrë, ka mendim të mirë për të tjerët dhe e madhëron krijimin e Allahut e dukuritë e bukurisë së të Vërtetit të Lartësuar e shkëlqimin e Tij, atëherë ky person gjen në veten e tij një gjendje poshtërimi e turpi, për rrjedhojë veten e shikon më të vogël se të tjerët. Kjo gjendje është modestia e zemrës. Kur gjurmët e kësaj modestie bëhen të dukshme në cilësitë e turpit, atëherë thuhet se kjo gjendje e këtij njeriu është modesti dhe personi u bë njeri modest.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: SHKALLËT E MODESTISË E TË MBURRJES

Në librin "Dyzet hadithe" kemi shpjeguar shkallët e gradat e mendjemadhësisë dhe prej këtij shpjegimi janë bërë të qarta edhe shkallët e modestisë. Prandaj është veprim i mirë të lexohet libri i lartpërmendur. Megjithëkëtë, këtu ne do të sjellim një përmbledhje të shkurtuar prej këtij libri, me qëllim që të plotësohet përfitimi. Por edhe ndarjet këtu nuk do të jenë si ato që kemi përmendur në librin në fjalë. Mëso se për modestinë ka shkallë dhe se kundrejt modestisë qëndron mburrja në të gjitha shkallët e modestisë:

E para, modestia e miqve të plotësuar të Allahut dhe e profetëve të mëdhenj, të cilët nëpërmjet shkëlqimeve të Vetes, emrave, cilësive e punëve, zemrat e tyre janë të nënshtruara në praninë e të Vërtetit të Lartësuar dhe të dukurive të bukurisë së Vetes së shenjtë e të madhështisë së Saj. Në zemrat e tyre gjendet qëllimi më i lartë i modestisë, gjithashtu ata shikojnë bukurinë e plotësimit hyjnor krijues dhe përuljen e adhurimit. Sa më shumë të jenë të plotësuar këto dy shikime e këto dy vështrime, aq më shumë plotësohen edhe ata në të vërtetën e modestisë. Më i dituri i njerëzve dhe adhuruesi më i madh i robërve të Allahut, Vula e profetëve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ishte më i nënshtruari e më modesti se të gjitha qeniet e tjera në praninë e të Vërtetit të Lartësuar, sepse ai shihte plotësimin e Zotit-Krijues dhe mangësinë e adhurimit, edhe te më i plotësuari i qenieve.

Ky grup njerëzish modestë e të nënshtruar ndaj të Vërtetit të Madhëruar, janë të nënshtruar edhe ndaj dukurive të bukurive të

madhështisë së Tij. Modestia te ata është hija e modestisë dhe e nënshtrimit ndaj të Vërtetit, por te ata duhet shtuar edhe modestia në pozitën e dashurisë. Te ata dashuria për dukuritë e të Vërtetit të Lartësuar është në vazhdën e dashurisë për të Vërtetin e Lartësuar. Kjo modesti, e dyzuar me dashurinë, është grada më e plotësuar e modestisë dhe e nënshtrimit.

E dyta, modestia e atyre që kanë arritur gradën e njohjes. Te ata është e njëjta modesti e i njëjti nënshtrim si i eulijave, por në një shkallë më të pakët se modestia e nënshtrimi i eulijave, sepse pozita e njohjes ndryshon sipas shikimit të prezencës.

E treta, modestia e dijetarëve, të cilët e kanë arritur diturinë në lidhje me Allahun në sajë të dritës së besimit. Gjithashtu, ata e kanë njohur veten e tyre në përputhje me masën e dritës së tyre, prandaj ata janë modestë ndaj të Vërtetit të Lartësuar dhe ndaj njerëzve, ashtu siç porositet për këtë cilësi të veçantë në urtësinë lukmaniane.[1]

Përballë këtyre shkallëve të modestisë qëndron mburrja, e cila bën që personi të shfaqë mendjemadhësi në të gjitha mbulesat. Le të mësohet se ndërmjet modestisë e servilosjes dhe ndërmjet mburrjes e egoizmit, ka dallime të mëdha në parimet, në qëllimet e në rezultatet.

Fillesa e modestisë është dituria për Allahun e dituria për veten dhe qëllimi më i lartë i modestisë është Allahu, ose respektimi i Allahut, kurse rezultati apo fryti i modestisë është plotësimi vetjak. Ndërsa fillesa e servilizmit është idhujtaria e injoranca dhe qëllimi më i lartë i servilizmit është vetvetja, kurse rezultati i servilizmit është mendjelehtësia, poshtërimi, mangësia dhe turpi. Fillesa e mburrjes është admirimi i vetes, dashuria për veten, injoranca, shkujdesja ndaj të Vërtetit e ndaj dukurive të Tij.

---

[1] Theksohet këshilla e Lukmanit për djalin e vet, në fjalën e të Lartit: "وَلاَ تُصَعِّرْ خَدَّكَ لِلنَّاسِ وَلاَ تَمْشِ فِي ٱلأَرْضِ مَرَحاً" *"Ue là tusai'ir khad'deke lin'nàsi ue là temshi fil-erdi merehan…"* **"mos e shtrembëro fytyrën tënde para njerëzve dhe ec nëpër tokë kryelartë…."** (Sure "Lukman", ajeti 18.)

Qëllimi më i lartë i mburrjes është vetvetja, krekosja e mashtrimi, kurse rezultati i mburrjes është rebelimi e tirania. Fillesa e respektimit të vetes është mbështetja te Allahu, është mbështetja te i Vërteti i Lartësuar dhe qëllimi më i lartë i respektimit të vetes është Allahu, kurse rezultati e fryti i respektimit të vetes është heqja dorë prej tjetrit, por jo prej të Vërtetit.

NDARJA E TRETË

ZEMRA E GJERË DHE ZEMRA E NGUSHTË

Mëso se për modestinë e për mburrjen ka faktorë e shkaqe të shumta, që në tërësinë e tyre, përmblidhen në zemrën e gjerë dhe në zemrën e ngushtë.

Një njeri është me zemër të gjerë sa herë që shikon në veten e tij plotësim, bukuri, pasuri, pozitë, pushtet dhe rregullim të gjendjes, por ai nuk interesohet për këto dhe në shikimin e tij këto nuk janë gjëra të mëdha e të rëndësishme.

Gjerësia ekzistenciale në këtë njeri është në atë masë që del mbi të gjitha prurjet e zemrës. Ena e ekzistencës së zemrës, në të cilën gjendet dituria e njohjes së të Vërtetit të Lartësuar, nuk mbushet me asgjë tjetër përveçse me të Lartin. Në lëndët e përshtatshme, të përgatitura për njerëzit, së bashku me njohjen e Allahut, zemra arrin në pozitën e qetësisë e të sigurisë. Edhe përmendja e të Vërtetit të Lartësuar (ziqri) e largon zemrën prej pozitave të natyrës e prej pamjeve të saj, në shikimin e tij rrëzohet poshtë e gjithë bota dhe gjithçka që ka në botë. Zemra e tij nuk lidhet me asgjë tjetër përveçse me të Vërtetin e Lartësuar dhe zemra e tij nuk gëzohet me asnjë send, përveçse me të Vërtetin. Vullneti i tij arrin një gradë, në të cilën ai nuk shikon në botët e ekzistencës, atë nuk e ndalon asgjë prej hyrjeve të zemrës dhe për këtë shkak ai nuk e mendon e nuk e sheh veten të madh e lavdishëm. Çdo gjë tjetër përveç të Vërtetit e gjurmëve të bukurisë e të madhështisë së Tij, në shikimin e tij janë të urryera. Ai vetë është burim i modestisë e i nënshtrimit ndaj të Vërtetit, ai e shikon veten të lidhur me njerëzit, sepse mendon se njerëzit janë prej të Vërtetit.

Gjithashtu, ai do të jetë burim për respektimin e për lavdërimin e vetes, sepse shpirti i servilizmit që ekziston prej kërkesave të arritjes së dobisë, nuk gjendet në zemrën e tij. Kërkimi i të Vërtetit e bën të detyrueshme që zemra e këtij kërkuesi të jetë e gjerë, pasi vetëm në zemrën e gjerë gjendet modestia e respekti ndaj vetes. Kundrejt këtij respekti për veten qëndron dashuria për veten e mahnitja me veten që vjen si pasojë e zemrës së ngushtë. Është dashuria për veten e mahnitja me veten që sjell ngushtimin e zemrës së njeriut.

Në vështrimin e tij ajo gjë është e madhe dhe, si e tillë, tregon meritën e tij, me të cilën ai krenohet, në të njëjtën kohë, kur ai është bërë skllav i vetes së tij. Për të arritur qëllimet që i ka vënë vetes, ai e ul veten e serviloset te ata prej të cilëve lakmon të arrijë atë çka dëshiron.

Fillesa e të gjitha parimeve në plotësimet është njohja e Allahut dhe heqja dorë prej vetes, kurse fillesa e të gjitha mangësive është dashuria për veten e mburrja me veten. Rruga e përmirësimit për të gjitha të këqijat është afrimi te i Vërteti i Lartësuar dhe heqja dorë prej dëshirave vetjake.

Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar:

مَّآ أَصَابَكَ مِنۡ حَسَنَةٖ فَمِنَ ٱللَّهِۖ وَمَآ أَصَابَكَ مِن سَيِّئَةٖ فَمِن نَّفۡسِكَۚ

"Mà esàbeke min hasenetin femine-ll'llàhi ue mà esàbeke min sej'jietin femin nefsike…"

"Çdo e mirë që të vjen, është prej Allahut dhe çdo e keqe që të ndodh, të vjen prej vetes tënde…"[1]

Në një poezie të Meuleviut thuhet: **"Nëna e idhujve është idhulli i vetes tënde."**

Njohja e Allahut vjen nëpërmjet dashurisë për Allahun. Kur kjo dashuri është e plotësuar, njeriu i ndërpret lidhjet me veten e tij dhe shkëputet nga të gjitha botët dhe në veten e tij. Ai nuk dëshiron asgjë,

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 79.

prandaj në të dyja botët ai është i pastër prej ndyrësisë së djallit e prej ndyrësisë së natyrës. Në brendësi të zemrës së tij lind drita e përjetësisë, e brendshmja e tij lëviz në drejtim të së jashtmes së tij, fjala e puna e tij janë ndriçuese, të gjitha fuqitë e të gjitha gjymtyrët e tij janë hyjnore e ndriçuese. Në të njëjtën kohë ai është modest, nuk i serviloset askujt, nuk e hedh syrin e shpresës e të dëshirës së tij në asnjë njeri dhe nuk shikon në ato që kanë në dorë njerëzit. Në anën e kundërt qëndron admirimi i vetes, mendjemadhësia, dashuria për veten.

Të gjitha këto bëjnë që njeriu të shkëputet prej Allahut dhe të bëhet skllav i vetes së tij. Kur njeriu bëhet skllav i vetes, sa herë që shikon diçka që i sjell kënaqësi, zemra e tij menjëherë shkon te ajo gjë, për rrjedhojë njeriu është i nënshtruar e i përulur para banorëve të kësaj bote, si dhe para pasurisë e para pozitës. Syri i lakmisë së tij shikon vetëm ato që janë në duart e të tjerëve dhe në të njëjtën kohë, mburret e krekoset para atyre që janë më poshtë se ai, prej të cilëve ai nuk shpreson asgjë.

NDARJA E KATËRT

KËSHILLË NË KËTË KAPITULL

Mëso se çdo dituri e çdo punë e largon njeriun prej dëshirave vetjake dhe prej cilësive djallëzore. Gjithashtu, dituria e puna pakësojnë te njeriu tiraninë e vetes. Këta dy faktorë të kërkuar janë dituria e dobishme hyjnore dhe puna e mirë.

Nga ana e kundërt, çdo dituri e çdo punë që sjell te njeriu mahnitjen me veten dhe tiraninë, nuk e shërojnë atë prej cilësive vetjake e poshtërsive djallëzore. Prandaj të të vijë turp o njeri për një dituri e për një punë që është prej djallit e prej shpirtit lakmues, sepse një dituri e tillë nuk është as dituri dobisjellëse e as dituri hyjnore, edhe nëse është dituri që ka lidhje me fushën e terminologjisë. Gjithashtu, një punë e tillë nuk është në përshtatje me shpirtin, edhe nëse ajo punë i ka të gjitha kushtet.

Baraspeshimi qëndron në ecjen drejt rrugës së vërtetë, ose në ecjen drejt rrugë së gabuar. Ti tani e di se cilat janë punët që kanë lidhje me veten e me të vërtetën. Gjithashtu ke mësuar se cilat janë shenjat e rezultatet e këtyre punëve. Këtu nuk e kemi fjalën për të gjitha rezultatet e për të gjitha frutat, pasi e veçanta këtu është ajo që ka të bëjë me modestinë e me mburrjen.

Në librin "El-Kàfij", prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet: *"O kërkues i diturisë! Dituria ka virtyte të shumta, por koka e diturisë është modestia dhe syri i saj është pastërtia prej smirës…"*[1]

Njeriu i ditur e punëtor duhet të mendojë për veten e vet, duhet të mendojë për gjendjet që kalon dhe për cilësitë e tij shpirtërore, njëkohësisht

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 83, Libri "Fadlul-ilmi", K. 14, Hadithi 2.

ka detyrë të kontrollojë veten dhe ta mbajë atë nën një inspektim të plotë, që të shohë se ç'kanë lënë trashëgim te ai dituritë e çdo lloji qofshin. Nëse ai është prej dijetarëve, le të shohë nëse drita e njohjes së Allahut e ka ndriçuar zemrën e tij dhe, nëse ai është bërë që të dashurojë të Vërtetin e dukuritë e bukurisë e të madhështisë, apo ai, për shkak të praktikimit të disa termave e shikon dijetarin dhe të gjithë dijetarët me syrin e përçmimit, patjetër është shikimi i Iblijsit. Për rrjedhojë, është bërë i atillë, sa i shikon dijetarët si lëvozhga, madje, në llogarinë e tij, dijetarët nuk hyjnë fare, prandaj ai i shikon njerëzit sikur të ishin kafshë.

Nëse njeriu është i tillë, atëherë le të mësojë se terminologjitë pa bërthamë janë bërë mbulesa që e pengojnë atë të njohë Allahun dhe le të dijë se ato terminologji janë bërë një copë e zezë e vënë para një fytyre të mbuluar që e pengojnë njeriun të shpëtojë prej skllavërimit të vetes e të dalë prej lidhjeve të natyrës, pasi ato e kanë bërë njeriun të mbyllur në burgun e natyrës dhe të lidhur me zinxhirët e djallit. Ky i varfër thërret me zë të lartë prej pozitave të pasionit e të dashurisë dhe i vë në dukje dituritë hyjnore në sytë e njerëzve, por në shpirt ai mban të fshehur idhullin e vetes, mban dashurinë për veten dhe adhurimin e vetes, prandaj ai është i shkujdesur ndaj Allahut të Lartësuar dhe është tiran ndaj atyre që janë me të vërtetë njerëz të të Lartit.

Iblijsi u largua prej pozitës së afrimit për shkak të mburrjes ndaj Ademit dhe, ti o bir i Ademit, me këtë mburrjen tënde ke qëllim të gjesh një rrugë për të shkuar te dituritë. Drita e njohjes së Allahut patjetër duhet ta bëjë zemrën hyjnore dhe ta largojë zemrën prej gjërave të mira të dukshme. Atëherë përse te ty ky rezultat i kundërt?! Përse zemra jote u bë banesë për djallin dhe një fushë e vënë nën sundimin e Iblijsit?! O i mjerë, ti pretendon se je prej njerëzve të Allahut e prej të diturve. Por edhe ky pretendim, gjithashtu, të vjen prej ndotjeve të vetes e të djallit. Këto ndotje kanë bërë që ti të merresh vetëm me veten tënde dhe të anashkalosh Allahun. Iblijsi ka bërë që zemra jote të jetë e gëzuar me konceptet e me fjalët lavdëruese në pozitën e diturisë, derisa ti u bëre të flasësh për ndriçimet e vetes, të emrave e të punëve. Ti vazhdon në pretendimin tënd se e shikon dijetarin që është

prej shkëlqimit të të Vërtetit të Lartësuar, ashtu siç i shikon të gjitha qeniet se janë prej shkëlqimeve të Tij. Por në pozitën e punës, ti bëhesh ortak me djallin, kur mburresh para bijve të Ademit e i dhunon ata me tiraninë tënde. Kjo të vë para detyrimit që të mësosh se ky qëndrimi yt, te ata që janë me të vërtetë dijetarë, është mburrje ndaj të Vërtetit të Lartësuar.

Kurse ti o i mjerë, me veprimin tënd e me mburrjen tënde para njerëzve, në të vërtetë, mburresh edhe ndaj të Vërtetit. Mjerim për ty o i mjerë i vënë në sprovë me disa koncepte. Ti merresh me disa terma dhe po e shpenzon jetën tënde duke u zhytur në pusin e natyrës, ti u largove prej të Vërtetit me anë të diturive e njohurive të vërteta, ti i tradhtove dituritë, tradhtove të vërtetën dhe dituritë e mirëfillta i bëre mjet për punën e djallit. Zgjohu pak prej gjumit dhe mos u gëzo me këto koncepte, mos u mburr me Iblijsin e mallkuar, sepse ai të tërheq drejt shkatërrimit, të largon prej shtëpisë njerëzore dhe të largon prej të Vërtetit të Lartësuar.

Nga sa u tha, rezulton se duhet të dihet gjendja e të gjitha diturive. Nëse ti je dijetar, jurist, ose dijetar në fushën e hadithit e në fushën e komentimit të Kur'anit Famëlartë, shiko me kujdes se ç'këshilla prej këtyre diturive kanë mbetur në zemrën tënde? Shiko se ç'fruta janë në pemën e ekzistencës tënde. Zotëria ynë, Ali bin Ebu Talibi *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kryet e diturisë është modestia."*[1]

Kur në veten tënde do të gjesh modestinë e përuljen, atëherë falëndero Allahun e Lartësuar dhe puno shumë që te ty të shtohet modestia e përulja dhe mos u bëj i pakujdesshëm ndaj mashtrimeve të vetes, sepse vetja jote dhe djalli të kanë vënë prita dhe presin rastin që të largojnë prej rrugës së të Vërtetit. Prandaj kurrë mos u mashtro me plotësimet e vetes dhe mos harro se mashtrimi vjen prej djallit. Gjithmonë të kesh mendim të keq për veten tënde dhe bëj kujdes dhe të jesh i frikësuar prej përfundimit të keq. Kur të shikosh se këto dituri kanë sjellë te ty admirimin e dashurinë për veten, atëherë mëso se je bërë një kafshatë për Iblijsin dhe je larguar prej rrugës së lumturisë. Pastaj shiko ç'ka mbetur në dorën tënde nga

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 38, Libri "Fadlul-ilmi", K. 14, Hadithi 2.

esencialja prej termave boshe. A ke mundësi të përgjigjesh për engjëjt e ashpër e të fuqishëm të Allahut? A ke mundësi të mashtrosh Allahun, të Diturin me atë grimcën e vogël që duket në rrezen e diellit që hyn nga plasaritja e derës dhe me ato format e me kuptimet e devijuara e me të tjera të ngjashme si këto?

Sikur të supozojmë se në këtë botë nuk do të zbulohen punët e fshehta dhe se është e mundur që njerëzit mposhten e të mashtrohen me përkëdhelje e duke u mburrur dhe, se në këtë botë, gjithashtu është e mundur që njerëzit të trajtohen me përçmim, duke i bërë ata të pafuqishëm, vallë a është e mundur që në varr, në Ditën e Gjykimit dhe a mund të kalohet mbi urën e Siratit me këto këmbë prej druri?

Dituria e Kur'anit Famëlartë dhe dituria e hadithit të nderuar patjetër duhet të përmirësojnë gjendjen tënde, patjetër këto dy dituri duhet të fusin te ty moralet e të dashurve të Allahut, ndryshe pas pesëdhjetë vjetësh që ke marrë dituritë fetare, shumë shpejt do të kesh cilësitë e djallit.

I dashur, kur dituritë hyjnore e fetare nuk na udhëzojnë ne në rrugën e të Vërtetit e në rrugën e së drejtës, kurrë nuk është edukuar as e brendshmja e as e jashtmja jonë, prandaj edhe puna më e përçmuar është më e mirë se e brendshmja dhe e jashtmja jonë, sepse rezultatet e punëve të kësaj bote vijnë shumë shpejt dhe të këqijat e punëve në këtë botë janë më të pakta. Por kur dituritë fetare bëhen kapital për të populluar botën, kjo është tregti me fenë. Dije se pesha dhe e keqja e kësaj është më e madhe se e çdo gjëje tjetër.

Në të vërtetë, njeriu me zemër të ngushtë mahnitet me disa terma që japin fryte djallëzore dhe veten e konsideron se është më i miri, madje më i virtytshmi i të gjithë robërve të Allahut dhe, për rrjedhojë, shtyp e tiranizon krijesat e Allahut dhe mburret para tyre. Në këtë gjendje, ai e mendon veten se është dijetar i madh dhe të tjerët janë injorantë pa asnjë vlerë.

Sa është masa e injorancës për të cilën ka nevojë njeriu që të pretendojë se ai, me anë të këtyre koncepteve boshe, ka arritur pozitën e

atyre që kanë dituri për Allahun dhe për engjëjt që i kanë shtrirë flatrat e veta nën këmbët e Madhështorit? Mirëpo krahas këtyre shkëlqimeve, parashikohet madhërim e respekt prej robërve të Allahut. Atyre u ngushtohet rruga në vendkalimet, ngushtohen edhe vendet kur ulen në kuvende. E gjitha kjo është mendjemadhësi pa shkak, është injorancë djallëzore, është trashëgimi e Iblijsit dhe errësirë mbi errësirë.

Padyshim që dituria është dritë, dituria e ndriçon dhe e zgjeron zemrën, dituria e bën zemrën të hapur, ndriçon rrugën e udhëzimit dhe rrugën për të ecur për te i Vërteti. Atëherë përse dolën në mesin tonë këto dituri formale, që janë errësira, ngushtim i zemrës, lajka e mburrje? A është e mundur që këto fjalë ne t'i konsiderojmë dituri dhe me to të krenohemi në këtë botë?

I dashur, çohu prej gjumit tënd të rëndë dhe trajtoi e mjekoi këto sëmundje të ndryshme me Kur'anin e me hadithin. Kapu në litarin e fortë të Allahut dhe qëndro në radhën e miqve të Allahut. I Dërguari i *Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!),* këto dy mirësi të mëdha i ka lënë për ne që të shpëtojmë prej errësirave të natyrës, duke u përmbajtur me Kur'anin e me hadithin, pasi vetëm kështu shpëtojmë prej prangave të natyrës dhe pajisemi me cilësitë e me sjelljet e profetëve e të miqve të Allahut.

Atëherë sa është kujdesi ynë që na largon prej diturive të profetëve e prej diturive të miqve të Allahut, na largon prej partisë së mendjes e na afron te djalli e te partia e injorancës? Kur do të mendojmë për përmirësim? Ti je bërë kërkues i diturisë, e kapërceve cakun e kërkuesit dhe u bëre dijetar, u ule të bisedosh për argumentet në fushën e jurisprudencës, të filozofisë, të hadithit e të diturive të tjera si këto që u thanë, porse ti kurrë nuk mendon që të përmirësosh veten tënde. Kur do të hedhësh hapin në rrugën e Allahut? Mos vallë jeta e kësaj bote të afroi ty me botën e tokës dhe të largoi prej Allahut e prej Botës së Ardhshme? Mos vallë jeta e kësaj bote shtoi në zemrën tënde lidhjen me këtë botë e me natyrën? Këtë të vërtetë e lexojmë në ajetin e nderuar:

۞أَلَمۡ يَأۡنِ لِلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ أَن تَخۡشَعَ قُلُوبُهُمۡ لِذِكۡرِ ٱللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ ٱلۡحَقِّ

"elem je'ni lil'ledhijne àmenù en takhshe'ë kulùbuhum lidhikri-l'làhi ue mà nezele minel-hak'ki…"

"A nuk është koha për ata që besuan, që zemrat e tyre të zbuten me përmendjen e Allahut dhe me atë që ka zbritur prej të vërtetës (Kur'anit)**…"**[1]

Kjo është gjendja e dijetarëve, kurse gjendja e atyre që punojnë, gjendja e atyre që mjaftohen me pak, gjendja e atyre që mjaftohen me pak dhe e adhuruesve, mbetet detyrë e domosdoshme të mbajnë nën kontroll të rreptë gjendjen e tyre dhe pastaj të shohin se ç'gjurmë kanë lënë në ata pesëdhjetë vjet adhurim e përmbajtje. A i ka afruar ata namazi që kanë falur gjatë pesëdhjetë vjetëve te moralet e profetëve *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* dhe te moralet e miqve të Allahut e te moralet e të dashurve të Allahut? A kanë futur këto vite adhurimi modestinë e nënshtrimin e cilësi të tjera të lavdëruara, të ngjashme me këto, apo namazi që ata kanë falur gjatë pesëdhjetë vjetëve, ka bërë që te ata të zërë vend admirimi i vetes, mendjemadhësia dhe lajkatimi e mburrja para robërve të Allahut?

Apo me këtë mendjemadhësi arrijnë deri aty sa të kërkojnë prej tyre respekt e nderim? Nëse është kështu, le të mësojnë se djalli ka vepruar në brendinë e tyre dhe se punët e tyre janë punë djallëzore e punë të vetes së tyre. Prandaj le të dinë se të tilla punë i largojnë ata prej lumturisë e prej lidhjes me Allahun dhe i afrojnë me djallin e me ushtritë e Iblijsit.

Namazi që është miraxhi i besimtarit dhe afruesi i të devotshmëve, patjetër duhet të ndalojë zemrën nga lidhjet me këtë botë, të zgjidhë prej zemrës prangat e natyrës dhe ta bëjë zemrën hyjnore.

Sexhdeja me krye në tokë për pesëdhjetë vjet patjetër duhet të bëjë që te njeriu të ekzistojë shpirti i modestisë e i nënshtrimit, kur në atë mjedis nuk ka vepruar djalli.

[1] Sure "El-Hadid", ajeti 16.

Një namaz që vjen me këto mungesa, është në dorën e djallit, është gatim i ardhur prej Iblijsit dhe nuk është brumë hyjnor. Një gatim i tillë, jo vetëm që nuk i heq sëmundjet e zemrës, por i shton të gjitha sëmundjet e dhimbjet e brendshme, përveç kësaj, e afron zemrën te partia e djallit dhe e injorancës. Mjerim i madh për atë që fal namaz dhe pretendon se me namazin e falur gjatë pesëdhjetë viteve kishte qëllim afrimin, madje në fillim të namazit të tij thoshte:

وَجَّهْتُ وَجْهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ *"...vexhehtu vexh'hij lil'ledhij fetare-s'semàvàti uel-erdi..."* **"...e kam kthyer fytyrën time drejt Atij që krijoi qiejt e tokën..."**[1] dhe me zemër në dorë thotë: ''إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِيْنُ''

"Ij'jàke naëbudu ue ij'jàke nesteijnu"

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë."[2]

Pas këtyre pretendimeve, çdo ditë ai largohet me etapa prej pozitës së afrimit te Allahu. Ai bëhet i braktisur prej miraxhit të afrimit dhe i afrohet Iblijsit e pozitës së tij e partisë së djallit. Në kompensim të fryteve të afrimit te i Vërtetit i Lartësuar dhe largimit prej shtëpisë së mashtrimit, te ai dalin në shesh frytet e mashtrimeve djallëzore, admirimi i vetes dhe mendjemadhësia që janë trashëgimi prej Iblijsit. Prandaj: *"A nuk ka ardhur koha...."* që në vazhdën e përmirësimit të vetes të hedhim hapa drejt mjekimit të sëmundjeve të vetes sonë?

Ne e humbën kapitalin, humbëm moshën e rinisë sonë pa asnjë kompensim. Me mendjemadhësinë e vetes e të djallit lamë të na dalë prej duarsh mosha e rinisë, me të cilën patjetër duhet të përgatitet lumturia për në të dyja shtëpitë, në këtë botë e në Botën Tjetër. Deri tani nuk kemi hyrë në brazdën e përmirësimit dhe vazhdojmë në shkujdesjen tonë, derisa të na dalë prej dore i gjithë kapitali i jetës sonë dhe të kalojmë prej kësaj bote me humbje të plotë, me të gjitha vështirësitë e me të gjitha të këqijat.

[1] Sure "En-Am", ajeti 79.
[2] Sure "El-Fatiha", ajeti 5.

Ditët e moshës së rinisë janë ditët me më shumë përparësi për të përmirësuar veten, sepse në këto ditë vullneti është më i fuqishëm. Gjithashtu, në këtë moshë edhe turbullirat shpirtërore dhe errësirat e shpirtit janë më të pakta. Në këtë moshë ne, njerëzit, jemi shumë më afër cilësisë së pastër të krijimit dhe akoma nuk jemi ngarkuar me barrën e rëndë të mëkateve. Për rrjedhojë, në moshën e rinisë nuk është punë e vështirë drejtimi e përmirësimi i fajeve e i gabimeve.

O të rinj, shfrytëzojeni moshën e rinisë dhe mos lejoni që kjo mirësi e madhe t'ju dalë prej dore për shkak të shkujdesjes suaj, sepse përmirësimi i vetes në ditën e pleqërisë është punë shumë e vështirë.

Në moshën e mesme njeriu ka shumë probleme që nuk ekzistonin në moshën e rinisë, por djalli dhe vetja lakmuese e mashtrojnë njeriun. Në këtë moshë, të dy këta armiq, e pengojnë njeriun që ai të fillojë përmirësimin dhe këtë punë ata e vazhdojnë, derisa njeriu të sprovohet me fishkjen nga pleqëria e të bëhet i pafuqishëm, ndërkaq mëkatet janë grumbulluar stivë-stivë njëri mbi tjetrin.

Gjithashtu, në këtë moshë edhe turbullirat shpirtërore janë të shumta. Më pas njeriu i kalon ditët e jetës së tij me zvarritje e me vonesa, derisa të konsumojë bazën e kapitalit të tij, për pasojë do të kthehet në shtëpinë e shpagimit me zhgënjime, pa ndihmë, i braktisur e me humbje të madhe. Këtë të vërtetë e lexojmë në ajetin e nderuar:

"وَالْعَصْرِ إِنَّ ٱلْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ" *"Uel-asri. In'nel-insàne lefij khusrin"*

"Betohem në kohën. Padyshim që njeriu është në një humbje të sigurt."[1] domethënë, njeriu është në humbjen më të madhe, sepse kapitalin me të cilin ai mund të siguronte lumturinë e përjetshme, e shkëmbeu me mjerimin e përjetshëm. Ato që kishte në jetën e tij për të siguruar shpëtimin, i shkëmbeu me shkatërrimin e me asgjësimin e vetes dhe deri në fundin e jetës së tij nuk u zgjua nga dehja e nga shkujdesja ku e futi veten.

[1] Sure "El-Asr", ajetet 1-2.

NDARJA E PESTË

DISA HADITHE TË NDERUARA QË FLASIN PËR KËTË ÇËSHTJE

Në librin "El-Kàfij", prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Ndër të tjera, Allahu i Lartësuar i shpalli Daudit (Paqja qoftë mbi të!): "O Daud, ashtu siç janë modestë njerëzit më të afërm te Allahu, po kështu njerëzit më larg Allahut janë mendjemëdhenjtë."*[1]

Ky hadith i nderuar është i mjaftueshëm për njerëzit e ndërgjegjshëm dhe për dijetarët. Afrimi te i Vërteti i Lartësuar është burimi i të gjitha lumturive, kurse largimi prej mjedisit të shenjtë është shkaku i të gjithë vështirësive. Ata që e duan Allahun dhe e kërkojnë Atë, janë prej atyre që e llogarisin veten prej ushtrisë së Allahut dhe prej dijetarëve. Megjithëkëtë, të gjithë ata që kryejnë ritualet dhe adhurimet, me qëllim afrimin te i Vërteti i Lartësuar, kanë detyrë të verifikojnë vetveten e ta mbajnë nën një kontroll të plotë, pasi rezultati i kërkuar arrihet vetëm në sajë të modestisë dhe qëndrimit sa më lag mendjemadhësisë. Në këtë çast, ne nuk i drejtohemi atyre që e kërkojnë diturinë dhe punën për këtë botë, sepse llogarinë atyre do t'ua bëjë Allahu i Lartësuar, por ne u drejtohemi atyre që pretendojnë se e duan Allahun dhe punojnë për t'u afruar te Ai.

Prandaj tani, bazuar mbi hadithin e sipërpërmendur, u themi këtyre pretenduesve se kanë detyrë të marrin në llogari vetveten dhe pastaj ky hadith le të jetë për ata një gurë prove, me të cilin të provojnë shpirtin e tyre lakmues dhe kur të shikojnë se në zemrat e tyre ka mendjemadhësi, ose në punën e tyre ka mburrje, le ta dinë se punët e tyre dhe dituritë e tyre nuk

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Et'tevàdu'u", Hadithi 11.

janë për Allahun, por janë për shpirtin e tyre lakmues. Sikur puna e dituritë e tyre të ishin për afrimin te Allahu i Lartësuar, ata patjetër që do të cilësoheshin për modesti, e cila e afron njeriun pranë Allahut të Lartësuar më shumë se çdo gjë tjetër.

Në librin "El-Kàfij", lexojmë se Isa bin Merjem *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"O apostuj! Kam një nevojë, dua të ma plotësoni!"* Apostujt thanë: *"U krye nevoja jote o shpirt prej Allahut!"* Atëherë ai u ngrit dhe u lau këmbët apostujve. Ata menjëherë thanë: *"Për këtë punë ne kemi më shumë detyrim o shpirt prej Allahut!"* Ai tha: *"Ai që ka më shumë detyrim ndaj njerëzve, është dijetari. Në të vërtetë, unë u tregova modest me këtë veprim, që ju pas meje të tregoheni modestë ndaj njerëzve. Modestia juaj ndaj njerëzve të jetë si modestia ime ndaj jush."* Pastaj Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Me modestinë gjallërohet urtësia dhe jo me mburrjen, ashtu siç rriten bimët e mbjella në fushë dhe jo në mal."*[1]

Gjendjet e burrave të mëdhenj, prej miqve të Allahut dhe e profetëve që përmenden në Kur'anin Famëlartë dhe në hadithet e nderuara, nuk janë për të shpjeguar historinë, por janë që njerëzit të plotësohen. Prandaj patjetër duhet të mbahen parasysh gjendjet e të mëdhenjve të botës, sidomos gjendjet e më të mëdhenjve dhe të gjithë të pajisen me cilësitë e tyre të nderuara e me moralet e tyre të mira. Dijetarët, në përgjithësi dhe krerët e dijetarëve në veçanti, kanë detyrim që ky hadith i nderuar të jetë sa më shumë në qendër të interesimit të tyre dhe kushtetutën fetare-morale ta marrin prej atyre që e njohin Allahun e Lartësuar dhe prej mësuesve të fesë.

Dijetarët le të marrin për vete mësim prej jetëshkrimit të të mëdhenjve, prej jetëshkrimit të nxënësve të të mëdhenjve dhe prej jetëshkrimit të atyre që vijnë pas këtyre të fundit. Gjithashtu, dijetarët kanë detyrë të pajisen me moralet e tyre të larta e të mëdha dhe të mendojnë rreth fjalëve që tha Isai, Mesihu *(Paqja qoftë mbi të!).* Patjetër ai mendoi se kishte nevojë për këtë punë, pasi me këtë punë ai demonstronte përuljen e modestinë më të thellë.

[1] "Usulul-Kàfij", vëll. 1, Libri: Fadlul-ilmi", K. "Sifetul-ulemài", Hadithi 6.

Fjala e Isait *(Paqja qoftë mbi të!): "Ai që ka më shumë detyrim ndaj njerëzve, është dijetari.", t*regon qartë se modestia është fryt i njohjes së Allahut dhe fryt i njohjes së vetvetes. Prandaj ky fryt patjetër duhet të jetë i dallueshëm te dijetarët.

Dijetari, prej të cilit mungon modestia dhe pret prej njerëzve nënshtrim e modesti, nuk është dijetar. Gjithashtu, edhe dituritë e konceptet që ai ka grumbulluar, janë ndyrësira të djallit. Sikur këto dituri e koncepte të çonin drejt lumturisë e shpëtimit, atëherë Iblijsi, me siguri, do të ishte i lumturuar. Dijetari që e ka humbur cilësinë e tij të veçantë të modestisë, është bërë një mbulesë e trashë dhe shpëtimi prej kësaj mbulese është prej punëve më të vështira. Ajo që tha Isai *(Paqja qoftë mbi të!): "Me modestinë gjallërohet urtësia.",* tregon se, kur në një zemër s'ka modesti, në atë zemër nuk mund të mbijnë e nuk mund të rriten farërat e urtësisë, ashtu siç nuk rriten bimët e mbjella veçse në një tokë fushë, kurse farërat e hedhura në gur nuk mund të mbijnë; ose me këtë shprehje kishte qëllim të tregonte se, derisa te dijetarët nuk ekziston modestia, ata s'kanë mundësi të mbjellin farërat e urtësisë në zemrat e njerëzve dhe t'i orientojnë ata. Modestia e zbut zemrën e ashpër dhe pastaj në atë zemër të zbutur dijetarët mund të mbjellin farërat dhe të arrijnë rezultatin. Të dyja këto mundësi janë të drejta, sepse te modestia qëndron përmirësimi i vetvetes dhe përmirësimi i tjetrit.

Ata që kanë marrë përsipër orientimin e njerëzve dhe e kanë bërë të njohur veten e tyre si udhëzues në rrugën e lumturisë, patjetër duhet t'i bëjnë thirrje njerëzve që të pajisen me këtë cilësi të vyer dhe të lexojnë jetëshkrimin e profetëve e të miqve të Allahut, që të shikojnë se si vepruan ata të mëdhenj me krijesat e Allahut. Duke lexuar jetëshkrimin e tyre, dijetari do të mësojë se, pavarësisht nga pozitat e nderuara që ata kishin, i zbutën zemrat e njerëzve dhe i nënshtruan ato zemra me moralet e tyre të larta. Derisa drita, pastërtia, dashuria e modestia nuk do të gjenden në zemrën e dijetarit e të orientuesit, ai kurrë nuk do të ketë mundësi të orientojë e të mësojë njerëzit, kurrë nuk do të ketë mundësi të mbjellë farërat e diturive e të urtësisë në zemrat e tyre.

Në librin "El-Kàfij", prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kërkojeni diturinë dhe stolisuni me diturinë me butësinë e me seriozitetin. Të jini modestë ndaj personit që i mësoni diturinë, të jini modestë edhe ndaj personit prej të cilit kërkoni dituri dhe të mos jini dijetarë prepotentë, ndryshe e gabuara juaj do të bëjë që prej jush të largohet e drejta juaj."*[1]

Por e drejta e dijetarit bëhet pa vlerë edhe me moralet e këqija e me cilësitë e ulëta. Kur dijetari është prepotent e mendjemadh, me këto vese të ulëta ai e bën pa asnjë vlerë cilësinë e veçantë të diturisë së tij. Kjo është tradhtia më e madhe për diturinë. Gjithashtu, prepotenca e mendjemadhësia i largon njerëzit prej të Vërtetit e prej të vërtetës.

Kur dijetari nuk punon me detyrën e dijetarit, domethënë, kur dijetari nuk vepron me moralet e mira, atëherë në sytë e njerëzve bie poshtë feja dhe dituria, besimi i tyre lëkundet, zemrat e njerëzve largohen si prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes së Allahut, ashtu edhe prej dijetarëve që nuk e kanë arritur gradën e njohjes së Allahut. Janë të pakta gjërat që mund të kenë ndikim më të madh se këto që u thanë më sipër.

Një moral i keq prej një dijetari, ose një punë kundërvajtje prej një dijetari, ndikon në degjenerimin e moraleve të njerëzve e të punëve të tyre aq shumë, sa nuk mund të gjendet një shembull i dytë. Prandaj mbetet detyrë për dijetarët që vazhdimisht të kontrollojnë veten, pasi ata kanë marrë përsipër t'i bëjnë njerëzit të lumtur, duke shtuar këtu edhe lumturinë e tyre personale. Degjenerimi i dijetarëve dhe punët e këqija, të dala prej dijetarëve, janë krejtësisht ndryshe nga degjenerimi e nga punët e këqija të të tjerëve. Dhe, për këtë, argumenti kundër dijetarëve është në formën më të plotësuar.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 1, Libri "Fadlul-ilmi", K. "Sifetul-ilemài", Hadithi 1.

NDARJA E GJASHTË

DISA HADITHE TË NDERUARA QË FLASIN PËR MENDJEMADHËSINË

Në librin "El-Kàfij", prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Mendjemëdhenjtë janë bërë në format e milingonave, që i shkelin njerëzit me këmbë, derisa Allahu ata t'i shkarkojë prej llogaridhënies."*[1]

Forma e padukshme e mendjemadhësisë është si forma e milingonës së pafuqishme. Ka mundësi që kjo formë, të ndikojë në ndarjen kohore të Ditës së Kiametit. Shkaku do të jetë se shpirti i mendjemadhit është i vogël dhe, dihet se mendjemadhësia vjen nga cilësia e shpirtit të pafuqishëm dhe nga zemra e ngushtë, në kuptimin se mendjemadhësia dhe e brendshmja e mendjemadhësisë janë të vogla e pa rëndësi, sepse forma e panjohur është e varur prej cilësive shpirtërore. Trupi është hija e shpirtit në botën e cilësive, por nuk i kundërvihet, sepse është i varur prej tij. Atëherë njeriu, shumë shpejt do të shohë sa i vogël e sa i përçmuar është shpirti në trupin dhe ky shpirt bën që trupi të marrë formën e kafshës së pafuqishme, që shtypet nën këmbët e njerëzve. Kjo do të vazhdojë, derisa njerëzit të mbarojnë punën e llogaridhënies.

Supozohet se kjo formë e padukshme e cilësive është e kundërta e cilësive të punëve në etapat kohore të botës së tokës, në të cilën njeriu e konsideron veten të madh, në një kohë kur i Vërteti e ka bërë atë të vogël, të përçmuar *"...ashtu siç bën, ashtu do të bëhet edhe me ty."*

Në librin madhor "El-Kàfij", prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Në Xhehenem ka një luginë për mendjemëdhenjtë, që quhet Sekar, e cila u*

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 235, K. "Elkibru", Hadithi 11.

ankua te Allahu i Gjithëfuqishëm për nxehtësinë e madhe dhe iu lut Atij që të merrte frymë. Ajo morri frymë dhe dogji të gjithë Xhehenemin."[1]

I dashur, sikur një njeri të besojë në këto hadithe, patjetër do të interesohej shumë më tepër se ne të tjerët për mjekimin e vetes. Ai vend për të cilin flet hadithi i nderuar është vendi i ndëshkimit dhe, kur ankohet zjarri i tejndezur prej nxehtësisë së madhe që i vuri zjarrin gjithë Xhehenemit, si do të jetë ajo nxehtësi për veten e tij? Si do të kemi mundësi ne të durojmë atë ndëshkim? Si do ta shpëtojmë veten tonë prej atij ndëshkimi, prej të cilit ankohet Xhehenemi dhe kjo për shkak të disa pak ditëve tiranie e mendjemadhësie kundër robërve të Allahut, ose për shkak të asaj mburrjeje që njeriu tregonte në punën e adhurimit e të bindjes ndaj të Vërtetit? Mjerim i madh për gjendjen tonë, për shkujdesjen tonë e për dehjen tonë! Siguri e mëshirë, siguri e mëshirë prej kësaj shkujdesjeje e prej gjumit tonë të rëndë!

O Zot i madh! Ne jemi robër të pafuqishëm, jemi të mjerë! Në dorë s'kemi asnjë send, përveç afrimit te Ti, s'kemi asnjë vendstrehim tjetër! A dëshiron të na ndëshkosh me këtë Zjarr? O Zoti ynë! Ti e di dobësinë tonë! Ti e di sa të mjerë jemi, ti e di sa e hollë është lëkura e mishi ynë, si do t'ia bëjmë ne në këtë ndëshkim?

O Zoti ynë, robërit Tuaj janë prej Teje, ata janë të lidhur me Ty! Të gjithë janë robërit Tuaj dhe ti je Zoti i tyre, prandaj trajtoi ata me madhërinë Tënde dhe mos i trajto me punët e tyre të këqija! Zoti ynë! Ti na krijove, Ti na dhurove mirësi që s'mbarojnë e s'kanë fund, pa kërkuar ndonjë shërbim paraprak! Të gjitha mirësitë e Tua janë që në fillim dhe nuk na i dhe se ne i meritojmë! Zoti ynë! Ti e përshkrove veten Tënde me cilësinë e mëshirës dhe me mëshirën gjithëpërfshirëse! Ne të njohim Ty për bujarinë e mëshirën! Ti ke thënë në librin Tënd Famëlartë: "إِنَّ اللَّهَ يَغْفِرُ الذُّنُوبَ جَمِيْعاً" *"…in'ne-ll'llàhe jagfiru-dh'dhunùbe xhemij'an…"* **"…Allahu i fal të gjitha mëkatet…"**[2]

[1] Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-Kibru", Hadithi 10.
[2] Sure "Ez-zumer", ajeti 53.

Prandaj ne i drejtohemi mëshirave të Tua. Ne jemi të dëshpëruar nga vetja jonë e prej punëve tona! Ç'na mbetet të bëjmë, që në sajë të punës ne të arrijmë afrimin pranë Teje?

Zoti ynë, ndëshkimi e dënimi ynë nuk shtojnë asgjë në madhështinë e në madhërinë Tënde! Butësia e mëshira për robërit e Tu nuk sjellin asnjë pakësim në gjerësinë e mëshirës Tënde! Ti je i përshkruar me bamirësinë dhe zakoni Yt është bujaria. Ne të kundërshtuam, ngaqë ishim injorantë e të paturpshëm dhe arritën deri aty sa të luftuam Ty dhe ngritëm krye kundër një të buti si Ti. Porse mëshira jote nuk ka lidhje me mëkatet e të krijuarit, ose me bindjen e tij ndaj Teje.

Zoti ynë! Na trajto me mirësinë Tënde e me mëshirën Tënde dhe mos na dëno me punët tona të këqija e me moralet tona të ulëta! Ti dhe vetëm Ti je më i mëshirshmi i mëshiruesve!

Në librin e nderuar "El-Kàfij", prej Ebu Abdullahut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë thënien e Ebu Xhaferit *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Pushteti është rroba e sipërme e Allahut dhe madhështia është rroba e poshtme e Tij. Cilido që merr sado pak prej këtyre dy cilësive, do të flaket në zjarrin e Xhehenemit me fytyrë përmbysur."*[1]

Prej Ebu Xhaferit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe prej Ebu Abdullahut *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nuk hyn në Xhenet ai që në zemrën e tij ka edhe një grimcë mendjemadhësie."*[2]

Në librin "Ikàbul-A'màl", prej Ebu Xhaferit *(Paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Mendjemadhësia është mjeti hipës, që çon në zjarr."*[3]

Gjithnjë prej tij, me përcjellësit e tij, lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Shumica e atyre që do të jenë në Xhehen'nem, janë mendjemëdhenjtë."*[1]

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Elkibru", Hadithi 3.
[2] "Usùlul-Kàfij", i njëjti kapitull, Hadithi 6.
[3] Sheh Es'sadùk, "Ikàbul-A'màl", Hadithi.7; "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 15, K. 58 prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi", Hadithi 14.

NDARJA E SHTATË

SHPJEGIMI: MODESTIA ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE PREJ SHOQËRUESVE TË CILËSISË SË PASTËR TË KRIJIMITMENDJEMADHËSIA ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS DHE PREJ SHOQËRUESVE TË CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Prej cilësive të natyrës së krijimit, me të cilat janë krijuar të gjithë individët e familjes njerëzore dhe asnjëri prej tyre s'ka mundësi t'i kundërshtojë, janë: modestia, nënshtrimi dhe madhërimi i çdo të madhi e madhështori.

Kur zemra e njeriut arrin të kuptojë madhështinë e ndonjërit, njeriu menjëherë e madhëron atë në sajë të cilësisë së krijimit të vet, pa menduar fare dhe kur është para një të madhi, ai e ul kokën dhe tregohet modest e i nënshtruar para tij. Kjo gjendje nuk i ndodh vetëm kur është para të madhit, por edhe kur është para atyre që kanë lidhje me të madhin.

---

[1] "Ikàbul-A'màl", Hadithi 9 dhe "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 15, K. 58, prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi", Hadithi 16.

Cilësia e krijimit është e nënshtruar ndaj të Madhit absolut, ndaj Madhorit në kuptimin e me të vërtetën e fjalës nënshtrim ndaj Madhorit, prandaj atij nuk i del përpara asnjë mbulesë e asnjë mendim i pjekur në natyrë e në dispozitat e natyrës. Madhërimi i tij e modestia e tij janë të përveçme për të Vërtetin e Lartësuar, sepse Ai është i Madhi absolut dhe çdo madhështi, çdo gjë e madhe, çdo mbretërim e çdo bukuri, janë hije të madhështisë, të madhërisë, të mbretërimit e të bukurisë së Tij. Njeriu, nën shtytjen e cilësisë origjinale të krijimit të tij, të pambuluar me dispozitat e natyrës, nga vetvetja është i nënshtruar para të Vërtetit të Lartësuar, është i nënshtruar edhe para dukurive të bukurisë e të mbretërimit të Tij kur ndeshet me to. Për njerëzit, nënshtrimi është esenca e modestisë ndaj të Vërtetit të Lartësuar dhe dora e veprimit të vetes e dora e Iblijsit është e shkurtër të veprojë në modestinë, e cila është baza e cilësisë së pastër origjinale të krijimit. Kjo cilësi është e pastër nga dashuria për veten, dëshirat dhe pritjen e dobisë.

Individi me këtë cilësi krijimi të pa mbuluar, në kohën që është modest ndaj të gjitha krijesave, nuk i nënshtrohet askujt përveç të Vërtetit të Lartësuar, fytyra e zemrës së tij nuk është e orientuar drejt asnjë sendi përveç Vetes së shenjtë të të Vërtetit të Lartësuar. Ky nënshtrim kaq i shumtë është vetë besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhid), kurse orientimi kah njerëzit nuk është esenca e orientimit te i Vërteti i Lartësuar, pasi ky moral e kjo cilësi janë prej burimit të diturisë, kurse dashuria, në vetvete, është esenca e njohjes së Allahut dhe esenca e dashurisë për Atë.

Një individ me këtë cilësi të pastër origjinale të krijimit, nuk i seviloset asnjërit prej krijesave, sepse fillimi i servilosjes është dashuria për veten dhe mbulimit prej të Vërtetit të Lartësuar. Tani u bë e qartë se modestia ndaj Allahut e ndaj njerëzve është prej shoqëruesve të cilësisë së pastër të krijimit. Nga këtu mësohet se mburrja e servilosja, janë prej cilësisë së mbuluar të krijimit, sepse njeriu, kur është i mbuluar me mbulesat shpirtërore, zotërues në të është admirimi e dashuria për veten. Pikërisht këtu është edhe fillimi kur njeriu i njeh vetvetes plotësime të shumta. Në të

vërtetë, me këtë njohje, ka lënë pas dore fillesën e plotësimeve. Sikur ky njeri të mos kishte dëshira materiale te të tjerët, patjetër që do t'i urrente ata.

Sikur te njerëzit të mos ishte kjo dëshirë, që i çon ata të mburren ndaj atyre që janë poshtë tij dhe të lajkatojë banorët e kësaj bote, që janë objekt i dëshirave të tij, nuk do të ishte bërë kjo cilësi e krijimit, që është mjeti hipës për të shkuar te Allahu i Lartësuar, pasi, me këtë cilësi, njeriu është i nënshtruar para të Vërtetit të Lartësuar e ndaj krijesave të Tij. Por për shkak se kjo cilësi është e mbuluar, ajo është bërë mjeti hipës për të shkuar te djalli e te natyra dhe gjithnjë, për shkak të mbulimit të kësaj cilësie, ai mburret para njerëzve dhe herë-herë i serviloset atyre.

QËLLIMI I NËNTËMBËDHJETË

MATURIA, E KUNDËRTA E SAJ, NXITIMI NË KËTË KAPITULL KEMI TRI NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI: MATURIA E NXITIMI JANË PREJ CILËSIVE TË JASHTME E TË BRENDSHME

Nga ana gjuhësore, fjala *maturi* në gjuhën arabe "تَؤُدَّةٌ" *"teud'detun",* është në kuptimin e përforcimit e të kapjes pas diçkaje dhe tregon kryerjen e punës me maturi dhe se ka siguri në lëvizje.[1]

Kurse nxitimi është e kundërta e punës që kryhet me maturi. Prandaj maturia është prej cilësive shpirtërore dhe gjurmët e kësaj cilësie nga jashtë janë siguria e lëvizjes me hap të vendosur.

Maturia arrihet, gjithashtu edhe nëpërmjet opinioneve e besimeve dhe prej këtu arrihet maturia te punët e te fjalët. Gjithashtu, edhe nxitimi e veprimi me shpejtësi rrjedhin prej zemrës në drejtimin për nga jashtë.

Veçori e ushtrive të mendjes nuk janë vetëm cilësitë e brendshme, ashtu siç del e qartë nga ekzaminimi në hadithin e nderuar. Madje kjo del e qartë në shembullin e jashtëm e të brendshëm, në të parat e në të fundit. Të gjitha punët e mira, në mënyrë të barabartë, janë prej ushtrive të mendjes,

[1] Fjalori "Lisànul-arab", vëll. 15, f. 191 dhe "Mexhmaul-Bahrejn", vëll. 3, f. 153.

qofshin të brendshme apo të jashtme, kurse të gjitha punët e këqija janë prej ushtrive të injorancës, qofshin të dukshme apo të brendshme.

Lidhja e së dukshmes me të brendshmen, ashtu siç pohohet në "Elhikmetul-muteàlijetu", nuk është lidhje e të diferencuarit me të diferencuarin, por është lidhje e plotësimit me mangësinë, është lidhje e njëshit në shumicën dhe e shumicës në njëshin[1] madje shpreh të dukshmen e të brendshmen. Kjo është shprehja më e mirë. Në të vërtetë, moral shpirtëror do të thotë dalja në dukje e të vërtetave dhe e sekreteve shpirtërore të brendshme, ashtu siç janë edhe punët e dukshme dalje në dukje të cilësive e të moraleve shpirtërore, si dhe lidhja e fuqishme mes pozitave shpirtërore dhe unitetit të këtyre pozitave. Të gjitha dispozitat e të brendshmes lëvizin në drejtimin për të qenë të dukshme dhe të dukshmet për të qenë të brendshme.

Nisur nga këtu, ligji i pastër i fesë i ka kushtuar një kujdes shumë të madh ruajtjes së të dukshmes dhe formës, madje ka vënë dispozita deri edhe mënyrën e qëndrimit ulur, qëndrimit më këmbë, ecjes dhe mënyrës së të folurit, sepse të gjitha punët e dukshme lënë te njeriu e në shpirtin e tij depozitime, me anën e të cilave shpirti arrin ndryshime rrënjësore. Kur njeriu nxiton në ecjen e tij, nxitimi do të zërë vend edhe në shpirtin e tij. Kështu qëndron çështja edhe me punët e mira të dukshme, të bëra me seriozitet, me qetësi e me siguri, qoftë kur kryhen si obligim, qoftë kur kryhen për hipokrizi. Gjithsesi, gradualisht në brendësi të shpirtit hyn cilësia e mënyra e kryerjes së punës së nderuar, domethënë në brendësi të shpirtit hyn siguria e qëndrueshmëria që janë fillimi i shumë punëve të mira e i shumë plotësimeve.

[1] "El-Esfârul-Erbeah", vëll. 1, f. 68.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: QËLLIMI ME MATURINË E NXITIMIN

Është shumë i qartë qëllimi me maturinë në hadithin e nderuar që thotë: "Vënia e maturisë kundrejt nxitimit." Nga ky këndvështrim, maturia shpreh rrugën e mesme në fuqinë e zemërimit dhe vënien e një kufiri në tejkalimin e nxitimit, ashtu siç kanë thënë disa dijetarë të mëdhenj, të cilët qetësinë e kanë numëruar prej degëve të trimërisë.[1]

Gjithashtu, qëllimi me maturinë mund të jetë qëndrueshmëria, e cila është prej gjendjeve të frenimit të fuqisë së zemërimit, që edhe kjo cilësi është prej degëve të trimërisë. Gjithashtu shpreh përmbajtjen e vetes në gjendje të rënduar, shpreh edhe durimin para ngjarjeve të ndryshme që ndodhin në botë. Prandaj ti o njeri, as mos u largo prej sheshit me nxitim, as mos e anashkalo e as mos u mbështet me shpejtësi në atë që është më e thjeshta e më e lehta. Kjo cilësi është më e përgjithshmja e ndodhive morale e shpirtërore, si dhe e ndodhive natyrore e trupore.

Kur shpirti është i vendosur, ai nuk del jashtë mbështjelljes së vet, sepse nuk është në përshtatje me të dhe, kundrejt papërshtatshmërisë, qëndron vendosmëria e qëndrueshmëria për të përballuar gjërat e papërshtatshme, pasi prej qëndrueshmërisë e sigurisë së shpirtit nuk do të pakësohet asgjë.

Me siguri, ajeti i nderuar: "فَاسْتَقِمْ كَمَآ أُمِرْتَ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ" *"Festekim kemà umirte ue men tàbe meake…" "…qëndro me vendosmëri ashtu siç je urdhëruar ti (o*

[1] Sadrul Metuelihijne Esh'shujràzij, "*Sherhu Usùlul-Kàfij*", vëll. 1, f. 447.

Muhamed) dhe bashkë me ty edhe ata që u penduan…"[1], tregon pozitën e këtij shpirti për të qëndruar me vendosmëri dhe shpjegon se arritja e një shpirti të tillë në shoqëri, detyrimisht është prej punëve më të rëndësishme, por në të njëjtën kohë është edhe prej punëve më të vështira.

Në një transmetim të ardhur prej të Dërguarit më të nderuar *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Mua më dolën thinjat prej sures "Hud" për shkak të urdhrit: "Qëndro me vendosmëri ashtu siç je urdhëruar."*[2]

Ky ajet i nderuar ka ardhur edhe në suren "Es-Shura", por veçimi i këtij ajeti në suren "Hud" është për shkak se i Larti në këtë ajet të sures "Hud", shton edhe frazën: **"dhe bashkë me ty edhe ata që u penduan…".** Kjo frazë nuk gjendet në ajetin e sures "Esh-shura". Ajeti i përmendur në suren "Hud" tregon se çështja e qëndrimit me vendosmëri në punët e umetit është punë shumë e vështirë dhe me probleme të shumta.

Në përgjithësi, vendosmëria e qëndrueshmëria në punë sjell qëndrueshmëri edhe në betejat luftarake, sepse njeriu i largohet punëve që nuk i përshtaten, i largohet edhe punëve të rënda, ngaqë ato janë të papërshtatshme për njeriun. Por njeriu nuk le asgjë mangët për të mbrojtur ligjet hyjnore, ashtu siç nuk le gjë mangët në punët shpirtërore jo të përshtatshme dhe nuk e humb sigurinë e vendosmërinë e vetes.

E kundërta ndodh në nxitimin që është njëra prej cilësive jo të mira. Për shkak të nxitimit, njeriu nuk stabilizohet dot në një punë të caktuar, ose i bën punët personale dhe për shkak të nxitimit, nuk e zotëron dot veten as në ngjarjet shpirtërore e as në gjendjet e rënduara trupore. Me këtë moral të keq arrin që edhe në qytetin e virtyteve të bëjë shumë punë të këqija individuale e shoqërore.

Njeriu, me shpirtin e nxitimit, ka shumë mundësi të humbë veten edhe në ndodhi të vogla. Gjithashtu, nga nxitimi njeriu mbyll sytë edhe para

[1] Sure "Hud", ajeti 112.
[2] Et'Tabrasij, "Mexhmaul-Bejàn", vëll. 5, f. 304.

detyrave hyjnore e shpirtërore. Për shkak të nxitimit, shpeshherë te njeriu bëhet sunduese fryma djallëzore, që e largon atë prej rrugës së të Vërtetit. Madje, në gjendje nxitimi, njeriu arrin deri aty sa edhe besimin e le në dorën e kësaj fryme djallëzore. Për rrjedhojë, humb thirrjet e fesë së tij, humb medh'hebin që ndjek, humb edhe nderin e vet.

Siguria e vetes dhe vendosmëria për të qëndruar fuqishëm, janë dy elemente që e ruajnë njeriun në përleshjen e tij me partinë e djallit dhe bëjnë që ai të triumfojë mbi ushtritë e injorancës e të djallit.

Siguria e vetes dhe vendosmëria për qëndresë janë dy faktorë që e bëjnë njeriun të fuqishëm të mposhtë fuqinë e zemërimit dhe fuqinë e dëshirave, gjithashtu këta dy faktorë bëjnë që njeriu të mos dorëzohet para sulmit të fuqisë së zemërimit e fuqisë së dëshirave, por bën që të gjitha fuqitë e tij të brendshme e të jashtme, të jenë në bindje të shpirtit. Në këtë rast, siguria e vetes dhe vendosmëria për qëndresë e bëjnë njeriun të jetë si një ndërtesë e lidhur mirë përballë ndodhive të dhimbshme, përballë trysnive shpirtërore e trupore dhe e ndalojnë njeriun që të bjerë në shkarje e në plogështi.

Ruajtja e fuqisë së besimit dhe e fuqisë së fesë, krahas sigurisë së vetes e qetësisë shpirtërore është një punë që kalon me lehtësi në kujtesën e njeriut në përballjen e tij me furtunat.

Siguria e vetes dhe vendosmëria për qëndresë ndalojnë edhe ndikimin e moraleve të huaja e karakteret e hipokritëve, bëjnë të mundur që njeriu të mos bëhet lodër në dorën e ndodhive.

Njeriu, me sigurinë e vetes e me vendosmërinë për të qenë i qëndrueshëm, është një fe më vete. Po e sqarojmë këtë mendim: Sikur të supozohet se rryma e furishme e moraleve të këqija dhe e moraleve jo fetare, të përfshinte të gjithë njerëzit, me siguri njeriu do të qëndronte përballë kësaj rryme të fuqishme si një mal madhështor, pa pësuar asnjë lloj egërsie në veten e tij e pa u ndier i vetmuar.

Me vendosmërinë e me sigurinë në veten e tij, njeriu ka mundësi të kryejë të gjitha detyrat individuale e shoqërore dhe të mos bëjë as shkarje e as gabime në asnjërën prej fazave të jetesës materiale ose shpirtërore.

Burrat e mëdhenj të fesë, në sajë të mirësisë së kësaj fuqie shpirtërore madhore, qëndruan para fytyrës së milionave injorantëve me moral të keq dhe kurrë nuk u shkoi në mendje të bëjnë ndonjë devijim. Ky shpirt i madh ishte te profetët e mëdhenj, kur ata, të vetëm, u ngritën përballë ideve të injorancës në të gjithë botën. Ata u ngritën fuqishëm, nuk u frikësuan, nuk u egërsuan e nuk qëndruan në vetmi, por qëndruan në mesin e kundërshtarëve, i mposhtën të gjitha idetë e mendimet e ndryshme jo logjike dhe me qëndrueshmërinë, me vendosmërinë e me sigurinë në veten e tyre, bënë hi e pluhur zakonet e njerëzve e të gjitha moralet e tyre të këqija, derisa mbartësit e atyre zakoneve e moraleve morën fenë e profetëve *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!).*

Ky shpirt i vendosur, krahas sigurisë te vetja, mundëson që edhe një grup i vogël të përballet me grupe të shumta dhe të triumfojë deri mbi mbretëritë e mëdha, pavarësisht se janë të vegjël si numër dhe kanë shumë pak pajisje.

Allahu i Lartësuar e ka theksuar fuqinë e sigurisë te vetja dhe vendosmërinë për qëndrueshmëri, madje këtyre dy faktorëve Ai i kushton një rëndësi shumë të madhe. Këtë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

إِن يَكُن مِّنكُمْ عِشْرُونَ صَٰبِرُونَ يَغْلِبُواْ مِاْئَتَيْنِۚ *"…in jekun minkum ishrùne sàbirùne jaglibù mietejni…"* **"...nëse prej jush janë njëzet të durueshëm** (trima të vendosur), **ata do të triumfojnë mbi dyqind…"**[1] Në fakt, është ashtu siç thotë i Larti.

[1] Sure "El-Enfal", ajeti 65.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIMI: MATURIA E QËNDRUESHMËRIA JANË PREJ CILËSISË SË PASTËR TË KRIJIMIT DHE JANË PREJ USHTRIVE TË ARSYES NXITIMI, SHPEJTËSIA, PAVENDOSMËRIA E PAQËNDRUESHMËRIA JANË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS E TË IBLIJSIT DHE JANË PREJ CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Më përpara kemi thënë se njeriu, sipas cilësisë së parë me të cilën e ka krijuar Allahu, është i atillë që dashuron plotësimin absolut dhe ka neveri prej mangësisë, por, kur orientohet kah mangësia, ai gjen një dashuri që nuk është për plotësimin absolut, gjen një dashuri që është prej mbulimit të cilësisë së krijimit. Prandaj orientimi kah vetja e tij, dashuria për veten dhe varësia ndaj kësaj dashurie janë prej dëshirave e qëllimeve kafshërore, janë ndjesi fallce prej djallit të brendshëm dhe prej djallit të madh të jashtëm. Të gjitha këto janë në kundërshtim me cilësinë e parë, me të cilën ai është krijuar.

Padyshim që shpejtësia, nxitimi, pavendosmëria e qëndrueshmëria vijnë prej frikës nëse do të arrijë nevojat vetjake dhe kënaqësitë e dëshirave kafshërore, ose prej frikës së humbjes së qëllimeve kafshërore.

Në një zemër ku rrezaton drita e Njëtimit të Allahut (teuhidi) dhe e njohjes së plotësimit absolut, ka siguri, vendosmëri, maturi e qëndrueshmëri. Zemra e ndriçuar me njohjen e të Vërtetit të Lartësuar i sheh kanalet e rrjedhjes së punëve në sajë të fuqisë së të Lartit, sheh edhe veten, sheh madhështinë e saj e lëvizjen e saj, sheh edhe kur ajo është në qetësi, sheh se të gjitha qeniet që gjenden në brendësi të saj, të gjitha janë prej Tij. Një zemër e tillë, e ndriçuar me ndritën e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, nuk shikon që frerët e punëve të qenieve të jenë në dorën e vetë qenieve. Në një zemër të tillë s'ka tronditje, s'ka nxitim e paqëndrueshmëri. E kundërta e zemrës së ndriçuar me njohjen e të Vërtetit të Lartësuar, është puna me zemrën e mbuluar prej njohjes, pasi zemra e mbuluar ka hyrë në mbulesën e admirimit të vetes, në mbulesën e dëshirave e të kënaqësive kafshërore. Kjo zemër ka frikë se këto kënaqësi nuk do t'i ketë, për rrjedhojë, individi me një zemër të tillë ka humbur sigurinë e zemrës. Prandaj edhe punët i bën me shpejtësi e me nxitim.

Ata që kanë arritur gradën e njohjes, thonë: "Lutja është në tri kategori:

E para, lutja për të pasur sa më shpjet dhe kjo është lutja e njerëzve të zakonshëm, të cilët janë skllevër të qëllimeve vetjake, prandaj nxitojnë të luten që të mos i humbin qëllimet e kësaj bote dhe qëllimet kafshërore.

E dyta, lutja nisur prej mundësisë. Kjo është lutja e krerëve të dijetarëve, të cilët gjithashtu janë të kushtëzuar me qëllimet e veta dhe mendojnë se lutja hyn në çështjet e gjykimit dhe se gjykimi i të Vërtetit të Lartësuar është i kushtëzuar me lutjen dhe, duke u nisur nga kjo anë, ata luten.

E treta, lutja nisur prej nënshtrimit e përuljes. Kjo është lutja e atyre që kanë arritur gradën e njohjes, atyre që kanë dalë prej skllavërisë së vetes dhe që kurrë nuk e hapin gojën të luten për shpresat vetjake e për

kënaqësitë që vijnë prej atyre shpresave. Këtë e lexojmë në vargjet e një poezie të Xhelaludim El-Meuleviut:

Unë njoh një grup eulijash,

Gjuhët e tyre i kanë të lidhura që të luten."[1]

Ata i luten Allahut, të nënshtruar e të përulur. Luten ngaqë e konsiderojnë lutjen qëndrim në vetmi me Allahun e Lartësuar dhe bashkëbisedim me të Dashurin absolut.[2]

Sikur njeriu të jetë me të vërtetë njeri, padyshim që e ka zemrën të ndriçuar me dritën e njohjes. Ai nuk do të ishte si skllav e i lidhur me vargonjtë e dëshirave në burgun e natyrës. Një njeri i tillë, kurrë nuk do ta bënte bashkëbisedimin me të Vërtetin e Lartësuar dhe orientimin për te Ai, si dhe përmendjen e Tij mjet për ndonjë punë tjetër.

Miqtë e Allahut e shikojnë lutjen si ndalim te i Vërteti i Lartësuar. Ata nuk e bëjnë bisedimin konfidencional me Allahun dhe qëndrimin në vetmi me Atë mjet për adhurimin e vetes e dashurisë për veten. Në të kundërt, ajo që ata kërkojnë me lutjen, është që lutja të jetë mjet për hapjen e portës së bashkëbisedimit në vetmi me të Dashurin.

Me ç'mjet patjetër duhet të hapet në zemrën e të dashurit një rrugë?[3]

Ne jemi skllevër të vetes e të dëshirave. Ne synojmë Allahun për frutat e kësaj bote dhe i bëjmë fli kënaqësitë shpirtërore të afrimit pranë të Dashurit absolut dhe ky qëndrimi ynë, padyshim është prej gabimeve më të mëdha. Sikur në zemrat tona të kishte një pjesë prej njohjes dhe në ato të kishte një shkëlqim prej dashurisë, padyshim që do të vdisnim prej turpit,

[1] Përmbajtja e vargjeve të një poezie të Xhelaudin El-Meuleviut, Fletorja 3. Në origjinal poezia është në gjuhën perse.
[2] El-Kajsarij, ."Sherhu Fusùs el-hikemi", f. 99.
[3] Përmbajtja e shkurtër e një poezie prej divanit "Neshàt" të El-Esfehànij'jit, f. 96. Poezia në origjinal është në gjuhën perse.

prandaj nga ky turp ne jemi kokulur deri Ditën e Kiametit. Njerëz të tillë, kur kërkojnë një send, në të vërtetë, e kërkojnë si një dhënie prej të Dashurit.

Vështro në të dashuruarin e vërtetë dhe në të tërhequrin absolut, Ali bin Ebu Talibin dhe lexo se ç'thotë në "Duanë Kumjl": *"O Zoti im, o Zotëria im, o Ndihmësi im e Zoti im, më dhuro të bëj durim në ndëshkimin Tënd! Por si do të duroj unë ndarjen prej Teje? Më dhuro mua, o Zoti im, të duroj nxehtësinë e zjarrit Tënd! Por si do të duroj, kur shikoj në bujarinë Tënde?"*

Ky i dashuruar i vërtetë ka frikë prej ndarjes, prandaj kërkon afrimin:

Fillimet e fyellit unë i dëgjoj si tregojnë

Rrëfenjat e dashurisë prej ndarjes ai ankohet

Derisa thotë:

Kushdo që vonohet prej origjinës së tij,

Ai kërkon ditën e bashkimin me Atë.[1]

Hapja e këtij libri madhor, me gjuhën e cilësisë së pastër të krijimit, i shikon mirësitë hyjnore si shtëpia e bujarisë së të Vërtetit të Lartësuar.

Shiko Ali bin Ebu Talibin *(Paqja qoftë mbi të!)* të parin e vargut të dashuruarve në Allahun. Ai nuk e kërkon Xhenetin për Xhenetin, por e kërkon se Xheneti është shtëpia e bujarisë së Allahut. Kurse ne të mjerët, çdo gjë që kërkojmë, e kërkojmë për veten tonë, i lutemi Allahut për veten tonë. Të dashuruarit me bukurinë e përjetshme, çdo gjë që kërkojnë, e kërkojnë për të Dashurin, e kërkojnë Xhenetin ngaqë e konsiderojnë shtëpi të bujarisë dhe jo si vendi ku ka për të ngrënë e për të pirë si kafshët.

Ne "kafshët" i kërkojmë kullotat e Xhenetit, edhe sikur në Xhenet për ne të mos ketë më shumë se kjo pozitë, kurse ata e kërkojnë Xhenetin

[1] Përmbajtja e një poezie të Xhelaludin El-Meuleviut në gjuhën perse.

dhe çdo gjë ka në Xhenet vetëm për të Dashurin. Çdo gjë ata e bëjnë mjet për të arritur te Ai, për të njohur Atë dhe për të përfunduar pranë Tij.

O Zoti ynë, na shpëto prej kësaj shkujdesjeje, na shpëto prej dashurisë për veten dhe çliroi zemrat tona prej skllavërisë së dëshirave dhe të zhytjes në kënaqësitë! O Zot, mbulesa e dashurisë për veten dhe e admirimit të vetes na kanë penguar të arrijmë pranë madhërisë Tënde! Largoi zemrat tona prej të dashurit në përgjithësi dhe me fuqinë Tënde ngrije këtë perde.

QËLLIMI I NJËZETË

MENÇURIA, E KUNDËRTA, MENDJELEHTËSIA NË KËTË KAPITULL KEMI SHTATË NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI: Ç'DO TË THOTË MENÇURI DHE MENDJELEHTËSI?

Mençuria është prej degëve të mbajtjes së fuqisë së zemërimit në vijë të drejtë dhe shpreh cilësinë e sigurisë shpirtërore, domethënë që fuqia e zemërimit nuk vlon me shpejtësi dhe pa justifikim, edhe kur ndodh diçka që është në kundërshtim me prirjen shpirtërore të kësaj fuqie, ose kur ndeshet me një punë të urryer, ose me një punë apo me një urdhër jo të përshtatshëm.

Gjithsesi, fuqia e zemërimit, edhe në këto gjendje, nuk del prej rrethit të vet dhe frerët e fuqisë së zemërimit nuk dalin nga dora.

Përballë mençurisë qëndron mendjelehtësia, e cila si fjalë, nga ana gjuhësore, në gjuhën arabe shpreh pamundësinë për mbajtjen e barrës. Fjala

mendjelehtësi, në gjuhën arabe "سَفِهَ" *"sefihe"* është në kuptimin e pakujdesisë e të peshës së lehtë.[1]

Përballë pakujdesisë e mendjelehtësisë qëndron qetësia e durimi dhe janë pikërisht këto dy cilësi që e nxjerrin shpirtin prej mbështjelljes së tij dhe e bëjnë që të adaptohet edhe me punët jo të përshtatshme; por në rrugën e injorancës frerët e mendjelehtësisë nuk janë të lëshuar pa kufi, domethënë se zemërimi te njeriu nuk vlon deri në atë gradë sa njeriu të mos e zotërojë veten.

Në fakt, mendjelehtësia është prej degëve të fuqisë së zemërimit dhe në origjinën e fjalës shpreh mendjen e lehtë dhe injorancën, gjithashtu tregon personin që s'ka mundësi të ruajë fuqinë e zemërimit, pasi një njeri i tillë është injorant dhe mendjelehtë.

Për të gjitha këto, mendjelehtësia është e kundërta e mençurisë dhe në esencë mendjelehtësia është e kundërta e mençurisë, pavarësisht se ky shpjegim mund të jetë në kundërshtim me të jashtmen e thënieve të gjuhëtarëve. Por është në përputhje të plotë me konsideratat dhe me bazën e gjuhës. Në të gjitha gjendjet, trajtimi gjuhësor i kësaj fjale s'ka lidhje me qëllimin tonë dhe analiza e kësaj çështjeje është jashtë detyrës së këtyre faqeve, duke shtuar se është një çështja pa shumë rëndësi.

[1] Ez'zubejdij, . "Tàxhul-Arùs", vëll. 9, f. 390.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: FRUTET E FUQISË SË ZEMËRIMIT

Mëso se fuqia e zemërimit, kur edukohet nën veprimin e mendjes e të ligjit është prej mirësive hyjnore më të mëdha dhe është ndihma më e madhe në rrugën e lumturisë. Në sajë të fuqisë së zemërimit ruhet sistemi i botës, ruhet individi e shoqëria. Gjithashtu, fuqia e zemërimit ka një ndikim të madh në formimin e qytetarisë së virtytshme. Njeriu e kafsha ruajnë veten e llojin e vet me këtë fuqi të nderuar. Në sajë të kësaj fuqie të nderuar sprapsen sendet që s'janë në përshtatje me natyrën e tyre dhe kështu e shpëtojmë veten prej asgjësimit e zhdukjes.

Sikur kjo fuqi të mos ishte te njeriu, patjetër që njeriu do të ishte i vonuar në shumë prej plotësimeve e përparimeve dhe kurrë nuk do të kishte mundësi të ruante institucionin e familjes e nuk do të mbronte dot qytetarinë e virtytshme.

Filozofët e dijetarët kanë shpjeguar detyrat e daljen prej cakut të mangësisë në fuqinë e zemërimit, ashtu siç kanë shpjeguar edhe minimizimin në këtë fuqi. Ata vinin në radhë të parë vlimin e kësaj fuqie në punët e jashtëzakonshme dhe ashtu siç dihet prej disave, për shkak të daljes prej minimizimit të fuqisë së zemërimit, njeriu shkon deri në vende të frikshme dhe e vë veten para rreziqeve, për shembull lundron me anije kur dallgët janë aq të mëdha, sa përplasen njëra me tjetrën. Këtë ai e bën me qëllim që fika të largohet prej tij.[1]

[1] Ibni Meskùjeh, "Tehdhijbul-Akhlàk", f. 173.

Por, edhe nëse mjekimi i fuqisë së zemërimit është me këtë rrugë, përsëri ky veprim konsiderohet teprim në punë, sepse baza e mjekimit është zgjimi i fuqisë së zemërimit prej shuarjes e prej dobësimit. Në të vërtetë, shuarja e fuqisë së zemërimit çon në defekte të rënda e në çarje të mëdha në sistemin shoqëror dhe në qeverisjen e qytetarisë së virtytshme. Në rastin e shuarjes e të dobësimit të fuqisë së zemërimit ndodhin gabime shumë të mëdha në mënyrën e jetës individuale e shoqërore, për rrjedhojë ndodhin të meta të mëdha në përgjumjen e kësaj fuqie të nderuar. Kur fuqia e zemërimit dobësohet, plogështohet, dembeloset, bëhet lakmitare, pakësohet durimi e vendosmëria, për rrjedhojë vjen largimi prej frontit të luftimit, qëndrimi ulur kur domosdoshmërish duhet qëndruar më këmbë, heqja dorë për të urdhëruar punën e mirë e për të ndaluar punën e ligë, vjen dorëzimi para të metave, deri edhe para turpit, poshtërimit e mjerimit.

Allahu i Lartësuar nuk e ka krijuar këtë fuqi te njeriu pa ndonjë qëllim e pa ndonjë dobi, por e ka bërë kapital, me të cilin njeriu të sigurojë lumturinë në këtë botë, e ka bërë një mjet që ai jetë krenar e me dinjitet, duke shtuar se fuqia e zemërimit është burimi i të gjitha lumturive në këtë botë.

Qëndrimi ulur, kur duhet të qëndrosh më këmbë, plogështia në çështjen e urdhërimit për punë të mirë e ndalimi i punës së keqe, si dhe mosmosndalimi i padrejtësisë së mizorëve, nuk është mençuri, por amulli dhe konsiderohet njëra prej cilësive të poshtra dhe prej cilësive jo të mira.

Allahu i Lartësuar në ajetet e Kur'anit Famëlartë i ka përshkruar besimtarët: **"أَشِدَّآءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَآءُ بَيْنَهُمْ"** *"…eshid'dàu alel-kuf'fàri ruhamàu bejnehum…"* **"…të ashpër me armiqtë e të mëshirshëm mes tyre…"**[1]

Allahu i Lartësuar i ka ndarë në mënyrë të qartë e të prerë luftëtarët trima prej atyre që rrinë në shtëpi e nuk dalin të luftojnë në rrugën e

[1] Sure "El-Fet'h", ajeti 29.

Allahut, duke i vlerësuar shumë lart gradët e mëdha që do të kenë te Ai luftëtarët në rrugën e Allahut.[1]

Gjithashtu, i Larti vlerëson shumë qëndrueshmërinë në sheshet e betejave luftarake, i nxit besimtarët për të dalë në radhët e para në përballjen me armikun dhe i nxit ata që të shkojnë në luftë.[2] Të gjitha këto realizohen në sajë të fuqisë së nderuar të zemërimit. Por, me shuarjen e me fishkjen e kësaj fuqie, njeriu privohet prej të gjitha këtyre virtyteve dhe i dorëzohet poshtërimit, i dorëzohet uljes në shkallën më të poshtme deri edhe rënies rob lufte. Gjithashtu, me shuarjen e fuqisë së zemërimit e me lënien e saj në heshtje, njeriu qëndron ulur dhe nuk i kryen as detyrat e veta që ka në këtë botë e as detyrat fetare.

Për të gjitha këto, sikur te një individ të shuhet e të fiket fuqia e zemërimit, patjetër që kjo fuqi duhet mjekuar me ilaçin e diturisë e të punës, derisa ai të rikthehet në gjendjen normale.

[1] Aludon për ajetin 95 të sures "En-Nisa".

[2] Aludon për ajetin 65 të sures "El-Enfal"; ajetin 38 të sures "Et-Teube" dhe ajetin 83 të sures "En-Nisa".

NDARJA E TRETË

SHPJEGIMI: RREZIQET E DEVIJIMIT TË FUQISË SË ZEMËRIMIT

Shumë njerëz janë vënë në provë me teprimin në zemërim. Hadithi i nderuar teprimin në zemërim e quan mendjelehtësi, e konsideron prej cilësive më të urryera e prej moraleve më të ulëta. Këto cilësi e morale, që e çojnë njeriun drejt shkatërrimit të plotë, janë shkak që ai të kalojë në vështirësi të mëdha në këtë botë e në Botën Tjetër. Kur fuqia e zemërimit del jashtë cakut të maturisë, ajo priret drejt ekstremit më të largët. Kalimi në ekstrem në zemërim, sjell asgjësimin e vetë të zemëruarit, të fesë së tij e të interesave të tij në këtë botë.

Në librin e nderuar "El-Kàfij", prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Zemërimi e prish besimin, ashtu siç e prish uthulla mjaltin."*[1]

Kur fuqia e zemërimit del jashtë kontrollit të mendjes, i ngjason një qeni të tërbuar. Në gjendje ashpërimi, zemërimi ia heq njeriut nga dora zgjedhjen që ai bën dhe e çon në tirani, e çon deri në shkeljen e ligjeve të respektuara, madje e çon deri aty sa i vret edhe besimtarët.

Gjithashtu, kjo errësirë shuan edhe dritën e besimit dhe ky zjarr i ndezur djeg të gjitha besimet e vërteta, djeg edhe dritat e dijes e të besimit dhe kështu bëhet fillesa për mijëra injoranca e për mijëra mendjelehtësira. Përfundimisht njeriu s'ka më mundësi të ndreqë këtë fuqi, sado e gjatë të jetë jeta e tij.

[1] "Usùulull-Kàfij", vëll. 2, K. "El-gadabu", Hadithi 1.

Fuqia e zemërimit, nga ana e rrezikshmërisë, qëndron mbi të gjitha fuqitë. Zemërimi mund të çojë në shpërbërjen e familjes me shpejtësinë e vetëtimës dhe brenda një minute mund ta nxjerrë njeriun prej qenies së tij dhe prej lumturisë në këtë botë e në Botën Tjetër.

Filozofët kanë thënë se njeriu, në gjendjen e shpërthimit të zemërimit është si një shpellë, në të cilën është ndezur një zjarr i madh, aq sa duket sikur në atë shpellë janë ndalur engjëjt ndëshkues të Xhehenemit. Tymi i atij zjarri është grumbulluar brenda në shpellë. Për rrjedhojë, prej shpellës, për shkak të fuqisë së madhe të shpërthimit, dëgjohen vërshëllima e zëra. Vetëkuptohet që shuarja e këtij zjarri kaq të madh është punë shumë e vështirë. Çdo send që hidhet në atë zjarr për ta shuar, merr flakë dhe zjarri ha një pjesë prej sendit të hedhur. Edhe uji që hidhet për ta shuar zjarrin, ndihmon që zjarri të ndizet edhe më shumë.[1]

Nga kjo anë, njeriu, në momentin e shpërthimit të zemërimit, është në gjendje mendjelehtësie, injorance e bëhet si bishë. Në këtë gjendje ai as nuk sheh e as nuk dëgjon, është bërë si i verbër e i shurdhuar. Për rrjedhojë, orientimi, udhëzimi e këshilla në karakterin e tij japin rezultat të kundërt dhe shpesh e ndezin edhe më shumë zjarrin e zemërimit të tij.

Filozofi Hipokrat ka thënë: "Jam në një anije që është vënë në provë me erëra të fuqishme e me tufane të mëdha, jam në mesin e dallgëve të detit që përplasen me njëra-tjetrën. Megjithëse jam në mesin e vorbullave të mëdha e në mesin e maleve të dallgëve, kam më shumë shpresë të shpëtoj nga sa ka personi i zemëruar në gjendjen kur zemërimi i tij ka marrë zjarr, sepse timonieri i anijes ka mundësi ta shpëtojë anijen prej shkatërrimit me anë të manovrimeve, kurse në gjendjen e një zemërimi të tillë, i zemëruari nuk shpreson për veten e tij asnjë mjet.[2]

[1] Ibni Meskùjeh, "Tehdhijbul-Akhlàk", f. 164-165; Dijetari Et'tùsij, "Akhlàku-n'nàsirij", f. 175-176.

[2] Ibn Meskùjeh, "Tehdhijbul-Akhlàk", f. 165.

Në një hadith të ardhur prej Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë*: "Zemërimi është një thëngjill prej djallit, që merr flakë në zemrën e birit të Ademit."*[1]

Ka shumë mundësi që ky zjarr i ndezur te ky njeri, të jetë ndezur me dorën e djallit dhe të jetë njëra formë e zjarrit. Këtë e lexojmë në ajetin e nderuar: **"نَارُ اللهِ الْمُوقَدَةُ الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ"** *"Nàru-ll'llàhil-mùkadeti. El'letij tet'taliu alel-efideti" "Zjarri i tejndezur i Allahut, depërton deri në thellësi të zemrës."*[2]

Në atë botë, në botën ku bëhen të dallueshme sekretet dhe ku zbulohen të vërtetat, ka shumë mundësi që e brendshmja e zjarrit të zemërimit të jetë e vërteta e zjarrit të zemërimit hyjnor, që është zjarri më i ashpër dhe zjarri që djeg më shumë. Ky zjarr bëhet i dallueshëm në brendësinë e zemrës dhe jashtë trupit. Ky zjarr është prej punëve të Xhehenemit dhe depërton nga jashtë për në brendësi. Njeriu është mes këtyre dy zjarreve: zjarrit të brendshëm e zjarrit të jashtëm.

Trysnia e këtyre dy zjarreve është aq e rëndë, sa nuk e mbajnë dot malet e kësaj bote, qoftë edhe për çast të vetëm.

Rrethimi i njeriut në zjarrin e Xhehenemit nuk është si rrethimi që e përfytyrojmë ne në këtë botë. Rrethimi në këtë botë është sipërfaqësor, domethënë e jashtmja mbështjell të jashtmen dhe në mes të brendshmeve s'ka kontakt, kurse zjarri hyjnor rrethon të jashtmen e të brendshmen dhe depërton në thellësi. Rrethimi i zjarrit hyjnor është dukuri e rrethimit të përjetshëm dhe, në një formë, bashkon të gjitha qeniet.

Zjarri i Allahut e djeg trupin me të jashtmen e me të brendshmen e tij, gjithashtu djeg edhe shpirtin e zemrën. Një zjarr i tillë nuk mund të përfytyrohet në botën e tokës, pasi të gjitha zjarret e kësaj bote nuk dalin prej kufirit të së dukshmes dhe nuk arrijnë në brendësi të njeriut. Por atje, e brendshmja digjet më shumë nga sa digjet e jashtmja dhe zjarri atje përfshin të brendshmen më shumë nga sa përfshin të jashtmen.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-Gadabu", Hadithi 12.
[2] Sure "El-Humezeh", ajetet 6-7.

Sikur të ishte e mundur të formësohej zemërimi në shpirt, ajo formë do të bëhej cilësi e brendshme për njeriun, sundimi i mbretërisë së cilësive do të ishte nën veprimin e shpirtit bishë dhe fytyra e fundit e njeriut me shpirtin bishë, do të ishte me fytyrën e bishës, për rrjedhojë, njeriu në botën e Berzahut dhe në Ditën e Gjykimit do të dilte me fytyrën e bishës.

Dihet se bishat e botës së Berzahut (koha që shtrihet nga dita e vdekjes deri në Ditën e Ringjalljes) kanë cilësi krejtësisht të ndryshme nga cilësitë e bishave të botës së tokës. Gjithashtu, edhe kafshëria e njeriut ndryshon shumë prej kafshërisë së të gjitha kafshëve. Në një hadith të ardhur prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Disa njerëz do të vijnë në sheshin e gjykimit me një fytyrë të atillë sa fytyra e majmunëve dhe e derrave do të jetë më e bukur."*[1]

Gjithashtu, njeriu në horizontet e plotësimit e të bukurisë, qëndron në radhën e ekzistencës më të lartë, madje qëndron aq lart, sa me atë nuk barazohet asnjëra prej qenieve. Gjithashtu, nga ana e mangësisë dhe e së keqes, karakterizohet me cilësi të poshtra, të atilla që nuk mund të jenë në asnjërën prej qenieve të tjera.

Këtë të vërtetë për këta njerëz, na njofton i Larti: **" أُولَئِكَ كَالْأَنْعَامِ بَلْ هُمْ أَضَلُّ"** *"…ulàike kel-en'àmi bel hum edal'lu…"* **"…ata janë si kafshët, madje janë më të humbur…"**[2]

"فَهِيَ كَالْحِجَارَةِ أَوْ أَشَدُّ قَسْوَةً" *"…fehije kel-hixhàreti eu eshed'du kasveten…"* **"…ato** (zemrat e tyre) **janë si guri, ose edhe më të forta se guri…"**[3]

Kjo poshtërsi e kjo cilësi e keqe bëhet burim prej të cilit shpeshherë bëhen ngjarje të këqija, që janë fillimi i shumë moraleve e punëve të liga, madje deri edhe i besimeve të prishura. Detyra e njeriut të ndërgjegjësuar

[1] Autori El-Fejd El-Kàshànij, "Ilmul-Jekijn", vëll. 2, f. 901.
[2] Sure "El-Araf", ajeti 179.
[3] Sure "El-Bekare", ajeti 74.

dhe që beson në Botën Tjetër mbetet të mjekojë veten e tij me çdo manovër e ushtrim dhe të pastrojë zemrën e vet prej kësaj poshtërsie të keqe.

Sikur njeriu të kalojë nga kjo jetë me këtë cilësi *(Allahu mos e lejoftë!)* dhe derisa atë ta përfshijë ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve, ai do të jetë në gjendje shumë të rëndë e do të jetë nën trysni shumë të rënda, do të jetë në zjarr e në dënime të shumta. Ka mundësi që këto gjendje të rënda e të vështira të zgjasin aq gjatë, sa është e gjatë jeta e kësaj bote, derisa te ai të arrijë ndërmjetësimi.

Në të vërtetë, ndërmjetësimi në Botën Tjetër nuk është një punë pa rrezik, pasi për ndërmjetësimin kërkohet lidhja mes ndërmjetësuesit dhe mes personit për të cilin ndërmjetësohet. Për të gjitha këto, personat që nuk e kanë pjesë të tyren dritën e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidin), nuk kanë mundësi të arrijnë dritën e ndërmjetësimit. Po kështu janë edhe ata që kanë kryer mëkate. Sado e madhe të jetë turbullira e mëkateve të këtyre të fundit, përsëri te ata do të arrijë ndërmjetësimi, por pas kohëve shumë të gjata.

Transmetohet prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi atë e mbi familjen e tij!)*: *"Luginat e ndërmjetësimit tim Ditën e Kiametit janë të rezervuara për mëkatarët e umetit tim, që kanë bërë mëkate të mëdha."*[1]

Shehu me dituri të plota, Shah Abadij, thotë: "Fjala *"rezervim"*, e të Dërguarit të Allahut nënkupton se ndërmjetësimi është mjeti i fundit me të cilin mund të ndërhyhet, por ndërhyrja do të ndodhë vetëm pas kohëve shumë të gjata.

Gjithashtu, edhe rezervimi është gjëja e fundit prej të cilit mund të përfitohet në kohën e mjerimit. Sikur të supozojmë se kjo kërkesë është e drejtë, do të ishte e mjaftueshme për të na zgjuar prej gjumit të shkujdesjes

[1] "Bihàrul-Envàr", vëll, 8, K. "Esh'shefàatu".

e prej mashtrimeve të djallit dhe do të bënte që ne të mendojmë rreth përmirësimit të vetes.

Gjithashtu veten tonë ta bëjmë që të jetë e përshtatshme me imamët. Në sajë të mirësisë së dashurisë së tyre, gjithashtu edhe në sajë të dritave të bindjes sonë, patjetër që do të meritojmë ndërmjetësimin e tyre dhe drita e ndërmjetësimit të tyre do të jetë së bashku me shkëlqimin e bindjes sonë. Të dyja këto do të ishin ndërmjetësim për ne, do të ishin një tërheqje kah shpirtrat e imamëve. Vetëm Allahu është udhëzuesi në rrugën e drejtë.

NDARJA E KATËRT

SHPJEGIMI: MJEKIMI I ZEMËRIMIT NË GJENDJEN E SHPËRTHIMIT

Duhet të dihet se njeriu ka detyrë të fillojë përmirësimin me qetësimin e vetes dhe të mos lejojë që zjarri i zemërimit të ndizet, të mos lejojë që flakët e zjarrit të zemërimit të arrijnë deri te sytë e te veshët e tij dhe të shuajë dritën e mendjes së tij. Padyshim që mjekimi është i pamundur në kohën e shpërthimit të zemërimit. Megjithatë, për të shuar zjarrin e zemërimit edhe në gjendjen kur zemërimi ka marrë zjarr, ka disa mjekime të përkohshme, nëse njeriu nga shpërthimi i zemërimit s'ka arritur akoma të çmendet plotësisht, derisa të mos jetë më e mundur që ai të ndalohet nga gjendja e vlimit.

Mjekimi në këto raste është që të përgatiten faktorët e përmbajtjes së vetes, njeriu të mbajë veten nën kontroll, sapo të ndiejë se gjendja e tij po fillon të ndryshojë. Këtë e bën që me fillimin e shenjave të para të zemërimit. Pikërisht në këto çaste njeriu ka detyrë të fillojë mjekimin e vetes, para se zemërimi te ai të ketë këputur frerët.

Nëse njeriu ka mundësi, le të largohet prej vendit ku gjenden faktorët që shkaktuan zemërimin, le të dalë menjëherë jashtë dhe të fillojë të merret me shumë punë të ndryshme, që s'kanë lidhje njëra me tjetrën. Nëse s'ka mundësi të largohet e të dalë jashtë, atëherë le të përmbajë veten dhe të mundohet të ndryshojë gjendjen, si për shembull të ulet, nëse është më këmbë, nëse është ulur, le të shtrihet, ose le të merret me punë krejtësisht të ndryshme nga punët që u bënë shkak për zemërimin.

Në librin "El-Kàfij" lexojmë: **"***Kur ndonjëri prej jush ka frikë prej vetes së tij, menjëherë le të shtrihet në tokë dhe nëse e ndien djalli, patjetër të largohet prej tij në çast."*[1]

Prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Çdo njeri që zemërohet me të afërmin e vet, le t'i marrë atij lejë dhe le ta lëmojë me dorë, sepse kur mitra lëmohet me dorë, ajo qetësohet."*[2]

Prej rrugëve të përgjithshme të qetësimit të zemërimit lexojmë prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!): "Kur zemërohej dhe ishte më këmbë, menjëherë ulej dhe, nëse ishte ulur, menjëherë shtrihej për tokë dhe zemërimi i largohej."*[3]

Kur zemërimi e mposht njeriun, i ka hequr frerët prej dore dhe, kur zemërimi është ashpërsuar e ka marrë zjarr, të tjerët kanë detyrim të fillojnë mjekimin e të zemëruarit. Mjekimi në këtë gjendje, megjithëse është shumë i vështirë, siç kemi thënë më sipër, në gjendje zemërimi në të zemëruarin nuk ndikojnë as këshilla e as predikimi, mjekimi i të zemëruarit duhet bërë me mënyrën e frikësimit, ose me sjelljen e personave prej të cilëve ai ka turp, sepse zemërimi në praninë e të mëdhenjve dhe të personave prej të cilëve i zemëruari turpërohet, nuk del hapur, por qëndron në brendësi dhe te njeriu lind dëshpërimi.

Por për shkak të përmbajtjes së zemërimit, të kësaj sprove të madhe, me të cilën njeriu vihet shpesh në provim, ka shumë mundësi që kjo gjendje të sjellë sëmundje shkatërruese. Prandaj është më e mirë që i zemëruari, në situata të tilla, të lihet në gjendjen e tij dhe është më mirë që zemërimi prej tij të largohet me metoda shkencore, megjithëse edhe kjo është një punë shumë e vështirë.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-Gadabu", Hadithi 12.
[2] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-Gadabu", Hadithi 2.
[3] "Kenzul-Um'màl", vëll. 7, Hadithi 18404.

NDARJA E PESTË

MJEKIMI BAZË I MENDJELEHTËSISË E I ZEMËRIMIT EKSTREM ME SHKAQET QË SOLLËN NDEZJEN E TIJ

Shkaqet janë të shumta, prandaj do të mjaftohemi të përmendim vetëm njërin prej shkaqeve, por që konsiderohet baza e të gjitha shkaqeve dhe është ndjenja e konkurrencës për njërën prej kërkesave vetjake shpirtërore, që është si konkurrenca e qenve kur grumbullohen mbi një cofëtinë. Kur fillon konkurrenca, te qentë vlon zemërimi e me pas, mes qenve, shpërthen grindja e lufta.

Prej të parit të Imamëve, Al bin Ebu Talibit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Në të vërtetë, kjo botë është një cofëtinë dhe ata që hidhen mbi këtë cofëtinë, janë të ngjashëm me qentë."* Ky është krahasimi më i mirë që mund të bëhet, pasi tërbimi i bijve të tokës mbi këtë cofëtinë që ka marrë erë, e tejkalon edhe tërbimin e qenve.

Nga kjo anë, dashuria për këtë botë duhet të konsiderohet baza e bazave dhe nëna e të gjitha sëmundjeve dhe kryet e të gjitha gabimeve. Kur dashuria për këtë botë zë vend në zemrën e njeriut, thjesht nga konkurrenca për ndonjërën prej punëve të kësaj bote, menjëherë në zemër shpërthen fuqia e zemërimit dhe, në gjendje zemërimi, njeriut i dalin nga dora frerët e zgjedhjes, nuk arrin të zotërojë veten dhe zemërimi e nxjerr njeriun prej rrugës së ligjit e të mendjes.

Mjekimi bazë për këtë fuqi është ndalimi i lëndës djegëse së kësaj fuqie që ishte dashuria për këtë botë. Sikur njeriu të pastrojë veten prej dashurisë për këtë botë, do të ishte i shkujdesur për punët e kësaj bote, por

do të ruante sigurinë e qetësinë e vetes, pavarësisht se do të humbë autoritetin, pasurinë, pozitën apo edhe kryesinë dhe te njeriu do të arrihej e vërteta e mençurisë, e durimit dhe e sigurisë në vetvete. Për rrjedhojë, te njeriu do të rritej qëndrueshmëria e vendosmëria. Për të ndaluar këtë lëndë, lëndën e dashurisë për këtë botë, që është origjina e të gjitha shkatërrimeve, njeriu ka detyrë të bëjë gjithçka që ka mundësi të përballojë prej ushtrimeve, pasi të gjitha janë në vendin e duhur. Në të vërtetë, njeriu e meriton ndalimin e kësaj lënde.

Mjekimi më i mirë i kësaj lënde është mendimi rreth gjendjes së të mëparshmëve dhe rreth tregimeve kuranore. Me këto mendime njeriu ka mundësi të ketë parasysh gjendjet e personave që kanë gëzuar kënaqësitë e llojeve të shumta prej pushtetit, madhështisë, pasurisë e pronës, por që në të vërtetë kanë përfituar prej të gjitha këtyre vetëm për disa ditë të kufizuara dhe, pas këtyre ditëve të pakta gëzimi në këtë botë, në varr nuk kanë marrë asgjë nga ato që kishin, përveç brengës e hidhërimit që nuk mbarojnë asnjëherë. Ata e lënë këtë botë të ngarkuar me peshën e gjërave, me të cilat u kënaqën në këtë botë e me poshtërsitë e kësaj bote. Ky është mjekimi më i mirë për njeriun e zgjuar prej gjumit të shkujdesjes.

Njeriu i mençur patjetër duhet të dijë masën e nevojave të jetesës së tij në këtë botë, por duhet të dijë edhe sasinë e mjeteve të jetesës e nevojat që ka për në Botën Tjetër, të shikojë nevojat që ka në këtë, edhe sikur të jetojë njëqind vjet, në të njëjtën kohë të shikojë sa nevoja ka edhe për jetën e përhershme që s'ka fund. Pastaj le të shikojë me sa humbje, brenga e pendime është përballur në këtë botë. Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar: **"وَالْعَصْرِ إِنَّ ٱلْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ"** *"Uel-asri. In'nel-insàne lefij khusrin"* **"Betohem në kohën. Padyshim njeriu është në humbje."**[1]

Allahu i Lartësuar betohet! Sikur njeriu të dijë me të vërtetë sa e madhe është humbja e tij, padyshim do të humbë qetësinë, kur të shikojë se kapitali i lumturisë i doli nga dora, madje edhe më shumë se kaq, kur këtë

[1] Sure "El-Asr", ajetet 1-2.

kapital ai e ka shpenzuar për punë të këqija dhe me këto punë i ka përgatitur vetes Xhehen'nemim e zjarrin e tij.

Njeriu derdh djersë e lodhet për nevojat e tij, të disa viteve jete në këtë botë, për të cilën ai shpenzon të gjithë kohën e tij, në një kohë kur kohën duhet ta shpenzojë për të arritur jetën e përhershme. Por jo vetëm kaq, njeriu, edhe zemrën e lidh me një vend që do ta lërë pas disa ditësh. Patjetër që me këtë njeriu nuk arrin asgjë tjetër përveç pendimit e brengosjes.

Sikur njeriu të mendojë pak për gjendjen e miqve të Allahut, të cilët janë mësuesit praktikë të njerëzimit, atëherë do të gjejë humbjen e vetes së tij.

O Zoti ynë, ne jemi në një gjumë të thellë! Jetët tona i shpenzuam në rrugët pa dobi, prandaj Ti na zgjo prej këtij gjumi të rëndë dhe bëj që të shohin rrugën e drejtë, zhvishi zemrat tona prej dashurisë për këtë shtëpi mashtruese, bëj që sytë tanë të mos shikojnë asnjë tjetër përveçse në Ty! Ndriçoi zemrat tona me më të bukurën e bukurive të Tua! Vetëm Ti je Mirësidhënësi, i Madhi!

NDARJA E GJASHTË

SHPJEGIMI: ARRITJA E CILËSISË SË MENÇURISË

Le të mësohet se, derisa njeriu është në këtë botë, është i ekspozuar të pësojë ndërrime e shndërrime. Në të vërtetë, ai ka mundësi të ndërrojë një cilësi me një tjetër. Thënia se morali i filanit është nga vetë cilësia e krijimit të tij, prandaj ai nuk mund të ndërrohet, është një thënie që s'ka bazë shkencore. Kjo kërkesë, në filozofi është kërkesë argument, është argument ekzistencial. Dëshmuesi më i madh për këtë argument, është fakti se, në ligjin e pastër të fesë, janë të ndaluara të gjitha moralet shkatërruese. Madje në ligjin e fesë janë vënë edhe dispozita të veçanta për mjekimin e moraleve shkatërruese. Në ligjin e fesë është urdhër i prerë të arrihen të gjitha moralet e mira, për të cilat gjithashtu janë vënë dispozitat përkatëse.

Derisa njeriu vazhdon të jetojë në këtë botë, patjetër duhet të dijë vlerën e jetës dhe të punojë shumë që të arrijë cilësitë e virtytshme, mbi të cilat janë ndërtuar themelet e lumturisë.

Pas shkuljes së cilësive të këqija prej vetes, me çdo mënyrë ushtrimi, patjetër që njeriu duhet të punojë shumë për të arritur cilësitë e mira, që janë e kundërta e cilësive të këqija. Cilësitë e mira te njeriu janë ushtritë e mendjes e ushtritë e të Gjithëmëshirshmit, prandaj njeriu sakrifikon në rrugën e arritjes së këtyre ushtrive. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia që te njeriu do të gjenden edhe morale të këqija. Kjo ndodh, sepse nuk është ndaluar lënda shkatërruese. Në të vërtetë, ndalimi i kësaj lënde shkatërruese është parathënia për përmirësimin e për lartësimin e njeriut drejt plotësimit. Por objektivi me më shumë interes është arritja e plotësimeve shpirtërore, të cilat janë shkak për lumturinë njerëzore dhe parathënie për të arritur plotësimin e plotë të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm.

Gjithashtu, as devotshmëria nuk shikohet në mënyrë të pavarur nga zbrazja e shpirtit prej cilësive të këqija. Në procesin e rrënjosjes së devotshmërisë, sa herë shikojmë në një etapë praktike të devotshmërisë, vërejmë se devotshmëria është një pastrim i vetes prej ndotjeve dhe ky pastrim, në vetvete është veprim paraprak për plotësimin e punës.

Gjithashtu është edhe pastrim prej cilësive të këqija, në atë mënyrë që në çdo njërën prej shkallëve të devotshmërisë, kur ne e vërejmë atë në kuptimin e saj të përgjithshëm, shikojmë se pastrimi është veprim paraprak për plotësimet shpirtërore, domethënë është plotësim i cilësive të mira e të virtytshme.

Çdo njëra prej shkallëve të plota prej shkallëve të devotshmërisë, do të thotë heqje dorë prej çdo gjëje, përveç të Vërtetit dhe pastrim prej idhujtarisë, në kuptimin e plotë që ka fjala idhujtari. E gjitha kjo është parathënia për arritjen e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi), është dalje përpara të Vërtetit të Lartësuar dhe dalja para të Vërtetit të Lartësuar është pikërisht qëllimi origjinal i krijimit. Kjo e vërtetë theksohet në hadithin kudsij: *"Isha një thesar i fshehur dhe desha të njihem, prandaj krijova krijesat, që të bëhem i njohur."*[1]

Më sipër kemi thënë se të gjitha bazat e ligjeve të vërteta qëndrojnë mbi dy cilësi hyjnore të krijimit: njëra është origjinale, e pavarur dhe është cilësia e dashurisë për plotësimin absolut, e cila është baza për dashurinë e Allahut; cilësia tjetër është e varur, informuese, është cilësia e neverisë nga mangësia.

Pikërisht kjo cilësi është baza e pastrimit dhe e devotshmërisë në kuptimin e saj të përgjithshëm gjithëpërfshirës. Të gjitha dispozitat ligjore, qofshin dispozita që kanë lidhje me punët shabllon, ose dispozita që kanë lidhje me punët e zemrës, në mënyrë të barabartë, janë të ndërtuara mbi bazën e këtyre dy cilësive hyjnore ekzakte origjinale.

[1] "Meusuatu atràfil-hadijthi-n'nebevij", vëll. 6, f. 507.

Dhe tani le të kthehemi në origjinën e kërkesës, që ishte arritja e cilësisë së mençurisë. Prandaj duhet ditur ajo që është vërtetuar në filozofi, që njeriu, në sajë të lidhjes shumë të fortë mes cilësive të trupit me cilësitë e shpirtit, për ato cilësi ka zhvillime për të panjohurën dhe për të njohurën, janë zhvillime të larta në esencën e vetë afrimit dhe janë afruese në esencën e vetë lartësimit, por si të gjitha fuqitë e depozituara te njeriu, ato janë një unitet.

Bazuar mbi këtë që u tha, të gjitha ndikimet e jashtme shkojnë në shpirt dhe ndikimet morale shkojnë drejt cilësive të trupit. Kur njeriu është aktiv në lëvizje e në pushime, ai punon me qetësi dhe ndihet i qetë. Në veprimin e tij, në punët që kanë formë, ai është si njerëzit e mençur dhe kjo formë e jashtme e tij depërton në shpirt dhe shpirti ndikohet nga kjo formë e tij e jashtme. E njëjta gjë është edhe me frenimin e zemërimit dhe me vetobligimin për butësi e mençuri. Kjo mençuri patjetër do të përfundojë në butësi.

Ky vetobligim i njeriut për butësi e mençuri shndërrohet në një shprehi të zakonshme në raport me njeriun. Kur njeriu është plotësisht i përkushtuar për një kohë të caktuar dhe e mban veten nën një kontroll të drejtë, padyshim do të arrijë rezultatin e kërkuar.

Ky mjekim shërues është përmendur në transmetimet e ardhura prej familjes ku është zbritur shpallja e Vulës së të Dërguarve *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!).*

Në librin "El-Vesàil", cituar prej librit "Nehxhul-Belàgah", prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Nëse nuk je i mençur, menjëherë trego mençuri. Në të vërtetë, janë pak të tillë të ngjashëm në një grup njerëzish, ndryshe ka mundësi të jesh njëri prej tyre."*[1]

Prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë*: "Kur nuk je i mençur, atëherë bëhu i mençur."*[2]

[1] "Vesàilu-sh'shij'atu", vëll. 15, K. 26 prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi".
[2] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El Hulmu", Hadithi 6.

NDARJA E SHTATË

PËRMENDJA E VIRTYTEVE TË MENÇURISË NË HADITHE

Përsa i përket virtyteve të butësisë, në kuptimin e mençurisë, të vërtetuara me rrugën e tekstit, ato dihen dhe janë të vërtetuara, gjithashtu edhe tekstet e nderuara, që flasin për këtë çështje, nuk janë të panjohura për njerëzit me mendje të shëndoshë.

Është e mjaftueshme të thuhet se, në lidhje me virtytin e butësisë, në kuptimin e mençurisë, Allahu i Lartësuar, në Kur'anin Famëlartë, butësinë në kuptimin e mençurisë, ia atribuon Vetes së Tij.

Këtë të vërtetë e lexojmë në ajetin 44 të sures "El-Isra": **"إِنَّهُ كَانَ حَلِيْماً غَفُوراً"** *"…in'nehù kàne halijmen gafùren"* **"…me të vërtetë, Ai është i butë dhe fal shumë.",** si dhe në ajetin 51 të sures "El-Ahzab": **"...وَكَانَ اللَّه عَلِيْماً حَلِيْماً"** *"…ue kàne-ll'llà alijmen halijmen"* **"…Allahu është më i dituri, më i buti. "**

Këto ajete janë argumente që tregojnë se butësia, në kuptimin e mençurisë, është prej cilësive të plotësuara absolute, cilësi me të cilat i Ekzistuari domosdoshmërish vetëcilësohet se ekziston me këto cilësi. Filozofia ka pohuar se cilësitë e të Vërtetit të Lartësuar shprehin ato cilësi që janë prej plotësimeve absolute dhe prej cilësive me të cilat Ai ekziston, megjithëse Ai s'ka nevojë të përshkruajë vetekzistencën me ato cilësi si veçanti që mund të fitohen me përgatitje ushtrimore dhe natyrore.[1]

[1] "El-Esfàrul-Erbeah", vëll. 6, f. 133.

Cilësitë e plotësuara janë prej ushtrive të Gjithëmëshirshmit dhe të gjitha ushtritë e të Vërtetit, të Gjithëmëshirshmit janë hija e Tij, por hija e sendit as nuk është e as nuk i kundërvihet sendit me një kundërvënie izoluese. Hija, në të vërtetë, i kundërvihet sendit në cilësitë dhe ndryshon në plotësimin e në mangësinë.

Kur'ani Famëlartë e ka shprehur këtë kuptim të hollë të njohjes dhe të vërtetës së argumentuar me ajete e me shenja. I Gjithëfuqishmi, edhe Ibrahimin *(paqja qoftë mbi të!),* mikun e të Gjithëmëshirshmit, atë që është prej të mëdhenjve të plotësuar në shtëpinë e ekzistencës, e ka përshkruar me cilësinë e butësisë.

Në ajetin 75 të sures "Hud", lexojmë fjalën e Allahut të Lartësuar: **"إِنَّ مُنِيبٌ"** **"إِبْرَاهِيمَ لَحَلِيمٌ أَوَّاهٌ"** *"In'ne Ibràhijme lehalijmun ev'vàhun munijbun"* **"Me të vërtetë, Ibrahimi ishte shumë i butë, shumë i dhimbshëm dhe kthehej shumë** (te Allahu)**."**

Edhe Ismailin *(paqja qoftë mbi të!),* të emërtuarin *i flijuari i Allahut*, Allahu i Lartësuar e ka përshkruar me cilësinë e butësisë. Për këtë njofton ajeti 101 i sures "Es-Safat": **"فَبَشَّرْنَاهُ بِغُلَامٍ حَلِيمٍ"** *"Febesh'shernàhu bigulàmin halijmin"* **"Ne e përgëzuam atë** (Ibrahimin) **me një djalë të butë."**

Në pozitën e përgëzimit për Ibrahimin *(paqja qoftë mbi të!)* Allahu i Lartësuar, për të përshkruar djalin me të cilin e përgëzoi, zgjodhi këtë cilësi ndër të gjitha cilësitë e plotësuara. Patjetër që ky përshkrim tregon kujdesin në shkallën më të lartë të Ibrahimit, mikut të Allahut, që ai dhe i biri të përshkruhen me këtë cilësi të plotësuar, ose tregon kujdesin e të Vërtetit të Lartësuar për t'i përshkruar të dy me këtë cilësi, ose tregon për të dyja çështjet së bashku. Gjithsesi, përshkrimi me këto cilësi vërteton vënien në radhën e parë të kësaj cilësie të nderuar.

Ky moral i nderuar, është lavdëruar edhe në transmetime, ashtu siç e meriton të lavdërohet. Në librin e nderuar "El-Kàfij", prej Pusit të diturive,

Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Allahu i Lartësuar pa dyshim që e do modestin, të butin."*[1]

Në një transmetim tjetër, të ardhur prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Allahu i Lartësuar, me të vërtetë e do modestin, të butin, të turpshmin, atë që turpërohet."*[2]

Ky lavdërim, te ata që kanë dashuri dhe që kanë arritur gradën e njohjes, është prej lavdërimeve më të mëdha, sepse dashuria hyjnore te ata nuk mund matet me asnjë send, as nuk mund të peshohet e as nuk mund të barazohet me ndonjë send.

Është cituar prej sheh El-Behàij *(paqja qoftë mbi të!)*: "Kur Allahu e do një njeri, nuk e privon atë prej takimit me Atë, por e çon drejt takimit me Të). Kjo veçanti është e mjaftueshme për njerëzit e ndershëm, të cilët kanë arritur gradën e njohjes dhe për ata me zemra që nuk flenë.

Në librin "El-Vesàil", prej sheh Sadukut *(paqja qoftë mbi të!)*, prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* prej prindërve të tij, prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!),* nga tërësia e porosive që i la Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"O Ali, a doni t'ju njoftoj se cili prej jush më ngjan mua më shumë në moral?"*

Ata thanë: "Po, o i Dërguar i Allahut!" I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* tha: *"Më i miri juaj me moral, më i madhi juaj në butësi, më i miri juaj në afërsinë e tij dhe më i fuqishmi juaj, është ai që e përmban më shumë veten e tij."*[3]

Në librin "El-Khisàl", prej sheh Sadukut *(paqja qoftë mbi të!)*, prej Imam Sadikut (*paqja qoftë mbi të!)* prej babait të tij, prej gjyshit të tij, prej Ali

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, f. 91, K. "El-Hilmu", Hadithi 4.
[2] I njëjti burim, f. 92, Hadithi 8.
[3] "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll 15, K. 26 prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi", Hadithi 9.

bin Ebu Talibit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Betohem në Atë që e ka shpirtin tim, se Ai nuk ka mbledhur një send mbi një send më mirë nga sa ka mbledhur mençurinë dhe diturinë."*[1]

Në këtë kapitull ka transmetime të shumta nga librat që merren në konsideratë, prandaj nuk lind nevoja të rikthehemi në ato transmetime.[2]

Në ndarjen e tretë prej ndarjeve të kapitullit të njëzetë kemi shpjeguar se butësia në kuptimin e mençurisë është prej cilësisë së pastër, me të cilën është krijuar njeriu dhe kemi thënë se kjo cilësi është prej ushtrive të mendjes e prej ushtrive të Gjithëmëshirshmit.

Gjithashtu kemi shpjeguar se mendjelehtësia është e kundërta e cilësisë së pastër, me të cilën është krijuar njeriu dhe kemi thënë se mendjelehtësia është prej ushtrive të injorancës dhe prej ushtrive të Iblijsit, prandaj këtu nuk do të vëmë një ndarje të veçantë për këtë çështje.

[1] Autori në tekstin e transmetimit nuk ka përmendur fjalinë "Betohem në Atë që e ka shpirtin tim në dorën e Tij!". Hadithi gjendet në librin "El-Khisàl", në faqet 4-5, Hadithi nr. 11

[2] "Usùlul-Kàfij", K. "El-Hilmu"; "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 15, K. 26 "Istihbàbul-hilmi" prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi".

QËLLIMI NJËZET E NJË

HESHTJA, E KUNDËRTA, FJALËT E KOTA NË KËTË KAPITULL KEMI KATËR NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI: DOBITË E HESHTJES

Nga ana gjuhësore, fjala arabe **"أَلصَّمْتُ"** *"es'samtu"* – *"heshtja"*, shpreh dëgjimin në qetësi. Këtu nuk është qëllimi për heshtjen absolute, sepse heshtja absolute nuk është prej ushtrive të mendjes dhe nuk është më e mirë se fjala, pasi fjala e thënë në vendin e në kohën e duhur është shumë më e mirë se heshtja.

Me fjalën shpërndahen dituritë e të vërtetat fetare, me fjalën shpalosen njohuritë dhe shpjegohet edukata e ligjit të fesë, madje edhe Allahu i Lartësuar është vetëcilësuar me cilësinë e fjalës. Prej cilësive të Tij të bukura është edhe *cilësori* **"أَلْمُتَكَلِّمُ"** *"El-Mutekel'limu"* – *"Folësi"*. Ky është shkaku që, në këtë transmetim, të folurit nuk është vënë kundrejt heshtjes, por është vënë fjala **"أَلْهَذَرُ"** *"el-hedheru"* – *"fjalë të kota"* – në kuptimin e thashethemeve e të fjalëve që nuk vjen dobi.[1]

Heshtja është prej ushtrive të mendjes, fjala është mjet me të cilin miratohet ligji, kurse mendja është heshtja e qëndrimi në qetësi, për të mos

[1] "Lisànul-arab", vëll. 15.

thënë fjalë boshe e për të mos u marrë me thashetheme. Kjo heshtje dhe ruajtja e gjuhës prej fjalëve që nuk sjellin asnjë dobi, si dhe ruajtja e gjuhës prej fjalëve të gabuara, është prej virtyteve e prej plotësimeve njerëzore. Me fjalë të tjera, mbajtja e gjuhës prapa dhëmbëve dhe bërja e këtij gjarpri thumbues, në përputhje me zgjedhjen e njeriut, konsiderohet prej arteve më të mëdha dhe janë pak ata që e arrijnë këtë përputhje.

Sikur dikush të kishte këtë fuqi, patjetër që do të ishte i ruajtur prej sëmundjeve dhe prej rreziqeve të shumta, sepse për gjuhën ka sëmundje e rreziqe të mëdha e të shumta, madje disa kanë përmendur për gjuhën deri njëzet sëmundje. Por me siguri që numri i sëmundjeve të gjuhës është më shumë se kaq.

Në tërësi, fraza *"krahas faktit që është prej plotësimeve të ekzistencës"* të folurit është burimi i plotësimeve të shumta dhe kuptohet se pa fjalën mbyllet porta e diturive. Allahu i Lartësuar e lavdëron shumë të folurit. Këtë e lexojmë në ajetet 1-4 të sures "Er-Rrahmàn": **"عَلَّمَ . خَلَقَ ٱلإِنسَانَ. عَلَّمَهُ الْبَيَانَ. اَلرَّحْمَنُ.الْقُرْآنَ "** *"Err'rrahmàn, Al'lemel-Kur'àn. Khalekal-insàn. Al'lemhul-bejàn"* **"I Gjithëmëshirshmi. Ai ia mësoi atij Kur'anin. Ai e krijoi njeriun. Ai i mësoi atij** (njeriut) **të folurit."**

Në këtë ajet mësimi i të folurit është vënë në krye të të gjitha mirësive në pozitën e mirësive të dhëna të species njerëzore. Por meqenëse gjuha nuk është e siguruar se është e shpëtuar prej sëmundjeve të saj, si dhe fakti që frenimi i gjuhës është një veprim që bëhet me vetë zgjedhjen e njeriut, padyshim që është prej punëve më të vështira, madje edhe qetësia e heshtja anojnë kah fjala. Ata që merren me ushtrime, ia imponojnë vetes heshtjen, njëkohësisht tregojnë interesim të veçantë që të qëndrojnë në vetmi. Në të vërtetë, qëndrimi në vetmi tregon se ky veprim është prej ushtrimeve që praktikojnë ata që kanë arritur gradën e njohjes, dijetarët.

Megjithatë, ata që përjetojnë gjendjen e praktikimit të ushtrimeve, janë shprehur se te fjala ka dobi të shumta, ka edhe të ardhura të shumta, kurse në veçimin ka privim prej njohjeve e prej shumë diturive dhe, se

shërbimi për njerëzit është më i preferuar se adhurimet me të cilat është obliguar njeriu, madje edhe më i mirë se adhurimet e punët e veçanta që bëhen me qëllim afrimin te i Vërteti i Lartësuar. Me fjalën arrihet bashkëjetesa mes njerëzve. Nga ana tjetër, edhe sëmundjet që vijnë nga bashkëjetesa me njerëzit janë aq të shumta, sa njeriu e ka të pamundur të ruajë veten prej këtyre sëmundjeve, prandaj shehët që praktikojnë ushtrime, anojnë kah veçimi më shumë nga sa anojnë kah jetesa në mesin e njerëzve.[1]

Njeriu, veçanërisht në fillimet e jetës së tij, patjetër duhet të mësojë e të përfitojë prej qëndrimit në mesin e njerëzve dhe të marrë pjesë në kuvendet e dijetarëve, të filozofëve e të moralistëve dhe të dëgjojë diskutimet e tyre, por, me kusht që ai të bashkëjetojë me njerëzit, duke pasur informacion për gjendjet e për moralet e personave në mesin e të cilëve bashkëjeton. Njeriu, në fillimet e jetës e në vijimësi, duhet të përfitojë nga qëndrimi në mesin e njerëzve që të mësojë mënyrat e sjelljes e të qëndrimeve të matura. Njeriu e ka të domosdoshme të mësojë e të fitojë dituri, njohje, morale të mira e mënyra sjelljeje, edhe kur është në moshën mesatare, madje edhe kur është në moshë të thyer. Gjatë gjithë jetës duhet të përfitojë prej shërbimit të dijetarëve e prej shërbimeve të njerëzve të mëdhenj. Të gjitha këto mësime njeriu i merr vetëm duke qëndruar në mesin e njerëzve.

Kur njeriu arrin në fund të qëllimeve, patjetër duhet të racionojë kohën dhe në një pjesë të saj duhet të merret me veten e tij, ndërsa pjesën tjetër patjetër duhet të merret me të Vërtetin e me përmendjen e Tij. Kur njeriu e ka të pamundur të bashkërendojë kohën e qëndrimit në vetmi me të Vërtetin e Lartësuar me kohën e qëndrimit në mesin e njerëzve, atëherë patjetër duhet të qëndrojë në vetmi derisa te ai të vërshojë plotësimi i përshtatshëm prej cilësive të larta. Kur njeriu shikon në veten e tij një gjendje sigurie, qëndrime të drejta, atëherë ai është i sigurt edhe në gjendjet

[1] "Ihjàu ulùmi-d'dijn", vëll. 2, K. "Fevàidul-azleti". Meulà Abdu-rr'rrez'zàk El-Xhijlànij, "Sherhu misbàhu-sh'sherij'ati"; Sadr Muteelihijne Esh'shijràzij, "Sherhu Usùlul-Kàfij

shpirtërore është i siguruar prej cytjeve djallëzore dhe merret me orientimin e njerëzve, merret me mësimin e njerëzve, me edukimin e robërve të Allahut dhe i shërben bijve të species së tij me rrugën e shoqërimit e të përzierjes me njerëzit. Një njeri i tillë e përgatit veten që të mos shkëputet prej shërbimit në favor të robërve të Allahut. Ky është një ligj i përgjithshëm për heshtjen, qëndrimin në qetësi dhe për mënyrën e të folurit dhe për mënyrën e orientimit të njerëzve që në fillim të punës, për faktin se është njeri i mësuar, prandaj detyrimisht duhet të merret vetëm me studime, me mësimdhënie, njëkohësisht të mësojë edhe vetë. Njeriu i mësuar nuk thotë fjalë të gabuara e fjalë të kota pa vlerë dhe kur njeriu plotësohet, fillon të mendojë dhe të merret me organizim. Njeriu i mësuar e frenon gjuhën, që ajo të mos përmendë asnjë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, ose merret vetëm me punë që lidhen me të Lartin, derisa në zemrën e tij të vërshojnë rrjedhat e cilësive hyjnore dhe kur ekzistenca e tij të bëhet e vërtetë, njeriu ka siguri në punët e në fjalët e veta. Atëherë ai merret me edukim, me mësimdhënie dhe me orientimin e njerëzve. Një njeri i tillë nuk ka çast që të mos jetë në shërbim të njerëzve, derisa Allahu i Lartësuar të jetë i kënaqur prej tij. Allahu i Lartësuar bën që ai të jetë ndër robërit e Tij edukues dhe i vesh atij rrobën e mësimdhënies e të orientimit. Nëse në këtë njeri ka ndonjë mangësi në punët që u thanë më sipër, i Gjithëfuqishmi, në sajë të këtij shërbimi, ia plotëson edhe ato mangësi që mund të ketë.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: DËMET E FJALËVE TË KOTA, TË FJALËVE PA LIDHJE, TË MARRJES ME FJALË TË GABUARA E PA VLERË DHE TË FJALËVE QË NUK SJELLIN DOBI

Shpesh kemi përmendur lidhjen mes shpirtit e cilësive të brendshme me cilësitë e jashtme e me fuqitë shpirtërore dhe kemi shpjeguar se e jashtmja dhe e brendshmja ndikojnë te njëra-tjetra, në atë mënyrë që plotësimi i njërit lloj të cilësisë, ose mangësia në atë lloj të cilësisë, ose saktësia, ose prishja e atij lloji të cilësisë, vepron edhe mbi llojin tjetër të cilësisë.

Gjithashtu edhe shpirti i shëndoshë e i plotësuar e vë në dukje shëndetin e plotësimin e tij prej shpërthimit të fuqisë së cilësive. Ky ndikim i cilësive nga brenda-jashtë është aq i dukshëm, sa mund ta krahasojmë me ujin e kulluar që rrjedh prej lëfytit të kanës së ujit. Pikërisht lëfyti i kanës shëmbëllen lidhjen e të jashtmes me të brendshmen. Për këtë njofton Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij: **"قُلْ كُلٌّ يَعْمَلُ عَلَى شَاكِلَتِهِ"** *"Kul kul'lun jaëmelu alà shàkiletihi…"* **"Thuaj, secili vepron sipas rrugës së vet…"**[1]

Kështu edhe shpirti i sëmurë, shpirti me mangësi dhe i mposhtur prej vështirësive e prej mjerimit, ka rënë nën veprimin e djallit, ka humbur lumturinë e plotësimin me të cilin është krijuar dhe është mbuluar me llojet e mbulesave. Ky shpirt i mbuluar e jep ngjyrën e vet prej kanaleve të fuqisë së tij, që janë lidhja mes pasurisë dhe cilësive hyjnore. Kjo është ngjyra e djallit, e kundërt me ngjyrën e Allahut. Kjo ngjyrë e bën të jashtmen e

[1] Sure "El-Isra", ajeti 84.

fuqive të cilësive të këtij shpirti sipas formës që ai ka, ashtu si kana e ujit, në të cilën uji i hidhur e i kripur që nuk pihet, duket nga jashtë, edhe kjo dukje bëhet nëpërmjet vendkalimeve që kanë lidhje me kanën e ujit.

Shumë rrallë ndodh që e njëjta fuqi e shpirtit të jetë kompakte me shpirtëroren dhe me fuqinë ruajtëse të shpirtit të fuqishëm. Është kjo përputhje që e pengon çdo njeri të dijë e të mësojë sekretin e këtij shpirti të fuqishëm. Kjo kompaktësi e ruajtje është e ashpër dhe është në kundërshtim me natyrën. Por një ditë kjo lidhje patjetër do të ndërpritet, ose këtu në botën e tokës, ose në çastet e daljes së shpirtit prej gjendjes së tij të natyrshëm, ose ka më shumë mundësi të ndërpritet prej zemërimit të fuqishëm, ose në rastet më të pakta ndërprerja ndodh kur sunduese bëhen dëshirat.

Nëse moralet e tij shpirtërore nuk dalin në dukje në këtë botë për shkak të përputhjes së cilësive të brendshme me të jashtmet, ose për shkak të kompaktësisë, në Botën Tjetër, ditën kur të vërtetat do të bëhen të dallueshme qartë, ditën kur do të zbulohen sekretet, atëherë nuk do të jetë dominuese fuqia e shpirtit të ashpër e kompakt. Atë ditë ajo që ishte brenda, do të dalë jashtë dhe sekreti do të dalë sheshit, por jo me rrugën e rrjedhjes e të depërtimit, siç ishte në botën e tokës, por prej rrugës së shkakut e pasojës. Në atë ditë vullneti i shpirtit është unik në lidhjen. Për këtë të vërtetë njofton Allahu i Lartësuar:

"يَوْمَ يُكْشَفُ عَنْ سَاقٍ" *"Jeume jukshefu an sàkin…"* **"...dhe ditën kur çështja ashpërsohet në kulm…"**[1] dhe **"يَوْمَ تُبْلَى السَّرَآئِرُ"** *"Jeume tuble-s'seràiru"* **"...ditën kur do të gjurmohen të fshehtat."**[2]

Atje as qëndrueshmëria e as rezistenca e shpirtit nuk kanë mundësi të ndalojnë daljen në shesh. Në atë botë të gjitha cilësitë bëhen të dukshme dhe të gjitha sekretet dalin në shesh. Në atë ditë do të bëhen të dukshme të

[1] Sure "El-Kalem", ajeti 42.
[2] Sure "Et-Tarik", ajeti 9.

mirat e të këqijat dhe të gjitha cilësitë do të jenë të formësuar. Në atë ditë, Ditën e Kiametit do të bëhet realitet kopjimi e revoltimi i cilësive.

Ajo që thamë këtu ka lidhje me dispozitat e rrjedhjes të së brendshmes në drejtin të së jashtmes e të shpalljes sheshit, në sajë të kësaj lidhjeje, mes shpirtit dhe fuqive të jashtme, të gjitha punët dhe zhvillimet e dukshme lënë gjurmë në shpirt.

Në sajë të punëve të mira, të punëve të liga, punëve të këqija dhe punëve të bukura, bëhen të dukshme cilësitë e mira e të virtytshme, ashtu siç bëhen të dukshme edhe cilësitë e liga e të këqija, atje arrihet formësimi i të brendshmes dhe trualli i kopjimit të cilësive. Rruga e fitimit të cilësive të mira qëndron në studimin e shprehjeve të holla e të sekreteve që përmbajnë këto shprehje, në përsëritjen e frazave të ziqrit (përmendjes së Allahut) e në kryerjen e punëve të mira, krahas të menduarit. Pikërisht kjo është rruga që mundëson arritjen e cilësive të mira në shpirt e në brendinë e njeriut. Punët e këqija dhe punët e liga kanë ndikim shumë të ashpër në shpirt. Në shumicën e rasteve, punët e këqija janë në përputhje të plotë me kënaqësitë e me dëshirat, për rrjedhojë kah ato dëshira e kënaqësi priret zemra e orientohet shpirti. Prandaj në legjislacionet hyjnore punët e liga e punët e këqija janë të ndaluara në mënyrë të prerë, që do të thotë, heqje dorë prej të gjitha elementeve të natyrës. Por ndonjë individ, apo disa individë nuk janë të bindur me punët e mira dhe me frazat e ziqrit, prandaj ato duhen përsëritur për shkak se ndikimi i punëve të mira e i frazave të ziqrit në një shpirt të tillë është i ngadaltë dhe shumë i pakët, për shkak se kundërshtimi i dëshirave e i kënaqësive sjell te njeriu një mungesë dëshire e braktisje të punës së mirë. Pasoja e kësaj braktisjeje rezulton se për punën e mirë nuk ka as pranim të zemrës e as afrim të shpirtit. Prandaj ndikimi i këtyre faktorëve në shpirt e në brendësi, është shumë i pakët, po kështu edhe cilësitë vetjake të njeriut ndikohen fare pak prej faktorëve të lartpërmendur. Për ndikimin e këtyre faktorëve në shpirt janë vënë kushte e rregulla etike, disa prej të cilave ne i kemi përmendur në librin "Àdàbu-s'salàti".[1] Disa të tjera po i

[1] "Àdàbu-s'Salàti", K. 4.

trajtojmë në mënyrë të përgjithshme këtu gjatë shpjegimit të punëve të mira e punëve të këqija dhe gjatë shpjegimit të ndikimit të mirë e të keq.

Përsa u përket fjalëve të kota e të padobishme, fjalëve të këqija dhe fjalëve të papërshtatshme, duhet të dihet se ato janë tepër dëmtuese për gjendjen e shpirtit dhe hedhin për tokë pastërtinë e njeriut, e bëjnë atë të padobishëm, heqin prej tij paqen e brendshme, seriozitetin, sigurinë e qetësinë.

Nga ana tjetër, ato bëjnë që te njeriu të shfaqet vrazhdësia, zemërimi, ashpërsia, shkujdesja dhe braktisja e punëve të mira. Gjithashtu, fjalët e kota e fjalët e gabuara e largojnë njeriun nga përmendja e Allahut të Lartësuar dhe bëjnë që shpirti i tij të mos e shijojë as ëmbëlsinë e adhurimit e as ëmbëlsinë e përmendjes së Allahut, dobësojnë besimin e njeriut dhe bëjnë që besimi te njeriu të shuhet fare. Fjalët e kota dhe fjalët e gabuara bëjnë që zemra e njeriut të vdesë dhe e shtyjnë njeriun drejt shkarjeve, drejt gabimeve e drejt pendimit. Gjithashtu, fjalët e kota e fjalët e gabuara shkaktojnë neveri e përçarje mes miqve e shokëve, shkaktojnë armiqësi mes njerëzve dhe bëjnë që njeriu të ketë mendim të keq për të tjerët, për pasojë e ulin në syrin e të tjerëve, i heqin sigurinë e besimin që të tjerët kanë te ai dhe bëjnë që në syrin e njerëzve ai të duket njeri pa vlerë e pa asnjë peshë.

Shumë rrallë ndodh kur dikush që merret me fjalë të kota e me fjalë të gabuara, është i pafuqishëm të disiplinojë e të mbajë gjuhën në masën e një peshoreje të saktë dhe në të njëjtën kohë të qëndrojë i ruajtur prej mëkateve e prej fajeve, edhe pse gjatë gjithë jetës së tij vazhdon të jetë i kënaqur me fjalët boshe e me fjalët e gabuara.

Për të gjitha këto, për qetësinë dhe heshtjen, janë dhënë porosi të shumta.

NDARJA E TRETË

PËRMENDJA E VIRTYTEVE TË HESHTJES DHE TË METAT E FJALËVE TË KOTA ME RRUGËN E TEKSTIT

Transmetimet e nderuara, që trajtojnë çështjen e shtruar në këtë kapitull, janë aq shumë, sa nuk mund të futen në këtë përmbledhje, prandaj do të mjaftohemi të përmendim vetëm disa prej këtyre transmetimeve.

Në librin "El-Vesàil", prej "Kuvendeve" të shehut Et'tùsij *(paqja qoftë mbi të!)*, prej Ebu Dherrit, *(paqja qoftë mbi të!),* lexojmë disa prej porosive që i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* i la Ebu Dherrit: **"***O Ebu Dherr, shpallja e të mirës është më e mirë se heshtja dhe heshtja është më e mirë se shpallja e të keqes. O Ebu Dherr, lëri fjalët e tepërta dhe mjaftohu vetëm me aq fjalë sa duhen për të kryer nevojën që ti ke. O Ebu Dherr, burri e ka mjaft të gënjejë kur flet për të gjitha sa dëgjon. O Ebu Dherr asnjë send tjetër nuk meriton të qëndrojë më gjatë në burg se gjuha. O Ebu Dherr, në të vërtetë Allahu i Lartësuar është në gjuhën e çdo njeriu që flet, prandaj burri le të ketë frikë Allahun, prandaj duhet të dijë se për çfarë po flet."*[1]

Prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (paqja qoftë mbi të!) në "Nehxhul-Belàgah", lexojmë: "S'ka të mirë në heshtjen për diturinë, ashtu siç nuk ka të mirë në fjalën me injorancë."[2]

[1] "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 12, K. 118 prej kapitujve të "Ahkàmul-ushreti".
[2] "Nehxhul-Belàgah", "Fjalët e shkurtra", nr. 182.

"Ai që flet shumë, gabon shumë. Ai që gabon shumë, i pakësohet turpi, atij që i pakësohet turpi, i pakësohet frika prej Allahut, atij që i pakësohet frika prej Allahut, i vdes zemra dhe atij që i vdes zemra, ka hyrë në zjarr."[1]

"Gjuha është si egërsira e tërbuar kur shterpëzon."[2]

"Kur plotësohet mendja, pakësohet fjala."[3]

Në porosinë e Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* për djalin e tij, Muham'med bin El-hanefij'jfeh, lexojmë: *"Allahu i Gjithëfuqishëm s'ka krijuar gjë më të mirë e më të keqe se fjalën. Me fjalën zbardhen fytyrat dhe me fjalën nxihen fytyrat. Dije se fjala është në lidhësen tënde, derisa ti nuk flet për atë dhe, kur t'i të flasësh për të, atëherë ti bëhesh në lidhësen e fjalës. Prandaj depozitoje gjuhën tënde, ashtu siç depoziton floririn e argjendin tënd, sepse gjuha është qen i tërbuar. Nëse ti e le zgjidhur atë, ai tërbohet. Ndodh që një fjalë e vetme, heq një mirësi. Ai që nga pakujdesia ia zgjidh litarin vetes, kjo zgjidhje e çon në të gjitha punët e urryera, e çon në të gjitha skandalet dhe më pas ai kurrë nuk shpëton dot prej kohës së tij. Ai do të këtë dënimin e Allahut dhe poshtërimin e njerëzve."*[4]

"Ai që e ruan gjuhën e tij, Allahu atij i ruan nderin."[5]

Prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) lexojmë: "Mos flisni shumë pa përmendur Allahun, sepse fjalët e shumta, pa e përmendur Allahun, ashpërsojnë zemrën dhe, njeriu që është më larg prej Allahut, është ai me zemër të ashpër."*[6]

Në librin "El-Ihtixhàxh" të Et Tabrasij'j, prej Ali bin Hysenit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë përgjigjen e tij kur është pyetur për fjalën dhe për

[1] I njëjti burim i mëparshëm, "Urtësia" nr. 349.
[2] I njëjti burim i mërpashëm, "Urtësia" nr. 60.
[3] I njëjti burim i mëparshëm, "Urtësia" nr. 71.
[4] "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 12, K. 119 prej kapitujve të "Ahkamul-ushreti", Hadithi 15.
[5] I njëjti burim i mëparshëm, Hadithi 17.
[6] I njëjti burim i mëparshëm, Hadithi 19.

heshtjen, se cila prej këtyre të dyjave është më e mirë: *"Për çdo njërën prej këtyre të dyjave ka sëmundje dhe, kur këto të dyja janë pa sëmundje, atëherë fjala është më e mirë se heshtja."* E pyetën: "Si është kjo o nipi i të Dërguarit të Allahut?" Ai u përgjigj: *"Allahu Fuqiplotë nuk i ka dërguar profetët dhe eulijatë me heshtjen, por i ka dërguar ata me fjalën, as Xheneti nuk meritohet me heshtjen, as ndihma e Allahut nuk arrihet me heshtjen. Nuk ka mbrojtje prej zjarrit me heshtjen. Me heshtjen nuk largohet as zemërimi i Allahut. Të gjitha këto janë me fjalën."*[1]

[1] I njëjti burim i mëparshëm, K. 118, Hadithi 2; Et'tabresij, "El-Ihtixhàxh", vëll. 2, f. 146, Hadithi 184.

NDARJA E KATËRT

SHPJEGIMI: HESHTJA, NË KUPTIMIN E QËLLIMIT, NË KËTË HADITH ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE PREJ SHOQËRUESVE TË CILËSISË SË PASTËR TË KRIJIMIT FJALËT E KOTA E FJALËT PËRÇART JANË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS DHE PREJ CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Më sipër kemi përmendur se për njeriun ka dy cilësi krijimi, njëra është origjinale dhe që është cilësia e pastër e krijimit për plotësimin absolut dhe plotësimi Absolut është i Vërteti i Lartësuar; kurse cilësia tjetër është e varur, që është cilësia e neverisë prej mangësisë. Mangësi është çdo gjë tjetër përveç të Vërtetit të Lartësuar nga ana e barazisë dhe e tjetërsimit. Ajo që konstatohet në këto dy cilësi është se ato janë prej shoqëruesve të cilësisë së pastër të krijimit dhe të cilësisë së varur. Prej kësaj rezulton se heshtja për të gabuarën dhe për fjalët e për punët e kota, përmbajtja e vetes nga fjalët përçart e nga fjalët e kota e ndihmojnë njeriun të mendojë e të merret me të brendshmen.

Gjithashtu ndihmojnë në pastrimin prej turbullirave dhe që të dyja i afrohen fillimit të plotësimit, që është objekti i dashurisë së cilësisë së pastër

të brumit me të cilin është gatuar njeriu. Këto dy cilësi largojnë edhe ferrat prej rrugës. Nga kjo anë, heshtja është prej cilësisë së pastër të brumit me të cilin është krijuar njeriu, prandaj heshtja është prej ushtrive të mendjes dhe prej ushtrive të Gjithëmëshirshmit; kurse fjalët përçart, fjalët e kota, fjalët pa vlerë dhe fjalët e gabuara e largojnë njeriun prej plotësimit absolut dhe e afrojnë me natyrën e me ligjet e saj janë objekti i neverisë së cilësisë së krijimit dhe detyrimisht bëjnë që cilësia e krijimit të jetë e mbuluar prej fillimit të plotësimit.

Kur njeriu është i mbuluar në cilësinë e tij origjinale të krijimit dhe i bashkohet natyrës së shpresave të saj, te njeriu lind një dashuri e rreme për fjalët pa vlerë e për fjalët e gabuara, ashtu siç ndodh me të sëmurin që ka oreks për ushqime që e dëmtojnë. Kur kjo cilësi del prej mbulesës, atëherë njeriu e kupton se kjo dashuri e rreme për fjalët e kota është burimi për lidhjen me natyrën dhe në këtë gjendje bëhet burim për neverinë që ka cilësia e krijimit. Çdo gjë që është burim për neverinë e cilësisë së krijimit, përfshirë frazat e ziqrit (përmendjes së Allahut), meditimin, heshtjen, qëndrimin në vetmi, bëhet i dashur për cilësinë e krijimit.

QËLLIMI NJËZET E DY

NËNSHTRIMI, E KUNDËRTA, MENDJEMADHËSIA NË KËTË KAPITULL KEMI DY NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME NËNSHTRIMIN MENDJEMADHËSIA

Nga ana gjuhësore, fjala *nënshtrim,* në gjuhën arabe **"إِسْتِسْلاَم"** *"istislàm"* shpreh shfaqjen e bindjes, të përuljes e të adhurimit të të Vërtetit dhe të së vërtetës[1], kurse grupi emëror *mbajtja me të madh*, në gjuhën arabe **«إِسْتِكْبَار»** *«istikbàr"* do të thotë *rebelim, mosbindje, tirani e mendjemadhësi.*[2]

Duhet ditur se, kur zemra e njeriut është pa sëmundje e pa të meta, e gjen të Vërtetin në sajë të cilësisë së pastër të krijimit dhe, pasi e arrin këtë, i nënshtrohet plotësisht të Vërtetit dhe, kur i nënshtrohet, e ndjek Atë në punët e formësuara shabllone. Prej zemrës pa sëmundje arrihet dorëzimi

[1] Fjalori "Lisànul-arab", vëll. 6, f. 354.
[2] Fjalori "Lisànul-arab", vëll. 12, f. 13.

dhe prej dorëzimit të zemrës arrihet përulja e formësuar, pikërisht ky dorëzim e kjo përulje është nënshtrimi.

Kur zemra është me të meta dhe në të ka zënë vend sëmundja e admirimit të vetes e dashuria për veten, në atë zemër ka zënë vend mendjemadhësia, e cila është një gjendje shpirtërore, në të cilin njeriut i duket vetja se është i madh e model që e ndjekin të tjerët dhe, kur njeriu punon në përputhje me këtë gjendje shpirtërore, ai vepron hapur me mendjemadhësi ndaj robërve të Allahut.

Kësaj arrogance i thuhet krekosje dhe kur njeriu revoltohet, burimi i revoltimit të tij është pikërisht kjo mendjemadhësi shpirtërore, kurse mosbindjes e tiranisë i thuhet konsiderimi i vetes i madh, që është mosbindje e tirani e ardhur prej mendjemadhësisë. Por mendjemadhësia është cilësi e kundërt me nënshtrimin, që siç u tha më sipër, shpreh përuljen e formësuar që arrihet nga nënshtrimi i brendshëm. Por jo çdo përulje është nënshtrim dhe jo çdo mosbindje e tirani është konsiderim i vetes i madh.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: NËNSHTRIMI ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE MENDJEMADHËSIA ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS

Nga shpjegimi që pamë në ndarjen e mëparshme mësohet se nënshtrimi është prej shoqëruesve të cilësisë së pastër të brumit me të cilin është gatuar njeriu dhe se nënshtrimi është prej ushtrive të arsyes.

Gjithashtu mësohet se mendjemadhësia është prej shoqëruesve të cilësisë së mbuluar të krijimit dhe se është prej ushtrive të injorancës. Sikur njeriu të vihet në provë me cilësinë origjinale të krijimit, me cilësinë e krijimit pa sëmundje, kjo cilësi është prej dhuratave hyjnore dhe se kjo cilësi është origjina e cilësisë së brumit të pastër, me të cilën është krijuar ai njeri. Kur te njeriu nuk kanë hyrë sëmundjet e të metat vetjake, kur te ai nuk ka hyrë mbulimi e turbullira shpirtërore, patjetër që ky njeri e gjen të Vërtetin e Lartësuar, gjithashtu ky njeri e do të Vërtetin, domethënë se, kur cilësia e pastër e krijimit të tij është e shëndoshë, atëherë patjetër që arrihet nënshtrimi.

Në hadithin e ardhur prej Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë: *"Besimtarët janë të përpunueshëm me lehtësi, janë të butë. Nëse ata drejtohen, ndjekin rrugën që u tregohet. Nëse ndalen diku për të jetuar, ata përshtaten."*[1]

[1] "Bihàrul-Envàr", vëll. 64, Hadithi 58.

Cilësitë: i butë, njeri që drejtohet dhe i përshtatshëm para të Vërtetit, janë prej cilësive të besimtarëve. Besimtarët, edhe kur ngarkohen me detyrime, janë të përulur: *"Besimtarin kur ti e mashtron, mashtrohet."*

Në tërësi, cilësia e pastër e krijimit të njerëzve e pranon të Vërtetin, prandaj te njeriu arrihet ky nënshtrim. Por nëse cilësia e krijimit është e mbuluar, për rrjedhojë të kësaj cilësie të mbuluar të krijimit të tij njeriu është bërë i atillë që e admiron veten dhe do veten e tij, atëherë ai njeri ka rënë nën ndikimin e elementeve të natyrës, që janë neveri e largim prej të Vërtetit e prej të vërtetës, te ai njeri ka hyrë fortësia e ashpërsia. Ai e konsideron veten të madh dhe rezultati i kësaj është se ai ngrihet edhe kundër të Vërtetit.

Nga ky shpjegim mësohet se nënshtrimi është prej ushtrive të arsyes dhe të Gjithëmëshirshmit, se nënshtrimi është shoqërues i cilësisë së brumit të pastër, me të cilën është gatuar ky njeri, kurse mendjemadhësia është prej ushtrive të injorancës e të djallit dhe është shoqëruese i cilësisë së mbuluar të krijimit.

QËLLIMI NJËZET E TRE

DORËZIMI, E KUNDËRTA, DYSHIMI NË KËTË KAPITULL KEMI TRI NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME DORËZIMIN DHE ME DYSHIMIN

Nga qëllimi i mëparshëm u mësua se nënshtrimi shpreh përuljen e brendshme dhe besimin e zemrës në të Vërtetin e Lartësuar, kur njeriu është krejtësisht i shëndoshë nga të metat dhe është pa asnjë cilësi të keqe. Kur zemra është e shëndoshë, i dorëzohet të Vërtetit.

Përballë dorëzimit qëndron dyshimi e mosnënshtrimi ndaj të Vërtetit të Lartësuar. Mospranimi i të Vërtetit dhe mosdorëzimi te Ai konsiderohen prej mbulimit të shpirtit, prej të metave të brendshme dhe prej sëmundjeve të zemrës.

Disa studiues thonë se dyshimi është vënë përballë dorëzimit. Nuk është vënë mohimi, sepse puna e mendjes është gjykimi e vendimi i formës së prerë në të gjitha punët, por puna nuk është kështu në lidhje me shpirtrat

iluzionarë, të cilët vetëm dyshojnë. Qëllimi me dorëzimin është vërtetimi në të gjitha punët, prandaj përballë dorëzimit patjetër duhej vënë dyshimi.[1]

Megjithatë, kjo thënie nuk mund të përjashtohet prej diskutimit, sepse shpirtrat iluzionarë nuk dyshojnë në të gjitha sendet, në të kundërt, disa herë ato janë të vendosur, herë tjetër mohojnë e përgënjeshtrojnë dhe herë tjetër kundërpërgjigjen. Në të vërtetë, mosdorëzimi ndaj të Vërtetit të Lartësuar, në një farë mase është i shoqëruar me dyshimin dhe ka shumë mundësi që nga ky këndvështrim dyshimi është vënë kundrejt dorëzimit dhe patjetër qëllimi me dyshimin këtu është në kuptimin e kundërshtimit të asaj që dihet mirë, ashtu siç janë shprehur për këtë çështje gjuhëtarët më të mëdhenj[2] që do të thotë se, e kundërta e asaj që dihet mirë, është më e përgjithshme se dyshimi i njohur, sepse dyshimi është një gjendje ngurrimi.

[1] Sadrul Muteelihijne Esh'shijràzij, "Sherhu Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 450.

[2] Lexo fjalorin "Sihàhu-lugati", vëll. 4 dhe në fjalorin "Lisàul-arab".

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: DOBITË E DORËZIMIT

Dorëzimi është prej cilësive të mira të besimtarëve dhe në sajë të cilësisë së dorëzimit realizohet mbledhja e pozitave morale dhe e diturive hyjnore. Ai që është i dorëzuar te i Vërteti i Lartësuar e te miqtë e Tij dhe kurrë nuk thotë para tyre "si" e "përse", por ecën përpara sipas shembullit të tyre me një hap hyjnor, shumë shpejt e arrin qëllimin.

Në lidhje me dorëzimin, disa prej atyre që kanë arritur gradën e njohjes, kanë thënë: "Besimtarët janë më afër qëllimit të kërkuar se sa dijetarët, sepse besimtarët ecin në rrugën që kanë ecur profetët, ndërsa dijetarët ecin sipas mendimit e mendjes së tyre. Ai që i është dorëzuar udhëzimit hyjnor, arrin qëllimin e dëshiruar nëpërmjet rrugës së drejtë. Rruga e drejtë është rruga më e shkurtër është rruga në të cilën s'ka asnjë rrezik, kurse ai që ecën nga ta çojnë këmbët, ndodh që të bjerë në shkatërrim dhe të humbë rrugën.

Njeriu patjetër duhet të përpiqet seriozisht që të gjejë një mjek të aftë. Kur gjen një mjek të tillë, e ka zakon të thotë "si" e "përse" dhe nuk i dorëzohet këtij mjeku, por ka qëllim të mjekojë veten sipas mendjes së tij, prandaj ka shumë mundësi, që ai ta pësojë. Njeriu duhet të përpiqet të ecë në udhën hyjnore, por për këtë duhet të gjejë një udhëzues, që ta fusë në këtë rrugë.

Kur ai e gjen këtë udhëzues, atëherë patjetër duhet t'i dorëzohet atij dhe të ndjekë udhëzuesin, të ecë në udhën që ecën udhëzuesi, të ndjekë udhëzuesin në këtë rrugëtim dhe ta vërë këmbën në vendin ku e vë udhëzuesi. Ne që kemi gjetur udhëzues Profetin më të nderuar *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe e dimë që udhëzimi i tij çon në të gjitha dituritë, patjetër duhet ta ndjekim atë në sjelljet e tij hyjnore

pa "si" e pa "përse". Sikur të duam të dimë filozofinë e dispozitave me mendjet tona të mangëta, shumë shpejt do të devijojnë nga rruga e drejtë dhe, për rrjedhojë, do të biem në shkatërrimin e përjetshëm, do të jemi si i sëmuri që do të mësojë sekretin e recetës së mjekut dhe pastaj dëshiron të përfitojë prej ilaçit. Një i sëmurë i tillë kurrë nuk e shikon anën e shpëtimit, sepse, ndërsa mundohet të mësojë sekretin e recetës, koha e mjekimit ka kaluar dhe kështu ai e çon veten drejt shkatërrimit.

Ne të sëmurët, ne që kemi shkarë në rrugën e humbjes, patjetër duhet të zbatojmë ecjen në rrugën hyjnore dhe për sëmundjet e zemrave tona të ndjekim këshillat e udhëzuesve në rrugën e udhëzimit dhe të mjekëve të vetes e të shpirtrave tanë, pa vënë në punë mendimet tona të mangëta e opinionet tona të dobëta. Kjo është rruga që na çon drejt arritjes së qëllimit dhe kjo është arritja në sekretet e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi). Madje ky dorëzim pranë shenjtërisë hyjnore është prej terminologjisë së sëmundjes shpirtërore, por që i jep njeriut pastërti të plotë dhe ia shton dritën e brendshme nga dita në ditë. Në Kur'anin Famëlartë, në ajetin 65 të sures "En-Nisa", Allahu i Lartësuar thotë:

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا۟ فِىٓ أَنفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا۟ تَسْلِيمًا ﴿٦٥﴾

"Fela ue rab'bike là juëminùne hat'ta juhak'kimùke fijma shexhere bejnehum thum'me là jexhidù fij enfusihim harexhen mim'mà kadajte ue jusel'limu teslijmen"

"Betohem në zotin tënd, jo, ata nuk janë besimtarë derisa të zgjedhin ty për të gjykuar konfliktet që kanë mes tyre dhe pastaj (pas gjykimit tënd) **të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe të mos binden sinqerisht."**

Ushqimi i besimit arrin në shijen e shpirtit të njeriut, kur njeriu ia dorëzon veten dispozitave hyjnore, në atë mënyrë që nuk e ndien veten ngushtë, por i pret ato me fytyrë të qeshur dhe me gëzim.

Në një hadith të transmetuar në librin "El-Kàfij", prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Besimi (imani) ka katër kolona: mbështetja në Allahun, lënia e punës në dorën e Allahut, kënaqja me gjykimin e Allahut dhe dorëzimi ndaj urdhrit të Allahut të Gjithëfuqishëm."*

Ai që nuk i ka këto katër kolona, s'ka besim dhe nuk përfiton prej së vërtetës së besimit në Allahun e Lartësuar.

NDARJA E TRETË

SHPJEGIMI: DORËZIMI ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES E TË GJITHMËSHIRSHMIT DHE ËSHTË SHOQËRUES I CILËSISË SË PASTËR TË BRUMIT TË KRIJIMIT E KUNDËRTA E DORËZIMIT, DYSHIMI, ËSHTË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS DHE ËSHTË SHOQËRUES I CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Patjetër duhet të dihet se egoizmi, tirania në mendime dhe admirimi i vetes është në kundërshtim me cilësinë e pastër me të cilën Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun. Njeriu është krijuar me cilësinë e dashurisë për Allahun, me besimin se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi), është krijuar me cilësinë për t'iu drejtuar vetëm Allahut dhe ndien neveri nëse i drejtohet ndonjë tjetri përveç të Lartit.

Kur cilësia e krijimit te njeriu është në gjendjen e saj origjinale dhe nuk është e mbuluar me mbulesat e natyrës, kurrë nuk do të përdoret tirania në mendimin dhe kapja pas natyrës në punët, nuk do të përdoret as ngjyra shpirtërore, por ka vetëm dorëzim ndaj të Vërtetit.

Me anën e cilësisë së pastër të krijimit, zemra e tij është si një pasqyrë e ndritshme, e cila është kthyer në drejtim të të Vërtetit dhe çdo send prej botës së panjohur në atë zemër gdhendet pa asnjë shtesë, pa asgjë mangët e pa asnjë veprim. Ajo zemër i dorëzohet prurjeve të panjohura deri në plotësimin e saj dhe dorëzimi zë vend në brendësi të kësaj zemre. Në këtë gjendje mbase për të arrihet gjendja e fshirjes absolute, për rrjedhojë njeriu bie në gjendje alivanie dhe goditet nga një gjendje shokimi të përgjithshme.

Kjo gjendje mund të realizohet në sajë të një kujdesi të veçantë mëshire, kur Allahu i Lartësuar e ka bërë këtë njeri prej atyre që kërkojnë dashurinë dhe kur njeriu është jashtë rrugës së egoizmit e jashtë rrugës së unit dhe, në sajë të shokimit absolut, e çon atë në shkëlqim e në tërheqje. Një gjendje e tillë u arrit për Musain, biseduesin me Allahun *(paqja qoftë mbi të!).* Për këtë gjendje njofton Allahu i Lartësuar: **" فَلَمَّا تَجَلَّى رَبُّهُ لِلْجَبَلِ جَعَلَهُ دَكّاً وَخَرَّ مُوسَى صَعِقاً"** *"…felem'mà texhel'là rab'buhù lilxhebeli xhealehù dek'ken ue harr'rre Mùsà saikan…"* **"…dhe kur madhështia e Zotit të tij shkëlqeu mbi malin, Ai e thërrmoi malin dhe Musai u shtri për tokë i alivanosur…"**[1]

Kur mangësitë gjenden, ato lartësohen me anën e këtyre shkëlqimeve të të Gjithëmëshirshmit, që arrihen prej kujdesit të veçantë hyjnor. Padyshim që kjo pozitë është shumë më e lartë se dorëzimi dhe ashtu siç është shumë e qartë, kjo pozitë arrihet vetëm në sajë të mbështetjes te Allahu dhe pranimit me kënaqësi të vendimit të Allahut. E kundërta e dorëzimit është dyshimi, në kuptimin e përgjithshëm që ka fjala dyshim, përfshirë në këtë kuptim *mosbesimin, përgënjeshtrimin dhe mohimin* dhe siç është shpjeguar më sipër, dyshimi është prej ushtrive të injorancës dhe është në kundërshtim me pastërtinë e cilësisë së krijimit. Gjithashtu kemi thënë se shkaku i dyshimit është mbulimi i cilësisë së krijimit me mbulesat e natyrës, të egoizmit, të pavarësisë së mendimit, kapjes pas natyrës e dashurisë për veten. Të gjitha këto janë në kundërshtim me cilësinë hyjnore të krijimit.

[1] Sure "El-Araf", ajeti 143.

Këtu është rasti të ndriçojmë këto faqe me një hadith të ardhur prej pjesëtarëve të ruajtur prej gabimeve të shtëpisë ku është shpallur shpallja.

Në librin "El-Kàfij" transmetohet sipas përcjelljes së Sufjan bin Uajneh, i cili tregon se e ka pyetur Imam Sadikun *(paqja qoftë mbi të!)* për fjalën e të Gjithëfuqishmit:

"إِلاَّ مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيْمٍ" *"Il'là men ete-ll'llàhe bikalbin selijmin"* **"Përveç atij që vjen te Allahu me zemër të shëndoshë."**[1]

"Zemra e shëndoshë është zemra në të cilën s'ka asgjë tjetër përveç Atij. Në çdo zemër që ka idhujtari ose dyshim, ajo zemër është e degjeneruar dhe, në të vërtetë me përkohshmërinë në këtë botë qëllimi është që zemrat e tyre të tyre të zbrazen për Botën Tjetër."[2]

Grupi emëror *zemër e shëndoshë* shpreh zemrën në të cilën s'ka asgjë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, shpreh zemrën e pastër prej idhujtarisë e prej dyshimit. Heqja dorë prej kësaj bote është prej porosive tepër të larta të miqve të Allahut, në kuptimin që zemrat zbrazen prej kësaj bote dhe përgatiten për Botën Tjetër. Këto zemra të zbrazura, në të vërtetë, janë prej pozitave të takimit me Allahun. Madje të gjitha legjislacionet, të gjitha fetë, dispozitat, moralet, bashkëpunimet e ndërsjella, fillimet, mbarimet e ushtrimet, të gjitha janë në rrugën e përgatitjes për të arritur takimin me Allahun. Ky është qëllimi origjinal prej të gjitha sendeve, kurse dorëzimi në të vërtetën e tij të plotë është garantues me të gjitha këto kuptime.

Të gjitha llojet e idhujtarisë e të dyshimeve e kanë burimin në mosdorëzimin e shpirtit të njeriut ndaj kujdestarit absolut. Ky kujdestar absolut është i Vërteti i Lartësuar.

Kur dorëzohet shpirti, dorëzohen të gjitha mbretëritë e ekzistencës, pastaj dorëzohen të gjitha gjymtyrët e dukshme, gjithashtu dorëzohen edhe fuqitë e mbretërisë. Dorëzimi i këtyre fuqive do të thotë që ai shpirt ose egoizmi i tij s'ka lëvizje e as qetësi, gjithashtu edhe marrja e atij shpirti ose lënia për një kohë të caktuar, janë të nënshtruara ndaj vullnetit të të Vërtetit

[1] Sure "Esh-Shuara", ajeti 89.

[2] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-Ikhlàs", Hadithi 5.

të Lartësuar. Me këtë arrihet një model i afrimit të përgjithshëm: *"Unë isha veshi i tij, me të cilin ai dëgjon dhe syri i tij, me cilin ai sheh."*[1]

Përballë dorëzimit absolut qëndron lëkundja e dyshimi. Dyshimi ka disa shkallë. Disa prej këtyre shkallëve janë *dyshim i dukshëm*, *dyshim i fshehtë* dhe *dyshim shumë i fshehtë*.

Dyshimi i dukshëm është tronditja e besimeve të ndritura të dukshme dhe *dyshimi i fshehtë* është lëkundja e diturive, lëkundja e sekreteve të besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi), lëkundja e zhveshjes dhe e bërjes Një, kurse *dyshimi më i fshehtë* është gjendja e llojeve të shumta të ngjyrosjes dhe pamundësia për të qenë në pozitat e përmendura.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Men àdhel-muslimijne ue ihtikàruhum" , Hadithet 7-8.

QËLLIMI NJËZET E KATËRT

DURIMI, E KUNDËRTA, HUMBJA E DURIMIT NË KËTË KAPITULL KEMI PESË NDARJE

NDARJA E PARË

QËLLIMI ME DURIMIN DHE ME HUMBJEN E DURIMIT

Për durimin ka disa përkufizime, por ne do të mjaftohemi me përmendjen e disa prej tyre. Studiuesi, njohësi, Havàxheh El-Ensàrij, ka thënë: "Durimi është përmbajtja e vetes për të mos u ankuar nga humbja e durimit."[1]

Durimi shpreh zotërimin e vetes për të mos u ankuar, krahas faktit se në brendësi durimi ka humbur. Gjithashtu durimi shpreh mosshfaqjen e humbjes së durimit të brendshëm e mosankimin prej punëve që shkaktojnë dhimbje në shpirt. Këto dy përkufizime shprehin durimin.

Gjithashtu, durimin e ka përkufizuar edhe dijetari i madh Et'tùsij *(paqja qoftë mbi të!)* me fjalë të përafërta me përkufizimin e mësipërm.[2]

---

[1] Kemaludijn Abdurr'rrez'zàk El-Kàshànij, "Sherhu Menàzlu-s'sàirijne", f. 195-196.

[2] Studiuesi Et'tùsij, "Eusàul-Eëshràf", K. "Es'sabru".

Durimi vihet në vijë të drejtë me dy punë: njëra është pasja e një neverie të brendshme për pësimet që i bien njeriut dhe puna tjetër është frenimi për të mos shfaqur ankesën e humbjen e durimit.

Shehu, njohësi, Abdurr'rrez'zàk El-Kàshànij, ka thënë: "Qëllimi me ankesën është paraqitja e ankesës te dikush dhe jo te i Vërteti. Përsa i përket ankimit te i Vërteti, ky ankim nuk është në kundërshtim me pozitën e durimit. Edhe Profeti Ejub *(paqja qoftë mbi të!)* iu ankua Allahut kur tha: **"أَنِّي مَسَّنِيَ الشَّيْطَانُ بِنُصْبٍ وَعَذَابٍ"** *"…en'nij mes'senije-sh'shejtànu binusbin ue adhàbin…"* **"…djalli më ka goditur me mundim e me dhimbje."**[1]

Megjithëkëtë, Allahu i Lartësuar, në të drejtën e Profetit Ejub, tha: **"إِنَّهُ أَوَّابٌ إِنَّا وَجَدْنَاهُ صَابِراً نِعْمَ الْعَبْدُ"** *"…in'nà vexhednàhu sàbiren, niëmel-abdu in'nehù ev'vàbun"* **"…Ne e gjetëm atë** (Ejubin) **të durueshëm. Sa rob i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti."**[2]

Në një hadith lexojmë se *Imam Bakiri (paqja qoftë mbi të!) kur ishte fëmijë, ka pyetur Xhaàbir bin Abdullah el Ensàrij: "Në cilën gjendje je më mirë?"*

Ai tha: *"Kur jam në gjendje varfërie. Kjo gjendje për mua është shumë më e dashur se kur jam në gjendje të kamur; edhe sëmundja për mua është shumë e dashur se shëndeti; gjithashtu edhe vdekja për mua është shumë më e dashur se jeta. Përsa na përket ne të Ehli Bejtit, gjendjet që na vijnë prej Allahut, si: varfëri, pasuri, sëmundje, shëndet, vdekje e lindje, të gjitha janë shumë të dashura për ne."*[3]

Mbase Xhabiri nuk ishte i sigurt në veten e tij dhe mendonte se nuk do të zotëronte dot veten në gjendje shëndeti, paqe, pasurie e fuqie. Me zemrën e tij ai nuk e pranon këtë botë dhe as nuk shkon të gjejë strehë në këtë fshat të errët. Nga kjo anë, ai tha ato që tha, por pozita e të qënit mik i Allahut, është një pozitë në të cilën të gjitha të ardhurat janë nën sundimin e

[1] Sure "Sad", ajeti 41.

[2] Sure "Sad", ajeti 44.

[3] "Xhàmiu-s'seàdàt", vëll. 3, f. 285.

tij. Sikur një miku të Allahut t'i jepej e gjitha pasuria e kësaj bote, ose të merrte prej kësaj bote të gjitha sendet, në zemrën e tij kjo s'do të kishte asnjë ndikim dhe asnjë send i kësaj bote nuk do të mund ta ndryshonte atë.

Në përgjithësi, durimi, me gradën e lartpërmendur, është prej pozitave të mesatarëve, kurse durimi me të cilin janë përshkruar eulijatë e plotësuar, është durimi i pozitave të larta, për të cilin do të flitet në vijim, ose është durimi për dhembjet trupore, të cilat detyrimisht bëjnë që në karakteret njerëzore të ketë ndikim prej tyre.

NDARJA E DYTË

SHPJEGIMI: GRADËT E DURIMIT

Gradët e durimit janë shumë dhe ne do t'i përmendim ato në ndarjen vijuese. Këtu do të përmendim disa gradë të durimit që përputhen me gradët e përmendura në hadithin vijues. Nga kjo anë, kjo ndarje do të jetë si një shpjegim për hadithin.

Në librin "El-Kàfij", me përcjellës deri te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: **"***Durimi është tri kategori: durimi në pësim, durimi në adhurimet dhe durimi para mëkatit. Kush duron në raste pësimi, derisa të largojë pësimin me ngushëllimet e mira, Allahu shkruan për atë treqind gradë dhe largësia nga njëra gradë në gradën tjetër është sa largësia mes qiellit e tokës. Kush duron në adhurimet, Allahu shkruan për të gjashtëqind gradë dhe largësia nga njëra gradë në gradën tjetrën është sa largësia mes kufijve të tokës deri në Arsh. Kush duron para mëkatit, Allahu shkruan për të nëntëqind gradë dhe largësia nga njëra gradë në gradën tjetër është sa largësia mes kufirit të tokës deri në fundin e Arshit."*[1]

Prej këtij hadithi të nderuar mësohen tri gradët e durimit, që janë parimet e durimit dhe prej esencave të durimit të mesatarëve.

Grada e parë, është durimi në raste pësimesh e vështirësish. Në të tilla gjendje njeriu e zotëron veten, as nuk ankohet e as nuk e humb durimin para njerëzve, kurse humbja e durimit para Krijuesit, për njerëzit e zakonshëm nuk është e metë, por është qortim për dijetarët, sepse humbja e durimit e ngurtëson njeriun.

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Es'sabru", Hadithi 15.

Humbja e durimit është tundim e vënie në dukje e vetes, por humbja e durimit te ata që kanë arritur gradën e njohjes është prej delikteve më të mëdha.[1] Hadithi i nderuar shpjegon se, për durimin në raste pësimesh, ka treqind gradë prej shpërblimit dhe se largësia nga njëra gradë në gradën tjetër është sa largësia mes qiellit e tokës.

Grada e dytë, është durimi në adhurimet. Kjo gradë e durimit tregon gjendjen kur njeriu është në bindje të të Vërtetit të Lartësuar. Në këtë gjendje njeriu e zotëron veten dhe vetja nuk ia merr njeriut frerët nga dora, që pastaj të lëshohet me të katra. Lëshimi i frerëve në mënyrë të përgjithshme është në dy pozita dhe durimi në njërën prej këtyre dy pozitave është shumë më i vështirë se në pozitën tjetër.

Pozita e parë, durimi i njeriut në këtë pozitë është më i lehtë, konkretisht është shkujdesje e plotë në lënien e adhurimeve. Prandaj durimi në këtë fazë shpreh rezistencën ndaj vetes e ndaj djallit, shpreh kryerjen e detyrave hyjnore në kuadrin e kufijve ligjorë të këtyre adhurimeve dhe edukatës së zemrës për kryerjen e adhurimeve. Në të vërtetë, kjo është prej çështjeve të mbarsura me probleme, të cilat ne i kemi shpjeguar në kumtesën: "Àdàbu-s'salàti"–"Etika e faljes së namazit".

Në këtë kumtesë janë shpjeguar fare pak rregulla prej edukatës e kushteve për kryerjen e adhurimeve dhe në veçanti në lidhje me faljen e namazit.

Pozita e dytë: në këtë pozitë, durimi është shumë i vështirë, është lëshimi i frerëve pas kryerjes së adhurimeve. Në këtë pozitë zotëruese është vetja, domethënë se në kryerjen e punës e në plotësimin e kushteve të punës, gjithashtu edhe në kushtet e dukshme e të brendshme të punës, njeriu nuk i ka frerët në dorën e tij dhe për këtë shkak ai vihet në provë me admirimin e vetes, me mendjemadhësinë dhe me derivatet e të ngjashmeve me këto dy vese të këqija. Mbase njeriu i bën thirrje për ndihmë djallit dhe shpirtit lakmues për punë të lavdëruara, për morale të lavdëruara dhe për ndjekjen e ligjit të pastër të fesë gjatë shumë viteve, me shpresën që të vihet

[1] El-Kàshànij, "Sherhu Menàzili-s'sàirijne", f. 198.

në provë me admirimin e vetes dhe me dashurinë për veten. Por në këto shpresa ai rezulton dështak, pavarësisht nga vështirësitë që kalon e nga ushtrimet.

Joshja e diturive, e punëve, dashuria për veten e admirimi i vetes, janë prej faktorëve shkatërrues që e tërheqin njeriun drejt gjendjeve të këqija e vështirësive të mëdha. Nëse njeriu nuk mban veten nën kontroll dhe nëse nuk e vazhdon kontrollin në shkallën e plotësuar, ashtu siç vepron një mjek i aftë dhe një infermier zemërdhembshur me të sëmurin, nëse ai nuk i diagnostikon të metat shpirtërore, adhurimet dhe punët e mira të dukshme, shumë shpejt do të shkatërrohet dhe ato do të jenë shkaku i dështimit të tij. Prej punëve më të vështira është zotërimi i vetes e mbajtja e vetes nën kontroll, në një mënyrë të mjaftueshme, në atë mënyrë që njeriu nuk do të lëkundet. Patjetër që njeriu duhet të kërkojë mbrojtje prej Allahut të lartësuar dhe të kërkojë përforcime vetëm prej Tij. Në disa raste, kurthet e vetes e të djallit janë aq të holla, sa gati është e pamundur të zbulohen, por natyrisht që ato zbulohen në sajë të ndihmës e të mbarësisë prej Allahut të Lartësuar. Durimi në adhurimet ka shtatëqind gradë dhe largësia mes një grade e një grade tjetër është sa largësia mes kufijve të tokës deri në Arsh. Kjo gradë e durimit qëndron sipër gradës së parë jo vetëm nga ana numerike e gradëve, por edhe nga ana e madhësisë dhe e gjerësisë së gradëve, sepse largësia mes një grade e një grade tjetër është sa largësia mes kufirit të tokës e Arshit.

Për durimin në adhurimet ka edhe pozita të tjera, që në këtë hadith nuk janë shpalosur, por që do t'i shikojmë kur të zgjerojmë rrethin e adhurimeve dhe të kalojmë në të vërtetat e në sekretet e besimit se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi).

Në këtë mënyrë, shpërblimi për të durueshmin nuk hyn në peshoren e gradëve, pasi ato janë shumë të mëdha janë të shumta si numër dhe janë larg prej sheshit të shenjtërisë së Tij, prandaj, në lidhje me shpërblimin e të durueshmit, është bërë garant vetë Allahu i Lartësuar, ose shpërblimi i tij është vetë Allahu, ashtu siç thuhet për të durueshmit se ata nuk shikojnë

Xhenetet e mirësitë tyre.[1] Zemra e shëndoshë është zemra në të cilën s'ka asnjë të adhuruar tjetër përveç Allahut. Në zemrën e shëndoshë, përveç Allahut, nuk është asgjë prej asaj bote, që është bota e daljes në shesh të cilësive dhe të sekreteve të zemrës.

Ka shumë mundësi që edhe ajetet e nderuara:

يَـٰٓأَيَّتُهَا ٱلنَّفْسُ ٱلْمُطْمَئِنَّةُ ﴿٢٧﴾ ٱرْجِعِىٓ إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ﴿٢٨﴾ فَٱدْخُلِى فِى عِبَـٰدِى ﴿٢٩﴾ وَٱدْخُلِى جَنَّتِى

"Ja ej'juhe-n'nefsul-mutmein'netu. Irxhi'ij ilà rab'biki ràdijeten merdijeten. Fedkhulij fij ibàdij. Uedkhulij xhen'netij"

"O ti shpirt i bindur plotësisht. Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar. Hyr në grupin e robërve të Mi. Dhe hyr në Xhen'netin Tim."[2] të theksojnë pozitën e atyre personave të plotësuar që janë prej eulijave. Në këto ajete të nderuara njeriut me shpirt të bindur plotësisht i flitet drejtpërdrejt që të kthehet të Zoti i tij, të kthehet te i Vërteti i Lartësuar, pa ngjyrën e emrave; kurse qenia e shpirtit i vetëkënaqur e i pranuar, është tërheqja e dashuruesit ndaj të dashurit, është anija në rrugëtimin për te Allahu, është rezultati i hyrjes në grupin e robërve të Allahut është krejtësisht e pastër nga ngjyrimet, është e cilësuar me të vërtetën e me sinqeritetin dhe fryti është hyrja në Xhenetin e Tij, në Xhenetin e takimit.

Grada e tretë, është durimi para mëkatit, në kuptimin se njeriu bën durim në luftën me veten e tij dhe me ushtritë e Iblijsit. Me qëndrime të drejta e me vendosmëri, njeriu i mposht ushtritë e Iblijsit. Për këtë gradë ka pozita, të vërteta, shprehje të holla e të shumta. Durimi në secilën gradë të kësaj pozite është më i vështirë dhe më i hollësishëm në adhurimet. Nëse dikush do të shpëtojë prej kësaj vorbulle, atëherë durimi në adhurimet për

[1] Tregon për transmetimet që flasin për adhurimin e njerëzve të lirë.
[2] Sure "El-Fexhr", ajetet 27-30.

atë do të jetë më i thjeshtë e më i lehtë. Prandaj puna më e rëndësishme për atë që ka marrë rrugën për te Allahu është durimi para mëkatit.

Gjithashtu edhe durimi për të luftuar fuqitë e dëshirës, të zemërimit e djallëzitë, që janë burimi i mëkateve të dukshme, është prej punëve më të rënda për njeriun dhe përballimi me durim i këtyre fuqive, është shumë më i vështirë se durimi në adhurimet e dukshme, për shembull qëndrimi përballë djallit e vetes është shumë i madh, sepse djalli e vetja janë fillimi i mëkateve të zemrës dhe i mëkateve të brendshme, prandaj durimi në luftën kundër mëkateve të zemrës e mëkateve të brendshme është prej punëve më të vështira, sepse në këtë luftë patjetër duhen shtruar dy qeniet dhe duhen refuzuar të dy burimet. Për atë që ka marrë rrugën për te Allahu, patjetër duhet të vërë këmbën mbi kokën e vet dhe të hedhë për tokë idhullin më të madh të vetes, të rrëzojë egoizmin prej piedestalit në zemrën e tij me dorën e kujdestarisë.

Njeriu patjetër duhet të thyejë këtë idhull, që të hyjë në të vërtetat e sinqeritetit, si dhe të lejohet për të hyrë në sekretet e sinqeritetit. Por, e gjitha kjo nuk mund të jetë një punë e lehtë pa përforcimet hyjnore dhe pa konsolidimin prej Allahut të Lartësuar. Durimi para mëkatit ka nëntëqind gradë dhe largësia nga njëra gradë në gradën tjetër është sa largësia mes kufirit të tokës dhe fundit të Arshit. Gradët e kësaj pozite të durimit janë më shumë se gradat e mëparshme si numër dhe si madhësi, sepse ndarësi në këto gradë është deri në fundin e Arshit.

Gjithashtu, për durimin para mëkateve ka të vërteta e sekrete që nuk hyjnë në peshoren e gradëve dhe të gjerësive fizike, pasi këto gradë janë vetë durimi, i cili patjetër duhet të jetë prej pozitave shpirtërore dhe prej diturive hyjnore.

Këtu duhet të shtojmë edhe një fjalë: Allahu i Lartësuar e ka përshkruar gjerësinë e Xheneteve sa largësia mes qiejve e tokës. Në këtë hadith, për të durueshmit janë përmendur gradë, gjerësia e çdo grade është më shumë se largësia mes qiellit e tokës. Pikërisht këtu në mendjen e autorit del njëra prej dy punëve:

E para: qëllimi me Xhenetin e përmendur në Kur'anin Famëlartë është Xheneti i punëve dhe për të cilin njofton Allahu i Lartësuar se ai:

"أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِيْنَ" *"…uid'det lilmut'tekijne"* **"…është përgatitur për të devotshmit."**[1]

Në një ajet tjetër njofton: **"أُعِدَّتْ لِلَّذِيْنَ آمَنُوا"** *"…uid'det lil'ledhijne àmenù…"* **"…është përgatitur për besimtarët…"**[2]

Por edhe përgatitja është punë e Xhenetit të punëve. Përsa i përket qëllimit me gradët e përmendura në këtë hadith të nderuar, janë gradë të Xhenetit të moraleve, duke i konsideruar se ato janë gradët e durimit, por durimi është prej moraleve, për rrjedhojë gjerësia e Xhenetit të moraleve është sipas masës së plotësimit të njeriut në shkallën e mesme dhe s'ka mundësi që për këtë shkallë të vihet një kufi.

E dyta, qëllimi me qiejt e tokën, në Kur'anin Famëlartë, është më i përgjithshëm se qiejt e toka nga ana fizike, pasi me këtë largësi përfshihen edhe qiejt e shpirtrave dhe tokat e hijeve, kurse përsa i përket gradëve të përmendura në transmetimin e nderuar, gradët e Xhen'netit janë për Xhenetin fizik.

[1] Sure "Al- Imran", ajeti 133.

[2] Sure "El-Hadid", ajeti 21.

NDARJA E TRETË

DISA GRADË TË DURIMIT TË VEÇANTË TË RRUGËTUESVE PËR TE ALLAHU DHE TË EULIJAVE

Tregohet se një i ri prej të dashuruarve, e ka pyetur Esh'shiblij për durimin, se cili durim është më i rëndë. Ai i tha: "A është durimi për Allahun?"

Esh'shiblij tha: "Jo.

Ai tha: "A është durimi me Allahun?"

Esh'shiblij tha: "Jo."

Ai tha: "A është durimi mbi Allahun?"

Esh'shiblij i tha: "Jo."

Ai tha: "A është durimi në Allahun?"

Esh'shiblij tha: "Jo."

Ai përsëri e pyeti: "A është durimi me Allahun?"

Esh'shiblij tha: "Jo."

Këtu i riu, i tha: "Ore i mjerë!"

Atëherë Esh'shiblij iu përgjigj: "Është durimi prej Allahut."

Esh'shiblij u ngashërye aq shumë, sa u alivanos."[1]

Dhe tani është detyra jonë të shpjegojmë në përgjithësi këto gradë të durimit, të përmendura në paragrafin e mësipërm:

Durimi për Allahun është prej pozitave të rrugëtarëve për te Allahu, atyre që e kanë zhveshur veten e shpresat e tyre vetjake dhe kanë emigruar për te Allahu. Çdo punë që ata e bëjnë në këtë zhveshje është vetëm për Allahun dhe jo për veten e tyre. Por derisa njeriu vazhdon të jetë nën rrobën e vetes e të mbulimit shpirtëror, të gjitha lëvizjet e tij, të gjitha pushimet e tij, të gjitha vendet ku kryhen ritet fetare dhe të gjitha adhurimet e tij, i bën për veten e tij. Në të gjitha këto ai vetëm i kërkon të Vërtetit. Gjithashtu, edhe me besimin e tij se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi) dhe me bindjen e tij, përsëri edhe këtë ai e bën për veten e tij.

Derisa njeriu vazhdon të jetë në shtëpinë e vetes, edhe hapat që ai hedh në ecjen drejt të brendshmes së tij, nuk janë hapa të hedhura në rrugën e emigrimit për te Allahu, nuk janë as hapat e një udhëtari e as hapat e një rrugëtari për te Allahu. Ecja e tij është si ecja brenda qytetit, që nuk mund të quhet udhëtim, pavarësisht se ai ecën në të gjitha anët e qytetit, apo të vendbanimit të tij.

Derisa nuk ka ndodhur dalja prej shtëpisë së vetes dhe prej shtëpisë së egoizmit, nuk është realizuar as udhëtimi e as emigrimi për te Allahu. Te ata që kanë arritur gradën e njohjes, të gjitha ushtrimet e këtij personi janë të gabuara dhe vetëm kur të bëhet realitet dalja prej shtëpisë së vetes dhe prej shtëpisë së egoizmit, atëherë ai është rrugëtar për te Allahu. Pikërisht në këtë pozitë durimi është për Allahun.

Durimi me Allahun ka dy pozita: njëra prej të cilave është e qëndrueshme në rrugëtarin dhe pozita tjetër është për ata që janë zgjuar pas

[1] El-Meula Abdu-rr'rrez'zàk El-Kàshànij, "Sherhu Menàzilu-s'sàirijne", K. "Es'sabru".

fshirjes. Qëllimi këtu është pozita e parë, e cila tregon se rrugëtari, pasi del prej shtëpisë dhe fillon të emigrojë për te Allahu, dëshmon se të gjitha lëvizjet e të gjitha pushimet e tij janë me fuqinë e me forcën e Allahut dhe se ai, në këtë punë, s'ka asnjë rol. Atëherë ai e sheh durimin e tij sikur të gjitha sendet janë për atë me Allahun dhe ky nuk është as besim e as argumentim, por është shikim i drejtpërdrejtë me sy, sepse besimi e argumentimi kanë të bëjnë me ata që janë të mbuluar.

Përsa i përket pozitës së dytë, është pozita e atyre që janë zgjuar. Kjo pozitë vjen, pasi rrugëtimet janë palosur njëra mbi tjetrën dhe rrugëtari ka përfunduar në asgjësimin e plotë e në fshirjen absolute. Atëherë ky rrugëtar, në sajë të kujdesit të të Vërtetit, kthehet në mbretërinë e Tij, për t'i dhënë përforcime të pafuqishmëve. Në këtë pozitë, ekzistenca e tij dhe punët e tij trupore bëhen të vërteta dhe të gjitha lëvizjet e pushimet e tij, në këtë pozitë, janë me Allahun, domethënë janë me Ekzistencën e vërtetë.

Në këtë pozitë ai është syri i Allahut, është veshi i Allahut dhe është dora e Allahut: *"...mbi mua është syri i Allahut, veshi i Allahut dhe dora e Allahut."*[1]

Përsa i përket durimit mbi Allahun, ky është durimi pas stabilizimit në këtë pozitë, domethënë në pozitën e durimit me Allahun, në kuptimin e parë. Në këtë pozitë njeriu e sheh veten të pastër prej kushtëzimeve të veprimeve dhe të zhveshur prej veprimeve. Gjithashtu, ai sheh se të ardhurat janë prej të Vërtetit të Lartësuar dhe kurrë nuk sheh në veten e tij, ose në botën ndonjë veprues tjetër përveç Allahut, atëherë durimi i tij është mbi Allahun, gjithashtu ai sheh se të gjitha sprovat e vështirësitë janë shkëlqime të emrave dhe të cilësive. Edhe të mbuluarit durojnë sprovat, durojnë mbi Allahun, durojnë mbi punët e Tij të emrave dhe të vetë qenies së Tij.

[1] Tregon atë që ka thënë Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!):* "Unë jam syri i Allahut, unë jam dora e Allahut, unë jam pranë Allahut dhe unë jam porta e Allahut."; "Usùlul-Kàfij", vëll. 1, f. 113, prej kapitujve të "Et'teuhijd", Hadithi 8.

Përsa i përket durimit në Allahun, ky durim është i veçantë për ata që kanë arritur praninë dhe kanë parë bukurinë e emrave. Në këto pamje e në këto shkëlqime, ata durojnë gjithnjë e më shumë dhe ruajnë zemrën e tyre gjithnjë e më shumë prej konsumimit e prej zhdukjes, ky është durim në Allahun.

Kurse durimi me Allahun për ata që kanë parë bukurinë e Qenies, për ata që kanë dalë prej pozitës së shikimit të bukurisë së emrave dhe kanë arritur pozitën e shikimit të Qenies. Në këtë pozitë ata durojnë gjithnjë e më shumë dhe e zotërojnë veten e tyre gjithnjë e më shumë. Ky është durim me Allahun.

Pas kësaj pozite, pozitës së konsumimit e të zhdukjes, ku nuk ekziston as emri i rrugëtarit e as fotografia e tij, nuk ekziston as durimi e as rrugëtimi.

Durimi prej Allahut, ky është durimi i të dashuruarve e i të mbuluarve prej bukurisë, të cilët, pasi kthehen në mbretërinë e tyre, duhet të bëjnë durim, sepse ata janë të mbuluar prej bukurisë së më të Bukurit për t'iu bindur Atij. Pikërisht kjo është pozita më e vështirë e durimit dhe ka shumë mundësi të jetë njëri prej kuptimeve të frazës: *"...asnjë profet nuk është lënduar ashtu siç jam lënduar unë."*[1] sepse , sa më shumë të shtohet, ky shtim i dashurisë kërkon që durimi prej ndarjes të jetë edhe më shumë, ashtu siç ka thënë Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!): "...më dhurove mua dhe unë durova ndëshkimin Tënd. Por si do të duroj ndarjen prej Teje?"*[2]

Por duart tona, duart janë të shkurtra, që të shtrihen deri në degët e pozitave të nderuara të eulijave, prandaj nuk duhet shtuar asnjë fjalë më shumë se kaq.

[1] Biàrul-Envàr", vëll. 39, K. 73, Hadithi 15.

[2] "Ikbàlul-A'màl". Autori Es'sej'jid Tàùs në lutjen e Kumejlit.

NDARJA E KATËRT

SHPJEGIMI: DURIMI ËSHTË PREJ USHTRIVE TË ARSYES DHE PREJ SHOQËRUESVE TË CILËSISË SË PASTËR TË BRUMIT, ME TË CILIN ËSHTË GATUAR NJERIU PADURIMI E MOSMBAJTJA E BARRËS JANË PREJ USHTRIVE TË INJORANCËS DHE JANË SHOQËRUESE TË CILËSISË SË MBULUAR TË KRIJIMIT

Mëso se njeriu është krijuar me cilësinë e pastër të dashurisë për plotësimin e bukurisë, me dashurinë për Allahun dhe me dashurinë për t'u orientuar te Allahu i Lartësuar. Çdo gjë që i vjen njeriut është prej Allahut edhe, nëse sipas natyrës ajo është e papërshtatshme për njeriun. Prandaj njeriu ka detyrë të mos e shfaqë padurimin dhe ta konsiderojë mangësi padurimin për ato që atij i vijnë prej Allahut të Lartësuar. Kur njeriu mbulohet me mbulesën e dashurisë për veten e me mbulesën e dashurisë për natyrën, në zemrën e tij bëhet sunduese papastërtia e admirimit të vetes dhe e dashurisë për veten e tij, atëherë njeriu bëhet i padurueshëm prej të ardhurave dhe është i padurueshëm edhe për shkak të humbjeve të kërkesave të natyrës.

Kurse njeriu shpirtëror, me natyrën origjinale të krijimit të tij të dhuruar prej Allahut të Lartësuar, bën durim dhe është i vendosur në të gjitha sendet, ai nuk është pa fre, fuqia e shpirtit të tij është zotëruese mbi kërkesat e natyrshme. Ai nuk trazohet e nuk turbullohet prej ndodhive, sepse është i çliruar prej dashurisë për këtë botë dhe prej dashurisë për veten. As humbja e këtyre të dyjave nuk e bën atë të turbullohet, sepse të gjitha shkarjet e kanë burimin prej dashurisë për këtë botë dhe prej dashurisë për veten. Fillimi bazë i mbulimit është vetëmbulimi me mbulesat e kësaj bote dhe me mbulesat e vetes. Prandaj edhe mbulesa e errët që ka ardhur në hadithin e nderuar është mbulesa e kësaj bote dhe mbulesa e vetes.[1]

Cilësia e krijimit që mbulon plotësimin absolut, kur mbulohet me mbulesat e kësaj bote dhe me mbulesat e vetes, e mendon plotësimin në kërkesat natyrale e të vetes, prandaj njeriu ka frikë, turbullohet e trazohet nga humbja e këtyre kërkesave. Por kur cilësia e krijimit del jashtë këtyre mbulesave dhe prej çdo gjëje që nuk është në përshtatje me të, atëherë njeriu ka frikë nga humbja që nuk do të arrijë të Dashurin dhe është i padurueshëm nga ndarja prej të Dashurit të vërtetë. Atëherë durimi i tij është durim prej Allahut. Ky durim është prej punëve më të vështira dhe vetëm Allahu është udhëzuesi në rrugën e drejtë.

[1] Lexo në librin "Bihàrul-Envàr", vëll. 55, Libri: "Es'semàu uel-àlemu", K. 5, Hadithet 3-5.

NDARJA E PESTË

SHPJEGIMI I HADITHEVE NË KËTË KAPITULL

Në librin "El-Kàfij", prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: **"***një grup njerëzish, Ditën e Kiametit do të vijnë te porta e Xhen'netit dhe do të trokasin. Atyre u thuhet: "Cilët jeni ju?"*

Ata përgjigjen: *"Ne jemi të durueshmit."* Atyre u thuhet: *"Për çfarë bëtë durim?"* Ata përgjigjen: *"Ne bëmë durim në bindje të Allahut dhe bëmë durim për të mos kundërshtuar Allahun."*

Atëherë Allahu i Lartësuar thotë: *"Ata thanë të vërtetën, futini në Xhenet. Kjo vërtetohet nga fjala e të Gjithëfuqishmit: "…të durueshmëve u jepet shpërblimi pa masë."*[1][2]

Prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Durimi është dy, durimi në mëkatin, që është i mirë e i bukur. Por më i mirë se ky durim është durimi kur Allahu Fuqiplotë të ka privuar ty."*[3]

Prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kur babait tim Al bin Husenit (paqja qoftë mbi të!) iu afrua vdekja, ai më shtrëngoi në gjoksin e tij e më tha: "O bir, të porosis me ato fjalë që më porositi babai im, kur iu afrua vdekja, të porosis me ato fjalë që edhe atë e kishte porositur i ati. O bir, të porosis: 'Bëj durim në të vërtetën, edhe nëse ajo është e hidhur."*[4]

---

[1] Sure "Ez-Zumer", ajeti 10.

[2] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Et'tà'atu uet'takvà", Hadithi 4

[3] I njëjti burim, vëll. 2, Hadithi 11.

[4] I njëjti burim, vëll. 2, Hadithi 13.

Prej Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Duroni në këtë botë, e cila në të vërtetë është vetëm një orë dhe nga ajo që ka kaluar prej kësaj kohe, ti nuk do të gjesh për atë as dhimbje e as gëzim, derisa ajo nuk ka ardhur dhe ti nuk e di, pasi, në të vërtetë, është vetëm ora jote, në të cilën ti erdhe në këtë botë. Prandaj duro në këtë botë në bindje të Allahut dhe duro në këtë botë që të mos i kundërshtosh urdhrat e Allahut."*[1]

Në lidhje me shpërblimin e punëve, prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Unë do të bëj durim prej këtij shërbëtorit tim dhe prej familjes sime, edhe atë që është më e hidhur se kungulli i egër. Ai që bën durim, arrin, me durimin e tij, një gradë prej gradëve të agjëruesit dhe ai që fal namaz, arrin edhe një gradë prej gradëve të dëshmorit, i cili është goditur me shpatë para këmbëve të Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!"*[2]

Prej "Nehxhul-Belàh" citojmë se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"I duruari nuk mbetet pa fitore, edhe pse koha do të zgjatet. Atë që nuk e shpëton durimi, e shkatërron padurimi."*[3]

Njoftimet e transmetimet që flasin për këtë çështje janë më shumë nga sa mund të futen në këtë përmbledhje.

[1] "Usulul-Kàfij", vël. 2, Hadithi 4.

[2] "Vesàilu-sh'shij'ati", vëll. 15, K. 25 prej kapitujve të "Xhihàdu-n'nefsi", Hadithi 5.

[3] "Nehxhul-Belàgah", K. "El-hukmu", 189.

QËLLIMI NJËZET E PESË

FALJA, E KUNDËRTA, HAKMARRJA NË KËTË KAPITULL KEMI DY NDARJE

NDARJA E PARË

SHPJEGIMI: FRUTAT E FALJES DHE DËMET E HAKMARRJES

Prej plotësimeve më të mëdha njerëzore është falja prej njeriut e personave që i kanë bërë atij keq. Cilësia e faljes është prej cilësive të bukurisë së të Vërtetit të Lartësuar dhe cilësimi me cilësinë e faljes është i ngjashëm me parimet e larta. Kush bie në edukimin e Zotit të botëve dhe bëhet i edukuar për të Vërtetin e Lartësuar, në atë njeri patjetër duhet të shkëlqejnë cilësitë e bukurisë së të Vërtetit të Lartësuar. Ai bëhet pasqyrë për bukurinë më të bukur hyjnore dhe për cilësitë më të mëdha të cilësive të të Vërtetit: mëshirë ndaj njerëzve, kalimi i të këqijave dhe falja e gabimeve të tyre.

Kur njeriu nuk i ka këto cilësi, ai kurrë nuk do të ketë mundësi t'i përgjigjet pyetjeve në varr dhe, dihet se në varr është koha e daljes në shesh të sekreteve. Prandaj kur ai do të pyetet prej Zotit të tij, nuk do të ketë mundësi të thotë: **"Allahu është Zoti im!"**

Në të vërtetë, përzgjedhja e këtij emri ndër emrat e tjerë, ka shumë mundësi të tregojë edukuesin te i cili ti je edukuar dhe fuqia e cilës dorë ka vepruar në ty në jetën e kësaj bote.

Kur njeriu është edukuar nën hijen e edukatës së Qenies të Shenjtë, me këtë edukatë është edukuar e jashtmja dhe e brendshmja e tij dhe ai ka mundësi të përgjigjet. Ndryshe ai ose nuk përgjigjet, ose ka më shumë mundësi të thotë: "Zoti im është djalli!", ose të thotë: "Zoti im ishte shpirti lakmues!"

Njeriu patjetër duhet të dijë se rrënja e faljes dhe e tolerancës vaditet prej heqjes dorë nga dashuria për këtë botë e nga dashuria për veten. Gjithashtu edhe rrënja e hakmarrjes dhe e zemërimit nuk janë në vendin e vet, pikërisht ky është objektivi në këtë qëllim, që të mësohet se edhe rrënja e hakmarrjes dhe e zemërimit vaditet prej dashurisë për këtë botë, prej dashurisë për veten dhe prej interesimit shumë të madh për përfitimet në këtë botë.

Prej këtij shpjegimi u mësua se falja është prej ushtrive të mendjes dhe ushtrive të Gjithëmëshirshmit është prej shoqërueseve të cilësisë së patër të brumit, me të cilin është gatuar njeriu.

Gjithashtu u mësua se kundërta e faljes është hakmarrja, e cila është prej ushtrive të injorancës e ushtrive të Iblijsit dhe se hakmarrja është prej shoqërueseve të cilësisë së mbuluar të krijimit. Ata që janë në cilësinë origjinale të krijimit të tyre, padyshim që janë të qëndrueshëm me cilësinë e pastër shpirtërore me të cilën janë krijuar, ata janë të pastër prej ndotjeve nga dashuria për këtë botë e nga dashuria për veten, ata janë të zhveshur prej vlimit të tërbuar, që është prej veçantive të shpirtit bishë.

Përsa u përket të mbuluarve me mbulesat e natyrës, ata janë të shqetësuar me shpresat vetjake dhe me kërkesat natyrore. Ata hidhen si të tërbuar mbi cofëtinën e tyre dhe përdorin fuqinë e zemërimit jashtë kuadrit të saj, gjithashtu përdorin edhe mjete që i ka dhënë Allahu i Lartësuar për të shpëtuar prej kurthit të kësaj bote e prej kurthit të natyrës, ata i përdorin për të rënë në shpirtin e ndyrë, të prirur për të keqen.

NDARJA E DYTË

PËRMENDJA E DISA HADITHEVE TË NDERUARA QË FLASIN PËR FALJEN

Në librin "El-Kàfij", me përcjellës prej Ebu Abdullahut, Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Kini detyrë të falni, sepse falja shton vetëm madhështi, prandaj falni që t'ju madhështojë Allahu!"*[1]

Prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Pendimi për faljen është shumë më i mirë e shumë më i lehtë se pendimi për dënimin."*[2]

Në "Nehxhul-Belàgah", prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë*: "Kur ke fuqi mbi armikun tënd, bëje faljen falënderim për fuqinë që ke mbi atë."*[3]

"Më i lavdëruari i njerëzve për faljen është ai që ka më shumë fuqi për të dënuar."[4]

Në librin "El-Kàfij", me përcjellës prej Ebu Abdullahut, Imam Sadikut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!),* në një hytbe ka thënë: *"A doni t'ju njoftoj për më të mirën e krijesave të kësaj bote dhe të Botës Tjetër? Falja për atë që të ka bërë padrejtësi, mbajtja e lidhjeve me atë që i ka shkëputur lidhjet me ty, bamirësia ndaj atij që të ka bërë keq dhe dhënia atij që nuk të ka dhënë ty?"*[5]

---

[1] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-afvu" – "Falja", Hadithi 5

[2] "Usùlul-Kàfij", vël. 2, K. "El-afvu" – "Falja", Hadithi 6.

[3] "Nehxhul-Belàgah", Gjykimi 11.

[4] "Nehxhul-Belàgah", Gjykimi 52.

[5] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "El-afvu", Hadithi 1.

Prej Muha'med bin Ali bin Husejn, me përcjellës prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë porosinë që i la Muham'med bin El-Hanefij'jeh: *"Vëllai yt, që i ka prerë lidhjet me ty, kurrë të mos jetë më i fuqishëm se ti për mbajtjen e lidhjeve me atë dhe për të keqen që ai të ka bërë, kurrë të mos jetë ai më fuqishëm për bamirësinë ndaj tij."*[1]

Hadithet e nderuara që flasin për faljen e atij që të ka bërë padrejtësi dhe për frenimin e zemërimit janë të shumta. Nga hadithet e nderuara që flasin për frenimin e zemërimit, përmendim:

Në librin "El-Kàfij", prej Imam Sexh'xhàdit, Imam Zejnel-Abidijni *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai që dëshiron të marrë rrugën për te Allahu, gëlltit dy gjëra: zemërimin ai e spraps me butësi dhe pësimin e spraps me durim."*[2]

Prej Imam Bakirit *(paqja qoftë mbi të!)* lexojmë: *"Kush e frenon zemërimin kur ka fuqi ta vërë në zbatim, Ditën e Gjykimit Allahu ia mbush atij zemrën me siguri e besim."*[3]

Prej Muhamed bin Ali bin Husen lexojmë: "Prej fjalëve të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* është edhe: *"Ai që e frenon zemërimin, atë e shpërblen Allahu dhe ai që duron në humbjen, atë e kompenson Allahu."*[4]

Me përcjellës prej Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut *(paqja qoftë mbi të!)* prej të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!)* lexojmë cfarë i ka thënë Aliut: *"O Ali, të lë një porosi të cilën duhet ta mbash në mendje: do të vazhdosh me të mira derisa do të mbash në mendje porosinë time: o Ali, ai që e frenon zemërimin kur ka mundësi ta vërë në zbatim, pas këtij frenimi, Allahu i jep atij siguri e besim dhe ai e gjen shijen e kësaj sigurie e të këtij besimi…"*[5]

---

[1] "Men là jahduruhul-fekijhu", vëll. 4, Hadithi 10.

[2] "Usùlul-Kàfij", vël. 2, K. "Kedhmul-gajdhi", Hadithi 9

[3] "Usùlul-Kàfij", vëll. 2, K. "Kedhmul-gajdhi", Hadithi 7.

[4] "Men là jahduruhul-fekijhu", vëll. 4, Hadithi 828.

[5] "Men là jahduruhul-fekijhu", vëll. 4, Hadithi 821.

Këtë pozitë dhe këtë pjesë të shpjegimit të haditheve e përfunduam. Plotësimin, me dashjen e Allahut, do ta bëjmë në një vëllimin tjetër.

I lutem Allahut të Lartësuar të bëjë mbarë cilësimin dhe realizimin e pajisjes me ushtritë e mendjes, të na ruajë e të na pastrojë prej ushtrive të djallit e të injorancës.

Falënderimi e lavdërimi, fillim e mbarim, nga jashtë e nga brenda, janë vetëm për Allahun e Lartësuar.

Ky vëllim u plotësua ditën e dytë të muajit Ramazan, të vitit 1363 të Hixhretit, në qytetin Mehal'làt, kur unë udhëtova për në këtë qytet prej Kumit, për shkak të nxehtësisë së stinës së verës.

Es Selamu alejkum!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Imam Khomeini, lider i paharrua....4
Parathënia e përkthyesit në gjuhën arabe....10
Parathënie....12
Artikulli i parë: Citimi i hadithit të nderuar....19
Artikulli i dytë: Shpjegimi i së vërtetës së mendjes e injorancës....25
Artikulli i tretë: Disa cilësi të dy të vërtetave, mendjes e injorancës....29
Shpjegimi i cilësive të injorancës....36
Orientim tjetër në kuptimin e fjalës "uxhàxh"....38
Urtësi hyjnore....39
Artikulli i katërt....43
Vënia përpara e mendjes dhe vënia e saj parapa....45
Kujtesë e nderuar dhe realizim i këndshëm....50
Fjala e hollë e njohjes dhe e vërteta e besimit....55
Artikulli i pestë: Shpjegim përmbledhës i disa fjalëve të hadithit....61
Shprehje e hollë....66
Artikulli i gjashtë: shpjegimi i disa ushtrive të mendjes e të injorancës....77
Qëllimi i parë: shpjegimi i të mirës dhe i së keqes....77
Qëllimi i të mirës dhe i së keqes....77
Qartësimi i qëllimit dhe shpjegimi i tij....80
Domosdoshmëria e përmirësimit të shpirtit....86
Qëllimi i dytë: Sqarimi i besimit dhe i mosbesimit....91
Sqarimi e plotësimi i kësaj kërkese....93
Vërtetimi i këtij qëllim me argument transmetues....96
Shjegimi: Besimi është në përputhje të plotë me natyrën e pastër....103
Në rrugën e arritjes së besimit....109
Plotësim....110

Qëllimi i tretë: Vërtetimi dhe mohimi.....120
Ndreqja e shpirtit prej mohimit.....126
Qëllimi i katërt: shpresa, e kundërta e saj, humbja e shpresës.....136
Shpjegim: Dallimi midis shpresës e joshjes.....139
Shpjegim: Dallimi mes frikës, që është prej ushtrive të mendjes e të mëshirëplotit dhe prejes së shpresës, që është prej ushtrive të injorancës e të djallit.....145
Mënyra e bashkimit të frikës me shpresën.....151
Qëllimi i pestë: Drejtësia dhe padrejtësia.....155
Drejtësia e padrejtësia në librat e moralit.....160
Mbi arritjen e virtytit të drejtësisë.....163
Qëllimimi i gjashtë: Kënaqësia dhe zemërimi.....171
Shpjegimi: Kënaqësia është prej ushtrive të mendjes, kurse zemërimi është prej ushtrive të injorancës.....174
Shpjegimi i shkallëve të kënaqësisë.....177
Parimet e pozitës së kënaqësisë.....181
Shpjegimi: Vënia në provë e besimtarëve.....184
Shpjegimi: Merita e kënaqësisë dhe qortimi i zemërimit në hadithe.....187
Qëllimi i shtatë: Falënderimi dhe mosmirënjohja.....191
Ç'kuptojmë me falënderim?.....191
Shkallët e falënderimit.....193
Falënderimi është prej ushtrive të mendjes dhe mosmirënjohja është prej ushtrive të injorancës.....197
Citimi i disa haditheve të nderuara që flasin për falënderimin.....202
Qëllimi i tetë: Dëshira dhe humbja e shpresës.....205
Ndikimi i dëshirës, i humbjes së shpresës.....208
Qëllimi i nëntë: Mbështetja dhe e kundërta e saj, dëshira e zjarrtë.....212
Kolonat "mbështetejes".....214
Analiza e këtij kapitulli dhe këshilla e dijetarëve.....223
Njohja e disa gradëve e shkallëve të *"mbështetjes*".....230

Shpjegimi: "tevek'kul" është prej ushtrive të mendjes.....234
Lavdërimi i mbështetejes te Allahu dhe qortimi i dëshirës në hadithe.....237
Plotësim.....245
Qëllimi i dhjetë e i njëmbëdhjetë: Dhembshuria e mëshira dhe e kundërta e këtyre të dyjave, ashpërsia e zemrimi.....249
Shpjegimi: Ndikimi i dhembshurisë.....252
Dallimi midis ashpërsisë dhe zemërimit.....258
Dhembshuria është prej prej ushtrive të mendjes.....261
Frytet e fuqisë së zemërimit.....264
Anormaliteti i fuqisë së zemërimit.....268
Përmendja e disa haditheve të nderuara që flasin për këtë çeshtje.....271
Kujtesë e shkurtër për mjekimin e zemërimit.....276
Mjekimi i zemërimit bëhet në gjendje qetësie shpirtërore.....279
Qëllimi i dymbëdhjetë: Dituria, e kundërta, injoranca.....284
Dituria është virtyti më i bukur.....287
Dituria është prej ushtrive të mendjes injoranca është prej të iblijsit.....290
Kujtesë në lidhje me disa mirësi të diturisë në hadithe.....292
Qëllimi i trembëdhjetë: Kuptimi, e kundërta, idiotësia.....295
Në lidhje me komentimin e këtij qëllimi dhe këshillës në këtë kapitull.....299
Kuptimi është prej ushtrive të mendjes idiotësia është prej ushtrive të injorancës.....303
Qëllimi i katërmbëdhjetë: Dëlirësia, e kundërta e saj, poshtërsia.....306
Plotësim.....308
Shpjegim: Frytet e fuqisë së dëshirave.....309
Shpjegim: Ndikimi i punëve në zemër.....311
Këshillë për përmirësimin e shpirtit.....316
Disa transmetime për mirësinë e virtytit.....320
Qëllimi i pesëmbëdhjetë:përkorja, e kundërta, dëshira.....323
Shkallët dhe gradat e përkorjes.....325
Shpjegim: Pozita e përkorjes në rapoart me sjelljen njerëzore.....328

Shpjegim: Dëshira për këtë botë sjell mbulimin prej të Vërtetit të Lartësuar.....331
Shpjegim: Përkorja është prej natyrës së pastër të krijimit dhe prej shoqërueseve të cilësisë së brumit me të cilin është gatuar njeriu kurse dëshira është prej shoqëruesëve të mbulimit të natyrës së krijimit.....333
Citimi i argumenteve tekst.....336
Qëllimi i gjashtëmbëdhjetë: Sjellja e butë, e kundërta, brutaliteti.....345
Shpjegimi: Ndikimi i sjelljes së butë në punët e njeriut.....347
Shpjegimi: Sjellja e butë dhe zemërgjërëisa janë prej ushtrive të mendjes brutaliteti e dhuna janë prej ushtrive të injorancës.....351
Disa njoftime të nderuara që flasin për këtë çeshtje dhe shpjegimi i këtyre njoftimeve.....353
Qëllimi i shtatëmbëdhjetë: Tmerrimi, e kundërta, guximi.....358
Shpjegimi: Shkallët e ndryshme të frikës.....360
Shpjegimi: Tmerri e frika janë prej ushtrive të mendjes guximi është prej ushtrive të injorancës e të djallit.....363
Qëllimi i tetëmbëdhjetë: Modestia, e kundërta, mendjemadhësia.....366
Shpjegimi: Shkallët e modestisë e të mburrjes.....368
Zemra e gjerë dhe zemra e ngushtë.....371
Këshillë në këtë kapitull.....374
Disa hadithe të nderuara që flasin për këtë çështje.....382
Disa hadithe të nderuara që flasin për mendjemadhësinë.....386
Shpjegimi: Modestia është prej ushtrive të mendjes mendjemadhësia është prej ushtrive të injorancës.....389
Qëllimi i nëntëmbëdhjetë: Maturia, e kundërta e saj, nxitimi.....392
Shpjegimi: Qëllimi me maturinë e nxitimin.....394
Shpjegimi: Maturia e qëndrueshmëria janë prej ushtrive të mendjes. Nxitimi e paqëndrueshmëria janë prej ushtrive të injorancës.....398
Qëllimi i njëzetë: Mençuria, e kundërta, mendjelehtësia.....403
Shpjegimi: Frutet e fuqisë së zemërimit.....405

Shpjegimi: Rreziqet e devijimit të fuqisë së zemërimit.....408
Shpjegimi: Mjekimi i zemërimit në gjendjen e shpërthimit.....414
Mjekimi bazë i mendjelehtësisë e i zemërimit ekstrem me shkaqet që sollën ndezjen e tij.....416
Shpjegimi: Arritja e cilësisë së mençurisë.....419
Përmendja e virtyteve të mençurisë në hadithe.....422
Qëllimi njëzet e një: Heshtja, e kundërta, fjalët e kota.....426
Shpjegimi: dëmet e fjalëve të kota, të fjalëve pa lidhje, të marrjes me fjalë të gabuara e pa vlerë dhe të fjalëve që nuk sjellin dobi.....430
Përmendja e virtyteve të heshtjes dhe të metat e fjalëve të kota me rrugën e tekstit.....434
Shpjegimi: Heshtja, në kuptimin e qëllimit, në këtë hadith është prej ushtrive të mendjes dhe fjalët e kota e fjalët përçart janë prej ushtrive të injorancës.....437
Qëllimi njëzet e dy: Nënshtrimi, e kundërta, mendjemadhësia.....439
Shpjegimi: Nënshtrimi është prej ushtrive të mendjes dhe mendjemadhësia është prej ushtrive të injorancës.....441
Qëllimi njëzet e tre: Dorëzimi, e kundërta, dyshimi.....443
Shpjegimi: Dobitë e dorëzimit.....445
Shpjegimi: Dorëzimi është prej ushtrive të mendjes e kundërta e dorëzimit, dyshimi, është prej ushtrive të injorancës.....448
Qëllimi njëzet e katërt: Durimi, e kundërta, humbja e durimit.....452
Shpjegimi: Gradët e durimit.....455
Disa gradë të durimit të veçantë të rrugëtuesve për te Allahu.....461
Shpjegimi: Durimi është prej ushtrive të mendjes dhe padurimi është prej ushtrive të injorancës.....465
Shpjegimi i haditheve në këtë kapitull.....467
Qëllimi njëzet e pesë: Falja, e kundërta, hakmarrja.....469
Përmendja e disa haditheve të nderuara që flasin për faljen.....471

الامام الخمینی (قدس)

جنود العقل و الجهل

الترجمة الى اللغة الألبانية: الحاج سليم اصطافى

تيرانا: 2016

نام کتاب: **جنود العقل و الجهل**

نویسنده: **الامام الخمینی (قدس)**

ترجمه با زبان آلبانی: **الحاج سلیم اصطافی**

زیر نظر: **شیخ ولنت (عباس) مریا**

ویرایش: **یریدا کولا**

مقابله: **سونیلا کاظمی**

صحافی: **صبریه فزا**

طراحی جلد: **صبریه فزا**

ناشر: جمعیت "**نسیم**"

چاپ اول: 1000 نسخه

چاپ: انتشارات "لیلو"

این کتاب با همکاری مرکز بین المللی تبلیغ منتشر گردد